

# ENVER HOXHA

VEPRA

54



**PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT  
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE  
SHQIPERISE**



ENVER HOXHA



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

# ENVER HOXHA

V E L L I M I

54

DHJETOR 1974 – MAJ 1975.

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»  
TIRANË, 1937



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 54-T

*Materialet e këtij vëllimi, një pjesë e të cilave botohen për herë të parë, janë shkruar gjatë periudhës dhjetor 1974 - maj 1975. Është koha kur populli, me komunistët në krye, vazhdonte t'i bënte ballë me sukses situatës së rëndë që krijuan armiqtë në disa sektorë të ideologjisë e në ushtri. Por Partia dhe udhëheqësi i saj e i popullit, i paharruari Enver Hoxha, në veprimtari të koordinuar të grupeve komplotiste zbuluan e demaskuan edhe punën sabotuese në ekonomi të Abdyl Këllezit, Koço Theodhosit e kompani. Analizat e thella dhe të hollësishme, si dhe udhëzimet konstruktive që përmban ky vëllim, hapën horizonte të gjera për punën e Partisë dhe mobilizuan komunistët e punonjësit për ndreqjen e gabimeve dhe shëndoshjen e gjendjes.*

*Në shkrimet e kësaj periudhe shquhet kujdesi i veçantë për forcimin e stabilitetit ekonomik të vendit. Masave punonjëse u kërkohet të rritin më tepër aktivitetin, që zhvillimi ynë të ecë me ritmet e parashikuara. Orientimi drejt një lufte të përditshme për planifikim, drejtim e administrim shkencor, kryekëput në kundërshtim me çka teorizonin «kokat e ekonomisë», shpreh synimin e lartë të udhëheqësit për ngritjen e nivelit të jetesës së popullit. Ai porositi që kjo rritje të bëhet gati*

njësoj për të gjithë, sidomos për fshatin, por pa krijuar shtresa të favorizuarish e të borgjezuarish.

Shoku Enver Hoxha ndalet gjatë te problemi i mprehtë i naftës. Nëpërmjet studimit, bisedave me kuaadro të Partisë e me specialistë, ballafaqimit të mendimeve që shfaqeshin, ai njohu mirë gjendjen në këtë sektor nevralgjik, nxori shkaqet e vërteta të mosrealizimeve dhe përcaktoi rrugët më efektive për plotësimin e detyrave. Që në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ më 26 dhjetor 1974, udhëheqësi i Partisë shfaqti shqetësimin dhe dha sinjalin që do të çonte në zbulimin e në likuidimin e veprimtarisë armiqësore në sektorin e naftës. Veçanërisht materialet e muajit shkurt 1975 përmbajnë kritika të rrepta lidhur me organizimin shkel e shko të punëve atje. Duke goditur me forcë gabimet dhe fajet e disa drejtuesve, që nga Komisioni i Planit të Shtetit deri tek Instituti i Naftës, autori në vëllim orienton të rritet kudo kërkesa e llogarisë. Ai thekson nevojën e mbështetjes gjerësisht te punëtorët naftëtarë, të cilët i këshillon jo vetëm të forcojnë disiplinën shkencore e teknike në punë, të përvetësojnë e të praktikojnë metoda më të përparuara në kërkimin e naftës e të gazit dhe të përdorin sa më mirë mjetet për të realizuar planin, por edhe të mbajnë lart vigjilencën, sepse «në naftë na kanë sulmuar kurdoherë armiqtë».

Në kushtet kur duhej të riparoheshin konsekuencat e veprimtarisë armiqësore e të çoheshin punët përpara, shoku Enver Hoxha i kushtoi kujdes të posaçëm forcimit të rolit udhëheqës të Partisë. Diskutimet në mbledhje të Byrosë Politike e të Sekretariatit të KQ, që për-

fshihen në këtë vëllim, përçojnë, midis të tjerash, idenë e rëndësishme të zhvendosjes së qendrës së gravitetit të punës së Partisë nga byrotë në plenumë. Ato tërheqin vëmendjen për të luftuar konceptin krejtësisht të gabuar e të dëmshëm, sipas të cilit «Partia janë vetëm aparatet dhe udhëheqja». Duke shpjeguar se Partia përbëhet nga masa e madhe dhe e organizuar e tërë komunistëve; udhëheqësi i saj thekson se është e domosdoshme që ata të drejtojnë kudo. Ky mësim i kundërvihet prirjes së dominimit në organizatën-bazë të disa kuadrove kryesorë, të cilëve, nënvizon shoku Enver Hoxha, s'u lejohet të bëjnë ligjin mbi Partinë, por Partia e klasa të ushtrojnë pushtetin e vet mbi ta. Në këtë aspekt shtrohet detyrë, krahas edukimit të vazhdueshëm, kontrolli sistematik i kuadrove, për t'i ruajtur të pastër, larg synimeve për tituj dhe rroga të mëdha.

Disa materiale të periudhës përmbajnë udhëzime të qarta për spastrimin e aparateve të Partisë e të shtetit nga hallkat e tepërta që krijojnë burokratizëm. Luftën kundër këtij rreziku autori e trajton në shumanshmërinë e saj. Ai poroset komunistët e punonjësit të revolucionarizojnë më tej stilin dhe metodën e punës, të forcojnë lidhjet midis tyre në organizatat e masave, si dhe të ushtrojnë kontroll mbi çdo gjë.

Trajtim shkencor i bëhet në këtë vëllim një vargu çështjesh të edukimit komunist. Theksi vihet te puna e Partisë me njerëzit, sidomos me ata që kanë gabuar. Shoku Enver Hoxha këshillon që cilido ta kuptojë mirë rëndësinë politiko-ideologjike të detyrave dhe të marrë

përgjegjësitë përkatëse. Në këtë kuadër tërheq vëmendjen e masave për të studiuar vazhdimisht marksizëm-leninizmin dhe përvojën e pasur të Partisë sonë. Detyra të mëdha shtrun ai edhe për forcimin e rolit të letërsisë dhe të arteve, për rritjen e frymës militante e të nivelit ideoartistik të veprave nga shkrimtarët e artistët, të cilët, në fjalën në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH më 20 dhjetor 1974, i quan ndihmës të Partisë për edukimin komunist të njerëzve.

Puna politike e Partisë, siç shkruan udhëheqësi i saj në shënimet e 9 janarit, «kurrë nuk duhet të ndahet ose të shkëputet nga rrënjosja e një kuptimi të thellë politik se atë që po ndërtojmë, duhet edhe ta mbrojmë». Kjo detyrë rritësohej me forcë pas dënimit të grupit puçist në ushtri. Duke njohur mirë si gjendjen moralopolitike të efektivave të mbrojtjes, ashtu dhe problemet e artit ushtarak, Komandanti i Përgjithshëm orientonte të reflektonte thellë dhe seriozisht kuadrot e ushtrisë, Partia të vihej në krye të çdo njësie dhe të bëhej kthesë rrënjësore si në studim, edhe në stërvitje.

Që në këtë periudhë, në diskutimin në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH më 21 maj, shoku Enver Hoxha hedh idenë se fije të padukshme të punës armiqësore ekzistojnë akoma dhe duhen zbuluar, prandaj shtrun si domosdoshmëri zhvillimin e pandërprerë të luftës së klasave. Krahas shpjegimit të rrezikshmërisë së zbutjes së saj, ai udhëzonte që lufta e klasave të veprojë kudo, atë ta udhëheqë Partia dhe ta bëjë tok me masat, me të gjitha format.

Në vëllim i kushtohet rëndësi mbrojtjes jo vetëm

nga agresioni ushtarak, por edhe nga diversioni ideologjik e politik i botës së jashtme. Autori, veçanërisht në Plenumin e 7-të të KQ të PPSH, analizon me objektivitet situatën e turbullt në botë, rezultat i politikës ekspansioniste të dy superfuqive. I rëndësishëm është konkluzioni që nxjerr për dobësimin e mitit të këtyre fuqive të mëdha, të cilat i ndjekin disfata të njëpasnjëshme. Shoku Enver Hoxha përshëndet ngrohtësisht fitoren e popujve të Vietnamit e të Kamboxhias mbi imperialistët janki, duke theksuar se «Imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik dhe borgjezia reaksionare duhen luftuar nga popujt me armë, sepse vetëm kështu ata mund të çlirohen».

Mësimet që burojnë nga materialet e këtij vëllimi, do t'u bëhen një nxitje e re komunistëve e kuadrove tanë në punën për të arritur objektivat e lartë të lëvizjes «Flamurtarë të mësimëve të shokut Enver Hoxha, luftëtarë të zbatimit të vendimeve të Kongresit të 9-të të Partisë».

Vëllimi është i pajisur me tregues.



# SHKRIMTARËT DHE ARTISTËT JANË NDIHMËS TË PARTISË PËR EDUKIMIN KOMUNIST TË NJERËZVE TANË

*Fjala në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

20 dhjetor 1974

Për këtë çështje shoku Dritëro Agolli<sup>2</sup> na i ka thënë mendimet në materialin që na është paraqitur nga Kryesia e Lidhjes. Tani mendoj të dëgjojmë shokët që marrin pjesë në këtë mbledhje.

*Fjalën e kërkoi shoku Hajro Zeneli, në atë kohë sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Durrësit. Shoku Enver Hoxha e ndërpreu duke i thënë:*

Ti, shoku Hajro, kur flet, si e ke më lehtë të rrish, në këmbë apo ulur?

**SHOKU HAJRO ZENELI:** Më lehtë e kam të rri në këmbë, shoku Enver, ndoshta më është bërë zakon, sepse kam qenë për një kohë pedagog.

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për zbatimin e detyrave të caktuara nga Partia për letërsinë dhe artet.

2. Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Unë e kam ndryshe, më pëlqen të flas shtruar, si populli. Nuk mund ta shpreh këtë ndjenjë si Dritëroi, që është poet i madh i Shqipërisë, por mendoj se kur populli rri shtruar, e bën këtë se nuk do të shkëputet nga toka, do të rrijë i lidhur fort me të, sepse idetë e tij vijnë nga materiali, nga tabani dhe prandaj ai nuk lëviz që andej. As babai, as nëna, as gjyshi e as gjyshja nuk kanë lëvizur nga kjo tokë. Popullit i pëlqen të jetë mbështetur më fort në të, që t'i ketë rrënjët më thellë në këtë truall. Sigurisht, kur jemi në mitingje me popullin, do të rrimë në këmbë. Megjithatë, meqenëse je mësuar të flasësh në këmbë, vazhdo ashtu, se prapë këmbët i ke në tokë. (*Të qeshura.*)

Do të ishte më mirë të na thoshe se çfarë bëjnë shkrimtarët e poetët e rrethit tuaj, sesa formulime të përgjithshme, që janë të njohura për të gjithë. Ka çështje nga këto që edhe duhet t'i dimë, por ne dëshirojmë të dimë më mirë si zhvillohet jeta kulturore-artistike në Durrës, ajo na intereson më shumë se formulat e zakonshme. Këtë e them jo vetëm për ju, por më duket se dhe Kryesia e Lidhjes po i fut shkrimtarët dhe artistët në gjëra burokratike. Do të isha i mendimit t'i thosha Dritëroit që të mos merrej me këto gjëra. Atë vërtet e kemi vënë kryetar të Lidhjes, po e kemi vënë pikërisht që me frymëzimin e tij, me veprat e tij të frymëzojë edhe artistët e shkrimtarët e jo të merret me punë burokratike.

Unë do të dëshiroja që Dritëroi të na thoshte në Sekretariat se në ç'stad është poezia në vendin tonë, cilat



janë karakteristikat e saj në zhvillim, cilat janë cilësitë e mira të saj e disa dobësi që shfaqen. Ti, Dritëro, je poet i kualifikuar dhe mund të na japësh të dhëna për këto çështje që kanë të bëjnë me brendinë, se për të pasur dijeni sa vepra u bënë, sa piktura u varën në mure etj., ato i mësojmë lehtë. Prandaj reflekto dhe na mbaj një «leksion» këtu në Sekretariat, se për këto njohuri kemi nevojë. Kjo do të jetë për ne një ndihmë e madhe që mund të na e jepni.

Neve na interesojnë më shumë pikërisht veprat, se nëpërmjet tyre duken qëndrimi, mendimet, konceptet që kanë krijuarit. Kjo ka më shumë rëndësi sesa të numërosh vajtjet në fshat. Shkrimtarët dhe artistët mund të venë në bazë, në prodhim, një herë apo dy herë, por disa prej tyre venë në fshat e nuk lidhen me jetën. Këto janë fenomene që ekzistojnë. Desha të di, gjithashtu, nëse Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve i është vënë detyrë të kontrollojë librat që dalin. Unë shoh plot nga shokët krijues që janë futur në komisione e në këshilla artistikë të institucioneve të ndryshme. Në qoftë se del nga shtypi një roman me devijime, fjala vjen, kush e ka fajin për këtë? A nuk mban përgjegjësi edhe Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve? Nuk e di si kuptohet në teori dhe në praktikë kjo çështje.

*Pasi diskutoi shoku Hajro Zeneli, shoku Enver Hoxha, iu drejtua shokut Musa Kraja, në atë kohë sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Shkodrës.*

Cilat kanë qenë traditat më të zhvilluara në të kaluarën në Shkodër dhe ç'bëhet për zhvillimin e tyre?

Cilat gjini donte populli të zhvilloheshin më shumë? Në ç'drejtime dukej frymëzimi i tij dhe a janë zhvilluar ato ashtu siç duhet të zhvillohen? Të marrim, për shembull, teatrin. Shkodra ka qenë në këtë drejtim një vend artdashës nga më të përparuarit në Shqipëri, si me thënë, nga më të vjetrit, pavarësisht se ka pasur edhe pjesë të dobëta. Ne e dimë që ajo ka ecur përpara. Si mendoni ju, a është e mjaftueshme kjo? A mund të na thoni diçka për autorët e pjesëve teatrale, për vënien e tyre në skenë, si dhe për edukimin e artistëve e ngri-tjen e talenteve të reja?

Në lidhje me krijimtarinë letrare desha të di nëse zhvillohet ndonjë aktivitet për njerëzit tanë më të shquar. Nuk them të mblidhen e të lexojnë librin, por e kam fjalën për një punë të menduar mirë nga studiuesit. Ata mund t'u flasin të rinjve dhe masës jo vetëm për mësimet e veprat e Partisë sonë, por edhe për veprat e shkrimtarëve e të poetëve tanë të mëdhenj. Organizoni ju aktivitete të tilla? Bëni komente nëpër organizata të rinisë e në fabrika që njerëzit të frymëzohen nga këto vepra, apo kjo punë i lihet spontaneitetit: kush të dëshirojë le të blejë librin dhe ta lexojë vetë?! Po nëpër shkolla, a bëhen aktivitete të tilla, apo mjaftohen vetëm me ato njohuri që janë vënë në tekst dhe kaq? Po për librat e tjerë që dalin dita-ditës, ç'punë bëhet?

*Pasi foli shoku Musa Kraja dhe shokët e tjerë të pranishëm, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Mendoj se, kur raportohet këtu, në Sekretariatën e Komitetit Qendror, si në çdo forum partie, duhet të bëhet kujdes që të ngrihen probleme sa më të studiuara.

Është më mirë që në këto raporte të na jepet një pasqyrë e qartë dhe e plotë e punës që bëhet lidhur me zbërthimin, kuptimin dhe zhvillimin e mëtejshëm krijues të një orientimi që ka dhënë Byroja Politike ose Komiteti Qendror i Partisë, sesa të kufizohemi në një numërim skematik të disa të dhënave.

Shokët e Ministrisë së Arsimit e të Kulturës, si dhe shokët e aparatit të Komitetit Qendror që merren me problemet e letërsisë e të arteve, i pyeta si i aktivizojnë shkrimtarët, poetët dhe artistët, se mos i ngarkojnë me punë zyre, duke i futur në një mënyrë a në një tjetër në ingranazhet e burokratizmit. Këtë pyetje e bëra sepse mendoj që Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të mos kthehet në një organ burokratik, përkundrazi, ajo duhet të jetë një qendër ku të rrihen gjallërisht mendime filozofike, artistike, estetike etj. Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve nuk duhet lejuar që të kthehet në një organ kontrolli të shkrimeve të ndryshme të të gjithë shkrimtarëve dhe poetëve të vendit, por, në radhë të parë, të punojë në shumë mënyra e forma për t'i frymëzuar ata që të shkruajnë sa më mirë.

Është për këtë arsye që poetin tonë të shquar revolucionar, Dritëro Agollin, që e kemi edhe kryetar të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, e këshillova të heqë dorë nga puna rutinë dhe burokratike e Lidhjes dhe i kërkova që në këtë mbledhje të na fliste për gjendjen e zhvillimit të poezisë sonë. Dhe ai na foli me plot kompetencë për këtë problem.

Gjatë këtyre 30 vjetëve të një jete të lirë në një vend ku ndërtohet socializmi, siç është vendi ynë, ne

kemi arritur suksese të shumta në lëmin e ekonomisë dhe të kulturës. S'ka asnjë dyshim se këto suksese nuk mund të ishin arritur pa ekzistencën e Partisë së Punës, pa vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste, pa vendosjen e pushtetit popullor, pa diktaturën e proletariatit dhe pa zhvillimin e vazhdueshëm të luftës së klasave. Të gjithë këta faktorë kanë bërë që të kryhen transformime të mëdha ekonomiko-shoqërore e, lidhur me to, edhe në edukimin e shumanshëm të punonjësve. Jeta ekonomike dhe kulturore e popullit tonë ka ndryshuar, ka përparuar. Njerëzit punojnë, prodhojnë, krijojnë, mësojnë dhe konsumojnë.

Në gjithë këtë zhvillim Partia ka bërë vazhdimisht analiza të shumanshme për momente kyç, të cilat i kanë ndihmuar komunistët dhe të gjithë punonjësit që këta të shihnin anët e mira, por edhe anët e dobëta, gjatë procesit të këtij zhvillimi.

Disa njerëz këto analiza që ka bërë Partia nuk i kanë vlerësuar aq sa duhej, nuk kanë parë në to thelbin e politikës e të filozofisë së Partisë, për të vënë në dukje se rezultatet e një etape, për të cilën bëhej fjalë, kanë anët e mira, por kanë edhe anët e dobëta që i shoqërojnë, ka faktorë pozitivë e negativë dhe këta faktorë janë edhe objektivë, edhe subjektivë. Jeta shoqërore për këta njerëz zhvillohet jashtë vullnetit të tyre, pasi, si kur dashkan edhe kur nuk dashkan këta, ngjarjet do të marrin rrjedhën e tyre «të predestinuar». Të tillë njerëz ndryshojnë nga pamja prej atyre që filozofojnë në mënyrë idealiste e mistike, por nuk ndryshojnë aspak nga botëkuptimet e tyre. Më parë thoshin

e besonin se kjo ose ajo «qe e shkrojtur», «kështu do të ngjiste», «ka një fuqi të mbinatyrshe, vendimeve të së cilës nuk mund t'u kundërshtosh». Këtë «forcë të jashtëzakonshme» e quanin «zot, perëndi, Krisht, pej-kamber» e me lloj-lloj emra shenjtorësh. Edhe tani ka njerëz që mendojnë në mënyrë metafizike dhe besojnë në disa «forca», të cilat i ngrenë si faktorë që gjoja vënë në lëvizje zhvillimin, siç janë për ta «burokracia, administrata, egoizmi, ndjenja e pronës private, ambicia, pozita etj.». Perëndia për këta është transformuar dhe ka zënë rrënjë pikërisht në ato botëkuptime e udhërrëfime në jetë që konsolidonin frymëzimin idealist dhe jetën e borgjezisë kapitaliste, tregtare a fajdexheshë. Sfera e veprimtimit të njerëzve të tillë në regjimin tonë, natyrisht, është ngushtuar dhe vazhdon të ngushtohet, por mentalitetet e dëmshme të tyre nuk janë pa efekt në jetë. Në jetë dhe në forma të ndryshme këto pikëpamje veprojnë, shumë herë duken krejt të parrezikshme, normale, fshihen nën një mentalitet që u përshtatet gjoja ligjeve, zakoneve, deri edhe «patriotizmit» të ri të epokës së Partisë. Ky është ai mentalitet mikroborgjez, këto janë ato mbeturina borgjeze e mikroborgjeze, kundër të cilave Partia marksiste-leniniste lufton dhe do të luftojë vazhdimisht deri në shoqërinë pa klasa.

Të mos mendojmë se njerëzit janë shkundur nga këto mbeturina, të mos mendojmë se me disa artikuj moralizues zhduken pa nishan këto vese dhe botëkuptime të rrezikshme, të mos mendojmë se, duke u përmirësuar niveli i jetesës së popullit, njerëzit bëhen të

imunizuar nga këto «sëmundje». Përkundrazi, mund të kemi një reminishencë të tyre, dhe këtë herë duke brohoritur «Rroftë Partia» që na krijoi bollëkun. Por tok me bollëkun dhe me mirëqenien, Partia duhet të krijojë në njerëzit dhe në shoqëri atë botëkuptim, ato zakone, ato ndjenja, ato shije, atë etikë, atë filozofi revolucionare që të mos lejojë pikërisht as ringjalljen e as përhapjen e botëkuptimeve mikroborgjeze e borgjeze.

Natyrisht, kjo nuk është një punë e lehtë dhe pikërisht në këtë mbështetet borgjezia, kapitalizmi kur shpreson «falimentimin e shoqërisë socialiste», «disfatën e komunizmit». Kapitalizmi llogarit pikërisht në atë filozofi, në ato botëkuptime dhe në ato marrëdhënie ekonomike, mbi të cilat janë mbështetur zhvillimi dhe konsolidimi i pushtetit të tij. E gjithë struktura dhe superstruktura e tij, natyrisht, e kanë shtypur njeriun në mënyrë të dyfishtë: edhe shpirtërisht, edhe fizikisht. Mbretëria e kapitalit, e fesë, e aristokracisë dhe e borgjezisë gjatë gjithë zhvillimit të historisë është ndeshur me forcat përparimtare, me përparimin, dhe ka lënë shumë gjymtyrë të saj në këto luftëra. Tani ka arritur në fazën e kalbëzimit të saj. Kapitalizmi, imperializmi, ka humbur njërën pas tjetrës pozitën ekonomike, politike dhe ideologjike. Revolucioni, popujt, po ia gërryejnë atij themelet. Marksizëm-leninizmi udhëheq popujt drejt jetës së re, socializmit dhe komunizmit. Kapitalizmi botëror, përpara disfatave që pëson, të mos kujtojme se i ka hedhur armët. Në synimet e tij ai mbështetet pikërisht në goditjet barbare dhe në luftë-

rat grabitqare imperialiste kundër çlirimit të popujve nga zgjedha e tij, por llogarit, gjithashtu, edhe atë botëkuptim e ato mbeturina që rëndojnë në ndërgjegjen e njerëzve, të cilat i kanë mbajtur ata si sklevër të tij tërë jetën.

Propaganda e imperializmit nuk ka njohur kurrë në këtë drejtim një shtrirje dhe një larmi kaq të gjerë sa në ditët e sotme për degjenerimin e njerëzve dhe të shoqërisë në tërësi, për të ringjallur në çdo formë dhe në çdo aspekt veset, ndjenjat, sentimentet, lakmitë, egoizmin, kusërinë, bandilizmin e dikurshëm të atyre njerëzve dhe të atyre shoqërive që mbështetnin fuqinë e tij. E tërë kjo është pasqyra e fytyrës së egër të kapitalit, pasqyra e degjenerimit të tij. Por me këtë mënyrë jetese ai përpiqet, prapëseprapë, të zgjatë jetën dhe sundimin e tij, duke ndikuar në popujt me propagandën që bën për t'i demoralizuar, për t'i hedhur këta jashtë rrugës së revolucionit.

Kapitalizmi, imperializmi, ka frikë nga revolucioni, nga proletariati, dhe jo nga lumpeni, ose nga ata demokratë e socialistë që e goditin me ujë trëndafili, dhe as nga revizionistët modernë, si ata të Bashkimit Sovjetik e të tjerët, që kanë tradhtuar idetë e marksizëm-leninizmit. Të gjithë këta, të veshur me ideologji të ndryshme pseudorevolucionare, janë forca e mjete të kundërrevolucionit, që i përdor kapitalizmi, imperializmi, për qëllimet e veta.

Në vështrim të këtyre gjërave, duke e ndier në çdo çast rrezikshmërinë e tyre, Partia jonë i mëson dhe i edukon njerëzit, i hedh këta në luftë për ndërtimin

dhe konsolidimin e shoqërisë socialiste e të fitoreve të arritura dhe për të përgatitur terrenin për ata objektiva të rinj që duhet të arrihen. Çdo qytetar i vendit tonë lypset, pra, të reflektojë thellë mbi atë se ç'kupton Partia kur thotë se «duhet të luftojmë me të gjitha forcat kundër presionit të jashtëm dhe të brendshëm të ideologjisë borgjeze e revizioniste». Ky armik i dyfishtë dhe njëkohësisht i njëjtë nuk është imagjinar, por real. Lufta duhet të bëhet e përditshme, të jetë aktive dhe të zhvillohet në të gjitha shfaqjet e jetës, në filozofinë e të gjitha këtyre shfaqjeve. Lufta duhet të bëhet me të gjitha mjetet, me edukim në shkolla, në fabrika, në ara, në punë e në shtëpi, me familjen e kokë më kokë me nënën, me bashkëshorten, me motrën, me fëmijët, me fqinjët, në të gjitha shfaqjet e tyre, duke vënë në dukje e duke inkurajuar të mirat dhe duke dënuar të këqijat. Po të veprojmë kështu, kemi fituar hap pas hapi mbi armikun. Farën e tij të keqe të mos e lëmë të mbijë dhe, sa nxjerr kokë, t'ia këputim këtë menjëherë.

Shkrimtarët dhe artistët kanë një rol jashtëzakonisht të madh në këtë drejtim. Populli dhe Partia kanë nevojë për ta. Ata, me krijimtarinë e me talentet e tyre, të ndihmojnë më mirë që të zhduken nga skutat e errëta të ndërgjegjes së njerëzve ato mbeturina që përmenda më lart, të vënë në dukje madhështinë e botës socialiste dhe virtytet e njerëzve të rinj të saj. Nën udhëheqjen e Partisë, punonjësit e letërsisë e të arteve të bëjnë atë punë të thellë ideologjike, politike, morale dhe etike që lypset për të luftuar ndikimet dhe helmet.



e botës së vjetër dhe të asaj kapitaliste e revizioniste aktuale, për të vënë në dukje dhe për të rrënjosur në karakterin e njerëzve tanë virtytet e larta komuniste. Ata të luftojnë që të luajnë kurdoherë rolin e ndihmësit të Partisë për formimin e njeriut të ri. Unë mund të them me keqardhje se mjaft komunistë dhe udhëheqës komitetesh të Partisë e institucionesh shtetërore nuk e kuptojnë si duhet rëndësinë e letërsisë dhe të arteve. Fjalët e arta të Leninit për rolin e letërsisë dhe të arteve për edukimin e masave ata i përsëritin në referatet që bëjnë, por, kur vjen puna në praktikë, i nënvleftësojnë ose i harrojnë.

Në drejtim të zhvillimit të letërsisë dhe të arteve Partia ka ndihmuar që të bëhet një hop i madh cilësor përpara. Jeta në vendin tonë është aq e madhe, aq e gjerë, aq e larmishme, aq e bukur dhe aq e hapët, sa që, po të zhytesh në të, nuk ke si të mos frymëzohesh të shkruash çfarë të duash, romane, poezi, drama, komedi, muzikë etj.

Shokët shkrimtarë, poetë, muzikantë, artistë, aktorë e regjisorë të teatrove dramatikë, të operës e të baletit, të kinematografisë etj., të frymëzuar nga puna dhe heroizmat e popullit, kanë arritur përparime shumë të mëdha në zhvillimin e letërsisë e të arteve në vendin tonë. Këtë e tregoi më së miri edhe krijimtaria letraro-artistike e realizuar me rastin e 30-vjetorit të Çlirimit të Atdheut. Artistët dhe shkrimtarët, të frymëzuar nga vendimet e Plenumit të 4-t të KQ të PPSH, erdhën në këtë jubile të madh me tërë ato krijime të bukura. Këto

realizime, në vargun e të tjerave, dëshmojnë edhe për mundësitë që krijohen kur populli është në fuqi e udhëhiqet nga një parti revolucionare, marksiste-leniniste, siç është Partia jonë e Punës.

Gjatë leximeve të autorëve të huaj të vendeve të ndryshme, ka prej tyre që më kanë pëlqyer, siç janë, për shembull, veprat e poezisë klasike e të prozatorëve të shquar francezë etj., por ka edhe shkrime që nuk më kanë pëlqyer fare, si shumë romane të reja, që më bien në dorë, të cilat bëj përpjekje t'i lexoj, por, t'ju them të drejtën, ato i kam flakur tej, sepse janë pa vlerë. Lëre pastaj «poezitë» moderne që kam lexuar, që qëndrojnë aq poshtë sa nuk mund të merret me mend. Duke lexuar të tilla «poezi», pyes veten: Ç'janë këta njerëz që merren me këto shkrime? Ndërsa përballë kësaj krijimtarië të çoroditur dhe pa asnjë vlerë ngrihen gjithnjë e më lart madhështia e letërsisë dhe e artit tonë të realizmit socialist, vlera e këngëve dhe e valleve tona popullore jashtëzakonisht të bukura.

Midis poetëve dhe prozatorëve tanë ka autorë që nxjerrin krijime letraro-artistike me vlerë, të tjerë që prodhojnë vepra me më pak vlerë; ka pastaj edhe nga ata që shkruajnë materiale pa ndonjë vlerë të veçantë. Këta të fundit, dhe sidomos poetët dhe shkrimtarët e rinj, kush do t'i ndihmojë të ecin përpara? Në këtë çështje ne duhet të bëjmë shumë kujdes, që ata t'i inkurajojmë e t'i ndihmojmë dhe në këtë drejtim një detyrë e veçantë u vihet shkrimtarëve dhe poetëve tanë

të afirmuar, si dhe atyre që janë më të përgatitur se të rinjtë. Por ndihma e parë dhe e vazhdueshme që duhet t'u japim atyre, është t'u çelim sytë e ndërgjegjes mbi realitetin e vendit dhe të popullit tonë. Ata vetë të mësohen që të shohin me sy e të ndiejnë me zemër zhvillimin e vrullshëm të jetës së popullit dhe ta pasqyrojnë atë besnikërisht në krijimtarinë e tyre të larmishme. Këtij zhvillimi t'i kuptojmë anët e tij më të thella e më të ndryshme, që zbulohen nëpërmjet njohjes së jetës materiale dhe të ndjenjave që lindin në çdo periudhë, nëpërmjet rrahjeve të mendimeve që krijohen nga antagonizmat e brendshëm e të jashtëm, të cilët ishin dhe janë të pandarë në jetën e një populli, në çfarëdo kohe dhe në çfarëdo qoshe të kontinenteve që ai jeton dhe lufton për ekzistencën e tij, për një jetë më të mirë, jetë në liri dhe në pavarësi ekonomike e politike.

Nëse gjejmë që poezitë e Dritëro Agollit janë të mira, arsyeja është se ato shprehin ndjenjat e pastra të popullit, janë të lidhura me realitetin, me njerëzit e punës, me baltën, me prodhimet e lulet e kësaj toke, me oxhaqet e mëdha të kombinateve dhe me hallet e gëzimet e njerëzve në vatrat e tyre familjare. Një poet që nuk e njeh realitetin, sado fantazi të zhvilluar që të ketë, nuk mund të bëjë dot një poemë të fuqishme. Në qoftë se fantazinë që ai ka e gërsheton mirë me realitetin objektiv të vendit, me jetën e gjallë të popullit dhe në shkrimet e tij lufton shprehjet plot fraza pompoze, ai mund të bëhet, gjithashtu, një shkrimtar me talent. Për shembull, sipas mendimit tim, Xhevahir Spahiu dhe disa poetë të rinj të tjerë kanë shumë ide, por mënyra

si i shprehin ato nuk është gjithmonë reale, jetësore. Është në dorën e tyre të bëjnë përpjekje për t'u lidhur më mirë me popullin, por, gjithashtu, është edhe në dorën e shokëve të tyre dhe të Partisë që këto talente të reja të nxiten në këtë drejtim, me qëllim që popullin të mos e shikojnë kryesisht nëpërmjet fantazisë së tyre, por të futen thellë në jetën, në rrjedhën dhe në vazhdimësinë e kësaj jete, në të gjitha këthosat e zigzagjet që bën populli për të arritur ato qëllime që i vë Partia dhe ta kenë të qartë se në jetë nuk është çdo gjë shesh me lule.

Ne nuk duhet të dekurajohemi që, krahas poetëve e shkrimtarëve të afirmuar, nuk shohim, siç u tha këtu, të dalin talente të reja të kalibrit të lartë. Duhet pasur parasysh se nuk është punë aq e lehtë të krijosh në një kohë të shkurtër pjesë letrare dinjitoze, poezi, romane etj. Që të shkruash vepra me vlerë, duhet edhe kohë, pastaj duhet të lidhesh me njerëzit, me popullin, të futesh në gjirin e masave, jo vetëm sa për të gjetur subjektin e romanit ose të poezisë dhe të largohesh menjëherë nga fshati ose fabrika, duke e konsideruar të mjaftueshme lindjen e idesë. Në këtë mënyrë vepra nuk ka për të dalë e mirë dhe e goditur, prandaj shkrimtarit i kërkohet të shtrohet këmbëkryq me njerëzit, të njohë, siç thashë, jetën, vështirësitë e shqetësimet, kënaqësitë dhe aspiratat e tyre etj.

Shumica e letrarëve tanë të rinj kanë një horizont kulturor, por detyra e tyre është që këtë kulturë ta lidhin mirë me jetën e vendit, me direktivat e Partisë. Duke u frymëzuar nga jeta e popullit dhe nga vija e

drejtë e Partisë, jam i bindur se me kohë edhe të rinjtë do të piqen dhe do të arrijnë të afirmohen.

Ka dy lloje shikimesh të zhvillimit të jetës: njëri është shikimi idealist, mistik, pesimist dhe konservator, dhe tjetri është shikimi realist, me frymë revolucionare, fryt i një analize materialiste të ngjarjeve dhe të historisë, plot me ndjenja optimiste për një ndryshim dhe zhvillim të mëtejshëm pozitiv të historisë e të zhvillimit të shoqërisë, të një shoqërie pa klasa. Ky shikim bëhet domen dhe botëkuptim i atyre njerëzve me virtyte të pastra e revolucionare që, duke u bashkuar me klasat përparimtare, goditin fort edhe tërë arsenalin e urreyer ideor dhe politiko-moral të forcave reaksionare. Për t'i edukuar dhe për t'i ndihmuar letrarët dhe artistët e rinj, është e domosdoshme që ne t'u mësojmë atyre e t'ua bëjmë të kuptueshme ideologjinë që udhëheq Partinë dhe klasën tonë punëtoare, marksizëm-leninizmin.

T'i mësojmë letrarët dhe artistët e rinj si ta lexojnë librin e hapët të jetës socialiste të vendit tonë, si ta studiojnë dhe si ta kuptojnë brendinë e këtij libri të mrekullueshëm. Të bëjmë që ata të dashurohen me çdo «germë» të këtij libri të jetës, të shohin dhe të ndiejnë rrahjen e fuqishme të forcës, të ndjenjave dhe të dëshirave të zjarrta të popullit. Ne duhet të punojmë që ata të shohin dhe të prekin realizimet kolosale të tij në të gjitha fushat, të shohin se si njeriu ynë i ri i një shoqërie socialiste, i udhëhequr nga një parti marksiste-leniniste, ka ndryshuar fushat, malet, ka sunduar rrjedhën e lumenjve dhe se si nga hiçi ka ngritur qytete të

tëra. Ne duhet të bëjmë që këta njerëz të rinj t'i shohin gjithë këto bukuri, gjithë këtë kolorit të pasur të njerëzve e të natyrës sonë dhe nga libri i mrekullueshëm, që është jeta e popullit, ata të bëjnë deduksionet, të hedhin në librat, në romanet e në poezitë, në këngët e në veprat teatrale, në tablotë e në skulpturat që krijojnë, gjithë këto thesare të mëdha të jetës sonë socialiste.

Po të ecin artistët dhe shkrimtarët tanë në këto drejtime dhe të mbruhën me këto mësimë, të futen kokë e këmbë dhe me të gjithë forcën e karakterit dhe thellësinë e ndjenjave të tyre të pastra e të zjarrta në vrullin revolucionar të jetës, ata me siguri do t'u japin popullit dhe atdheut vepra të mrekullueshme, që do të jenë pasqyrimi i punës së madhe që bëhet në vendin tonë për ndërtimin e socializmit dhe për formimin e njeriut të ri. Veprat e tyre do t'u përngjasin, për nga dobia e madhështia, hidrocentraleve gjigante, fabrikave e kombinateve, fushave të bukura me grurë dhe bregoreve plot pemë frutore, do t'u përngjasin bukurive të qyteteve tona, shkollave e çerdheve, ku cicërojnë kalamanët e lumtur të vendit tonë socialist, ku klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe inteligjencia popullore, me mendjen dhe me mjeshhtërinë e tyre, krijojnë dhe ndërtojnë një jetë të re, të lumtur e të begatshme.

Mendoj se një ndihmë tjetër që duhet t'u jepet shkrimtarëve të rinj me më pak eksperiencë dhe akoma të paformuar, veç këshillave dashamirëse të poetëve, shkrimtarëve, piktorëve e muzikantëve të shquar, ose vërejtjeve që këta do t'i bëjnë prodhimtarisë krijuese të të rinjve, do të jetë sidomos krijimtaria e bukur

dhe e pasur e talenteve tona të mëdha, shkrimet dhe kompozimet e mira që këto nxjerrin në dritë, që do t'i frymëzojnë më të rinjtë dhe ata më pak të përgatitur nga ana ideoartistike. Veprat që i kanë dhënë poezisë, prozës, muzikës, pikturës etj. shkrimtarët dhe artistët tanë të mirënjohur, duhet të bëhen objekt kryesor studimi dhe frymëzimi për të gjithë ata që merren me letërsi dhe me art për sa u përket etikës, brendisë, trajtimit të problemeve etj. Kjo krijimtari është dhe do të jetë një shkollë dhe ndihmë e madhe që do t'u jepet të rinjve nga artistët e afirmuar, nga veprat e të cilëve nuk mësojnë dhe nuk edukohen vetëm ata që porsa kanë filluar të shkruajnë, por edhe lexuesit, të gjithë ata që nuk merren me shkrime, pasi ato na frymëzojnë edhe ne.

Veprat e mira të shkrimtarëve, të poetëve dhe të artistëve të shquar na pëlqejnë, për arsye se ato përshkohen nga ide dhe mendime me vlerë, të cilat nuk zbresin nga qiejt, por rrjedhin nga njohja e gjendjes së vërtetë të sendeve, të realitetit tonë, nga zhvillimi i jetës politike dhe shoqërore të popullit. Këto ide dhe mendime pasqyrojnë në mënyrë të drejtë e të saktë dëshirat, gëzimet e hidhërimet, jetën dhe thellësinë e mendimit të popullit, ato lidhen me perspektivat tona, prandaj jo vetëm na pëlqejnë, por edhe na frymëzojnë e na gjallërojnë në punë. Objekti i ndihmës për krijuesit e rinj duhet të bëhen, pra, më shumë veprat e arrira të autorëve të afirmuar sesa një organizim skematik i dhënies së ndihmës nga ana e tyre. Kur në veprat e shkrimtarëve dhe të artistëve, në pikturat e

në kompozimet e tyre muzikore shprehën mendimi i thellë dhe zemërgjerësia e popullit e vihen në dukje personazhe reale nga jeta, kjo i bën ata që janë pasqyruar në këto krijime të mendojnë: Vallë, me punën që kryejmë, e meritojmë këtë nder që na bëhet? Dhe kjo pyetje që këta ia drejtojnë vetes, i frymëzon e ua shumëfishon forcat për të punuar akoma më shumë.

Në veprat e shkrimtarëve tanë, qofshin këta edhe të rinj, ka frymëzime, ka mendime, ka shije, ka art. Të gjitha këto mund të mos jenë kurdoherë të thella, mund të mos jenë të përsosura. Dihet se pema nuk e jep frutën që kur mbin mbi tokë. Kështu ndodh edhe me shkrimtarët dhe artistët e rinj, por me kohë edhe këta do të rriten, do të pihen në mendime dhe do të dinë të krijojnë pjesë më të bukura, me vlera më të thella e më të qëndrueshme.

Në krijimtarinë e tyre shkrimtarët e rinj duhet të frymëzohen, në radhë të parë, nga vija e Partisë dhe vepra kolosale e njerëzve të punës, por, siç thashë, ata duhet të mësojnë edhe nga shokët e tyre shkrimtarë, poetë dhe artistë më të vjetër e më me eksperiencë. Në artistët dhe letrarët e rinj, bile edhe në ata të vjetrit, me një punë sistematike edukative, duhet të luftohen e të zhduken me durim egoizmi, ambicia e mendjemadhësia, që kanë mbetur te ne si njolla nga shoqëria me klasa antagoniste. Një gjë e tillë është e domosdoshme për një zhvillim dhe çelje në shumicë e me aromë të këndshme të luleve të bukura shumëngjyrëshe të një kopshti të tillë socialist si yni. Por, mendoj unë, nuk mund të pretendojmë që të tëra talentet të arrijnë



në të njëjtën kohë në po atë nivel zhvillimi. Prandaj nuk duhet të bëjmë krahasime vend e pa vend midis individëve që merren me krijimtari, duke u shprehur se prodhimet e këtij ose të atij tjetrit qëndrojnë lart, kurse të këtij ose të kësaj s'qenkan gjë! Jo, nuk duhet vepruar kështu. Letërsia, arti, muzika, bile edhe ekonomia, shkencat dhe gjithë kultura e vendeve dhe e popujve të botës janë zhvilluar jo përnjëherësh, ato kanë kaluar hap pas hapi nga stadet më të ulëta në ato më të lartat. Dallime, natyrisht, kurdoherë ka pasur, jo vetëm kur janë arritur nivele të larta të shkencave, të letërsisë e të kulturës, por edhe kur nuk ka pasur të tilla. Koha dhe jeta do t'i bëjnë vetë dallimet.

Në literaturën botërore të epokave dhe të shekujve të ndryshëm përmenden njerëz që në kohën e tyre kanë qenë nga më të dëgjuarit, por në shekujt e mëvonshëm u ka rënë vlera fare dhe ata janë harruar. Në një libër për Akademinë Franceze është shkruar për ato autoritete të shquara franceze dhe botërore, që nuk u pranuan kurrë në akademi, si: Molicri, Rusoi, Dideroi, Balzaku e të tjerë. Aty thuhet se shumë nga këta, kur kanë paraqitur kandidaturat për t'u pranuar në akademi, janë rrëzuar. Po kush i ka rrëzuar këta dhe kush është zgjedhur në vend të tyre? Autorët e librit tregojnë se ata që janë zgjedhur në vend të këtyre autoriteteve, kanë qenë njerëz, krijimtaria e të cilëve s'kishte aq vlerë, prandaj, me kalimin e kohës, shumë prej tyre janë harruar dhe disa kanë humbur, si i thonë fjalës, pa nam e pa nishan. Një nga këta autorë, edhe vetë akademik, paraqit në këtë libër madhështinë dhe pa-

vdekshmërinë e Molierit që nuk u pranua kurrë në akademi. Në fund të fundit, ç'i duhej Molierit kolltuku luksoz i Akademisë Franceze, kur kolltukun e tij të vjetër, ku ai vdiq duke luajtur komeditë e tij të pavdekshme, venë dhe e prekin me respekt edhe sot e kësaj dite me miliona njerëz?

Përmenda shembullin e Akademisë Franceze për të ilustruar idenë se është koha ajo që bën diferencimin për shumë njerëz e vepra. Ato që janë me vlerë më të madhe, kryeveprat, mbeten në shekuj si monumente të pavdekshme që nuk shlyhen kurrë, të tjerat, me njëfarë vlere mediokre, zihen në gojë për një kohë, kurse ato që s'vlejnë, rrëzohen krejtësisht dhe askush s'flet më për to. Pra mund të bësh sa të duash përpjekje për të imponuar një vepër që nuk e meriton, por ajo nuk e ka jetën të gjatë. E kundërta është po aq e vërtetë, bëj çfarë të duash, organizo *cabale*<sup>1</sup>, sajo kritika të paqena me frymë ambicieje e denigrimi për një vepër të mirë, megjithatë kjo nuk zhduket dot, nuk i ulet vlera, por i reziston çdo veprimi dhe, më në fund, imponohet me vlerat e saj të mëdha.

Mendoj se një vepër, e çdo gjinie qoftë, ka anët e mira, ka edhe anët e saj të dobëta. Pikërisht për këtë është e nevojshme kritika, por jo kritika denigruese, e shtyrë nga ambiciet dhe ndjenjat e tjera të sëmurë, por kritika e drejtë, objektive, konstruktive.

Nuk kam asnjë pretendim që në këto pak mendi-

---

1. Frëngjisht — intrigë.

me të thjeshta që po shfaq, të vihem në rolin e kritikut letrar dhe të hiqem si i tillë. Jo, s'jam i kësaj kategorie, por mendoj se një vepër, e çfarëdo gjinie qoftë, duhet të ketë thelbin e vet në rrugën e drejtë politike, ideologjike, morale dhe të paraqitë realisht gjendjen, anët e përgjithshme e tipike të saj. Vepra, në radhë të parë, duhet t'i frymëzojë, t'i edukojë dhe t'i entuziazmojë lexuesit. Forca dhe intensiteti me të cilët do ta bëjë ajo këtë, varen nga thellësia e brendisë ideologjike dhe e formave, e stilit, e figurave, e ngjyrave etj., që përdor autori.

Klasikët tanë të mëdhenj, Marksí, Engelsi, Lenini dhe Stalini, në veprën e tyre kolosale kanë trajtuar edhe problemet e letërsisë e të arteve. Revizionistët dhe trockistët përpiqen ta minimizojnë këtë kontribut të madh të klasikëve. Një gjë të tillë ata e bëjnë me qëllim që të hapin fushë të gjerë për qelbësitat e tyre të të gjitha gjinive që po lëshojnë si rrëqe nga të katër anët.

Unë i këshilloj shkrimtarët e artistët, veçanërisht kritikët letrarë dhe kritikët e arteve, që, krahas studimit të teorisë marksiste-leniniste, të lexojnë me shumë kujdes, në veçanti ato raste jo të pakta, ku klasikët tanë bëjnë kritika për shkrimtarë dhe artistë. Ato janë analiza të thella dhe model për ne se si duhet ta gjejnë një vepër letraro-artistike.

Nuk dua të hyj në hollësitë e një kritiku, siç e thashë më lart, por, të më falin, një kritikë dëshiroj t'ua bëj kritikëve tanë letrarë. Kritika e tyre disa herë nuk është as e thjeshtë, as e kuptueshme, pra jo kurdoherë e kapshme nga ata që e lexojnë dhe duan të

mësojnë. Në mjaft nga këto kritika ka shumë frazeologji, mbytet ajo që duhet të vihet në dukje në një analizë lumë dhe shpesh përdoren fraza e terminologji të stërholluara dhe «specifike» për të dhënë përshtypjen e «kompetencës» dhe se gjoja i kanë nxjerrë ujë veprës. Por duke vepruar kështu, këta harrojnë lexuesin, tek i cili kjo lloj kritike është pa efekt të madh. Në qoftë se mund të jap një këshillë, kjo është braktisja nga kritikët tanë e prirjeve, po të shfaqen këto te disa prej tyre, për të imituar kritikët modernistë borgjezë të kohëve të sotme që i bëjnë kritikën e tyre të errëta, konfuzë e çoroditëse, nën maskën e asaj që kritikën t'ua përshtatin gjoja veprave të kohës.

Edhe në lëmin e kritikës letrare dhe artistike të borgjezisë në kohë të ndryshme, ne do të shohim stadi dhe forma të ndryshme të saj. Pa u ngjitur në kritikën aq therëse, aq të thella, sa edhe të thjeshta e të kuptueshme të Volterit, por edhe të kritikëve të dekadave të para të shekullit tonë, do të vërejmë se ato nuk kanë qenë «të alambikuara», si me thënë, «të dredhura e të përdredhura», siç kanë degjeneruar arti, letërsia dhe kritika borgjeze e revizioniste aktuale.

Kritika jonë letraro-artistike duhet të frymëzohet dhe të ndjekë rrugën parimore të klasikëve të mëdhenj dhe të Partisë sonë. Kritikët tanë të jenë realistë, ashtu siç janë veprat që analizojnë, të jenë të thjeshtë, të kuptueshëm, koncizë dhe të kapshëm nga publiku. Kritika duhet të jetë edukuese, prandaj ai që e bën atë nuk duhet ta quajë veten sikur flet nga «maja e Olimp-it», por ta konsiderojë autorin e një vepre si shok që

i flet shokut për ta këshilluar kurdoherë për të mirë.

Duhet pasur edhe një çikë takt, shokë, në ndihmën që do t'u jepet atyre që krijojnë. Të kemi parasysh psikologjinë e njerëzve, ndjenjat e tyre. Vërejtja që u bë këtu për sa u përket kritikave subjektive, është me vend. Nganjëherë kritikën që bëhen për veprat letrare ose muzikore janë të ekzagjeruara dhe subjektive. Nga shkrimtarët, nga poetët dhe nga artistët tanë ne duhet të kërkojmë që brendia, thelbi i veprës, të jetë në rrugë të drejtë partie dhe të nxitet nga një frymëzim i shëndoshë revolucionar në shërbim të socializmit. Kjo është kryesorja që duhet të kenë parasysh autorët tanë në krijimtarinë e tyre. Pastaj se si do t'i ndërtojë njëri ose tjetri temën që ka zgjedhur, personazhet, është puna e shkrimtarit, e poetit, e muzikantit. Ai, më mirë se kushdo, i gjen vetë figurat artistike që i pëlqejnë, di cili moment duhet nënvizuar për ta forcuar më tepër boshtin ideopolitik të veprës etj. Për çështje si këto secili duhet të vendosë vetë. Nuk do të ishte aspak e rekomandueshme që dikush t'i thoshte, për shembull, një shkrimtari ose një tjetri: «Sikur t'i heqësh këtë ide ose varg e t'i shtosh atë tjetrin, sikur ta shkurtosh pak këtu e ta zgjatësh atje, të heqësh këtë figurë artistike e të vësh një tjetër» etj. Në një rast të tillë shkrimtari do të kishte të drejtë t'i thoshte bashkëbiseduesit: «Atëherë bëje më mirë vetë ti një vjershë ashtu si të pëlqen dhe mua mos më ngatërro!». Nuk duhet tepruar duke ndërhyrë me kritika pa vend të veprave letraro-artistike, sepse një ndërhyrje e tillë subjektive nuk është ndihmë, por masakrim. Kritikën nuk duhet të

bëhen në këtë mënyrë. Në qoftë se do t'i lëmë të tjerët të bëjnë vërejtje pas vërejtjesh pa mbarim për botimin e një vjershe, të një pjese teatrale etj., vepra do të dalë për lumë e do të kthehet në një «sallatë ruse». Veçanërisht të kemi shumë kujdes që me letrarët e rinj të bëjmë një politikë të drejtë ndihme e kritike, në kuptimin që ata as t'i tulatim, as t'i trembim, duke u folur në mënyrë të prerë: «Poezia jote nuk vlen», «Shkrimi yt është fare i dobët» etj. Të kemi, gjithashtu, parasysh edhe anën tjetër, që të mos i mburrim pa bazë, sepse kështu mund «të fluturojnë». Qëllimi është t'i ndihmojmë të ecin përpara, që këta, si gjithë të tjerët, t'i shërbejnë me devotshmëri pullit.

Me pak fjalë, kur një vepër është e drejtë në vijë dhe vlerat artistike nuk i mungojnë, por që mund të çalojë diku për sa i përket këtij ose atij aspekti, nuk duhet ngurruar shumë për ta botuar, për ta ekspozuar, për ta ekzekutuar ose për ta vënë në skenë. Por dua të ritheksoj se nuk do të ishte me vend dhe e drejtë që, nga ana tjetër, njerëzit e letërsisë dhe të arteve të mbajnin qëndrim mospërfillës ndaj kritikave e sugjerimeve të drejta, me karakter esencial ideologjik e artistik, që u bëhen nga kritikët ose lexuesit.

Teatri ynë, qoftë ai dramatik, qoftë ai i operës dhe i baletit, ka fituar eksperiencë dhe ka krijuar një traditë, por asnjëherë nuk duhen pushuar përpjekjet për të gjetur mjete dhe mënyra të tjera më të reja e me frymë revolucionare, për ta pasuruar dhe për ta bërë më të përsosur këtë eksperiencë dhe traditë. Teatri

duhet të pasqyrojë realitetin tonë revolucionar, kërkesat e klasës punëtore dhe të fshatarësisë kooperativiste për të konsoliduar shoqërinë e re. Natyrisht, teatri për ne është një armë politike dhe ideologjike për edukimin e njerëzve, prandaj ai duhet të jetë i kuptueshëm dhe, që të jetë i tillë, duhet të shprehë ndjenjat dhe dëshirat e tyre.

Është e domosdoshme që dramaturgjia jonë të ngrihet në një nivel sa më të përsosur, t'u largohet banaliteteve, dhe jo vetëm t'i përgjigjet shkallës së sotme të kulturës së masave që frekuentojnë këtë teatër, por ky të jetë njëkohësisht frymëzuesi i një përparimi të mëtejshëm të shijeve dhe të hovit revolucionar për një jetë më të kulturuar.

Ne, natyrisht, jemi kundër artit dramatik modernist, që përpiqet t'i inkuadrojë dhe t'i robërojë njerëzit në shoqërinë e konsumit, t'i privojë ata nga ndjenjat e pastra dhe nga një moral njerëzor revolucionar në mendime dhe në veprime.

Sigurisht, teatri ynë revolucionar nuk ka dhe nuk mund të ketë tiparet individuale të një artisti, por tiparet më të mira të masës, të shoqërisë sonë socialiste. Kjo nuk do të thotë aspak, siç pretendon borgjezia me «teoritë» e saj për teatrin, se teatri ynë revolucionar i ul, i nënvleftëson ose i zhduk fare personalitetin dhe talentin krijues të artistit. Përkundrazi, teatri ynë revolucionar u hap artistëve një fushë aq të gjerë ndjenjash e mendimesh që pasurojnë shumë shpirtin e tyre dhe mundësitë e tyre të krijimit.

Bota e brendshme e artistëve tanë nuk i njeh ato

kufizime që i imponohen artistit në shoqërinë borgjeze. Të tillë artistë në shoqërinë borgjeze kanë vetëm iluzionin e një «lirie krijimi», kurse në të vërtetë veprimtaria e tyre është e kushtëzuar dhe, natyrisht, e orientuar nga realiteti borgjez, nga një jetë plot me fenomene anormale, amoralë, ekstravagante. Pikërisht janë këto fenomene çoroditëse dhe ekstravaganca që u japin shkrimtarëve ose artistëve borgjezë përshtypjen e «lirisë në krijimtari». Sallat e errëta të kinemave dhe të teatrove të tyre janë të pushtuara nga qëllimi për të krijuar ankth në zemrat e spektatorëve, që ky ankth t'u qepet pas trupit gjithë ditën e tërë javën dhe t'u bëhet një jetë e dytë. Këtë përmbajtje, këtë qëllim, këtë formë dhe këtë estetikë i hedh poshtë dhe i lufton estetika jonë revolucionare, e frymëzuar nga ndjenjat e pastra të popullit dhe për t'u shërbyer masave të popullit.

Në këtë vështrim ne duhet t'i japim një impuls të madh edhe artit popullor nëpërmjet zhvillimit të lëvizjes artistike të amatorëve, dhe me këtë të mos kuptojmë vetëm këngët dhe vallet popullore. Këto dy gjini të dashura nga populli duhet t'i zgjerojmë dhe t'i pasurojmë.

Ne kemi tani njerëz të zotë të penës. Unë nuk them që këta të mos shkruajnë romane e poema, sepse ato janë ushqim i shëndoshë e i domosdoshëm për edukimin e njerëzve tanë të shoqërisë socialiste, por vë re se ka prirje të theksuar në njerëzit e letërsisë që të ndjekin rrugën e atyre që kanë çarë në krijimtari me romane e poezi dhe një prirje nënvleftësimi e mosinteresimi për të shkruar edhe drama, librete e skenarë filmash dhe skeçe për estradat. Kam dëgjuar të thuhet:



«Ç'të bëjmë, me pahir nuk mund të shkruhet», «s'ka prirje, s'ka talente për këto gjini». Sa mendime pa baza dhe të dëmshme! Këta njerëz bëjnë një gabim të madh, pasi lënë pas dore ose, ca më keq, i nënvleftësojnë këto gjini, që kanë, gjithashtu, një rëndësi të pallogaritshme për edukimin e njerëzve tanë. Edhe ata që kanë pasur prirje për gjini të tilla dhe që janë shquar në këtë fushë të krijimtarisë letrare e artistike, kanë filluar pak nga pak ta neglizhojnë. Teatrot shohim të mbushen plot. Kinematë, po kështu, edhe këto çdo natë janë plot. Por ç'të shohin spektatorët? Repertorët janë të vjetër, jo në kuptimin se nuk bëjnë, por nuk kanë subjekte të reja. Filma bëjmë pak, shumë pak. Të mos pretendojmë të kemi pjesë teatrale të hartuara në mënyrë të përsosur. Një kërkesë e tillë do të na çonte, me siguri, drejt mbylljes së teatrit dhe do të na bënte të shikojmë ditë e natë, siç po shohim, dramatizimin e romanit «Zekthi». Përse të mos vëmë më shumë ndonjë nga veprat tona, por të ngulim këmbë gjithnjë me «Zekthin», sa na ka mbirë në sy duke e parë ngaherë në televizor? «Zekthi», me subjekt nga historia e karbonarëve, nuk ka ndonjë vlerë aq të madhe sa për t'u vënë kaq shumë në dukje.

Kinematë tona po vënë në ekran filma të këqij të huaj, kapitalistë e revizionistë. Si durohet nga njerëzit tanë që të jepen për t'u shfaqur filma revizionistë çekoslovakë, rumunë ose hungarezë, si, për shembull, «Si u bëra polic» e të tjera qelbësira? Jo vetëm zgjedhja e filmave të jashtëm bëhet keq, gjë që sjell shumë dëme në edukimin e njerëzve dhe të rinisë sonë, por

jepen arsye bajate: «Ç'të bëjmë, s'kemi filma», thonë. Mendimi im është se filmat që prodhon kinostudioja jonë janë shumë të mirë, janë të mrekullueshëm në krahasim me ata që na servirin nga jashtë, me banditë dhe me kauboj.

Ne kemi artistë të mrekullueshëm, që, pa ngurruar aspak, i quaj të kalibrit botëror. Dhe këtu kam parasysh jo vetëm aktorë të vjetër, si: Sandër Prosi, Pjetër Gjoka, Naim Frashëri, Tinka Kurti, Ndreko Luca, Pandi Raidhi, Skënder Sallaku e të tjerë, por edhe më të rinj, si: Rikard Ljarja, Demir Hyskja e disa të tjerë, djem e vajza që s'ua kam mësuar akoma emrat. Me këta aktorë të mrekullueshëm e regjisorë me talent që kemi, jo të bëjmë nja dy a tre filma në vit, por shumë më tepër<sup>1</sup>, mjaft që t'u përgatitim skenarët dhe kushtet e punës e të jetesës së tyre. Këto janë thesare për ne, por nuk dimë t'i përdorim si duhet.

Ne kemi këngëtarë të mrekullueshëm, të cilët i quajmë të operës. Kështu qofshin, por këta dhe këngëtarë të estradave, si dhe këngëtarë të dalë nga populli, e kënaqin shumë publikun me koncertet që japin. Mirëpo këta artistë të mëdhenj dhe të tjerë më pak të mëdhenj se këta a nuk mund të luajnë në filma, nuk mund të xhirohen me ta filma nëpërmjet të cilëve t'i këndojnë kësaj jete kaq të bukur që lulëzon përpara

---

1. Pas fjalës së 20 dhjetorit të shokut Enver Hoxha, numri i filmave artistikë të prodhuar nga kinostudioja «Shqipëria e re» u dyfishua. Në vitin 1986 u realizuan 13 filma artistikë, përveç 40 dokumentarëve dhe 16 filmave vizatimorë.

syve tanë, kësaj jete që po ndërtojmë me duart tona? Sigurisht që mundet.

Nuk duhet në asnjë mënyrë që estradat e rretheve të kufizohen me disa këngë, me disa skeçe që japin në qytetet ku janë ngritur. Mendimi im është se estradat dhe teatrot profesionistë të rretheve duhet të kthehen në qendra e në mjete të fuqishme organizuese e propaganduese, për t'i dhënë një zhvillim të madh si në gjerësi, edhe në cilësi ngritjes së teatrove dhe të estradave në qendra pune, shkolla, dhe sidomos në kooperativat bujqësore.

Entuziazmohemi shumë kur në skenat e Teatrit të Operës e të Baletit të kryeqytetit, në koncertet dhe në estradat e rretheve, shohim të marrin pjesë me qindra e me qindra vajza dhe djem të rinj që luajnë në mënyrë aq të përsosur dhe këndojnë me një zë aq të harmonishëm, melodioz e të përpunuar, sa harron që ata janë tornitorë, që janë punëtorë të ndërmarrjes artistike «Migjeni» ose të kombinatit «Stalin», se janë leshpunuese nga Kukësi, studente nga Shkodra ose nxënëse nga Gramshi.

Sa zhvillim të madh ka arritur arti ynë! Këta njerëz të rinj të talentuar janë në gjendje të luajnë me plot ndjenja e me patos në pjesë teatrale, të luajnë role të rëndësishme në filma, të mësojnë të këndojnë këngë e të kërcëjnë valle të ndryshme. E kam fjalën për të gjithë ata që janë pa shkollë artistike. Shkolla ne kemi hapur dhe do t'i zgjerojmë, por të mos harrojmë dhe të mos nënvleftësojmë artin e madh, që ndodhet si një thesar i çmuar në gjirin e popullit e që po zhvillohet

dita-ditës drejt lartësive të reja. Këtë ne duhet ta organizojmë edhe më mirë.

Jam në dijeni për udhëzimet e dhëna, sipas të cilave estradat dhe teatrot tanë profesionistë të qyteteve duhet të japin shfaqje edhe në fshatra. Por, nga sa kam dëgjuar, këto institucione akoma nuk po e zbatojnë si duhet këtë direktivë të Partisë, pasi edhe sot ato japin pak shfaqje nëpër fshatra, shumicën e të cilave e japin më tepër në fshatrat e afërta të qyteteve. Është detyra e tyre që teatrot dhe estradat tona profesioniste ta shtrijnë veprimtarinë edhe në zonat më të largëta, duke e mbuluar kudo fshatin tonë me shfaqjet e tyre artistike.

Sot, kudo, në të gjitha kooperativat bujqësore të vendit, ka grupe këngëtarësh e valltarësh të shquar popullorë, ka e dalin dita-ditës instrumentistë të talentuar, që i kënaqin dhe i edukojnë masat e gjera të kooperativistëve me ekzekutimin e pjesëve që luajnë. S'ka asnjë dyshim se në fshatra, krahas tyre, ka edhe talente me prirje për artin dramatik, njerëz të zotë në këtë fushë, humoristë të hollë, me të cilët mund të krijohen, gjithashtu, grupe në çdo kooperativë bujqësore, për të dhënë atje edhe shfaqje teatrale e estrade. Prandaj teatrot profesionistë të qyteteve dhe të estradave, kur venë në fshatra, t'i zbulojnë këto talente në gjirin e masave, t'i nxitin e t'i inkurajojnë dhe të organizojnë me to trupa teatrale amatore, t'i ndihmojnë për t'i organizuar e për t'i mëkëmbur, të caktojnë nga njerëzit e tyre drejtues artistikë që t'i kenë nën kujdestari për t'i ndihmuar derisa të ecin me këmbët e veta. Kështu,

në fshatin tonë socialist do të lulëzojnë edhe arti dramatik amator, do të rriten njerëz e talente të reja, që do të pasurojnë edhe skenat, edhe repertorin e teatrove tanë profesionistë.

Mësuesit dhe mësueset që punojnë në kooperativat bujqësore, komunistë dhe të paorganizuar në Parti, djem e vasha artdashëse, duhet të ndihmojnë në zgjerimin e veprimtarisë artistike në fshat. Shtëpitë e kulturës në kooperativa të bëhen me tërë kuptimin e fjalës qendra të vërteta kulturore. Shihni si i kërcejnë e si i këndojnë njerëzit tanë me një talent të madh vallet dhe këngët popullore! Këta kooperativistë dhe kooperativiste janë të aftë të luajnë edhe pjesë teatrale, ata e njohin mirë jetën dhe, po t'i organizojmë si duhet, do të ndiejnë një kënaqësi të madhe për vete, do t'i kënaqin e do t'i gëzojnë edhe të tjerët.

Por ne duhet të shkojmë edhe më tej. Në gjirin e popullit kanë dalë në çdo periudhë artistë të talentuar, bile duke qenë edhe analfabetë, që kanë krijuar vepra me vlerë të madhe artistike, ndër to edhe kryevepra. Po tani, që të gjithë të rinjtë e të rejat janë me shkollë 7 dhe 8-vjeçare, nuk mund të ngjasë kjo? Me siguri që po. Të punojmë, pra, t'i kërkojmë, t'i nxitim, t'i përkrahim kudo ku janë, në qendra pune, prodhimi e në fshatra, dhe atëherë do të kemi shumë kooperativistë, tornitorë, tekstiliste e punonjëse si ato të «Migjenit», që të krijojnë punime artistike aq të bukura, saqë do të entuziazmojnë e do të frymëzojnë edhe artistët profesionistë. Të çajmë muret e ngrira të akademizmit, të formave të ngurta, të shkrijmë aku-

llin që mban mbërthyer kaq talente të reja, pasi gjoja duhet shkollë për këtë, duhet shkollë për atë etj. Partia nuk është kundër shkollës, por edhe kur s'kemi pasur shkolla të veçanta të poezisë, të muzikës, të pikurës etj., populli ka krijuar e vazhdon të krijojë, të nxjerrë nga gjiri i vet talente të mrekullueshme.

Personalisht ndiej një kënaqësi kur dëgjoj muzikë, qoftë atë të kompozitorëve të mëdhenj klasikë e përparimtarë të botës, qoftë krijimet muzikore të kompozitorëve tanë. Por, të them të drejtën, këngët dhe vallet e bukura të popullit më pëlqejnë më shumë, më emocionojnë me bukurinë, me forcën dhe, njëkohësisht, me thjeshtësinë e tyre. Nuk flas kështu vetëm për faktin se jam shqiptar. Jo, por sepse këngët e vallet tona popullore janë me të vërtetë të bukura, shumë të bukura. Partia ka bërë një vepër të madhe që ngriti në një pedestal të lartë dhe përjetësoi gjithë këtë pasuri të rrallë që kemi trashëguar nga e kaluara. Ajo, që në vitet e para të Çlirimit, kur populli ishte akoma i varfër dhe jetonte me privacione të mëdha, iu vu me forcë kësaj pune, duke ngulur këmbë që të prodhoheshin instrumente popullore, të mos lireshin pas dore këngët e vallet popullore. Ju kujtohet, shokë, kur u dhanë udhëzime për këto çështje? Dhe këngët e instrumentet popullore janë bërë sot një ushqim shpirtëror shumë i shëndetshëm për masat tona punonjëse dhe për rininë tonë.

Në qoftë se shkrimtari a poeti dëshiron të shkruajë, ose muzikanti të kompozojë një pjesë muzikore me një frymëzim të madh për mjerimin e popullit

shqiptar në të kaluarën dhe për gëzimet e tij, le t'u drejtohet këngëve dhe melodive të popullit, në të cilat do të gjejë një burim të fuqishëm frymëzimi. Kujtoni, bie fjala, këngën «Mbeçë, more shokë, mbeçë», që edhe Dritëro Agolli e ka futur në poemën e tij «Nënë Shqipëri». Kjo është një këngë me vlerë jo vetëm për fjalët e zgjedhura me mjeshtëri të rrallë artistike, për fuqinë e saj të madhe shpirtërore, por edhe për faktin se në brendinë e saj pasqyron në mënyrë shumë sintetike të kaluarën e mjeruar të popullit shqiptar. Nuk ngopesh së dëgjuari këtë këngë të interpretuar me një mjeshtëri aq të rrallë nga këngëtarët popullorë të rrethit të Skraparit Demir Zyko e Medi Kushi me shokë.

Populli ynë ka qenë kurdoherë optimist. Edhe kur ka qarë, edhe në gëzime, ai nuk e ka humbur kurrë besimin në të ardhmen, dhe ky optimizëm, kjo madhështi e tij janë përjetësuar në trashëgiminë e pasur të letërsisë gojore, në këngët, në vallet, në kostumet dhe në traditat e tjera të mrekullueshme të tij. Kjo është diçka madhështore, që e realizon në art në mënyrë të përkryer vetëm gjenia e popullit.

Ndonjëherë shoh në televizor koncerte që japin grupet e këngëtarëve popullorë të rretheve të ndryshme. Në mes tyre ka shumë pjesë me të vërtetë të larta e të bukura, nga përmbajtja dhe nga melodia. Në mjaft raste kam vënë re se është arritur të bëhet një thurje logjike e tërheqëse në mes formës së melodisë popullore dhe përmbajtjes së re të këngëve. Kështu, për shembull, më pëlqejnë fort këngët që këndon me aq ndjenjë e dashuri këngëtarja popullore Fatime Sokoli

për heroin e Dragobisë Bajram Curri e për trimëritë e popullit luftëtar të atyre anëve. Në një emision të televizionit më pëlqyen mjaft, gjithashtu, disa këngë që i kënduan këngëtarë popullorë të qytetit të Kavajës për vajzat duararta që endin qilimat, për punëtorët dhe punëtorët e fabrikës së qelqit që pikturojnë në vazo trëndafila aq të bukur sa, kur dëgjoje këngën, të dukej sikur kishe përpara dhe ndieje aromën e këndshme të trëndafilave. Në një emision tjetër dëgjova të këndonin edhe këngëtarë nga Elbasani, qytet me tradita muzikore, ku qysh para 60 vjetësh ka qenë ngritur Shkolla Normale, një nga institucionet arsimore të rëndësishme, që, veç një armate të tërë mësuesish patriotë, ka nxjerrë edhe muzikantë e kompozitorë. Por, të them të drejtën, meloditë «e përpunuara» të festivalit të këngës popullore të këtij rrethi, pa dashur t'i nënvleftësoj, m'u dukën të varfra e të ftohta në krahasim me koloritin, freskinë dhe bukurinë e këngëve plot frymëzim të artit popullor. Kjo nuk do të thotë që kompozitorët tanë të heqin dorë nga «përpunimi» i këngëve ose i valleve popullore, nga muzika e kultivuar, si i thonë, por këto «përpunime» e «kultivime» të jenë kurdoherë të mbështetura jo vetëm aty-këtu me një akord a motiv në trashëgiminë kombëtare, por të jenë të mbrujtura me baltën e kësaj toke, të jenë të frymëzuara nga krijimtaria, puna e aspiratat e këtij populli dhe atij t'i kushtohen, atij t'i pëlqejnë, atë ta ngrenë peshë. Po u largove nga ky taban, as popullit tënd nuk i shërben, por as popujt e tjerë s'kanë pse të të vlerësojnë, sepse nuk sjell gjë



të re në thesarin e përbashkët të kulturës e të artit përparimtar botëror.

Një natë tjetër dëgjova në televizor interpretimin e disa motiveve popullore në violonçel dhe në piano. Jo vetëm u kënaqa shumë, por thashë: Ja sa bukur mund të zhvillohet muzika jonë e kultivuar mbi bazën e motiveve popullore!

Në këtë rrugë të drejtë janë krijuar vepra me vlerë, si ato të kompozuar nga Çesk Zadeja, Tish Daija e shumë të tjerë. Këngë si ajo «Për ty, atdhe», kompozuar nga Pjetër Gaci dhe interpretuar nga Artisti i Popullit Mentor Xhemali, do të mbeten të pavdekshme në thesarin e artit tonë të ri. Kjo këngë është një himn për atdheun tonë socialist, për popullin e Partinë tonë të pamposhtur. Ajo lindi në momentet e vështira të bllokadës revizioniste, atë e përshkon një frymë e lartë revolucionare e optimiste. Të mos them çdo ditë, por në dy-tri ditë, në momente gëzimi ose vështirësish, mua më pëlqen ta dëgjoj në magnetofonin tim dhe kurdoherë më emocionon e më frymëzon në punë.

Kështu ndodh edhe me shumë këngë të tjera të bukura, si të Avni Mulës me shokë, që aq shumë i do dhe i këndon publiku, që interpretohen me aq mjeshtëri të lartë, me aq patos e ndjenja jo vetëm nga këngëtarë të njohur e të talentuar, si: Ramiz Kovaçi, Gaqo Çako, Vaçe Zela e të tjerë, por edhe nga këngëtarë e këngëtare të reja, profesioniste e joprofesioniste, si: Zeliha Sina, Ema Qazimi, Shyqyri Alushi, këngëtarja e vogël Violeta Zefi e shumë të tjerë.

Në asnjë mënyrë të mos heqim dorë nga këngët po-

pullore, përkundrazi, të përpiqemi që kompozitorët tanë të mbështeten fort pikërisht në këto këngë. Nuk është me vend që në shkollën e mesme artistike «Jordan Misja» nxënësit të nisin të mësojnë më përpara muzikën klasike të huaj e pastaj muzikën popullore shqiptare. Vërejtja që bëri për këtë çështje shoku Ramiz është shumë e drejtë. Sado t'ua mësojnë nxënësve muzikën e huaj, ata nuk e arrijnë, për shembull, Listin, i cili, edhe ky u bë kompozitor i famshëm pikërisht sepse diti t'i gjallërojë rapsoditë popullore hungareze. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Shopenin, Bizenë e të tjerë, që u bënë të dëgjuar duke pasur për bazë muzikën e popullit.

Jeta e gjerë dhe e larmishme e vendit tonë kërkon me shumicë njerëz që të merren me artin, me muzikën. T'i zbulojmë, t'i përkrahim e t'i nxjerrim ata në skenë dhe nga skena do të ketë prej tyre që do të shquhen e do të dërgohen në shkolla speciale dhe përsëri do të kthehen me shumicë në gjirin e popullit tonë artdashës.

Partia jonë dëshiron dhe përpiqet që çdo vepër që del në dritë, të jetë sa më e përsosur nga të gjitha anët, mirëpo përsosmëria nuk është një punë e lehtë, ajo do kohë, kërkon përvojë, kërkon edhe aftësi, të cilat nuk lindin me njeriun, por zhvillohen dhe përpunohen gjatë procesit të edukimit të vazhdueshëm të prirjeve të tij. Njerëzit kanë shumë prirje, që duhen shfrytëzuar e që duhen zhvilluar, për të mirën e shoqërisë sonë socialiste. Në këtë drejtim, si në çdo gjë, Partia duhet të luajë rolin vendimtar, jo vetëm nga ana materiale, por sido-

mos nga ana ideore, duke i frymëzuar njerëzit me ideologjinë e saj, me marksizëm-leninizmin. Poetët, shkrimtarët, muzikantët e të tjerë, të gjithë artistët tanë ta mësojnë marksizëm-leninizmin jo vetëm nga librat, por edhe në jetë, atje ku ai zbatohet konkretisht nga populli. Libri ka rëndësi të madhe për informimin dhe për edukimin e njeriut, prandaj njerëzit tanë duhet të kenë edhe libra dhe t'i lexojnë ata me zell. Por frymëzimi i njerëzve, formimi i botëkuptimit dhe edukimi i tyre nuk duhen kufizuar vetëm me libra. Ca më tepër njerëzve të paformuar ideologjikisht e politikisht, që kanë edhe prirje ekstravagante, në kundërshtim me orientimet e Partisë, nuk duhet t'u japim në duar çfarëdo librash, sidomos nga ata me përmbajtje të dëmshme, me helme, pasi kjo ndikon negativisht në formimin e tyre. Lexuesve tanë ne duhet t'u sigurojmë atë literaturë që ka karakter revolucionar. Mirëpo duhet të kemi parasysh se ka shkrimtarë të vendeve të tjera që kërkojnë ngritjen e klasës punëtore në revolucion, por revolucionin ata nuk e kuptojnë si marksistët; si pasojë, shtjellimin e çështjes së revolucionit, në prozë a në poezi, nuk janë në gjendje ta trajtojnë si shkrimtarët, poetët dhe artistët tanë. Prandaj ne të kemi shumë kujdes që artistët dhe shkrimtarët tanë të rinj t'i brumosim kurdoherë e vazhdimisht me idetë e marksizëm-leninizmit, me qëllim që, nën udhëheqjen e Partisë, ata të piquen, të krijojnë për popullin dhe të mendojnë si populli. Duke vepruar kështu do të shohim sa fryte të mëdha e të shëndetshme do të kemi.

Në krijimtarinë tonë letrare të pasqirimit janë

shquar shumë shkrimtarë dhe poetë shqiptarë. Me kohë një pjesë e mirë e tyre janë afirmuar, prandaj veprat me vlerë që kanë nxjerrë ata dhe që na pëlqejnë aq shumë, mendoj të bëhen objekt studimi jo në mënyrë diletante, por sistematike. Më kujtohet se si në shkollën frënge, që kam mbaruar, na i mësonin mirë, në mënyrë sistematike e me themel, veprat e shkrimtarëve dhe të poetëve francezë. Por talent të mrekullueshëm kanë edhe poetët e shkrimtarët tanë, që janë të lidhur ngushtë me popullin, që frymëzohen e mësojnë prej tij dhe, mbi këtë truall të shëndoshë, krijojnë vepra popullore me vlera ideoartistike. Prandaj krijimet e këtyre është e domosdoshme jo të lexohen shkel e shko, sa për të shkuar radhën, jo me t'i kënduar një herë e të vendosen në raft, por të studiohen me vëmendje e me këmbëngulje, pasi në to pasqyrohet realiteti i madh i jetës, heroizmi i popullit tonë që ndërton socializmin.

Krijimet e bukura të shkrimtarëve tanë nuk na pëlqejnë vetëm neve; ato u pëlqejnë edhe të huajve. Nuk e kam fjalën këtu vetëm për romanet e Ismail Kadaresë, ose për poemat e Dritëro Agollit dhe të disa letrarëve tanë të tjerë, që janë përkthyer në gjuhë të huaja, por edhe për veprat e shumë shkrimtarëve e poetëve të tjerë. Në rast se arrijmë të përgatitim vetë përkthyes të zotë në gjuhët e huaja (pasi gjuhën tonë të bukur të huajt kurdoherë e kanë injoruar, kjo është arsyeja që nuk gjen në vende të tjera zotërues të mirë të gjuhës shqipe), ne do të kemi shumë sukses në popullarizimin e krijimtarisë letraro-artistike shqiptare jashtë atdheut. Prandaj le t'i vihemi punës që vetë ne të përgatitim

kuadro që të zotërojnë mirë gjuhë të tjera, për të përkthyer në to veprat e shkrimtarëve tanë.

Jemi informuar se ekspozita «Arti shqiptar në shekuj» që hapëm në Paris, ka ngjallur një jehonë të jash-tëzakonshme në publikun përparimtar francez. Na kanë njoftuar se me mijëra e me mijëra njerëz, duke përfshirë kritikë, letrarë, artistë, filozofë, diplomatë e të tjerë kanë vajtur me ëndje për ta vizituar ekspozitën tonë, të cilën e kanë vlerësuar si një nga më të mirat që janë organizuar në kryeqytetin frëng. Vizitorët e saj janë habitur me zhvillimin e artit tonë, ashtu siç u habitën spektatorët e huaj me Festivalin e Dytë Kombëtar Folklorik të Gjirokastrës, kur e panë në film, ose para disa vjetësh me muzikën e vallet tona popullore në festivalin e Dizhonit, ku u paraqit arti ynë i mrekullueshëm popullor. Mendoni kur të huajt të kenë tekste të përkthyer në një nivel të lartë me poezi ose proza të poetëve e të shkrimtarëve tanë, ata do të njohin e do të zbulojnë shumë anë të jetës materiale e shpirtërore të popullit tonë, që ndërton jetën e re të një shoqërie me të vërtetë socialiste.

Pra në këtë drejtim duhet të punojmë me të gjitha forcat. Nuk mjafton ta propagandojmë jashtë shtetit madhështinë e popullit shqiptar vetëm në fushën e traditave kombëtare, por t'i bëjmë të njohur opinionit botëror edhe luftën e punën e madhe të Partisë, të kësaj partie marksiste-leniniste që po ndërton socializmin në vendin e vet pa u trembur aspak nga lufta e gjithanshme që i bëjnë borgjezia dhe revizionistët modernë. Ne duhet të bëjmë që bota borgjezo-revizioniste ta shi-

kojë forcën e madhe të marksizëm-leninizmit në Shqipëri jo vetëm në fushën ekonomike, por edhe në ato të artit e të kulturës. Ne ndërtojmë në të gjitha drejtimet me maksimumin e mundësive që kemi, gjë që edhe miqtë e shikojnë në veprat e realizuara dhe frymëzohen me heroizmin e popullit tonë.

Ka mjaft të huaj që, edhe pse janë borgjezë, flasin mirë për vendin tonë. Shqipëria për të huajt në të kaluarën ka qenë një «fushë e shkretë», për të cilën s'dinin asgjë. Kur tani ata shohin zhvillimin e arkeologjisë sonë dhe nivelin shkencor të kërkimeve tona në këtë fushë, habiten e thonë: «Si është e mundur që në këtë vend të kenë qenë fshehur gjithë këto thesare?! Mirë që i keni zbuluar vetë, na thonë, sepse, po të kishit kërkuar ndihmën e të tjerëve, do t'jua kishin grabitur».

Ka në botën e jashtme njerëz të pajisur me një kulturë të madhe artistike, që njohin, si i thonë fjalës, në majë të gishtave, kulturën dhe artin bizantin, për shembull. Vlerësimi që këta kritikë u bëjnë tablove murale të Onufrit dhe veprave të autorëve të tjerë shqiptarë, është jashtëzakonisht i lartë. Ata nuk shohin në këto krijime artistike plasticitetin e artit bizantin. Në pikturat, në ngjyrat e deri në gërxfet e truallit tonë që pasqyrohen në to, ata vërejnë një gjallëri të veçantë. «Edhe shenjtorët, thonë ata, kanë fytyra njerëzish dhe paraqiten si shqiponjat nëpër male».

Kaq kisha për të thënë për disa nga çështjet që u ngritën në këtë mbledhje. U urojmë të gjithë punonjësvë të frontit të letërsisë dhe të arteve suksese edhe më të mëdha në zbatimin e detyrave të Plenumit të 4-t

të Komitetit Qendror të Partisë, si dhe të detyrave të tjera që kanë shtruar Partia, populli e ndërtimi socialist para letërsisë e arteve.

Më vjen keq që akoma nuk kam mundur ta shikoj ekspozitën e arteve figurative, e cila u hap me rastin e 30-vjetorit të Çlirimit, sepse më kanë penguar punët e shumta që i dini, shokë; megjithëkëtë, do të gjej rastin dhe do të vete patjetër ta shikoj. Më kanë informuar se atje janë ekspozuar vepra shumë të mira nga pikëpamja ideologjike dhe të goditura nga ana artistike. Talentet e reja, me siguri, do të rriten. Kjo për të ardhmen ka shumë rëndësi. Vetë ekspozita që u hap, flet për sukseset tona të mëdha në këtë fushë. Punë të mbarë!

*Botuar për herë të parë,  
me shkurtime, në gazetën  
«Zëri i popullit», nr. 16 (8247),  
19 janar 1975*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë  
nga procesverbali i mbledhjes  
së Sekretariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# PUNA KRIJUESE E POPULLIT DHE VEPRA E PARTISË T'U SHËRBEJNË PEDAGOGËVE SI BAZË PËR PUNËN SHKENCORE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**20 dhjetor 1974**

Çështjet që u ngritën në diskutimet e shokëve kanë rëndësi. Tani ju, që morët pjesë në këtë mbledhje të Sekretariatit të KQ të PPSH, duhet të reflektoni thellë mbi vërejtjet dhe mbi sugjerimet që u bënë, si dhe mbi detyrat që ju dalin për të vënë në jetë vendimet e Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror të Partisë. Për këtë qëllim duhet ta merrni në dorë seriozisht punën e organizatave-bazë të Partisë në universitet dhe, pa u kënaqur me nxjerrjen e disa konkluzioneve të sipër-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur nga komiteti i Partisë i Universitetit të Tiranës «Mbi punën e bërë nga organizata e Partisë e universitetit dhe për masat që duhen marrë për të vënë në jetë mësimet e Plenumit të 4-t të KQ të PPSH».



faqshme, përpikuni t'i futeni më thellë brendisë së çështjeve.

Mendimet që dalin për masat që gjykohet të merren tani në universitet nga rektori dhe nga sekretari i komitetit të Partisë të këtij institucioni, duhet të diskutohen me shokët e aparatit të Komitetit Qendror, që janë të ngarkuar me problemet e arsimit dhe të kulturës, dhe pastaj çështjet të diskutohen hollësisht me anëtarët e komitetit të Partisë të universitetit, ku të zhvillohet me ta një debat i zjarrtë revolucionar për problemet.

Në drejtim të universitetit, të shkollave të tjera të larta dhe të të gjitha atyre institucioneve që kanë të bëjnë me shkencën dhe me problemet shoqërore, duhet të organizohet një ndihmë dhe kontroll partie c shtetëror. Ne jemi kundër rehatit të zbukuruar me «lule» e «të justifikuar» me fraza të lidhura mirë në mënyrë intelektuale, përpjekje këto që në fakt synojnë të fshehin frymën e intelektualizmit, siç ndodh me disa pedagogë. Ne nuk mund t'i lejojmë të tilla shfaqje të dëmshme, që mund të duken ca më tepër në organizatat-bazë të Partisë të universitetit dhe të shkollave të tjera të larta.

Të kemi kujdes, shokë, se në qoftë se organizatës-bazë të Partisë i imponojmë diçka në mënyrë dogmatike, edhe ajo mund të na imponojë neve një zgjidhje oportuniste të çështjes, prandaj, që të mos ngjasë as njëra, as tjetra nga këto, është e domosdoshme të zhvillohet atje një debat parimor, në frymë marksiste-leniniste. Kështu, kur merret një vendim i drejtë për

zgjidhjen e një problemi në universitet, ky duhet t'u shtrohet pastaj gjithë studentëve e pedagogëve, të vihen këta në dijeni për vendimin që është marrë dhe të kërkohet mendimi i tyre për vënien e tij në jetë. Për këtë qëllim çështja duhet të diskutohet gjerë e gjatë, të dëgjohen pikëpamjet dhe vërejtjet e studentëve e të pedagogëve dhe pas kësaj pune të vazhdohet ndjekja me kujdes e kontrollit për zbatimin e vendimeve.

Të mos harrojmë, shokë, që t'u theksojmë komunistëve dhe njerëzve të paorganizuar në Parti, pedagogëve dhe studentëve, rrezikun që paraqet shfaqja e intelektualizmit në universitet. Duhet punuar që njerëzit atje të jenë, si kudo, të ndershëm, të mos mashtrojnë duke kopjuar e duke huajtur vend e pa vend nga të huajt. Në të gjitha këto institucione rëndësi e madhe duhet t'i vihet kontrollit të brendisë së punës mësimore, të teksteve etj., sidomos për lëndët e shkencave shoqërore.

Do të jetë gabim që pedagogët tanë të mos lexojnë libra të huaj, të mos nxjerrin prej tyre konkluzione të drejta e revolucionare dhe të mos mbajnë qëndrime kritike sa herë e shikojnë të nevojshme. Nga librat e huaj që lexon, një autor mund të nxjerrë një argument ose ndonjë ide, por rregullisht, sipas rastit e rëndësisë së gjërave, kjo nuk lejohet pa vënë në punimin e vet referimin se i kujt është ai argument apo ajo ide. Në shkollat tona të larta gjëra të tilla mund të jenë bërë. Është e domosdoshme që të luftohen me rreptësi pikëpamjet e huaja e revizioniste në shkencat shoqërore. Në universitet, natyrisht sipas rregullave të vëna,

edhe në të ardhmen do të studiohen libra në gjuhë të huaja, por ata në asnjë mënyrë nuk duhet që të merren e të futen në tekstet tona, duke bërë plagjiaturë, kopjim, që nuk është tjetër veçse një formë e mbulluar vjedhjeje. Ku është këtu ndershmëria komuniste?

Në këtë prirje të palejueshme, veç mendjemadhësisë, nxjerr veshët edhe shfaqja e kultit për të huajt dhe e përcmimit të veprave të Partisë dhe të punës krijuese të popullit. Puna krijuese dhe e nderuar e popullit dhe vepra e pavdekshme e Partisë duhet t'u shërbejnë pedagogëve të shkollave të larta si bazë për frymëzim edhe për punë shkencore, kulturore dhe artistike. Pedagogët tanë të shkollave të larta duhet të studiojnë thellë e me këmbëngulje mësuesit tanë të mëdhenj të marksizëm-leninizmit, të rejat e shkencës, si dhe materialet e përvojën e Partisë sonë.

Plagjiaturën e dënon edhe borgjezia, megjithëse kjo vepron kështu për arsye krejt të ndryshme nga tonat. Borgjezia e ka hallin tek të hollat e situara nga shitja. Ajo, me vendim gjyqi, në mbrojtje të së drejtës së autorit, i merr nga kopjuesi të gjitha paratë e realizuara nga shitja e librave të botuar që janë kopjuar dhe ia dorëzon ato autorit të vërtetë. Autorët borgjezë, duke pasur frikë nga ky detyrim ligjor, kur marrin një citat nga një tekst, shënojnë me përpikëri në librin e tyre burimin nga e kanë marrë citatin ose idenë.

Kopjimi i shkrimeve të gatshme fsheh, gjithashtu, vesin e dënueshëm të përtacisë. Një autor borgjez ose revizionist, që ka bërë një libër, është përpjekur të pasqyrojë në tekst pikëpamjet filozofike të rendit bor-

gjez ose revizionist në fuqi në vendin e tij dhe ka nxjerrë në të disa konkluzione të vlefshme për interesat e klasës apo të shtresës që përfaqëson, kurse disa nga pedagogët tanë as e kanë vrarë mendjen në këtë drejtim, as e marrin këtë mundim, se preferojnë t'i marrin të gatshme nga të tjerët dhe, për të mbuluar plagjiaturën, futin aty-këtu në tekstet që bëjnë edhe disa nga citatet tona. Jo, shokë, Partia nuk na mëson të veprojmë kështu. Prandaj duhet luftuar me rreptësi e vazhdimisht kundër shfaqjeve të tilla kaq pa përgjegjësi.

Të kuptohemi drejt. Partia nuk e përbuz kulturën përparimtare botërore, përkundrazi, ajo e vlerëson shumë atë dhe e ka shprehur vazhdimisht qëndrimin e saj pozitiv ndaj mendimit krijues të popujve dhe mendimtarëve e krijuesve të mëdhenj përparimtarë, por kurdoherë ky vlerësim duhet parë nën prizmin e marksizëm-leninizmit. Nën vlerësimi i kulturës përparimtare botërore do të ishte një minus në zhvillimin kulturor e teknik të vendit, në përgatitjen kulturore e teknike të inteligjencies sonë.

Një kritikë, mendoj unë, mund t'u bëhet, gjithashtu, edhe studentëve, që, nga frika se mos përsëritin klasën, heshtin dhe nuk i kritikojnë ata pedagogë që bëjnë veprime jo të rregullta, sepse këta hakmerren ndaj atyre që kritikojnë. Siç shihet, ndjenja e hakmarrjes ndaj atyre që kritikojnë, sidomos ndaj vartësve, ekziston edhe në universitet. Bile do të thosha se këtu pedagogu mund të hakmerret më lehtë ndaj studentit, të cilin e ka në dorë dhe mund t'i drejtojë pyetje aq të holla, sa ta rrëzojë në provim, jo një herë, por edhe shumë

herë me radhë. Është e përhapur frika në provime që ka studenti nga pedagogu. Natyrisht, në raste të tilla, mbajtja e një qëndrimi parimor lyp kurajë komuniste nga studenti që bën një kritikë. Por edhe ky duhet ta ketë të bazuar kritikën në adresë të pedagogut, jo të flasë pa baza dhe pa u matur.

Jam informuar se as nëpër katedra, dekanate dhe as në rektoratin e universitetit nuk janë organizuar si duhet diskutimet për temat e lëndëve që pedagogët përgatitin për t'u dhënë studentëve, pse kjo punë konsiderohet si një terren i çdo pedagogu, të cilit gjoja nuk ka përse t'i ndërhyjë kush, se ai është «kompetent» etj. Thuhet se kush të dojë, le të vejë të dëgjojë në auditor, ku pedagogu bën leksionin. Kjo është në rregull, po çështja që nuk organizohen mbledhje, sidomos në katedra, për të diskutuar për temën që do të mbahet nuk është aspak e rregullt. Prandaj mbledhje për diskutime të tilla duhet të bëhen herë pas here edhe më parë se të zhvillohen leksionet. E tërë kjo të mos konsiderohet një procedurë formale dhe burokratike, po të konsiderohet ndihmë dhe kontroll, pse kështu si po veprohet tani nuk ekziston as ndihmë, as kontroll, dhe shkohet sipas shprehjes së huaj për ne «lëshomë, të të lëshoj».

Është e çuditshme që disa pedagogë i zhvillojnë leksionet ashtu si i kanë përgatitur para shumë vjetësh dhe nuk marrin as mundimin më të vogël që përmbajtjen e tyre ta konsultojnë me kolegët e vet, që këta t'u bëjnë vërejtje e t'u japin mendime për pasurimin e tyre. Një qëndrim i tillë tregon se pedagogu është plagjiator, se, duke qenë dembel, ai nuk i pasuron lek-

sionet me kohë me shembuj e ide të reja. Ai i largohet konsultimit se nuk do që të futet në mengenenë e të tjerëve, që do t'i thoshin: «Ç'e ke këtë ti, more shok, ky leksion është i dobët» etj.

Ndonjë pedagog nuk i konsulton leksionet me të tjerët edhe për arsye se mos i dalin në shesh dobësitë dhe niveli i ulët shkencor i përgatitjes, se mos i ulat «krenaria universitare», gjë që mund ta marrin vesh organet eprore dhe për këtë mund ta transferojnë nga universiteti në ndonjë shkollë të mesme ose 8-vjeçare të ndonjë rrethi të largët.

Kur nxirrni konkluzione ose kur përcaktoni detyra, mendoj ta studioni mirë realitetin, të bëni krahasimin e gjendjes që ekziston në universitet me të kaluarën dhe të parashikoni perspektivën. Secili në universitet, sipas shkallës së njohjes që ka, duhet të vrasë mendjen për problemet që shtrihen, me qëllim që të thellohet në to. Kështu, përveç asaj se çfarë përmirësimesh janë bërë lidhur me këto probleme, ju do të dini sa të mprehta janë akoma këto aktualisht, në ç'drejtme vazhdojnë të vërtetohen gabime dhe ç'këshillohet që të bëhet më tej për forcimin e punës. Nga ky preokupacion i vazhdueshëm ju do t'i futni këtij ose atij problemi që del përpara për t'u zgjidhur, do të dini çfarë prirjesh ekzistojnë në universitet në drejtim të tyre dhe ç'masa duhet të merrni.

Këto të meta shokët drejtues të universitetit duhet t'i ndreqin në rrugë dhe në frymë partie. Po vepruam kështu, do të shikojmë se si të gjithë pedagogët tanë do t'i vihen punës me zell.

Ministria e Arsimit dhe e Kulturës ka një përgjegjësi të madhe në këtë drejtim. Ajo, në bazë të orientimeve që i jepen vazhdimisht, duhet të organizojë një punë serioze e të vazhdueshme për këto çështje. Të mos mendojë Ministria e Arsimit dhe e Kulturës se kjo punë u përket një ose dy kuadrove për arsimin që punojnë në aparatet e Komitetit Qendror të Partisë, të mos mendojë kjo ministri se ekziston vetëm për të siguruar defterët dhe orënditë shkollore. Jo! Misioni dhe detyra e Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës janë shumë më të mëdha e të gjera dhe, në radhë të parë, përgatitja e programeve shkollore, drejtimi dhe përmbajtja parimore e tyre, sigurimi i brendisë së shëndoshë marksiste-leniniste të teksteve, dhënia me cilësi të lartë e mësimave dhe syri e kontrolli i vazhdueshëm mbi të gjitha këto.

*Botuar për herë të parë, me  
ndonjë shkurtim, në librin:  
Enver Hoxha, «Raporte e  
fjalime 1974-1975», f. 112*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Raporte e fja-  
lime 1974-1975», f. 112*

## KËTË BAZË TË SHËNDOSHË PËR TË ECUR PËRPARA E KA KRIJUAR PARTIA

*Nga biseda gjatë vizitës në ekspozitën  
«Shqipëria sot»*

24 dhjetor 1974

Në paraditen e datës 24 dhjetor shoku Enver Hoxha vizitoi ekspozitën «Shqipëria sot». Shumë punëtorë, kooperativistë, intelektualë që kishin ardhur për ta vizituar këtë ekspozitë, me të parë udhëheqësin e shtrenjtë, shpërthyen në duartrokitje e brohoritje për Partinë. Shoku Enver Hoxha u takua me montatorë, gjeologë, specialistë, heronj të punës socialiste, u shtrëngoi duart e u përqafua me ta. Me këtë rast kishin ardhur këtu edhe shokët Adil Çarçani, Haki Toska, Manush Myftiu, Nexhmije Hoxha e shokë të tjerë.

Nëpër pavijonet e ndryshme të ekspozitës, udhëheqësin e dashur të Partisë e të popullit e shoqëroi drejtori i saj Anastas Gëdeshi.

Reparti i parë në ekspozitë paraqiste mineralet. Një nga gjeologët i shpjegoi shokut Enver Hoxha vendet ku janë zbuluar minerale, ato që janë vënë në shfrytëzim dhe vende të tjera ku vazhdojnë kërkimet.



«Vendburimet e mineraleve të zbuluara i tregojnë llambat që ndizen, — thotë shoqëruesi, — këto tregojnë ku ka naftë, ku gaz dhe ku ujë».

**SHOKU ENVER HOXHA:** Në hartë ka akoma vende bosh, kjo tregon se ne kemi për të zbuluar akoma vende të tjera me pasuri të tilla. Mineralec janë një pasuri shumë e madhe, por dhe më të çmueshëm janë njerëzit që i kanë zbuluar dhe po i zbulojnë këto pasuri për të mirën e atdheut.

**SHOKU STILIAN PILI:** Këtu, afër Laçit, është një vendburim që furnizon me ujë të bollshëm edhe Durrësin<sup>1</sup>.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mirë do të ishte të kishim gjetur edhe flori, sepse kështu vendi ynë bëhet edhe më i pasur.

*Duke parë me vëmendje eksponatet, prodhime të industrisë mekanike, të naftës, të drurit e të letrës, e duke dëgjuar shpjegimet e ciceronëve, shoku Enver Hoxha u ndal para stendave të ndryshme të ekspozitës, u interesua, bëri pyetje e vlerësime.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Janë të kënaqur njerëzit nga prodhimi i shkrepëseve në vend? Më përpara shkrepëset e vendit u digjnin rrobat.

**CICERONI:** Po, të kënaqur janë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Sa kushton një kuti shkrepësesh e prodhuar në vend?

**CICERONI:** Pesëdhjetë qindarka.

Këto janë prodhimet e kartonit në vendin tonë, ky

---

1. Ky vendburim është Fushëkuqja.

lloj është prodhuar kryesisht si ambalazh. Përveç kartonit ne prodhojmë tri lloje letre, perspektiva e prodhimit të saj në të ardhmen do të jetë akoma më e mirë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Prodhimi i mirë varet edhe nga lënda e parë.

**SHOKU THOMA AFEZOLLI:** Këto janë prodhime të ndryshme të Uzinës së Gozhdë—Bulonave që nuk prodhoheshin më parë në vendin tonë. Ja dhe maketi i Rafinerisë së Ballshit që do t'i rritë edhe më shumë sasinë dhe cilësinë e naftës. Nafta jonë do të jetë me një cilësi të mirë, si e vendeve të zhvilluara të botës në industrinë e naftës. Kjo do të jetë baza e petrokimisë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ju uroj suksese!

Ja ku qenkan ekspozuar anijet! Njëherë, kur u takova me Stalinin, ai më pyeti: «Keni pisha ju në Shqipëri?». «Kemi», iu përgjigja. «Po të keni, duhet të ndërtoni vaporë», më tha ai. Dhe ja, tani ne arritëm të ndërtojmë anije, bile të mëdha, megjithëse këto që shikoj janë metalike, prej hekuri. I uroj për këto suksese kolektivin dhe organizatën-bazë të Partisë të Kantierit Detar të Durrësit.

*Para maketit të Hidrocentralit të Fierzës shoku Enver Hoxha u takua me profesor Petrit Radovickën.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Sa më shumë hidrocentrale që ndërtojmë, aq më i ri bëhesh ti, shoku Petrit.

**SHOKU PETRIT RADOVICKA:** Partia na bën të rinj, shoku Enver.

*Pasi dëgjoi shpjegimet për punën që ishte bërë e po bëhej në hidrocentral, shoku Enver Hoxha u interesua për rezultatet e studimeve që ishin ndërmarrë për*

*këtë vepër të rëndësishme për ekonominë tonë dhe në fund përgëzoi gjithë ndërtuesit e hidrocentraleve.*

**SHOKU BASHKIM ZAJMI:** Këto, shoku Enver, janë prodhimet e Uzinës Elektroteknike në Tiranë. Janë ekspozuar prodhime për pajisje elektrike, duke filluar që nga prizat, çelësat elektrikë e gjer te siguresat, reflektorët e të tjera prodhime të tilla. Të gjitha këto lloje të telave janë prodhuar në Uzinën e Telave në Shkodër.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shumë mirë, ju përgëzoj.

*Para pavijonit të komunikacionit, shoku Enver Hoxha iu drejtua inxhinierit që ndodhej aty:*

Si të quajnë?

**SHOKU DIOGJEN PAPAJANI:** Më quajnë Diogjen.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ti nuk je si ai Diogjeni i lashtësisë, që kishte vetëm fenerin. Ti ke gjithë këto të mira, ke gjithë këllë dritë.

**SHOKU DIOGJEN PAPAJANI:** Kemi Partinë dhe ju që na ndriçoni, shoku Enver.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Tani ju ka ardhur një ministër i ri<sup>1</sup>, që është punëtor i palodhur. Atë e ndihmon shumë edhe shoku Milo Qirko, i cili ka eksperiencë në këtë sektor pune. Çështja është që, me këto masa që merr Partia, të ngrihen edhe kuadro të tjerë të rinj.

Këto janë prodhimet e bukura të industrisë së lehtë që i kanë nxjerrë duart e shkathëta të grave e të vajzave tona. Me çfarë lëkure i bëni?

---

1. Shoku Luan Babameto.

**SHOQJA MIRANDA KALO:** Me lëkurë qengji, keci, lepuri dhe deleje.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po me lëkurë dhelpre bëni?

**SHOQJA MIRANDA KALO:** Bëjmë, por jo në sasi të madhe.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si është kualiteti i lëkurës së dhelprës te ne?

**SHOQJA MIRANDA KALO:** Nuk është i keq. Ato prodhime që nxjerrim pothuaj i eksportojmë të tëra.

**SHOKU ENVER HOXHA:** I paskeni bërë shumë të bukura, ju uroj!

*Në pavijonin e trikotazheve e të konfeksioneve shoku Enver Hoxha u interesua për rrethet që dalloheshin në prodhimin e veshjeve. Duke parë me radhë eksponatet, ai tha:*

Këto prodhime janë të bukura, ju përgëzoj. Por të tëra, sa po shohim, me materialet tona janë prodhuar? Ka pasur raste që jua kanë kthyer konfeksionet e prodhuara për eksport? Si duken ngjyrat e tyre, janë të qëndrueshme?

*Pasi mori përgjigje, ai vazhdoi:*

Të prodhohen sa më shumë, se duhet të vishet populli; edhe prodhimet të jenë të mira, në mënyrë që ai të kënaqet. Ja, këto çanta që keni ekspozuar qenkan të bukura, por këto kuletat e vogla janë edhe më të bukura. Bëni sa më shumë kuleta të lira, se po na prishen paratë nëpër xhepa. Të kemi kuleta me shumicë në treg që njerëzit t'i përdorin për të ruajtur të hollat. Edhe valixhet qenkan shumë të bukura. Gjith-

ashtu shumë të bukur qenkan këta qilima. Të gjithë të Tiranës janë?

**CICERONI:** Jo, këta qilimat këtu janë prodhime të Kukësit e të Kavajës.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kavajasit nuk janë të përmendur vetëm për prodhimin e qilimave, por shquhen edhe si futbollistë. Njëherë, kur vizitova Fabrikën e Qelqit në Kavajë, u thashë se unë jam me skuadrën e «Besës». Çfarë modelesh keni bërë tani?

**CICERONI:** Prodhimet i kemi kryesisht për eksport dhe po mundohemi të përhapim modelet tona shqiptare, por kemi bërë edhe qilima sipas modeleve që kanë kërkuar të huajt.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të përhapni modelet tona me motive shqiptare. Ju përgëzoj për sukseset që keni arritur. Ju keni mundësi të arrini rezultate të tjera akoma më të mëdha, sidomos në drejtim të përmirësimit të cilësisë. Ndërmarrja artistike «Migjeni» i ka të gjitha punëtoret gra e vajza me shkollë, prandaj janë të mëdha edhe mundësitë e tyre për të dhënë prodhime me cilësi të mirë, të bukura siç janë këto, bile edhe më të bukura, në mënyrë që të pëlqehen nga të gjithë.

Ndërmarrja juaj ka krijuar edhe grupe artistike amatore shumë të mira. Unë i kam parë e i kam dëgjuar aktivitetet e tyre dhe më kanë pëlqyer shumë. Kur shikon amatoret tuaja të këngëve e të valleve popullore, të duket sikur ato vajza punëtores, që këndojnë e kërcëjnë aq mirë, janë artiste profesioniste. Përgëzojini ato nga ana ime!

*Në stendat ku ishin ekspozuar prodhime nga ndër-*

*marrjet e ndryshme artistike të të gjithë vendit, shoku Enver Hoxha pyeti:*

Ç'thonë punonjësit e tregtisë, ka kërkesa jashtë për këto prodhime?

**SHOKU ÇERÇIZ HOXHA:** Ka. Ne prodhojmë kryesisht për tregtinë e jashtme.

*Duke parë llojet e shumta e të ndryshme të pipave të vendosura në njërën nga vitrinat, shoku Enver Hoxha bëri një bisedë të shkurtër me shoqëruesit:*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Unë kam qenë «i dashuruar» me pipat dhe kam cigarishte të llojeve të ndryshme, por tani që kam lënë duhanin, nuk besoj të më nevojiten më. Duhani e dënton shumë shëndetin.

I pëlqejnë të huajt pipat me dru mareje dhe a ndikon lloji i drurit në cilësinë e prodhimit?

**SHOKU ÇERÇIZ HOXHA:** Po, sepse rezistenca ndaj djegies varet nga lloji i drurit.

*Pasi përgëzoi për sukseset, shoku Enver Hoxha u drejtua te shoqet Fahrije Saliçaj dhe Vita Konomi.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si jeni, shoqja Fahrije? O, ja tek qenka dhe shoqja Vita! Si je me shëndet ti, Vita, me punë si ia çon?

**SHOQJA VITA KONOMI:** Mirë, shoku Enver.

**SHOQJA FAHRIJE SALIÇAJ:** Këto janë Heroinat e reja të Punës Socialiste Lule Preza<sup>1</sup> dhe Vitore Muzina<sup>2</sup>.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shumë mirë, gëzohem

---

1, 2. Tekstiliste në kombinatin e tekstileve «Stalin». Titulli «Hero i Punës Socialiste» iu dha më 21 nëntor 1974.

që i takoj. Le të bëjmë një fotografi së bashku për ta pasur kujtim. Hajde dhe ti, Nexhmije!

Unë kam dëgjuar që ne bëjmë stofra shumë të mira e të bukura, por çështja është që edhe për tregun e brendshëm të prodhohen kështu. Të shikohet mirë cilësia e prodhimit të tyre, në mënyrë që të pëlqehen sa më shumë nga të gjithë.

**SHOQJA FAHRIJE SALIÇAJ:** Po, shoku Enver, i kemi kurdoherë parasysh kërkesat për të dhënë prodhime me cilësi të lartë.

**SHOKU VANGJO ILO:** Këtu janë ekspozuar këpucë të prodhuara në Tiranë, Korçë, Gjirokastrë e Shkodër. Janë prodhime të mira me lëkurë origjinale dhe me përngjasime të saj.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po me lëkurë derri bëni këpucë?

**SHOKU VANGJO ILO:** Bëjmë edhe me lëkurë derri.

*Për këpucët, shoku Enver Hoxha porositi të bëhen përpjekje që të përmirësohet cilësia e, sidomos, e atyre për fëmijë, se këta i prishin më shpejt. «Këpucët e fëmijëve në mënyrë të veçantë, theksoi ai, të jenë më të buta dhe më rezistente. Edhe këtu mua më pëlqen të shikoj më tepër këpucët që janë prodhuar për fëmijët».*

*Në pushimin prej disa minutash që u bë nga shokët e udhëheqjes, në një sallë të ekspozitës, u zhvillua kjo bisedë e shkurtër:*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kur shikon ekspozitën, gëzohesh me mallrat e shumta të konsumit të gjerë, që

prodhohen sot te ne! Ku kemi qenë më përpara e ku jemi tani! Ky është sukses i mrekullueshëm, po ta krahasosh me të kaluarën.

*SHOKU ANASTAS GËDESHI:* Ekspozitën e kanë parë mbi 150 000 vizitorë, që kanë ardhur në mënyrë kolektive dhe individuale. Përshtypjet e tyre kanë qenë shumë të mira.

*SHOKU HAKI TOSKA:* Vizita ka pasur nga të gjitha rrethet?

*SHOKU ANASTAS GËDESHI:* Po, nga të gjitha, nga qendra pune, nga kolektiva të ndryshëm punonjësish, nga shkollat. Edhe nga Kombinati Metalurgjik kanë ardhur. Kjo ekspozitë është një pasqyrë e zhvillimit të të gjithë jetës në vendin tonë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kanë historinë e tyre mjaft nga këto prodhime, që ne ishim të detyruar t'i importonim nga Bashkimi Sovjetik, nga Gjermania etj.

*SHOKU HAKI TOSKA:* Kur shikonim punime të kinezëve me kocka, thoshim: «Çfarë arti kanë këta!». Tani ne arritëm të punojmë vetë me kockën.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Më kujtohet kur shoqja Eleni Pashko na solli njëherë në Komitetin Qendror të Partisë një lugë të kromuar të prodhuar nga reparti mekanik i kombinatit të tekstileve «Stalin». «Si, bëjmë edhe ne lugë?!», u çuditëm atëherë. «Është e mirë, i thamë shoqes Eleni, vetëm duhet ta hollojmë ca»<sup>1</sup>.

*SHOKU HAKI TOSKA:* 30 vjet kanë kaluar, por

---

1. Më vonë u krijua një linjë e veçantë e prodhimit të lugëve në Uzinën Metalike të Gjirokastrës.



gjatë këtyre tri dekadave kemi kapërcyer një etapë shumë të madhe.

*Vizita rifilloi në repartin e prodhimeve të qelqit e të porcelanit.*

**SHOQJA JULI DEDI:** Këto janë prodhime të fabrikave të qelqit të Kavajës dhe të Tiranës. Prodhimet e tyre janë të llojeve të ndryshme, duke filluar që nga serviciot e ujit, të pijeve e gjer te vazot e ndryshme.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Fabrika e Qelqit e Korçës ka mbetur prapa me prodhimet e saj.

Po këto servicio porcelani kush i prodhon?

**SHOKU NIKOLLA MITRUSHI:** Këto janë prodhime të Fabrikës së Porcelanit të Tiranës. Kërkesat nga konsumatorët janë të mëdha, sidomos për serviciot me ngjyra dhe me dekor.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të prodhoni sa më shumë e më mirë për popullin, në mënyrë të tillë që prodhimet tuaja të përdoren nga qyteti dhe nga fshati.

*Pastaj shoku Enver Hoxha kaloi në repartin ku ishin ekspozuar prodhimet e pajisjeve shtëpiake nga uzinat e vendit. Ai qëndroi përpara një sobe, e hapi atë dhe shikoi vendin e zjarrit, të pjekjes etj.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** E mirë është. Më përpara ne në Gjirokastrë kishim vetëm Qaton kovaç, kurse tashti, veç të tjerave, prodhohen edhe lavatriçel

*Duke kaluar nëpër pavijonin e bujqësisë e të blegtorisë, shoku Enver Hoxha ndoqi me vëmendje të gjitha shpjegimet që jepeshin.*

**SHOKU JORGO ÇOKA:** Këtu janë ekspozuar bimët industriale, pambuku dhe llojet e ndryshme të duhanit.

Këto lopët në fotografi janë «Laramane», «Xhersej» etj. Vënia në përdorim e makinerive moderne për përpunimin e qumështit ka dhënë rezultate të mira. Ja procesi i skremimit të qumështit. Ja dhe gjalpi i ambalazhuar në makineri.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ja, këtu qenka vendosur fotografia e Lezan Pislit me dhitë e tij të dashura.

Unë mendoj që prodhimtaria e shpendëve duhet të shtohet, prandaj të kihet parasysh ushqimi që u jepet. Në këtë sektor kemi pasur përparime në krahasim me të kaluarën. Tani po punohet shumë mirë.

*SHOKU ILIA PALI:* Çdo gjë u rregullua me ngritjen e Kombinatit të Pulave.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Si e rregulloni raportin e lindjeve për sa u përket sekseve, sa për qind janë meshkuj e sa femra?

*SHOKU ILIA PALI:* Zakonisht 5 për qind është diferenca.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Punoni sa të mundeni dhe rregullojeni këtë punë, se na duhen vezë për popullin. Sikur të arrijmë që ta shesim me 70 qindarka kokrrën e vezës, do të jetë një gjë e madhe.

*SHOKU ILIA PALI:* Prodhimi i mishit të pulës për shitje në treg është rritur, kurse çmimi i tij është ulur.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shumë mirë. Jepu të falat e mia të gjithë shokëve.

*SHOKU ILIA PALI:* Faleminderit shumë, shoku Enver. Dëshira e gjithë kolektivit tonë është që ju të bëni një vizitë në Kombinatit e Pulave.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Mirë, po atje është e

ndaluar të hyhet, se ka rrezik të na sëmuren pulat.

**SHOKU ILIA PALI:** E rregullojmë atë punë, marrim leje. Ne me gjithë qejf do të bënim përjashtim për një rast të tillë.

*Në vazhdim të vizitës shoku Enver Hoxha u njoh me prodhimet e lëndës drusore në vendin tonë, pastaj kaloi para stendave që paraqitnin materialet nga sektori i ndërtimit dhe dëgjoi shpjegimet për punën që bëhet për parafabrikatet, për cilësinë dhe shpejtësinë në punë që fitohet nga prodhimi i tyre.*

**SHOKU FAIK ALIMEHMETI:** Ky këtu është maketi i qytetit të ardhshëm të Ballshit që do të ndërtohet mbi këtë kodër, për të mos e rrahur era dhe për ta kapur dielli. Ballshi do të ketë një popullatë prej 15 000 banorësh.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shumë mirë, ky qytet i ri e i bukur do të jetë me të vërtetë një vepër madhështore.

*Pastaj shoku Enver Hoxha shikoi pavijonin e zhvillimit të arsimit e të kulturës, ku ishin ekspozuar, veç të tjerash, edhe artikuj të ndryshëm shkollorë, e më pas dëgjoi shpjegimet e inxhinier Ali Dedejt për funksionimin e një makine llogaritëse.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ne ju dëgjuam me respekt për funksionimin e kësaj makine, por nuk i kuptojmë hollësitë teknike. Ju uroj suksese në punën tuaj.

Ti Petraq<sup>1</sup> je nga Korça. Të përgëzoj ty dhe të tje-

---

1. Shoku Enver Hoxha i drejtohet inxhinierit Petraq Kolevica, që kishte projektuar ekspozitën.

rët për këtë punë të mirë që keni bërë. Edhe në Korçë kam dëgjuar se ke bërë gjëra të mira. Sidoqoftë, duhen dëgjuar me respekt edhe vërejtjet e shokëve, se kritikata na bëjnë mirë. Edhe vetë duhet t'i pranojmë të metat që shikojmë në punën tonë.

*Duke iu drejtuar të pranishmëve, shoku Enver Hoxha tha:*

Nuk kam çfarë t'ju them tjetër veçse kjo ekspozitë është shumë e bukur! Të gjithë ju keni kontribuar në ngritjen e saj. Kjo ekspozitë pasqyron përpjekjet e mëdha që po bën populli ynë, klasa punëtore, inteligjencia, fshatarësia, nën udhëheqjen e Partisë. Përparime të mëdha kemi bërë e do të bëjmë akoma më shumë. Kemi krijuar një bazë të shëndoshë për të ecur përpara edhe për sa u përket kuadrove, dhe gjithë këtë forcë të madhe e ka krijuar Partia. Prandaj të rrojë Partia!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura gjatë bisedës së zhvilluar duke vizituar ekspozitën, që gjenden  
në AQP*

# NGJARJET QË NA NDODHËN NË USHTRI T'I SHOHIM TË LIDHURA NGUSHTË ME DETYRAT PËR REALIZIMIN E PLANIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

26 dhjetor 1974

Po marrim në shqyrtim çështjen e parë lidhur me plotësimin e planit ekonomik e kulturor të vitit 1974 dhe detyrat për vitin 1975. Ka ndonjë pyetje për shokët që janë marrë me përgatitjen e relacionit? Veç përgjigjeve që do t'u japin pyetjeve që mund të bëhen, shokët të na shpjegojnë gjërat kryesore, kyç, më të rëndësishme të planit, duke përmendur se ku janë hasur vështirësi dhe në ç'drejtime duhen bërë përpjekje për t'i kapërcyer këto, me qëllim që të mos na përsëriten mosrealizimet e planit. E mira është që shokët të na vënë në dijeni për këto gjëra.

Kisha një pyetje për Koçon [Theodhosi]: Në rela-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për plotësimin e planit të vitit 1974 dhe për projektplanin e zhvillimit të ekonomisë e të kulturës së RPSH për vitin 1975.

cion thuhet që problemi i naftës nuk ka shkuar mirë për mungesë organizimi e drejtimi në shpim-kërkime. Ç'përgjegjësi kanë ndërmarrjet në bazë e ç'përgjegjësi keni ju, edhe ti, Koço, veçanërisht si ministër? Kur do të mbarojmë me këtë frazë justifikuese: «për mungesë organizimi e drejtimi» dhe kur do të merren masa? Unë mendoj që këto gjëra t'i shikojmë me përgjegjësi.

*Pasi Koço Theodhosi u përpoq të justifikohej se mosrealizimet kanë ardhur gjoja nga mungesa e materialeve etj., shoku Enver Hoxha, duke iu drejtuar atij, vazhdoi:*

Jo, mosrealizimet në naftë dhe në disa zëra të tjerë, si, për shembull, gjetja e sasisë së rezervave të naftës, nuk kanë të bëjnë me objektet e materialet që marrim nga jashtë. Mirëpo pa siguruar rezervat e naftës, nuk mund të realizohet edhe plani i nxjerrjes së saj.

Ti je ministër dhe duhet ta dish se kush i bënte studimet e pikave për kërkimin e vendburimeve para krijimit të Institutit të Naftës. Nuk është me vend të na thuash: «S'kam qenë në atë kohë!». Pavarësisht nga kjo, ti duhet ta dish historikun e punëve në naftë.

Sa kohë vazhdoi Drejtoria Gjeologjike dhe çfarë rezultatesh dha kjo? Patën rezultate pikat e studimit të saj? Keni bërë ndonjë studim ju për të parë se në atë kohë që vepronte Drejtoria Gjeologjike, kemi pasur rezultate të sigurta, apo ato ishin me një skartim kaq të madh, siç po ndodh tani?

Ju ia keni varur gjithë këtë të ardhme të naftës këtij instituti. Ti thua që ky institut bën këto e bën ato, por më duket se kështu ai s'po bën gjë.

E ngre këtë problem për arsye se kërkimet në naftë duhet të na japin rezultate dhe të jenë shumë më të leverdishme nga ç'janë aktualisht. Veç kësaj, këta organizma që krijojmë, duhet t'i provojmë në jetë, nëse japin apo nuk japin rezultate dhe sa japin, ose, në qoftë se nuk japin, pse dhe si mund të japin rezultate më të mira për qëllimin që janë krijuar. Unë për këtë arsye e bëj këtë pyetje, se, sipas mendimit tim, të tilla shpjegime, sa për të na vënë në dijeni si është gjendja, nuk janë të mjaftueshme. Çështja nuk është vetëm për të thënë që ke përgjegjësi ti Koço, se e dimë ne që ti ke përgjegjësi dhe përgjegjësi të madhe. Është fare kollaj të marrim masa ndaj teje, por puna nuk zgjidhet me kaq. Prandaj duhet parë si shkon puna atje në bazë, ç'probleme ka, qofshin këto organizative, teknike etj.

Unë nuk them tani se instituti nuk duhet të jetë. Në sektorë të ndryshëm kemi e duhet të kemi institute kërkimesh e studimesh, por çështja është që këtë punë duhet me e pa një çikë nga afër: Çfarë detyrash duhet t'i japim institutit dhe ku çalon puna?

Nuk e kam fjalën vetëm për punën e institutit, që patjetër duhet ta shikojmë, por them që ta shohim problemin e naftës në tërësi. Qëllimi është të bëjmë që instituti të jetë me të vërtetë në krye të të gjithë punës studimore e kërkimore. Pra, të shikojmë ta mbajmë institutin me këto funksione që ka tani, apo, në qoftë se ai nuk i kryen dot të gjitha këto punë, të krijojmë edhe organizma të tjerë ndihmës? Këtë nuk duhet ta neglizhojmë.

Pastaj, Instituti i Naftës ka një rëndësi të madhe,

puna e tij është shumë e ndërlikuar. Prandaj, për këtë, duhen parë të gjitha kompetencat e dhëna.

Kur konstatojmë se njëra ndërmarrje ose tjetra nuk ecën si duhet, lypset t'i qepemi dhe të shohim nëse e kemi drejt organizimin e punës atje apo jo, domethënë, pasi ta kemi organizuar punën në një sektor, duhet t'i kthehemi ta shohim si na vete dhe jo të mbyllim sytë, por t'i shohim problemet me kohë. Kur puna në një vend nuk na ecën një herë, dy herë, e kjo vazhdon dy vjet, tre vjet, atëherë nuk duhet ta lëmë të vejë më gjatë e të presim derisa ta ngremë një gjë të tillë tani, në mbledhjen e Byrosë Politike. Ne edhe në Byro mund ta ngremë, por ju që drejtoni sektorin e naftës, duhet t'u jepni rrugëzgjidhje me kohë punëve.

Pse nuk ia keni thënë Qeverisë më parë që nuk e keni mirë në dorë punën e Institutit të Naftës? Pse këtë faj ti e lë të trashet?

Që ti dhe Qeveria të mos e shtroni me forcë këtë çështje jetike, kjo i kushton shumë atdheut, prandaj për këtë problem duhet menduar seriozisht!

Po pse vazhdohet të ketë avari të shumta në shpimet? Si do të shkojmë kështu, duke pritur me vite të tëra pusët që janë mbytur nga avaritë? Këto janë gjëra me përgjegjësi.

Nuk është çështja që tani nuk nxjerrim më naftë, por diskutojmë se duhen nxjerrë e duhen zbuluar aq rezerva nafte e gazi sa caktojnë planet, ndryshe na krijohen situata jashtëzakonisht të vështira dhe mund të na ngjasin gjëra aq të dhimbshme sa për të vënë duart në kokë.



Kështu është edhe për problemet e tjera të planit. Mund të thotë shumë «arsye», për shembull, Pirro Dod-biba, jo kështu e jo ashtu, por kemi thënë shumë herë që mekanizmat e punës që i japim bujqësisë të llogariten deri në një dhe të shkurtohen respektivisht forcat e punës. Megjithëkëtë, ju vini këtu e na thoni: «Ka rënë përtokë çështja e patates, sepse do forca pune.»! Po ku do t'i gjejmë ne forcat e punës, në qoftë se nuk vëmë në përdorim jo vetëm mekanizmat e mëdhenj, por edhe ata të thjeshtit? Po të veprojmë kështu, atëherë do të kemi forca pune edhe për patatën, edhe për fasulen. Mirëpo këto gjëra nuk na shkojnë mirë dhe, në radhë të parë, këto varen nga organizatat-bazë të Partisë, të cilat, shpesh, vetëkënaqen. Kjo është e palejueshme. Në qoftë se Partia vihet në krye të detyrës për të mos i lënë këto probleme rrugëve, atëherë të gjitha çështjeve do t'u jepet zgjidhje. Prandaj, më parë duhet të mobilizojmë organizatat e Partisë. Po nuk u mobilizua Partia, s'kemi gjë në vijë për këto punë.

Më duket se po përpiqeni të na hidhni hi syve<sup>1</sup>. Na

---

1. Ndonëse akoma nuk qe zbuluar veprimtaria armiqësore e Abdyl Këllezit, Koço Theodhosit, Lipe Nashit e bashkëpunëtorëve të tyre, shoku Enver Hoxha, qysh në këtë mbledhje, duke iu referuar fakteve, si dhe fjalëve të përgjithshme të këtyre armiqve, me të cilat ata përpiqeshin të mbulonin punën sabotuese të tyre, vë gishtin në plagë, duke u thënë troç se janë pikërisht ata fajtorët e vërtetë për situatën e krijuar në sektorin e naftës. Ky shqetësim dhe ky sinjal i dhënë nga shoku Enver Hoxha ishte hapi i parë që do të çonte në zbulimin dhe në likuidimin e veprimtarisë armiqësore në fushën e ekonomisë.

thoni se janë realizuar shpimet, se janë realizuar këto ose ato! Partisë nuk i intereson metrazhi i shpimeve, por zbulimi dhe nxjerrja e naftës. Prandaj mua më duket më mirë që të vini të na thoni pse nuk u realizuan deytirat sesa të justifikoheni për të mbuluar punën e dobët.

E njëjta gjë, Koço, mund të thuhet edhe për nxjerrjen e kromit. Përse na vjen në plan kështu çështja e zbulimit të kromit? Unë kam dëgjuar nga ju edhe më parë se është zbuluar krom, por tani shoh se në plan është vënë një ulje prej qindra mijë tonësh. Si shpjegohet kjo?

Edhe ju të bujqësisë bëni më pak diskutime e arsyetime pa bukë dhe futjuni punës më mirë, se po t'i vëmë në plan gjërat kështu si i paraqitni ju, do të jetë një lloj sikur të vëmë qerren përpara buajve. Ju të dikasterit duhet të shikoni mirë përse ua vonuat aq shumë kooperativave bujqësore makinat e tharjes së misrit. Përse u prit derisa të ndërhyhej që këtej për këtë problem? Ky është një shembull që flet për mospërdorimin e makinerive. Në qoftë se këtu, në Byronë Politike, na i thoni gjërat kështu në përgjithësi, atëherë nuk dalim gjëkund. Këto lloje makinash ishin bërë nga Uzina Mekanike Bujqësore, por rrinin pa u përdorur. Këtë të na thoshit ju, përse ndodhi kështu. Dhe është fakt që në sektorin e bujqësisë janë shumë makineri pa u vënë në përdorim e, në vend të tyre, ju vini punëtorë. Ti Pirro me përgjigjet e tua këtu, po e mohon faktin që nuk e keni llogaritur mirë fuqinë punëtore, se nuk i keni marrë parasysh edhe mekanizmat e rinj. Tani kërkohet të futen në përdorim të

gjithë mekanizmat që janë destinuar për bujqësinë. Unë nuk e kuptoj justifikimin tënd. Ti thua se nuk po e mohon këtullë, por e vërteta është se këto fakte flasin vetë. Këto gjëra në sektorin tuaj nuk duhen lënë kështu. Të merren masa që gjithë këta mekanizma të vihen në përdorim dhe të ekonomizohen mirë forcat e punës. Në bazë të arsyeve e të mundësive të studiuara thellësisht, duhet të merret zotim këtu në Byronë Politike që plani të realizohet dhe të mos na dilni pastaj me justifikime, si ato që na përmendët këtu për pataten, jo «duhet të kishim bërë qilizmë tokën e patates» ose që duhet bërë kështu e ashtu. Këto janë punë të apartateve e të specialistëve të bujqësisë, që duhet t'i mendojnë mirë gjërat, të marrin masa e të vënë çdo gjë në rrugë të drejtë.

Jam dakord me projektplanin që ka paraqitur Qeveria, vetëm doja të shtoja që, për zbatimin e detyrave shtetërore, të cilave duhet t'u qëndrojmë në kokë, është e domosdoshme që Partia të shkundet, të vihet mirë në lëvizje, ndryshe nuk do të na ecë mirë puna. Të kemi parasysh, sidomos, momentin aktual, ngjarjet që na ndodhën në ushtri. Por të kihet kujdes që Partisë të mos i tërhiqet vëmendja vetëm në këtë anë dhe të harrojë realizimin e detyrave të planit.

Partia duhet të kuptojë se lufta më e madhe që duhet t'i bëjmë punës armiqësore që na u vërtetua në ushtri, është, së pari, të jemi vigjilentë ndaj kësaj pune armiqësore; së dyti, dhe po aq e rëndësishme, të punojmë me të gjitha forcat për të realizuar planin, sepse armiku do të synojë shumë për të ndikuar në

këtë drejtim, do të synojë për keqësimin e gjendjes ekonomike dhe do të flasë kundër Partisë. Armiku përpiqet të godasë në të gjitha drejtimet. Çrregullimet në sektorët e ndryshëm të ekonomisë, sidomos të kesh apo të mos kesh vezë ose mish, ai përpiqet t'i shfrytëzojë për qëllimet e veta. Prandaj këto çrregullime të evitohen, sepse nuk janë thjesht ekonomike, ato sjellin pasoja jo të mira nga ana politike.

Partia, natyrisht, duhet të bëjë një punë të madhe, sidomos, nga ana organizative, sepse në këtë drejtim më duket se nuk bëhet sa duhet. Kam përshtypjen se vazhdon një paralelizëm jo i drejtë midis organeve të Partisë dhe atyre ekonomike, në vend që gjithsecili të bëjë si duhet punën e vet. Ajo që është planëzuar duhen bërë përpjekje të realizohet. Por në rast se Partia nuk ecën në mënyrë të organizuar, në rast se ajo nuk ndjek si duhet realizimin e detyrave të planit, jetën, zhvillimin e gjërave në gjithë punën organizative, politike, në rast se komunistët nuk u futen thellë çështjeve, në rast se nuk japin vetë shembullin në punë, nuk mund të ecet, pse, ndërsa një sektor shkon përpara, një tjetër mbetet prapa.

Paralelizmin në punët e Partisë e të shtetit duhet ta shohim që këtu, në aparatën e Komitetit Qendror. Çdo punë, më duket mua, duhet të bëhet e organizuar dhe e koordinuar mirë. Shokët e ngarkuar kryesisht me çështje ekonomike në aparatën e Komitetit Qendror, mendoj se duhet ta kenë më mirë parasysh këtë, të mos bien në paralelizëm me shokët e sektorëve shtetërorë e të ekonomisë.

Është e qartë se vetëm pak veta këtu në aparat, që ndjekin politikën ekonomike të Partisë në sektorë kaq të gjerë, nuk ua dalin dot detyrave, por çelësi i kryerjes si duhet të detyrave qëndron në organizimin e mirë të punës. Shokët sekretarë të Komitetit Qendror që kanë në dorë planin, bashkë edhe me ata katër ose pesë instruktorë, mund ta vënë përpara punën, sepse ne kemi organizatat-bazë të Partisë në sektorët ekonomikë, kemi edhe komitetet e Partisë, edhe ministritë. Sekretarët e sektorëve ekonomikë ose të bujqësisë, kur venë në bazë, duhet të organizojnë e të mobilizojnë Partinë, veçanërisht në disa drejtime kryesore, t'u flasin shokëve për politikën e problemit, duke i trajtuar çështjet nga ana ideologjike, por të parashikojnë edhe format e organizimit e të hedhjes në punë të komunistëve, të kuadrove. Me një fjalë, ne duhet të vemi në bazë jo si era, po të shtrojmë gunën, duke qëndruar dy, tri ose katër ditë, t'u japim shokëve të bazës si ushqim direktiva se si duhet të punojnë për gjithë fushatën, për zgjidhjen mirë të problemit që kemi caktuar. Pasi të ikin shokët, atëherë organizata e Partisë të vazhdojë t'i kryejë vetë detyrat, duke bërë përpjekje për të arritur rezultate konkrete, ndërsa ne këtej të kujdesemi që të vazhdojmë punën për të kontrolluar zbatimin e detyrave.

Mua më duket se kështu duhet të veprojnë edhe organizatat e masave, si ato të bashkimeve profesionale etj., dhe jo të thonë se kanë planin e tyre. Po çfarë plani kanë ato? Plani i organizatave të masave duhet të përgatitet në përshtatje me direktivat e Partisë, me detyrat që lëshon ajo vazhdimisht. Jashtë këtyre direktivave e

detyrave ato nuk mund të kenë plan tjetër. Prandaj çështjet kryesore, për të cilat u jepet orientim Partisë në bazë dhe gjithë punonjësve, organizatat e masave duhet t'i përcaktojnë drejt dhe për këto çështje të mobilizohen, të organizojnë edhe propagandën e tyre. Udhëheqjet kryesore të këtyre organizatave do të venë të kontrollojnë e të ndihmojnë, por, gjithashtu, ato duhet të veprojnë në mënyrë të organizuar.

Këto që po them mendoj se duhet, absolutisht, t'i bëjmë dhe kurdoherë të mendojmë pse i ngjau Bashkimit Sovjetik katastrofa, që atje po vazhdon të thellohet gjithnjë e më shumë. Atje kishte rezoluta e leksione, urdhëresa e gjithfarë materialesh të tjera të shkruara, bile që në kohën e Stalinit, bëheshin mbledhje pas mbledhjesh, ku diskutohej për problemet e ndryshme, por në çdo anë kishte zënë rrënjë një rutinë e tmerrshme burokratike, nga e cila ne duhet të ruhemi shumë. Prandaj çdo veprim duhet parë në zhvillimin e kohës, të revolucionarizohet, të ndryshohet e të përsoset vazhdimisht, që të japë edhe më pas fryte të mira në një situatë të re të krijuar dhe më të përparuar. Në këtë çështje, si për çdo gjë, roli udhëheqës i Partisë është kryesor dhe i padiskutueshëm.

Kohët e fundit na ka dalë edhe një çështje tjetër që na preokupon shumë. Cila është kjo? Me zbulimin dhe shpartallimin e veprimtarisë armiqësore të grupit puçist në ushtri, janë marrë edhe masa ndaj disa oficerëve. Në këto kushte vëmë re se disa kuadro drejtues po tregohen shumë sektarë. Por ata janë të tillë pikërisht sepse janë oportunistë. Me qëndrimet sektare që mbajnë

ata duan «të jenë brenda», kanë frikë nga Partia se mos kjo i quan oportunistë, po, në fakt, kështu si po veprojnë, ata janë oportunistë. Këta shokë hiqen se gjoja janë me vijën e Partisë, por kjo vijë ecën drejt, as nga e majta, as nga e djathta.

Tani, pas asaj që ka ngjarë në ushtri, ka nga ata që ngrihen në organizatat-bazë dhe i thonë këtij apo atij: «Jashtë ti nga Partia!», por ama nuk guxon njeri t'u thotë: «Po dale, more shokë, pse të dalë ai jashtë nga Partia? Ai vërtet ka të bëjë me këtë ose atë të dënuar, po nuk është i ndërlikuar me atë». Në qoftë se ngrihet e thotë një fjalë një i afërmi i një armiku, njerëz të tillë sektarë i drejtohen duke i thënë: «Mos je edhe ti me Beqir Ballukun e me Petrit Dumen?». Qëndrime revolucionare janë këto? Ose një tjetër del dhe njofton se do të ndajë gruan ose kjo burrin. «Po, po, ta ndash», i thonë. Ta ndajë?! Po të dojë, le ta ndajë, se ne nuk ndërhyjmë në çështje familjare, por që ta nxitë Partia njërin apo tjetrin të ndajë bashkëshortin, këtë ajo s'e bën, sepse, në radhë të parë, ajo ka për qëllim ta shërojë, ta ndreqë fajtorin, prandaj është e udhës t'i themi gruas së tij: «Moj shoqe, ti ke tre-katër fëmijë me të, përpiqu ta bësh njeri atë, sepse ne do t'i japim punë, nuk do ta hedhim në radhët e armikut». Ka edhe raste që, kur një grua kërkon me të drejtë ndarje nga burri, që është me të vërtetë armik, sepse ajo do që të rrojë me Partinë, prokurori i thotë: «Dil jashtë! S'ke punë këtu!». Ç'janë këto gjëra, more shokë? Ç'janë këto situata që krijojnë këta njerëz sektarë? Pra, në shumë raste konstatojmë qëndrime të tilla sektare, po disa

nga anëtarët e Partisë nuk kanë kurajën të mbrojnë vijën e drejtë të Partisë.

Të kemi kujdes, shokë, të luftohen qëndrimet sektare, që të mos na krijohen situata të rënda, se pastaj mund të na ngjasin shqetësime të mëdha në masat e popullit.

E kisha çështjen këtu, që kjo që na ngjau, natyrisht, Partinë duhet ta preokupojë vazhdimisht që të mos na përsëritet, prandaj të mos harrohen këto gjëra. Kryesorja tani është të mobilizohemi për realizimin e planit, të mos merren njerëzit me pësh-pëshe, ndryshe na mbeti gruri pa u mbjellë, na mbetën detyrat pa u realizuar. Prandaj në këto drejtime të reagojmë dhe të reagojmë drejt.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*



# TI FUTEMI THELLË STUDIMIT TË TEORISË SË ARTIT USHTARAK

Shënime<sup>1</sup>

9 janar 1975

Puna armiqësore e Beqir Ballukut, e Petrit Dumes dhe e Hito Çakos, natyrisht, e ka dëmtuar stërvitjen ushtarake. Këtij problemi kyç ne duhet t'i futemi thellë dhe ta analizojmë. Një gjë të tillë është e domosdoshme ta kryejmë për të rregulluar si duhet stërvitjen ushtarake, që ajo të bëhet e lehtë në të kuptuar, e thellë në mendime dhe e shpejtë në të zbatuar. Këto tri orientime duhet absolutisht të shoqërojnë tekstet, leksionet dhe stërvitjet praktike.

Kënaqësinë më të madhe kuadri oficer duhet ta ketë atëherë kur ushtarët dhe kursantët i ndjekin me zell mësimet. Kuadrot, nëpërmjet punës së tyre, të

---

1. Këto shënime shoku Enver Hoxha i ka shkruar pas Plenumit të 6-të të KQ të PPSH, në data të ndryshme, më 30 dhjetor 1974, më 6 dhe 9 janar 1975. Ato u përgatitën për një bisedë me kuadro të ushtrisë. Pastaj materiali u dërgua në ushtri në formë broshure dhe u punua me komunistët, kuadrot dhe efektivin e forcave tona të armatosura.

bëjnë që ushtarët të kuptojnë dhe të ndiejnë se në ushtri vijnë të mësojnë gjëra të mëdha dhe jo të rëndomta, se ata vijnë të mësojnë artin e luftimit, por tok me këtë mësojnë edhe gjëra të tjera të rëndësishme, mësohen me rregullin dhe me disiplinën. Për këtë shërbejnë puna ideopolitike dhe tërë stërvitjet ushtarake që zhvillohen në ushtri. Që stërvitja ushtarake të kuptohet drejt është e domosdoshme të zhduken fryma e sëmurë dhe ajo praktikë e keqe që ekziston në disa drejtime, deri edhe tek termat administrativë. Në ushtri njerëzit të mësohen që ata jo vetëm në jetën e përditshme, por edhe në luftë të fitojnë shpejtësinë për kryerjen e detyrave, për vënien përnjëherë në vend të padrejtësive dhe për korrigjimin e gabimeve që vërte-tohen. Ata të mësohen se asgjë nuk duhet lënë zvarrë. Në këtë mënyrë zhduken objektet e pakënaqësive.

Elementët tradhtarë, që zbuluam në ushtri, i shtonin zullumet dhe pakënaqësitë në kuadrot dhe duhet kuptuar se këtë e bënin për të tërhequr vëmendjen nga mësimi, nga edukimi, nga stërvitja. Këta armiq u jepnin kuadrove të studionin «psikologjinë e ushtarit sovjetik», me këtë ata u vinin kazmën moralit dhe psikologjisë së Partisë sonë, ashtu siç u orvatën t'i vinin kazmën tërë teorisë ushtarake të saj.

Këta elementë armiq dhe disa kuadro të lartë në ushtri, bashkëpunëtorë të tyre, kanë qenë dhe mbetën pa kulturën e përgjithshme dhe pa kulturën ushtarake të mjaftueshme. Kultura e tyre ushtarake ishte e sipërfaqshme, pse, në kohën që ata studiuin në shkollat e Bashkimit Sovjetik, nuk mundën ta zotëronin atë,

për arsye se jo vetëm kishin një kulturë të paktë, por nuk dinin as gjuhën ruse. Kjo i ka penguar shumë ata që të kuptonin përmbajtjen e teksteve shkollore e të leksioneve që u bëheshin, pa lëre literaturën përkatëse plotësuese që duhej të lexonin e të përvetësonin.

Këtyre pengesave u duhet shtuar edhe vetë karakteri i rëndë, dogmatik, klasik i një ushtrie të madhe, siç ishte ushtria sovjetike, që kishte ndërtuar një art ushtarak të vetin, sipas kushteve në të cilat ajo u zhvillua. Për njerëzit tanë ka qenë e zorshme të dallonin elementet revolucionare të këtij arti ushtarak nga ato të mbeturinave të artit të vjetër ushtarak rus dhe të eksperiencës moderne të fituar në betejat e Luftës së Dytë Botërore kundër hitlerianëve.

Natyrisht, kuadrot tanë morën atje ca njohuri të përcipta për disa norma politiko-ushtarake, po disa prej tyre harruan Luftën tonë Nacionalçlirimtare, pse një pjesë këtë nuk e bënë ashtu siç duhej, por edhe ata që luftuan mirë në atë kohë, eksperiencën e Luftës Nacionalçlirimtare e panë më vonë si një bagazh pa rëndësi përpara asaj çka «kishin mësuar» në shkollat ushtarake. Por, për fat të keq, ajo që «kishin mësuar» ishte e paktë dhe ata as që morën mundimin ta zgjeronin. Ata mësuan më mirë funksionimin dhe përdorimin e armëve të ndryshme, që i jepeshin me pakicë ushtrisë sonë jo vetëm në numër, por edhe në lloje; mësuan, sa mësuan, gjithashtu, disa rregullore dhe u kthyen prej andej për të punuar për forcimin e organizimit të ushtrisë sonë.

Krahas me këtë, ne kërkuam edhe instruktorë ush-

tarakë sovjetikë për të na ndihmuar. Por, duke i gjykuar punën dhe ndihmën e tyre me syrin kritik, del se këta ishin më shumë njerëz të praktikës ushtarake sesa teoricienë ushtarakë, ishin më shumë njerëz që kishin komanduar reparte në luftë ose që punonin nëpër shtabe. Në fakt, ndihma e tyre ka qenë më shumë praktike, organizative dhe fare pak, për të mos thënë aspak, teorike. Kështu edhe disa nga kuadrot tanë u treguan më shumë praktikienë, u përpoqën t'u mësonin të tjerëve ato gjëra që kishin mësuar vetë, por përpjekje serioze për të zgjeruar horizontin e vet dhe për të thelluar dijenitë e tyre për artin ushtarak revolucionar, për filozofinë marksiste-leniniste, që e udhëheq dhe e zhvillon këtë art, ata nuk bënë. Më të shumtit harruan edhe atë rasishte të çalë që mësuan dhe që mund t'i ndihmonte për të lexuar dhe për të studiuar për pasurimin e njohurive fillestare, për të nxjerrë konkluzione, për të bërë krahasime dhe për të gjetur mënyrën dhe formën më të përshtatshme për t'i përdorur dhe për t'i aplikuar në terrenin tonë njohurisë e fituara.

Në ushtri kërkohen përpjekje serioze për studimin e Artit Ushtarak të Luftës Popullore, të Tezave të Këshillit të Mbrojtjes. Këto janë një ushqim i shëndetshëm i teorisë revolucionare për luftën popullore në kushtet e kohëve moderne, të shpikjeve të mëdha, të armëve atomike dhe të strategjive e të taktikave të ndryshme që kanë përdorur, përdorin dhe do të përdorin armiqtë. Kjo teori dhe këto teza nuk e harrojnë dhe nuk e nënvlerësojnë armikun që do të kemi përpara. Njëkohësisht

ato trajtojnë, dhe kjo është me një rëndësi të madhe, se si duhet të luftojnë ushtari dhe kuadrot tanë, si të mbrohen, si të sulmojnë e si të tërhiqen në kushte të ndryshme, si të ruajnë forcat dhe kur duhet të pranojnë sakrificën. Kjo gjë, trajtimi i këtyre problemeve, nuk mund të bëhet në qoftë se ke një horizont të ngushtë të njohurive ushtarake, sidomos për ushtritë e huaja. Ajo kërkon njohuri të shumta, të cilat duhet t'i shkosh në shoshën e imët të marksizëm-leninizmit, kërkon që të kesh parasysh jo vetëm këtë teori, por edhe eksperiencën e Luftës sonë Nacionalçlirimtare. Pra, jo ta harrosh dhe ta nënvlerësosh këtë eksperiencë, pse, po e bëre këtë, shkëputesh nga tabani, nga themeli.

Beqir Ballukut e pasuesve të tij u kishte dalë nami i rremë e pa baza si njerëz që gjoja njihnin problemet ushtarake, por ky ishte një bluf. Praktikizmin e tyre ata e vetëquanin «shkenca dhe arti ushtarak» i Ushtrisë sonë Popullore. Edhe shkrimet e referatet e disa kuadrove që vegjetonin si pedagogë në shkollat tona ushtarake ose në akademi, jo vetëm që lënë shumë për të dëshiruar, por ato duhet të jenë kopje të këqija të një literature të huaj revizioniste, siç edhe u vërtetua. Kjo është gjendja për sa i përket anës teorike, pse ana praktike e studimit dhe e përdorimit të armëve të ndryshme besoj se duhet të jetë më mirë.

Elementët tradhtarë, që u munduan të organizonin komplotin ushtarak, injorancën e tyre e mbulonin me fudullëkun dhe me arrogancën e vet. Ata s'mungonin orë e çast të përdornin terma të mëdhenj ushtarakë: «arti ushtarak», «strategjia dhe taktika», «arti klasik

borgjez dhe ai revolucionar», «tërheqja strategjike», «strategji difensive e strategji ofensive». Këto ata i dinin vetëm si terma, kurse kuptimin nuk ua dinin.

Termat që përmenda më lart janë të njëllajtë si në manualët tona ushtarake marksiste-leniniste, ashtu edhe në ato të ushtrive borgjezo-imperialisto-revizioniste. Vetëm se, dhe kjo është gjithçkaja, ndryshojnë kuptimi dhe përmbajtja, pse ndryshojnë luftërat e drejta revolucionare nga luftërat e padrejta, grabitqare dhe shfarosëse imperialiste. Pavarësisht se armët e ndryshme të zjarrit që përdorim si ne, si armiku janë të njëllajta, përdorimi taktik i tyre nuk është i njëllajtë, si në sasi, si në lloje, ashtu edhe në kohë, pse edhe taktikat, edhe qëllimet janë të ndryshme. Njëri mendon këtë apo atë rrugë për të arritur fitoren, ndryshe mendon tjetri t'i bëjë varrin armikut të vet. Këtu qëndrojnë edhe ndryshueshmëritë në strategji dhe në taktika. Duhet t'i njohësh të dyja. Por, shokë oficerë dhe ushtarë, në rast se nuk studioni thellë e me rrënjë strategjinë dhe taktikën e Ushtrisë sonë Popullore, në qoftë se ato nuk i keni bërë gjak dhe kockë të trupit tuaj, në të gjithë komponentët e tyre, jo vetëm që e keni zor, por as do t'ju vlejë njohja e strategjisë dhe e taktikave të armiqve të jashtëm. Armiqtë që zbuluam në ushtri ju jepnin juve të mësonit librat e revizionistëve dhe ju fshihnin ata të Partisë suaj. Pra, ata bënë krejt të kundërtën e asaj që kërkonte Partia. E kuptoni tash ç'djallëzi e ç'tradhti të madhe që luanin?!

Është fakt se çështjet që përmenda, ata jo vetëm nuk ua mësuam kurrë kuadrove, por edhe kur këtyre

ua ka shpjeguar Partia, këta elementë armiq i përbuzën dhe i fshehën ato nga masat e oficerëve dhe të ushtarëve. Ky veprim ishte armiqësor. Por duhet thënë se, nga ana tjetër, këta armiq jo vetëm që nuk i dinin këto parime, por nuk kishin as praktikën e studimit. Ata thoshin se s'kishin ç'u duheshin këto gjëra as kuadrove dhe as ushtarëve. Qëllimi i tyre doli qartë: të dobësonin me çdo mjet ushtrinë dhe mbrojtjen e vendit.

Lufta nuk bëhet vetëm me armë. Është njëra anë që armën duhet të dish ta përdorësh mirë në beteja. Por që të udhëheqësh mirë një betejë dhe shumë beteja njëra pas tjetrës duhet ta kesh kokën plot, të dish ligjet e luftës, jo t'i njohësh përciptas dhe vetëm t'i numërosh këto ligje, por ajo që ka rëndësi është t'i zbatosh.

Unë nuk kam për qëllim që të numëroj ligjet e luftës, vetëm dëshiroj shkurtimisht të përsëris disa parime që na mësojnë klasikët tanë. I studioni thellë veprat e këtyre, se janë një thesar i paçmuar. Këto mësohen në shkollat dhe në akademitë ushtarake, por aplikimi i tyre në mënyrë korrekte dhe që ato t'u përshtaten situatave, rrethanave, terrenit dhe gjendjes ekonomike e politike të vendit duhet bërë në mënyrë konkrete dhe në ngjashmëri sa më të përafërt me kushtet e luftës. Po ashtu duhet të njihen armiku, forca e tij, organizimi, armatimet dhe efekti i tyre, gjendja moralo-politike dhe ekonomike e tij, gjithashtu, strategjia dhe taktika që ai ka përdorur, përdor ose do të përdorë. Një studim i tillë nuk lejohet të bëhet i përciptë, sepse, po nuk u thellove, shkohet në luftë me sy mbyllur, duke mos

ditur ç'ke përpara dhe ç'forma e metoda lufte të vë armiku përballë.

Është e kuptueshme se këto duhen ditur, se duhen njohur mirë ligjet e përgjithshme të luftës, por është po aq e rëndësishme të jesh në gjendje të ndërtosh edhe skema parashikuese të përiferuara me ato të luftës. Kjo kërkon të studiosh seriozisht dhe të bësh stërvitje të panumërta në praktikë.

Unë jam plotësisht i sigurt që udhëheqësit kryesorë të ushtrisë, që tradhtuan, nuk mësonin, nuk studionin fare. Ata merreshin me çikërrima, me letra, me ahengje e me mburrje. Faktet tregojnë se këta njerëz nuk mbajtën kurrë referate në shkollat ushtarake, në akademi ose me kuadrot e njësive etj. për probleme të dorës së parë të strategjisë dhe të taktikës sonë ushtarake dhe të armiqve. Disa raporte që mbanin ngandonjëherë ishin të përgatitura nga qatipët e tyre, po ato ishin kashtë nga përmbajtja. Në to kishte gjëra të përgjithshme të një rutine të përditshme, kritika në adresë të të tjerëve dhe fraza bombastike e mburrëse për ushtrinë, që stërvitej dhe mësohej në boshllëk të madh.

Ushtarit të ushtrisë sonë, që duhet ta njohë mirë terrenin e vet ku vepron, jo vetëm nga ana e relievit, por sidomos nga ana politike, ekonomike etj., as që i bëhej fjalë për këtë anë: mendohej se «ai i njeh këto instinktivisht, se mjafton t'i flitet në mënyrë të përgjithshme, pa të tjerat i mëson nga gazetatat, librat» etj.

Të gjitha këto, që formojnë një bazë të shëndoshë ideologjike, politike e ushtarake tek ushtari ynë, i cili duhet të dijë për se lufton, ku do të luftojë, ç'do të gjejë



atje, ku dhe kur duhet të tërhiqet, ku dhe kur do të organizojë kundërsulmin etj., nuk kanë pasur rëndësi për kuadrot armiq drejtues të ushtrisë. Rëndësi për ata kishte rendja me një frymë e ushtarëve, pa pirë asnjë pikë ujë për 7 orë me radhë pas një vrapimi të lodhshëm. Kjo ishte për ushtarët «kalitja fizike» ala Petrit Dume që vetë bridhte me kalë. të cilit në vend të ujit i jepte qumësht me vezë të rrahura. Edhe ato të pakta nocione lufte që u mësonin ushtarëve jepeshin në mënyrë dogmatike. Puçistët dhe pasuesit e tyre nuk vritnin mendjen t'i thellonin e t'i zhvillonin këto nocione, por më në fund gjetën metodën tradhtarë të futnin literaturën revizioniste. Jo, nuk u duheshin këtyre «udhëheqësve-tradhtarë parimet dhe kërkesat e Artit tonë Ushtarak të Luftës Popullore. Mendimi i tyre ishte se kuadrot dhe ushtria nuk duhej t'i njihnin ato, nuk duhej t'i mësonin e t'i zbatonin, pse, ndryshe, këtyre tradhtarëve do t'u dilte kallaji.

E para e punës, këta armiq kishin vendosur që ushtrinë ta mbanin në padije, ta mësonin me ato gjëra dhe me ato teori të armikut që do të na sulmonte, domethënë të mos i kundërviheshim këtij me Artin tonë Ushtarak të Luftës Popullore. Por direktiva dhe kujdesi i Partisë për studimin dhe zbatimin në jetë të këtij arti ua prishnin atyre këtë plan të koordinuar me agjunkturën sovjetike etj.

Është e domosdoshme që kuadrot ushtarakë dhe gjithë ushtria jonë të bëjnë një kthesë rrënjësore në studimin e Artit tonë Ushtarak dhe në stërvitjet, të hedhin poshtë jo vetëm «stilin dhe metodën» e punës që nga-

herë e përmendin, por ata duhet të flakin tej, në radhë të parë, mentalitetet dhe pikëpamjet e vjetra dhe të shtrembra të artit ushtarak borgjezo-revizionist. Duhet ta mësojë dhe ta mësojë mirë ushtria jonë Artin tonë Ushtarak revolucionar të Luftës Popullore. Kuadrot dhe ushtarët, në radhë të parë, të kuptojnë thellë parimet bazë të këtij arti që zhvillohen në Tezat e Këshillit të Mbrojtjes dhe këto të mos i mësojnë shabllon, por në mënyrë krijuese dhe t'i thellojnë. Të kihet parasysh që çdo taktikë duhet të jetë pjesë e strategjisë dhe të gjitha taktikat e përdorura në luftë duhet të përbëjnë strategjinë.

Fitorja përfundimtare mbi armikun do të vijë si rezultat i strategjisë sonë revolucionare dhe i taktikave të studiuara shkencërisht, ndërsa një studim i përciptë, aventuresk dhe një zbatim i çrregullt, jorigoroz i strategjisë dhe i mbështetur në taktika e në strategji po ashtu të studiuara keq, spontane dhe të rastit, sjellin disfatën.

Disa nga kuadrot kryesorë të ushtrisë, e sidomos ata të grupit armiqësor, nuk kishin ide të qarta dhe të drejta teorike për strategjinë dhe taktikat, prandaj ata nuk mund t'ua bënin si duhej të qarta në praktikë ushtarëve.

Ushtaraku ynë duhet të jetë i përgatitur mirë qysh tani, që, nesër, në rast lufte, të jetë në gjendje të nuhatë situatën e tij dhe të armikut që ka përpara dhe që po e lufton, t'i punojë imagjinata, të jetë vigjilent dhe të ketë parasysh ose të përfytyrojë koniunkturat që mund të krijojnë luftimet, të dijë të marrë vendime taktike të shpejta dhe të drejta, vendime të tilla që të mos pri-

shin unitetin e qëllimit strategjik. Gjithashtu, ai nuk duhet të neglizhohë dhe, për më tepër, të mos harrojë unitetin e veprimeve luftarake të koordinuara me repartet e tjera, veprime këto që përbëjnë pjesë jo të shkëputura të strategjisë globale. Pa bashkëveprim nuk mund të arrihen sukcesi e fitorja në veprimet luftarake. Ky bashkëveprim, koordinim e bashkërendim i veprimeve midis reparteve të ndryshme nuk është një gjë e lehtë, siç mendojnë dhe siç veprojnë me mendjelehtësi disa që japin komandën. Komanda për një veprim të tillë lyp një numër informatash ekzakte, të shumëllojta dhe të shumanshme për ushtrinë tënde dhe për gjendjen e armikut. Të gjitha këto duhet të jenë për komandat dhe për shtabet e çdo instance një objekt nga më seriozët i punës, sepse në bazë të tyre do të merret një vendim me rëndësi për veprime taktiko-operative në përputhje me strategjinë globale.

Në lojërat dhe në stërvitjet e ushtrisë sonë nuk duhen lejuar dobësi në këtë drejtim. Këto dobësi mund të vijnë nëse komandantët tanë kanë mangësi në dijet e tyre, por edhe nëse ata nuk i zbatojnë si duhet edhe ato që dinë, nëse nënvleftësojnë informacionin, nuk e trajtojnë dhe nuk e studiojnë atë si në kohë lufte, nëse secili mendon vetëm për veprimin e shkëputur të repartit të vet, për t'u treguar se vepron me «shkathtësi», nëse nuk koordinojnë, pasi t'i gjykojnë, manovrimet dhe taktikat e sugjeruara nga repartet që bashkëveprojnë. Në qoftë se nuk bëhen këto, atëherë do të krijohet konfuzion i madh, që, nesër, në rast agresioni, do të jetë me pasoja.

Pse mund të ngjasin këto dobësi? Mendoj se shkak u qëndron në punën e pamjaftueshme për edukimin e kuadrove, në studimin jo me baza të teorisë së këtyre çështjeve, që, megjithëse përbëjnë probleme teorike dhe praktike të veçanta për çdo repart, ato janë, gjithashtu, të përbashkëta dhe të ndërlidhura për të gjitha repartet. Reparti mund të ketë mjaft informata, por, kur ndërlidhja s'punon, asgjë s'vlen. Po kështu ndodh kur artileria ose tanket s'janë në gatishmëri. Kjo është abëcëja, por ka në ushtri dhe disa që nuk e dinë mirë këtë abëcë.

Ushtria jonë duhet të dijë mirë për se lufton. Kjo lyp një punë politike të vazhdueshme. Puna politike që bën Partia me njerëzit tanë, që ndërtojnë socializmin, kurrë nuk duhet të ndahet ose të shkëputet nga rrënjësia e një kuptimi të thellë politik se atë që po ndërtojmë, duhet edhe ta mbrojmë, se armiku i brendshëm, i ndihmuar nga i jashtmi, na saboton gjatë ndërtimit dhe i jashtmi synon të na sulmojë për të na shkatërruar dhe për të djegur çdo gjë që ndërtojmë, që popullin ta robërojë.

Lufta, në përgjithësi, dhe ajo që do t'i bëjmë ne armikut nuk duhet menduar se «është një formë e vendosur që më parë» dhe se nuk duhet të lëvizim nga ajo formë. Jo. Ajo duhet konsideruar dhe është një proces i ndërlikuar me të njohura dhe me të panjohura, me të pritura dhe të papritura. Prandaj, zotësia e kuadrove dhe e ushtarëve tanë qëndron në atë që të parashikojnë shumanshmërinë e situatave që mund të krijohen gjatë luftimeve, të mprehin vigjilencën dhe të rritin aftë-

sitë e tyre për të marrë masa të vendosura, të shpejta dhe të drejta.

Kuadrot tanë ushtarakë, që mësojnë në shkolla ose në akademi, si edhe pedagogët e tyre duhet të kenë kujdes nga teoritë e artit ushtarak klasik të kohëve të kaluara ose moderne. Në këtë çështje ka rëndësi interpretimi i këtij arti. Për ne nuk ka kuptim dhe nuk është i efektshëm studimi i këtij arti, në rast se ky nuk interpretohet në mënyrë revolucionare dhe nuk hap pikërisht atë perspektivë që orienton Partia dhe që shërben për t'i bërë armikut një luftë të ashpër dhe të vazhdueshme deri në disfatën e tij të plotë.

Për kuadrot tanë është e qartë se strategjia dhe taktika nuk mund të jenë të shkëputura nga njëra-tjetra. Por të mos kuptohet sikur strategjinë duhet ta kenë parasysh vetëm shtabet kryesore të njërive të mëdha të ushtrisë. Jo, është e nevojshme dhe e domosdoshme që strategjia, goftë dhe në mënyrë të pjesshme, të njihet dhe nga njësitë e repartet më të vogla për zhvillimin e mirë të operacioneve. Njohja e strategjisë nga të gjithë është shumë e domosdoshme dhe e nevojshme për arritjen e sukseseve të veprimeve taktike.

Është, gjithashtu, e domosdoshme që njerëzit, qofshin këta kuadro apo ushtarë, të kuptojnë se në luftë ka vlerë të madhe situata e njohur në hollësi, por pa e shkëputur këtë nga qëllimi i përgjithshëm i luftimit. Njohja e situatave konkrete ka vlerë të madhe, por kjo nuk duhet të na bëjë që të nënvleftësojmë hollësitë dhe zhvillimin dinamik të tyre. Nuk duhet harruar asnjëherë se në kohë lufte situatat dhe koniunkturat zhvillohen

me shpejtësi dhe paraqiten të komplikuar. Prandaj ato duhen ndjekur me kujdes që të merren vendime të sakta.

Njohja e ligjeve revolucionare të luftës është e domosdoshme të bëhet si në kohën e grumbullimit dhe të studimit të informacioneve deri në hollësi, ashtu edhe në kohën kur vendosim të futemi në aksion, në luftë, në çdo formë të luftës që kërkon zhvillimi i betejës, në mbrojtje, në sulm, në kundërsulm, në tërheqje etj. Pra, të gjitha fazat e betejës zhvillohen objektivisht dhe si oficeri, edhe ushtari duhet t'i njohin këto ligje revolucionare të luftimit.

Një shembull tipik në këtë drejtim është për të parë se si i përdorte me një mjeshtëri të madhe ligjet e luftës dhe mënyrat e luftimit Aleksandri i Madh i Maqedonisë. Në luftime ai merrte kurdoherë parasysh armikun që kishte përballë, taktikën e tij të luftimit, terrenin ku zhvillohej beteja dhe, me një shpejtësi të madhe, në përshtatshmëri me ligjet e luftës dhe brenda strategjisë së tij globale, ndërtonte taktikat e ndryshme të luftimit, që nga betejat frontale, sulmet apo mbrojtja me formacionin luftarak në formë «katrorë» dhe deri te lufta «partizane» dhe ndjekja e organizuar jo vetëm për shpartallimin e armikut, por për asgjësimin e plotë të tij.

Mora për shembull Aleksandrin e Madh, pse, sipas mendimit të tij, është tipik gërshetimi aq i lartë i strategjisë së tij globale me taktikat operative. Luftërat e tij kishin një qëllim kryesor: të krijonte një perandori të madhe që filloi nga Atika, kaloi Helespontin dhe arri-

ti deri në Indus. Qëllimi i tij ishte zhvillimi ekonomik dhe përhapja e kulturës greke kudo ku kalonte. Jo vetëm kaq, por ai synonte, gjithashtu, të bënte një shtarim të kulturës greke me kulturën po aq të madhe të popujve të Orientit. Prandaj, kur studiojmë historinë e luftërave të Aleksandrit, gjatë gjithë rrugës ku ai kaloi me luftime, shohim krijimin e «satrapive»<sup>1</sup> dhe të qyteteve të mëdha, që lindën edhe si baza ekonomike për prapavijat e tij, që zgjeroheshin, por edhe si qendra intelektuale dhe zhvillimi të një qytetërimi greko-egjiptian, greko-persian, greko-indian.

E përmenda këtë ndodhi historike për të vënë në dukje se sa drejt i kuptonin dhe i zbatonin ligjet e luftës dhe sa mirë i koordinonin strategjinë dhe taktikat në luftime tre shekuj para erës sonë njerëz të mëdhenj.

Sigurisht, në kohët tona të atomit ajo që thashë për Aleksandrin e Maqedonisë mund të duket anakronike dhe kështu është. Tani ushtritë, armatimet, shkencat luftarake, strategjia dhe taktikat e ushtrive agresore dhe të luftërave popullore çlirimtare janë krejt ndryshe nga ato të periudhës së lashtësisë. Ushtria jonë zbaton Artin Ushtarak të Luftës Popullore, që është një art marksist-leninist revolucionar, i cili u qëndron përballë dhe u shkakton disfata strategjisë dhe taktikave të fuqive të mëdha imperialisto-revizioniste.

Në rast të një lufte, në fillim, qoftë nga forca e madhe e armikut që na sulmon ose nga elementi befasi,

---

1. Krahinë që qeverisej nga një satrap (sundues i një kra-  
hine te persët e lashtë).

ne mund të detyrohemi të përdorim një «strategji mbrojtjeje». Por asnjëherë dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të përdorim vetëm strategjinë mbrojtëse. Kjo duhet të mbështetet në një sasi operacionesh taktike ofensive. Ne duhet të evitojmë gabime në luftë, në dy drejtime: as të mos zhvillojmë vetëm «strategjinë difensive» pa operacione ofensive derisa të kundërsulmojmë, dhe as të zhvillojmë «aventurizmin ofensiv» që është me pasoja të rrezikshme.

«Strategjia mbrojtëse» të çon, pa dyshim, në pasivitete, në pesimizëm. Ajo sikur të jep përshtypjen se gjoja mbrohen forcat, por në të vërtetë lejon armikun që të marrë frymë dhe të organizohet. Arti ynë Ushtarak i Luftës Popullore e shpjegon mirë këtë moment dhe kërkesat e tij për të duhen zbatuar me shkathtësi, përndryshe armiku të bllokohet dhe të çon drejt e në luftën partizane. Pikërisht ky ishte objektivi i tradhtarëve aventurierë Beqir Balluku dhe Petrit Dume. Masat që u orvatën të merrnin ata gjoja për mbrojtjen e bregdetit dhe për zëvendësimin e forcave kompakte operative me forca «vullnetare», që ata i konsideronin «partizane», pa vlerë, kishin për qëllim të dobësonin rezistencën tonë përpara sulmit armik, të parapërgatitnin shkoqjen e ushtrisë sonë në njësitë të vogla partizane dhe të errësonin e ta bënin jooperuese komandën unike e të përgjithshme.

Lukeni<sup>1</sup> dhe mjaft historianë romakë tregojnë se Cezari kapërceu detin me legjionet dhe kohortat e tij

---

1. Poet latin (39-65).



dhe u sul drejt Orikumit (Pashalimanit në Vlorë). Mincius Rufus, që komandonte një pjesë të eskadrës së Pompeut, e mbyti këtë dhe u mbyll në Durrës, ku mbërriti me shpejtësi edhe vetë Pompeu i ardhur nga Thesalia. Dyrrachiumi (Durrësi) ishte vend i fortë dhe atje ai kishte grumbulluar ushqime, municione, armë dhe floririn. Filloi kursi se kush do ta zaptonte më parë Durrësin, Cezari apo Pompeu. Dhe këtë e zaptoi Pompeu.

Cezari kishte zënë vend afër Apolonisë, buzë lumit Aaos (Vjosës) dhe ishte në pozita të këqija, se forcat, që i priste të vinin me Mark Antonin, s'po dukeshin. Kur Cezari e pa flotën dhe Mark Antonin që doli në horizont dhe hodhi ankorat në Nympheon, u vërsul i uritur me legjionet e tij drejt Durrësit. Mirëpo murit s'i bihej dot me kokë. Durrësi nuk merrej dhe Pompeu, duke e parë se kundërshtari po dobësohej, e ndoqi atë deri në brigjet e lumit Aaos dhe Cezarit legjendar i shkaktoi një disfatë të madhe, saqë legjioneve të tij u hyri paniku dhe për pak vranë edhe perandorin e tyre, i cili përpiqej t'i mbante që të mos braktisnin fushën e luftës. «Por Pompeu s'diti të fitojë, — tha Cezari, — ai nuk na ndoqi të na shfaroste».

Dhe Cezari dy ditë e dy net, i mbyllur në një dhomë, mendonte për sulmin e ardhshëm. «Si e bëra unë atë gabim që atakova Durrësin, — tha Cezari, — ai është vend i fortë, nuk merret, prandaj duhet ta nxjerr Pompeun nga Durrësi dhe ta çoj në atë fushë, ku është më e përshtatshme për mua». Dhe kështu bëri, e çoi Pompeun në Farsali (vend në Thesali), ku e theu përfundimisht.

Këtë episod të luftërave të Cezarit me Pompeun në vitet 50-48 para erës sonë e solla si shembull të strategjisë dhe të taktikës së ndjekur nga dy burra të mëdhenj. I përmenda, gjithashtu, edhe se këto beteja u zhvilluan në tokën tonë, në brigjet tona, në portet tona, që ishin aq të forta dhe të papushtueshme edhe nga Cezari. Kurse «strategët» e qelbur, si Beqir Balluku e Petrit Dumja, nuk u vinin rëndësi porteve dhe anës së detit. Ata ishin të manovrave të mëdha të «stepave të gjera të pafund të Rosisë dhe të fushave të Danubit». Dyrrachiumi, Apolonia, Aosi s'kishin shumë rëndësi për ta. Ata ishin për luftën partizane dhe për t'i lënë armikut mundësi që të na zaptonte toka.

Dikush mund të thotë: «Këto që na thotë Enveri janë «histori të vjetra», lufta, taktikat dhe strategjia tash kanë ndryshuar». Ashtu është vërtet, por, duke mësuar mirë luftën moderne, s'bëjmë keq të njohim edhe të vjetrat dhe të bëjmë disa herë nga ndonjë analogji që mund të na vlejë.

Që të fitosh mbi armikun është e domosdoshme ta njohësh mirë atë, të njohësh taktikën e tij dhe taktikën tënde ta ndërtoosh në atë mënyrë që t'ia shkatërrosh armikut taktikën e tij. Kështu do të fitojmë ne mbi të. Të mos kujtojmë se taktikat janë të pandryshueshme. Përkundrazi, ato janë të shumëllojshme, pse jeni të detyruar që çdo taktikë të armikut, forcës së tij të gjallë, gjendjes politike dhe morale të ushtrisë armike, forcës së zjarrit të tij dhe konfiguracionit të terrenit, qoftë ky natyror, qoftë i fortifikuar, t'u kundërvëmë taktikat tona. Nga ana tjetër,

edhe armiku e studion taktikën tëndë dhe ai është munduar të ta zbulojë atë qysh më parë, por edhe gjatë luftimeve përpiqet të të diktojë me taktikat e veta dhe të adoptojë kështu taktika të reja operative.

Armikun, strategjinë, taktikën dhe të gjitha strategjemat e tij të luftës nuk mund dhe nuk duhet pritur t'i mësosh kur fillon lufta ose gjatë luftimit. Jo, ato duhet t'i mësosh dhe t'i studiosh qysh më parë në libra dhe në artikuj të ndryshëm. Po si t'i mësosh? Siç bënin vallë Hito Çakoja me Petrit Dumen, të cilët vetë jo vetëm nuk studionin, por merrnin libra të huaj, jepnin porosi t'i përkthenin, u ndërronin titujt dhe ua jepnin kuadrove tanë t'i hanin sikur të ishin prodhimi ynë, ndërsa materialet e Partisë sonë i nënvlerësonin dhe i zhduknin? Kjo do të thotë të hedhësh poshtë marksizëm-leninizmin dhe ta zëvendësosh atë me teorinë borgjezo-revizioniste të luftës, të mësosh teorinë e mareshalëve sovjetikë, që deformojnë faktet e ngjarjet për të vënë me krenari në dukje personalitetet e tyre dhe për të përçmuar, për të zhdukur krejt personalitetin e madh të Stalinit, i cili ishte i madh, pse ndiqte dhe aplikonte në beteja ligjet e vërteta të doktrinës së marksizëm-leninizmit. Ç'mund të tregonte në memuarët e tij një Zhukov që, kur luftoi, luftoi mirë, pse udhëhiqej nga Stalini, por, kur mbaroi lufta, filloi të devijojë në teoritë e tij të luftës, saqë Stalini u detyrua të merrte masa? A ishin të drejta këto masa? Koha e tregoi se ishin të drejta. Zhukovi doli një antimarksist, një puçist që solli në fuqi Hrushovin dhe ky më në fund e hodhi atë poshtë si një limon të shtrydhur, pse kë-

konte t'i zinte vendin. Hrushovi e quajti «bonapartist» dhe memuaret e këtij bonapartisti ua vinte në dorë oficerëve tanë Hito Çakoja.

Partia jonë do të lejojë që kuadrot tanë të njihen me literaturën ushtarake armike, po kjo të mos bëhet me qëllim për të deformuar doktrinën dhe Artin tonë Ushtarak të Luftës Popullore, siç bënin tradhtarët Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako e të tjerë. Këtë literaturë kuadrot e ushtrisë sonë duhet ta njohin të përpu-nuar, që të dinë se si ta luftojnë, po jo ta adoptojnë. Pastaj një gjë e tillë do të lejohet në mënyrë të kufizuar, aq sa duhet dhe, që të kuptohet drejt kjo që do të lexohet nga kuadrot tanë, më parë nga të gjitha e mbi të gjitha duhet të mësohen prej tyre teoria marksiste-leniniste dhe Arti Ushtarak i Ushtrisë sonë Popullore. Këta të studiohen mirë me synim që çdo kuadër të nxjerrë prej tyre mësim, konkluzione teorike e praktike.

Në shkrimet e tij Marksi i shkruan Engelsit edhe për Luftën e Krimesë<sup>1</sup> se «Mendimi i lord Raglanit<sup>2</sup> ishte më i drejtë nga ai i Kanroberit<sup>3</sup>, se në luftën e Almas<sup>4</sup> duhej të atakoheshin rusët më mirë nga toka sesa nga

1. Kjo luftë u zhvillua gjatë viteve 1853-1856 ndërmjet Anglisë, Francës dhe Turqisë, nga njëra anë, dhe Rusisë cariste, nga ana tjetër, të cilat ishin në konflikt për synimet e tyre push-tuese në Lindjen e Afërt dhe në Ballkan.

2. Kryekomandant i ushtrisë angleze në Luftën e Krimesë.

3. Kryekomandant i ushtrisë franceze në Luftën e Krimesë.

4. Lumë në Krime, vendi ku u zhvillua beteja e ushtrisë ruse me ushtritë e bashkuara të anglezëve, francezëve dhe turqve më 20 shtator 1854, në Luftën e Krimesë.

deti». Një gjykim i tillë vlen sa një mijë harta dhe plane që bëheshin në letër. Është një çështje me rëndësi të mësohen kuadrot të lexojnë, si të lexojnë dhe ç'të nxjerrin të dobishme nga këto lexime.

Nuk duhet ta nënvlerësosh armikun, por as edhe ta mbivlerësosh. Elementët armiq, që zbuluam në ushtri, zhvillonin tendencën e nënvlerësimit të forcës numerike në njerëz dhe në armatime të armiqve tanë dhe me pompat më të mëdha frynin «zotësinë, heroizmin, krenarinë dhe pathyeshmërinë e shqiptarit». Kjo bëhej me qëllim nga ana e tyre për të lënë të kuptohej se, edhe sikur të lidhen duart, edhe po të mos mësohet Arti ynë Ushtarak, edhe sikur të mos ekzistojnë Partia dhe edukata politiko-ideologjike e saj, shqiptari mund të dalë kurdoherë fitimtar në çdo betejë dhe kundër kujtdo qoftë. Kjo dëmtonte përgatitjen ushtarake për të qenë kurdoherë në gatishmëri e të pathyeshëm.

Lufta nuk është një përrallë e shtojzovalleve, por një ngjarje shumë, shumë serioze, që ne nuk e duam, por që «trimi» Hito Çako predikonte «të bëhej sa më parë». Atë na e imponojnë armiqtë dhe ne duhet ta përballojmë. Shqiptari brez pas brezi ka luftuar, ka qenë dhe është trim dhe ka fituar, por ai s'ka qenë trim i marrë, por i mençur. Është kjo mençuri e bashkuar me trimërinë që e ka nxjerrë atë faqebardhë në beteja. Edhe tani shqiptari trim e i guximshëm, si kurdoherë, duhet t'i shtojë vetes mençurinë, zotësinë dhe diturinë në beteja, pse ky unitet është një faktor i rëndësishëm për fitoren. Dituria e njerëzve në të gjithë botën sot është

zgjeruar dhe është thelluar në të gjitha drejtimet. Ajo është një libër i hapur, i pambaruar dhe i pafund. Në çdo shkencë dhe në art ka disa ligje që i ka zbuluar praktika, që mendja e njeriut i ka pasuruar dhe, duke u bazuar në to, duke i kombinuar në mënyrë revolucionare, njeriu ka arritur në shpikje të mëdha që zotërojnë dhe transformojnë natyrën.

Po kështu edhe në artin ushtarak ka ligje të luftës, që duhet t'i dimë, t'i njohim dhe t'i perfeksionojmë në mënyrë revolucionare. Po s'bëmë këtë gjë, ne do të jemi më pak të përgatitur se armiku dhe do të rrezikojmë qenien tonë si popull i lirë. Studimi i ligjeve të luftës nuk është diçka e ngrirë, formale, stereotipe, sepse dhe vetë ligjet janë të gjalla e në zhvillim, në perfeksionim, ato janë në themel të zbulimeve të reja, siç ngjet edhe në shkenca të tjera. Prandaj asgjë të mos mësohet «angari», të mos mësohet «për të mësuar», por çdo gjë të tretet, të bluhet mirë nga kuadrot tanë, pse vetëm kështu, kur ta zotërojnë mirë vetë shkencën tonë ushtarake, ata do të jenë në gjendje t'ua mësojnë këtë edhe të tjerëve.

Ushtria jonë ka në duart e saj materiale shumë të vlefshme të Partisë, ka veçanërisht të zbërthyerat parimet e kërkesat e Artit Ushtarak të Luftës Popullore, që shtjellojnë në mënyrë të thellë dhe të qartë ato ligje të luftimit që përmenda më lart, të cilat duhet të studiohen dhe të kuptohen nga të gjithë. Këto parime të vihen në themel të studimeve dhe të stërvitjes ushtarake. Ato nuk mund të shkëputen kurrë nga pushka;

nga mitralozi, nga raketa dhe deri te stërvitja rreshtore. Nuk mund as të ndërtosh dhe as të hedhësh në kozmos ose në Hënë një raketë, pa ditur dhe pa aplikuar me korrektësi të madhe ligjet që drejtojnë sendet, ngjarjet, evenimentet.

Grupi i tradhtarëve, që zbuluam dhe qëruam nga gjiri i ushtrisë sonë heroike, ishte vendosmërisht kundër një edukimi dhe stërvitjeje shkencore e të koordinuar të kuadrove dhe të ushtrisë sonë. Kishin qëllime të thella armiqësore ata, që nuk e zbatonin Artin tonë Ushtarak, që nënvlerësonin dhe denigronin punën politiko-ideologjike të Partisë. Plani i tyre ishte që ata të degjeneronin ushtrinë tonë dhe t'i edukonin ushtarët e oficerët jo me shkencën ushtarake marksiste-leniniste të dalë nga eksperiencia e ushtrisë sonë, të bazuar në ligjet e luftës që përcaktuan mësuesit tanë ideologë të mëdhenj të marksizëm-leninizmit dhe në eksperiencën botërore të luftërave të drejta, që kanë zhvilluar dhe zhvillojnë popujt kundër kolonizatorëve, të vjetër dhe të rinj. Ky plan i këtij grupi tradhtarësh ishte një komplot shumë i rrezikshëm, mjaft i komplikuar dhe serioz. Pa asnjë dyshim ky komplot ishte i organizuar nga agjenturat e jashtme, si ajo sovjetike, jugosllave etj. Këta armiq ushtarakë ishin agjentë të kamufluar, që u raportonin padronëve të tyre gjendjen e vendit tonë, merrnin urdhra dhe direktiva veprimi nga jashtë dhe i zbatonin këto hap pas hapi. Askush të mos mendojë me naivitet se këto çka organizuan këta armiq janë gjëra të shkëputura, të rastit. Jo, asgjë nuk është e rastit

dhe ata që lëviznin fijet e këtij komploti dhe që vinin në lëvizje këta tradhtarë marioneta, janë me eksperiencë të madhe në komplete.

Le të reflektojnë thellë dhe seriozisht kuadrot e ushtrisë në ato çka numërova më lart dhe të dalin me konkluzione e detyra për të korrigjuar të metat e dobësitë dhe për të shëndoshur gjithnjë e më shumë gjendjen. Asnjë ushtar dhe oficer nuk duhet të ngelë i paqartë për veprimtarinë armiqësore të këtyre tradhtarëve. Sentimentalizmi i sëmurë, të cilin nuk e udhëheqin dhe nuk e pranojnë ideologjia e Partisë, logjika dhe analiza e fakteve, me siguri të çon në qorrsoqacë e në greminë, pse kështu i ke lejuar vetes të udhëhiqesh nga pamjet e jashtme, nga miqësia e sëmurë etj.

Por, për fat të mirë (fjala «fat» është një term idealist, por që populli e përdor), në sajë të vigjilencës, të forcës politike, ideologjike dhe organizative të Partisë, në sajë të kuadrove heroikë dhe besnikë të ushtrisë, komploti jo vetëm që dështoi dhe u dërrmua, por, ta kemi të qartë, ai nuk mundi ta infektonte masën e ushtarëve dhe të kuadrove. Komploti kishte prekur disa kuadro të lartë, tek të cilët tradhtarët kishin shpresë se nëpërmjet tyre do të kishin në dorë gjithë kuadrot dhe do t'i çonin këta si «berrat» kundër Partisë.

Kuadrot patriotë dhe komunistët marksistë-leninistë në ushtri, me gjithë këtë gjendje kaotike që përpiquej të krijonte ky grup tradhtarësh, mësonin, edukoheshin me Artin tonë Usharak të Luftës Popullore. Ata bënë çmos derisa i gjenin dhe i studionin mate-



rialet e Partisë, ashtu të cingvara nga puna e tradhtarëve, dhe përpiqeshin të nxirrnin maksimumin e mundshëm që mund të nxirrej prej tyre.

Tani puçistët i shporrëm nga mesi ynë, kuadrot e zgjuar dhe të zotë të ushtrisë, me mësim, me vendosmëri, me këmbëngulje do t'i plotësojnë boshllëqet dhe, në një kohë shumë të shkurtër, do të bëhen kuadro me aftësi e me merita të veçanta, sepse çdo gjë që do të dinë e do të mësojnë, do të jetë revolucionare dhe në mënyrë revolucionare do ta zbatojnë në jetë. Ky është besimi i patundur i Partisë dhe i Komitetit të saj Qendror.

Kuadro e ushtarë, komunistë dhe anëtarë të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, bashkohuni si një grusht i çeliktë siç keni qenë, jeni dhe që do të jeni kurdoherë rreth Partisë sonë të dashur! Partia ka dashuri dhe besim të madh te ju, pse jeni bijtë e saj. Tradhtarët ishin vetëm një grusht plehrash që i qëruam nga gjiri ynë i shëndoshë. Tradhtuan ata, kurse ju qëndruat besnikë shembullorë të Partisë dhe të popullit, të cilët ju duan si më parë dhe akoma më shumë se më parë. Partia dhe populli edhe ju kritikuan, por kjo na dha forcë kolosale të gjithëve, pse nuk u kritikuat vetëm ju, por të gjithë. Ne bëmë autokritikë të sinqertë, të hapët, që të gjithë: ushtarë, kuadro, Parti, në ushtri dhe në terren, udhëheqës të ushtrisë dhe të terrenit, deri tek anëtarët e Komitetit Qendror.

Ç'solli tërë kjo veprimtari partie? Një forcë kolosale në zemrat tona, në gjirin e popullit, dhe kjo forcë na çon përpara. Pra, ushtarë dhe oficerë, përpara nën

udhëheqjen e Partisë dhe me besim të shumëfishuar në forcat, në mençurinë dhe në zotësinë tuaj!

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Për Ushtrinë Popullore» (Përmbledhje veprash), vëll. II, Tiranë, 1984, f. 264*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Për shkencën» (Përmbledhje veprash), vëll. I, f. 528*

## NË NAFTË NA KANË SULMUAR KURDOHERË ARMIQTË. TA SHIKOJMË MIRË KËTË PROBLEM

*Bisedë me shokun Hysni Kapo*

3 shkurt 1975

Mbrëmë isha në Shtëpinë e Partisë. Atje erdhi edhe Abdyl Këllezi. «Çfarë kemi ndonjë gjë?», e pyeta. «Nuk kemi gjë», m'u përgjigj. Ndenji një çikë, pastaj tha: «Atje në naftë nuk po na shkojnë punët mirë». «Pse nuk na shkojnë mirë, — ia ktheva unë. — Çfarë ka ndodhur?». «Po ja, nafta nuk na ecën», vazhdoi ai. «E di që plani i kërkimeve nuk është realizuar, — i thashë. — Këtë çështje e kemi ngritur edhe në Byronë Politike dhe kemi diskutuar jo vetëm për atë që nuk po realizohet plani i prodhimit, por edhe për çështjen e organizimit. Ne kemi ngritur një institut studimesh për naftën që as shtete të zhvilluara kapitaliste mbase nuk e kanë një të tillë kaq të madh, me qindra veta!». «Dhe pikërisht atje nuk po na ecën puna», më tha Abdyl. «Po si mendon ti, pse nuk na ecën puna?», e pyeta. «Janë konceptet që pengojnë», u përgjigj ai. «Cilat janë këto koncepte? Nuk

na flet pak për këto?», i thashë. «Po ja, — m'u përgjigj, — ka lloj-lloj. Sipas njërit prej këtyre në naftë duhet të ecim me hope, sipas një tjetri duhet të ecim duke u thelluar». Pastaj ai tha se ka grindje midis drejtuesve të këtij sektori. «Po mirë, — iu drejtova, — për këto grindje përse nuk merr masa Qeveria që t'i zgjidhë?». «Unë kam vajtur atje në vend, bashkë me Koçon [Theodhosi], në muajin shtator, — pohoi ai, — dhe ia kam thënë të tëra këto që po jua numëroj».

«E ke vënë në dijeni Qeverinë për të tëra këto?», e pyeta. «Po, kam bërë edhe një raport për këto probleme, bile në detaje», u përgjigj. «Më thuaj ndonjë gjë edhe mua nga konceptet që kanë drejtuesit atje», iu drejtova atij. «Kur isha në vend, — më tregoi, — u ngrit njëri e tha: «Shoku Abdyl Këllezi, këtu nuk mund të gjejmë naftë»». «Po ka naftë apo nuk ka?», i ndërhyra unë. «Ka», tha Abdyli. «Atëherë, gjersa ka, përse nuk mund të gjejmë?», iu drejtova. «Se midis drejtuesve ka teorira që bien në kundërshtim me njëra-tjetrën», theksoi ai. «Po ti me cilën nga këto je dakord?», e pyeta. «Unë jam për atë të thellimit», u përgjigj. «Nuk më thua, si është kjo teori e thellimit?», i kërkova. «Kjo thotë që, kur t'i futemi një shtrese, t'i vemi asaj deri në fund dhe të gjejmë naftë», shpjegoi. «Po atëherë përse nuk keni vepruar kështu? — iu drejtova. — Unë kam shtruar çështjen që atje ku ka naftë, të thellohem».

Abdyli më tregoi se i kishte thënë bashkëbiseduesit që përmendi: «Mirë, more djalë, ne kemi një vendim». «Po ç'po bëhet këtu?», i qe kthyer ai. «Vjen një urdhër e kërkon të ngrihet sonda nga një vend ku është ven-

dosur dhe të vejë gjetkë. Shpo këtej, shpo andej; ngrije sondën këtej e çoje diku tjetër».

Unë nuk i ndërhyja Abdylit, se kisha letrën e punëtorit që më jepte disa sinjalizime. «Po kush i jep këta urdhra njëri pas tjetrit?», i thashë pastaj. «I jep Instituti i Naftës», m'u përgjigj. «Kush është për këta urdhra, drejtoria apo ministria?», e pyeta. «Është drejtoria, — më tha, — se ministria drejton në teori. Në praktikë duket sikur atje drejton Lipe Nashi, po në fakt drejton instituti». «Si është e mundur të drejtojë Lipe Nashi, kur këtij nuk i kanë lënë asnjë njeri, kur Drejtoria e Përgjithshme e Naftës nuk ka asnjë kryegjeolog ta ndihmojë?», i ndërhyra unë. «Kështu është, — pohoi Abdylit, — se të gjithë specialistët e lartë janë në institut». «Po çfarë bën kjo drejtori?», e pyeta. «Ajo merret me punët administrative, me kamionët e me çështje të tjera si këto», sqaroi ai.

Kur u interesova të di cilët janë personat që drejtojnë në institut, Abdylit më tregoi se një nga këta është Beqir Aliaj. «Mos është ai që e ka gruan sovjetike?», shtova unë. «E kishte, po e ka lënë atë dhe ka marrë një shqiptare», kërceu Abdylit. Por Beqiri njihet si njeri i rëndë, arrogant e mendjemadh. «Përveç këtij atje është edhe një tjetër i quajtur Koço Plaku», tha Abdylit. E pyeta se kush është ky. «Vëllai i Panajot Plakut», u përgjigj. «Po pse, vëllanë e Panajot Plakut keni vënë ju të punojë në një sektor kaq jetik të ekonomisë?», iu drejtova. «Ai është gjeolog i mirë, — nënvizoi Abdylit, — bile ka zbuluar edhe një fushë naftë. Ka pastaj edhe kuadro të tjerë. Vajtëm me Koçon

dhe dëgjuam për punët». «Po çfarë masash morët?», kërkova të di. «Së pari, — shpjegoi Abdyli, — diskutova unë atje: U thashë përse po veproni kështu e pse ashtu». «Po pastaj çfarë u bë? E shtruat në Qeveri problemin dhe çfarë masash mori Qeveria?», e pyeta. «E shtruum dhe Qeveria ngarkoi shokun Adil që ta shikonte këtë çështje. Ekzakt nuk e di, por më duket se shoku Adil ka bërë disa mbledhje me komisionin, ka nxjerrë disa gjëra dhe më njoftoi që këto ia ka thënë të gjitha shokut Haki [Toska] me radhë në një raport, bile me emra». «Këto janë shumë serioze, more Abdyli», i thashë.

Me një fjalë, pata përshtypjen se Abdyli donte të tregonte që këto gjëra i ka thënë ku duhet dhe tani po m'i thotë edhe mua. «Çështjen ju duhet ta merrni më seriozisht, — i theksova. — Gjersa Instituti i Naftës është organizuar me qindra veta, si nuk e keni shikuar më parë këtë çështje? Pastaj, kur është aprovuar gjithë kjo organikë?», e pyeta. «U aprovua kur u bë mbledhja e Qeverisë», m'u përgjigj. «Po që instituti po fryhet dhe merr në dorë çdo problem, që Drejtoria e Përgjithshme nuk ka gjë në dorë për të drejtuar naftën, si nuk ju kanë tërhequr vëmendjen këto çështje? Ju nuk i keni vënë një herë pyetjen vetes: «More, po çfarë po bën kjo drejtori? Po pastaj ministria?», iu drejtova unë. Ai më tha: «Ne më parë kishim njëfarë komisioni të naftës, ku ishte edhe Ramiz Xhabia. Mirëpo atje bëhej siç thoshte Lipe Nashi dhe Ramiz Xhabia u mënjanua». E pyeta se çfarë bën tani Ramizi. «Ai është njeri shumë i mirë, — m'u përgjigj, — po një çikë i rëndë, flet, bërtet, ka pretendimin të shtohet kjo, të shtohet ajo etj.» «Mos i kanë

vënë gjë bërrylat të tjerët, more Abdyl?», ia preva fjalën. «Nuk besoj», më tha.

Pastaj e pyeta pse u hoq nga nafta Perikli Prifti. «Atje ka qenë, — tha, — po e hoqëm, e prumë për mirë në universitet. Ai ishte një kuadër me të vërtetë i mirë në naftë. Andej hoqëm edhe sekretarin e Partisë dhe në vend të tij vumë një inxhinier të naftës, njeri shumë i mirë. Ky tani nuk merret fare me naftën, se merret me të gjitha çështjet». «Domethënë në naftë tani nuk kemi asnjë anëtar të Komitetit Qendror, — konstatova. Edhe një shoqe kandidate të Komitetit Qendror që kishim sekretare partie në Fier, Naunka Bozon, e hoqëm andej».

*SHOKU HYSNI KAPO:* Ajo erdhi nënkryetare e Këshillit të Përgjithshëm të BGSH këtu në Tiranë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Me një fjalë, tani nuk na ka mbetur asnjë nga shokët e Plenumit në këtë sektor kaq të rëndësishëm në Fier.

Nuk m'u durua më, prandaj i thashë Abdylit: «Ju keni përgjegjësi për këtë problem. Shokët e bazës jo me fjalë, por me dokumente më kanë informuar se nafta po na sabotohet». «Po ja, unë i kam vënë në dukje këto gjëra», u justifikua Abdyli.

Mendova ta linim me kaq. Por, ndërsa fillova bisedën me shokët për probleme të bujqësisë, Abdyli iu kthye prapë këtij problemi dhe shtoi: «Duhet ta shohim, shoku Enver, se nafta ka rëndësi të madhe». Atëherë u hodh Pilo Peristeri dhe, siç e ka ai, tha: «Këta intelektualët kështu e kanë, po kjo çështje duhet të shikohet me të vërtetë mirë, se mos ka punë armiqtësore

në sektorin e naftës». «Po të jetë kështu, këtë nuk na e fal as populli, as Partia. — theksova unë. Për të shtënë në dorë naftën tonë na kanë sulmuar të gjithë armiqtë: italianët, sovjetikët, Tuk Jakova, Pajo Islami e kush nuk na ka sulmuar për të na dëmtuar në këtë sektor. Prandaj ta shikojmë mirë problemin e naftës», përfundova, dhe me kaq e lamë këtë çështje. Doja të ishte edhe Hakiu këtu sot që të na fliste një çikë për këtë problem. Dua të di ç'mendon edhe ai.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*



# ORGANIZATA E PARTISË NË SEKTORIN E NAFTËS TË KUPTOJË MIRË PËRGJEGJËSITË QË KA DHE TË VIHET NË KRYE TË PUNËVE

Shënime

3 shkurt 1975

Nga leximi i një protokolli të aktivitetit të kërkimeve të naftës e të gazit<sup>1</sup> dhe nga bisedat që kam bërë me disa shokë për mosrealizimet që janë krijuar në këtë sektor, dëshiroj të ngre disa probleme shumë serioze e të mprehta që dalin lidhur me këtë çështje.

Kongresi i 6-të i Partisë, siç dihet, ka shtruar detyrën që, krahas intensifikimit të mëtejshëm të nxjerrjes së naftës nga vendburimet ekzistuese, të siguroheshin vendburime të reja për naftë dhe gaz, duke e përqendruar shumë vëmendjen në shpim-kërkimet dhe në punimet gjeofizike, me qëllim që të arriheshin e të tejkaloheshin rezervat e llogaritura. Zbatimi i kësaj detyre shumë të rëndësishme që vuri Kongresi i Partisë, do të sillte plotësimin e detyrave të këtij plani pesëvje-

---

1. Është fjala për aktivitetin që u zhvillua në muajin nëntor 1974.

çar dhe do të shërbente në të njëjtën kohë për të fuqizuar më tej bazën e lëndëve djegëse në pesëvjeçarët e ardhshëm.

Kjo detyrë që vuri Kongresi, si të gjitha detyrat e tjera, ishte plotësisht e realizueshme, sepse mbështetej në aftësitë naftëmbajtëse tashmë të provuara të nëntokës sonë, në një bazë të fuqishme materiale dhe teknike të krijuar në këtë sektor të industrisë, në investimet e mëdha, në ngritjen në një nivel më të lartë cilësor të punimeve të kërkimit për naftë e gaz dhe sidomos të strukturave që do të përbënin objektet e shpimit, si dhe në përgatitjen e kuadrove të rinj, në punën e ndërgjegjshme vetëmohuese dhe në eksperiencën shumëvjeçare të kuadrove e të të gjithë punonjësve të tjerë të këtij sektori.

Pasi vuri këto detyra reale dhe mobilizuese në sektorin e naftës e të gazit, Partia kërkoi nga naftëtarët, teknikët, inxhinierët dhe kuadrot drejtues të naftës, që të përqendronin vëmendjen në organizimin dhe në vendosjen e një disipline të rreptë shkencore e teknike në punë, të përvetësonin e të praktikonin metoda më të përparuara në kërkimin e naftës e të gazit, të rritnin më tej kualifikimin e tyre dhe të përdornin me efektivitet sa më të madh mjetet e shumta që u qenë dhënë e do t'u jepeshin për përdorim.

Instituti i Naftës, i cili duhej të drejtonte punën studiuuese e shkencore për zbulimin e rezervave të reja të naftës dhe të gazit, siç jemi në dijeni, nuk e ka kryer detyrën e ngarkuar. Gjatë katër vjetëve të këtij pesëvjeçari ai nuk ka arritur rezultate.

Situata e krijuar në zbulimin e rezervave të reja të naftës e të gazit është tepër e rëndë. Nga mosrealizimet në ekonominë tonë, më kryesori është ai i naftës, nga i cili na krijojnë çrregullime shumë të mëdha. Kjo gjendje na ka krijuar vështirësi për arritjen e objektivave të caktuar për nxjerrjen e naftës edhe gjatë viteve të pesëvjeçarit të ardhshëm. Është e tepërt të flasim për rëndësinë jetike që ka nafta, veçanërisht për vendin tonë. Ajo është bërë sot një problem botëror dhe për të mund të pëlçasë edhe luftë e përgjithshme. Shtetet imperialiste kanë bërë luftëra për të zotëruar pellgjet e pasura me këtë lëndë të parë strategjike. «Mos e prek zonën e naftës, — e paralajmëroi njëherë Anton Ideni<sup>1</sup> Hrushovin, — ndryshe pëlçet luftë që nesër». Dhe, në fakt, sot po zhvillohet një luftë e ashpër ndërimperiale për këtë qëllim. Mosplotësimi i detyrave për rezervat e naftës dhe të gazit në vendin tonë në kushtet e solme të acarimit të krizës energjetike botërore dhe të ashpërsimit të luftës së klasave në shkallë ndërkombëtare, do të thotë ngadalësim i ritmeve të zhvillimit të shpejtë dhe intensiv të ekonomisë popullore, dobësim i armës së mprehtë të naftës, që shërben si një nga lëndët e para nga më të rëndësishmet për zhvillimin e pavarur politik dhe ekonomik. Ne duhet të jemi vigjilentë në këtë çështje, se armiku në dy drejtime të rëndësishme sulmon: në radhë të parë, ai synon të godasë Partinë dhe pastaj ushtrinë dhe ekonominë tonë e mbi të gjithë sektorët e tillë si naftën, pra:

---

1. Ish-kryeministër i Anglisë.

ndaj në këto drejtime ne duhet të ecim me shumë kujdes.

Partia dhe Qeveria, duke studiuar gjendjen aktuale, do të përcaktojnë, sigurisht, edhe rrugët më të përshatshme për ndreqjen e saj, por, para se të bëjnë këtë, duhet të njihet mirë gjendja e vërtetë e gjërave në industrinë e naftës e të gazit. Lidhur me këtë situatë dëshiroj të shpreh tani mendimet e mia të formuara sidomos nga leximi i protokollit të mbajtur në nëntor të vitit të kaluar në aktivin e kërkimeve të naftës e të gazit.

Mendoj se drejtuesit e Institutit të Naftës, të Drejtorisë së Përgjithshme të Naftës e deri disa kuadro të Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave nuk i kanë trajtuar politikisht këto probleme shqetësuese, ata nuk janë udhëhequr nga detyrat e Kongresit të 6-të të Partisë, nga materialet e Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror të Partisë dhe nga direktivat e herëpashershme të Byrosë Politike për naftën. Drejtuesit e Institutit të Naftës dhe ata të Drejtorisë së Përgjithshme të Naftës i kanë zënë në gojë detyrat e vëna nga forumet e Partisë, bile ata me fjalë edhe kanë përmendur se «vëmë politikën në plan të parë», por në praktikë s'kanë vepruar kështu. Ndryshe, nuk kanë si shpjegohen qoftë edhe ato gabime e faje të pranuar nga ata vetë, një pjesë të të cilave do t'i përmend më poshtë. Të përpiqesh për të justifikuar të metat, apo për t'i fshehur këto të meta, siç është vepruar nga ndonjë kuadër në aktivin e kërkimeve të naftës e të gazit, kjo, në mos më keq, do të thotë ta vësh politikën në plan të fundit.

Partia na mëson se mbështetja fort te masat është faktori kryesor për t'i bërë ballë bllokadës imperialisto-revizioniste dhe për të realizuar me sukses planet ekonomike. Por në Institutin e Naftës dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Naftës e kanë shkelur në mënyrë flagrante parimin e rëndësishëm të zbatimit të vijës së masave. Atje nuk është marrë jo vetëm mendimi i punëtorëve dhe i teknikëve, por as ai i gjeologëve, sepse edhe për problemet e diskutueshme kanë vendosur vetëm «papët e naftës», të cilët janë treguar «të padurueshëm» për t'i shtruar mirë problemet, për të rrahur dhe për të sheshuar drejt mendimet e kundërta që të interpretohen shkencërisht materialet faktike, që të caktohen me arsye e jo arbitrarisht pikat e shpimit etj.

Duke iu përgjigjur pyetjeve që i janë bërë në aktiv për mosrealizimet e vërtetuara, drejtori i Institutit të Naftës, Beqir Aliaj, ndër të tjera, ka thënë: «Unë, Protoko Murati dhe Koço Plaku<sup>1</sup>. . . duhet të jemi të durueshëm në dëgjimin e diskutimeve të të tjerëve», kurse Koço Plaku ka pranuar që «Më shpesh në debat jam futur vetë, pa tërhequr kolektivin, masën e punonjësve». Doemos nuk mund të tërhiqej mendimi i kolektivit për sa kohë që Protoko Murati, Koço Plaku, Beqir Aliaj e të tjerë kishin qëllimet e tyre dhe u pëlqente më shumë të dëgjonin frazat bombastike të ndonjë inxhinieri, që pro-

---

1. Beqir Aliaj, Protoko Murati e Koço Plaku për veprimtari antiparti e për sabotim në sektorin e naftës morën dënimin e merituar nga gjyqi i popullit.

jektonte puse jashtë strukturës, sesa mendimin krijues të naftëtarëve.

Po përse të ndodhë kështu atje? Nuk e dinin kuadrot, të cilëve u është besuar të drejtojnë sektorin e naftës, se në dobi të punës duhej të tërhiqnin edhe mendimin e gjeologëve dhe të naftëtarëve? S'ka njeri në Shqipëri që të mos dijë se zbatimi i vijës së masave qëndron në themel të politikës së Partisë sonë, pra këtë e dinë edhe këta, por, me sa duket, vija e masave atyre nuk u ka ardhur për hosh. Është interesante të dihet që, para se të mblidhej aktivi, raporti që mbajti në të drejtori i institutit i qe shtruar një konsultimi të gjerë me pjesën më të madhe të gjeologëve të naftës, të cilët analizuan dobësitë e punës dhe dhanë mendimet e tyre për kapërcimin e pengesave, mirëpo drejtori nuk i mori parasysh ato, shtoi vetëm ndonjë gjë të vogël dhe perifranoi ato mendime që kishte në kokën e vet. Sa larg është qëndrimi i tij dhe i shokëve që e ndjekin në këto veprime, nga mësimi i madh i Partisë, sipas të cilit: kuadrot të mësojnë masat dhe të mësojnë prej tyre, duke qenë njëkohësisht edhe mësues të urtë, edhe nxënës të zellshëm!

Në Institutin e Naftës nuk është përfillur eksperiencia e gjeologëve dhe e masës së naftëtarëve, sepse atje kanë penguar fort shfaqje të tilla të sëmura, si: intelektualizmi, teknokratizmi, burokratizmi, arroganca dhe prepotenca e drejtuesve. Organizata e Partisë në sektorin e naftës, si duket, nuk i ka kuptuar këto rreziqe.

Më ka bërë përshtypje të keqe diskutimi që mbajti

në aktiv njëfarë Milto Gjipopulli<sup>1</sup>, i cili, në vend që të nxjerrë shkaqet e dobësive dhe të bëjë autokritikë për gabimet e tij shumë të mëdha në punë, «ka filozofuar» me fraza pompoze e libreske, duke përmendur se «e veçanta dhe e përgjithshmeja janë relative», se «thelbi nuk është tamam shfaqje», se «strategjia e kërkimeve ka qenë e drejtë, kurse taktika e gabuar» etj. Diskutimi i këtij «filozofi» e «strategu», që bashkë me shokët e tij i kanë vënë kazmën perspektivës së naftës, ishte i turbullt dhe i errët. Për mua qëllimi i tij nuk duket aspak i ndershëm. M'u krijua përshtypja se ky llafazan, në qoftë se nuk gabohem, u përngjet atyre «specialistëve» sabotues sovjetikë që na shpreheshin me fjalë të mëdha «filozofike», por nga ana tjetër donin të na nxirrnin sytë.

Prepotenca e drejtuesve të naftës arrin deri atje sa, kur ndonjëri mban qëndrim kritik ndaj punës së tyre, këta të qepen dhe të ndjekin si inkuizitorët. Në një rast ishte arritur deri atje sa Koço Plaku kishte urdhëruar: «Të digjet raporti në zjarr!». Ja, gjer ku kishte arritur prepotenca e këtij njeriu, i cili, po të kishte mundësi, jo vetëm letrat, por edhe njerëzit do t'i hidhte në zjarr. Ai nuk u përgjigjet as pyetjeve që i bëhen në aktiv për gjendjen e krijuar, por kërkon të na hedhë hi syve, duke thënë se gjoja e paskësh ndër-gjegjen të vrarë për dështimet që kanë shkaktuar! As

---

1. Siç u vërtetua më vonë, Milto Gjipopulli zhvillonte veprimtari armiqësore për të sabotuar në sektorin e naftës, prandaj u dënua nga gjyqi i popullit.

Beqir Aliaj nuk u ishte përgjigjur të gjitha pyetjeve që i qenë adresuar. Edhe atyre pak pyetjeve që denjoi t'u përgjigjej, u kishte kaluar anash, duke mos folur për perspektivat e zbulimit të vendburimeve të naftës.

Në organizatën e Partisë të institutit dominojnë intelektualë: gjeologë, inxhinierë dhe disa teknikë. Këta intelektualë vërtet janë anëtarë partie, por në karakteristikat e shumë prej tyre nuk do të lexosh fjalët: masovik, popullor etj., që janë tipare sidomos të komunistëve, por «arrogant», «prepotent». Më e keqja është se këta veprojnë kështu, duke e quajtur veten kuadro të Partisë. Këta me fjalë thonë: «Jemi të Partisë», por me konceptet që ruajnë dhe me punët që kanë bërë s'janë të tillë.

Në Institutin e Naftës ka rënë shumë disiplina teknike, shkencore dhe ajo shtetërore në punë. Megjithëse Kongresi i 6-të i Partisë në mënyrë të veçantë i ka vënë theksin nevojës së forcimit të kësaj disipline edhe për nxjerrjen e naftës dhe të gazit, kjo jo vetëm nuk është forcuar, por, në të kundërtën, është dobësuar, bile në një shkallë të dënueshme. Është praktikuar bredhja pa asnjë justifikim, pa farë përgjegjësie nga një strukturë në tjetrën, braktisja e një sheshi dhe fillimi i një tjetri, pa i çuar gjer në fund detyrat e kërkimit, si, bie fjala, në Shkodër, Tiranë, Berat, Elbasan etj. Është vonuar studimi i shpejtë i strukturës në Skrapar e gjetkë, duke u lejuar hallakatja nga një profil në tjetrin. Është shumë e çuditshme se për ç'arsye është lejuar dhe kush e ka rekomanduar një praktikë të tillë pune.

Metodika më e saktë dhe më shkencore e kërkimit



në naftë, siç mendohet, është sqarimi gradual i problemeve nga e njohura tek e panjohura, nga marrja e rezultateve të puseve në analizën e tyre dhe në kalimin pastaj në puse të tjera, duke ndjekur plotësimin e profileve shkallë-shkallë e një nga një, gjë që e ka kundërshtuar pa të drejtë Protoko Murati, që nuk i duron mendimet e kundërta, veçanërisht kur ato hedhin dritë mbi fajet e tij.

Duke filluar një punë, pa mbaruar një tjetër, sikundër përmenda, është vonuar sqarimi i strukturës, është krijuar në radhët e punonjësve të naftës një gjendje paniku, mosbesimi dhe pasigurie, situatë jashtëzakonisht e rrezikshme kjo dhe si e tillë e dënueshme rreptësisht nga Partia.

Nuk janë nxjerrë kudo në pah ligjësitë e përbashkëta të strukturave brenda brezit dhe ligjësitë e ndryshimit të fenomeneve gjeologjike nga një vend në tjetrin. Nuk ka pasur studime komplekse për sheshet dhe për strukturat që do të atakoheshin, ka munguar puna këmbëngulëse shkencore në të gjitha pjesët e saj përbërëse, si dhe bashkërendimi i drejtë i punimeve rilevuese gjeologjike, i punimeve gjeofizike dhe i atyre tematike. Për shpimin e puseve nuk janë nisur nga analizat shkencore objektive, por nga ide të paraformuara e të dyshimta. Këto qëndrime sabotuese kanë sjellë si pasojë derdhjen si lumë dhe pa efektivitet të fondeve monetare e materiale të shtetit.

Duke dashur të justifikojë disi qëndrimin e tij e të drejtuesve të tjerë të Institutit të Naftës ndaj kërkesave të disiplinës teknike e shkencore në punë, Protoko Mu-

rati ka thënë në aktiv sikur ata paskan përmirësime në punë, paskan kapur me precizion fenomene të rëndësishme gjeologjike, që kanë çuar në rritjen e shkallës së njohjes së ndërtimit gjeologjik, por cilësia e punimeve nuk është në nivelin e duhur. Ky person, të cilit Partia i ka besuar detyrën e shefit të gjeologjisë në institut, nuk thotë asgjë përse s'punohet me cilësi. Cila është arsyeja që në pesëvjeçarin e kaluar, kur ata kishin më pak eksperiencë dhe mjete, u zbuluan tri vendburime naftë, ndërsa këta katër vjetët e fundit është zbuluar vetëm një, që edhe ky rezultoi me rezerva naftë shumë të kufizuara? Çfarë thonë për këtë fakt Beqir Aliaj dhe Lipe Nashi, i pari drejtor i Institutit të Naftës dhe i dyti drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Naftës? Ç'kanë bërë këta gjatë gjithë kësaj kohe?

Të meta dhe dobësi serioze vërshen në organizimin dhe në drejtimin shkencor të punëve nga organizmat drejtues të sektorit të naftës, atje nuk është mbajtur përgjegjësi dhe nuk është ushtruar kontrolli i duhur për plotësimin e detyrave të planit. Ndaj problemeve të ndërlikuara që ngrinte zbulimi i rezervave të reja të naftës dhe të gazit, drejtuesit e këtij sektori janë kënaqur me konstatime, vetëm me konstatime, pa u qederosur që të nxjerrin shkaqet e vërteta të mosrealizimeve.

Kur u mblodhën në aktivin e kërkimeve të naftës e të gazit, disa shokë me të drejtë kritikuan raportin e mbajtur, duke arsyetuar se ai «ka më tepër karakter konstatues», se në të «nuk nxirren shkaqet kryesore të mosukseseve, duke i paraqitur dështimet si të rastit».

Në vend që të përcaktonin masat konkrete dhe efektive që shpimet e kërkimet të qëllojnë në shkallën e duhur strukturat naftëgazmbajtëse, drejtuesit e Institutit të Naftës justifikohen me vështirësitë e ndërtimit gjyologjik, pa i tërhequr vëmendjen vetes se këto vështirësi kapërcehen me rritjen e shkallës së njohurive, me thellimin e studimeve përgjithësuese dhe me një punë të organizuar mirë.

Kur u krijua Instituti i Naftës, ishte e nevojshme ndarja e specialistëve në zona të ndryshme, në breza, po kur specialistët u shtuan shumë, kjo ndarje frenoi iniciativën e ndërmarrjeve që janë të shpërndara. Grupimi i specialistëve në breza i kufizoi njohuritë e tyre, sepse brezi i një rrethi, për shembull, nuk e njeh atë të një rrethi tjetër. Me mungesën e kësaj njohjeje specialisti i një brezi e ka të vështirë të japë mendime të vlefshme për projektet e brezit tjetër, sepse e njeh pak. Kjo vërejtje është bërë nga specialistët, por nuk është përfillur nga drejtoria e institutit. Meqenëse nuk është marrë parasysh më parë, le të shikohet kjo si një çështje që ka të bëjë me organizimin e mirë të punës paskëta.

Shumë herë ishte folur për një analizë të rëndësishme përgjithësuese të punimeve të kërkimit për naftë e gaz gjatë 12 vjetëve, por ky studim, si dhe disa të tjera, është zvarritur për vite me radhë. Këtë neglizhencë të pafalshme Beqir Aliaj e «ka justifikuar» në aktiv me disa fjalë, duke thënë: «Unë kam përgjegjësi të madhe për moskryerjen me kohë të këtij studimi, mbasi puna e përditshme nuk më ka lejuar të kontrolloj

sa dhe si duhet». Nuk paska pasur kohë shoku drejtor të kontrollonte punën për këtë studim tepër të rëndësishëm, sepse e paskan penguar punët e ditës! Arsyetim prej kuadri është ky?

Grupi tematik ka punuar disa «tema» që nuk janë nxjerrë nga analiza të thella teknike e, megjithëkëtë, nuk është ngarkuar më asnjëri që t'i ripunojë. Me sa duket punimet bëheshin sa për të realizuar planin e temave, po jo planin ekonomik të shtetit!

Në këshillin shkencor të institutit kanë kaluar shpesh materiale të papërgatitura, pa cilësitë e nevojshme dhe me shumë dyshime rreth vërtetësisë së tyre shkencore etj. Këtë fakt e kanë pranuar të tërë drejtuesit e naftës. «Të metat tona të kësaj natyre, — ka thënë Koço Plaku, — i kanë kushtuar shumë shtrenjtë ekonomisë popullore» dhe më pas ka shtuar: «Kjo nuk do të thotë se duhet të biem moralisht». Çudi! Pasi ka bërë tërë këto të zeza, që u detyrua t'i pohonte me gojën e tij, ky njeri (të mos harrojmë se është vëllai i Panajot Plakut dhe ka sabotuar sistematikisht) i jep kurajë vetes, duke thënë: «Do të përmirësoj punën që të korr rezultate në të ardhmen». Koço Plaku ka bërë edhe disa propozime në aktiv, por jam i mendimit që këto «propozime», që bëjnë njerëz të tillë të dyshimtë, e kemi për detyrë t'i rishikojmë me kujdesin më të madh e jo qorrazi. Për të sheqerosur të metat që shihen açik, Koço Plaku i bie gjoksit, duke i atribuar vetes meritat: «Ne thyem bllokadën e koordinuar revizionisto-imperialiste etj. dhe zbuluam rezerva të reja nafte atje ku të huajt i mohonin... , ne kemi eksperiencë të madhe

në kërkimet, kemi përgatitje të mirë teknike» etj. Bravo! Po kur është kështu, përse nuk janë bërë hapa përpara?! Atëherë cila është arsyeja e mosrealizimeve? Në përgjigje të kësaj pyetjeje të vështirë Protoko Murati, Koço Plaku, Beqir Aliaj e ndonjë tjetër kanë thënë në aktivin e kërkimeve të naftës e të gazit se «Na ka munguar metoda dhe stili i përshtatshëm në punë». Duke lexuar këto fjalë në protokoll, menjëherë më vajt mendja tek armiqtë e betuar të Partisë sonë, si: Beqir Balluku, Petrit Dumja, Hito Çakoja e kompani, të cilët, për të mbuluar tradhtinë e tyre, donin të fshiheshin pas «metodës e stilit të punës»!

Të gjithë drejtuesit e naftës kanë thënë se nuk janë marrë me punët që u janë ngarkuar, por me çështje anësore, administrative! Përse vallë të ketë ndodhur kështu, kur këta e dinë fort mirë se Partia u ka besuar detyra shumë të rëndësishme drejtuese, që kanë të bëjnë me të tashmen dhe me perspektivën e nxjerrjes së naftës në vendin tonë? Vallë vetëm me «administratomaninë» e tyre të shpjegohet kjo shmangie e rëndë nga detyrat?

Këta, kur flasin për zbulimin e vendburimeve të naftës e të gazit, në vend që të bëjnë analizë të sinqertë në raport se për ç'arsye kanë dështuar, merren me teorizime të tilla, si, bie fjala, «Për brezin e Krujës s'kemi problem objektin, por fluidin; për brezin e Beratit kemi objektin problem; kurse për brezin e Kurveleshit është problem objekti dhe fluidi». Ç'teorira! «Objekt-fluid, fluid-objekt»!

Ka munguar kërkesa e llogarisë nga lart dhe nuk

është inkurajuar kritika nga poshtë. Edhe kur janë bërë kritika nga naftëtarët, teknikët ose inxhinierët, këto nuk janë pritur mirë. Drejtuesit as që kanë çarë kokën për kritikën që u janë bërë, se ishin «vetë zot e vetë shkop». Ata kanë vepruar si në mall të babës dhe bënin ç'u pëlqente. Për katër-pesë vjet vazhduan dështimet në naftë dhe jo vetëm drejtuesit e institutit, por as drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Naftës, Lipe Nashi, as Ministria e Industrisë dhe e Minierave nuk kërkuan hesap pse vazhdon kjo situatë, cilat janë shkaqet, cilët janë fajtorët, ç'thonë komunistët e naftëtarët për këtë gjendje. «Ne jemi pajtuar shumë me dështimet e njëpasnjëshme që kemi pasur», pohon Koço Plaku. «Për këtë situatë kemi përgjegjësi», shtojnë Protoko Murati e Beqir Aliaj. Dhe kujtuan se me kaq çështja do të vulosej, duke menduar se Partia do të lejojë të vazhdohet me të njëjtën gjendje, në të njëjtin gjumë.

Në vend që t'ua shtronte për diskutim kritik gjeologëve, teknikëve e punëtorëve situatën e rëndë të krijuar, Lipe Nashi, kuptohet qartë, për të mbytur kritikën e vartësve, i thotë njërit prej tyre, që ishte duke diskutuar: «Ti shumë po kritikon, por gabimet e tua nuk i shikon?». Aspak marksist nuk është ky qëndrim i Lipe Nashit ndaj kritikës. Çdo njeri mund të gabojë në punë e sipër, por kjo askujt nuk ia heq të drejtën e kritikës.

Edhe për Koço Theodhosin mund të themi se, kur shkante për të parë gjendjen e krijuar në nxjerrjen e naftës dhe të gazit, ai bisedonte edhe me ndonjë tjetër, por vetëm mendimet e drejtorit të përgjithshëm merre

parasysh, se ato i dukeshin kurdoherë më të drejtat, megjithëse dështimet vazhdonin njëri pas tjetrit për vite me radhë. Disa herë e kemi porositur Koço Theodhosin në mbledhjet e Byrosë Politike që të ketë kujdes për ta pasur në dorë industrinë e naftës, por, si tregojnë punët, ai nuk ka vepruar sipas këtyre porosive, sepse perspektivat e naftës i ka lënë vetëm në dorën e institutit e të drejtorisë, sikundër përmenda edhe në mbledhjen e Byrosë Politike të dhjetorit të vitit të kaluar<sup>1</sup>. Në mbledhjen e aktivitetit të kërkimeve të naftës e të gazit, Koço Theodhosi e ka quajtur «bombë» kritikën që ka bërë për drejtuesit e sektorit të naftës, por ajo nuk ishte aspak e tillë, përkundrazi, mua m'u duk mjaft e butë.

Në kuadrot drejtues të sektorit të naftës, midis të tjerash, kanë lulëzuar edhe tekat e sëmura. Kështu, gjatë analizave të mosrealizimeve në shkallë instituti, disa shokë të kabinetit gjeofizik janë përpjekur të justifikohen pa arsye dhe, çka është akoma më e neveritshme, në disa raste kanë synuar t'ua hedhin përgjegjësinë të tjerëve e veçanërisht kabinetit të përgjithësimeve. Ky veprim hileqar i këtyre kuadrove është shumë larg nga ato qëndrime të ndershme e burrërore, që karakterizojnë punonjësit tanë të edukuar nga Partia. Këto shfaqje, si dhe disa të tjera, që kanë dalë në diskutime, duhet të na tërheqin vëmendjen seriozisht, se në sektorin e naftës po na infektohen kuadro nga sëmundje të rrezikshme, prandaj lypset që atje të vërë dorë sa më parë Partia.

---

1. Shih në këtë vëllim f. 63.

Në fund të punimeve të aktivitetit ka thënë nja dy fjalë edhe drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Naftës, i cili nuk u lodh shumë kur përmendi se të metat e problemit «do t'i shohim më drejt». Ai nuk harroi të deklarojë: «Garantoj Partinë dhe shokun Enver për nxjerrjen e naftës», sikur me këtë që bëri ai do ta vinte Partinë në gjumë.

Është për të ardhur keq, se për gjithë këtë situatë të rëndë nuk na ka vënë në dijeni as sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Fierit, as sekretari i këtij komiteti, që merret atje me çështjet e naftës. Edhe shokët anëtarë të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë, që punojnë në sektorin e naftës, nuk janë treguar në lartësinë e detyrave për kuptimin me kohë të gjendjes dhe të sinjalizonin Komitetin Qendror që të merreshin sa më parë masat e nevojshme.

Këto ishin disa përfundime ku kam arritur unë për gjendjen në sektorin e naftës. Për përcaktimin e mëtejshëm të dobësive, të të metave dhe të fajeve nga drejtuesit e sektorit të naftës, si dhe për masat që duhen marrë për shëndoshjen e gjendjes, të tërheqim sa më gjerë mendimin e naftëtarëve. Organizata e Partisë e sektorit të naftës të kuptojë mirë përgjegjësitë që ka dhe të vihet në krye të punëve. Para së gjithash, sipas mendimit tim, do të na duhet të shikojmë problemin e kuadrit në organizmat drejtues të sektorit të naftës. Në këtë drejtim të vrasim mendjen shumë. Të përmbysim situatën e krijuar dhe të ndihmojmë për eliminimin sa më parë të disa të metave që përmenda, si dhe të të tje-



rave që do të vërtetohen. Pastaj të shikojmë edhe disa anë të organizimit të drejtimit të sektorit të naftës dhe të vetë institutit, i cili mendoj se duhet të merret vetëm me studimet për zbulimin e vendburimeve të naftës dhe të gazit.

*Botuar për herë të parë, me disa shkurtime, në librin: Enver Hoxha, «Gjithmonë vigjilencë» (Për organet e Punëve të Brendshme), vëll. i 2-të, f. 352*

*Botohet i plotë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **TË DHËNA SHQETËSUESE, QË TË BËJNË TË MENDOSH SE NË NAFTË KA PUNË ARMIQËSORE**

*Bisedë me shokun Paskal Sinani*

**4 shkurt 1975**

*Pasi mori një letër nga një teknik shpimi i Ndërmarrjes së Shpim-Shfrytëzimit të Naftës në Patos, i cili i shkruante për punën pa përgjegjësi që bëhej veçanërisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Naftës dhe në Institutin e Naftës; meqenëse kishte dyshuar shumë për punën shkel e shko që bëhej atje, si dhe për punë armiqësore të fshelur nën maskën e arrogancës, të prepotencës, të zotësisë teknike etj., shoku Enver Hoxha thirri për disa shpjegime shokun Paskal Sinani, në atë kohë kandidat i Komitetit Qendror të Partisë dhe drejtor i Ndërmarrjes së Shpim-Kërkimit të Naftës e të Gazit në Sarandë.*

*Në takim mori pjesë edhe shoku Haki Toska, në atë kohë anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i KQ të PPSH.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si jeni me shëndet, shoku Paskal? Sot në mëngjes erdhët nga Saranda?

**SHOKU PASKAL SINANI:** Jo, shoku Enver, qysh prej dy javësh unë jam në Shkollën e Partisë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shumë mirë paske bërë që vazhdoke Shkollën e Partisë.

Të thirra, shoku Paskal, për të biseduar me ty, veç të tjerash, edhe për gjendjen e vendburimeve të naftës në Sarandë. Ti drejton në atë rreth Ndërmarrjen e re të Shpim-Kërkimit të Naftës e të Gazit, e cila në fillim na dha shpresa të mira. Porsa u zbulua kjo fushë naftëmbajtëse, erdhën e na dhanë sihariqin: «Na doli naftë!». Mirëpo më vonë shpresat u venitën dhe, të them të drejtën, tani nuk e kemi hiç të qartë situatën atje. Dimë që ka dalë gaz, po edhe ky nuk po shfrytëzohet akoma. Një mendim të saktë për punimet në këtë zonë, për rezultatet e arritura, për organizimin e punës dhe për perspektivën nuk kemi. Të paktën unë personalisht nuk kam. Prandaj, me sa është e mundur, dëshiroj, shoku Paskal, të më sqarosh lidhur me këto çështje, duke pasur parasysh kurdoherë konkluzionet e Plenumit të kohëve të fundit të Komitetit Qendror të Partisë<sup>1</sup> për sa u përket interpretimit të fakteve dhe qëndrimeve që mbahen nga njerëzit në sektorin e naftës.

Më fol hapur, shoku Paskal, ç'mendon ti për gjendjen në sektorin e naftës. Është punuar mirë atje apo keq? Çfarë ka shkuar mirë e çfarë ka shkuar keq? Janë vërtetuar gabime në kërkim, në shpim e në shfrytëzim

---

1. Është fjala për Plenumin e 6-të të KQ të PPSH që u mbledh më 16 dhe 17 dhjetor 1974, ku u shqyrtua zbatimi i detyrave që vendosi Plenumi i 5-të i KQ të PPSH për forcimin e punës në ushtri.

apo jo? Kanë vepruar sipas orientimeve të Partisë Ministria e Industrisë dhe e Minierave, Drejtoria e Përgjithshme e Naftës dhe Instituti i Naftës në këto drejtime? Ty, natyrisht, të është përplasur një grumbull i madh provash në Sarandë, përballë të cilit ke pasur mendimet e tua, kurse ata më lart të tyret. Dua të di: Çfarë mendimi ke pasur dhe ke për këto ti, si kandidat i Komitetit Qendror? Mund të na thuash gjë në këtë drejtim? Nuk është nevoja të ngrihesh në këmbë për të folur, nuk është nevoja, gjithashtu, të na bombardosh me fjalë boshe, se nuk i dëshiroj frazat e ujditura bukur e pa bukë, por kërkoj mendimin tënd sa më të saktë për të gjitha problemet që përmenda.

*Në përgjigje të këtyre pyetjeve, shoku Paskal Sinani dha disa shpjegime, duke shtuar në fund se atë dhe shokë të tjerë të sektorit të naftës i vret ndërgjegjja që nuk i kanë justifikuar me rezultate të mira në prodhim shpenzimet e mëdha që janë bërë.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po pse ju vret ndërgjegjja?

**SHOKU PASKAL SINANI:** Sepse, siç thashë, nuk kemi pasur ato rezultate që pritnim, nuk kemi zbuluar sasinë e planifikuar të naftës, por vetëm një vendburim gazi.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kush jua pati dhënë këtë plan?

**SHOKU PASKAL SINANI:** Drejtoria e Përgjithshme e Naftës dhe Instituti i Naftës.

**SHOKU ENVER HOXHA:** E kishin mbështetur

shkencërisht ata studimin që kishin bërë? Si argumentoj ekzistenca e naftës në këtë fushë?

*SHOKU PASKAL SINANI:* Studimet e tyre më duket se nuk janë të bazuara.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Pikërisht në këtë konkluzion dal edhe unë, që këto studime nuk janë të bazuara.

Sikur të të thonë tani të shkosh në Mal të Gjerë, se atje duhet të ketë rezerva për 8 milionë tonë naftë, do ta hash ti këtë? Sigurisht që jo, pse për një gjë të tillë më parë duhen bërë studime shkencore. Prandaj edhe të pyeta nëse rezervat e naftës në Sarandë ishin të bazuara apo jo.

Përpara se të niseshe ti për të punuar në këtë ndërmarrje të Sarandës, të vunë në dijeni drejtuesit e drejtorisë dhe të institutit se si ishte gjendja atje dhe për objektivat që do të arriheshin? Kush ishte ai që të shoqëroi?

*SHOKU PASKAL SINANI:* Më çoi drejtori i përgjithshëm, Lipe Nashi.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Çfarë të tha ai me këtë rast? I shtroi hartat me ty që të të tregonte se ç' rezultate janë arritur, çfarë vërtetonin të dhënat sizmike, ç'rëndësi të madhe kishte kjo punë për atdheun tonë etj.? T'u bënë ty këto shpjegime?

*SHOKU PASKAL SINANI:* Jo, shoku Enver.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Domethënë, ata të njofuan vetëm për këtë, që Partia dhe Qeveria të kanë emëruar drejtor në këtë vend dhe kaq. Sa sonda dërguan atje?

*SHOKU PASKAL SINANI:* U dërguan fillimisht pesë sonda.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ndërmarrja që drejtoni ju, ka gjeologë?

*SHOKU PASKAL SINANI:* Po, ka inxhinierë e gjeologë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kanë marrë pjesë në studimin e këtij vendburimi këta inxhinierë e gjeologë dhe ishin të një mendimi me drejtorinë dhe me institutin?

*SHOKU PASKAL SINANI:* Jo, ata kishin mendime të kundërta. Edhe unë vetë kisha mendim të kundërt.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ti ose ndonjë tjetër nga shokët e Sarandës ishit në mbledhjen e Qeverisë ku u analizua çështja e naftës?

*SHOKU PASKAL SINANI:* Jo, asnjë nga ne nuk ishte.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Si i shpjegon ti këto çështje, shoku Paskal? Si mendon, e kanë kryer si duhet detyrën që u takon shokët e institutit? Nuk e kam fjalën këtu vetëm për zonën e Sarandës, por në tërësi.

*SHOKU PASKAL SINANI:* Jo, mendoj se ata nuk e kanë kryer detyrën e tyre.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Byroja Politike ka orientuar qartë se është e domosdoshme që, pa harruar perspektivën, të shfrytëzohen më shumë vendburimet ekzistuese. Ne kemi një sërë vendburimesh të njohura, prandaj rreth këtyre duhet të kërkojmë. Të shikojmë më parë konturet këtu; të dalim edhe jashtë këtyre

kontureve, pastaj mund të shkojmë në ndonjë vend tjetër, pse kjo do të shërbejë për zbulimin e fushave të reja naftëmbajtëse që kërkon Partia. Por, siç duket, nga ana e shokëve të sektorit të naftës nuk janë marrë me seriozitetin më të madh vendimet dhe orientimet e Partisë për këto çështje.

Gjeologjia i jep të dhënat për strukturën e tokës, se ku duhen bërë shpimet etj.

**SHOKU PASKAL SINANI:** Po, të gjitha i jep gjeologjia në bazë të interpretimeve që bëhen nga rilievimet, sizmika dhe analizat paleontologjike, që përcaktojnë moshën e tokave etj.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mund të më thuash, ka kontradikta në mes gjeologëve të këtyre sektorëve?

**SHOKU PASKAL SINANI:** Ka pasur kontradikta nga më të ndryshmet. Këto kontradikta nxorën krye edhe në konsultën që u bë kohët e fundit<sup>1</sup>, ku ishin dhe Abdyl Këllezi e Koço Theodhosi.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po Ministria e Industrisë dhe e Minierave çfarë roli luan në sektorin e naftës?

**SHOKU PASKAL SINANI:** Ministria nuk luan asnjë rol, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Naftës po.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kur vjen atje ministri, takohet edhe me ju, apo vetëm me Lipe Nashin? I kanë folur hapur punëtorët atij për gjendjen në sektorin e naftës?

**SHOKU PASKAL SINANI:** Punëtorët i kanë shpre-

---

1. Është fjala për aktivin e kërkimeve të naftës e të gazit.

hur hapur mendimet e tyre, por zërin tonë nuk para e dëgjon. Ministri bën çfarë i thotë drejtori i përgjithshëm.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po ju jeni kënaqur duke iu përgjigjur se kështu na thotë drejtorja dhe kështu duhet të veprojmë, apo i keni përkrahur mendimet e drejta të punëtorëve? Punëtorët atje nuk kanë pesë muaj në punë, po janë të vjetër, se kanë ardhur nga pusët e naftës. Çështja është sa dëgjoen punëtorët.

*SHOKU PASKAL SINANI:* Përpara se të caktoeshin pikat, drejtuesit e sektorit të naftës nuk i kanë dëgjuar punëtorët.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po me punëtorët si sillen drejtuesit, për shembull, drejtori i institutit, Beqir Aliaj?

*SHOKU PASKAL SINANI:* Ai nuk i pranon kollaj vërejtjet që i bëhen, i mbivlerëson shumë veten dhe mendjen e tij.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Çfarë del kur nuk vërtetohet në jetë ideja e tij, ose kur del e kundërta e asaj për të cilën ka ngulur këmbë ai? Kur ndodh kështu, nuk mund të themi gjithmonë se kjo është pasojë vetëm e konceptit të tij gjeologjik, por është me vend të pranojmë se, në të njëjtën kohë, janë edhe pakujdesia e madhe, mungesa e seriozitetit në studime, shfaqjet e megalomanisë në punë e në konceptet e tij shkencore dhe kjo megalomani ndikon shumë keq, nuk merr parasysh as të dhënat e sakta gjeologjike dhe as vërejtjet e studimet e shokëve. Prandaj të tjerët e kanë për detyrë t'i kërkojnë llogari.

Në formimin gjeologjik të globit dhe si rrjedhim



i transformimeve të mikroorganizmave që përbëjnë naftën, shumë gjëra janë arritur të vërtetohen me anën e shkencës, kurse disa të tjera nuk janë vërtetuar akoma. Siç dihet, shtresat e naftës nuk janë njëloj në botë, në të njëjtat struktura dhe në të njëjtat thellësi. Ato ndryshojnë, ashtu siç kanë ndryshuar, gjithashtu, gjatë epokave milionare, kontinente të tëra dhe ishuj të mëdhenj e të vegjël janë fundosur e të tjerë janë krijuar në epoka të ndryshme gjeologjike. Kështu ka ndodhur, për shembull, përpara më shumë se 20 shekujve edhe në vendin tonë që deti ishte afër Apolonisë, kurse tani është larguar me kilometra të tërë. Natyrisht, shokët gjeologë i dinë më mirë këto çështje, që unë i njoh në mënyrë të përciptë, por i këshilloj ata që kurrë të mos mendojnë se kanë arritur kulmin e diturisë. Prepotenca në një mendim ose në një teori çon në rrugë të gabuar. Kështu njëri mund të ketë të drejtë për atë që thotë, po edhe mund të mos ketë, prandaj, për ta vlerësuar mendimin e tij, lypset të rekomandohet diskutimi shkencor dhe ky të kontrollohet nga Partia. Që kjo punë të bëhet siç kërkohet, organizata e Partisë duhet t'i luftojë prepotencën dhe megalomaninë që mund të shfaqen në disa shokë.

Shkenca vërteton se gëlqerorët janë naftëmbajtës, mbi ta janë edhe ranorët, gjithashtu naftëmbajtës. E ç'të flas unë, more shoku Paskal, kur ju i dini mirë këto çështje? Teoria që përmenda, në përgjithësi është e vërtetuar. Por nuk përjashtohet që mendimet e dhëna të mos jenë kurdoherë të sakta, se, kuptohet, kemi të bëjmë me diçka që fshihet nën tokë, por në këtë drej-

tim ne duhet të na ndihmojnë edhe të dhënat e shkencës botërore.

Ka disa që, kur flasin, përdorin fraza të tilla, si: «Shkenca e veçantë e shqiptarëve»! Është e njohur se struktura e vendit tonë ka disa veçori, siç është thyeshmëria e terrenit etj., megjithëkëtë shkenca e naftës, që ka përparuar shumë në vendet e tjera, nuk është shqiptare. Në vendet e tjera, nga njëri në çdo tri puse që shpohen, marrin naftë, kurse këto vitet e fundit ne kemi arritur të hapim disa puse dhe s'kemi marrë naftë nga ndonjëri prej tyre. Mund të qëllojë që të hapim 4-5 puse e të mos gjejmë naftë, po ama jo kështu siç po ndodh, që hap puse e mos nxirr naftë. E di çfarë i thonë kësaj, shoku Paskal? Kësaj i thonë që kjo punë të na kushtojë «qimet e kokës» dhe naftë të mos zbulojmë. Tani, me gjendjen e krijuar, duhet të bëjmë dyfishin e shpenzimeve për të plotësuar detyrat, se kemi humbur edhe katër-pesë vjet kohë.

Kur shikohet që nuk po realizohet plani i naftës, secili duhet të mendojë: «Pse ndodh kështu?». Edhe Koço Theodhosi, që është ministër dhe anëtar i Byrosë Politike, edhe kuadrot e Drejtorisë së Përgjithshme të Naftës dhe të institutit, edhe ti, shoku Paskal, të kishit menduar që më parë, t'i vinit gishtin kokës dhe të thoshit: «More, po ç'po ndodh me naftën?». Në qoftë se ti shikoje që punët nuk venin mirë, duhej të vije këtu në Komitetin Qendror të Partisë dhe të na ngrije probleme me rëndësi. Po të mos veprohet kështu, ndodh pastaj si në ushtri dhe e keqja zhvillohet siç ngjet kur hiqet filli i çorapit.

Mosrealizimi i planit, format e punës që përdoren, organizimi jo i mirë, mungesa e kontrollit dhe e drejtimit nga baza etj. janë të dhëna shumë shqetësuese që të bëjnë të mendosh se në sektorin e naftës ka punë armiqësore. Të gjitha këto, të marra në tërësi, krijojnë atë terren të përshtatshëm që mund ta shfrytëzojnë elementët armiq për të minuar planet tona për naftën, prandaj Partia na këshillon që, kur diskutimet dhe vërejtjet e punonjësve të naftës ndeshen me ato të drejtuesve të institucioneve të naftës, si kudo, të bëhen ballafaqime e debate të rrepta në bazë. Dhe këto debate të mos jenë formale, prej tyre të nxirren edhe konkluzione. Dikush në sektorin e naftës mund të mos jetë dakord për një problem të rëndësishëm edhe me ministrin, me drejtorin e institutit. Këtu nuk ka asgjë kundër parimeve të pranuar prej nesh. Por, në një rast të tillë, Qeveria dhe Komiteti Qendror i Partisë duhet të vihen në dijeni për pikëpamjet e kundërta që ndeshen; ato të bëhen objekt diskutimi edhe aty dhe, pasi të shohiten me kujdes, të sqarohet përfundimisht se cili mendim është i drejtë dhe cila do të jetë rruga e zgjidhjes.

Unë të pyeta, shoku Paskal, se në çfarë drejtimi ka mundësi të na sabotojë më lehtë armiku. Për shembull, a mund të na çorientojë ai me të dhëna të pasakta? Dhe ti u përgjigje: «Po». Kjo është e drejtë. Ai që është armik mund të të çojë për shpime në një vend ku nuk ka fare naftë. Armiku mund të ngadalësojë punën për zbulimin e vendburimeve të reja, të dëmtojë mjetet dhe veglat, të bëjë analiza të gabuara që bëhen shkak për

konkluzione të shtrembra, pa përjashtuar këtu edhe shkaktimin e zjarreve.

Të gjitha pikat nevralgjike të naftës, si gjeologjia, rilevimet, sizmika, paleontologjia, kuadri që punon atje etj., janë shikuar e duhen parë përsëri me sy partie dhe me saktësi shkencore. S'ka asgjë të keqe, por do të ishte një punë shumë e mirë që të verifikohet me kujdes dhe me partishmëri kush është ky ose ai kandidat që mendohet të punojë në institucionet e naftës, çfarë origjine dhe gjendje shoqërore ka, si i ka aftësitë dhe zellin në punë, me cilët persona ka lidhje miqësore e familjare etj., pastaj ta futim të punojë në naftë.

Neve kjo bisedë na shërbeu. Megjithatë, ti reflektu akoma për këtë çështje. Unë e Hakiu këtu jemi, kurdoherë që do të duash të vish, këtu do të na gjesh. Partia ka nevojë për ndihmën tuaj<sup>1</sup>. Ki parasysh në punë vendimet dhe orientimet e Partisë jo vetëm si drejtor, por edhe si kandidat i Komitetit Qendror që je. Ti, bashkë me shokët, duhet të punoni për ta ngritur Partinë në këmbë atje, për të dhënë mendime për punën e njerëzve dhe për të zbatuar detyrat. Gjykimi dhe mendimi i secilit të vlerësohen pa bërë në asnjë mënyrë obstruksion<sup>2</sup>, pa penguar zhvillimin e punëve. Çdo gjë që del, të vërtetohet dhe, në qoftë se në ato që parashtrajnë shokët ka dhe një grimë mendim të padrejtë, atëherë ju, si organizatë partie, të

1. Pas dy ditësh shoku Enver Hoxha e priti përsëri shokun Paskal Sinani dhe zhvilloi me të një bisedë tjetër. (Shih në këtë vëllim f. 136.)

2. Nga frëngjishtja — pengesë me qëllim.

nxirrni të vërtetën për të luftuar atë që nuk është e vërtetë. Kjo është e para.

E dyta, atje te ju, në bazë të rregullave dhe të shkencës, duhet të mobilizohet Partia në një punë intensive, se kemi shumë nevojë për naftë.

E treta, të rritet vigjilenca. Vigjilenca të jetë e madhe nga çdo punonjës i Republikës Popullore të Shqipërisë, se nafta është sektor me rëndësi jetike. Nuk kam ndonjë gjë të veçantë për vigjilencën, por ato që kemi thënë, t'i kemi kurdoherë parasysh.

Edhe sa ditë të mbetën në shkollë?

**SHOKU PASKAL SINANI:** Edhe një ditë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** U bëni shumë të fala gjithë shokëve. Dalshi faqebardhë!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

## PUNËTORET TË PUNOJNË, TË JENË VIGJILENTË, TË BËJNË KRITIKË E AUTOKRITIKË

*Bisedë me shokun Paskal Sinani*

6 shkurt 1975

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si jeni me shëndet, shoku Paskal? Mbaruat punë në shkollë?

**SHOKU PASKAL SINANI:** Po, mbarova që dje.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Desha të bisedoja përsëri me ju, pasi lexova protokollin e mbledhjes së aktivitetit që keni bërë për naftën në muajin nëntor të vitit të kaluar, ku merrnin pjesë edhe Abdyl Këllezi e Koço Theodhosi dhe ku keni qenë edhe ju. Pashë se edhe ju keni diskutuar dhe keni bërë shumë pyetje atje. Do të doja të më thoshit diçka në mënyrë të përmbledhur për mendimet e shokëve që folën në aktiv.

**SHOKU PASKAL SINANI:** Gjatë diskutimeve disa shokë u shprehën kundër qëndrimeve të Drejtorisë së Përgjithshme dhe të Institutit të Naftës, duke thënë se bëhej presion mbi ta.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mbetë i kënaqur ti nga

përgjigjet që të dhanë pas gjithë atyre pyetjeve që u bëre?

*SHOKU PASKAL SINANI:* Jo, nuk mbeta.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kush t'i dha përgjigjet?

*SHOKU PASKAL SINANI:* Drejtori i institutit, Beqir Aliaj.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Është i drejtë kursi që kanë ndjekur ata për të zbuluar rezervat e naftës?

*SHOKU PASKAL SINANI:* Tempet e zbulimit janë shumë të ngadalla në krahasim me ato të prodhimit. Para vitit 1960 ka pasur zigzage, periudha e mëvonshme është shumë e përparuar, se zbuluam vendburime të tjera. . . , kurse tani, pas pesë-gjashtë vjetësh, është zbuluar vetëm një.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Sipas mendimit tuaj, cilat janë arsytet që e shpjegojnë këtë?

*SHOKU PASKAL SINANI:* Themelorja, sipas mendimit tim, është se nuk i përgatitim me cilësi të mirë strukturat.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Dhe kush i ka fajet për këtë? Dua të di konkretisht se kush merret me këto probleme.

*SHOKU PASKAL SINANI:* Shokët e institutit: Beqir Aliaj, Petraq Xhaçka, Kogo Plaku, Protoko Murati dhe të tjerë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Si të thanë në institut kur të dërguan në Sarandë?

*SHOKU PASKAL SINANI:* Më thanë se më kish-te caktuar Partia të shkoja atje.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Partia të tha, po s'duhet

harruar se jo çdo veprim i bërë «në emër të Partisë» është gjithmonë në përputhje me interesat e saj. Partinë, në një sektor të veçantë të jetës, përkohësisht, mund ta zënë edhe në grykë, ashtu siç ndodhi në ushtri. Drejtorinë e Përgjithshme apo Institutin e Naftës i ka krijuar Partia, por ata nuk janë Partia. Ty të thanë, shoku Paskal: «Shko në Sarandë, se kështu ka vendosur Partia!». Dhe ti, si ushtar i saj, vajte atje. Mirë, ti vajte në Sarandë, po drejtuesit e Drejtorisë së Përgjithshme e të institutit të thanë se ç'do të bëje atje?

*SHOKU PASKAL SINANI:* Lipe Nashi nuk më tha gjë, nuk m'i qartësoi objektivat që kërkohej të arriheshin, nuk ma tregoi situatën.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Një punë të tillë kaq formale, ku i transferuari nuk sqarohet për detyrat që i ngarkohen, nuk mund ta shpjegojmë duke menduar në mënyrë «foshnjore», siç i themi ne naivitetit në punët e Partisë.

Nga studimi me vëmendje i materialeve të Partisë ti ke parë se, përveç të tjerave, ekzistojnë edhe tri rreziqe që i kanosen Partisë: burokratizmi, teknokratizmi dhe intelektualizmi. Kur ka burokratizëm në kokën e Partisë, është keq; kur ka pastaj edhe teknokratizëm, është ca më keq; ndërsa kur ka edhe intelektualizëm, është shumë më keq. Në Institutin e Naftës lulëzojnë të tria këto sëmundje. Gjersa atje kemi në krye elementë teknokratë, njerëz jo të mirë, si vëllanë e Panajot Plakut, Beqir Amerikën, siç quhej ky më parë, që e ka mendjen në Moskë, se ka pasur gruan sovjetike dhe ka dy fëmijë të rritur atje, për të cilët vazhdon të



tregojë interesim, puna nuk mund të shkojë mirë. Po të kemi në një organizatë partie me shumicë teknokratë dhe intelektualë dhe vetëm një punëtor, sikurse ndodh në organizatën e Partisë të Institutit të Naftës, s'ka dyshim se të parët patjetër që do t'ia hipin në kurriz organizatës së Partisë.

Në mbledhjet e organizatës së Partisë të këtij sektori sundojnë prepotentët. Ka edhe njerëz që ngrihen e flasin kundër të metave, por prepotentët i ndjekin kritikuesit si inkuizitorët. Prepotenca e Koço Plakut kishte arritur gjer atje sa kishte thënë: «Raportin ta hedhim në zjarr», duke e cilësuar autorin si në kohën e inkuizicionit. Fjala «inkuizicion», dihet, lindi në Jug të Francës, kundër një rryme kristiane që quhej *katharos*, domethënë «e pastër». Kjo rrymë kundër katolicizmit papist përbënte atëherë një ngritje krye, pra një rrezik për Vatikanin, prandaj ky organizoi në atë kohë inkuizicionin kundër burrave e grave, pleqve e fëmijëve të atyre që bënin pjesë në këtë rrymë, dërgoi forca të mbretit të Spanjës e të Francës dhe me mijëra e dhjetëra mijë njerëz të pafajshëm i hodhi si pa gjë të keqe në zjarr. Kur i thoshin shefit të inkuizicionit «Çfarë bën ashtu, Torkemada?», ai përgjigjej: «S'ka asgjë, i digjni të gjithë, pa zoti le t'i zgjedhë cilët janë të mirët dhe cilët të këqijtë!».

Po të shikojmë karakteristikat e Beqir Aliajt, të Koço Plakut dhe të shumë të tjerëve, do të lexojmë: «Është arrogant, prepotent». Kur bëhet mbledhja e organizatës së Partisë në sektorin e naftës, sundojnë këta elementë dhe e keqja më e madhe është se një

qëndrim të tillë e mbajnë «në emër të Partisë». «Jemi njerëz të Partisë», thonë këta, por nuk janë të tillë, përkundrazi, janë elementë antiparti.

Këto t'i thashë për të të shpjeguar se njerëzit e Partisë duhet t'i bëjnë sytë katër, që të mos u shpëtojë asgjë armiqtësore pa nuhatur, se «njerëz të Partisë» qenë Beqir Balluku e Petrit Dumja, që kishin arritur deri në Byronë Politike, por përfunduan si armiq të Partisë e tradhtarë të atdheut. Edhe në sektorin e naftës instituti ka marrë të gjitha fuqitë atje dhe nuk peshon njeri tjetër.

E lexova protokollin për të cilin të fola dhe tani jam në gjendje të të them se kush na ka sabotuar dhe çfarë metodash ka përdorur. Këto mendime i kam duke u bazuar në diskutimet që janë zhvilluar. Ata që kanë sabotuar, janë sigurisht në pozita armiqtësore, por nuk janë budallenj. Vetëm me «autokritikën» që kanë bërë për fajet e tyre, ata meritojnë dënimin më të rëndë.

Në rast se shefi i sektorit të gjeologjisë bën «autokritikë» se ka neglizhuar punën kryesore që i ka ngarkuar Partia, se nuk i ka studiuar me vëmendje të dhënat kryesore, se ka dhënë pika shpimi në bazë të studimeve jo të drejta, a nuk është kjo veprimtari e një sabotatori? Mos vallë sabotatori duhet të ketë brirë për t'u njohur?

Ka disa vite që gjeologjia nuk po na jep të dhëna të sakta për të nxjerrë naftë. Ky njeri, sa për t'u justifikuar, mund të na thotë se është ai që zbuloi Gorishtin. Kur paska zbuluar këtë, atëherë përse i ka lejuar këto pika të pastudiuara? Pse janë derdhur kot, në kërkime

e shpime, gjithë këta miliona lekë? Fakti që dikur paske bërë diçka, nuk të jep të drejtë më pas t'i vësh kazmën asaj që bëre. Kështu duhet t'i shikojmë ne komunistët këto çështje.

Mbase të duket njeri i mprehtë ai Milto Gjipopulli, siç më the, po unë e lexova diskutimin e tij në aktiv dhe përshtypja që më la ishte ajo e një llafazani që përpiqet të tregojë se «zotëron» filozofinë marksiste-leniniste dhe bile këtë ditka edhe ta përdorë në diskutimin e çështjeve të naftës! Të gjitha fjalët e tij ishin demagogji bajate. Ai nuk mjaftohet me këtë demagogji, por bën edhe «teorinë» e strategjisë dhe thotë se strategjia në çështjen e naftës është perspektiva e saj e drejtë. Pikërisht këtë strategji që ai e mburr, në fakt e ka luftuar. Thotë se «kemi gabuar në gjërat e vogla», por të mos harrojmë aspak se kjo taktikë që përdorin këta njerëz i ka vënë kazmën strategjisë. Këto që flet janë të gjitha llafe. Ai pastaj me paturpësi hidhet e citon Leninin dhe këtë e bën për të na hedhur hi syve, për të mbuluar të metat, sikurse bënë dikur edhe sovjetikët, që i shporrëm. Kemi eksperiencë ne me njerëzit e kallëpit të tij.

Gjatë leximit të protokollit të aktivitetit të naftës nuk e kuptova mendimin që ke dhënë ti për një diskutant. Ti ke thënë atje se ai u kundërvihet pikëpamjeve të kadrove të drejtorisë së institutit, por ky fakt në vetvete nuk përjashton aspak që ai të ketë të drejtë. Ja, për shembull, është i drejtë kursi që kanë marrë ata të institutit për të zbuluar rezervat e naftës? Jo! Vetë ti thua se nuk është i drejtë. Pse u shpuan shumë puse dhe u bënë bazamente, duke harxhuar brenda një kohe kaq të shkurtër

tër miliona lekë, dhe nuk u veprua qysh 10 vjet më parë edhe në zonën ku kemi tri vendburime kryesore, sikurse më shpjegove ti? Përse nuk u zbatua vendimi i Byrosë Politike që të intensifikohej kërkimi me baza shkencore në një vend të njohur? U ndërtuan depo të posaçme për naftën, se u tha që nuk do të kishte vend ku të hidhej prodhimi derisa të ndërtohej oleodoti, por naftë nuk u mor. Mendim i pjekur nga ana e Institutit të Naftës është ky? Sigurisht, nuk është rezultat i një mendimi racional, por një mendim shumë i cekët.

Tani po të kujtoj, shoku Paskal, ç'ka thënë afërsisht ky diskutant në aktiv. Ai shprehu mendimin se duhet të ecim sipas vendimit të Komitetit Qendror, të hedhim hapa të sigurt, të mos ecim në tym drejt së panjohurës, po të nisemi nga e njohura, e të tjera. Pra, ai kritikon atë metodë pune të shtrembër që ndjekin drejtuesit e institutit. «Të vazhdojmë punën në këto dy a tri puse, — ngul këmbë ai (dhe më duket e shpjegon mirë pikëpamjen e tij), — dhe jo të hapim një këtu e, pa mbaruar, të ikim, të hapim një tjetër më tutje dhe po kështu përsëri edhe andej të largohemi». Unë mendoj se, duke arsyetuar kështu, do të ecim në rrugë të drejtë.

Këto që them i vërtetojnë të dhënat që kam nxjerrë nga diskutimet e Protoko Muratit dhe Beqir Aliajt. Ata gjoja bëjnë autokritikë për fajet e tyre dhe me këtë qëndrim hipokrit mund të kenë impresionuar edhe shokë të udhëheqjes, po ne nuk i hamë ato që mendojnë ata.

Unë nuk jam dakord as me Zenel Hamitin<sup>1</sup>, që i ka

---

1. Në atë kohë zëvendësministër i Industrisë dhe i Minerave.

bërë një pyetje provokuese këtij diskutanti. Sipas pyetjes së tij del se u dashka të veprohet përsëri siç kemi filluar, domethënë «shko këtu e shko atje!». Me pyetje të tilla ndaj kuadrove me kurajë, Zenel Hamiti tregon se nuk «është në vete» ai vetë dhe jo të tjerët. Ose Lipe Nashi që i thotë një diskutanti tjetër: «Ti shumë po kritikon, po gabimet e tua nuk i sheh!?!». Dhe ai i përgjigjet drejt: «Gabimet i njoh, por edhe kritikoj». Një pyetje e tillë është provokuese, aspak në frymë partie dhe synon të mbytë kritikën. Mua nuk më ka pëlqyer zhvillimi i punimeve të aktivitetit që u bë për kërkimet e naftës e të gazit.

Ti ke origjinë punëtori, vetë, gjithashtu, ke qenë punëtor dhe Partia të ka zgjedhur kandidat të Komitetit të saj Qendror. Këto të dhëna janë pozitive, por ama sabotimin që na është bërë në naftë nuk na e vuri askush tjetër në vesh përveç një punëtori të thjeshtë e kurajoz, që më shkroi mua një letër. Ky akuzon me gisht dhe jep fakte, dokumente. Ai shprehet hapur se në sektorin e naftës ka punë armiqësore, bën kritikë me guxim deri edhe për anëtarin e Byrosë Politike, Koço Theodhosi, dhe ka të drejtë.

Ky punëtor i vjetër, teknik i mesëm, komunist, shpjegon se lëvizja e sondave nga një vend në tjetrin bëhet pa kritere. «Sipas mendimit tim, — sqaron ai, — kjo është punë armiqësore, pse në çdo bazament derdhen deri 500 mijë lekë. Ne nuk e kuptojmë këtë qëndrim!». Për këtë çështje ai dhe shokë të tjerë kanë folur edhe në Parti, por, siç duket, fjalët e tyre nga një vesh u kanë hyrë, nga tjetri u kanë dalë drejtuesve të

Partisë. Me një fjalë, atë s'e ka dëgjuar e s'e ka përfillur njeri.

Punëtori i naftës, që më shkroi letrën, më thoshte:

«Thirra njëherë punëtorin e vjetër të naftës Kapllan Hajdari, që e njohim të tërë. «More Kapllan, — e pyeta, — çfarë janë këto që po ndodhin atje?». «As unë nuk i kuptoj, — më tha ai, — po ama e shoh se nuk janë gjëra të mira». «Po si do t'i bëhet halli kësaj gjendjeje? Pse nuk vete te Lipe Nashi t'i thuash ç'janë këto gjëra?», e pyeta. Dhe ai vajti i tha: «Shoku Lipe, nuk e kuptoj si bëhen këto punë». «Gjëra të tilla do të ndodhin, janë të natyrshme», iu përgjigj i sigurt Lipja. Pas një muaji Kapllan Hajdarin «e internuan» në Sarandë». Me të kanë vepruar tamam siç bënte Hito Çakoja me ata vartës që nuk i bindeshin qorrazi.

Pra, një komunist i thjeshtë e informoi Komitetin Qendror, duke kërkuar që të vërë dorë në këto çrregullime. Atëherë unë kërkoja protokollin e mbledhjes së aktivitetit të kërkimeve të naftës e të gazit dhe pashë se në këtë sektor ka me të vërtetë gjëra të këqija, nga të cilat ne shokët e udhëheqjes duhet të nxjerrim mësim. Po të kishim në komitetin e Partisë të sektorit të naftës, në Institutin e Naftës, në byronë e komitetit të Partisë të rrethit punëtorë dhe disa inxhinierë të aftë e guximtarë, ne do të kishim gjetur me siguri naftë. Gjersa atje kemi në krye elementë teknokratë, njerëz jo të mirë, si vëllanë e Panajot Plakut, Protoko Muratin, Beqir Aliajn e ndonjë tjetër, punët nuk do të venë mbarë, se këta s'kanë si të mendojnë për punën.

Unë të pyeta: «I dëgjojnë atje punëtorët dhe tekni-

kët e mesëm?». Dhe ti më folë drejt: «Nuk i dëgjojnë sa duhet, shoku Enver». Ky është një nga rreziqet më të mëdha për Partinë, prandaj po flasim vazhdimisht, sido që këto mund të duken si gjëra të parëndësishme.

Sa dëm të madh i kanë sjellë shtetit qëndrime të tilla! Kësaj i thonë të harxhosh pesë vjet me radhë gjithë ato shuma dhe përsëri të mos gjesh naftë! Naftë ka, por nuk na kanë lejuar ta zbulojmë e ta nxjerrim njerëzit me këto pikëpamje e qëndrime. Tani na duhet të bëjmë dyfishin e shpenzimeve për të vënë punën në vend.

Kur themi se, për shembull, shoku Paskal Sinani është punëtor partie, ne duhet ta besojmë atë, po, njëkohësisht, edhe ta kontrollojmë. Kështu na mëson Partia. Nuk ka rrugë tjetër. «Unë kam besim tek ti, — të thotë përgjegjësi, — po punën tënde do ta ndjek me vërejtje, me imtësi dhe do të të bëj kritika kur bën gabime, për ndreqjen e të cilave ti e ke detyrë të mendosh». Në qoftë se bindesh për ato që të kritikon ai më lart, shoku apo vartësi, dhe je dakord, mirë, në qoftë se nuk bindesh, atëherë, po qe nevoja, vjen deri këtu në Komitetin Qendror të Partisë dhe kërkon të takohesh edhe me Sekretarin e Parë të tij!

Është për të ardhur keq se as sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Fierit, as sekretari i këtij komiteti që merret me sektorin e naftës, nuk kanë ardhur të na vënë në dijeni për një çështje kaq të madhe. Këtë gjë nuk e bëtë as ju shokët e Plenumit të Komitetit Qendror, që nuk u treguat në lartësinë e duhur.

Na vihet, pra, detyrë që në drejtimin e punëve në

sektorin e naftës të zgjedhim njerëz të mirë, punëtorë. Të krijohet atje një situatë e tillë që inxhinieri të mos i thotë dot punëtorit: «Ulu ti atje, se nuk di!», por të diskutojnë e të shqetësohen së bashku për punën. Kur punëtori vë re shenja mospërfilljeje nga ana e inxhinierit, t'i thotë këtij: «Pa dale, more shoku inxhinier, se vërtet ti ke dituri nga shkolla, po kam edhe unë diturinë time, përvojën time. Këto që thua ti, do t'i bëjmë, por vetëm pas një diskutimi rigoroz kolektiv, pra t'i bëjmë të bindur për përfitimet që do të kemi, jo në hava».

Unë, shoku Paskal, të thirra, siç të thashë në fillim, për të të dëgjuar dhe për të të thënë mendimin tim personal që punët në sektorin e naftës nuk janë në rregull, që organizimi atje është i gabuar, që Instituti i Naftës duhet të ketë vetëm detyra studimi: të studiojë puset, gjeologjinë, paleontologjinë, sizmikën dhe të japë pikat me përgjegjësi. Me të tjera gjëra ai nuk duhet të merret, se tani i ka marrë përsipër të gjitha, bën studime, jep urdhra etj., është bërë një «trust» kolosal.

Unë nuk jam dakord me qëndrimin e mbajtur për këto çështje nga organet drejtuese të Partisë në sektorin e naftës. Atje ka një komitet partie që është ngritur, po ky nuk duhet të ecë me sy mbyllur.

Byroja Politike e zbuloi punën armiqësore të Beqir Ballukut, por, me gjithë vigjilencën që u tregua për zbulimin e komplotit të rrezikshëm që ishte krijuar në ushtri, ne kemi përgjegjësi, sepse të metat e mëdha nuk u zbuluan dot më përpara. Këtë e kanë thënë të gjithë ata që e duan Partinë, që kanë besim tek ajo dhe nuk



e kam fjalën për shpifjet e armiqve. Vihet pyetja: «Po kuadrot e sektorit të naftës ku kanë qenë deri tani? Pse nuk e kanë ngritur zërin e tyre më parë për gjendjen e vështirë në naftë?»:

Tani problemi shtrohet që të zbulojmë vendburime të reja dhe unë kam besim se do të zbulojmë. Në rast se deri tani nuk kemi zbuluar në të gjitha zonat ku kemi kërkuar, kjo gjendje ka ardhur sepse na kanë penguar këto që thamë. Kështu është kur shpon kuturu. Mund të lejohen gabime në një masë të tillë që në dy-tri puse të gjejmë të paktën një, po ama jo siç ka ndodhur, se këto shpime i kushtojnë shumë popullit.

Çështja është që të mobilizohen naftëtarët për të zbuluar shkaqet, për të folur lirisht dhe për të realizuar planin. U thoni punëtorëve: «Si mendoni ju për këto gjëra?». Më përpara t'u kërkohet mendimi atyre, pastaj të flitni ju. U thoni, gjithashtu, atyre: «E kuptoni ju këtë urdhër që ka dërguar instituti?». «Jo!», do të thonë ata. «Po këto që themi ne, i kuptoni?». «Nuk para i kuptojmë as këto», mund t'ju thonë përsëri. Dhe ju u shpjegoni me durim e me qartësi se «këtë urdhër të institutit po e bëjmë problem përpara jush, se nuk na duket i drejtë, se është i shtrembër, prandaj mendojmë të na vijë këtu urdhërdhënësi, të cilin ta futim në mençjen e klasës, që të dërsijë».

Të zgjojmë Partinë dhe punëtorët e sektorit të naftës, që ata të kërkojnë të zbatohen atje me rreptësi direktivat e Partisë dhe rregullat e caktuara nga Qeveria. Të tregohet kujdes ndaj kuadrove me arsim të lartë. Të mos ndodhë kurrë që, për arsye se dolën dy-tre inxhini-

erë sabotatorë, të krijohet një kuptim i shtrembër për të gjithë kuadrot me arsim të lartë dhe t'u mbahet mëri pa vend. Në asnjë mënyrë nuk duhet të kuptohet kështu kjo çështje. Shumicën e kuadrove në sektorin e naftës e kemi të mirë.

Prandaj reflekto, shoku Paskal, se ti je një kuadër që ke dalë nga gjiri i klasës punëtore në sektorin e naftës. Çështjen e teknokratizmit që të përmenda, bluaje mirë në mendje. Në sektorin e naftës kemi një klasë punëtore nga më të mirat, pararojës së të cilës i ka hipur në kurriz një sëmundje e rrezikshme, ajo e teknokratizmit.

Një problem me rëndësi për mbarëvajtjen e punëve në naftë është dhe përgatitja e mirë e kuadrove të rinj nga universiteti. Kërkohet që qysh këtu të punohet në mënyrë të tillë që kur universitarët të shkojnë për të punuar në gjirin e klasës punëtore, në «nxehtësi», në «zjarr», në mengene, të jenë të përgatitur, prandaj intelektualizmi të luftohet që atje, në praktikë dhe në teori. Organizata e Partisë e sektorit të naftës ta kuptojë mirë këtë rrezik.

Ti ke dëgjuar për një djegie që ndodhi në Qytetin Stalin. Fajtorët u arrestuan. Aparati që ishte në vend tregonte vazhdimisht të gjitha lëvizjet e nxehtësisë: 230°, 260°, 295°, kurse në regjistrin e punëtorit, të cilit i paguheshin 600 lekë në muaj për të shënuar në çdo kohë lëvizjet e temperaturës, u gjetën të shënuara vetëm vlera temperature normale! Kjo do të thotë se ky punonjës i pandërgjegjshëm gënjente, i shënonte shifrat sipas oreksit, se në kohën e punës bridhte poshtë e për-

pjetë dhe, kur kthehej, regjistronte në mënyrë fiktive sikur temperatura kishte qenë normale. Po të kishte qenë njeri me ndërgjegje inxhinieri përgjegjës, komunist ose i paorganizuar në Parti, po t'i kishte kontrolluar edhe vetë herë pas here shifrat e kartogramit, që punëtori i hidhte veresie në regjistër, doemos që do të vërente rrezikun para se ky të bëhej kërcënues. Mirëpo, kur vajti punëtori tjetër për të ndërruar të parin, kazani i bitumit mori flakë dhe u krijua një gjendje alarmante, sa mund të digjej gjithë rafineria. Tri zjarre në katër ditë na ndodhën atje! Shfaqje të tilla nuk duhen gjykuar me mendjelehtësi dhe si të rastit. Ky është një faj i madh që ndodh për mungesë vigjilence. Kështu veponte edhe Koço Plaku, kur i dërgonte të dhënat kuturu dhe pa i kontrolluar fare. Protoko Murati ka thënë se dobësitë që dalin «vijne nga stili e metoda e punës», tamam ashtu siç thoshin Beqir Balluku, Petrit Dumja dhe Hito Çakojë për të mbuluar tradhtinë e tyre.

Problemet që janë në studim e sipër duhet të rishikohen kudo. Prandaj t'u thuash kuadrove që t'i shikojnë me kujdes. Në rast se duhet të hapim një pus, ta zëmë, në Borsh, i thuaj më parë Koço Plakut ose ndonjë tjetri: «Pa hajde ma shpjego një çikë si dhe përse vendosët kështu.». Ti ke të drejtë të interesohesh kudo për naftën, se je kandidat i Komitetit Qendror. Në këlë drejtim të kesh parasysh gjithçka u theksua në Plenumin e kohëve të fundit të Komitetit Qendror.

Ti, natyrisht, nuk ke nevojë të hapësh defterin kur të bisedosh me këta njerëz për punë të tilla, por gjen rastin për të vajtur atje ku ke nevojë të shikosh. «Mo-

re, shoku filan, — i thua për shembull njërit, — do të më japësh përgjigje për ato pyetjet që të bëra në aktivin e naftës, se atje nuk the gjë për to». Ose i thua se «lidhur me ato pyetjet që bëra në mbledhjen e nëntorit, përgjigjet që dhe nuk i kuptova, prandaj mund të më japësh tani një shpjegim më të qartë?». Nuk është nevoja që të prononcohesh me të, po vetëm dëgjoje me kujdes për të parë nëse i ka ulur pendët apo vazhdon të qëndrojë si më parë. Ai që e ndien se «i kruhet koka», mund të përgjigjet ashtu si do ti e të thotë: «Paskam menduar gabim atëherë!». Në një rast të tillë ti e kupton që ai e paska ndërruar mendimin dhe këtë konstatim e mban për vete në xhep. Ose mund të shkosh një ditë në Fier, në Drejtorinë e Përgjithshme të Naftës apo në institut për të kërkuar këtë ose atë shpjegim për çështjet shqetësuese dhe i thua, për shembull, Beqir Aliajt se nuk e kemi të qartë këtë ose atë çështje dhe nuk e dimë do të ecim me teorinë e këtij apo të atij gjeologu. Pasi të të përgjigjet ai se do të ecim, bie fjala, me këtë teori, atëherë e pyet përsëri: «Mund të ma shpjegosh një çikë këtë?». Por këto biseda t'i bësh me kujdes të madh, se e di ti që ikin fjalët menjëherë dhe ata e nuhatin me vrimat e hundës qëllimin e pyetjeve që u bëhen. Edhe nuancat përpiqen t'i marrin vesh, se ai që bën punë armiqësore, kërkon të fshihet me dinakëri. Me njerëzit e Partisë, me njerëzit e popullit duhet të jemi të çiltër, kurse me armikun, në qoftë se është vërtet armik, të jemi të kujdesshëm sa t'i përgatitim kurthin që të bjerë brenda.

Në këtë drejtim ti vepro qetësisht, kërko edhe ndih-

mën e Komitetit Qendror, i cili nuk do të lejojë të kalojnë në kaq lehtë këto dështime, por do t'i hyjë në thelb problemit, duke marrë dhe masat përkatëse. Ne duhet të bindemi plotësisht për atë që do të bëjmë e pastaj të veprojmë si revolucionarë, siç kemi vepruar kurdoherë.

Është shqetësues fakti që punët në sektorin e naftës nuk na ecin. Ne vërejmë se te kuadrot atje ka koncepte të gabuara që pengojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara.

Në këto kushte lypset të armatosemi me vigjilencë. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Naftës e të Institutit të Naftës duhet t'i respektojmë dhe t'u besojmë, por kjo nuk do të thotë të flemë. Mjaft kemi ndenjur në gjumë. Pra, edhe t'i kontrollojmë. Kur ka kritika ndaj punës dhe organizimit të saj, duhet t'ua themi pa ngurrim dobësitë që kanë.

Më kanë treguar se punonjësve atje nuk u bëhet të shkojnë në institut, është krijuar një ftohje dhe frikë deri në marrëdhëniet midis kuadrove. Unë them se, po të marrim masa për disa nga kuadrot si ata që përmenda, atëherë do të hapen gojët e njerëzve, ashtu siç u bë edhe për Beqir Ballukun, Petrit Dumen, Hito Çakon e të tjerë. Njerëzit druhen të flasin, se kur vijnë atje, për shembull, Koço Theodhosi e të tjerë, marrin me vete gjithë «shtatmadhorinë e naftës», të përbërë nga Lipe Nashi, Beqir Aliaj, Koço Plaku e të tjerë. Njerëzit në bazë i shohin drejtuesit e sektorit të naftës që kuvendojnë e shoqërohen me ministrin, me zëvendësministrin e të tjerë, prandaj dhe nuk marrin kurajë të flasin për fajet e tyre. E kupton ti situatën që kri-

johet? Kështu mendonin edhe për Beqir Ballukun: «Është me Enverin», dhe çdo veprim të keq të tij nuk ia thoshin njeriu! Edhe naftëtarët e kuadrot e naftës kështu thonë për drejtuesit e tyre. Me këtë nuk dua të mohoj kurajën e punëtorëve, se punëtor është ai që më shkroi mua letër dhe ua tha në sy shokëve Haki Toska dhe Adil Çarçani pikëpamjet e tij edhe për Koço Theodhosin.

Këto që thashë janë zbërthim në praktikë i teorisë dhe i mësimëve të Partisë. Punëtorët duhet të punojnë, të luftojnë, të jenë vigjilentë, të bëjnë kritikë dhe auto-kritikë, kudo Partia të drejtojë.

*Botuar për herë të parë, me disa shkurtime, në librin: Enver Hoxha, «Gjithmonë vigjilencë» (Për organet e Punëve të Brendshme), vëll. i 2-të, f. 362*

*Botohet i plotë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

## INTELEKTUALËT DHE TEKNIKËT TË NE JANË NDIHMËSIT E KLASËS PUNËTORE

*Bisedë me sekretarët e parë të komiteteve  
të Partisë të disa rretheve të vendit<sup>1</sup>*

7 shkurt 1975

Ju, shokë, thoni se roli udhëheqës i Partisë dhe kontrolli i klasës punëtore nuk kanë qenë në nivelin e duhur në sektorin e naftës, se atje ka pasur organizime e riorganizime të nxituara, se komunistët kanë

---

1. Në shënimet e mbajtura lidhur me këtë bisedë, shoku Enver Hoxha shkruan:

--Shokët Hysni Kapo dhe Haki Toska thirrën në Komitetin Qendror të Partisë për të raportuar për gjendjen e krijuar në industrinë e naftës e të gazit katër sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të rretheve Fier, Vlorë, Berat e Lushnjë (me përjashtim të sekretarit të Sarandës), në juridiksionin e të cilëve ushtrojnë veprimtarinë e tyre Drejtoria e Përgjithshme e Naftës, Instituti i Naftës, si dhe ndërmarrjet e naftës.

Qëllimi i thirrjes në raport të shokëve të lartpërmendur, nga ana e dy sekretarëve të Komitetit Qendror të Partisë, ishte që ata të raportonin përse është punuar keq për studimin, kërkimin, zbulimin dhe prodhimin e naftës; si mendon për këto

pasur vërejtje për prepotencën e Koço Plakut, të Protoko Muratit, të Beqir Aliajt etj., se janë bërë studime shkel e shko, se programet e kërkimit të naftës nuk janë zbatuar, është lënë sizmika pas etj.

Atëherë lind pyetja: Përse ju, shokë, nuk i keni ngritur deri në Komitetin Qendror të Partisë këto vërejtje që paskeni pasur?! Kur ju thërresim këtu, na thoni se problemet po i analizoni hollë dhe po merrni masa për përmirësimin e gjendjes etj. Atëherë pse nuk vepruat kështu më përpara edhe për këtë gjendje që është krijuar në naftë? Ju duhej të ishit në korent të punës që bëhet në këtë sektor dhe të shqetësoheshit se për ç'arsye ndodh që për disa vjet me radhë nuk po zbulohen vendburime të reja naftë. Pse nuk protestohet kur del se të dhënat që jep Instituti i Naftës janë të ga-

---

çështje Partia në rreth e në bazë; çfarë analizash janë bërë dhe ç'përfundime janë nxjerrë prej tyre; çfarë masash politike, ideologjike, organizative, teknike etj. mund të merren në të ardhmen për të ndrequr situatën; a mund të jenë këto pasoja të rënda rezultat i një pune armiqësore në sektorin e naftës etj.

Unë nuk i dëgjova plotësisht raportimet e sekretarëve të parë të komiteteve të Partisë të rretheve që përmenda më lart, për arsye se nuk munda të marr pjesë që në fillim të takimit dhe përsëri më vonë m'u desh të largohesha para mbarimit të këtij takimi. Megjithatë pata rastin t'u bëja atyre disa pyetje për çështjet që më shqetësonin më tepër dhe të dëgjoja se si e shpjegonin ata situatën e krijuar në sektorin e naftës dhe ç'mendonin për të dalë nga kjo gjendje.

Më në fund, pasi i pyeta shokët edhe për disa kuadro të sektorit të naftës, u shpreha edhe unë disa mendime». (AQP).



buara, ose kur shikohet që recepturat e solucioneve s'janë të bazuara?

Ju thatë se keni dëgjuar të flitet në institut se «me teknikën mund të zgjidhet gjithçka». Ne nuk jemi kundër teknikës, prandaj kemi sjellë shumë makineri e mjete moderne, por jemi kundër mbivlerësimit të saj. Ne kemi zbuluar fusha naftëmbajtëse edhe pa mjetet e fuqishme që keni sot. Po si i zbuluam ato atëherë kur nuk i kishim të dhënat e elektronikës? Ka fakte të pakundërshtueshme që vërtetojnë plotësisht se teza e teknokratëve, sipas së cilës «teknika zgjidh gjithçka», nuk mund të qëndrojë në këmbë. Ne po vërejmë me vëmendje se në sektorin e naftës ka njerëz e kuadro që i teprojnë shumë kërkesat për teknikën. Në këto rrethana mendoj se është e domosdoshme të ngrihet më lart vigjilenca dhe të shtrohet pyetja: Cilët janë këta që flasin kështu në institut dhe ç'qëllime kanë kur fetishizojnë teknikën? Dëmi mund të mos vijë drejtpërdrejt nga këto gjykime, por ne duhet të shikojmë me kujdes se mos këto mendime hidhen për të fshehur ato veprime që janë kryer dhe për të justifikuar dështimet. Këto koncepte e botëkuptime, që shprehen andej-këtej, Partia, në rreth e në bazë, duhet t'i njohë e t'i luftojë në gjithë punën e saj.

Akoma makina e pajisje të tjera dashkan drejtuesit e sektorit të naftës kur nuk po shfrytëzojnë mirë dhe kur lëvizin pa asnjë kriter, bile në mënyrë shumë të dyshimtë, nga një vend në tjetrin, me shpejtësi shumë të madhe, duke i dëmtuar, edhe ato që kanë në përdorim? Këto kërkesa nuk janë me baza të shëndosha.

Ne e dimë që disa materiale e mjete në sektorin e naftës mungojnë, por nuk janë këto faktori kryesor që ka penguar punën. Këtë e dinë shumë mirë edhe vetë ata që i ngrenë këto pretendime.

Ti Pirro [Gusho], kur të pyeta unë, the se në byronë e organizatës së Partisë në Institutin e Naftës janë tetë intelektualë e një punëtor! Ja, që këtu, mendoj unë, duhet të ndalemi një çikë dhe të reflektojmë, se nuk e kemi mirë këtë raport. Merrni me mend se në ç'nivel është kontrolli i klasës punëtore dhe sa zbatohet vija e masave ku udhëheqin kjo organizatë-bazë dhe kjo byro! Raporti i përbërjes së byrosë duhej të ishte i kundërt, pra tetë anëtarë të byrosë të ishin punëtorë dhe një të ishte intelektual. Këto çështje ju këshilloj t'i shikoni mbi bazën e mësimeve të Partisë e jo formalisht.

Me sa duket, organizata e Partisë në Institutin e Naftës është mbushur me burokratë. Të kuptohemi mirë, shokë, se ne nuk jemi kundër njerëzve të ditur, përkundrazi. Po nuk jemi aspak dakord që ata t'ua hipin në zverk punëtorëve e të mos dëgjojnë zërin e tyre. Klasa punëtore duhet t'u kërkojë llogari atyre, që diturinë e fituar ta vënë në shërbim të popullit, të atdheut dhe të ndërtimit socialist të vendit. Intelektualët dhe teknikët te ne janë ndihmësit e klasës punëtore, ata nuk mund të bëjnë këtu ligjin dhe as t'u imponohen punëtorëve, por t'i nënshtrohen ligjit që shpreh vullnetin e klasës. Unë ngul këmbë edhe një herë që në byro të ketë më shumë punëtorë se intelektualë, sepse, po të mos veprohet kështu, jam i bindur që, kur të ngrihet një punëtor e të kritikojë drejtuesit, siç bëri Kapllan

Hajdari, një njeri me partishmëri të lartë dhe me shpirt heroik, ata «do ta internojnë» larg që t'i mbyllin gojën.

Në qoftë se Ministria e Industrisë dhe e Minierave nuk i ka kryer mirë detyrat për naftën, ti, Pirro, si sekretar i parë që je në Komitetin e Partisë të Rrethit të Fierit, e ke kapur ndonjëherë ministrin, Koço Theodhosin, për të biseduar seriozisht me të se për ç'arsye nuk ecin mirë problemet e naftës? E ke ftuar ndonjëherë atë në byronë e komitetit të Partisë të rrethit kur është diskutuar lidhur me këto çështje? Ti thua se e ke ftuar, por jo për problemet kryesore të naftës. Kjo nuk është e drejtë. Atëherë ç'vlerë ka ta ftosh për probleme pa rëndësi? Përgjigjja është e qartë, se edhe ti nuk je thelluar në këto probleme.

Kur të pyeta se cila është teoria më e drejtë për nxjerrjen e naftës dhe të gazit, që është shfaqur në mbledhjen e këshillit shkencor të institutit, dhe cilat koncepte mbronin në këtë drejtim, ti, Pirro, m'u përgjigje se ishe me konceptin e sekretarit të organizatës-bazë të Partisë, sipas të cilit «nëntoka jonë ka naftë». Kjo gjë dihet nga të gjithë, por çështja qëndron në atë se çfarë bëhet për të zbuluar vendburimet e naftës. Ti duhet të jesh në korent të të gjitha problemeve të naftës, se dy janë detyrat kryesore që ka rrethi i Fierit: plotësimi i planit të naftës dhe të bujqësisë. Nafta është lëndë kryesore e parë për industrinë, për mbrojtjen, për gjithë ekonominë. Në mbledhjen e aktivitetit për kërkimet e naftës e të gazit u shfaqën «teori» e koncepte të gabuara, por, me sa duket, ti i ke qëndruar në sipërfaqe kësaj çështjeje. Është e kotë të imagjinosh tani për

sa kohë që nuk je futur në thellësi dhe nuk i ke studiuar e nuk i ke ndjekur këto probleme. Për të sqaruar disa anë të problemit, neve na u desh të merrnim proces-verbalin e asaj mbledhjeje, dhe, pasi e studiuam, gjykuam cilat janë teoritë dhe prirjet e shfaqura atje. Ti që nuk vajte në atë mbledhje, besoj nuk e ke bërë këtë punë. se nuk ke nuhatur gjë.

Po t'i them unë, me pak fjalë, cilat janë teoritë e shfaqura atje. Njëra është «teoria» e elementëve të dyshimtë që na rekomandon të ecim symbyllur e kulture duke shkuar ku të mundemi, që nga Oboti në Konispol, në Krujë e kudo, mjafton që të shpërndahe mi sa më shumë andej-këtej nëpër Shqipëri dhe të bëjmë shpime të pastuduara mirë e pa rezultate. Një «teori» e tillë nuk na ka dhënë asgjë deri tani dhe as që mund të na japë as në të ardhmen. Edhe këta elementë, që kanë të tilla «pikëpamje», flasin «për rëndësinë e madhe të naftës», «për nevojat e shumta që ka shteti për të», «për detyrat që dalin lidhur me nxjerrjen e rezervave të mëdha që ka vendi ynë» dhe «rekomandojnë» që, për të bërë këtë, duhet të gjejmë fusha. Dhe fushat «i kemi caktuar» thonë ata!

Mirëpo teoria tjetër, e drejtë, është ajo që rekomandon Partia, sipas së cilës duhet të ecim në mënyrë shkencore, hap pas hapi, duke bërë më parë studime të thella, shkencore, komplekse e të plota dhe kjo gjithnjë nën kontrollin e Partisë dhe të organeve shtetërore. Kështu, në qoftë se në Skrapar filluam shpimin në pikat e caktuara që më parë mbi bazën e një studimi shkencor, atëherë është e nevojshme që t'i shkojmë

deri në fund jo vetëm pusit që shpuam, por, duke i bërë të gjitha shërbimet sipas planit dhe studimit të hartuar, mbi bazën e të dhënave që marrim prej tij, të vazhdojmë kërkimin e asaj fushe nga lindja dhe nga perëndimi, nga jugu dhe nga veriu e jo të largohemi 7 kilometra, sepse gjoja në këtë distancë, sipas mendimit të Beqir Aliajt, Koço Plakut e të tjerëve, na qenka kulmi ku mund të gjendet nafta!

Në aktivin e kërkimeve të naftës e të gazit, që u bë në nëntor të vitit të kaluar, u shfaq edhe një «teori» tjetër. Kjo është «teoria» e shfrytëzimit të puseve ekzistuese në kundërshtim me rregullat, që çon në përmytjen e puseve me ujë. Dhe ç'rezulton nga kjo? Nga njëra anë, nuk zbulojmë fusha, shpenzojmë fonde të mëdha, por njëkohësisht mbytim edhe puset, domethënë nuk i shfrytëzojmë fushat naftëmbajtëse në mënyrë shkencore. sipas nevojave që na paraqiten. Kësaj i thonë të sabotosh dhe t'u përgatitësh fushën imperializmit, revizionizmit dhe reaksionit botëror, që të na diktojnë ligjet e tyre skllavëruese në lidhje me naftën, të na hedhin zinxhirët. Kjo kështu është «teoria» e lënies së vendit pa naftë, e sabotimit kriminal të ekonomisë dhe e minimumit të mbrojtjes së vendit!

Ti, Pirro, porositë e Partisë nuk i ke vënë vath në vesh, prandaj nuk i ke zbatuar mirë në drejtimet që përmenda. Shumë janë lënë këta njerëz jashtë kontrollit të Partisë e të shtetit, prandaj gjer sot kanë livadhësuar pa fre.

Unë e quaj me vend që, në bazë të planit të shtetit të aprovuar për zbulimin e rezervave të naftës, edhe

ndërmarrjeve të kërkit mund t'u detajohet afërsisht ky plan, që ato të kenë një detyrë më konkrete për të mobilizuar më mirë punonjësit për realizimin e detyrave që u dalin. Kjo metodë pune mund të praktikohet. Sikundër tha shoku Gaqo<sup>1</sup>, nuk është mirë që shokët e dikasterit të mos venë për të biseduar shtruar me shokët e rrethit e të bazës rreth problemeve që preokupojnë të dyja palët. Vërejtja juaj në këtë drejtim, shoku Gaqo, është e bazuar. Por unë mendoj se, kur Partia në rrethin e Vlorës apo në rrethe të tjera, nëpërmjet punës edukative dhe bindëse, do t'i ketë bërë të ndërgjegjshëm punëtorët për domosdoshmërinë e luftës kundër burokratizmit, intelektualizmit dhe teknokratizmit, për nevojën e ushtrimit më të fuqishëm të kontrollit punëtor, për raporte të drejta në marrëdhëniet kuadër-masë etj., punëtorët do të ngrihen me guxim kundër shfaqjeve e fenomeneve negative dhe, po të jetë nevoja, ata do të jenë të gatshëm t'u vënë këmbët në një këpucë shokëve të Ministrisë së Industrisë e të Minierave, të Drejtorisë së Përgjithshme të Naftës, të Institutit të Naftës apo edhe Pirro Gushos.

Si është e mundur të lejohet nga Partia që zëri i masës, zëri i punëtorëve, të mos dëgjohet nga disa kuadro? Këta kuadro, të molepsur nga kjo sëmundje e rrezikshme, me kërkesën e masës, duhet të venë menjëherë në gjirin e saj që të shtrohen. Partia ka porositur vazhdimisht që kuadrot të bisedojnë me parti-

---

1. Gaqo Nesho, në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Vlorës.

shmëri dhe gju më gju me punëtorët, duke i zgjidhur bashkë me ta problemet që dalin. Këtë porosi të Partisë nuk e keni zbatuar mirë, në radhë të parë ju, dhe për këtë keni përgjegjësi. Kjo tregon se jo të gjithë komunistët që punojnë në industrinë e naftës janë në nivelin e detyrave që u ka ngarkuar Partia. Kush do t'i bëjë të ndërgjegjshëm punonjësit e naftës, Partia apo Beqir Aliaj që saboton? Beqir Aliajn dhe gjithë të tjerët, që kanë punuar si ky, Partia dhe punëtorët t'i detyrojnë të japin llogari se për ç'arsye nuk i kanë të studiuar pikat e shpimit etj.

Pikat e shpimit për shumë kohë, tha shoku Gaço, i kanë zvarritur, me gjithë kërkesat e përsëritura të rrethit në këtë drejtim, dhe pastaj, me ca presion, ata kanë dhënë shumë pika menjëherë, sa për të mbyllur gojët, pa parë se si e ku jepen këto pika, mbi ç'baza e studime janë caktuar etj. Kjo ndodh sepse për ta, me sa duket, s'ka shumë rëndësi që groposen paratë e popullit. Në qoftë se ekonomia jonë dëmtohet, kaq u bën atyre.

Veprimtaria e tyre të bën të dyshosh shumë, por lind pyetja: Ç'bëjnë gjeologët e puseve që janë në ndërmarrjet e shpimit? Ju duhet t'i përgatitni ata që, kur të marrin pikat e shpimit, të mos veprojnë mekanikisht, por të mendojnë, të studiojnë e të gjykojnë me përgjegjësi si dhe mbi ç'baza i ka menduar e i ka studiuar këto pika instituti, a janë nisur nga kritere shkencore apo jo. Unë mendoj se gjeologu i pusit duhet të kualifikohet që të jetë në gjendje të bëjë studime paleontologjike, ai duhet të marrë kampionët, t'i çojë për

analizë në laboratorin përkatës, të ndjekë përfundimet e analizës dhe t'i përpunojë këto për të konkluduar nëse përrputhen me të dhënat e institutit, me studimet etj. Në këtë drejtim gjeologët e puseve duhet të japin një ndihmë të madhe.

Prandaj, duhet të ngrihen në këmbë Partia dhe masat që gjeologët të njohin gabimet e fajet e tyre, që punonjësit e Institutit të Naftës të vijnë të gjithë atje në bazë dhe të japin llogari. Vënien e kuadrove para përgjegjësisë, në kuptimin që këta të japin llogari para masave, nuk po e zbatoni mirë të gjithë ju drejtuesit e punës së Partisë në rrethe. Unë, Hysniu, Haku dhe shokët e tjerë të udhëheqjes këtu në Komitetin Qendror, nuk bëjmë dot shumë punë, po s'u punua më shumë e më mirë nga ju drejtuesit e Partisë në bazë.

Ka kaq vjet që s'kemi zbuluar asnjë vendburim të ri naftë! Atëherë ç'do të bëhet? Cila është perspektiva? Ne, nga njëra anë, duam naftë që të punojë gjithë kjo industri që kemi ndërtuar e do të ndërtojmë, por, nga ana tjetër, duam edhe të shesim, sepse kemi nevojë të blejmë pajisje, makineri e mallra të tjera. Po nuk zbuluam naftë, po nuk e bëtë mirë ju punën tuaj për të vënë para përgjegjësisë së Partisë njerëzit, kuadrot e specialistët, kjo detyrë nuk mund të kryhet. Mjaft më me justifikime «jo ka penguar kjo, jo ka penguar ajo; jo ishte kështu, jo po ishte ashtu», se këto qëndrime na pengojnë të shikojmë që në industrinë e naftës po na sabotohet. Edhe lëvizjet e kuadrit të sektorit të naftës ne nuk i dimë, por kërkojmë t'i dimë, Pirro Gusho! Lëvizjet e specialistëve të mirë e të ndershëm



ka rëndësi të studiohen në kuadrin e këtyre mos-realizimeve, për të pasur një tablo më të qartë e më të plotë të veprimtarisë së zhvilluar kundër ekonomisë sonë.

Nuk është aspak e vërtetë që inondimi i puseve pas-ka ndodhur për shkak të mbishfrytëzimit të tyre, që qenka «imponuar nga nevojat e vendit për naftë»! Këtë shpjegim që ju është dhënë me qëllim të keq, mos e pranoni, se e ka burimin në «teorinë» që përmenda më lart. Plani ynë nuk është bërë që të dëmtohet regjimi i shfrytëzimit të puseve. Udhëheqja e Partisë dhe e shtetit nuk e ka pasur dhe nuk e ka kurrë këtë mendim.

Sabotuesit, me qëndrimet e tyre dhe me premtimet pa baza, i kanë mbajtur Partinë e shtetin në ankth e në gëzime të kota. Ata thonë «naftë do të ketë», se «kemi vajtur këtu e atje, kemi shpuar kaq e aq puse, nga të cilat pritet të gjenden rezerva naftë» dhe varrosin kë-shtu miliona lekë të popullit!

Në aktivin e kërkimeve të naftës e të gazit këta sabotues e pranuan hapur dhënien e pikave të pastuduara, lëvizjen e sondave sa andej-këtej etj. Nuk mund të priten rezultate pozitive në qoftë se puna u lihet në dorë njerëzve si Koço Plaku, Protoko Murati, Beqir Aliaj apo Milto Gjikapulli. Ky i fundit është i dyshimtë. Duke u kthyer nga Kina për në Shqipëri, ai ka qëndruar në Moskë dhe ka marrë takim me kunatën e tij që është martuar atje. Kur pyetëm për Milto Gjikapullin, na u tha se ai ishte «njeri i mirë», «i zgjuar» e plot llafe të

mirë», «i zgjuar» e plot llafe të tjera. E si qenka i mirë ky njeri, kur mund të jetë edhe agjent i sovjetikëve?! Ç'na hyn në punë neve «zgjuarsia» e tij në këto rrethana?

Nafta është sektori më jetik i ekonomisë së vendit tonë, prandaj nga asnjëri nuk lejohet të nënvleftësohet perspektiva e saj, siç është nënvleftësuar në fakt deri sot. Duhet të hapim sytë, të jemi shumë vigjilentë në këtë drejtim! Puna e Partisë është e shumanshme, ajo nuk duhet t'i nënshtrohet rutinës dhe njerëzit të merren me çfarë t'u dalë përpara, pa vështuar nga e tashmja dhe e ardhmja, pa dalluar atë çka është kryesore nga ajo që është e dorës së dytë. Në metodën tuaj të punës nuk duhet të lejoni t'u zënë sytë gjërat e vogla, sa të mos shikoni problemet kryesore e të rëndësishme që keni. Edhe gjërat e vogla kanë rëndësinë e tyre, prandaj nga të tjerët kërkoni që t'u sinjalizojnë edhe për këto, kur mendojnë se prapa tyre fshihen gjëra me rëndësi, por të mos harroni të mëdhatë.

Për sektorin e naftës ne kemi pasur sinjalizime nga komunistë të thjeshtë, të cilët na shkruajnë, duke u shprehur hapur, se atje bëhet punë armiqësore. Ata ngulin këmbë se për moszbulimin me kohë të këtyre sabotimeve ka përgjegjësi edhe ky apo ai kuadër, duke përfshirë edhe ndonjë anëtar të Byrosë Politike<sup>1</sup>, me emrin e të cilit sabotuesit kanë gënjyer, janë fshehur dhe u kanë mbyllur gojën punëtorëve e komunistëve.

---

1. Siç u provua me fakte, këta ishin armiqtë e Partisë dhe të popullit Abdyll Këllezi dhe Koço Theodhosi.

Këto duhet t'i kuptosh mirë ti, Pirro Gusho; se ke nevojë të mprehësh vigjilencën revolucionare dhe të hapësh sytë më tepër. Në këtë drejtim duhet të jemi të tërë të vëmendshëm. Ne bëmë tërë atë Plenum të Komitetit Qendror për problemet e ushtrisë, po nuk nxorët ju, shokë, mësim të mëdha nga ato ngjarje të hidhura? Partia na ka porositur të kemi besim, po ama dhe të kontrollojmë, të mos ecim si qorrat!

Këto gjëra desha t'ju them. Ju lutem të më falni, se më duhet të largohem. Ju vazhdoni punën!

Punë të mbarë dhe mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

## SECILI TË KRYEJË DETYRËN NË PËRPUTHJE ME PARIMET DHE ME NORMAT E VENDOSURA

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit  
të Kuvendit Popullor të RPSH<sup>1</sup>*

28 shkurt 1975

*Që në fillim shoku Enver Hoxha u interesua se si i zgjidhin disa probleme e detyra këshillat popullorë. Ai bëri pyetje, dëgjoi me kujdes përgjigjet dhe e shndërroi diskutimin e vet në një bashkëbisedim pune me pjesëmarrësit në mbledhje.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Vihen në dijeni që më parë anëtarët e këshillave popullorë për rendin e ditës? U dërgohet materiali para mbledhjes dhe u jepen atyre shpjegime plotësuese rreth tij, kur vijnë në mbledhjen e këshillit popullor? Pse nuk ka nga ana e tyre shumë kritika për punën e komiteteve ekzekutive? Mund të na i thoni arsyet?

---

1. Në pikën e parë të rendit të ditës të kësaj mbledhjeje u diskutua rreth raportit «Mbi punën e organeve të pushtetit në rrethet e Vlorës e të Lezhës për tërheqjen e masave në qeverisjen e vendit».

**SHOKU SIHAT TOZAJ<sup>1</sup>:** E kemi diskutuar edhe në komitetin ekzekutiv, edhe në byronë e komitetit të Partisë të rrethit çështjen e një aktivizimi më të mirë të anëtarëve të këshillit popullor, me qëllim që ata ta ndiejnë më shumë rolin që kanë si përfaqësues të popullit në organin më të lartë të pushtetit në rreth.

**SHOKU ENVER HOXHA:** E ndiejnë ata përgjegjësinë e tyre për rolin që luajnë si këshilltarë popullorë, apo nuk e ndiejnë?

**SHOKU SIHAT TOZAJ:** Përgjegjësinë ata mendoj se e ndiejnë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Pse atëherë nuk aktivizohen? Në qoftë se njeriut, për shembull, i pëlqen një ëmbëlsirë që ka përpara, ai e ha atë me shije. Kur dikush e ndalon ta hajë, duke i rënë duarve me shufër, sigurisht, ai nuk e ha dot. Pse, pra, nuk e hakan «ëmbëlsirën» këshilltarët e rrethit të Vlorës?

Këtu u tha se ata janë me shkollë të mesme, bile ka prej tyre edhe me të lartë, në një kohë që nuk kanë arsim të tillë gjithë punonjësit e aparatit të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit. Kur është kështu, si shpjegohet që punonjësit e emëruar të aparatit të komitetit ekzekutiv janë më të fuqishëm se këshilltarët e zgjedhur prej popullit?!

**SHOKU SIHAT TOZAJ:** Këtu ekzistojnë dy koncepte: ai i mbivlerësimit të vetvetes nga punonjësit e

---

1. Në atë kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Vlorës.

aparatis dhe koncepti tjetër se njerëzit që punojnë nëpër aparate dinë më shumë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Domethënë, sipas këtyre koncepteve dei se aparatet qëndrokan mbi Partinë e mbi pushtetin, komiteti ekzekutiv mbi këshillin popullor dhe byroja e komitetit të Partisë mbi plenumin e rrethit! Në qoftë se kuptohet kjo gjë ndryshe nga ç'po them unë tani, atëherë «ndryshja» do të ishte zbatimi i vijës së Partisë. Është komiteti i Partisë mbi byronë e rrethit, apo byroja mbi komitetin? Është komiteti ekzekutiv mbi këshillin popullor, apo këshilli popullor mbi komitetin ekzekutiv? Si kuptohet kjo çështje me rëndësi parimore, teorike, praktike dhe jetike, të cilën Partia e ka ngritur vazhdimisht? Pse nuk vihet në vend sipas vijës së Partisë dhe ligjeve të shtetit? Çështja duhet kuptuar jo vetëm për t'u shtruar drejt, por edhe për t'u zbatuar drejt në praktikë. Mirëpo jo të tërë e kuptojnë dhe e zbatojnë si duhet këtë. Po s'u kuptua kjo, s'është kuptuar një problem me shumë rëndësi, prandaj duhet punuar seriozisht në këtë drejtim.

Është e vërtetë, siç thatë ju, se opinioni i këshilltarëve është që punonjësit e aparatit i dinë punët më mirë. Këta i njohin vërtet më mirë problemet. Po dua të pyes: Përse ndodh kështu? Sepse drejtuesit e rrethit mbështeten vetëm te punonjësit e aparatit dhe jo te këshilltarët. Duke e nënvleftësuar këshilltarin, ai nuk e ndien nevojën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në qeverisjen e vendit dhe merret vetëm me punën e tij të përditshme. Sigurisht, këshilltari e ka për detyrë të shikojë edhe punën për të cilën paguhet nga shoqëria,

por, ka, gjithashtu, detyrë të shikojë edhe si punon kryetari i komitetit ekzekutiv të rrethit, si ecën i tërë rrethi, se këtë kontroll ai e ushtron në emër të popullit që e ka zgjedhur.

Unë nuk them se aparati nuk duhet përfillur, pasi është lehtë të kuptohet që pa aparate nuk punohet dot, por, theksoj, të mos harrojmë se aparatet janë ato që preken më shpejt nga sëmundja e rrezikshme e burokratizmit dhe bëhen bartëset e saj. Te punonjësit e aparateve vihen re shfaqje të arrogancës, të prepotencës, të megalomanisë. Disa herë prej tyre lëshohen urdhra, të drejtë, por ka raste edhe të padrejtë. Këto shfaqje duhen kuptuar mirë, se, po nuk u kuptuan, nuk do të mund të luftohen me sukses.

A ndryshohen vendimet që merrni ju në komitet, kur këshilltarët bëjnë vërejtje dhe kritika për to? I ndryshoni pikëpamjet, mendimet dhe vendimet tuaja kur, sipas vërejtjeve të këshilltarëve të popullit, ato nuk përputhen plotësisht me kërkesat e jetës, me vijën e Partisë ose me ligjet e shtetit dhe nuk përkrahen nga masat, apo ngulni këmbë në tuajën? Kur këshilltari popullor jep një mendim për diçka që s'është e drejtë, diskutohet ky mendim, hidhet në votë, apo zëri i tij shkon në vesh të shurdhër?

**SHOKU SIHAT TOZAJ:** E vëmë në votë. Në përgjithësi, shoku Enver, ne nuk i imponohemi këshillit, përpiqemi të jemi korrektë edhe në këtë çështje.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të dëgjohet apo jo zëri i këshillit popullor nga ana e komitetit ekzekutiv, nuk është çështje korrekte, po parimore, që ka të bëjë me

kuptimin filozofik, marksist-leninist të karakterit popullor të pushtetit. Me parimin, sigurisht, të jeni korrektë, se e keni për detyrë. Secili duhet të kryejë detyrën e vet në përputhje me parimet dhe me normat e vendosura.

Sa herë në vit mblidhet këshilli popullor në rrethin e Lezhës?

*SHOKU SHAQIR DIBRA*<sup>1</sup>: Katër herë në vit.

*SHOKU AVNI SALIU*<sup>2</sup>: Duke nxjerrë mësimë edhe vetë ne, si organe të pushtetit, nga ngjarjet e hidhura në ushtri, po mundohemi të ngremë punën e aparatit e të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Aparatet na kanë bërë gjëmën në ushtri, prandaj këta organizma dhe drejtuesit e tyre duhet të vihen nën kontrollin e Partisë dhe të masave. Të mos ndodhë kurrë e kundërta, që klasa dhe Partia të vihen nën kontrollin e aparateve e të udhëheqësve. Aparatet nuk duhen lejuar të vishen me «autoritet» të jashtëligjshëm. Nëpunësit e tyre, kur s'punojnë mirë dhe nuk u tregohet vendi për fajet që kryejnë, hiqen si mbretër para njerëzve.

Në qoftë se Partia e drejton pushtetin jo vetëm nëpërmjet funksionarëve, por nëpërmjet gjithë anëtarëve të saj që punojnë në pushtet, kjo do të thotë se ajo nuk përbëhet vetëm nga komitetet dhe aparatet, por nga tërë njerëzit e vet, që studiojnë materialet e Partisë.

1. Në atë kohë kryetar i Këshillit Popullor të Rrethit të Lezhës.

2. Në atë kohë sekretar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Lezhës.



Cilido që e kupton ndryshe këtë problem, është nën ndikimin e burokratizmit. Këto çështje që shprehin botëkuptimin e njerëzve duhen trajtuar thellë në Parti.

Vërtet kryetari i komitetit ekzekutiv drejton punën e pushtetit dhe, meqenëse është anëtar i Partisë, zbaton vijën e saj, por vetëm kaq nuk është e mjaftueshme. Para së gjithash, shteti, si organizatë politike e klasës punëtore, si forcë në duart e Partisë, udhëhiqet jo nga një komunist, por nga masa e komunistëve. Po ta marrim e ta llogaritim Partinë vetëm me udhëheqjen dhe me aparatën e saj, llogaria do të jetë krejtësisht e gabuar. Forca dërmuese e Partisë, e përbërë prej rreth 100 mijë komunistësh, drejton pushtetin, aparatet, punën e këshillave popullorë dhe masat e gjera punonjëse.

*SHOKU RRAPO DERVISHI*<sup>1</sup>: Ne kemi shokë të mirë e të aftë në pushtet, por punët e pushtetit kanë vështirësi, prandaj duhet të përpiqemi së bashku kundër rrezikut të burokratizmit.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Nuk mohohet që kemi shokë të mirë në organet e pushtetit, veçse ngjarjet e hidhura nuk po bien nga qielli, këto vërtetohen këtu në tokën tonë, në Shqipëri.

Ka njerëz që, siç tha shoku Rrapo, e kuptojnë shumë mirë nevojën e luftës së ashpër kundër burokratizmit, ka që e kuptojnë mirë, ka që e kuptojnë disi mirë, ka që e kuptojnë keq, por ka edhe nga ata që

---

1. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Gjirokastrës.

s'e kuptojnë hiç. Këto i thashë për anëtarët e Partisë, por, doemos, kështu ndodh edhe me njerëzit e paorganizuar në Parti.

Doja të shtoja diçka që mbase nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen që analizojmë, por që mua më shqetëson. Flitet shumë për luftën e klasave, si forca kryesore lëvizëse e shoqërisë socialiste, por ne, këtu në Presidium, po shikojmë që në disa fshatra nuk e zhvillojnë mirë atë. Na vijnë disa propozime që njerëz të dënuar të falen, pa e plotësuar dënimin, megjithëse mungojnë kushtet ligjore. E kuptoni ju, shokë, sa i dëmshëm është ky qëndrim kur ka raste që merren në mbrojtje pa të drejtë vrasësi, vjedhësi i pasurisë socialiste apo përdhunuesi e të tjerë? Pa pyetur se vrasësi i ra në qafë barbarisht një shtetasi, se vjedhësi parazit nuk është penduar aspak për aktin e urryer që kreu, mblidhet fshati dhe i propozon Presidiumit për falje! Ky qëndrim i gabuar tregon se Partia në disa fshatra nuk punon si duhet për t'i edukuar njerëzit me ndjenjën e luftës së klasave. Kjo provon se atje janë të theksuara ndjenjat mikroborgjeze të liberalizmit dhe mbeturinat e fiseve, të hatëreve etj.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbalit i mbledhjes së Presi-  
diumit të Kuvendit Popullor,  
që gjendet në AQP*

# INTERPRETIMI DREJT I DISPOZITAVE LIGJORE NUK LEJON QËNDRIME SUBJEKTIVE E ARBITRARE

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit  
të Kuvendit Popullor të RPSH*

28 shkurt 1975

Dispozitat ligjore duhet të interpretohen drejt, sipas frymës së vërtetë të tyre dhe jo në mënyrë subjektive e arbitrare. Në qoftë se ligji është i paqartë ose mund të lihet shteg për dy kuptime, atij t'i bëhet interpretimi autentik nga Presidiumi i Kuvendit Popullor.

Ne duhet t'i kushtojmë vëmendje punës së gjykatave për interpretimin dhe zbatimin e drejtë të ligjeve. Para disa ditësh vajza e shkurorëzuar e një tradhtari më shkruante se e kishte dënuar babanë, se ajo është me Partinë etj. Ish-bashkëshorti e kishte paditur në gjykatë për shkurorëzim dhe gjykata, pasi i ndau, ia merr nga gjiri mëmës vajzën e vogël 11 muajshe dhe ia jep babait, i cili do të martohet nesër dhe nuk do të ketë mundësi ta rritë fëmijën si mëma, që është zor të mar-

tohet më, sepse atë, si xhins i tradhtarit, nuk e merr njeri për grua. «Unë, shoku Enver, nuk kam njeri tjetër veç Partisë dhe juve, — vazhdonte të shprehej letërshkruesja, — por nuk më duket se është e drejtë që t'i merret mëmës foshnja nga gjiri, kur ajo s'ka faj».

Me këtë rast u rekomandova organeve përkatëse ta rishikonin vendimin e gjykatës sipas procedurës së caktuar nga ligji, sepse ligjet e shtetit tonë, që përshkohen thellësisht dhe tërësisht nga fryma e humanizmit socialist, nuk e lejojnë heqjen e fëmijës së vogël nga gjiri i një mëme që nuk është dënuar penalisht për ndonjë krim, që nuk i është hequr e drejta prindërore, që nuk vuan nga ndonjë sëmundje infektive etj. Jeta do të tregojë si do të jetë ajo në të ardhmen, por sa kohë që do të punojë kokulur, si shtetase e republikës, asaj nuk mund t'i mohohen të drejtat e siguruara nga shteti. Sipas mendimit tim, ky qëndrim i nxituar i gjykatës nuk ishte në vijën e Partisë, prandaj shpreha mendimin që gjykata le të vendosë sipas bindjes së saj, por të më njoftojë vendimi që do të merrej për çështjen në fjalë. Në qoftë se, sipas ligjit në fuqi, ankueses nuk do t'i jepej e bija për rritje, unë do t'ia parashtroja çështjen për diskutim Presidiumit të Kuvendit Popullor, i cili, po qe se do të vërente që Kodi i Familjes përmban ndonjë dispozitë ligjore që nuk është e drejtë, do ta korigjonte me siguri atë sipas procedurës së parashikuar me ligj. Pas kësaj u njoftova se gjykata e shkallës së dytë, që kishte shqyrtuar çështjen me kërkesën e

prokurorit, prishi vendimin e gjykatës së rrethit, sepse e gjeti të padrejtë.

Po marr edhe një shembull tjetër: Një grua kishte kërkuar të ndahej nga bashkëshorti që kreu krime të rënda, por gjykata e zvarriti shqyrtimin e padisë së shkurorëzimit! Askush nuk e dëgjoi ankesën e saj kundër zvarritjes së gjykimit. Atëherë ajo më shkroi mua një letër. Kërkonte që unë të ndërhyja dhe të merrja «përgjegjësinë» për zbatimin e ligjit. Dhe unë e mora përsipër këtë «përgjegjësi» për mbrojtjen e ligjit, se jam Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë, se jam komunist dhe e kam për detyrë të kërkoj me këmbëngulje të zbatohet ligji nga cilido.

Një vajzë më shkruante se babai i vet u përjash-tua nga Partia për fajet që kishte kryer. Bashkëshorti i saj, me të cilin ajo kishte lidhur martesën e pakonsu-muar, donte ta shkurorëzonte me anën e një përfaqësuesi të pajisur me prokurë të posaçme. Shkurorëzimi me përfaqësues bëhej se i shoqi ndodhej përkohësisht jashtë shtetit e nuk mund të paraqitej në gjykatë para tre muajve. Babai i bashkëshortit të ankueses, nën presio-nin e opinionit, bëri ç'ishte e mundur që, në bazë të ligjit, të zgjidhej martesë sa më parë me anë përfaqësuesi.

Ligji ynë e njeh edhe të drejtën e ngritjes së pa-disë së shkurorëzimit nëpërmjet përfaqësuesit të paji-sur me prokurë të posaçme, prandaj edhe burri i ankue-ses, sipas porosisë së babait të tij, shpejt e shpejt dër-goj një prokurë për t'u shkurorëzuar me gruan, e cila, sikurse më shkruante, e dënon veprimtarinë e të atit. Kur njerëzit lidhin martesën para zyrës së gjendjes

civile, ligji ynë me të drejtë kërkon paraqitjen personale të bashkëshortëve të ardhshëm, sepse nuk është pranuar të lidhet martesë me përfaqësues dhe pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve. Në kohën e mbretërve të Francës ka ndodhur që, kur deshi të martohesh Luigji i 16-të me Mari Antuanetën. Luigji i 15-të dërgoi në Austri kontin e Gramonit të pajisur me prokurë dhe Mari Antuaneta, pasi hyri në Francë, u prit në një katedrale, ku u bë ceremonia e martesës së saj me Luigjin e 16-të.

Unë pyes: Është e drejtë që ta lidhësh martesën në prani të çiftit dhe ta zgjidhësh atë në mungesë të tij me përfaqësues? Në rast se zgjidhja me përfaqësues është e nevojshme në disa raste kur ka pengesa serioze për paraqitjen e bashkëshortit para gjykatës dhe kur shkurorëzimi duhet bërë sa më parë që të jetë e mundur, këto raste duhet të përcaktohen mirë nëpërmjet interpretimit të ligjit nga organi kompetent.

Kur pyeta nëse e praktikojnë shpesh zgjidhjen e martesës me përfaqësues, më thanë se kjo dispozitë e ligjit zbatohet rrallë. Mirëpo vajzën që më shkroi letër mua, e shkurorëzuan menjëherë, pa e pezulluar gjykimin për tre muaj, sa të kthehej bashkëshorti paditës, që të shpjegohej personalisht me gruan e të thoshte vetë para gjykatës nëse me të vërtetë nuk e donte më atë ose, në të kundërtën, po të bindej se ajo e dënonte sinqerisht babanë e saj dhe kishte shkëputur përfundimisht lidhjet me të, të hiqte dorë nga gjykimi i padisë. Në qoftë se gjatë jetës ajo do të lidhej me babanë, përsëri ai ruan të drejtën e shkurorëzimit. Atëherë pse nuk

pritet që koha të provojë ç'qëndrim do të mbajë bashkëshortja? Eksperiencia jonë ka treguar se njerëzit e mirë e të vendosur janë shkëputur nga të afërmit e tyre kur këta kanë tradhtuar. Ne kemi shembuj të kohës së Luftës Nacionalçlirimtare, kur, megjithëse ndonjë pjesëtar i familjes ishte tradhtar, pjesëtarët e tjerë të saj qëndruan me Partinë. Në raste të tilla Partia ka vepruar drejt, në rrugën e Marksit, ajo nuk i ka braktisur njerëzit pa u dhënë mundësi të provohen në jetë. Ka njerëz që vërtet deklarojnë se u shkëputën nga klasa, por ne nuk duhet as t'u besojmë këtyre me sy të mbyllur, as të shprehim mosbesim të parakohshëm. Koha provon shumë gjëra. Ne u besuam atyre që u provuan në luftë, por duhet t'u besojmë edhe këtyre që japin prova në frontin e ndërtimit të socializmit. Pse, kjo që po bëhet tani, vallë nuk është luftë? Kjo është lufta e klasave, që përbën forcën kryesore lëvizëse të shoqërisë socialiste dhe është më e zorshme nga ajo që bëmë dje.

Një anëtarë partie, që është gjini me një armik, më shkruante se nuk i flet njeri, nuk i japin shtëpi dhe ka mbetur rrugëve. «Vete te xhaxhai, — vinte në dukje ajo, — por edhe ai më thotë: «Vajzë, unë mund të të pranoj në shtëpi vetëm po të më porositë ndonjë udhëheqës!!»». Nuk janë të drejta këto qëndrime braktisëse ndaj njerëzve të pafajshëm vetëm pse ata janë farefis me armiqtë.

U zgjata pak me këta shembuj për të theksuar nevojën e kuptimit dhe të zbatimit të drejtë, në frymë partie, të ligjshmërisë sonë revolucionare dhe për t'u

ruajtur nga sektarizmi. Organet gjyqësore të kenë kujdes në këtë drejtim, se janë porositur edhe herë tjetër.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Presi-  
diumit të Kuvendit Popullor,  
që gjendet në AQP*



## PROBLEMET NUK ZGJIDHEN VETËM NGA APARATET

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

3 mars 1975

Kisha disa vërejtje për çështjen që shqyrtojmë.

Para së gjithash, mendoj se duhet ta kemi të gjithë të qartë që në ushtri ka pasur dhe ka akoma burokratizëm. Ky burokratizëm ka dëmtuar Partinë dhe interesat e mbrojtjes së atdheut. Organizatat e Partisë në ushtri, kuadrot politikë e ushtarakë, duke mos u treguar në lartësinë e detyrave, në disa raste, me dashje apo pa dashje, e kanë ndihmuar burokratizmin. Prandaj, në këto kushte, komunistëve, kuadrove dhe gjithë efektivit në ushtri u vihet si detyrë të luftojnë me të gjitha forcat burokratizmin, këtë armik të rrezikshëm të Partisë sonë. Faktet treguan se burokratizmi në ushtri ishte bërë i rrezikshëm. Po të mos merreshin masa energjike

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për ndërtimin e organeve të aparateve të komiteteve të Partisë dhe të rinisë në ushtri.

kundër tij, ai mund të çonte deri në likuidimin e diktaturës së proletariatit. Situata që ishte krijuar nuk është një përrallë, por një realitet dhe provon se jo kudo dhe kurdoherë organizatat e Partisë në ushtri kanë punuar si duhet.

Duhet të luftojmë me forcë konceptin krejtësisht të gabuar e të dëmshëm, sipas të cilit «Partia janë vetëm aparatet dhe udhëheqja»! Jo! Partia përbëhet nga masa e madhe dhe e organizuar e tërë komunistëve. Në qoftë se kjo masë e gjerë komunistësh nuk i kupton politikisht dhe ideologjikisht vijën, direktivat, parimet dhe normat e Partisë, ligjet e shtetit, si dhe nevojën e domosdoshme të zbatimit në praktikë të tyre, atëherë socializmi në vendin tonë do të rrezikohet. Me këtë dua të them se mendimi që problemet do t'i zgjidhin vetëm aparatet (dhe është për të ardhur keq se ky mendim ekziston te një pjesë njerëzish) është në kundërshtim me ideologjinë e Partisë. Ideologjia jonë marksiste-leniniste na mëson se aparatet (jo vetëm aparatet shtetërore dhe ekonomike, për të cilat flitet zakonisht, por edhe ato të Partisë) preken më lehtë nga burokratizmi dhe bëhen bartëse të tij. Burokratizmi, veç të tjerave, shfaqet edhe në mënyrën e dhënies së urdhrave dhe të shpjegimeve që u bëhen direktivave që lëshohen.

Burokratët na propozojnë që në aparatet e Partisë në ushtri të shtohen edhe shumë njerëz të tjerë, duke kërkuar të dyfishohen dhe, po të lejoheshin, edhe të trefishohen! Ne nuk i zhdukim aparatet, nuk jemi kundër tyre, sepse ato u shërbejnë organeve dhe forumeve pranë të cilave janë krijuar, por a mund të mendohet

se problemet do të zgjidhen vetëm në qoftë se i dyfishojmë njerëzit e aparateve, sikurse na është kërkuar, duke pretenduar se qenkan «lë nevojshëm»?

Teoria dhe eksperiencia jonë e ndërtimit socialist na flasin e na mësojnë shumë për rrezikshmërinë e burokratizmit. Ky burokratizëm dhe shfaqjet e tij duhet të analizohen thellë në ushtri e në terren dhe të luftohen me rreptësi nga organet shtetërore të të gjitha instancave, nga organet ekonomike në industri, në bujqësi e kudo, nga organizatat e masave dhe sidomos nga Partia. Ju, shokë, që jeni ftuar në këtë mbledhje, duke vënë një kuadër këtu, dy atje dhe tre ose pesë gjetkë, kujtoni se bëni një punë shumë të madhe. Pa dashur të mohoj aftësitë dhe eksperiencën tuaj, mund të them se ju nuk i keni kuptuar si duhet rrezikun e burokratizmit dhe burimet e tij.

Burokratët te ne, shokë, nuk duhen kuptuar, shikuar dhe identifikuar siç i përshkruan borgjezia: njerëz me «braca lustrina», që ruanin mëngët e xhaketave, duke i veshur ato me këllëfë prej bezeje, njerëz me gjyzlykë, që nuk lëviznin nga karrigia dhe, që të mos u griseshin pantallonat, i vishnin nga prapa me lëkurë. Tani nuk ka më burokratë të tillë primitivë, sepse, me kalimin e kohës, në kushtet e reja, edhe ata janë modernizuar, prandaj kanë të tjera mënyra veprimi e sjelljeje, të tjera mentalitete.

Burokratizmin, shokë, mos e mendoni si një fenomen të thjeshtë, përkundrazi, ai është tepër i rrezikshëm, sepse pengon çdo gjë të re, çdo gjë revolucionare, çdo zhvillim. Ai shfaqet në rutinën, në indiferen-

tizmin, në letra etj., që frenojnë punën e dobishme e të zhdërvjellët.

Të gjithë ne, shokë, por veçanërisht ju që punoni në ushtri duhet të dini që, në rast se nuk e kuptojmë mirë rrezikun e burokratizmit dhe të burokratëve, kjo do të thotë se nuk kemi kuptuar gjë nga mësimet e Partisë në këtë drejtim.

Lexova një raport dhe nxora konkluzionin se, pa analizuar thellë çështjen, kurrë nuk mund të imagjinohen ai dëm dhe ai sabotim i rëndë e sistematik që i janë bërë punës së Partisë në ushtri nga tradhtarët Beqir Balluku, Hito Çako, Petrit Dume e të tjerë. Para kësaj nuk janë asgjë dreqat dhe darkat që organizonin këta me shokët e tyre. Këto shfaqje të sëmundjes së rrezikshme të burokratizmit në ushtri kishin prekur edhe disa kuadro e komunistë. Puna armiqësore e tradhtarëve synonte ta edukonte këtë masë njerëzish, natyrisht, jo që t'i shërbenin atdheut, por që të shkatërronin makinat, armët, municionet etj. Qëllimet dhe veprimtaria komplotuese dhe puçiste e armiqve në ushtri, që ishin mburrur me ideologjinë reaksionare borgjezo-revizioniste, kamufloheshin edhe në shtratin e ngrohtë të burokratizmit.

Prandaj, shokë, të kuptohet drejt se luftën kundër burokratizmit dhe forcimin e punës së Partisë për edukimin e njerëzve nuk e bëjmë dot duke fryrë aparatet e Partisë e të rinisë në njësi. Në ushtri ka plot komunistë, por a e kryejnë mirë detyrën e Partisë gjithë këta shokë? Si është punuar për të edukuar ata mijëra anëtarë partie dhe dhjetëra mijë të tjerë anëtarë të

Bashkimit të Rinisë në ushtri? Kjo anë e çështjes duhet parë e forcuar, ndryshe nuk do t'ua dalim në krye detyrave të mëdha që na presin. Mos vallë tërë punën e Partisë në ushtri do ta bëjë instruktori i edukimit apo ai i kuadrit? Si është e mundur të shpresojmë që tërë këto probleme që ka ushtria do të na i zgjidhë një instruktor apo një sekretar partie? Jo, kështu nuk duhet menduar! Janë shumë serioze këto gjëra, shokë! Sado të shkriheshin këta në punë, vetëm nuk do t'ia dilnin mbanë me sukses.

Ne kemi komunistë të vjetër me nga 25, 30 e më shumë vite shërbimi si oficerë në ushtri. Këta nuk dinë vallë t'i lexojnë materialet e klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe të Partisë?! Dinë, posi, por ka mjaft prej tyre që nuk i lexojnë me kujdes, nuk i zbatojnë ato si duhet, ose nuk i zbatojnë fare, pse të tillë shokë shikojnë, në radhë të parë, interesat ose dinjitetin personal apo të të afërmeve e të shokëve të tyre dhe marrin nëpër këmbë interesat dhe dinjitetin e shtetit të diktaturës së proletariatit.

Mua më duket se nuk mund të kapërcehen vështirësitë dhe nuk mund të përmirësohet puna e Partisë, atje ku na shkon keq, duke menduar: «Oburra të shtojmë kuadrot!». Direktiva e Partisë është që çdo kuadër komisar duhet të jetë edhe kuadër ushtarak dhe çdo ushtarak të jetë komisar. Në goftë se kuptohet dhe zbatohet mirë kjo direktivë, atëherë nuk ka nevojë të shtohen instruktorë të tjerë për aparatet e Partisë në ushtri, por t'u caktohen qartë detyrat komandantëve dhe komisarëve dhe këta të punojnë për t'i zbatuar me

përpikëri këto detyra. Nuk është me vend t'u thuhet këtyre kuadrove: «Ti, shok, do të merresh vetëm me punën ushtarake, kurse ti tjetri vetëm me punën politike», sepse të dyja i shërbejnë të njëjtit qëllim, këto detyra nuk mund të shkëputen njëra nga tjetra. Prandaj të porositen oficerët që t'i futen me kujdes zërthimit të direktivave të Komitetit Qendror të Partisë përgjithësisht dhe të atyre që kanë të bëjnë me ushtrinë në mënyrë të veçantë, të bëjnë planin e zbatimit të tyre në praktikë, t'u shpjegojnë ushtarëve kuptimin e tyre etj., etj. dhe të shkrihen në punë. Këto porosi të Partisë as oficerët, as ushtarët të mos i harrojnë!

Burokratizmi zhduket vetëm nën kontrollin e rreptë të masave. Po të mos ketë një kontroll të tillë mbi burokratët dhe mbi punën e tyre nga ana e masave punonjëse, burokratizmi do të zhvillohet, familjariteti i sëmurë në mes kuadrove oficerë do të trashet dhe gojët do të mbyllen për t'u fshehur të metat. Po kush është në ushtri masa e ushtarakëve, së cilës u dashka t'i fshihen dobësitë e punës së kuadrove? Kjo masë ushtarakësh është e organizuar në Parti ose në radhët e rinisë. Çfarë të fshehtash paskemi për masën e komunistëve dhe të të rinjve, kur shtrojmë para tyre detyra për forcimin e disiplinës ushtarake, të aftësisë mbrojtëse, për mirëmbajtjen e teknikës luftarake etj.? Asnjë të fshehtë! Armiqtë komplotistë që u zbuluan në ushtri vërtet mbajnin sekret nga Partia dëmtimin e mjeteve luftarake etj., por ata e bënë këtë mbasi druheshin se, po t'u merreshin vesh poshtërsitë që bënë, do ta pësonin, siç e përsuan. Këtë frymë ata e kanë futur prej kohësh në ushtri.

Për këto arsye u arrit deri aty sa në mbledhjet e organizatave-bazë të Partisë ose të rinisë jo vetëm nuk kishte kritikë, por, përkundrazi, u fërkoheshin krahët njërit e tjetrit duke lejuar veprimet që përmenda.

Po përse ia kanë lejuar vetes këto qëndrime organizatat-bazë të Partisë? Sepse kanë ruajtur «dinjitetin» e «zëdhënësve» të burokratizmit! Mësuesit tanë të mëdhenj, Lenini e Stalini, na mësojnë se kontrolli i masave do të rrëzojë nga funksionet që kryejnë edhe njerëz me të kaluar të mirë, por që nuk punojnë mirë. Të kaluarën e tyre duhet ta respektojmë, por burokratizmin e tyre, cilëtdo që të jenë këta, duhet ta luftojmë pa mëshirë. Do të pajtohet organizata-bazë e Partisë apo ajo e rinisë me qëndrimin jo të drejtë të një oficeri, që këtij të mos i bjerë «prestigji» para masës së vartësve? Në asnjë mënyrë! Më parë oficeri duhet të ruajë dinjitetin e Partisë, interesat e popullit e të diktaturës së proletariatit, pastaj veten. E theksoj këtë, sepse te disa oficerë dhe kadro të tjerë, kur kritikohen, vërehet një prekshmëri e tillë në ndjenja, gati-gati si ajo e grave borgjeze, që, po t'i lëndosh një çikë në sdrën e tyre të sëmurë, reagojnë në mënyrë të pahijshme. Qëndrimi përkëdhelës ndaj gabimeve e të metave në punë të kuadrit nuk është aspak marksist. Shfaqjet negative të kuadrove ne duhet t'i luftojmë që në embrion, në rrugën e drejtë që na mëson Partia, dhe të mos lejojmë të ecet siç ka ndodhur në disa raste.

Ushtria ka aparate që, në disa drejtime, e lyp nevoja të jenë më të përqëndruara e më të kufizuara nga

ato të sektorit shtetëror. Por puna armiqësore në ushtri e ka favorizuar dhe e ka ndihmuar aparatën burokratike. Burokratizmi nuk qëndron vetëm te letrat e shkresat, por shfaqet edhe në anë tekniko-ushtarake. Në qoftë se do të orvateshim ta dallonim burokratizmin në të gjitha format e shfaqjet e tij, mund të kishim disa lloje, si, bie fjala, burokratizmi i letrave, i shtetit, i Partisë, burokratizmi tekniko-ushtarak etj. Në qoftë se kundër burokratizmit do të bëhet një luftë e madhe, e ashpër dhe e drejtë, siç e parashikoj të bëhet, do të na duhet një kohë mjaft e gjatë. Lufta kundër tij duhet zhvilluar vazhdimisht e shkallë-shkallë.

Me heqjen nga ushtria të armiqve Beqir Balluku, Hito Çako, Petrit Dume e të tjerë nuk do të thotë se u zhduk burokratizmi nga ushtria. Ai është i gjallë akoma brenda në ushtri, sepse është kultivuar me kohë atje nga tradhtarët.

Atëherë, kush do ta bëjë në ushtri luftën kundër burokratizmit? Si do të zgjidhet ky problem? Unë them se vetëm aparatet nuk mund ta zgjidhin këtë çështje tepër të rëndësishme. Burokratizmi në ushtri shkatërron nga revolucionarizimi i jetës ushtarake, nga revolucionarizimi i ndërgjegjes së ushtarakëve, nga revolucionarizimi i organizatës së Partisë dhe ky revolucionarizim jo me fjalë, por me vepra. Nuk bëhet lufta kundër burokratizmit vetëm me referatin e një instruktori të edukimit. Në qoftë se nisemi nga parimi që punën ideopolitike në ushtri do ta bëjnë vetëm aparatet, shfaqjet burokratike nuk do të zhduken. Edhe oficerët,



ushtarët, komunistët dhe të rinjtë mund e duhet të bëjnë referate dhe t'i mbajnë ato pa qenë të shtyrë nga njeri. Ai që bën referatin të mos teorizojë pa vlerë, por ta lidhë teorinë shumë ngushtë me praktikën, me topin, me pushkën, me ruajtjen dhe me pastrimin e armës e deri te gjërat më të vogla. Një njeri apo disa njerëz, sado të aftë që të jenë, nuk janë në gjendje t'i bëjnë të gjitha punët. Kush i ka topin dhe mitralozat në dorë? Kush i ka raketat dhe prapavijën? I kanë të rinjtë ushtarë, që edukohen nga Partia. I keni shtruar ju çështjet kështu apo jo? Prandaj kërkohen interesim e përpjekje më të mëdha dhe më shumë iniciativë, që leksionet të mos priten vetëm nga lart, por të përgatiten sipas nevojave që kanë shokët në bazë, se kështu këto do të jenë sa më konkrete e të dobishme.

Ushtria jonë është udhëhequr, është përkrahur dhe është ndihmuar nga Partia, e cila, bashkë me popullin, nuk është kursyer dhe ka sakrifikuar e sakrifikon jashtëzakonisht shumë që ushtria të forcohet vazhdimisht. Populli, me Partinë në krye, lufton për të ndërtuar socializmin, por socializmi edhe duhet mbrojtur. Mbrojtja e socializmit dhe forcimi i ushtrisë kërkojnë prapavija të shëndosha. Duhet mbajtur kurdoherë parasysh se nga populli, nga punonjësit e nga shteti i tyre bëhen shumë sakrifica për ushtrinë.

Në raportin që na është paraqitur nuk shikoj të fli-tet gjëkund për burokratizmin dhe për luftën kundër tij. Në të kanë kaluar bile edhe gabime të tilla, siç është shprehja: «Strumbullari i repartit është koman-

danti dhe komisari»<sup>1</sup>! Kjo nuk është as e drejtë, as e vërtetë. Një shprehje e tillë ideologjike është krejt e gabuar. Kush është, pra, atje strumbullari? Pa mohuar aspak rolin e komandantit dhe të komisarit, mund të themi me plot gojën se strumbullari, si kudo, edhe në repart e në tërë ushtrinë është Partia! Mendoj se kjo shprehje që gjendet në raport, juve ju ka kaluar pa u vënë re, por të bëni kujdes, se në dokumentet e Partisë nuk duhet të lejohen terma të tillë, sepse nga njerëzit merren si orientime, bile mund të ndodhë që për to të shkruhet edhe ndonjë artikull në gazetën «Zëri i popullit», prandaj të ruhemi që edhe kur flasim, e jo më kur shkruajmë, të mos bëjmë gabime të tilla. Ne jemi njerëz politikë dhe, duke u nisur nga ideologjia jonë, nuk mund të themi kurrsesi që komandanti dhe komisari na qenkan strumbullari i repartit, sepse, po të pranonim këtë tezë, atëherë do të duhej që të gjithë, pra edhe Partia, t'u bindeshin atyre!

Nuk mund të ecet me koncepte kaq të ngushta, sipas të cilave punët e Partisë kryhen vetëm nga aparatet. Njerëzit e Partisë duhet të ngrihen sa më shumë dhe të punojnë vetë në rrugën e Partisë, të bëjnë referate, të bëjnë mbledhje, të diskutojnë, të kritikojnë, të bëjnë autokritikë, të shpjegojnë problemet e paqarta, të nxitin marrjen e vendimeve të drejta dhe të ngulin këmbë për zbatimin e përpiktë të tyre, ndryshe, nuk

---

1. Ky koncept ka ekzistuar te poliagjenti Mehmet Shehu. Me koncepte të tilla, ai kërkonte të eliminonte rolin udhëheqës të Partisë.

mund të kuptohen aktiviteti dhe lufta në gjirin e një partie revolucionare. Lufta dhe puna e Partisë nuk mund të bëhen me rrogëtarë. Në Parti nuk mund të shtrohet plotësimi i detyrave sipas parimit: «Më paguaj më parë, pastaj të bëj një leksion, një konferencë etj. dhe nuk kam asnjë përgjegjësi në qoftë se nuk më paguan për punën».

Nuk jam në kundërshtim që, siç kemi vendosur, të shtohen disa kadro të nevojshëm brenda efektivit të ushtrisë, prandaj bashkohem me propozimin e shokut Hysni [Kapo], por jam i mendimit që të mos fryjmë aparatet e reparteve, sepse po vërejmë një prirje jo të vogël të fryrjes së tyre, gjë që bën të zhvillohet më tej burokratizmi dhe, për rrjedhim, të na vërtetohen ngjarje jo të mira. Si është e mundur të dekorohet tjetri me titullin e lartë «Hero i Punës Socialiste», kur atij jo shumë kohë më parë i qe bërë vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna, masë kjo që duhej të ishte e pasqyruar në dokumente? Pse nuk pasqyrohen në mënyrë të plotë e të qartë me të mirat e me të metat karakteristikat e kuadrove e të komunistëve?

E kemi thënë disa herë që karakteristikën nuk e bën vetëm punonjësi i kuadrit, por edhe komandanti, komisari, bashkë me oficerët e tjerë, gjithmonë nën kontrollin e Partisë dhe të masës. Komandanti me komisarin nuk përjashtohet që të bien edhe në ujdin e njëri-tjetrit dhe t'i bëjnë kështu vartësit një karakteristikë të bukur, joreale, sikurse vepronte Hito Çakoja. Mirëpo, kur masa e plotfuqishme të fshikullojë me shufër dhe të kërkojë të shkruhet në karakteristikë ai faj

që ka bërë kuadri, komanda ose ju jeni të detyruar ta pasqyroni në dokumente.

Dua të vë në dukje se edhe këtë herë ne pranuar raporte të tilla për ushtrinë me nga 20 e 25 faqe, ku ju keni grumbulluar e keni thënë çdo gjë, por herë tjetër nuk do të lejojmë më të na i përgatitni kaq të gjata. Në materialet ne duam të na paraqiten gjërat kryesore, se prej tyre mund të nxjerrim përfundime më të drejta, por jo si profkat që na servirte Hito Çakoja. Nuk është e drejtë të bëni raporte duke shkruar ç'ju del përpara, sa të mos merret vesh problemi kryesor.

Këto kisha për të thënë për këtë çështje. Më falni për tonin që përdora gjatë diskutimit, por kjo ndodhi se gjendja nuk është në atë masë që duhet kur lexojmë raporte si ky edhe të tjera të këtij lloji për ushtrinë. Duhet t'i futemi thellë kësaj pune. Prandaj, pa hyrë në detaje, mendoj të kapërcehen këto pengesa, duke praktikuar një stil e një metodë pune më të mirë. Ndryshe nuk ka si ecet përpara.

Unë do të përpiqem që Byroja Politike dhe Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë të largohen nga gjërat e vogla, se këto bëhen pengesë për të parë çështjet kryesore. Me hollësitë e problemeve, që nuk i takojnë Byrosë apo Sekretariatit të KQ të Partisë, duhet të merren dhe t'i zgjidhin shokët që u takojnë. Sa probleme që keni për të zgjidhur vetë ju, nuk duhet të na i sillni neve këtu. Kështu si është vepruar me këtë material, nuk po marrim vesh çfarë kërkoni ju prej nesh, çfarë doni të vendosim ne Sekretariati i Komitetit Qendror. Ç'është kjo metodë raportimi në udhëheqje?!

Vetë ju, shokë, mos mendoni se jeni në gjendje t'i shikoni personalisht të gjitha gjërat dhe me të tëra hollësitë e veçoritë. Të jeni të sigurt se, sado të zotë që të jeni, nuk mund të pretendoni se i zgjidhni në mënyrë të përsosur të gjitha çështjet, në qoftë se ato nuk i shikon tërë Partia, duke përdorur metodat e saj të drejta, luftarake, revolucionare. Shikimi i çështjeve, duke marrë parasysh instancat që i shqyrtojnë, nuk mund të bëhet kudo njëlloj, prandaj këtu, në udhëheqje, duhet të na vijnë gjërat kryesore, nga të cilat duhet të shikojmë si ka vendosur Partia në bazë dhe çfarë mund të vendosim ne këtu. Edhe vendimi që do të marrim varet shumë nga mënyra se si na ekspozohet problemi nga ana juaj. Prandaj, mendimi im është që këto probleme t'i shikojmë.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Për Ushtrinë Popullore» (Përmbledhje veprash), vëll. II, Tiranë, 1984, f. 283*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Për Partinë»  
(Përmbledhje veprash), vëll.  
i 3-të, f. 234*

# TE NDIHMOHET EFEKTIVISHT FSHATI PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT TË NENËS DHE TË FËMIJËS

*Diskutin në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

3 mars 1975

Si janë përpjesëtimet e mjekëve pediatër me ata të specialiteteve të tjera? Këtu u tha se për mbrojtjen e shëndetit të nënës e të fëmijës punojnë qindra kuadro. Po çfarë janë këta kuadro? Sa prej tyre shërbejnë në qytet e sa në fshat? Pse janë më shumë mjekë në qytet, kur dihet se popullsia më e madhe është në fshat?!

Arsyeja që u tha këtu se «në qytet kemi spitalet e pediatriisë» mua më duket se nuk qëndron plotësisht. «Kemi rehatllëkun në qytet», duhej thënë më drejt, dhe në fshat lejohet të ketë gjithë ato të meta në shërbimin shëndetësor! Sado e hidhur, e vërteta mbetet

---

1. Në këtë mbledhje u mor në shqyrtim edhe raporti i paraqitur nga Ministria e Shëndetësisë «Mbi masat për zbatimin e detyrave të Plenumit të 11-të të KQ të PPSH për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve».

ajo që është. Fjalët e tua<sup>1</sup> nuk e ndryshojnë dot realitetin. Ju mund të jeni duke përgatitur kuadro, por përpjesëtimet dhe shpërndarja e tyre duhet të jenë sipas nevojave të popullsisë. Pediatri të vejë atje ku është shumica e fëmijëve dhe jo atje ku ka rehatllëk. Të mos na ndodhë edhe në sektorin e shëndetësisë si në ndonjë sektor tjetër, ku me qindra veta, mbasi mbarojnë shkollën e pasi kryejnë shërbimin ushtarak, nuk kthehen më në vendin e punës ku ishin.

*Pasi diskutuan edhe shokë të tjerë, shoku Enver Hoxha tha:*

T'i vihet efektivisht në ndihmë fshatit për mbrojtjen e shëndetit të nënës dhe të fëmijës e jo vetëm të hidhen parulla për ngushtimin e dallimeve thelbësore midis qytetit dhe fshatit. Si mund të ngushtohen këto dallime, duke pasur në qytet një nivel jetese dhe shërbim shëndetësor shumë më të mirë sesa në fshat? Kush punon në punët më të rënda, gruaja në qytet apo ajo në fshat? Sigurisht që gruaja në fshat. Dështimet dhe lindjet e parakohshme të fëmijëve janë më të shumta në qytet apo në fshat? Atëherë përse grumbullohen mjekët në qytete? Për këto probleme që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me shëndetin e nënës dhe të fëmijës, duhet t'i nxjerrim më mirë konkluzionet.

Në ç'masë i përdorin punonjësit e shëndetësisë injeksionet që u bëjnë grave për të evituar lindjet e parakohshme? A i kanë në sasinë e duhur këto injeksio-

---

1. I drejtohet Llambi Ziçishtit, në atë kohë ministër i Shëndetësisë; më vonë u dënua nga gjyqi i popullit për veprimtari armiqësore.

ne? Sa prej tyre përdoren në qytet e sa në fshat? I them këto, sepse mjeku i fshatit tonë, si mjek i një vendi socialist, duhet të jetë i pajisur me gjithçka të nevojshme për të ushtruar profesionin e tij. Prandaj të gjitha mjetet dhe medikamentet e nevojshme duhet t'ia japim për përdorim edhe fshatit. Sigurisht, diçka edhe fshatit i jepet, por duhet parë sa është kjo «diçka» në ndihmë të shëndetit që i jepet fshatit në krahasim me qytetin.

Ju shokë të Ministrisë së Shëndetësisë na thoni se «i plotësojmë të gjitha kërkesat e fshatit». Ne e dimë sa kërkesa bëhen nga baza dhe sa prej tyre nuk ka mundësi të plotësohen. Të na thoni «nuk kemi mundësi», këtë ne e pranojmë, se e dimë që kuadrot e mjeteve të nevojshme akoma i kemi të kufizuara, por të pretendoni se kërkesat që bëhen nga fshati i plotësoni, këtë nuk mund ta pranojmë, se në fakt nuk është plotësisht kështu.

Shokët e Ministrisë së Shëndetësisë duhet të njihen me ligjet tona, sidomos për ato çështje që u takojnë t'i dinë. Të marrim të drejtat që ka me ligj gruaja shtatzënë. Në bazë të ligjit për sigurimet shoqërore shtetërore, gruas punëtore ose nëpunëse, sipas vjetërsisë në punë, i paguhen 70-85 për qind të pagës mesatare të muajit të fundit për paaftësinë e përkohshme në punë. Për kohën që kjo është me lejen e barrës dhe të lindjes, sipas vjetërsisë në punë, merr 75-95 për qind të pagës mesatare mujore të tre muajve të fundit të punës para fillimit të shtatzënësisë. Ndërsa në fshat gruaja kooperativiste përfiton më pak. Meqenëse gratë në fshat pu-



nojnë në kushte më të vështira se ato të qytetit, në këtë drejtim duhet menduar thellë, si komunistë, që të bëhen korrigjimet e nevojshme duke i ngushtuar këto diferenca<sup>1</sup>.

Derisa shteti ynë socialist, duke u përpjekur që gratë punëtore dhe nëpunëse t'i lindin dhe t'i rritin fëmijët sa të jetë e mundur më mirë, me ligjin për sigurimet shoqërore shtetërore u njeh dhe u siguron atyre ndihmën materiale për lejen e barrës dhe të lindjes, duhet që këtë trajtim, për analogji, ta kuptojnë mirë dhe, me sa kanë mundësi, ta japin për gratë shtatzëna edhe kooperativat bujqësore. Kjo do të thotë që pushimi e ndihma të jepen jo në momentin e fundit, kur gruaja do të lindë, por disa javë para lindjes dhe disa javë pas lindjes, sipas ligjit. Aq më keq kur ndodh që gruas shtatzënë në kooperativë nuk i jepet edhe leja që i takon. Më kanë thënë se, gjatë vitit 1974, 3 100 gra kooperativiste nuk kanë marrë fare lejen e shtatzënisë. Pse lejohet një gjë e tillë? Të drejtat që i takojnë me ligj gruas në fshat duhen respektuar medoemos si nga kryesitë e kooperativave bujqësore, ashtu dhe nga vetë ato. Nga ana tjetër, ç'kuptim do të kishte leja që merr gruaja shtatzënë, kur ndodhin raste që ajo vërtet s'punon në kooperativë, por punon gati deri në ditën e lindjes në oborrin kooperativist?

Kolektivi i kooperativistëve, i udhëhequr nga Par-

---

1. Në bazë të ligjit mbi pensionet për anëtarët e kooperativave bujqësore, gruaja kooperativiste, gjatë lejes së shtatzënisë e të lindjes, përfiton 80 për qind të të ardhurave mesatare ditore që ka realizuar gjatë vitit të fundit kalendarik.

tia, të kuptojë se, për ato pak gra që janë shtatzëna dhe që duhen ndihmuar docmos, nuk prishet kooperativa sikur këto të punojnë, ta zëmë, 80-90 ditë më pak dhe për këtë periudhë kohe të paaftësisë të përfitojnë edhe ndihmë materiale. Me një mobilizim pak më të madh të të gjithë anëtarëve të tjerë të kooperativës, kjo e fundit nuk do të dëmtohet, po të veprohet sikurse thashë më sipër. Po të bëhet kjo, atëherë ndihma për grupin e fshatit do të jetë më e ndjeshme.

Në organizimin e ndihmës mjekësore dhe në shpërndarjen e personelit të shërbimit mjekësor kam përshtypjen se nuk po ecet drejt. Ku venë këta mjekë që përgatitni ju, shokë të shëndetësisë? Futen nëpër spitalet e qyteteve, siç janë futur?! Shikojeni këtë punë me sy partie, me sy revolucionar. Ndërtohen spitale të mëdha në qytete, duke menduar se këtu do të kurohen edhe qytetarët, edhe fshatarët. Kjo nuk është e drejtë. Këtu në Tiranë duhet të kemi spitale me aparatura speciale, ku të shtrohen të sëmurët rëndë që duhet të kurohen nëpërmjet këtyre aparaturave të veçanta. Të tjerët le të shtrohen në spitalet e rretheve ku banojnë.

Kemi të dhëna që në shumë raste spitale tona të mëdha janë kthyer në hotele për disa të vetëquajtur të sëmurë! E kemi thënë shumë herë se kjo nuk duhet të ndodhë. Disa masa janë marrë në këtë drejtim, por, sidoqoftë, përsëri duhet treguar kujdes që asnjëri të mos qëndrojë në spital më shumë nga sa ka nevojë.

Në qytete duhet të bëjmë spitale, po këto të jenë me një madhësi të studiuar mirë, duke caktuar dhe kri-

teret, se cilët mund të shtrohen aty, sa kohë duhet të qëndrojnë zakonisht sipas llojit dhe shkallës së përhapjes së sëmundjes. Po kështu të caktohen edhe rregullat se kush mund të vejë në ambulancat për t'u mjekuar e për të marrë pushimin për paaftësi të përkohshme. Edhe mjeku, herë pas here e jo çdo ditë (se ka sëmundje që s'ka nevojë të mbikëqyren çdo ditë), sipas rastit, duhet të shkojë në shtëpi të të sëmurit për të dhënë këshillat dhe ndihmën e nevojshme.

Për t'i ardhur më tepër në ndihmë fshatit, lidhur me parandalimin dhe shërimin e sëmundjeve, të disponohen fonde të posaçme e të krijohen qendra shëndetësore. Natyrisht, jo në çdo fshat e kooperativë të bashkuar ka mundësi të dërgohen edhe mjek patolog, edhe pediatër etj., por shërbimi shëndetësor në fshat duhet organizuar në këtë ose atë formë jo më pak e më keq se në qytet. Kjo gjë është e domosdoshme, sepse nuk mund të vejë, për shembull, grua shtatzënë e fshatit të largët për t'u vizituar në konsultoren e qytetit, duke bërë një udhëtim të vështirë që është i dëmshëm dhe i pamundur për të.

Na përmendni se numri i mamive është shtuar<sup>1</sup> dhe sot ato shërbejnë në çdo fshat. Mirëpo janë në gjendje këto që ta trajtojnë e ta ndihmojnë si duhet foshnjën që u vjen në duar? Kanë aftësi ato ta mësojnë nënën për regjimin që duhet të mbajë gjatë barrës dhe lindjes? Ç'ndryshime shihen efektivisht pas vajtjes së ma-

---

1. Në vitin 1986 në fshat shërbenin 2 836 mami me arsimitë mesëm.

mive në fshat në uljen e dështimeve, të vdekjeve të fëmijëve, në higjienën e nënës e të fëmijës etj.? Gjithashtu duhet parë si punojnë ato, rrinë e presin vetëm në maternitet, apo janë vajza të gjalla e revolucionare dhe venë shtëpi më shtëpi për t'u mësuar grave ato që dinë vetë. Duhet ndjekur nga afër dhe konkretisht puna e tyre, prandaj duhet të bëhet njëfarë kontrolli.

Ulja e vdekjeve në fëmijë është një tregues i mirë, veçse kjo çështje nuk duhet parë në përgjithësi, por konkretisht. Mjeku pediatër apo gjinekolog, natyrisht, mund të luajë një rol të madh në edukimin e shtetasve me ndjenjën e kujdesit për ruajtjen e shëndetit të nënës dhe të fëmijës, por rolin kryesor në këtë fushë e luajnë vetë nëna dhe opinioni shoqëror në kooperativë. Këto gjëra, përveç Partisë, nuk mund t'i rregullojë e t'i sjellë në vijë sa duhet asnjë mjek. Nëna duhet të bëjë një kujdes të madh ndaj fëmijës jo vetëm para se ajo të lindë, por edhe pas lindjes. Duhet një luftë këmbëngulëse dhe e vazhdueshme nga ana e Partisë për të mbrojtur nënën dhe fëmijën, që janë burimi i jetës. Kësaj çështjeje i është vënë rëndësi dhe në këtë drejtim janë arritur suksese, por ekzistojnë akoma shumë mbeturina të vjetra, që pengojnë përparimin.

Një nga mbeturinat që na pengon për ruajtjen e shëndetit të nënës dhe të fëmijës është moskuptimi i mirë i rëndësisë së qëndrimit ndaj gruas. Ne nuk duhet të mendojmë se gruaja, sidomos në fshat, trajtohet mirë dhe sipas ligjeve të shtetit e frymës njerëzore të Partisë. Unë mendoj se për këtë çështje në fshat duhet të bëjmë analiza më të thella e të arrihet në konkluzione

e detyra për të përmirësuar rrënjësisht gjendjen. Duhet të njohim se një rol negativ në këtë drejtim luan besimi fetar, i cili në shekuj ka kultivuar përcëimin e gruas nga burri, gjurmë që shfaqen edhe sot në njerëz të veçantë.

Në radhë të parë është e domosdoshme të formojmë koncepte të drejta e të qarta në kokën e fshatarit, i cili të ketë respektin e duhur për gruan dhe për foshnjën që ajo mban në bark, të kuptojë se ç'duhet bërë që ajo të lindë fëmijë të shëndetshëm dhe ta rritë këtë. gjithashtu, të shëndoshë. Këto koncepte duhet t'i krijojmë jo vetëm te burri i saj, por në gjithë masën e fshatarëve. Për këtë qëllim të bëhet një propagandë intensive, e cila të shoqërohet me masa konkrete për krijimin e të gjitha kushteve të nevojshme që u vijnë efektivisht në ndihmë nënës dhe fëmijës në fshat. Në fund të fundit mamia ka një detyrë të caktuar, një funksion shoqëror e teknik, por në këtë çështje kanë të bëjnë edhe gjëra të tjera që lidhen me punën që kryen gruaja kooperativiste. Në qoftë se kjo, kur është shtatzënë, merr pjesë në procese pune të tilla, si mbledhja e pambukut, prashitja e duhanit etj., ku kërkohet të qëndrojë në shumë në pozicion të përkulur, atëherë gruaja ka rrezik që fëmijën ta lindë para kohe. Prandaj, nuk duhet hequr vëmendja nga këto gjëra, që nuk janë të thjeshta e teknike, sikurse duken në pamje të jashtme, por, para së gjithash, janë probleme shoqërore, me karakter ideologjik e politik dhe që ndikojnë për të ardhmen e vendit tonë.

Natyrisht, nuk shërohet çdo gjë vetëm me ilaçet që

përdoren, kërkohet edhe një edukatë e shëndoshë massive, që t'u kundërvihet mentaliteteve prapanike dhe të krijojë një ndjenjë më njerëzore në qëndrimin ndaj gruas, ndaj nënës. Këtë punë ne duhet ta bëjmë mirë dhe këtu ka një fushë të gjerë veprimi për personelin shëndetësor, për organizatat e masave, veçanërisht për Bashkimin e Grave. Partia t'i vërë më shumë në lëvizje të gjitha levat e saj, me qëllim që në të ardhmen të arrijmë më tepër rezultate në drejtim të mbrojtjes së shëndetit të nënës e të fëmijës, sidomos në fshat.

*Botuar për herë të parë,  
me ndonjë shkurtim, në  
librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1974-1975»,  
f. 120*

*Botohet i plotë sipas tekstit të  
nxjerrë nga procesverball i  
mbledhjes së Sekretariatit të  
KQ të PPSH, që gjendet  
në AQP*

# NË KUSHTE TË QETA DEMOKRACIA E PARTISË ËSHTË MË E GJERË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

3 mars 1975

Siç dihet, komiteti i Partisë është në fuqi dhe ushtron kompetencat e dhëna për atë kohë sa është zgjedhur nga konferenca e Partisë. Kur është e mbledhur konferenca e Partisë, gjithë punën e drejton kjo, si organi më i lartë në rreth.

Megjithëse kur mbledhet konferenca, nuk funksionon më plenumi i komitetit të Partisë, prapëseprapë mbetet aparati i Partisë me sektorët përkatës, si ai i kuadrit, i edukimit, i statutit etj., që disponojnë të dhëna e materiale të nevojshme për konferencën. Sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit ka të drejtë të thotë në konferencën e Partisë mendimin e tij për punën e

---

1. Në këtë mbledhje, midis të tjerash, u diskutua edhe për nevojën e disa ndryshimeve që i duhen bërë shtojcës së udhëzimit «Mbi zhvillimin e zgjedhjeve të organeve udhëheqëse të Partisë».

kuadrove, sikurse edhe çdo komunist tjetër, që është zgjedhur delegat në konferencë, ka të drejtë të flasë për punën e sekretarit të parë.

Po kështu, për analogji, kur mbledhet kongresi i Partisë, Komiteti Qendror nuk i ushtron më kompetencat e tij si forum. Kështu ish-Sekretari i Parë i Komitetit Qendror, ish-anëtari i Byrosë Politike, apo ish-sekretari i Komitetit Qendror të Partisë ka të drejtë të shfaqë mendimin e tij për të gjitha propozimet që bëhen në përfaqësi ose në kongres. Këta mund të thonë se vërtet është propozuar për t'u zgjedhur në forumin e Partisë ky apo ai shok, por të dhënat që kemi ne për të janë të tilla. Secili nga anëtarët e forumit, që bie nga fuqia kur mbledhet kongresi, mund të thotë se, gjatë gjithë periudhës që ka qenë i zgjedhur në komitet shoku që propozohet, nuk e ka merituar me punën dhe me qëndrimin e tij besimin e kongresit apo, sipas rastit, të konferencës, duke parashtruar edhe arsytet.

Të gjitha parimet ideologjike e organizative i vendos Partia. Edhe parimet që udhëheqin procedurën e zgjedhjeve të organeve udhëheqëse të Partisë i vendos Partia, e cila vepron në mënyrë krejt demokratike. Para këtyre parimeve të gjithë komunistët janë njësoj. Por demokracia, në raport me kohën kur zbatohet, ka disa kufij. Ka demokraci që lidhet me momentet krejt të qeta, kjo demokraci është më e gjerë. Ka demokraci që nevojisht bëhet më e shtrënguar, pra është disi e kufizuar nga rrethanat që mund të krijohen. Ka dhe demokraci shumë të shtrënguar, kjo ndodh atëherë kur vendi është në gjendje lufte. Në një situatë të tillë reak-



sioni të madh nuk ka kohë të mblidhen organet e Partisë, sikurse veprohet në kohë paqeje, prandaj plotësimi i vendeve vakante të organit të Partisë nuk bëhet normalisht me zgjedhje, por me kooptim prej vetë këtij organi ose nga lart dhe kur bëhet mbledhja vihen në dijeni shokët.

Në praktikë, sidomos po ta vështrojmë çështjen nga ana psikologjike, ne ruajmë diçka nga mënyrat e vepërimeve të kohës së luftës, sepse, në përgjithësi, ai që dominon në zgjidhjen e problemeve është mendimi i udhëheqjes. Mendimi i udhëheqjes, sikurse na mëson marksizëm-leninizmi, është i nevojshëm dhe i dobishëm, prandaj duhet marrë në konsideratë, por Partia na e ka bërë të qartë se mbi mendimin e masës së komunistëve, mbi mendimin kolegjial të Partisë s'ka asnjë mendim tjetër dhe, pa marrë këtë mendim, nuk mund të vendoset për çështjen e rëndësishme. Çdo praktikë e ndryshme nga sa përmenda nuk është e pranueshme.

Edhe në zgjedhjet e komitetit të Partisë duhet të zbatohet rigorozisht ky parim. Secili komunist, që është tani ose ka qenë më parë në udhëheqje, ka të drejtë të thotë mendimin e tij se ky apo ai anëtar i udhëheqjes ka punuar keq dhe nuk e meriton të zgjidhet më anëtar i komitetit të Partisë, ashtu sikurse mund të thotë për ndonjërin që është shok i mirë, ka punuar shumë mirë etj. Mund të ngrihet ndonjë tjetër dhe të thotë të kundërtën: që kjo nuk është e vërtetë. Dhe kështu fillon debati. Kësaj i thonë demokraci.

Anëtarët e forumeve mund dhe duhet të jenë të mirë; prirja e të gjitha organeve udhëheqëse të Partisë

ka qenë e tillë që në to të vijnë njerëz të mirë, që në përgjithësi kanë punuar pa u lodhur, por, po të flasim për një procedurë zgjedhesh demokratike, siç duhet të jetë në konditat aktuale, del se kjo praktikë që ndiqet nuk është shumë demokratike, sepse është më tepër shprehje e vullnetit të drejtuesve, ka frymën e burokratizmit të tyre dhe frymën e diktimit nga lart.

Sipas procedurës së zgjedhjeve, që kemi miratuar ne, deri tani kandidaturat e mundshme janë paraqitur me lista të përgatitura më parë nga aparati i komitetit të Partisë dhe këto kandidatura u janë dhënë për diskutim delegatëve në bazë zone. Atje janë lexuar emrat dhe pastaj kanë votuar, duke mos e lexuar fare karakteristikën e atyre shokëve që kanë qenë të zgjedhur. Vetëm për ndonjë shok që nuk ka qenë më parë në udhëheqje është kërkuar t'i lexohet karakteristika.

Me ndryshimin që propozohet t'i bëhet shtojcës së udhëzimit «Mbi zhvillimin e zgjedhjeve të organeve udhëheqëse të Partisë», lihen të lira organizatat-bazë që të propozojnë ato kandidatura, të cilat do t'u duken më të përshtatshme. Për sa i përket numrit të kandidaturave të mundshme, ky mund të caktohet si orientim para propozimeve në organizatë. Në qoftë se nga organizata e uzinës «Traktori», për shembull, ku duhet të paraqiten dy kandidatura, u paraqitën katër, s'prishet ndonjë punë, se këta do të shohiten në përfaqësi.

Propozimet për kandidaturat që bëjnë organizatat-bazë nuk i përjashtojnë komitetet e Partisë nga kjo e drejtë. Mendoj se të zgjedhurit në forumin e Partisë, që japin llogari në konferencë, kanë të drejtë të disku-

tojnë si ish-anëtarë të zgjedhur të udhëheqjes së Partisë dhe si anëtarë të Partisë. Po kush tjetër ka të drejtë të flasë në përfaqësi? Këtu kanë të drejtë të flasin të gjithë shokët dhe shoqet, duke gjykuar jo nga llafet, por nga vetë jeta e komunistit, nga dokumentet e tij që ka aparati i Partisë, pra nga njohja e përditshme në jetë e në punë e kandidatit që propozohet. Çështjen e së drejtës të komitetit të Partisë për të propozuar kandidatura mund ta shikojmë edhe në Byronë Politike, po qe se nuk do të konkludojmë këtu në Sekretariat.

Propozimet që do të bëhen për zgjedhjen e shokëve, të cilët do të bëjnë pjesë në forumet e Partisë, duhet të jenë të tilla që të sjellin në udhëheqje njerëz besnikë, të ndershëm, të aftë e revolucionarë, që mund të kryejnë detyrën e drejtuesit të punës së Partisë në rreth. Ne kemi me mijëra anëtarë partie që mund të zgjidhen në organet drejtuese, por ai që do të zgjidhet në plenumin e komitetit të Partisë duhet të dalë nga zjarri i luftës revolucionare për zbatimin e vijës së Partisë, të ketë një të kaluar të mirë, të jetë me kapacitet e me cilësi të tjera të shquara.

Mund të ndodhë që ndonjë nuk është dakord me kandidaturën e propozuar. Kjo është demokratike. Në këto raste do të thuhet edhe arsyet. Sekretari i parë i komitetit të Partisë të rajonit, në emër të komitetit të Partisë, mund t'u thotë komunistëve të një organizate se për ç'arsye ata nuk e propozojnë kandidaturën, për shembull, të një shoqeje. Me këtë rast ai përmend cilësitë e saj, duke vënë në dukje se e shikon me vend që ajo të jetë kandidate për anëtare komiteti. Ai me

këtë rast mund t'i pyesë komunistët se çfarë të metash ka shoqja për të cilën diskuton, me qëllim që t'i vihen asaj në dukje e t'i korigjojë. Ka rëndësi të dihet se për ç'arsye nuk do të propozohet, për shembull, për sekretar i komitetit të Partisë ai shok që njihet si i mirë. Natyrisht, në mbledhje e konferenca do të ketë edhe të deleguar, që do të ndihmojnë në zgjidhjen e drejtë të këtyre çështjeve.

Kandidaturat e shokëve që propozohen për t'u zgjedhur në organet udhëheqëse të Partisë të diskutohen dhe të votohen në mënyrë demokratike, sikurse përcakton Statuti i Partisë. Me procedurën që është në fuqi, kjo gjë nuk po zbatohet mirë në praktikë. Ashtu siç e kishim vendosur në zgjidhjen e kësaj çështjeje, mund të ketë qenë e drejtë për një periudhë, po për periudhën e tanishme mund të mos jetë më e drejtë.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Për Partinë» (Përmbledhje veprash), vëll. i 3-të, f. 229*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Për Partinë»  
(Përmbledhje veprash), vëll.  
i 3-të, f. 229*

## **DUHEN LUFTUAR PA MËSHIRË BUROKRATIZMI, TEKNOKRATIZMI DHE INTELEKTUALIZMI**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**5 mars 1975**

Dëshiroj të shpreh edhe unë mendimet e mia për problemin që kemi marrë në shqyrtim, mendime këto, shumica e të cilave puqet me ato të të gjithë shokëve që diskutuan sot. Çka do të them është në vazhdim të dy materialeve që kanë marrë shokët e Byrosë Politike po për çështjen e naftës.

Komiteti i Partisë i Rajonit të Naftës Patos-Marinzë, në mbledhjen e tij speciale të datës 24 shkurt 1975, mori në analizë konkluzionet e kontrollit punëtor të ngritur nga organizata-bazë e prodhimit e Kallm-Vërrisë dhe, pasi analizoi punën në këtë rajon e nxori përgjegjësitë për gjithë punonjësit e naftës, midis të tjerash, thotë:

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për analizën që i bëri Këshilli : Ministrave gjendjes së rëndë në industrinë e naftës.

«Përgjegjësi për këto ka dhe Ministria e Industrisë dhe e Minierave, e personalisht Koço Theodhosi, i cili është njohur me problemet e Kallm-Vërrisë, me lëvizjet e padrejta të sondave dhe nuk ka marrë masa për eliminimin e tyre.

Koçoja nuk ka ushtruar kontroll, por i ka quajtur të mirëqena studimet e veprimet e institutit dhe të Drejtorisë së Përgjithshme, duke pasur tek ata besim të tepruar. Megjithëse ka ardhur disa herë në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në institut, nuk ka nxjerrë që më parë konkluzione të drejta për metodën e drejtimit, të kërkimit dhe të shfrytëzimit racional të vendburimeve ekzistuese. Koçoja asnjëherë nuk ka ardhur dhe të shtronte probleme në Komitetin e Partisë të Rajonit të Naftës Patos-Marinzë».

Ky që thashë është rezultat i kontrollit punëtor që u bë në këtë rajon të naftës. Se ç'do të thonë më tej punëtorët, kur të vihen në dijeni për vendimin, të tërë e marrim me mend, kjo do të thotë se ata nuk do të qëndrojnë me kaq.

Koço Theodhosi, si pjesëtar i këtij forumi të Partisë dhe si ministër i Industrisë dhe i Minierave, ka përgjegjësi shumë të rëndë për mosrealizimin e planeve në naftë dhe për sabotimin në këtë sektor. Varet tash si dhe sa kuptohet prej tij kjo përgjegjësi. Për mua auto-kritika që bëri këtu nuk jep asnjë garanci që ai ta ketë kuptuar thellë këtë gjendje.

Përgjegjësia e shokëve të Komisionit të Planit të Shtetit dhe e Abdyl Këllezit duket sikur nuk ekziston. Në fakt, Abdyl ka përgjegjësi të rëndë, se të vesh disa

herë rresht në naftë dhe të mos zbulosh të metat, nuk është diçka e thjeshtë. Unë kam përshtypjen se Abdyl Këllezi hiqet si një perëndi e paprekshme, si njeri që i njeh në themel të gjitha çështjet ekonomike. Me një fjalë, në qoftë se do të veprosh drejt në çështjet ekonomike, duhet pyetur Abdyl Këllezi, kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit. Mirëpo, atëherë, për këto që kanë ndodhur, si nuk paska përgjegjësi ai? Megjithatë, Komisioni i Planit të Shtetit nuk ka bërë asnjëherë autokritikë, qoftë edhe në mënyrë tangente. Abdyl Këllezi kurdoherë vetëm kritikon. Të tërë shokët e udhëheqjes, kur venë në bazë dhe pyeten nga kuadrot atje për të bërë ndonjë gjë, vijnë këtu, e diskutojnë çështjen me shokët. pastaj dërgojnë përgjigje. Ndryshe vepron Abdyl. Kështu, te shokët e rretheve është krijuar mendimi i gabuar se Abdyl Këllezi t'i rregullon punët në vend, se, siç u tha këtu me të drejtë, ai ua jep milionat. Mirëpo veprime të tilla nuk janë në rrugë partie. Këto veprime prej kapadaiu nuk duhen lënë të kalojnë kësh-tu, se pastaj na ngjasin gjëra të rënda.

Ne e kemi dëgjuar shumë herë Abdylin të na thotë se u ka rekomanduar punëtorëve në naftë të mos hedhin shumë argjil etj. Ai përmend fjalë të tilla «teknike» që punëtorët të thonë: «Shiko, aq shumë marrka vesh shoku Abdyl për naftën, sa nuk na e merrte mendja». Dua të them se ne nuk duhet të mbajmë qëndrime të tilla kur vemi para shokëve dhe njerëzve të thjeshtë. S'është gjë e mirë të punosh për t'u dukur.

Shtetit i humbën me qindra milionë lekë të rinj dhe fusha të reja nafte nuk iu dhanë vendit. Kjo do të

thotë se kemi humbur kështu disa vjet e do të na duhen akoma disa të tjerë për të fituar kohën e humbur dhe çmimi i tonit të naftës do të na dyfishohet. Ky sabotim na bëhet në momentet më të rënda të një krize të madhe që po kalon bota për naftë. Gjatë kësaj kohe ne do të detyrohemi të importojmë karburante me çmime të larta.

Si mund ta shpjegojmë këtë sabotim? Pse duhet ta cilësojmë kështu? Le të flasim me gojën e atyre që na kanë sabotuar naftën, të cilët thonë: «Naftë ka, për këtë nuk ka asnjë dyshim!».

I pyesim:

— Po pse s'na jepni fusha dhe naftë?

— «Sc kemi harruar detyrat kryesore, jemi marrë me çikërrima»!

— Përse e keni bërë një gjë të tillë?

— «Kemi bërë gabim, bëjmë autokritikë»!

— I keni bërë si duhet përgatitjet e fushave?

— «Jo, nuk i kemi studiuar me kujdes, kemi dhënë pika shpimi të pastudiuara, kemi ecur nga një vend në tjetrin me sonda etj.».

— Po pse e keni bërë këtë?

— «Gabim kemi bërë, e njohim».

— Cili ka qenë orientimi i Partisë për kërkimet?

— «Orientimi ka qenë të nisemi nga e njohura në të panjohurën».

— Po ju, atëherë, pse vepruat ndryshe?

— «Po ja, e bëmë, gabim».

— Konsultoheshit për këto probleme të mëdha me Partinë, me punëtorët, me bazën?



— «Jo shumë, nganjëherë aspak».

Kur sabotatorët vajtën në Sarandë të jepnin llogari përpara kolektivit për dështimin, Koço Theodhosi ka thënë: «Mos e acaroni çështjen me ta, nuk është nevoja të krijohen fërkime». Kur iu vu çështja në Qeveri nga Paskal Sinani, që e dëgjoi vetë, Koçoja tha: «Nuk më kujtohet». Kjo «nuk i kujtohej» as drejtorit të përgjithshëm të naftës, Lipe Nashit, dhe as Beqir Aliajt, drejtor i Institutit të Naftës!

Mirë, mund ta pranojmë atë që thotë Koçoja, se nuk i kujtohet ajo thënie në Sarandë, po gjithë puna e tij gjatë këtyre 4-5 vjetëve vërteton pikërisht atë që atij «nuk i kujtohet» ta ketë thënë në Sarandë. Asnjë fërkim, asnjë kontradiktë nuk ka pasur ai me drejtuesit e sektorit të naftës. Faktet tregojnë se këta kanë bërë si kanë dashur, kanë vepruar në kundërshtim me orientimin e Partisë, s'kanë pasur disiplinë shkencore dhe kontroll të rreptë, çdonjëri prej tyre kishte «teorinë» e tij, kurse shteti nuk kishte naftë!

Koço Theodhosi, si anëtar i Byrosë Politike dhe ministër i Industrisë dhe i Minerave, që është përgjegjës për zbatimin korrekt të vijës së Partisë në këtë sektor jetik të vendit, ç'emër i vë kësaj pune që është zhvilluar në naftë jo incidentalisht, jo një vit, po pesë vjet me radhë? Edhe sot këtu ai nuk ia vuri akoma gishtin kësaj. E pyes Koçon: «Këtë çështje që pamë dhe analizuan sot, përse nuk e pamë një vit apo dy vjet më parë?». Këtu ka disa arsye të mëdha dhe anësore, që së bashku kanë influencuar.

Koçon «e vret ndërgjegjja», po nuk është e mjaft-

tueshme të të vrasë ndërgjegjja dhe sidomos pasi dëmtohen interesat e Partisë dhe të shtetit nga një punë e tillë armiqësore që vazhdon prej 4-5 vjetësh.

Është mirë kur shoku bën autokritikë për gabimet që ka kryer, por, sidomos për një udhëheqës kryesor, është më mirë të bëjë më pak gabime dhe aspak gabime të rënda dhe parimore.

Çdo komunist, kur bën autokritikë, mendoj se duhet t'i analizojë thellë problemet ku janë vërtetuar gabime e ku ai vetë ka gabuar dhe cilat janë shkaqet që e kanë shtyrë të gabojë. Atëherë autokritika ka vlerë për personin, për Partinë, për punën. Ta përmbledhësh autokritikën në disa formula stereotipe «Kam faj, kam gabuar, s'kam qenë vigjilent, kam besuar» etj., etj. nuk ndihmon gjë, e lë problemin pa zgjidhje të plotë dhe jo vetëm për problemin në fjalë, por edhe për probleme të tjera për analogji.

Mjaft herë problemet, zgjidhjet e tyre dhe mësimet që nxirren prej tyre, merren dhe mbeten të shkëputura, bëhet sikur ato përgjithësohen, por në fakt nuk përgjithësohen dhe nuk kryhen si duhet analiza edhe në sektorë të tjerë. Partia bën përgjithësime dhe askush nuk mund të na akuzojë se këto përgjithësime janë lakonike e të thurura shtrënguar. Ne të kundërtën po bëjmë, po e zgjatim përgjithësimin dhe e ilustruam atë me shembuj që s'ka ku vete më tutje. Kurse gjatë zbatimit në praktikë të këtyre formulimeve, këto i kthejmë pikërisht në formula stereotipe dhe slogane.

Kështu Partia, jo një herë, po vazhdimisht, ka folur dhe ka shpjeguar normat e saj, ligjet e saj dhe të klasës,

ç'është klasa punëtore, ç'është shteti, ç'është administrata shtetërore, ç'është diktatura e proletariatit, ç'është dhe si duhet të bëhet lufta kundër burokratizmit e kundër teknokratizmit. Ta kemi të qartë, Partia të gjitha këto nuk i ka anoncuar si formula të thata, por i ka zhvilluar dhe është udhëhequr kurdoherë nga teoria jonë marksiste-leniniste. Po ashtu marksizëm-leninizmin Partia jonë e ka bluar në kokë e në gjak dhe e ka zbatuar në kushtet e vendit tonë. Kur them në kushtet e vendit tonë, kuptoj një sërë gjërash dhe për këto gjëra, që kur u formua dhe deri tash, në periudha të ndryshme, Partia ka përcaktuar strategjinë e vet të drejtë, ka caktuar taktika të ndryshme, por që i shërbenin strategjisë, ajo ka përcaktuar, gjithashtu, programet e saj. Këtu ne duhet t'i gjejmë bazat e fitoreve të mëdha dhe të vazhdueshme të Partisë që ndërton me sukses socializmin.

Mirëpo kjo eksperiencë e madhe e Partisë duhet studiuar thellë dhe jo përciptazi, duhet studiuar së bashku me teorinë e klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe të verifikohet nën dritën e kësaj teorie. Si bëhet kjo punë që është me rëndësi kolosale? Kjo bëhet, ka rezultate, por ka dhe shumë të meta. Të metat kryesore janë studimi vetëm libresk, pa e lidhur atë me praktikën e pa e verifikuar me teorinë dhe këtë anasjelltas me praktikën, por mjaft herë duke përsëritur slogane.

Le të marrim dy çështje: luftën kundër burokratizmit dhe luftën kundër teknokratizmit. Këto çështje kushedi sa herë dhe me dhjetëra vjet të tërë janë shtruar nga Partia. Këto janë shtruar edhe nga ana

teorike, edhe nga ana e rrezikshmërisë së tyre në praktikë. A u bëhet luftë këtyre dy të këqijave të rrezikshme për Partinë, për ideologjinë e saj dhe për ndërtimin e socializmit? U bëhet, por jo sa duhet dhe jo si duhet, nuk ka akoma koncepte të qarta ideologjike për këto dy çështje. Kjo ngjet jo se nuk është shtruar, por se nuk thellohen shokët. burokratizmin ata e quajnë si një fenomen thjesht praktik: «Bëhen shumë shkresa, bëhen shumë mbledhje, dhe këto të gjata, zgjidhen problemet me urdhra nga zyra, janë fryrë disa organika etj. dhe merren e jepen urdhra për t'i penguar ato». Këto janë dhe duhet bërë luftë kundër tyre, por çështjet të kuptohen më thellë, pse bëhen këto gjëra dhe pse përsëriten derisa arrijnë të bëhen të rrezikshme për Partinë dhe për ekzistencën e socializmit.

Për të ilustruar këtë rrezikshmëri të këtyre dy të këqijave të kombinuara, burokratizmit dhe teknokratizmit, për të mos folur për punën armiqësore të Fadil Paçramit, le të marrim punën armiqësore në ushtri dhe atë që vërtetohet në sektorin e naftës.

Në dokumentet e Partisë, që në kohën e luftës, flitet kundër burokratizmit; atëherë, natyrisht, jo shumë, flitet ngandonjëherë për intelektualizmin, por pak dhe aspak për teknokratizmin. Që kur u çlirua Shqipëria dhe deri tash, lufta kundër burokratizmit, intelektualizmit dhe teknokratizmit në këto dokumente vjen vazhdimisht duke u shtuar, duke u ashpërsuar. Kjo nga ana teorike dhe praktike dialektikisht është e shpjegueshme.

Në kohën e luftës, në kushtet kur ne luftonim në

mal, kur nuk kishim akoma në dorë pushtetin, kur nuk zotëronim veçse pushkën, në radhët tona nuk shtrohej çështja e luftës kundër burokratizmit. Edhe çështja e intelektualizmit as që shtrohej në atë kohë dhe ca më pak ajo e teknokratizmit, pse edhe Ushtria jonë Nacionalçlirimtare nuk vuante atëherë nga oficerë të karrrierës, burokratë dhe teknokratë. Për sa i përket burokratizmit në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare, vetë karakteri i saj nuk lejonte të zhvillohej një e keqe e tillë, pse Partia edukonte dhe kërkonte shkathtësi në kulm në çdo gjë, në mendim, në veprim, që çdo gjë të kryhej në kohën e caktuar, debatet shterpe dhe llogjet e kota atëherë nuk lejoheshin. Lufta Nacionalçlirimtare nuk ishte një ndërmarrje as e vogël dhe as e thjeshtë dhe, po të mos ishte Partia Komuniste e Shqipërisë në krye të saj, me një ideologji të qartë, me një strategji dhe taktikë të drejtë, burokratizmi mund ta pengonte luftën dhe ata intelektualë që ishin ose edhe fshatarësia me karakterin e saj mikroborgjez mund t'i nxirrnin vështirësi dhe pengesa Luftës Nacionalçlirimtare. Kjo nuk ngjau, se Partia ishte plotësisht në udhëheqje. Asnjë forcë armike, e jashtme dhe e brendshme, nuk mund ta lëkundte atë.

Me çlirimin e Shqipërisë dhe me marrjen e pushtetit Partia qëndroi dhe qëndron e patundur në ballë, në udhëheqje.

U ndërtua pushteti i ri i këshillave, u krijua aparati shtetëror, lindi tok me të edhe elementi i burokratizmit, që duhej luftuar. Ata shokë që duan të studiojnë dokumentet e Partisë, mund të konstatojnë se menjë-

herë pas Çlirimit filloi të flitej kundër burokratizmit dhe, sa kohë që kalonte që nga ditët e para dhe deri tash e më shumë, më ashpër është folur dhe po flitet kundër burokratizmit, kundër intelektualizmit dhe kundër teknokratizmit.

Bujqësia u zhvillua me sukses dhe me luftë në rrugën e socializmit. Industria u zhvillua, gjithashtu, me sukses dhe me luftë. Arsimi dhe kultura u zgjeruan me sukses. Partia krijoi inteligjencien e re, teknikën e re, teknologjinë e re, agroteknikën moderne, bëri organizime të shumta të ndërmarrjeve të ndryshme, pushteti u zgjerua, u forcua etj. në të gjitha drejtimet. Këto u arritën vetëm në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë. Socializmi po ndërtohet me sukses dhe ky ndërtim na ka armatosur me eksperiencë për të dalluar anët e dobëta dhe rreziqet që e kërcënojnë atë. Për ta bërë këtë luftë me sukses Partia duhet të jetë në krye, pse, po humbi Partia vigjilencën, atë e mbulon «skleroza» që quhet burokratizëm, teknokratizëm, intelektualizëm dhe të këqija të tjera me origjinë mikroborgjeze, revizioniste, kapitaliste, që çojnë në shkatërrimin e socializmit e të diktaturës së proletariatit.

Ne analizuam gjerësisht ç'na ngjau në ushtri, ku kishim kuadro të luftës dhe një organizatë të madhe partie. Atje lulëzonin burokratizmi dhe teknokratizmi me brirë, kurse Partinë në ushtri e kishte zënë gjumi, asaj i kishin zënë frymën, përpara syve të saj shkeleshin ligjet e Partisë, ligjet e diktaturës dhe nga disa përgatitëj komploti për të shkatërruar socializmin.

Ç'na ngjet tash në sektorin e naftës? Atje lulëzojnë,

gjithashtu, burokratizmi, intelektualizmi dhe teknokratizmi. Partisë dhe klasës në naftë u kanë zënë frymën, ato i kanë neutralizuar. Dhe Ministria e Industrisë dhe e Minierave, me Koço Theodhosin në krye, rri e bën sehir një situatë të tillë.

Kur e pyeta Koçon se si i konsideron ai këto drejtori që na i përmendi këtu, u përgjigj se «ato janë drejtori që duhet të luajnë rol». Këto, ashtu siç po punojnë tani, janë të gjitha organizma burokratikë, punë zyre. Ç'është kjo? A nuk është burokraci?! Pikërisht në këtë kuptim e them dhe unë se shokët e drejtorisë së kuadrut të ministrisë nuk kanë vajtur në bazë që të shikojnë se si punojnë kuadrot. Ne jemi anëtarë të Byrosë Politike dhe duhet t'i kuptojmë mirë këto që themi. Në ministri ka drejtori të financës, po çfarë ka konstatuar kjo drejtori kur në sektorin e naftës po hidhen kot me miliona lekë? Çfarë del nga kjo?

Kur thuhet se «në ministri kemi drejtori për çështjet e tjera», del sikur fajin për mungesën e një drejtorie naftë në ministri duhet ta ketë dikush tjetër! Mirëpo ti Koço vetë ke qenë dakord për shkëputjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Naftës.

Ti the se Beqir Aliaj nuk jepte kurrë llogari. Po të isha unë në vendin tënd, atë do ta kisha fluturuar që tre vjet më parë e do t'i thosha: «Qërohu këtej!».

Çfarë bëhet kur një njeri nuk jep llogari dhe nuk çan kokën as për Partinë?! Përse nuk e ke hequr Beqir Aliajn nga detyra? Në sqarimet që po na jep s'ka logjikë, ato janë kontradiktore. Tani gjete një version tjetër «shpjegimi», meqenëse ajo që the në Qeveri se

«nuk mban mend të kesh folur për shuarjen e debateve», është zor të besohet.

Përse janë nënvleftësuar shtresat ranore gjatë këtyre katër vjetëve?! Kur këtë gjë nuk na e shpjegon ministri i Industrisë dhe i Minerave, atëherë kush do të na e thotë? Në qoftë se li ngre çështjen që shtresat ranore janë nënvleftësuar «për arsye teknike», unë këtë tezë ta rrëzoj vetëm me argumentin e thjeshtë që Shqipëria ka jetuar 25 vjet duke shfrytëzuar naftën e shtresave ranore, bile me mjete teknike shumë më primitive se ato që kemi sot. Është e vërtetë teoria se gëlqerorët kanë rezerva naftë, por të thuash se shtresat ranore nuk kanë naftë, kjo nuk qëndron! Ju kërkoni «copa» të mëdha, prandaj tërë ranorët që japin nga 30 dhe 40 tonë naftë në vit ose në pesëmuajor, sipas jush, nuk duhen!

Që një sërë njerëzish në sektorin e naftës janë drejtpërdrejt përgjegjës, që Koço Theodhosi dhe ndihmësit e tij kanë fajë dhe përgjegjësi, që edhe shokë të tjerë kanë edhe ata përgjegjësinë e tyre, kjo është e qartë. Po vallë u zgjidh çështja duke ndarë këto përgjegjësi dhe duke dhënë disa dënime? Jo, mendoj unë. Mua më duket se duhet ta analizojmë thellë çështjen, në anën teorike të problemeve.

Si në çështjen e ushtrisë, ashtu edhe në atë të sektorit të naftës nuk duhet t'i gjykojmë gjërat vetëm nga ana faktike dhe teknike, por, të bazuar në këto, të nxjerrim konkluzione teorike. Tradhtarët në ushtri kishin dy qëllime që mund të quhen kardinale: të likuidonin Partinë si parti marksiste-leniniste në fuqi dhe të ndryshonin strategjinë e luftës së Partisë. Këto ishin



dy qëllimet e tyre kryesore. Për këto u përpoqën dhe përdorën një sërë taktikash që të pengonin masat ushtarake e t'i shndërronin ato në veprime ushtarake kundër strategjisë së Partisë sonë dhe pro strategjisë së tyre tradhtarë. Strategjia e Partisë sonë është: «Ta mbrojmë atdheun me çdo kusht e në çdo rrethanë nga një sulm ose nga sulme të kombinuara armiqsh dhe t'i asgjësojmë ata; armikut të mos i lëshojmë asnjë pëllëmbë tokë pa luftë». Strategjia e tradhtarëve është e kundërta: «T'i lëshohet vendi armikut dhe të kapitulohet para forcës së tij».

Nga këto dy strategji të kundërta do të lindte edhe konflikti në mes masave dhe programeve ushtarake të Partisë, që do të bënin të triumfante strategjia e saj në rast sulmi nga armiku, nga njëra anë, dhe masave e programeve sabotuese që zhvillonin tradhtarët Beqir Balluku, Petrit Dume. Hito Çako, nga ana tjetër, për t'ua kundërvënë atyre të Partisë. Këta armiq arritën për një kohë të gjatë të vepronin dhe kjo për arsye se organizata e Partisë në ushtri këto probleme nuk i shikonte në prizmin e ideologjisë së vet, por lejoi që problemet kardinale të shikoheshin në ushtri gjoja nën prizmin e ideologjisë marksiste-leniniste, kurse në realitet ato shikoheshin nën prizmin burokratik dhe teknokratik ushtarak.

Ç'na treguan faktet? Letra e Hapur e Komitetit Qendror, që ishte një dokument në radhë të parë teorik dhe si çdo gjë i përkiste Partisë të vinte në zbatim ato që përmbaheshin në të, u trajtua në formë burokratike, heqja e gradave u pa formalisht, kurse tërë buokra-

tizmi i aparateve ushtarake, me të gjitha karakteristikat e tij, qëndroi jo vetëm në fuqi, por haptazi i diktonte Partisë urdhrat dhe vendimet e veta.

Burokracia ushtarake nuk konsistonte vetëm në letra dhe në fryrjen e aparateve, por ajo bazohej në teknokracinë ushtarake. Kjo teknokraci, në kuptimin më të keq të fjalës, dominonte mbi çdo gjë. Nuk janë vetëm fjalët e Hito Çakos që e vërtetojnë këtë që thoshte se «Pa Parti unë mund të bëj, po pa shtab nuk mund të bëj». Ky ishte një koncept i tërë i huaj filozofik antimarksist, sipas të cilit dituria ushtarake, teknika ushtarake, armët janë mbi çdo gjë. «Njeriu, politika më parë se arma» ishte për puçistët dhe pasuesit e tyre vetëm një formulë e zbrazët.

Organizatat e Partisë në ushtri ecnin nën kamxhikun e burokratëve dhe të teknokratëve. Këto dy prirje, dy plagë, dy sëmundje të rënda, që dokumentet e Partisë i rrahin, i godasin ashpërsisht në çdo faqe të tyre, e kishin vënë në ushtri filozofinë e Partisë sonë në gjumë, në gjunjë. Kush e përfaqësonte këtë burokratizëm dhe teknokratizëm ushtarak? Vallë vetëm pesë-gjashtë veta? Jo, këta janë kryesorët, por rrënjët janë më thellë, janë më të gjera, janë në një botëkuptim filozofik të shtrembër që është krijuar dhe që është përhapur te kuadro të ushtrisë dhe tek ushtarë. Një formim i tillë në koncepte është shumë i rrezikshëm. Rrezikshmëria e tij mund të gjykohej kur arrihet deri atje sa Partia dhe kuadrot, brenda në një nga armët e diktaturës së proletariatit, siç është ushtria, të mos reagojnë dhe të pranojnë pa i ndëshkuar ata që thoshin

«Ç'më duhet mua Partia, mua më duhen shtabet» ose kur, jashtë ligjeve të Partisë, suprimohen dhe denigrohen komisarët.

Si në ushtri, edhe në sektorin e naftës, njerëzit harruan rolin vendimtar të Partisë në çdo gjë, ata harruan se ajo është udhëheqja e çdo gjëje, dhe jo një udhëheqje formale, pasive, por aktive. Pa partinë marksiste-leniniste në udhëheqje të klasës punëtore nuk mund të ekzistojë diktatura e proletariatit, nuk mund të ekzistojë pushteti popullor dhe të ndërtohet socializmi. Është lehtë të thuhet një formulim i tillë, por ky duhet kuptuar thellë dhe duhet luftuar vazhdimisht për ta vënë në jetë dhe për ta mbrojtur nga një sërë rreziqesh që marksizëm-leninizmi na i mëson cilat janë, që mësimet e Partisë dhe eksperiencia e madhe e saj na i vë çdo ditë në dukje. Këta armiq të Partisë janë të brendshëm dhe të jashtëm, janë të hapët dhe të maskuar. Komunistët duhet të edukohen që t'i dallojnë dhe t'i luftojnë ata.

Faktet tregojnë se Koço Theodhosi, dhe si ai ka edhe të tjerë në ministrinë ku punon, edhe si komunist e ca më keq si anëtar i Byrosë Politike, nuk edukohet sa duhet, nuk mëson teorinë tonë për veprim dhe nuk thellohet në mësimet dhe në eksperiencën e Partisë. Koçoja dhe gjithë të tjerët që përmenda, nuk e kanë kuptuar se nafta s'është vetëm një çështje teknike, por është një çështje partie, është një çështje ideologjike. Edhe vendet kapitalisto-revizioniste nuk i shpëtojnë këtij ligji, për ta nafta, para se të jetë një çështje teknike, është një çështje politike, dominimi, shfrytëzimi,

skllavërimi i të tjerëve. Teknika vihet në shërbim të kësaj strategjie të armikut.

Në vendin tonë, ku udhëheq Partia, edhe kjo ka, gjithashtu, strategjinë e vet — ta bëjë naftën një armë në duart e shtetit të proletarëve për të ndërtuar socializmin dhe për ta mbrojtur atë nga rreziqet që i turren nga rrethimi kapitalisto-revizionist.

Mirëpo Koço Theodhosi nuk është thelluar në këtë problem jetik dhe gjithë organizimin, mjetet, kërkimet i ka lejuar të futen në rrugën e tmerrshme të burokratizmit dhe të teknokratizmit, të cilët i kanë mbytur Partinë dhe klasën punëtore në sektorin e naftës, i kanë bërë inoperuese, i kanë shmangur nga drejtimi dhe nga objekti strategjik i tyre. Teknokratizmi ka dominuar në drejtuesit e sektorit të naftës dhe në ministrinë ku drejton Koçoja. Ç'thoshin teknikët bënte ai. Po kush ishin këta teknikë që komandonin? Ç'karakteristika kishin ata? Kjo nuk e shqetësonte as Koçon, as organizatën e Partisë të sektorit të naftës; këta ishin për ta teknikë «të zotë» të një problemi «me të panjohura të mëdha» dhe kaq. Në sektorin e naftës, që e drejton Koçoja, ka lloj-lloj idesh të mira dhe të këqija, ka kuadro që ngrihen në mbledhje dhe në prezencën e tij thonë se «Në Institutin e Naftës ka punë armiqësore», por Koços, anëtarit të Byrosë Politike, aq i bën, ai as që alarmohet, bile përpiqet të shuajë edhe debatet, duke qenë i ndërgjegjshëm që për vite me radhë naftë nuk po zbulohet dhe plani nuk realizohet!

Koços, kur bëhen organizime, as i shkon ndër mend të ketë parasysh që këto, siç na mësojnë Partia,

ideologjia dhe eksperiencia e saj, duhet të jenë të thjeshta, operuese dhe joburokratike. Kur bëhen organizime dhe fryhen e shumëzohen organikat, atëherë gjendja është mjaft e rrezikshme. Koçoja, në vend që të marrë masa, është i kënaqur që sektorin e naftës e drejton tjetërkush, pa u thelluar se ky drejtim bëhet në rrugën armiqësore dhe të sabotimit. Dhe krijimin e këtij «trusti» të naftës që e kanë mbytur burokratizmi dhe teknokratizmi, ai e merr si shembull për të krijuar të tilla «truste» në sektorë të tjerë që varen nga Ministria e Industrisë dhe e Minerave. Ai krijon kështu një burokratizëm nga të katër anët.

Po ta pyesësh Koçon «E ke shkurtuar numrin e punonjësve në ministri?», ai të përgjigjet me siguri: «Po». Mirëpo kur numëron që jashtë ministrisë janë krijuar drejtori mbi drejtori, atëherë do të dalë që personeli jo vetëm nuk është shkurtuar, por përkundrazi, është tre dhe katërfishuar. Dhe përgjigjja vjen shpejt: «Janë zgjeruar punët». Unë këtë e di, por di dhe një gjë tjetër që më mëson Partia: duhen luftuar pa mëshirë burokratizmi, teknokratizmi dhe intelektualizmi.

«Po unë s'jam kundër që ta bëjmë këtë luftë», mund të më thotë Koçoja. Mirëpo faktet nuk e vërtetojnë këtë. «Duhet ta bëjë Partia këtë luftë», mund të thuhet, gjithashtu. Dakord, por duhet ta mësojmë dhe ta lejojmë organizatën e Partisë që ta bëjë këtë luftë. Ka organizatë partie në sektorin e naftës dhe organizatë partie që duhet të jetë nga më të mirat, sepse është në gjirin e klasës punëtore. Por kjo organizatë

partie në këtë sektor është shtypur nga burokratizmi, nga teknokratët, që në bazë dhe deri në ministri. Vetëm në byronë e Partisë të Institutit të Naftës ka 3 tekno-kratë dhe një teknik të mesëm, pra asnjë punëtor. Atëherë, kush vendos atje? Këtu qëndron tragjedia. Klasa dhe Partia flasin, propozojnë, kritikojnë, po askush nuk i përfill, askush nuk i dëgjon. Ligjin dhe vijën atje, more Koço, i zbatojnë të tjerët, që janë bartës të pikëpamjeve antiparti dhe antisocialiste. Jo vetëm nuk dëgjohen Partia dhe klasa, po shkohet deri atje sa Koço Theodhosi, anëtar i Byrosë Politike, jep rekomandimin që të mos ndizet debati në Parti dhe në punëtorë! Kështu nuk u priset qetësia atyre që sabotojnë. Këto, që them, Koço, janë çështje serioze, janë çështje teorike dhe nuk duhet të lejojmë që t'i marrë era. M'i kundërshto, po të jenë të gabuara, dhe, në qoftë se këto që po them ti nuk i peshon, je i lirë të studiosh klasikët tanë dhe të m'i kundërshtosh, por të siguroj se këto që them, i kam të bazuara në teorinë marksiste-leniniste të Partisë sonë dhe në eksperiencën e saj.

Ti, Koço, ke përgjegjësi të rëndë për këtë punë të ligë që është zhvilluar në sektorin e naftës, për të cilën meriton dënim të rëndë. Dënimi i rëndë dhe i merituar do të jetë heqja jote nga Byroja Politike dhe nga udhëheqja e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave. Ky është mendimi im, pse nuk e vërtetove me punë besimin që të ka dhënë Komiteti Qendror.

Ti, Koço, duhet të japësh prova se e ke kuptuar këtë faj të rëndë. Këtë duhet ta kuptosh e ta analizosh

thellë e jo ta shohësh në mënyrë sentimentale, të gjesh arsytet e këtyre ndodhjeve dhe të gabimeve të tua, sepse vetëm kështu do t'i korigjosh e do të ringjallësh dhe ne për këtë luftojmë. Në këto situata traumat, njëra pas tjetrës, nuk janë të mira, por ne nuk mund të vëmë në barazim interesat e mëdhenj të Partisë e të popullit me disa njerëz, cilëtdo qofshin këta, duke i lejuar që të dëmtojnë këta interesa të lartë, pa i ndëshkuar.

Për sa u përket disa drejtuesve të sektorit të naftës, ata janë elementë armiq dhe sabotatorë. Faktet që kemi për ta janë të qarta dhe me punën tonë ne do t'i bëjmë akoma më të qarta. Mendimi im është se shpejt do të vërtetohet çdo gjë për sabotimin konkret që është bërë dhe kam bindjen se do të gjejmë naftë, se ka.

Përveç këtyre që thashë, duke shqyrtuar këto fenomene, na dalin përpara edhe probleme të tjera ideologjike dhe organizative, në të cilat organizata e Partisë e sektorit të naftës nuk thellohet sa duhet, shumë herë atë e mbulon euforia. Kjo nuk duhet lejuar, se ka rreziqe.

Nuk duhet lejuar të harrohet, në radhë të parë, roli i Partisë. A ka mundësi të harrohet një gjë e tillë jetike? Po, ka mundësi të zbehet ky rol, të harrohet dhe të luftohet. Kjo mund të bëhet haptazi ose në mënyrë konspirative, por edhe padashur, pa e kuptuar. Këto raste të fundit e kanë burimin në studimin përciptazi të teorisë së Partisë, në mosvënien në zbatim drejt e në mënyrë revolucionare të kësaj teorie në gjithë gamën politike, ekonomike, organizative, arsimore, kulturore, ushtarake etj.

Çdo gjë, çdo veprim, çdo mendim duhet të shihet në prizmin e ligjeve të Partisë. Partia drejton çdo gjë dhe ky drejtim nuk është dhe nuk mund të kuptohet fiktiv, por është real. Nuk mund të fitonte populli, nuk mund të vendosej pushteti popullor, nuk mund të ekzistojë dhe të veprojë diktatura e proletariatit, nuk mund të ekzistojnë dhe të veprojnë administrata shtetërore dhe Qeveria pa udhëheqjen, pa drejtimin efektiv të Partisë. Të gjitha këto, një nga një dhe së toku, janë çështje kapitale të teorisë sonë. Këto probleme, teorike dhe praktike, nuk janë të reja për Partinë tonë, ajo u udhëhoq nga këto parime që kur u themelua dhe, duke kaluar dekada e dekada, i mësoi dhe i zbatoi edhe më mirë. Prandaj po e ndërtojmë me sukses socializmin.

Po socializmi nuk është ndërtuar plotësisht dhe nuk mund të vazhdojë të ndërtohet dhe të perfeksionohet pa luftën e klasave. Derisa ekziston lufta e klasave, kuptohet se nga dikush duhet bërë luftë kundër dikujt, se luftojnë dy klasa, klasa punëtore në aleancë me fshatarësinë, nga njëra anë, kundër borgjezisë kapitaliste me imperializmin dhe me revizionizmin social-imperialist, por edhe kundër mbeturinave të klasës feudo-borgjeze të vendit, edhe kundër helmit dhe ideologjisë së saj në ndërgjegjen e njerëzve, nga ana tjetër. Këtë luftë duhet ta udhëheqë Partia dhe ta bëjë tok me masat, me të gjitha format dhe në të gjithë sektorët.

Çështjet parimore që përmenda më lart, edhe lufta e klasave, duhet të bëhen objekt i një studimi të thellë dhe të vazhdueshëm që të kuptohen si në teori



dhe në praktikë. Pse duhet bërë kjo? Se edhe brenda në Parti zhvillohet lufta e klasave. Të gjithë komunistët, që kanë taserën e Partisë në xhep, nuk janë të prerë me një thikë. Ka anëtarë partie që e dinë teorinë, orientohen drejt, e zbatojnë atë me kujdes dhe mendojnë megjithatë se duhet të mësojnë gjithë jetën që t'i shërbejnë gjithnjë e më mirë Partisë. Ka të tjerë anëtarë që njohin teorinë, por jo në themel, dhe ndiejnë një vetëkënaqësi. Ka edhe anëtarë partie që dinë disa gjëra përciptazi, ka më së fundi nga ata që s'interesohen fare për të mësuar etj. Me një fjalë, ka dhe do të ketë vazhdimisht disnivele në ngritjen e anëtarëve të Partisë. Në përgjithësi, më shumë ka që mbështeten në një praktikizëm të madh në krahasim me anëtarët e Partisë të formuar si duhet, ideologjikisht dhe politikisht, dhe që dinë ta kombinojnë mirë teorinë me praktikën. Natyrisht, Partia duhet të vazhdojë luftën e pandërprerë për këtë edukim të shumanshëm. Ky edukim është i domosdoshëm të bëhet, pse tek ata që kanë nivel të ulët ideologjik ruhen mbeturinat dhe idetë mikroborgjeze, të cilat, po s'u luftuan nëpërmjet teorisë dhe praktikës, si brenda dhe jashtë Partisë, atëherë çdo gjë rrezikohet. Këtë nuk e kuptojnë si duhet mjaft anëtarë partie, nuk e kuptojnë se i ka mbuluar praktikizmi dhe s'dinë ose s'duan t'i përdorin si busull mësimet e Partisë dhe ideologjinë e saj, se i pengojnë veset mikroborgjeze, mendjemadhësia, arroganca etj.

Duhet të kemi të qartë, teorikisht dhe në praktikë, disa parime filozofike dhe organizative të Partisë sonë. Klasa punëtore dhe partia e saj janë hegjemone

dhe nuk lejojnë dualitet në asgjë. Ato përdorin të gjitha mjetet për të zbatuar strategjinë e tyre, që është ndërtimi i socializmit dhe i komunizmit. Të tilla mjete janë pushteti popullor, diktatura e proletariatit dhe armët e saj, administrata shtetërore dhe qeveria që udhëheq këtë administratë, format e tjera drejtuese të ekonomisë e të kulturës, organizatat e masave etj. Të gjitha këto i drejtojnë klasa punëtore dhe partia e saj dhe mbi të gjitha qëndrojnë klasa dhe partia. Vënia e barazisë në formulën «Partia dhe Qeveria» parimisht është e gabuar. Unë mendoj se duhet thënë: «Qeveria mori këtë apo atë vendim në bazë të direktivave të Partisë», ose «Komiteti Qendror vendosi», kur ai vendos vetëm, por mund të thuhet edhe «Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria vendosën», kur është rasti që ata vendosën së bashku për një problem. Kurdoherë dhe vazhdimisht çështjet zgjidhen nën udhëheqjen e Partisë; kjo gjë nuk është formale, por parimore.

Partia, dhe këtë, natyrisht, të gjithë e dinë dhe të gjithë e thonë, nuk është vetëm udhëheqje e të gjitha rangjeve dhe e aparateve të tyre. Por ka disa që edhe në teori, edhe në praktikë këtë nuk e kuptojnë si duhet. E dinë se Partia dhe udhëheqjet janë një dhe të pandara, se ka ligje dhe norma që i përcaktojnë të drejtat, kompetencat, norma që duhet të zbatohen rigorozisht. Por në praktikë jeta na tregon se shkelen, se keqpërdoren dhe keqkuptohen, se udhëheqjet shumë herë këto i zbatojnë formalisht dhe me metoda pune të padrejta vihen në pozita të privilegjuara ndaj masës së Partisë. Kjo tregon se ka boshllëqe në edu-

kimin ideologjik të anëtarëve të Partisë dhe mbeturinat mikroborgjeze ngrenë krye.

Një çështje tjetër, që duhet të kuptohet dhe të zbatohet drejt, është parimi që Partia nuk ka vetëm rolin të edukojë politikisht dhe ideologjikisht veten e saj dhe masat, por t'i edukojë këto për një qëllim, që të drejtojnë efektivisht, në të gjithë sektorët e vendit. S'ka dhe s'mund të ketë dy lloje drejtimi: ekonominë e drejton Qeveria, ideologjinë e drejton Partia. Jo, aparati i shtetit dhe Qeveria duhet të jenë në duart e proletariatit dhe të Partisë së tij si një mjet i fuqishëm i edukimit, në frymën e diktaturës së proletariatit dhe të socializmit. Në fakt, ku është shumica dërrmuese e Partisë? Në industri, në bujqësi, në aparatet shtetëror, në Qeveri, në organizatat e masave. As në teori, as në praktikë nuk mund të ketë dualitet në këtë çështje. Kudo udhëheq Partia. Pra, kur themi se Partia ka detyrë edukuese, nuk duhet të kuptojmë se këtë detyrë e kanë vetëm byrotë e Partisë dhe aparatet e tyre, këto kanë disa detyra të caktuara në këtë drejtim, por detyrën e edukimit të Partisë dhe të masave, si politikisht, si ideologjikisht, e kanë gjithë Partia, të gjitha organizatat-bazë, të gjithë komunistët, kudo që janë, kudo që punojnë.

Kjo është e qartë, mund të thotë ndonjë shok. Unë them jo, nuk është kurdoherë ashtu. Ka shumë komunistë që punojnë në pushtet, në ekonomi etj., që dinë shifra, rregullore, njohin teknologjinë, por që nuk marrin mundimin t'i shoqërojnë mendimet, veprimet dhe urdhrat e tyre me shpjegime politike dhe ideologjike.

Kjo, mendojnë këta, është punë e tjetërkujt. Por ka shokë udhëheqës të forumeve të Partisë, bile më takoi rasti me një sekretar të parë rrethi që, si pa të keq, propozoi: «Të merren masa që Plenumi i 6-të, raporti dhe fjalimi i shokut Enver të shpjegohen edhe në komitetet ekzekutive». Kjo mund të duket e çuditshme, por kështu është, sikur orientimet e Partisë janë vetëm për Plenumin e Komitetit Qendror dhe nuk duhet t'i jepen pushtetit!

Unë kam folur për rolin e organizatave-bazë. Ju të gjithë, shokë, gjithashtu, vazhdimisht po flitni, gjithë Partia po flet. Mirëpo organizata-bazë duhet të jetë kudo në udhëheqje, që të jemi në rregull me parimin, që Partia të udhëheqë çdo gjë. Kjo nuk kuptohet si duhet teorikisht, prandaj nuk zbatohet si duhet në jetë. Organizatat-bazë, na mësojnë Lenini dhe Stalini, nuk duhet ta përqendrojnë punën vetëm brendapërbrenda tyre dhe të harrojnë masën, detyrat jashtë, planet, politikën.

Ne kemi caktuar disa norma, organizata mbledhet një herë në muaj. Çfarë diskutohet në mbledhje në përgjithësi? Gjëra anësore, bëhet kritikë dhe autokritikë. Të bëhen më shumë mbledhje të organizatës-bazë dhe të zgjatin ato më shumë se dy orë kjo quhet shfaqje burokratizmi, humbje kohe, thuhet: «Na mbyten mbledhjet». Kurse në zyra mbledhjet vazhdojnë nga dy dhe tri ditë me radhë. «Këtu, në zyra, është normale, është e pranueshme, nevojitet», thonë disa. Po pse është e pranueshme këtu dhe nuk është e pranueshme në Parti, që udhëheq? Pse ky nënvleftësim i rolit të Partisë?

Pse ky mënjanim i saj? Pse ministri dhe drejtori nuk japin llogari përpara organizatës-bazë, që udhëheq tërë punën e Partisë në dikaster? Këtë çështje duhet ta thellojmë edhe ideologjikisht, edhe organizativisht. Të mos harrojmë, na mëson Lenini, presionin e aparatit burokratik mbi Partinë. Kini parasysh çështjen e ushtrisë dhe problemin e naftës. Lenini nga praktika ka nxjerrë konkluzionin teorik. Eksperiencia jonë e vërteton tezën e Leninit. Ky presion që pengon demokracinë në Parti, për asnjë minutë nuk pushon, pavarësisht se disa herë nuk bie në sy. Faktet e ngjarjet na e tregojnë këtë. Këtej ne duhet të nxjerrim, pra, konkluzione se ekziston rreziku i ndikimit burokratik të aparateve shtetërore mbi Partinë.

Por nuk është vetëm ky presion, shokë. Anëtarët e Partisë udhëheqin dhe drejtojnë, por krahas tyre janë me qindra mijë shokë dhe masa të gjera që nuk janë anëtarë partie, por që janë në lëvizje, në punë, në prodhim, ka shumë e shumë prej tyre që drejtojnë nën udhëheqjen e Partisë. Të gjithë këta janë njerëz të mirë, por derisa në Parti kemi shokë me mbeturina, që edhe teorikisht, edhe politikisht janë akoma me nivel të ulët, ç'mund të themi për masën? Patriotizmi dhe dashuria për Partinë dhe për atdheun socialist nuk kanë bërë akoma që të zhduken nga ndërgjegjja e tyre idetë mikroborgjeze. Fshatari ynë është patriot, por nga fshatrat na vijnë me dhjetëra propozime në Presidiumin e Kuvendit Popullor që të falim hajdutë, kriminelë, vrasës. Kur oficerët e lartë anëtarë partie bënë atë që bënë, kur anëtarë partie në sektorin e naftës bënë atë

që bënë, atëherë duhet të marrim me mend ç'presion mund të bëjnë mbi Partinë këto masa njerëzish që nuk i kuptojnë si duhet ligjet e Partisë, të diktaturës, dhe që kanë vëset e burokratizmit, të teknokratizmit etj. Edhe vetë komunistët nuk kanë një nivel të njëllojtë për t'i kuptuar këto gjëra si duhet. Në organet e pushtetit dhe në administratën shtetërore ka më shumë të paorganizuar në Parti, që diktaturën e proletariatit, demokracinë proletare, pushtetin popullor dhe administratën e vet nuk arrijnë t'i konceptojnë si na mësojnë Partia dhe teoria e saj. Atëherë influenca e tyre në Parti është e madhe, në rast se Partia nuk është vigjilente. Që të jetë vigjilente, ajo duhet të kalitet, të edukohet me teorinë e saj marksiste-leniniste, që të edukojë edhe masat.

Në ushtri, në këtë armë të diktaturës, ku kemi një masë të madhe njerëzish, organizata e Partisë, në vend që të ishte e mprehtë dhe vigjilente, u tregua nga më të fjeturat, nga më amorset përpara rrezikut që i kërcënonte atë dhe diktaturën. Burokratizmi, këtë herë ushtarak, dhe teknokratizmi, po ushtarak, ishin bërë një fenomen «i pranueshëm» për anëtarët e Partisë dhe njerëzit e paorganizuar në Parti, për të gjithë kuadrot. Është këtu shembulli më tipik se si aparatet e shumta (pse ushtria ka aparate), të fryra, të pakontrolluara dhe të padrejtuara nga Partia dhe nga ideologjia e saj, linden burokratizmin dhe vënë në rrezik ndërtimin e socializmit.

Ajo që ndodhi në sektorin e naftës na tregon të njëjtin fenomen. Dhe këtu burokratizmi shtetëror, që

nga ministria e deri në bazë, kishte arritur të sabotonte realizimin e planit nën pretextin se do të realizohej plani i naftës dhe do të udhëhiqej më mirë puna duke organizuar «truste» gjigante për ne. Atje intelektualët dhe teknokratët kishin marrë drejtimin shtetëror në dorë, vepronin si donin, na ngopnin me «teori» dhe me terma teknikë. Elementë të tillë ishin vënë mbi Partinë, u kishin vënë bërryllin asaj dhe klasës punëtore nga udhëheqja, këtë as donin ta dëgjonin, as donin ta konsultonin.

Tash, kur do të shtrohet çështja në Parti dhe në punëtorët e sektorit të naftës, këta do të thonë shumë gjëra, ashtu siç ngjau edhe në ushtri. Po ku ishin më parë? Pse nuk flitnin? Ata edhe flitnin, po i kishin mbytur burokratizmi dhe teknokratizmi, që janë të huaj dhe armiq të teorisë e të praktikës revolucionare marksiste-leniniste. Njerëzit me të kaluar të mirë, thotë Stalini, ne duhet t'i respektojmë, por, në qoftë se ata janë bartësit e burokratizmit, t'i luftojmë pa mëshirë. Po pse ata nuk i shkruan një herë udhëheqjes për ato që mendonin? Sepse ju, Koço Theodhosi dhe Abdyl Këllezi, kur venit në rrethet ku nxirret naftë, punëtorët ju shihnin më shumë të rrethuar me «shtatmadhorinë» e burokratëve. Dhe pikërisht në kohën kur ata po vepronin kundër Partisë dhe klasës, propozohet e dekorohet me titullin e Heroit të Punës Socialiste njëri nga këta burokratë, të cilin Qeveria pak kohë më parë e kishte paralajmëruar se do ta pushonte nga puna për gabimet që kishte bërë. Gjithashtu Qeverisë iu propozua dhe ajo i dha «Çmimin e Republikës» një-

rit prej këtyre sabotatorëve. Këto dekorime bëhen në nëntor 1974, pasi në një mbledhje në muajin tetor çenë ngritur shokë dhe kishin thënë se «në Institut ka punë armiqësore» dhe kur, pikërisht në atë nëntor kur u dekoruan këta, ishte bërë një aktiv për problemet e naftës, procesverballi i të cilit na hapi sytë. Kur mbahehen të tilla qëndrime, si të guxojë atëherë punëtori të flasë? Megjithatë punëtori dhe anëtari i Partisë guxoi, shkroi, ai akuzoi deri edhe Koço Theodhosin.

Këto ndodhi shumë të rrezikshme do t'i lëmë të na kalojnë si histori të kohëve të kaluara? Do t'i konsiderojmë si ndodhi të veçanta, apo do të na shërbejnë si mësim të mëdha për të këqyrur me vigjilencë të lartë partie çdo gjë nëse e kemi të drejtë apo të gabuar dhe t'i korrigjojmë këto gabime e jo vetëm ne këtej lart, po tok me bazën. U bë gabimi që kur u organizua Drejtoria e Naftës jashtë ministrisë. Shokët e Qeverisë u këshilluan vetëm me teknikët e burokratizuar e të teknokratizuar. Po organizimin aktual kush e bëri? Pësë-gjashtë veta këtu lart e vendosën. Pra, megjithëse u gabua herën e parë, edhe herën e dytë nuk u pyet njeri dhe as u mor mendimi i Partisë dhe i klasës punëtore të sektorit të naftës. A nuk është ky një veprim burokratik? S'ka asnjë dyshim që po. Atëherë pse u veprua kështu? Duhet ta themi se ka shokë që u pëlqen mendja e tyre. Eksperienca e udhëheqjes, na mëson Stalini, ka rëndësi të madhe, po eksperienca e Partisë dhe e masave është një gjë kolosale që nuk duhet nënvleftësuar.

Kemi theksuar me të drejtë që Partia duhet të kri-



tikojë, sa herë që është rasti, forume dhe udhëheqës forumesh, cilëtdo qofshin këta. Të flasim hapur, zhveshur, si komunistë që jemi, a bëhet kjo në praktikë? Jo, nuk bëhet! Në Parti ka kritika për të thjeshtët, por për drejtuesit nuk ka sa duhet, dhe sa më lart të ngjitesh, aq më shumë zbutet kritika. Kurse disa nga ne, anëtarë të Byrosë Politike, sekretarë të Komitetit Qendror, zëvendëskryeministra, ministra e të tjerë janë si «të paprekshëm», sikur janë «të pagabueshëm» edhe kur bëjnë gabime. Dhe fakt është se gabime bëhen. Ja, për ato po flasim.

Është shtuar numri i drejtorive, po krijohen «truste». Kush i bën këto? Kush i vendos? Këto duhet t'i mendojmë mirë dhe, po të duhen, dhe atje ku duhen, drejtoritë mund t'i bëjmë, por jo të themi pastaj se fajin e ka ai ose ky.

Shtimi i organizmave pa vend shton numrin e nëpunësve, të komanduesve, të elementëve joprodhues, shton burokratizmin, i cili krijon fodullët, prepotentët dhe arrogantët e industrisë apo të aparateve shtetërore dhe të Partisë, pse, siç e pamë nga faktet, Partia nuk është e imunizuar. Prandaj mendoj dhe propozoj të mos heqim dorë nga vendimi që kemi marrë për thjeshtimin e aparateve të Partisë dhe të pushtetit, vendim që mendoj se ka kaluar në arkiv, po të kontrollohen me kujdes statistikat e shtesave. Duhet t'i kontrollojmë këto aparate shtetërore dhe të Partisë që po na fryhen pa u ndier dhe që vetë me duart tona shtojmë burokratizmin dhe elementët joprodhues.

Në mbledhjen e Plenumit të 6-të të Komitetit Qe-

ndror, në mes të tjerash, fola edhe për kultin jo vetëm të personit, por edhe për kultin e byrove. Kjo kam përshtypjen se u aprovua, u gjend kritikë e drejtë. Por mund të mjaftohet me kaq? Jo, duhet vepruar me konsekuencë revolucionare, marksiste-leniniste.

Në veprat e Stalinit, në një moment kur ai kritikon këtë fenomen në Partinë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik (fenomen që paraqitet edhe te ne), thuhet: Qendra e gravitetit të punës dhe të drejtimit të kalojë nga byrotë në plenum. Këto të bëhen shkolla drejtuese<sup>1</sup>. Kështu thotë Stalini. A ka ku të vejë më qartë? Jo, s'ka!

Ta shohim punën tonë në këtë prizëm dhe në atë që formulova si «kulti i byrove». A jemi ne në rrugën që na mësojnë mësuesit tanë të mëndhenj në këtë çështje? Jo, nuk jemi plotësisht, kemi të meta. Pashur, në praktikë ne ndonjëherë e konsiderojmë Byronë Politike mbi Komitetin Qendror dhe, pavarësisht se në parim pranojmë të kundërtën, në praktikë ndodh që Byroja Politike i dikton plenumit rendin e ditës, pa u konsultuar më parë e gjerësisht me anëtarët e plenumit, bile, edhe me bazën për problematikën e çështjeve që do të shqyrtohen në plenum, me qëllim që diskutimet e vendimet të bëhen dhe të merren me përgjegjësinë e plotë që kërkon funksioni që i ka ngarkuar Kongresi i Partisë Komitetit Qendror.

Rendi i ditës i çdo mbledhjeje të plenumit mund të propozohet nga Byroja Politike, por, natyrisht, të

---

1. Shih: J. V. Stalin, Veprat, vëll. 6, f. 216-217.

diskutohet e të vendoset në plenum. Unë mendoj se nuk është e thënë që medoemos plenumi të thirret vetëm dy herë në vit, siç kemi vendosur, por ai mund të mbli-dhet edhe më shpesh, kur është e nevojshme.

Në mbledhjet e Plenumit të Komitetit Qendror By-roja Politike jo vetëm të kërkojë llogari, por edhe t'i japë llogari forumit më të lartë, të inkurajojë kritikën nga poshtë-lart dhe atë paralele.

Unë nuk them të mos i këshillojmë shokët, të mos u shpjegojmë atyre direktiva të rëndësishme, por nuk është me vend t'i thërresim orë e çast, t'u flasim edhe për gjëra të vogla, për të cilat duhet t'u punojë vetë koka, individualisht dhe kolektivisht. Një metodë pune e tillë duhet të zhduket, pse është një nga ato sëmun-dje që lindin kultin e byrove, shkarkimin nga vetja të përgjegjësisë dhe krijimin e elementëve të buokra-tizmit.

Këto ishin, shokë, disa refleksione jo të panjo-hura, por që mendova t'i shtroja me rastin e kësaj pune të sëmurë. Për to mund të diskutojmë, t'i vëmë çështjet më drejt, nuk them sot, por në ndonjë mbledhje tje-tër, po të shihet e nevojshme.

*Botohet për herë të parë, me ndonjë shkurtim, sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali t mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH, që gjendet në AQP*

# STRUMBULLARI NË USHTRI ËSHTË PARTIA

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

5 mars 1975

Partia duhet të interesohet shumë për çështjet ushtarake, se ky është një problem nga më të rëndësishmit. Ne po ndërtojmë socializmin, por duhet edhe ta mbrojmë atë. Deri tani në çështjet e mbrojtjes armiqtë na kishin sabotuar sistematikisht, duke mashtruar Partinë.

Organizimi i punës në shkollat e lira ushtarake do të ketë disa probleme, siç janë ndjekja e stërvitjes sipas programit nga punëtorët, kooperativistët, rinia e vullnetarët; përvetësimi i mësimëve; përgatitja teorike e komandantit apo e instruktorit; zbatimi drejt i programeve të caktuara; mirëmbajtja e armëve etj. Çështje të tilla i shikon jo vetëm organizata e Partisë në shtabin e Shkollës së Lirë Ushtarake ose organizata e Partisë e

---

1. Në këtë mbledhje, midis të tjerash, u shqyrtuan edhe një relacion për Shkollën e Lirë Ushtarake dhe një raport për gjendjen e masat që duhen marrë për të forcuar punën Ideopolitike dhe ndërtimin e Partisë në ushtri.

nënrepartit, të cilat duhet të ndalen konkretisht në to, por edhe organizatat dhe byrotë e kooperativave të bashkuara, që kanë një shkollë të lirë ushtarake. Po të ndiqet çështja në mënyrë të shkëputur, do të bëhet një punë shumë burokratike, prandaj, që të eliminohet çdo veprim burokratik, këto byro të kooperativave të dërgojnë të deleguarit e tyre dhe të krijohet kështu një udhëheqje kolegjiale për çështjet ushtarake. Pikërisht këtë organizëm në relacion e quajnë komitet, por, po të doni, mund ta quajmë edhe byro. Vetëm duhet kuptuar drejt se këto komitete ose byro, që ngrihen në shkollat e lira, nuk janë për të drejtuar krejt punën e Partisë të kooperativave ose të ndërmarrijeve, por vetëm çështjet ushtarake.

Pra, së pari, të kemi parasysh që komitete të tilla nuk krijohen për të udhëhequr të gjitha punët e Partisë në kooperativë. Në qoftë se ato u marrin funksionet byrove të kooperativave, atëherë krijimi i tyre është i gabuar. Në teori kjo mund të kuptohet e të shtrohet drejt, por gjatë zbatimit në praktikë të mos ndodhë që komiteti i Shkollës së Lirë Ushtarake të kthehet në një komitet partie rajoni i disa kooperativave bujqësore. Së dyti, të kemi shumë kujdes që me këtë organizim të mos i kërkohet organizatës së Partisë të terrenit të merret vetëm me probleme ushtarake. Po të mos kuptohet drejt ky problem, atëherë ka rrezik që organizatën-bazë të Partisë të terrenit të na e kthejnë në një organizëm thjesht ushtarak. Komiteti i Shkollës së Lirë Ushtarake i ka funksionet të kufizuara, se edhe stërvitja e rezervistëve dhe e vullnetarëve është e kufizuar.

Pra ai nuk mund të mblidhet e të funksionojë si organ permanent.

Për këtë komitet ne duhet të caktojmë një afat zgjedhjeje për një ose dy vjet. Komiteti s'ka pse të mblidhet përditë, por vetëm kur ka probleme, sidomos kur forcat janë të grumbulluara, për shembull, në fillim dhe në fund të stërvitjes, për të shtruar detyrat dhe për të bërë konkluzionet, të cilat ua vë në dukje edhe organizatave-bazë të Partisë. Mundet që stërvitjet të mbarojnë edhe në gjashtëmujorin e parë të vitit, por komiteti, për të ndjekur detyrat, mban lidhje me komandën e Shkollës së Lirë Ushtarake. Në qoftë se lind problemi për të bërë ndonjë stërvitje plotësuese, atëherë komanda e Shkollës së Lirë Ushtarake i propozon sekretarit të komitetit që ai t'u rekomandojë organizatave të Partisë të terrenit që forcat vullnetare, megjithëse e kanë përfunduar planin e stërvitjes, të lejojnë edhe disa ditë për të kryer një detyrë plotësuese për mbrojtjen. Komiteti e shqyrton këtë propozim dhe, kur e gjykon me vend, ua shtron edhe organizatave-bazë. Pas kësaj merret vendim nëse do të bëhet stërvitja e kërkuar nga komanda apo jo. Pra, komiteti vazhdon të funksionojë, por nuk mblidhet shpeshherë. Mendoj që ne ta miratojmë vendimin për t'i krijuar këto komitete partie të shkollave të lira dhe pastaj e shikojmë në praktikë si do të na venë punët. Po u pa e nevojshme, mund të mos ngremë komitet partie mbi bazën e Shkollës së Lirë Ushtarake, në këtë rast byrotë dhe organizatat-bazë të Partisë të çdo kooperative të bashkuar të interesohen vetë direkt për problemet e mbrojtjes. Mirëpo,

kur Shkolla e Lirë Ushtarake përfshin disa kooperativa, del çështja se si do të bashkërendohet puna.

Për sa i përket relacionit, kisha edhe një vërejtje që e kam bërë edhe në një mbledhje të Sekretariatit. Përcaktimet të kihen mirë parasysh. Strumbullari i batalionit, i një reparti apo njësie tjetër ushtarake nuk janë komandanti e komisari, sikurse thuhet në relacion, por Partia. Këta, komandanti e komisari, janë kuadro të zgjedhur ose të emëruar.

Kisha edhe një çështje tjetër. Eksperiencia e hidhur e së kaluarës, e veprimtarisë armiqësore të Beqir Ballukut dhe e të tjerëve duhet të na hapë sytë, prandaj Shkollën e Lirë Ushtarake ta bëjmë me të vërtetë shkollë për edukimin e rezervistëve dhe të të gjitha forcave vullnetare rreth e qark saj. Çështja kryesore këtu qëndron te programi. Natyrisht, programet e Shkollës së Lirë Ushtarake duhet të jenë të diferencuara: ndryshe për rezervistët dhe ndryshe për forcat e tjera që marrin pjesë vullnetarisht në këto shkolla.

Për sa i përket përgatitjes së rezervistëve, duhet të kemi programe të shkallëzuara dhe jo të zbatojmë çdo vit të njëjtin program e të përsëriten të njëjtat gjëra! Kjo nuk duhet të ngjasë, se ndryshe stërvitja do të ishte një kohë e humbur kot. Ne kemi për detyrë që në Shkollën e Lirë Ushtarake të përgatitim rezervistët dhe gjithë strukturat e tjera. Ose, të marrim edhe të rinjtë, ushtarët e ardhshëm. Këta t'i mësojmë me programin e stërvitjes, që, kur të venë në shërbimin e detyrueshëm ushtarak për dy ose tre vjet, shumë gjëra që do të mësonin muajt e parë në ushtri t'i kenë

parapërgatitur qysh në Shkollën e Lirë. Deri tani puna përgatitore ushtarake që bëhej me rininë nuk merrej parasysh kur i riu mobilizohej në ushtri, kështu që aty fillonte nga e para. Tani, me Shkollën e Lirë, të bëhet punë e organizuar dhe i riu të vejë në ushtri i mësuar.

Programet duhet të kenë çdo vit një freskim edhe për kualifikim të mëtejshëm të rezervistëve, sepse ata, së pari, kanë mbaruar ushtrinë në armë të ndryshme e, së dyti, kanë bërë edhe stërvitje për disa vjet, gjë që duhet mbajtur medoemos parasysh në hartimin e programeve të shkollave të lira ushtarake.

Çështje tjetër me rëndësi është zbatimi i programit të stërvitjes gjatë kohës së caktuar për çdo vit. Programet të zbatohen me kualitet të lartë dhe me kujdes nga oficerët e jo të bëhen stërvitje sa për të kaluar radhën. Për këto teori që ne mësojmë, siç janë teoria marksiste-leniniste, teoria e artit ushtarak etj., rëndësi ka edhe zbatimi i tyre. Ato që ka mësuar rezervisti, i riu e kushdo tjetër nga Tezat e Këshillit të Mbrojtjes apo nga teoria e Artit Ushtarak të Luftës Popullore, të zbatohen mirë në jetë.

Lidhur me zhvillimin e punës ideopolitike në ushtri të heqim dorë nga metodat burokratike. S'ka pse të vendosim ne që këtu, siç thuhet në material, që në programet e stërvitjes të caktohen shtatë për qind për këtë lëndë, dy për qind për atë, pesë për qind të jenë kështu e ashtu etj. Byroja Politike jep vijën, orientimet kryesore të ndërtimit të programeve, dhe mbas kësaj ndiqet e kontrollohet zbatimi i këtyre orientimeve. Nuk do të ishte e drejtë që këtu të caktojmë



hollësira me kaq e aq orë. Ne jemi udhëheqja kryesore, prandaj hollësitat u përkasin komiteteve të Partisë të instancave më të ulëta t'i zgjidhin.

Rëndësi ka shembulli i mirë i atij që zhvillon punën ideopolitike. Në qoftë se ajo që flet punëtori politik nuk zbatohet nga vetë ai, kthehet në demagogji dhe komprometon edhe Partinë, se ai atje del e flet në emër të Partisë.

Për kurset apo shkollat që u fol këtu, desha të pyes nëse janë studiuar mirë këto propozime, apo na thuhet vetëm si numra që «Hajde, të marrim 400-500 vota e t'i shpiem për t'i përgatitur si kuadro politikë!». Në qoftë se duam të bëjmë me të vërtetë një punë të bazuar, që të mësojnë e të përfitojnë gjithë këta kuadro, në kurse a në Shkollën e Partisë qofshin, duhen edhe pedagogë, edhe kushte të tjera, prandaj pyes që a janë studiuar mirë këto çështje. Me fjalë të tjera, të merren masa që kuadrot të cilët venë atje, të mësojnë dhe të dalin të përgatitur për atë që na duhet neve, e jo t'i çojmë formalisht. Pra, të organizohet e të kontrollohet mirë kjo punë.

Kisha edhe diçka tjetër lidhur me materialet e paraqitura. Këtë herë i pranuan këto materiale të gjata me nga 20 e 30 faqe, por unë propozoj që materiale të tilla të mos pranojmë më. Në mbledhjen e Byrosë Politike dhe në atë të Këshillit të Ministrave duhet të vijmë për shqyrtim gjërat kryesore. Në raporte të përmbledhura çështjet më të rëndësishme, se vetëm këstu mund të shihet ku i dhemb këtij ose atij sektori, e jo të futemi në një pyll ku të mos dimë nga të dalim.

Ja, për shembull, unë kisha vërejtje edhe për këtë material, se është një «pyll i madh», që numëron këtë e atë, aq sa, duke e lexuar, u detyrova të thosha: «More, shokë, çfarë kërkon nga ne?». Mirëpo këtë s'po e gjeja dot. Për të zbuluar thelbin e problemeve duhet të vëmë «dylbi»! Po t'i shikosh këto materiale, del se në to ka po ato gjëra që ua kemi thënë ne shokëve për t'i zbatuar. Këto porosi tonat kthehen e na thuhën përsëri neve! Prandaj, shokë, të na shkruani për kryesoren; në qoftë se na duhen, ne i gjejmë pastaj edhe hollësitë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

## NDËRTIMEVE TONA T'U JAPIM TIPARE ME TË VËRTETË SOCIALISTE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

5 mars 1973

Së pari, unë jam i mendimit që sheshit të kryeqytetit, si kryeqendër e vendit tonë socialist, t'i japim tipare me të vërtetë socialiste, prandaj në këtë vend të largohemi nga ndërtimet me betonarme dhe të ngremë të atilla ndërtesa që të mund ta përfaqësojnë denjësisht Shqipërinë edhe nga ana e arkitekturës. Pra, të kihet parasysh që të ruhet individualiteti i ndërtimeve tona.

Së dyti, mendoj se nuk duhet të ketë ndërtesa banimi në qendër. Keni vende të tjera sa të doni për t'i ndërtuar ato. Mendimi im i përgjithshëm është që, edhe

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për caktimin e destinacionit të objekteve në projektidenë e qendrës së Tiranës; për studimin urbanistik të bllokut «Luigj Gurakuqi» dhe për vendin e ndërtimit të Muzeut Historik. Për maketin dhanë shpjegime arkitektët Koço Miho dhe Sokrat Mosko.

sikur të mbeten vende bosh në qendër, aty të mos ngrihen ndërtesa banimi. Nuk flas këtu për ato që janë ngritur në rrugën «Luigj Gurakuqi», për të cilat nuk kam kundërshtim.

Së treti, aty në shesh ne duhet të ruajmë sa të jetë e mundur më shumë gjelbërimin. Për më tepër, edhe gjelbërimin që kemi pasur në këtë qendër dalngadalë po e humbasim, duke ngritur ndërtesa, sikur të mos kishim vende të tjera për këtë qëllim! Në këtë shesh, mendoj unë, ne duhet të ndërtojmë për sot, për pesë apo dhjetë vjetët e ardhshëm, pa harruar edhe perspektivën, kur popullsia e vendit tonë do të arrijë katër deri pesë milionë banorë; pra, t'u lëmë vend për ndërtimin e Shqipërisë socialiste edhe brezave të ardhshëm. Atyre që do të vijnë pas nesh, sigurisht që do t'u krijohen mundësi më të mëdha për të ndërtuar me sasi e cilësi shumë më të mirë nga ç'ndërtojmë ne sot.

Neve na duhet të bëjmë një sallë të përshtatshme për zhvillimin e kongreseve<sup>1</sup>, që mund të jetë me kapacitet prej 2 000 vendesh dhe me anekset përkatëse. Këtë pallat, për të cilin do të bëhen shpenzime të mëdha, nuk duhet ta vendosim diku prapa ndërtesave të tjera, nëpër qoshe, por në një vend sa më të përshtatshëm.

Edhe muzetë me rëndësi kombëtare mendoj të jenë

---

1. Këtë ide shoku Enver Hoxha e shpalli në mbyllje të punimeve të Kongresit të 8-të të Partisë. Pallati i Kongreseve, një nga veprat e rëndësishme dhe më e bukura që u ndërtua gjatë pesëvjeçarit të shtatë, u përrua më 30 tetor 1980, në prag të hapjes së Kongresit të 9-të të PPSH dhe të 45-vjetorit të themelimit të saj.

në qendër dhe jo qosheve. Sidoqoftë, ato ne do t'i bëjmë, por më parë duhet të përcaktohet vendi ku do të ndërtohen, si dhe koha e fillimit dhe e mbarimit të tyre. Këto institucione me rëndësi ne mund të mos i përfundojmë brenda një plani pesëvjeçar.

Tani dua të pyes pak për atë që u tha këtu se është menduar që të zihet pamja e rrugës «Kongresi i Përmetit» që të mos duket prej saj xhamia. Cila qenka kjo «perspektivë» kaq e madhe që na detyroka ta zëmë pamjen e kësaj rruge? Në qoftë se ka njerëz që mendojnë të bëhet diçka «për të mos rënë në sy xhamia», ky është një gjykim foshnjor. Xhamia është lënë në qendër të Tiranës, ku ishte, jo për të mbajtur gjallë besimin fetar, por si monument kulture me rëndësi, i ruajtur dhe i mbrojtur nga shteti. Prandaj nuk është i drejtë mendimi për të mbyllur perspektivën e rrugës «Kongresi i Përmetit» që t'i zëmë sytë xhamisë!

Edhe gjykimi që të prishet lulishtja në sheshin «Skënderbej», se ndan më dysh bulevardin kryesor, mua më duket se është i gabuar. Të kemi parasysh se në këtë lulishte çdo ditë dhe çdo orë rrinë të rinjtë, fëmijët dhe pleqtë, që çlodhen ose dalin në fotografi. Përse ta prishim e ta mbulojmë me asfalt këtë vend të këndshëm që u pëlqen kaq shumë njerëzve tanë? Kjo lulishte thyen edhe monotoninë e pamjes në qendër të Tiranës. Prandaj unë nuk jam as për këtë.

Teatrin e Operës dhe Bibliotekën Kombëtare mendoj, gjithashtu, t'i kemi këtu në qendër. Biblioteka që kemi sot, fjala vjen, nuk mjafton për Shqipërinë

e së ardhmes. Nuk them që të ngremë qysh tani një bibliotekë të madhe, por, më vonë, edhe këtë duhet ta bëjmë patjetër. Pra, kur është fjala për qendrën e Tiranës, duhet ta matim me kujdes të madh çdo objekt që do të ndërtojmë aty. Të parashikohet edhe se ku do të vendosen ndërtesat që thamë. Unë nuk jap asnjë mendim kategorik, se nuk dua të imponoj kështu zgjidhje të pastudiuara, prandaj të mendohet me kujdes për çdo objekt. Për të gjitha këto duhet menduar jo vetëm lidhur me fasadat, por edhe për thellësinë. Disa vende në qendër, sipas projektidesë, mbeten bosh. Si do të veprohet me to?

Çdo objekt që do të ngremë në qendër ta bëjmë në mënyrë të tillë që ai dhe sheshi mbi të cilin do të ngrihet të kenë sa më shumë dritë. Nga sa kam lexuar, ka edhe një lloj tjetër ndriçimi që mund t'i bëhet sheshit nga jashtë dhe që do t'i jepte atij një bukuri të veçantë, sidomos natën. Ky ndriçim përdoret për objekte të rëndësishme, kur nuk ka ndërtesa pranë. Për sa fola, natyrisht, nuk mund të bëjmë gjë tani. Por, pas disa vjetësh, kur të ndërtojmë hidrocentrale të tjera, do të kemi mundësi që ta ndriçojmë në mënyrën që thashë edhe qendrën e kryeqytetit tonë.

Në projektide ju keni parashikuar edhe ndërtimin e një MAPO-je të vogël, në verilindje të Pallatit të Kulturës. Unë them se kjo mund të bëhet, por të jetë e madhe dhe me shumë kate. Sheshi këtu do të ketë lëvizje të madhe, prandaj se si mund të bëhet kjo MAPO, këtë mendojeni dhe zgjidheni ju specialistët.

Nga Sahati e lart nuk ka ndonjë bllok të madh, prandaj ndërtesat është më mirë të jenë kështu, të thjera. Në qoftë se mund të bëjmë ndonjë objekt tjetër këtu, është më mirë, pse, siç e keni parashikuar ju në këtë sektor, ndërtimi është i të njëjtit tip me atë të Lushnjës, kurse s'duhet harruar se Tirana është kryeqytet. Në qoftë se ndërtojmë apartamente për banim, të tregohet kujdes që të ndërtohen nga ana e diellit e të mos veprojmë si me ato që janë ngritur anës së Lanës. Nuk mund t'i bëjmë të tëra ndërtimet kulla-kulla, prandaj kërkohet të studiohen e të parashikohen mirë këto gjëra.

Ndërtesat që ngremë duhet të lidhen edhe me perspektivën, të mendohet si do t'i bëjmë: në vijë të drejtë, apo do të ngjitemi lart? Mendimi im është që me ndërtimet në qendër nuk duhet të ngjitemi në shumë kate. Objektet e ardhshme aty të mos e kalojnë lartësinë e Pallatit të Madh të Kulturës. Sheshet e mëdha si ky yni, nga sa kemi parë kur kemi qenë jashtë, në televizor ose në fotografi, nuk kanë ndërtesa shumë të larta.

Për të përcaktuar stilin e të ndërtuarit duhet të bëhen adaptime, të organizohen debate dhe konferenca. Stili të vendoset jo sipas imagjinatës së formuar në erë, por sipas studimeve të mbështetura në arkitekturën tonë. Edhe nga përvoja e huaj mund të përfitohet, por nga ajo që është e mirë. Në shfrytëzimin e përvojës së mirë të të tjerëve të kihet parasysh metoda krijuese realiste socialiste, pra, të përshtatet ajo për vendin tonë, duke e kombinuar dhe me traditat e tij, gjë që më duket se nuk e kemi arritur përherë si duhet. Këtë

mendim e kam jo vetëm për shokët që kanë mbaruar shkollat jashtë, por edhe për ata që i kanë kryer studimet këtu, sepse të tërë mund të ndikohen nga literatura e huaj. Natyrisht, do të shfrytëzojmë edhe literaturë të huaj, për të marrë eksperiencën e mirë.

Na është thënë se të huajt që kanë ardhur në Shqipëri i kanë quajtur shumë të mira ndërtesat tona pesëkatëshe; atyre u ka pëlqyer ruajtja e traditave dhe sidomos gjelbërimet te ne.

Edhe për materialet e ndërtimit duhet të mendohet në mënyrë të posaçme. Në cilësinë dhe bukurinë e ndërtimeve luajnë rol të gjitha: bojërat, gurët, mermeri etj. Natyrisht, të tëra ndërtimet nuk mund të bëhen me mermer. Por ndonjë prej tyre, sipas rëndësisë që paraqet, mund ta bëjmë edhe me mermer. Përveç mermerit, ne kemi gurë të tjerë të mrekullueshëm, të cilët mund t'i përdorim në ndërtime, prandaj të gjejmë mënyrat që na kushtojnë më lirë për shfrytëzimin e tyre.

Krahas cilësisë, kërkohet edhe shpejtësi, prandaj edhe këtë duhet ta kemi parasysh kur ndërtojmë.

Këto vërejtje dhe kritika që u bënë këtu, të mos merren për keq. Përkundrazi, ju them sinqerisht se ne e vlerësojmë shumë punën e arkitektëve tanë. Ata kanë bërë gjëra shumë të mira dhe janë në gjendje ta kryejnë me sukses edhe këtë detyrë të madhe.

Ne mund të shfaqim ndonjë mendim për ndërtimet, që mund të mos jetë krejtësisht i drejtë. Por Partia na mëson të bëjmë debate dhe kudo e kurdoherë



të shprehim me çiltërsi atë që ndiejmë. Rrahja e mendimeve është kurdoherë e dobishme. Po të jetë nevoja, le të diskutojmë prapë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

## JU PO TREGONI NJË SHIEMBULL TË LARTË GATISHMËRIE E PATRIOTIZMI

*Letër drejtuar të rejave dhe të rinjve  
të kooperativës bujqësore «Enver Hoxha» të Bujanit*

22 mars 1975

Të dashur shokë dhe shoqe të rinisë,

Me letrën që më dërguat, ju më jepni një tog si-hariqesh: bashkë me kooperativistët e tjerë realizuat planin e hapjes së tokave të reja për pesëvjeçarin e pestë dhe tani ju, të rinj e të reja, jeni hedhur në aksion për krijimin e një blloku me vreshta e, në të njëjtën kohë, keni dalë vullnetarë për të marrë pjesë në ndërtimin e hekurudhës Përrenjas-Guri i Kuq dhe të linjës hekurudhore brenda Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit. Me këto sihariqe ju më gëzuat shumë dhe ma bëtë zemrën mal. Ju përgëzoj ngrohtësisht për punën e palodhur që keni bërë e vazhdoni të bëni për të forcuar e për të lulëzuar kooperativën tuaj bujqësore, si dhe për kontributin që do të jepni, krahas gjithë rinisë së vendit tonë, me pjesëmarrjen tuaj në veprat e më-

dha me rëndësi kombëtare, për ta bërë gjithnjë më të gëzuar e më të begatshme jetën e malësorëve trima të atyre anëve dhe të të gjithë popullit tonë heroik.

Duke kaluar nga njëri aksion në tjetrin, ju po tregoni një shembull të lartë gatishmërie e patriotizmi të zjarrtë socialist. Kjo është karakteristikë për gjithë rininë e vendit tonë, që ecën kurdoherë e vendosur në rrugën revolucionare të Partisë. Me të rinj e të reja sulmues si ju, atdheu ynë bëhet përherë e më tepër i pamposhtur nga çdo armik, populli i pathyeshëm, Partia jonë më e çeliktë dhe familjet tuaja krenare e të lumtura.

Ju uroj shëndet dhe suksese të reja në frontet e punës, të mësimit dhe të kalitjes ushtarake.

Juaji

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Letra të zgjedhura», vëll. i 2-të, f. 284*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Letra të zgjedhura», vëll. i 2-të, f. 284*

## JO RAPORTE ME FRAZA STEREOTIPE, POR ME PROBLEME KONKRETE

Shënime<sup>1</sup>

26 mars 1975

Në organizatat-bazë të Partisë vërchen dobësi. Ky është fakt dhe duhet analizuar pse vjen një gjë e tillë. Natyrisht, Partia ka bërë analiza, por këto nuk janë thelluar e nuk janë bërë objekt serioz diskutimi dhe, mbi këtë bazë, të veprohej në mënyrë revolucionare.

Ë para, organizatat në përgjithësi jo kurdoherë pyeten sa duhet, ndodh që u imponohet një veprim. Mund të bësh leksione, por mendimin dhe veprimin revolucionar të Partisë ta shtypin burokratizmi dhe fodullëku, në qoftë se këta nuk luftohen. Një nga të këqijat është dominimi në organizatë i disa kuadrove kryesorë, që drejtojnë edhe forume të Partisë, edhe organe shtetërore. Këta kuadro rrallë kritikohen, sikur nuk gabojnë kurrë, dhe, kur kritikohen, abuzojnë me

---

1. Këto shënime shoku Enver Hoxha i ka bërë pasi lexoi një raport të përgatitur nga grupi i Instrukturëve të aparatit të KQ të PPSH.

funksionet që kanë, shumë herë edhe hakmerren.

Një shok, në një raport që na bën, e harron fare këtë sëmundje të drejtuesve të pushtetit (anëtarë partie), që kanë fuqinë në dorë dhe në fakt sundojnë mbi organizatat e Partisë, duke thënë: «Partia udhëheq». Por kjo është një udhëheqje formale dhe shoku që shkruan raportin e mjaft të tjerë si ai, në shumë raste. të gjitha shigjetat i drejtojnë kundër organizatës-bazë duke thënë: «Ajo nuk punon mirë, ajo nuk është në krye». Ndodh që të sulmohet organizata-bazë me kritika pa vend. Kjo është e palejueshme dhe në kundërshtim me normat e Partisë, përkundrazi, duhet të sulmohen ata që e pengojnë organizatën-bazë dhe këta janë shpeshherë njerëz me pozita në Parti dhe në shtet, që shkelin ligjet dhe normat e Partisë.

Pra, të tëra fajet po i hidhen organizatës së Partisë. Kjo ka faje, po më shumë faje kanë ministria, administrata, kuadrot kryesorë, që nga ministri dhe drejtorët. Shumica e këtyre janë anëtarë partie dhe, po nuk u vunë me shpatulla në mur, deri në ulje nga përgjegjësia, deri në përjashtim nga Partia, sipas gabimeve e fajeve, organizata-bazë s'ka fuqi. A do të lejojmë që disa «të mëdhenj» e «përgjegjës» të bëjnë ligjin në organizatën-bazë? Ne «në teori» mund të flasin se ka faj organizata, por ka faj edhe ministri, kanë faj drejtorët e jo shoferi dhe fshirësja e ministrisë. Në qoftë se nuk krijohet guximi revolucionar që të kritikohen eprorët në organizatën e Partisë, atëherë kjo nuk do të veprojë.

Duhet të bëhen leksione ku të shpjegohen ç'është

organizata-bazë, detyrat e saj dhe të komunistëve, të drejtat dhe detyrimet, përgjegjësia kolektive dhe individuale, ç'janë udhëheqësit, ç'detyra dhe ç'të drejta kanë. Këto çështje të kuptohen teorikisht, të zbatohen dhe të mbrohet zbatimi i tyre, ndryshe s'ka organizatë-bazë, ajo mbetet formale.

Shokët e grupit të instruktorëve na raportojnë për shumë gjëra që shikojnë në rrethe e në bazë, por neve s'na mjaftojnë këto. Flitet, për shembull, që çështja e përgatitjes ushtarake neglizhohet në shkollë. Mirë që flitet në çdo referat për të tre komponentët, po se ç'bëhet me ta, kjo nuk na intereson?! Atëherë pyesim: Kush do të interesohet, kur nuk interesohet Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, kur nuk interesohen dekanatet dhe rektorati i universitetit, i Institutit të Lartë Bujqësor etj., drejtoritë e shkollave dhe organizatat-bazë të të gjitha këtyre institucioneve? Mos vallë presin shokët instruktorë që të interesohet dikush tjetër, ndonjë «mbifuqi», kur thonë se kjo duhet të bëhet e qartë për të gjitha shkollat e larta?

Një këshillë: Të merren masa ndaj atyre që, me gjithë ndihmën e dhënë, nuk i kryejnë detyrat, dhe të vihen të drejtojnë njerëz të rinj. Atëherë puna do të ecë.

E keqja qëndron në fryrjen e aparateve të ministrive, jashtë ministrive, nëpër institute e drejtori të përgjithshme. Këtu janë grumbulluar njerëz që marrin rroga kot, që sorollaten, që pengojnë. Këta organizma u krijuan gjoja që të ecë puna mirë, por kjo po sabotohet. Të bëhet shumë kujdes për këto që themi,

të studiohen një për një në vend dhe të merren masa konkrete, përndryshe do të na ngjasin gjëra të papëlqyera.

Flitet e flitet për burokratizmin, por ç'janë këto që dëgjojmë? Është krijuar, për shembull, një drejtori e përgjithshme e furnizimit materialo-teknik të bujqësisë, e cila ka mbi 20 veta. Në 26 rrethe janë krijuar agjenci po për këtë detyrë dhe që të gjitha kanë minimumi 500 veta personel. Po përse i duam gjithë këto drejtori dhe këta drejtorë që rrinë nëpër zyra, që nuk merren vesh, që nuk koordinojnë punën, që njëri i bie gozhdës dhe tjetri potkoit? Qeveria nuk i kontrollon vallë? Nuk është e dëmshme një gjë e tillë dhe në raporte po na thuhet fraza stereotipe? Shpejt të bëhen kontrole dhe të zhduken këto gangrena nga trupi i shtetit!

Në kombinatin e tekstileve «Stalin» 70 makina rri në jashtë për 5 vjet me radhë. Pse nuk merr masa vetë kjo ndërmarrje kaq e madhe? Ku do t'i vërë ministria këto makina? Po kombinati pse s'vepron, po bën shir? Na ngopin me fjalët «burokratizëm, teknokratizëm, operativitet, zhdërvjellësi, ekonomizëm, intelektualizëm». Pse nuk vepron në mënyrë revolucionare? Ku konsiston puna politike që bëhet? Ku konsistojnë kontrolli i punëtorëve, kontrolli i shtetit, patriotizmi?

Konkluzion: Më vjen shumë keq kur, duke kënduar, mësoj se ndodhin gjëra të tilla. Kam përshtypjen se edhe shokët instruktorë nuk e ndihmojnë si duhet

---

1. Menjëherë kjo drejtori u suprimua.

dhe sa duhet Partinë. Ata janë vazhdimisht në bazë, vazhdimisht thërresin njerëz edhe lart, kurdoherë qëmtojnë më shumë ndodhi, por them se më shumë mund të kontribuojnë në organizimin e ndihmës që i duhet dhënë Partisë. Instruktorët, mendoj unë, japin këshilla të përgjithshme dhe nuk marrin guximin t'u japin shembullin komunistëve revolucionarë, që të kritikojnë deri edhe ata udhëheqës që gabojnë. Ata nuk kanë kurdoherë guximin e duhur ta bëjnë këtë detyrë si anëtarë partie dhe si instruktorë të Komitetit Qendror që janë, dhe vijnë na i thonë gjërat neve, që ne të kritikojmë. Këtë punë duhet ta bëjnë edhe ata, prandaj të marrin guximin.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



## KUADROT KANË ROLIN E TYRE, POR JO TË BËJNË LIGJIN MBI PARTINË

Shënime<sup>1</sup>

26 mars 1975

Duke studiuar projektplanin e punës që na kanë paraqitur për Plenumin, Byronë Politike dhe Sekretariatit e Komitetit Qendror, kam këto vërejtje:

Temat, siç propozohen, kanë tendencë të trajtohen në përgjithësi, gjë që mund të shtyjë ata që do t'i përgatitin të tjerrin fraza stereotipe, të bëjnë gjoja teorigjizime. Kur thuhet «Partia na mëson se duhet të luftohet burokratizmi, teknokratizmi» etj., ky nuk është shpjegim teorik, por diktim vetëm ç'duhet bërë dhe jo në se konsiston, ku e ka burimin, ku ka konkretisht burokratizëm, pse shfaqet dhe ç'duhet bërë kundër tij.

---

1. Ky material, si dhe ato të datave 23 mars dhe 3, 4, 11 e 15 prill 1975, janë shënime të shokut Enver Hoxha. Në një broshurë të veçantë që lu dërgua komiteve të Partisë në rrethe, u quajtën diskutime në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH dhe si të tilla u përfshinë edhe në librat «Për diktaturën e proletariatit», «Raporte e fjalime 1974-1975», «Për pushtetin popullor» etj.

Shumica e temave në këtë projektplan janë formuluar në mënyrë simpliste.

Këtë gjë e theksoj se ka shokë që flasin për teknokratizëm, bëjnë referate, por një problem të tillë e kuptojnë shumë ngushtë, sikur kjo ka të bëjë vetëm me specialistët, inxhinierët, gjeologët, mjekët e të tjerë. Ka edhe punonjës partic që flasin për çështjen e teknokratizmit, por harrojnë se në punën e tyre, po të mos tregohen revolucionarë, po të mos luftojnë rutinën, burokratizmin dhe intelektualizmin, vetë janë teknokratë.

Të drejtosh Partinë jo në mënyrë revolucionare, s'bën tjetër veçse kthehesh në një burokrat dhe teknokrat të dëmshëm, pse rregullat, normat, vijën e Partisë nuk i kupton dhe nuk i zbaton në mënyrë të gjallë, duke ua përshtatur kohës, rrethanave dhe njëkohësisht duke ruajtur kurdoherë parimet.

Për disa shokë të vjetër që kanë punuar në aparate partie themi se «kanë një eksperiencë të madhe». Kjo është e vërtetë dhe, për këta shokë, një eksperiencë e tillë është kthyer në një teknikë, ashtu siç është mekanika për inxhinierin. Por në qoftë se ndodh që ky i fundit, duke nxjerrë në plan të parë teknikën, shndërron në teknokrat, kështu edhe kjo «eksperiencë e madhe», po të zhvishet nga fryma revolucionare e të shkëputet nga parimet, mund të kthehet edhe për punëtorin e Partisë në teknokratizëm e burokratizëm dhe në këtë rast këto të këqija i zënë frymën Partisë. Prandaj rreziqet e këtyre sëmundjeve nuk janë vetëm për teknikët e sektorëve jashtë Partisë, por edhe për sektorët e brendshëm të Partisë.

Tradhtari i Partisë Hito Çako ka deklaruar në mënyrë cinike se «në kuadrot e ushtrisë, e cila është armë e diktaturës së proletariatit, nuk na prekin ligjet e proletariatit». Kur shtrembërohet në mënyrë të tillë teorike përgjegjësia e ushtarakëve para ligjit dhe mjaftohet të luftohet kundër këtyre qëndrimeve vetëm me shpjegime sempliste, ato bëhen të rrezikshme.

Në disa aparate shtetërore, dhe sidomos në disa kuadro me arsim të lartë, përveç të tjerave, ka hedhur rrënjë të thella teknokratizmi. Ata e quajnë veten se janë «kompetentë» në punën e tyre e, duke qenë edhe komunistë, e injorojnë rrezikshmërinë e teknokratizmit për zhvillimin e punëve dhe për Partinë. Ata flasin për «kompetenca», dhe kompetenca kanë e duhet të kenë, por, në rast se këto, plus teknokratizmi, plus burokratizmi etj., nuk luftohen, do të zhvillohen, siç u zhvilluan në naftë, në Ministrinë e Industrisë e të Minierave dhe gjetkë, atëherë vetë Partia në këta organizma burokratizohet, teknokratizohet, intelektualizohet dhe organizata e Partisë atje vetëm sa e mban emrin marksiste-leniniste, sepse esenca e saj ka ndryshuar. Ky është një rrezik i madh që duhet luftuar me forcë, politikisht, ideologjikisht, organizativisht dhe, kur është nevoja, edhe administrativisht. Ky rrezik vjen më shumë nga kuadrot, prandaj nuk duhet të lejojmë që kuadrot e aparateve dhe të administratës, të prekur nga këto sëmundje, të na krimbin Partinë. Partia duhet të ushtrojë ligjin e saj mbi ta dhe jo sëmundjet e tyre të lihen që të infektojnë Partinë.

Shokët, pra, në planin e punës sonë duhet të na

sjellin analiza marksiste të problemeve, shkurt e qartë dhe jo të na bëjnë agjitacion bajat ose teori me lëng qepe.

Tema teorike me përmbajtje të thellë duhet me-  
doemos të bëhen. Edhe në këto raporte pune që na pa-  
raqiten për shqyrtim mund dhe duhet të futen konsi-  
derata politike e ideologjike edhe për ne, por të kihet  
parasysh që të mos na konsiderojnë si «kooperativistët  
e rinj» për këto probleme.

Ne e kemi organizuar çështjen e problemeve që  
marrim në shqyrtim, po kështu dhe Qeveria, por du-  
het të mos vazhdohet të merren shumë probleme, të  
shkruhen për çdo problem shumë faqe, të thërriten në-  
për mbledhjet shumë njerëz, saqë të kthehen në kon-  
ferenca. Mbledhje të tilla shumë të gjera nën pretekstin  
e «një pune të gjerë e të hapët» frenojnë kritikën e  
rreptë dhe parimore, si rrjedhim humbet kontrolli  
dhe, siç shohim, në disa dikastere po bëhen gabime  
serioze.

Te ne kuadro ka boll, me organika dhe me listor-  
ganika. Kjo është një fryrje e madhe që krijon buro-  
kracinë dhe që ka lejuar pikërisht të bëhen këto gabi-  
me. Nga një anë, gjoja teorikisht, e luftojmë dhe  
flasim kundër burokratizmit, kurse, nga ana tjetër, në  
praktikë atë e shtojmë dhe, për ta fshehur këtë shtesë,  
sajojmë terma e krijojmë drejtori gjoja të domosdosha-  
me, por që, në fakt, punën nuk e kanë bërë si duhet,  
përkundrazi, disa sabotojnë. Me të tilla veprime krijoj-  
më jo vetëm hallka të panevojshme, por, çka është më  
e rrezikshme, edhe një mentalitet burokratik.

Ministritë duhet të vënë rregull dhe disiplinë në punët e tyre, pse vërehen lëshime. Janë krijuar hallka organizative të shumta dhe të panevojshme, të cilat pengojnë seriozisht punën dhe mbytin iniciativën. Disa ministri kanë shkuar nga një rrugë jo e drejtë për këtë çështje, që nuk i përshtatet plotësisht vijës së Partisë. Krijimi i gjithë këtyre drejtorive e nëndrejtorive, agjencive dhe nënagjencive duket sikur shpejton realizimin e detyrave, sikur pushteti i afrohet më shumë bazës. Po harrohet se të gjithë këta organizma rëndojnë aparatet, bëjnë që të krijohet një hierarki jorevolucionare. njëri i jep urdhër tjetrit dhe, sa më lart qëndron njeriu, aq më i rëndë bëhet, humbasin elasticiteti, fryma revolucionare dhe kontakti me bazën. Duket sikur shkohet në bazë, por kësaj vetëm i jepen urdhra dhe nuk i plotësohen nevojat. Baza humbet kështu hovin dhe iniciativën dhe, në vend që shumë gjëra t'i zgjidhë vetë, dëshpërohet kur sheh kaq njerëz me rrogë fikse, me jo më pak se 700 lekë në muaj. Të gjitha këto nuk janë të mira.

Një situatë e tillë, e lënë pa u riparuar për vite me radhë, në Bashkimin Sovjetik shkaktoi katastrofën. Shprehja «aparatchikët»<sup>1</sup> nuk ishte vetëm një slogan përbuzës, por edhe një realitet i hidhur.

Ky rrezik ekziston edhe te ne në qoftë se nuk e luftojmë kurdoherë e sistematikisht. Unë jam i mendimit se nuk është shumë e nevojshme të bëhen fjalime të gjata dhe të japim e të vazhdojmë të japim

---

1. Nëpunësit e aparateve.

udhëzime, kryesorja është të marrim masa organizative për të ndrequr gjendjen, pse fjalime ka boll dhe të flasësh e të flasësh, të shkruash e të shkruash dhe të mos marrësh masa të përshtatshme për ato që flutur dhe që shkruan, do të thotë «të bluash si mulliri pa kokrra». Shkrimet dhe librat duhet të shërbejnë për të mësuar diçka të re, që të na ndihmojë për të çuar punën përpara, për të spastruar të këqijat, të panevojshmet, ferrat që na ngatërrojnë këmbët.

Ne themi se vijën e kemi të drejtë dhe të tillë e kemi, por ka organizma dhe njerëz që e zbatojnë edhe me gabime, disa herë kjo vijë edhe shtrembërohet, nuk kuptohet, ose kuptohet, por zbatohet gabim. Atëherë nuk duhet të na zërë gjumi në dafina, pse edhe Partia Komuniste (bolshevike) e Bashkimit Sovjetik e kishte vijën të drejtë, atë e kishin përpunuar Lenini dhe Stalini, por ç'u bë më pas me këtë vijë, të gjithë e dimë, dhe përse? Për shumë arsye. Por një gjë e tillë mund të na ngjasë dhe neve.

Nëpër mbledhje e fjalime nuk mungohet të flitet në mënyrë superlative: «Kemi kuadro të mrekullueshëm». Edhe Stalini thoshte se «kuadri zgjidh çdo gjë». Këto afërsisht janë njësoj, por në Bashkimin Sovjetik kundërrevolucionin e bënë kuadrot, natyrisht kuadrot e këqij. Po të mirët ku ishin? Ç'u bënë? Pse nuk reagon? Atje as klasa punëtore nuk reagoi. Po pse? Se e kishin mbytur «aparatchikët». Formalisht në Bashkimin Sovjetik flitej sa të duash për rolin e klasës punëtore, por ajo ishte zbatuese dhe jodrejtuese. Një rrezik i tillë mund të jetë iminent edhe te ne, në rast se nuk zbatoj-

më në jetë parimet marksiste-leniniste e mësimet e Partisë sonë. Kuadrot kanë vendin e tyre, kanë rolin e tyre, por këta jo të bëjnë ligjin mbi Partinë, por Partia e klasa të bëjnë ligjin mbi ta. Kjo nuk është punë e lehtë dhe që mund të kryhet me një leksion, duhet një edukim dhe një kontroll i vazhdueshëm.

Ne përgatitim njerëzit që të udhëheqin klasën dhe nuk përgatitim këtë ashtu si duhet që të drejtojnë. Hezitohet shumë të vihet një punëtor të drejtojë një ndër-marrje, pse thuhet që duhet me shkollë, me universitet. Sigurisht që duhet shkollë, por kuadrove me shkollë më parë duhet t'u bëjmë shkollën e klasës punëtore, domethënë të mësojnë se ata janë nën drejtimin e klasës, se duhet të dëgjojnë klasën, të pyesin klasën dhe të lodhen si klasa. Ne duhet t'i mësojmë punëtorët që t'i zëvendësojnë kuadrot në drejtim dhe këta të zëvendësojnë punëtorët në punën e tyre. Të bëhet qarkullimi me seriozitet të madh, pse kjo nuk po bëhet si duhet dhe këtu qëndron një e keqe e madhe.

Kuadrot tanë të mësuar dhe të mirë shumë herë rriten me një pikëpamje joproletare, sipas së cilës «ata do të drejtojnë». Dhe ç'ndodh? Njerëzit «e mësuar» qëndrojnë në krye të piramidës, kurse ata të punës në fund. Kjo nuk është e drejtë, nuk është aspak e mjaftueshme që kjo kuptohet gjoja teorikisht, por, edhe sikur të kuptohet, teoria duhet të zbatohet në praktikë, gjë që për këta është ca e zorshme, e hidhur, me perturbatione, pse veprojnë në frymën e sëmurë të sentimentalizmit e të burokratizmit, nën maskën se «nuk ecin keq gjërat edhe kështu», ose duke thënë «i dhamë

kaq vjet shkollë dhe ky kuadër të shkojë në bazë, në prodhim! Po kush do të drejtojë? Këta na duhen në dikaster, në institut, në universitet» etj.

Ky është një kompleks që duhet të kuptohet dhe të zgjidhet politikisht, ideologjikisht, organizativisht dhe financiarisht. Duhet të bëhet një freskim i madh i çdo gjëje në të gjitha këto drejtime të studiuara me kujdes dhe të merren masa të përshtatshme njëra pas tjetrës, njëra të plotësojë tjetrën. Kjo do të na forcojë Partinë, pushtetin, diktaturën e proletariatit, ekonominë dhe kulturën tonë socialiste.

S'ka dyshim se vija e Partisë sonë është e drejtë dhe me zbatimin e saj në jetë ne kemi arritur kaq suksese në të gjithë sektorët, por në rast se lejojmë shtrembërimet qoftë nga njerëz, qoftë nga organizma jo të përshtatshëm ose të dyshimtë, atëherë kjo vijë dhe sukseset mund të zbehen e të na krijohen situata të vështira. Të gjitha ato që na ngjanë dhe konkluzionet reale që nxjerrim prej tyre vërtetojnë këto që themi. Pesimistë nuk kemi qenë kurrë, as jemi dhe as do të jemi të tillë, por të mbyllim sytë përpara këtyre fenomeneve negative, të mos thellojmë arsyet e të mos propozojmë edhe zgjidhjet përkatëse, këtë nuk do ta bëjmë kurrë. Në jetë dhe në punë duhet të mbështetemi në realitetin, të parashikojmë mirë të ardhmen dhe, në mënyrë revolucionare e me besim, të spastrojmë terrenin nga të këqijat, që ta përgatitim këtë të ardhme çdo ditë e më të lumtur për popullin. Kurdoherë e kam theksuar se euforia e pabazuar dhe rrubullakosja e të metave me një cipë optimiste janë



shumë të rrezikshme, prandaj këto s'duhet t'ia lejojmë vetes, se janë mbyllje e syve përpara një gjendjeje të sëmurë dhe duke folur si «tellall» për luftën e klasave, nuk bëhet tjetër veçse dobësohet kjo luftë.

Vija e drejtë politike dhe organizative e Partisë është çdo gjë, ajo është garancia e sukseseve tona tash dhe në të ardhmen, ashtu siç ka qenë dhe në të kaluarën. Këtë vijë marksiste-leniniste do ta zbatojnë njerëzit. Prandaj Partia i edukon me kujdesin më të madh punonjësit si dhe kuadrot e organizuar ose jo në Parti, mbasi këta kanë një mision të rëndësishëm. Por ky mision nuk është ekskluziv i tyre dhe i marrë e i kuptuar jashtë klasës punëtore dhe masave që udhëheqin. Pikërisht këtu hegjemoni të Partisë dhe të klasës së saj kuadrot duhet ta kuptojnë drejt nga ana ideologjike dhe të luftojnë për zbatimin në praktikë të parimeve. Kuadri është me vlerë të madhe kur edukohet dhe vepron në bazë të ideologjisë marksiste-leniniste, kur kupton dhe zbaton mirë në jetë vijën e Partisë. Është konditë *sine qua non* që kuadri t'u shpëtojë ideologjisë borgjeze dhe kllapave të saj që e presin në rrugën plot luftëra dhe vështirësi. Kuadri mund të jetë i ri, pa eksperiencë, mund të jetë edhe i kaluar dhe me eksperiencë; i pari duhet të mësojë në shkollën e klasës, në ligjet dhe në normat e klasës; i dyti duhet të vazhdojë dhe ai ta kalitë eksperiencën e vet në ligjet e klasës dhe në normat e klasës, që janë ato të Partisë.

Tërë jetën kuadri duhet të bëjë revolucion, të jetë në revolucion me vetveten e me të tjerët. Ky duhet të jetë ligj, ndryshe kuadri myket, e kap skleroza mik-

roborgjeze që ka shumë emra: mendjemadhësi, arrogancë, karrierizëm; kujton se u bë qendra e vëmendjes, e mbulon plogështia, rehatia, i lindin ambicie dhe dëshira të paligjshme, kërkon pozita të dënueshme dhe jashtë ligjit, bëhet formal me vijën dhe ideologjinë e Partisë dhe kështu fillon dhe rritet degjenerimi i tij. Të gjithë kuadrot nuk janë dhe nuk mund të bëhen të tillë, por vigjilenca e gjithë Partisë, e klasës dhe e masave punonjëse për asnjë moment nuk duhet të bjerë. Kjo të kuptohet drejt: kuadrove u duhet besuar, por edhe duhet kontrolluar puna e tyre. Të kuptohet drejt se kuadrot vazhdimisht duhen edukuar, por edhe qortuar, edhe ndëshkuar sipas fajeve, kur bëjnë. Të flesh duke menduar se këta janë kuadro, të lejosh që këta të veprojnë jashtë normave të Partisë, se qenkan të vjetër, të mbyllësh njërin sy përpara gabimeve dhe fajeve të tyre, kjo do të ishte shumë e rrezikshme. Këto gabime duhen evituar medocemos.

Qoftë në Parti, qoftë në pushtet sidomos, kuadrot duhet të kuptojnë se çdo funksion, çdo kompetencë, çdo e drejtë që u akordohet me ligj apo me orientim, janë jo tituj, jo favore, jo kompetenca për personin e tyre, por detyra partie dhe shtetërore për ta, janë atribut që u jepet për të kryer direktivat, për të organizuar dhe për të kryer punën brenda ligjeve dhe normave të Partisë dhe të shtetit. Të gjitha këto çështje duhet të kuptohen politikisht dhe ideologjikisht e të kontrollohet nga vetë kuadri dhe nga të tjerët nëse shikohen dhe zbatohen çështjet me këtë sy partie. Ka shumë kuadro që janë larg ta bëjnë këtë si duhet dhe

vazhdimisht, prandaj ata gabojnë, prandaj bëhen të pakënaqur kur «bien nga fiku», pse që më parë kishin krijuar iluzione të gabuara, notonin në iluzione të gabuara, me kohë ata ecnin në kundërshtim me vijën e Partisë, pse nuk e shihnin, nuk donin ta shihnin, nuk ndihmoheshin të korrigjoheshin, ose nuk i pranonin korrigjimet.

Korrigjimet e të metave në njerëzit, në udhëzimet, në direktivat duhet të bëhen vazhdimisht kur duken, pale kur trashen. Njerëzit që sëmuren, që i mbulon burokratizmi, intelektualizmi, zor se mund t'i shohin dhe t'i pranojnë me lehtësi të metat, gabimet dhe shtrembërimet. Këta njerëz duhet të dimë se borgjehzohen dhe, kur bëhen të tillë, duan të punojnë më pak, të krijojnë organizma mbi organizma që t'u kryejnë punët pa kokëçarje të madhe nga ana e tyre, të krijojnë nën vete dhe përreth sa më shumë vartës për të ndarë ose për të hequr fare përgjegjësinë, për të shtuar autoritetin e tyre si «gjeneralë» të një ushtrie të madhe dhe për të shitur mend më shumë. Në këto pikëpamje, në presionin e teknokratëve e në të tjera rrethana e kanë burimin të famshmet listorganika të krijuara në kundërshtim me vendimet e Byrosë Politike. Ne e dimë se ajo vendosi të shkurtohen organikat e aparateve shtetërore dhe ato u shkurtuan në masën 5 mijë veta. Mirëpo më pas, nën pretekstin e «listorganikës», ata që dëbuam nga dera, na hynë gjashtëfish më tepër nga dritarja, domethënë organikave iu shtua në fakt edhe «listorganika» me rreth 30 mijë veta. Ç'janë këta 30 mijë dhe si konsiderohen? Këta janë nëpunës, rrogë-

tarë, inxhinierë, teknikë e të tjerë dhe të gjithë, për t'u maskuar, jo vetëm që në organikë nuk konsiderohen nëpunës, siç janë në fakt shumica dërrmuese, por, duke qenë në listorganika, cilësohen «punëtorë» ata që në fakt s'janë punëtorë.

Deri atje të çon burokratizmi sa të bësh edhe gabime të rënda ideologjike revizioniste dhe inxhinierët e nëpunësit t'i klasifikosh si klasë punëtoare. Në këtë mënyrë, me një akt legal, është ligjëruar një parim ilegal revizionist, janë integruar shtresa të tjera në klasën punëtoare, është konfunduar kjo, i është humbur me këtë mënyrë klasës punëtoare tërësia dhe hegjemonia dhe është bërë heterogjene, derisa t'i merret pushteti.

Të tilla gabime serioze nuk duhet t'i lejojmë të bëhen, të tilla gabime duhet t'i njohim në rrezikshmërinë e tyre dhe t'i korrigjojmë sa më parë. Këtu luhet me fatin e Partisë dhe të socializmit, prandaj, për t'i mbrojtur këta, në asnjë mënyrë nuk mund të shkohet nga ideja e gabuar se mos i bjerë prestigji ndonjërës prej levave të Partisë o të pushtetit. Jo, Partia dhe klasa nuk mund të sakrifikojnë të tërën për një pjesë që është e gabuar. Kjo është me rëndësi të madhe parimore dhe e theksoj sepse ngandonjëherë bëhen arsyetime subjektive, që nuk të çojnë në mbrojtjen e parimeve. Parimet duhen mbrojtur kundër çdo furtune qoftë. Furtunën, edhe në qoftë se vjen, duhet të jemi të përgatitur mirë ta përballojmë, por kur je i sëmurë, furtunën s'e përballon dot. Krimbi nuk duhet lejuar të hyjë në trupin e shëndoshë, por duhet ta ngordhësh pa hezitim që në vezë.

Ja ç'na ngjau në naftë, një sabotim dhe një punë armiqësore e theksuar nga një grup nëpunësish, si Lipe Nashi, Beqir Aliaj e ndonjë tjetër. Unë nuk do të hyj në detaje për këtë, pse çështja është e njohur.

Desha të theksoj një aspekt tjetër të çështjes. Ministria e Industrisë dhe e Minierave, me Koço Theodhosin në krye, në fakt e kishin shkëputur krejt Drejtorinë e Përgjithshme të Naftës nga ministria dhe ajo ishte bërë «një trust që vetadministrohej». Ajo kishte buxhetin e saj, fondet e saj në devizë, ajo mund ta shiste tejkalimin e planit dhe dollarët t'i merrte vetë mbi kuotat e caktuara, të blinte me ta ç'të donte, jashtë planit. Me fjalë të tjera, kjo u ngjiste ndërmarrjeve vetadministruese jugosllave. Këtë farë ndërmarrjeje Ministria e Industrisë dhe e Minierave e jepte si shembull për krijimin e ndërmarrjeve të tjera, siç i krijoi. Drejtoria e Përgjithshme e Naftës ishte bërë edhe bankë. Me fondet e saj dhe me materialet e naftës ajo ndërtonte ura, rrugë në qytete, blinte, shiste, pajiste me aparatura spitale e ndante edhe peshqeshe, automobila, televizorë etj., ku kishte qejf Lipe Nashi, i mbulluar, i ndihmuar, i mbrojtur nga Pirro Gushoja.

Pra, ja ç'do të thotë të mungojë vigjilenca, të besohet qorrazi, të merren vendime delikate me një lehtësi sikur blen një palë këpucë. Kuadri është i vlefshëm kur punon mirë, por ai bëhet i keq kur del nga binarët e Partisë, vret e pret dhe ua hipën Partisë dhe klasës në zverk.

Në të gjitha organizatat e Partisë, sidomos të aparateve shtetërore e të Partisë, në qendër e në rrethe, ne duhet të bëjmë jashtëzakonisht kujdes në zbatimin

drejt të vijës së Partisë, pse fare lehtë mund ta dobësojmë kritikën në mes njëri-tjetrit dhe të na krijohet mendimi se jemi të pakritikueshëm, sikur ligjet e Partisë dhe të shtetit nuk janë për ne, por për të tjerët. Sidomos në ato organizata ku nuk ka punëtorë që të na shkundin si duhet kur bëjmë gabime, ne duhet të mos harrojmë se jemi anëtarë partie dhe duhet me doemos të veprojnë dhe të mendojmë siç vepron dhe siç dëshiron klasa, siç e lypin interesat e Partisë dhe të klasës. Këtë të mos e harrojmë kurrë, se përndryshe i kemi bërë Partisë një dëm të pallogaritshëm.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1974-1975», f. 128*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1974-1975», f. 128*

**PARTIA DO QË NIVELI I JETESËS SË POPULLIT  
TË JETË I KÛNAQSHËM, POR JO TË KRIJOHEN  
SHTRESA TË FAVORIZUARISH DHE  
TË BORGJEUARISH**

Shënime

28 mars 1975

Kudo dhe kushdo në vendin tonë flet se «jemi shumë mirë, ka çdo gjë, mallra ushqimore dhe industriale». Po kështu në çështjen e strehimit në qytete janë bërë shumë përmirësime, sido që nevojat janë akoma të mëdha, kurse në fshat strehimi është i mirë dhe nuk ekziston si problem, ndërsa gjendja ekonomike edhe këtu është përmirësuar, por është akoma prapa nivelit të jetesës së punonjësve të qytetit.

Ne konstatojmë se çmimet në treg nuk kanë pësuar asnjë ngritje për punonjësit. Kjo ndodh edhe për meritë të shtimit të prodhimit nga ana e punonjësve, por edhe pse një numër prodhimesh bujqësore tonat ose të importuara subvencionohen nga shteti për të ruajtur stabilitetin. Për prodhimet e fabrikuara në vend marzhet e shitjes, përqindjet e akumulimit etj. nuk ja-

në të larta. Kështu ka stabilitet çmimesh, qiratë janë të ulëta e nuk lëvizin dhe të drejtat e sigurimeve shoqërore shtetërore janë stabël. Shkollat, kurimet dhe shumë avantazhe të tjera të ne janë falas.

Nga ana tjetër, në vendin tonë nuk ekziston papunësi dhe në çdo familje të paktën burri dhe gruaja punojnë, por edhe prindërit e tyre ose vazhdojnë të punojnë, ose kanë dalë në pension. Pra, zakonisht në një familje me 5 veta, 3 ose 2 prej tyre marrin rrogë dhe një është pensionist, prandaj fuqia blerëse nuk është e paktë. Shumë familje me radhë kanë shtëpi komode, të mobiluara, mjaft kanë televizor, për të mos folur për radio, kanë edhe frigorifer, edhe makinë për të larë rrobat, kanë edhe të holla të depozituara në arkat e kursimit. Po të marrim sidomos një kategori nëpunësish të lartë, atëherë do të kemi një tablo edhe më të mirë të gjendjes ekonomike të punonjësve. Këto kategori që përshkrova më sipër, dhe veçanërisht nëpunësit dhe specialistët e lartë, bëhen kështu të privilegjuar në krahasim me të tjerët dhe rrojnë shumë më mirë.

Ne, edhe në të kaluarën, krejt ndryshe nga vendet revizioniste, kemi pasur diferenca të vogla midis pagave të ulëta e të larta. Në vitin 1967 këto diferenca mbetën në raport 1 me 2 deri 2,5. Por në këtë drejtim gërshëra duhet ngushtuar më tej. Të kuptohet drejt, Partia lufton dhe do të luftojë kurdoherë që të përmirësohet vazhdimisht jeta e njerëzve, por e të gjithëve, duke u udhëhequr nga parimi i drejtë që të mos ketë barazim në paga, por as favorizime për kurrkënd. Çdo pagë t'u përshtatet sasisë dhe cilësisë së punës që bën



gjithsecili dhe dallimet e pagave në mes të punonjësve të shkojnë duke e ngushtuar marzhin e tyre. Kjo nuk duhet kuptuar si «ulje» e nivelit të jetesës së punonjësve, por si një nxitje për përmirësimin e nivelit të jetesës, duke prodhuar më mirë, më shpejt dhe më lirë. Në këtë rrugë të drejtë forcohet stabiliteti ekonomik, shkohet jo drejt ngritjes së rrogave, por drejt uljes së çmimeve, shkohet drejt solidaritetit të punonjësve dhe kalitjes së ndërgegjes proletare të njerëzve, të cilët në këtë mënyrë luftojnë kundër borgjezimit.

Nuk duhet harruar se në këto momente «rrojta shumë mirë» e «disave» sjell me vete borgjezimin e tyre dhe, duke e quajtur veten si «të zotë e të mësuar», ësh-të e natyrshme, thonë ata, «që të rrojmë mirë», «shteti na jep, se punojmë dhe e meritojmë». Por këto pikë-pamje dhe këto situata ne duhet t'i ndjekim me vëmendje dhe me vigjilencë si situata dhe fenomene shoqërore të rrezikshme, që krijohen në shoqërinë tonë socialiste pa u dukur, pa kuptuar.

Këto ne nuk duhet t'i shikojmë si shfaqje individuale, përkundrazi, në rast se me ligjet dhe urdhëresat tona nuk i korrigojmë dhe nuk i adaptojmë në përputhje me situatat e krijuara, mund të na krijohen jo një ose dhjetë persona, por grupe të tëra dhe shtresa njerëzish të borgjezuar, të dalë nga shoqëria jonë socialiste, që ndikohen lehtë ose që bëhen bartësit e revizionizmit dhe të borgjezisë së re që kërkon të ruajë privilegjet e fituara, t'i zgjerojë këto në kurriz të punëtorëve dhe të fshatarëve dhe, më në fund, edhe të komplotojë, siç bënë Beqir Balluku, Hito Çakoja, Petrit Dumja

e të tjerë, për të rrëzuar diktaturën e proletariatit.

Në Byronë Politike për çështjen e rëndësishme të sistemit të pagave kemi marrë një sërë vendimesh për rregullimin e mëtejshëm të rrogave, për afrimin më shumë të rrogave të larta me ato më të ulëta, për ngushtimin po ashtu të kategorizimeve edhe të punëtorëve, edhe të nëpunësve, me qëllim që të mos ekzistojnë disnivele të mëdha në paga dhe në vetë punëtorët, por, çka është e rrezikshme, sidomos në mes të nëpunësve e intelektualëve në krahasim me klasën punëtore dhe sidomos me kooperativistët. Natyrisht, te ne vazhdojnë të qëndrojnë parimet «kush punon ha» dhe «sipas punës, edhe paga», por për këtë të dytën varet si i përcakton koeficientët dhe ndryshimet në pagesat sipas punës, i shikon këta në prizmin e ligjeve të diktaturës, në prizmin e klasës punëtore dhe në interes të socializmit, apo nuk je rigoroz në shikimin e të gjithë këtyre rregullatorëve.

Të mos na mbulojë euforia dhe kënaqësia e përgjithshme dhe të mos lejojmë anomali që mund t'u kushtojnë shtrenjtë Partisë dhe socializmit. Lenini thotë se «prona private lind çdo ditë kapitalizmin...»<sup>1</sup>, por edhe «rrogat e majme» ngjallin dëshirën për të krijuar fitime më të mëdha, të rregullta e të parregullta, ato krijojnë dëshirën të rrosh, të hash, të vishesh më mirë dhe të borgjezohesh, duke u maskuar nën parulla komuniste, duke pasur edhe taserën e Partisë në xhep. Po të të thotë Partia: «Çohu tash, se nevoja e atdheut e do që

1. Shih: V. I. Lenin, Veprat, vëll. 31, f. 8.

të transferohesh», atëherë thartohesh, bëhesh i pakënaqur. Kur për një arsye të drejtë ulesh në funksion, domethënë të pakësohen të ardhurat dhe «nderet», atëherë bëhesh përsëri i pakënaqur, bëhesh një pre i ndikimeve revizioniste.

Shokët, natyrisht, të gjithë i aprovojnë këto që themi, i gjejnë të drejta dhe shqetësohen, por veç vendimet e rëndësishme që kemi marrë, nuk janë ndjekur si duhet. Unë mendoj se këto vendime kanë hyrë në dollapët e burokratizmit shtetëror dhe rutina bën t'i mbulojë pluhuri, i lë të ecin më javash në rrugën e tyre, pa u qenderosur të shikohet se si zbatohen, pa i ballafaquar me politikën ekonomike të vendit etj., etj.

E keqja e madhe në disa nga kuadrot tanë shtetërorë është një vetëkënaqësi jo e shëndoshë që na shpjegohet: «Kur e studiuam këtë problem, mobilizuam këtë dhe atë, u bë projekti, u mor vendimi» etj. Po fati i mëtejshëm i tyre? «Do të vijë relacioni» (burokratik), kur t'i vijë radha pas dy vjetësh dhe gjatë kësaj kohe dalin një mori problemesh të mëdha, por më shumë të vogla, që na bëjnë të harrojmë të mëdhatë. Dhe një mëngjes na pëlçet një punë e keqe si në ushtri, në naftë e nesër në ndonjë vend tjetër!

Dhe cilët janë këta që përpiqen t'i hedhin bombën pushtetit popullor? Janë pikërisht ata elementë anti-parti, antimarksistë e të degjeneruar që nxjerrin brirët nga këto lëshime të palejueshme që bëhen.

Partinë e gëzon shumë fakti që gjithë populli, me klasën punëtore në krye, është ngritur në këmbë dhe po i godet fort burokratizmin e burokratët dhe këtë

luftë të madhe masat tona punonjëse nuk e kuptojnë në mënyrë të sipërfaqshme, por, në radhë të parë, politiki-  
kisht dhe ideologjikisht.

Klasa dhe Partia ta kenë parasysh iluzionin e di-  
save që mendojnë se «do të kalojë edhe kjo valë, pas-  
taj do të kthehemi prapë ku ishim». Nga kjo frymë  
duhet të ruhen sidomos ata që edhe rrogë të mirë e  
fikse marrin, por, përveç kësaj, marrin edhe honorare,  
bëjnë më pak orë pune për rrogën që marrin, japin  
edhe mësim me shpërblim, korrigjojnë libra, shkru-  
ajnë ndonjë artikull, bëjnë ndonjë pllakatë, recension  
etj. Po t'i mbledhësh të ardhurat që realizojnë nga të  
gjitha këto, u bëhen dy rroga! Këta njerëz, me masat  
që po marrim, do t'i humbasin këto të ardhura. Populli  
duhet ta dijë se, që të marrësh honorare mbi honorare,  
kjo bie në kundërshtim me normat e moralit tonë pro-  
letar. Në qoftë se disa nga këto rregulla për honorare  
janë vënë nga ana e shtetit, kjo është bërë për të për-  
krahur veprimtarinë krijuese shkencore, artistike etj.  
të njerëzve të ndershëm në shërbim të revolucionit e  
të socializmit. Mirëpo krahas tyre kanë dalë parazitë dhe  
burokratë që, duke u fshchur padrejtësisht pas ligjeve,  
spekulojnë dhe shndërrohen në kërpuçdhë të helmatisura.

Prandaj t'u vëmë fshesën këtyre lloj shfaqjeve  
dhe shtëpinë ta mbajmë të pastër. Shteti i proletarëve as-  
një njeriu të ndershëm nuk i bën dhe nuk do t'i bëjë ku-  
rrë padrejtësi, por askush të mos guxojë t'i bëjë padrej-  
tësi shtetit, se ligjet e tij e godasin rëndë. Partia u thotë  
këtyre: «Rroni dhe punoni ndershmërisht, që të meritoni  
respektin e shoqërisë, të klasës punëtore e të Partisë».

Partia e ka edukuar dhe e edukon popullin t'i gjykojë drejt politikisht problemet dhe njerëzit, të mos bjerë në kurthet që ngre armiku, që, kur s'duhet, hiqet liberal, dhe kur duhet luftuar liberalizmi, na hiqet revolucionar, majtist.

Klasa dhe populli të thellohen në mësimet e Partisë, çdo gjë ta gjykojnë në interesin e përgjithshëm, të evitojnë shikimin e problemeve dhe të njerëzve thjesht dhe vetëm në prizmin personal dhe të flasin, të mos mbyllin gojën për të mbrojtur të drejtën dhe të drejtin, për të luftuar ligësinë dhe të ligun.

Interesi i Partisë e do që niveli i jetesës së popullit të jetë i kënaqshëm, por pa lejuar që të krijohen individë dhe shtresa të favorizuarish dhe të borgjezuarish. Partia, gjithashtu, duhet të jetë shumë kursimtare dhe të mos harrojë për asnjë moment situatat e vështira që ekzistojnë dhe kërcënimet për luftë. Prandaj, si konkluzion, këto probleme jetike Partia dhe organet shtetërore duhet t'i kenë kurdoherë parasysh.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1974-1975», f. 141*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1974-1975», f. 141*

# MARKSIZËM-LËNINIZMI — ARMA E KLASËS PUNËTORE

Shënime<sup>1</sup>

29 mars 1975

Siç e kam thënë edhe herë të tjera, në rast se studimi i teorisë sonë (teoria e Marksit, e Engelsit, e Leninit dhe e Stalinit) nuk bëhet në lidhje të ngushtë me mësimet e Partisë dhe me praktikën 30-vjeçare të ndërtimit të socializmit në vendin tonë, ky studim nuk do t'u shërbejë aq sa duhet kuadrove. E mësuar vetëm në libra, teoria ka rrezik të harrohet, jo plotësisht, por të mos shfrytëzohet si duhet dhe kur duhet për të zgjidhur drejt problemet që u dalin kuadrove dhe organeve të ndryshme të Partisë e të shtetit.

Studimi libresk, pa u lidhur në mënyrë fort të organizuar me praktikën, harrohet, ose herë pas here kuadrit mund t'i kujtohen disa reminishenca nga ato që ka mësuar në libra, por që as di t'i lidhë me pro-

---

1. Këto shënime shoku Enver Hoxha i ka përdorur në një bisedë me shokun Ramiz Alla.

blemin dhe rrezikohet kështu të mos udhëhiqet drejt në zgjidhjen e çështjes që i vihet përpara.

Shumë herë kuadrot që mësojnë teorinë në libra bien në praktikizmin e në rutinën e përditshme të punës dhe harrojnë se teorisë që kanë mësuar duhet t'i rikthehen vazhdimisht, për të bërë jo vetëm studim integral, por edhe të pjesshëm, lidhur me problemet e jetës. Në klasikët tanë të mëdhenj nuk mund të gjenden receta për hallet e përditshme të vendit, por tek ata do të gjendet kurdoherë vija e përgjithshme, ligji i pagabueshëm teoriko-politik për veprim.

Një kuadri me kulturë marksiste-leniniste, me kulturë të përgjithshme dhe me kulturë speciale, një frazë, një paragraf, një ide e teoricienëve tanë të mëdhenj i hap horizonte të gjera pune dhe vështrimi të drejtë. Por marksizëm-leninizmi nuk duhet të jetë i kuptueshëm vetëm për njerëz të mësuar, kryesisht ai duhet të bëhet arma e klasës punëtore. Kjo, në radhë të parë, duhet ta përvetësojë e ta dijë këtë armë dhe ta përdorë si duhet, pse është arma e saj. Klasa udhëheq dhe nuk lejohet të mendohet për asnjë çast se marksizëm-leninizmi është një filozofi që mund të punohet, të përvetësohet dhe të përdoret vetëm nga inteligjencia, pse kjo është në gjendje ta kuptojë. Një pikëpamje e tillë të çon në rreziqe të mëdha. Inteligjencia absolutisht duhet ta mësojë marksizëm-leninizmin, se atëherë do të bëjë më pak gabime në punë dhe në jetë, por kryesorja është ta mësojë si duhet klasa teorinë e saj. Dhe këtë e ka për detyrë t'ia mësojë asaj Partia, t'ia bëjë të qartë, të kuptueshme dhe të zbatueshme.

Partia, anëtarët e saj duhet ta dinë në radhë të parë teorinë e Partisë së Punës të Shqipërisë. Ne aktualisht klasën e kemi të ngritur, me shkollë, me zotësi teknike, e kemi mjaft të ngritur edhe ideologjikisht, por na vihet detyrë që ta edukojmë dhe ta kalitim më tej.

Prandaj, si në të gjitha çështjet, edhe në drejtim të edukimit teorik, të formave të ndryshme që kemi caktuar, mendoj të bëjmë sondazhe dhe analiza për të parë nëse janë të përshtatshme apo mos duhen ndryshuar, mos duhen përmirësuar, duke hequr disa që kanë qenë të përshtatshme për një situatë të kapërcyer, dhe të vendosim të tjera që i kërkojnë situatat dhe ngritja e nivelit kulturor të klasës dhe të kuadrove.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



## KUADRI DUHET TË EDUKOHET NË SHKOLLËN E KLASËS PUNËTORE

*Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë  
të Partisë*

31 mars 1975

Problemet që dalin nga ndihma e kontrolli në ushtri për punën me kuadrin, dhe që ne po i diskutojmë sot në këtë mbledhje të organizatës-bazë të Partisë, paraqitin mjaft interes.

Nuk do të zgjatëm veçanërisht në diskutimin tim për punën me kuadrin e ushtrisë, sepse për këtë çështje, sigurisht, do të flasim edhe shokët e tjerë, veçse dua të theksoj që Partia na mëson ne anëtarët e saj se vërtet kuadri luan një rol të madh në zbatimin e vijës sonë, por, megjithëkëtë, nuk është ai që zgjidh çdo gjë. Vijën e Partisë e zbatojnë kuadri, klasa dhe masa, të udhëhequr nga Partia.

Disa kuadro kanë prirje ta heqin veten sikur ata na qenkan të destinuar vetëm të kenë pozita, të jenë «mbretërit» e situatës, të drejtojnë e t'u japin këshilla të tjerëve, kurse këta të fundit u dashka të zbatojnë

urdhrat! Në veprimtarinë e kuadrove të tillë ne shikojmë të shfaqen një sërë qëndrimesh negative, siç janë, për shembull, kënaqja me çdo kusht e interesit vetjak, ndjenja mikroborgjeze e rehatisë, shmangia ndaj kritikave nga poshtë dhe gatishmëria për të kritikuar vend e pa vend të tjerët, hakmarrja ndaj atyre që kritikojnë etj. Këto qëndrime e kanë burimin në kuptimin e shtrembër të detyrave që atyre u ka caktuar Partia dhe manifestohen me shfrytëzimin arbitrar të përgjegjësiave për të kënaqur tekat e sëmura, që janë krejt të huaja për kuadrot tanë dhe që krimbin Partinë dhe rrezikojnë socializmin.

Ka njerëz që mendojnë se vendin e punës dhe kompetencat e lidhura me të i kanë si «shpërblim» për cilësitë «e rralla» që lidhen vetëm me personin e tyre! Kjo tezë është antimarksiste. Partia na i ka caktuar vendet e punës dhe kompetencat jo për të kënaqur dëshirat tona, po për të kryer detyrat, prandaj kërkon t'i bëjmë mirë këto detyra, pa kërkuar përfitime personale. Partia, shokë, është kundër sentimentalizmit të sëmurë ndaj kuadrove. Po të jetë se kuadri punon drejt dhe nuk shkel vijën e Partisë, mirë, ai është i nderuar, në të kundërtën, kur punon mbrapsht dhe cenon sadopak interesat e Partisë, atëherë doemos lind nevoja e edukimit të tij me kritikë dhe me ndëshkim.

Kuadri, na këshillon Partia, duhet të mësojë diturinë dhe shkencën, por, para së gjithash, ai duhet të edukohet në shkollën e klasës punëtorë. Po nuk bëri shkollën e klasës, kuadri nuk vlen. Një kuadër që nuk është i pajisur me edukatën dhe me shpirtin e klasës, sot

ose nesër, po të ketë mundësi, është gati t'ua hipë në zverk Partisë dhe masës.

Kur themi që kuadrot të mësojnë klasën, kjo nuk ka aspak kuptimin që intelektualët ose njerëzit me shkollë të lartë janë më të përshtatshmit për të edukuar klasën dhe, prandaj, mund t'i imponohen kësaj. Partia jonë e ka kuptuar me kohë dhe do ta kuptojë akoma më mirë në të ardhmen që duhen edukuar më parë njerëzit e klasës e pastaj, nëpërmjet tyre, të edukohen të tjerët. Klasa punëtore ka të drejtë t'u imponojë ligjin atyre që nuk janë të klasës. Intelektualët burokratë kurrë nuk duhen lejuar që t'u imponojnë ligjin e tyre klasës dhe Partisë. Kjo çështje ka rëndësi të madhe parimore, teorike dhe praktike. Partia na e ka mësuar me kohë këtë çështje serioze, por shohim se nuk vihet si duhet në jetë.

Për edukimin e kuadrit nuk shtrohet çështja që të kënaqemi vetëm me marrjen e disa masave të njëanshme, por kërkohet që kuadrot të kenë kurdoherë parasysh një gjë: Të merren me studimin e teorisë sonë marksiste-leniniste dhe ta zbatojnë atë thellësisht në praktikë, duke vështruar vetveten, punën që bëjnë dhe duke gënjyuar çdo ditë nëse veprimi i kryer prej tyre i shërben ose jo çështjes së revolucionit. Në qoftë se ata nuk e bëjnë këtë, atëherë ranë në batak.

Partia i ruan kuadrot e saj, se mezi i ka rritur e mezi i ka, por në qoftë se bien në baltë 10 ose 20 veta, që nuk e dëgjojnë Partinë, kësaj nuk i prishet shumë punë. Në qoftë se Partia nuk e shikon me shumë vëmendje punën e kuadrove dhe nuk i korrigjon me ko-

hë ata që gabojnë, atëherë do të vërtetohen edhe ngjarje të rënda që shkaktohen nga fajet e mëdha.

Edukimi i kuadrove duhet të bëhet objekt i një pune e lufte të përditshme të Partisë në terren dhe ca më tepër në ushtri. Në terren i kemi të gjitha kushtet konkrete që Partia dhe klasa punëtore t'i eliminojnë dobësitë e kuadrove dhe shfaqjet negative të veprimtarisë së tyre, kurse në ushtri çështja është pak më ndryshe, atje kërkohet një luftë më e ashpër kundër teknokratizmit dhe burokratizmit. Në rast se kuadrot e Partisë do të praktikojnë metodën dhe stilin revolucionar në punë e në studim, atëherë do të jetë më e zoshme të depërtojë në radhët e tyre ideologjia e huaj me shfaqjet e saj të shëmtuara. Partia ka theksuar vazhdimisht se trajtimi marksist-leninist i problemeve të ushtrisë dhe i kuadrove të saj nuk është punë e lehtë. Ne, shokë dhe shoqe, lypset të ruhemi nga përdorimi i frazave të tilla, si «Në ushtri ka kuadro të nrekullueshëm» etj. Këtë nuk duhet ta bëjmë, jo se kuadrot ushtarake s'janë të mirë, përkundrazi, por që t'i ruajmë ata nga mendjemadhësia, që rrezikon të na shkaktojë fatkeqësi për atdhecin.

Kundërrevolucionin në Bashkimin Sovjetik e bënë pikërisht ata kuadro që kishin harruar rrugën e klasës punëtore, mësimet e Leninit e të Stalinit. Këto mësimet janë aktuale dhe do të mbeten të pavdekshme për revolucionarët e vërtetë, por Partia Bolshevike s'është më bolshevike, s'është më leniniste, ajo është kthyer në parti revizioniste fashiste dhe Bashkimi Sovjetik në një vend kapitalist. Përse ndodhi ky proces regresiv?

Sepse kuadrot në Bashkimin Sovjetik dalngadalë u borgjezuan dhe i zunë frymën Partisë.

Duke përfituar nga kjo eksperiencë e hidhur e të tjerëve, Partia nuk duhet ta zgjidhë çështjen e revolucionarizimit të kuadrove vetëm teorikisht, por ta zbatojë atë në praktikë. U bënë 30 e ca vjet që Partia po e udhëheq me lavdi popullin tonë. Ka njerëz që, gjatë kësaj periudhe, kanë marrë pjesë në dy luftëra të mëdha: në atë Nacionalçlirimtare dhe në këtë për ndërtimin e socializmit, që është shumë më e madhe se e para. Këtë luftë të gjatë e kanë bërë Partia, klasa, masa. Kuadrot kanë luajtur dhe luajnë rolin e tyre në këto luftëra, por kjo nuk do të thotë aspak se ata mund të bëjnë çfarë të duan e të sillen si t'u pëlqejë, pa përfillur interesat e Partisë dhe të popullit. Ai kuadër që vepron në kundërshtim me këta interesa, përgjigjet para klasës në fuqi, e cila është në gjendje t'i diktojë cilitdo vullnetin e saj. Lufta kundër shfaqjeve të rrezikshme që duken te kuadrot, nuk do të thotë aspak përçmim i rolit të tyre, përkundrazi, ky qëndrim flet qartë për kujdesin e madh të Partisë për ruajtjen e kuadrove nga shfaqjet e huaja.

Në udhëheqjen e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave, që drejton sektorë pune ku milton një masë e madhe punëtorësh e minatorësh, nuk ka asnjë punëtor; shumë nga kuadrot që punojnë në këtë ministri janë intelektualë, inxhinierë dhe disa dallohen si teknokratë, burokratë. Si do ta mbikëqyrin këtu punën e kuadrove Partia dhe klasa? Ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë se organizata e Partisë në këtë dikaster nuk

është në pozita revolucionare, ajo është burokratizuar, është intelektualizuar.

Kemi mijëra traktoristë dhe punonjës të tjerë të dalluar në bujqësi, por a ka ndonjë prej tyre që punon në Ministrinë e Bujqësisë? Nuk ka! Është për të ardhur keq që në këto dikastere me rëndësi, në kyçe drejtuese, punon edhe ndonjë njeri i keq nga ana politike! Ky veprim i habitshëm rrjedh për mungesë të theksuar të vigjilencës revolucionare. Jo kështu, shokë! Kësaj gjendjeje Partia duhet t'i japë fund sa më parë duke çuar atje në drejtim punëtorë.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Naftës dhe në Institutin e Naftës qenë mbledhur burokratë! Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Naftës dhe ai i Institutit të Naftës, bashkë me disa të tjerë, ishin armiq dhe hajdutë. Ata sundonin në organizatën e Partisë, i imponoheshin asaj dhe kishin dëbuar jashtë udhëheqjes shtetërore dhe të Partisë punëtorët me përvojë.

Shokët më raportuan se në aktivin e naftës, që u mbajt në Fier për të analizuar punën armiqësore të zhvilluar atje, u ngrit në këmbë klasa punëtoare. «Çfarë të bëjmë me këta sabotatorë?», pyetnin të revoltuar punëtorët. «Atë që mendoni vetë, u përgjigjeshin të deleguarit nga qendra, sepse Komiteti Qendror ka porositur të vendosni ju që jeni zotë të punës. Shkarkojini armiqtë dhe vendosni në drejtimin e punëve njerëzitet më të mirë të klasës, të cilëve, dashur pa dashur, do t'u binden teknokratët dhe burokratët».

Por edhe ne, shokë, kemi faj të rëndë për ato që ndodhën në industrinë e naftës. Të organizosh organet

drejtuese të naftës në atë mënyrë siç qe vepruar, është krejt gabim. Nafta qe shkëputur nga drejtimi i Partisë dhe i Qeverisë. Armiqtë sabotues mund të bënin atje çfarë të donin. Dhe kështu bënë, ata i shfrytëzuan për qëllimet e tyre të neveritshme dobësitë tona në fuqishën e organizimit. Ka drejtues, si Koço Theodhosi, që kanë vajtur shumë herë atje, kanë dhënë edhe urdhra, por prapëseprapë interesat e Partisë e të atdheut u minuan nga armiqtë. Do ta ruajmë ne Koço Theodhosin para kritikës së rreptë për gabimet e rënda të tij, vetëm pse ai është ministër etj.? Aspak. Ky qëndrim nuk do të ishte marksist. Të mos pengohet kritika me arsye-timin e shtrembër se shoku që ka gabuar kryen një detyrë shumë të rëndësishme ose është udhëheqës. Le të jetë cilido, ai që ka gabuar do të kritikohet. Në Partinë dhe në shtetin tonë nuk ka dy disiplina, por vetëm një disiplinë.

Në mes nesh ka dhe duhet të ketë dashuri, solidaritet parimor, respekt reciprok, se jemi komunistë, por nuk ka miqësi të sëmurë, përkrahje të padrejtë, se mbi të gjitha e në radhë të parë ne nuk vëmë as veten, as shokun, po Partinë dhe popullin. Për këto arsye situatën e kemi të mirë, Partinë e kemi të shëndoshë, por ama vërejmë edhe të meta, dobësi, gabime dhe faje të natyrës që përmenda.

Po flasim shumë kundër burokratizmit, teknokratizmit e intelektualizmit, por nuk po kuptohen thellë këto shfaqje shumë negative, që janë pjellë e ideologjisë së huaj. Kur flasim për teknokratët, për shembull, kujtojmë se të tillë janë vetëm mekanikët, kimistët, in-

xhinierët, por harrojmë se edhe shumë nga ne këtu, që absolutizojnë rolin e shkencës, të teknikës e të inteligjencies teknike, shndërrohen dalngadalë në teknokratë. Ju ka shkuar ndonjëherë në mendje kjo? Në qoftë se nuk e kuptojmë dhe nuk e ushtrojmë mirë zatin tonë si punëtorë partie, në qoftë se nuk vihem në mengenenë e klasës punëtore dhe nuk çmojmë lart rolin e masave, në qoftë se nënvleftësojmë politikën në raport me teknikën dhe përçmojmë nevojat e njerëzve etj., atëherë nuk jemi në rregull me detyrat që na janë besuar. Po ç'është detyra jonë si punëtorë partie? Është një zant që ka veçoritë e veta, si ai i mësuesit, i inxhinierit etj., por duhet ushtruar me shumë përgjegjësi dhe me shpirt revolucionar. Vërehet me keqardhje se disa kuadro nuk po e vrasin fort mendjen për të punuar në mënyrën më revolucionare dhe më të përshtatshme, prandaj, pavarësisht se flasim me terma partie, janë kthyer në burokratë. Mund të flasësh me terma partie, por megjithëkëtë mund të mos jesh revolucionar.

Ju ka rënë ndonjëherë rasti që kur jeni ndodhur në mes të punëtorëve të bëni autokritikë para tyre? Keni thënë ju ndonjëherë: «Unë, shokë, kam bërë këtë ose atë gabim»? Mund të ngrejë ndonjëri nga ju dorën për të treguar se ka bërë diçka në këtë drejtim, qoftë edhe një herë të vetme? Asnjë! A i keni pyetur ju, shokë, punëtorët çfarë mendimesh kanë ata për ju dhe për punën tuaj, duke i ftuar sinqerisht që të flasim me zemër të hapët? Jo, nuk i keni pyetur. Ky qëndrim i kuadrove, doemos, krijon një situatë mjaft serioze. Pse nuk



e bëjmë këtë detyrë, more shokë? Pse nuk marrim, bie fjala, 40 punëtorë për të punuar në ministri me qëllim që ata të përbëjnë gjysmën e punonjësve të dikasterit? Partia duhet t'i edukojë kuadrot gjer në atë shkallë sa vetë këta të thonë: «Hajde këtu në vendin tim, ti shoku punëtor, se unë zëvendësministri do të shkoj të punoj në vendin tënd, tek tornoja jote, pranë së cilës të mësoj zanatin tënd, bukurinë, kënaqësinë dhe vësh-tirësitë e kësaj pune dhe të punoj atje sa të ketë nevojë Partia. Gjatë kësaj kohe dhe unë do të marr pagën tënde».

Po nuk e bëri këtë veprim zëvendësministri, do të jetë punëtori ai që do t'i thotë: «Pa djersitu një çikë këtu ti, shoku zëvendësministër ose drejtor, siç jam djersitur dhe unë! Ti je inxhinier, qofsh shëndoshë! Edhe puna ime është shumë e nderuar dhe unë kam fituar eksperiencë, se jam ai që punoj drejtpërdrejt në prodhim dhe nxjerr të mirat materiale nga duart e mia».

Ka quadro që nuk i ha merakun për punën dhe nuk e gjejnë kënaqësinë në punë. Ata kënaqen vetëm kur venë në shtëpi e shikojnë televizorin dhe gëzohen me komoditetin e shtëpisë dhe të familjes. Kur shkojnë në punë, pa lëvizur nga tavolina, tërë ditën marrin telefonin: «Alo! Alo! Kërkoni këtë material? Nuk kemi këtë material, na mungon kjo, na mungon ajo» etj. Kërkohen materiale të planifikuara nga importi për të bërë diçka, pa vrrarë mendjen të përgjigjen se bota është e turbullt, se Egjipti nuk po e hap kanalin e Suezit etj.

«Çfarë plan pune ke ti, shoku zëvendësministër,

çfarë do të bësh nesër?», e pyetën këtë shok punëtorët. «Nuk kam plan, për këtë më zutë ngushtë», u përgjigj ai. «Po si s'paske plan, kur këtu bëhet gjithë kjo punë, kemi gjithë këto halle?», e kritikuan atë me shumë të drejtë punëtorët.

Punëtori, që do të punojë në organet qendrore, duke mos u pajtuar me frymën burokratike, duke punuar me metodë e stil revolucionar, do ta mbyllë derën e zyrës dhe do të shkojë uzinë më uzinë, te njerëzit e klasës, për të parë si venë punët në bazë. Në qoftë se dikush do t'i thoshte punëtorit: «Dale, more shok, ku po shkon, qëndro këtu, se kemi për të bërë një shkresë», ai do t'i përgjigjej: «Nuk më duhet shkresa, do të shkoj të kuvendoj atje drejtpërdrejt me punëtorët, që t'i shikoj si punojnë, çfarë dëshirash e kërkesash kanë, me ç'pengesa e vështirësi ndeshen e nuk do t'u them llafe kot ose ta quaj detyrën të kryer duke dërguar një shkresë sa «për të qenë brenda»». Punëtori që do të emërohej punonjës i një dikasteri qendror, do të kishte kurajën t'i përgjigjej eprorit si duhej dhe jo me servilizëm, ai do t'i pyeste punëtorët e uzinës apo të ndërmarrjes: «More shokë, si punon drejtori juaj, ç'mendim keni për të, a keni qenë dakord me emërimin e tij?». Në qoftë se shokët e tij të klasës do t'i përgjigjeshin se drejtorin e emëroi komiteti i Partisë pa i pyetur ata, ai do të ngrinte zërin se për ç'arsye është shkelur direktiva e Komitetit Qendror të Partisë, sipas së cilës, për të emëruar drejtorin e ndërmarrjes etj. duhet marrë pëlqimi paraprak i kolektivit punonjës.

Atdheu ka nevojë për njerëzit e mësuar e të ditur,

por kjo nuk do të thotë aspak që vetëm këta mund të jenë drejtorë, kurse punëtorët, që punojnë 20 vjet dhe kanë tërë atë eksperiencë pune, nuk qenkan të aftë të drejtojnë! Si mund të lihej në funksione drejtuese në naftë i vëllai i tradhtarit Panajot Plaku vetëm se ai na qenkësh «gjeolog i kualifikuar»?! Përse duhej të qëndronte atje ky armik, që deshi t'i vinte kazmën ekonomisë sonë, kur mund ta drejtojë punën një punëtor që e njeh sektorin e naftës, që gëzon respektin e të gjithëve, që nuhat punën armiqtësore dhe denoncon gjer tek unë sabotimin sistematik, se i dhimbsen Partia, puschiteti popullor dhe ekonomia socialiste? Ky punëtor dhe shumë të tjerë si ky mund të drejtojnë që ç'ke me të.

E di përse të pyeta ty, shoku Xhevdet<sup>1</sup>, për sekretarin e Parë të Komitetit të Partisë të Rrethit të Gramshit Mihal Dodbibën? Se kam dëgjuar të flitet keq për të. Ai, që dukej para nesh aq i butë e i urtë si ndonjë vajzë, qenka arrogant e prepotent para të tjerëve. Do të mbajë qëndrim Partia ndaj këtyre arrogantëve e prepotentëve apo jo? E keqja më e madhe qëndron në faktin se ky kuadër nuk është i vetëm. Edhe Pirro Gushoja, që për pesë vjet me radhë ka mbrojtur tërë diversantët atje në naftë, i tillë është. Kur ngrihej ndonjëri e kërkonte me të drejtë që Lipe Nashi të jepte llogari për gabimet e tij përpara Partisë, Pirroja hidhej me nervozizëm e thoshte se kritikuesi duhej përjash-tuar nga Partia! Pse, me këta njerëz do të mbrohet

---

1. I drejtohet shokut Xhevdet Pataj, që mbajti raportin në organizatë.

Partia?! Në goftë se Pirro Gushoja ka hedhur dy pushkë në luftë, u dashka ta lëmë të na rrezikojë shtetin socialist?! Jo, punëtorët nuk e lënë atë që të marrë në mbrojtje armiqtë e Partisë!

Sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Kukësit nuk e ka kryer mirë detyrën, po kështu edhe kryetari i komitetit ekzekutiv të këtij rrethi. prandaj këta të dy duhet t'i lëvizim një çikë, se i ka zënë gjumi. Le të shkojnë të punojnë në Krumë apo gjetkë për t'u shkundur nga plogështia. Edhe drejtori i Ndërmarrjes Bujqësore në Krumë është bërë si aga, njëri i mban kalin, tjetri pallton. tre veta i shkojnë nga pas për t'i shërbyer në restorant etj. Shefit të llogarisë të Ndërmarrjes Tregtare i gjetën një teneqe me 40 000 lekë të fshehur nën dhe! Ku janë njerëzit e Partisë dhe të pushtetit në rrethin e Kukësit, që heshtin para qëndrimeve të neveritshme të këtyre njerëzve, dhe përse heshtin? Po ata që kanë vajtur me shërbim në Kukës ç'kanë bërë që nuk i kanë vënë re këto shfaqje të rrezikshme?

Ka dhe ndonjë kuadër që është i degjeneruar, si Andrea Mançoja, për shembull, që shtëpinë e tij e kishte bërë dyqan me plaçka të grabitura brenda e jashtë. Kur i kërkoheshin shpjegime këtij se për ç'arsye nuk kishte ardhur çeliku, ai përgjigjej shpejt e shpejt: «Po ja, e ka fajin gjermani, që është kështu e ashtu». E shante Andrea Mançoja gjermanin, borgjez e revizionist thoshte për të, dhe veten e hiqte revolucionar, por nuk mungonte të bënte matrapazllëqe me Lipe Nashin dhe të ishte vetë një vjedhës e armik.

Disa shfaqje të natyrës që përmenda, si dhe të tjerë që shihen aty-këtu ndër ne, vërtetojnë se, me gjithë luftën e ashpër që ka bërë dhe bën Partia për revolucionarizimin e marrëdhënieve midis kuadrove dhe masave, për zbatimin e vijës së masave, për kalitjen ideopolitike të njerëzve, për forcimin e vazhdueshëm të demokracisë socialiste etj. dhe me gjithë sukseset e pamohueshme që ka pasur ajo në këto drejtime. prapëseprapë lufta kundër burokratizmit do të vazhdojë gjersa të ekzistojnë klasat dhe lufta e klasave.

Me fitoren e revolucionit tonë popullor dhe me përmbysjen e pushtetit të vjetër feudo-borgjez, ne e kemi zhdukur përgjithmonë burokracinë si sistem, por nuk kemi shpëtuar nga shfaqjet e burokratizmit që, në një formë a në një formë tjetër, duken edhe në kushtet e shoqërisë socialiste. Një ndër aspektet e rrezikshme të burokratizmit është krijimi i organizmave të panevojshëm, i hallkave të ndërmjetme dhe shtimi i organikave. Fryrja e organikave dhe grumbullimi jashtë masës i nëpunësve dhe i specialistëve të ndryshëm nëpër zyrat e ndërmarrjeve, të institucioneve dhe të organizatave, në qendër e në bazë, e kanë bërë administratën shumë të rëndë, të pamanovrueshme, kanë shkëputur njerëzit nga puna drejtpërdrejt në prodhim e nga lidhjet me masat dhe i kanë kthyer këta në memurë që vërejnë për rroga dhe rehati. Ja përse, në kompleksitetin e luftës klasore kundër shfaqjeve të burokratizmit, shkurtimi e thjeshtimi i organikave është bërë nevojë e domosdoshme dhe urgjente. Por me

rëndësi të dorës së parë është të kuptohet ç'është burokratizmi.

Burokratizmi është një e keqe, që, sikurse thoshte me të drejtë Lenini, mbetet pjesërisht e ringjallet edhe pas thyerjes së sistemit burokratik, prandaj lufta që zhvillohet vazhdimisht kundër tij duhet kuptuar jo thjesht si masë tekniko-administrative, por sidomos si masë me karakter të theksuar politik, ideologjik dhe organizativ. Po nuk u kuptuan thellë edhe në këto drejtime, shfaqjet e burokratizmit, edhe pasi të jenë luftuar një herë, do të rilindin më pas. Këtë na e vërtetoi eksperiencia jonë. Byroja Politike kishte vendosur të bëheshin shkurtime në organikat dhe shkurtime të bënë, mirëpo ne shikojmë me dhimbje se tani numri i njerëzve që marrin rroga kot, që sorollaten, që ushqejnë burokratizmin, është shtuar përsëri, duke fryrë organikat dhe listorganikat në aparatet e qendrës, në rrethe e në ndërmarrjet ekonomike, në organet e pushtetit e të Partisë. Kështu do t'i mbajmë gjithë këta njerëz? Jo. Do t'u futim gërshërën atyre që janë të tepërt. Gjithsej 200 komunistë ishim kur filluam luftën dhe 70 000 partizanë kur bëmë luftën, por vepronim të ndërgjegjshëm e të bindur për atë që na thoshte Partia. Shkonte shoku në fshat, mblidhte fshatarët, bënte punën politike me ta, pastaj, kur kthehej, na sillte prej andej dhe bukën për partizanët, bënte dhe luftën me armë. Tani, për të bërë diçka, shtojmë organikat! Gjoja po specializohemi!

Duhet të bëjmë kujdes për shpërndarjen e drejtë të kuadrit. Kemi gjithë ata inxhinierë që na janë mble-

dhur në zyra, në një kohë kur ushtrisë i mungojnë shumë inxhinierë elektrikë e mekanikë. Më mirë të punohet në torno se të rrihet pa punë në zyrë.

Partia ka orientuar që të ngrihen në ndërmarrje, në fabrika etj. byrotë teknologjike, të cilat duhet të kenë në përbërjen e tyre një, dy inxhinierë dhe një numër punëtorësh, sa të gjykohet me vend, por jo 80 ose 100 veta. Përse duhen tërë këta?! Për shpërndarjen dhe për transportimin e plehrave e për të tjera çështje si këto janë krijuar drejtori të posaçme në Ministrinë e Bujqësisë, në sistemin e së cilës (në aparatën qendror, në ndërmarrjet bujqësore dhe në institutet kërkimore) janë grumbulluar afër 10 000 veta në administrata, nga 3 000 që ishin më 1966! Po kështu është vepruar edhe në ministritë e tjera. Përse nuk shikohen këta organizma, institucione e drejtori që na janë krijuar vend e pa vend? Në qoftë se i shikojmë, mos vallë duhet t'i duartrokasim? Jo! Këto shfaqje duhet të mos shikohen të veçuara, por në tërësi, të lidhura me njëra-tjetrën dhe të likuidohen sa më parë.

Fryrja e organikave dhe shtimi i kuadrove që merren me punë administrative në kurriz të prodhimit është çështje teorike. Ky veprim, veç të tjerave, përkon edhe me «teorinë» reaksionare revizioniste, e cila pretendon që, në kushtet e revolucionit tekniko-shkencor e të kapitalizmit monopolist-shtetëror, klasa punëtoare po integrohet me borgjezinë dhe po humbet frymën revolucionare, duke ia lënë inteligjencisë rolin udhëheqës në revolucion! Meqenëse klasa punëtoare po shndërrohet në «bashkëpronare e bashkëdrejtuese» e

ndërmarrjeve kapitaliste, sipas këtyre sociologëve revizionistë nuk paska më nevojë të bëhet revolucioni për të përmbysur borgjezinë, se ky qëllim gjoja mund të arrihet me revolucionin tekniko-shkencor!

Partia na mëson se rrethimi kapitalisto-revizionist ndaj Shqipërisë socialiste është real, por disa kuadro e përdorin si slogan këtë mësim të vlefshëm, këtë përfundim të saktë që kemi arritur ne nga eksperiencia jonë. Rrethimi kapitalisto-revizionist nuk është krijim fantastik, por rrezik i vërtetë që bëhet çdo ditë e më serioz. Armiqtë e shikojnë Partinë tonë siç është, të fortë, komuniste e parimore. Ne u kemi shpallur luftë imperializmit, revizionizmit dhe reaksionit botëror. Shqipëria e vogël nuk u vete qorrazi nga pas, por u çjerr maskën pa frikë qëllimeve të tyre të errëta, prandaj ata kanë reaguar dhe do të reagojnë ashpër kundër nesh. Në këto rrethana situata politike dhe lufta që zhvillojmë ne kundër armiqve janë e do të jenë të rrepta.

Disa shokë mendojnë se «Armiqtë s'kanë ç'na bëjnë, ne jemi të fortë, prandaj ata le të çirren sa të duan». S'ka dyshim që ne jemi të fortë, por, po të mos i vlerësojmë realisht armiqtë, po të na rritet mendja, nuk do të jemi të fuqishëm dhe, një ditë, armiqtë mund të na godasin e të na shkatërrojnë. Me qëllime të këqija dhe me këto parulla gjoja revolucionare u përpoqën të na vënë në gjumë dhe të na godasin në befasi armiqtë Fadil Paçirami me shokë në fushën e kulturës, të letërsisë dhe të arteve, Beqir Balluku e kompani në fushën e mbrojtjes së atdheut dhe Lipe



Nashi e të tjerë në ekonomi, në industrinë e naftës. Epiqendra e tërë kësaj veprimtarie të egër armiqësore ishte në ushtri. Armiqtë i kishin vënë vetes detyrë që, pasi t'i përpunonin njerëzit ideologjikisht, t'i demoralizonin ata dhe t'i thyenin, ta linin vendin pa naftë dhe të organizonin një puç, ashtu sikurse po dëgjojmë të ndodhë në vende të tjera.

Këto veprime të ndyra janë të bashkërenduara midis armiqve të jashtëm e të brendshëm, prandaj neve nuk na lejohet një qëndrim mospërfillës ndaj këtyre armiqve. Te ne ka pasur nënvleftësim të punës armiqësore, aq sa disa shfaqje të armiqve janë quajtur «gjëra të vogla», «të rastit», duke u justifikuar se kjo gjë ka ndodhur kështu apo ashtu. Duhet vigjilencë. Ai që është vigjilent, është revolucionar. Dhe në ballë të punës për forcimin e vigjilencës duhet të jenë Partia dhe klasa.

Njerëzit tanë duhet të punojnë me vrull, guxim, iniciativë dhe vetëveprim në të gjitha fushat e ndërimit tonë socialist. Vetëm puna është burim i mirëqenies në Shqipërinë socialiste. Prandaj cilido, në vendin e punës së tij, në brigadë, sektor, institucion shkencor e kulturor, qendër pune e prodhimi, çdo ditë dhe çdo orë, të punojë me ndërëgjegje të lartë dhe me disiplinë proletare për realizimin e detyrave. Kjo është njëra anë e çështjes. Ana tjetër, veçanërisht e rëndësishme, është ajo e mbrojtjes nga armiqtë, qofshin këta të brendshëm ose të jashtëm, të punës sonë dhe të fitoreve të arritura. Nuk ka kuptim të derdhësh djersë, kur nuk merr masa për të mbrojtur, po të jetë nevoja edhe me

gjak, atë që është fryt i mundit dhe i djersës së popullit. Njerëzit duhet të rrojnë thjesht dhe të mendojnë më parë për të mirën e atdheut, pastaj për të tyren personale.

Partia ka vijë të drejtë, vetëm se duhet të shmanjë sa më shumë gabimet dhe disa shtrembërime që vërtetohen në zbatimin e kësaj vije. Për këtë qëllim duhet që njerëzit tanë të kuptojnë drejt vijën e përgjithshme politike të Partisë, të binden në drejtësinë e saj, të kryejnë mirë detyrat që u ngarkohen dhe të marrin përgjegjësitë që rrjedhin nga këto detyra. Çështja është që nga mendimet revolucionare të hidhemi në lëvizje revolucionare. Përgjithësisht te ne kështu veprohet, sepse njerëzit janë të bindur që e ardhmja e tyre është e sigurt nën udhëheqjen e Partisë, se niveli i jetesës së tyre do të ngrihet më lart vetëm me punë të ndershme. Populli ynë është punëdashës, ai i ka nderuar bijat e bijtë e tij që nuk kursejnë mundin e tyre për perspektivën e ndritur të Shqipërisë socialiste. Shembuj të tillë s'ka nevojë të përmendim, se të gjithë ne e dimë sa të mrekullueshëm janë njerëzit tanë duarartë, këta nuk janë një e dy, por me qindra mijë. Zelli për të bërë efektivisht tetë orë punë e jo për të qëndruar tetë orë në punë, si dhe gatishmëria për të shërbyer atje ku ka nevojë atdheu janë virtyte të njeriut tonë të ri, të rritur dhe të edukuar nga Partia. Me gjithë sukseset e shënuara, nuk do të thotë se aty-këtu nuk ndeshemi edhe me punonjës apo specialistë që para interesave të socializmit vënë egoizmin e tyre. Me zor e bindën një inxhinier elektrik, që e ka

familjen në Elbasan, të lëvizte nga Durrësi! «Ngrehu e shko edhe ti në Elbasan!», i thanë. «Jo, nuk vete atje», thoshte! Ky «kuadër» e lexon vendimin e Byrosë Politike me predispozicionin e keq që të kapet pas një diçkaje të shprehur atje dhe, pasi e interpreton në favor të tij, thotë: «Unë jam gati të shkoj atje ku ka nevojë atdheu, por nuk më takon të shkoj». Kur vjen puna për të shkuar vërtet atje ku ka nevojë atdheu, gjen shumë «arsye» për t'u shmangur ky «kuadër», i gatshëm me llafe.

Te ne janë arritur shumë suksese në fushat politike, ideologjike, ekonomike, shoqërore, kulturore, të mbrojtjes etj. Populli ynë vështroon me krenari rrugën heroike që ka përshkuar gjatë më shumë se tri dekadave nën udhëheqjen e Partisë, ai sheh me kënaqësi se si është përmirësuar e përmirësohet vazhdimisht jeta e tij, si është bërë Shqipëria një vend me industri moderne e me bujqësi të zhvilluar socialiste, me një art dhe kulturë që lulëzojnë në truallin kombëtar.

Të gjithë e dinë ç'po bëhet përreth nesh. Bota kapitaliste dhe revizioniste është kredhur e tëra në një krizë të thellë ekonomike, financiare, politike, ushtarake etj. Si rezultat i kësaj krize janë ngritur pa precedent çmimet e mallrave të konsumit, niveli i jetesës së punonjësve në vendet kapitaliste po ulët çdo ditë e më tepër në mënyrë të ndjeshme. Te ne, Partia, me politikën e saj të drejtë, ka bërë që pesha e rëndë e kësaj krize të mos ndihet nga masat punonjëse; dyqanet tona janë të mbushura me mallra dhe çmimet nuk janë ngritur. Edhe të huajt, që kanë vizituar dhe vizitojnë

vendin tonë, janë habitur me stabilitetin e ekonomisë shqiptare dhe me zhvillimin e kënaqshëm të saj.

Sukseset nuk duhet të na marrin mendjen, sepse mundësitë për të ecur më shpejt drejt arritjeve më të mëdha i kemi. Ne duhet të vështrojmë përpara, prandaj të rritim akoma më tepër aktivitetin që puna jonë të jetë më frytdhënëse, që zhvillimi ynë të ecë me ritmet e parashikuara nga Partia dhe ngritja e nivelit të jetesës të bëhet për të gjithë gati njësoj dhe jo të krijojen privilegje për disa shtresa.

Lufta e klasave, e zhvilluar sipas mësimeve të marksizëm-leninizmit, forcon ndërgjegjen e masave dhe u tregon këtyre epërsinë e pushtetit tonë popullor, u tregon se diktatura e proletariatit duhet të ushtrohet pa u ndalur që, siç nënvizon Marksi, të zhdukë krejtësisht të gjitha dallimet klasore.

Populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, u çlirua dhe ai e do socializmin. Por rëndësi të madhe ka të kuptojë ç'është socializmi, si ndërtohet ai dhe ç'ligje e udhëheqin këtë ndërtim. Ky ndërtim nuk bëhet si në gjalpë, pse socializmi rrezikohet jo vetëm nga jashtë, por edhe nga brenda, jo vetëm nga elementë të dekluar o të mundur të borgjezisë dhe të agallarëve, por edhe nga elementë të borgjezisë së re që lind terreni i infektuar nga mbeturinat borgjeze e mikroborgjeze ku ndërtohet socializmi. Kjo borgjezi e re mund të lindë te ne si ai bari i egër në një fushë të pastër me grurë.

Pse ngjet një fenomen i tillë, që përmenda më lart, nga nëpunës e punëtorë partie? Kjo ngjet pse nuk bëhet lufta e klasave dhe nuk ushtrohet diktatura e

proletariatit kudo e në çdo gjë me forcë të madhe. Pikërisht lufta e klasave zbutet shumë herë dhe bëhet veçanërisht e rrezikshme kur zbutet nga nëpunës, administratorë e punonjës partie që mendojnë se çdo gjë e kanë kuptuar në rrugën e Partisë, por që në fakt teorinë e saj as e kanë kuptuar dhe as e zbatojnë drejt. Të tillë njerëz, që futen në rrugën e të menduarit dhe të të vepruarit borgjez, fshihen nën emrin e Partisë dhe përdorin diktaturën gjoja të proletariatit për ta shtrembëruar atë në favorin e krijimit të një fushe sa më të gjerë e më të frytshme për zhvillimin e ideve të tyre liberalo-borgjeze dhe për krijimin e kushteve për fitime personale. Në qoftë se nga ana e diktaturës së proletariatit nuk zhvillohet një luftë e ashpër dhe e pamëshirshme kundër këtyre shfaqjeve, atëherë bëhet iminent rreziku i restaurimit të kapitalizmit në vendin tonë.

Klasa punëtore dhe Partia e saj kurdoherë, në mënyrë shkencore, duhet të analizojnë situatat që zhvillohen, të studiojnë pabarazitë që ekzistojnë dhe do të ekzistojnë në lidhje me diferencimin në pagat sipas punës, por ato nuk duhet të lejojnë që të ekzistojë një diferencë e madhe në të ardhura në mes qytetit dhe fshatit dhe, ca më keq, kjo të konsiderohet si diçka e drejtë dhe politike e ideologjike. Në këto çështje ekziston te ne elementi dhe botëkuptimi kapitalist dhe, me gjithë masat e marra, shohim se në disa kuadro dhe veçanërisht nëpunës, është krijuar një frymë jo e shëndoshtë mirëqenieje dhe borgjezimi. Ka mjaft njerëz që luftojnë të shtojnë pronën personale, të kenë

të gjitha mjetet shtëpiake të një elementi borgjez dhe të gjitha këto dëshira, që nuk bien erë proletare, i mbulojnë me frazeologjinë: «Këto nuk i vodhëm, këto i blemë me rrogën tonë» etj. Kjo është e vërtetë, por standardi i jetesës nuk duhet lejuar që të ngrihet me diferencime të mëdha, zyrtarët nuk duhet të rrojnë shumë më mirë se punëtorët dhe fshatarët më keq se aleatët e tyre të qytetit. Kjo gjë rrjedh veçanërisht nga rrogat e larta të zyrtarëve. Një situatë e tillë krijon ata elementë të borgjezisë së re që lind nga gjiri i klasës, nga gjiri i Partisë, të cilët, në rast se nuk ndreqen e nuk spastrohen, bëhen të rrezikshëm. Është e vërtetë se për këtë duhet edukatë politike dhe ideologjike, por duhen edhe masa në përshtatje me këtë edukatë.

Ka kohë që Byroja Politike ka vendosur që sistemi aktual i pagave duhet të rishikohet, por studimi akoma nuk po paraqitet. Duhet të shkojë duke u mbyllur gërsëhëra, pagat e larta akoma të ulen, në mënyrë që niveli i ngritur i jetesës për një kategori njerëzish të mos nxitë dëshirën e një jetese borgjeze, dëshirën e fitimit e të stimulit material. Duhet, pra, të marrim masa që kjo pabarazi në sistemin e pagave të punës të zvogëlohet<sup>1</sup> dhe këtë mund ta bëjmë me plot ndërgjegje se niveli i jetesës do të jetë i mirë. Ndryshe lejojmë zhvillimin e elementit kapitalist në qytet, sidomos

1. Në mbledhjen e 26 dhjetorit 1975, Byroja Politike e KQ të PPSH miratoi studimet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave i RPSH për uljen e pagave të larta dhe për përballimin nga ana e shtetit të investimeve dhe të shpenzimeve shoqërore-kulturore të kooperativave bujqësore.

nën pretekstin se këtü pronë personale «ma ka garantuar Partia».

Duhet ta kuptojnë njerëzit se ndjenja e pronës është një sëmundje e tmerrshme dhe armike e socializmit. Ajo nuk zhduket as me 10 dhe as me 100 vjet, duhet një luftë e ashpër në ndërgjegjen e njerëzve dhe një luftë e përditshme, pse kjo ndjenjë shfaqet në marrëdhëniet shoqërore e familjare reciproke dhe spikat përnjëherësh në jetën e përditshme: në shitjen e blerjen, në sa të ardhura kam unë, sa ke ti, ç'fuqi blerëse kam unë, ç'fuqi blerëse ke ti etj.

Duhet të mos harrojnë komunistët, punëtorët e vërtetë, fshatarët patriotë dhe nëpunësit e thjeshtë e besnikë, anëtarë partie ose jo, se, po të mësohesh të rrosh si borgjezi (pse prona personale e shfrenuar, lufta për të pasur sa më shumë komoditete dhe përfitime të çojnë te borgjezia), ky është një rrezik i madh që naturret, të cilin duhet ta luftojmë dhe jo vetëm me fjalë.

Lufta e klasave duhet të veprojë kudo. Ajo është ushtarake, dhe ne pamë se ç'na bënë armiqtë në ushtri; ajo është edhe ekonomike, dhe ne pamë ç'na bënë armiqtë në naftë; por ajo është, gjithashtu, edhe administrative, dhe ne po shohim ç'po na bëhet me fryrjen e tmerrshme të aparateve.

Me fjalë të tjera, pse na ngjanë të gjitha këto? Se lufta e klasave nuk bëhet e ashpër, se diktatura e proletariatit nuk godet si duhet në të gjitha drejtimet, se clementi borgjez i ri ngre krye duke vepruar nën petkun e marksistit. Prandaj duhen luftuar këta rene-

gatë të borgjezuar, nuk duhet të kihet mëshirë për ta, pse të tillë njerëz, siç e vërtetuan dhe po e vërtetojnë analizat, synojnë të rrëmbejnë pushtetin dhe Partinë nga duart e klasës punëtore. Prandaj të spastrohen organikat, të spastrohen aparatet shtetërore dhe të Partisë, të spastrohet vetë Partia nga njerëzit që nuk vlejnë si anëtarë partie. Çdo gjë duhet të jetë nën drejtimin e Partisë marksiste-leniniste, në duart e klasës punëtore dhe të emërohen në punë ata njerëz që dallohen nga thjeshtësia proletare dhe nga besnikëria ndaj Partisë dhe atdheut socialist.

*Botuar për herë të parë,  
me ndonjë shkurtim, në li-  
brin: Enver Hoxha, «Ra-  
porte e fjalime 1974-1975»,  
f. 148*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Raporte e fja-  
lime 1974-1975», f. 148*



# FORMIMI DHE ZHVILLIMI I BORGJEZISË SË RE TITISTE JUGOSLLAVE

Shënime

1 prill 1975

Procesi i zhvillimit kapitalist në Jugosllavi ka krijuar kontradikta midis procesit të bashkimit ekonomik të popujve të ndryshëm me nacionalitete të ndryshme të këtij vendi. Vetadministrimi, duke filluar që nga ai i ndërmarrjeve të vogla, deri tek ato të mëdhatë, nuk është veçse një formë kapitaliste e drejtimit të ekonomisë. Të gjitha ndërmarrjeve që vetadministrohen u janë lënë kompetenca të mëdha decentralizuese dhe u është caktuar një formë shumë e zbehtë ose fare e paqenë centralizuese. Këto ndërmarrje vetadministruese kanë krijuar një burokraci dhe një teknokraci të atillë, sa jo vetëm që nuk mund të ecin përpara, por ato punojnë për të krijuar fitime legale dhe ilegale për kastën burokratike.

Superfuqitë kapitaliste, që kanë investuar kapitale me qëllime kolonialiste në Jugosllavi, nuk mund ta bënin një gjë të tillë, në qoftë se nuk do të kishin mbështetjen politiko-ideologjike të regjimit të vendit. Por edhe kjo nuk mund të ishte e mjaftueshme për ta, në rast se ekonomia nuk organizohej dhe nuk drejtohej me forma kapitaliste. Kapitalistëve të huaj investitorë nuk u interesonte se si do ta mbiquanin titistët këtë

organizim të ekonomisë. Atyre u interesonte natyra dhe funksioni i këtij sistemi, që t'u siguronte investimet dhe fitimet dhe të krijonte stabilitet për ta në ndërhyrjet politiko-ushtarake në këtë vend.

Organizimi kapitalist i ekonomisë jugosllave nuk mund të mos ndiqte rrugën shoviniste nacionaliste, për arsye se kasta burokratike qoftë në planin e brendshëm, qoftë në atë të jashtëm nuk mund t'u nënshtrohej ligjeve të klasës punëtore, internacionalizmit të saj. Partia në Jugosllavi nuk ishte më një parti e klasës punëtore. Atje sundonin revizionistët, matrapazët, mashtruesit, kasta e borgjezisë së re në ekonomi, në ushtri, në kulturë, në arsim. Nuk ekziston frymë proletare as në ekonomi, as në politikë, as në ideologji. Çdo gjë është borgjezuar. Nacionalizmi borgjez u bë detyrimisht ideologjia dominuese. Kjo gjendje ka krijuar elementët e përçarjes së kombësive dhe «uniteti», në qoftë se ekziston dhe në qoftë se mund të ekzistojë edhe më vonë, nuk është në baza socialiste, proletare, marksiste-leniniste, por ai është një unitet në baza kapitaliste, me kontradikta armiqësore në mes popujve që formojnë Federatën. Ky farë uniteti mund të ekzistojë dhe të mbahet, natyrisht, me forcë, pse disa popuj do të dominohen nga kasta më të forta, që do të bëjnë ligjin mbi popujt e tjerë. Jugosllavia titiste mund «të rrojë» në Federatë, por ajo është një Federatë e varfër, është si një lopë që milet nga shumë duar dhe së cilës i kanë dalë brinjët. Prandaj sistemi i vetadministrimit i shtyn republikat e ndryshme drejt armiqësisë dhe drejt kërkesave të kapitaleve të huaja. Kjo do të thotë se

klikat kapitaliste shoviniste thërresin robërinë ekonomike të vendit, robërinë politike, zhdukjen e lirive dhe të drejtave demokratike, shtypjen e klasës punëtore, zhdukjen e frymës internacionaliste dhe izolimin e klasës punëtore jugosllave nga klasa punëtore ndërkombëtare dhe nga revolucioni botëror. Titoja e ktheu Jugosllavinë në një rezervë të borgjezisë kapitaliste botërore. Borgjezia titiste nuk mund ta gjejë rrugën e unitetit nacional. Kjo borgjezi mund të përdorë terma të majtë, por rruga e saj nuk është veçse «uniteti» nationalist serbo-kroat i carit Aleksandër, i veshur me rrobat e kohës së pasluftës së Dytë Botërore.

Derisa borgjezia e re titiste jugosllave vendosi në Jugosllavi pushtetin e kapitalit, me këtë ajo vendosi edhe shtypjen e kombësive, nuk njihte më *de facto* barazinë në mes kombësive dhe zhduku mundësinë e bashkëpunimit dhe të vëllazërimit vullnetar të tyre. Parulla «bashkim-vëllazërim» jo vetëm nuk dëgjohet më, dhe ka arsye të thella që s'dëgjohet, por, edhe kur e thonë ndonjëherë, ajo ka mbetur një slogan anakronik dhe pa përmbajtje. Politika e titistëve nuk është veçse një politikë gjysmimperialiste, në pamundësi të bëhet e plotë, se nuk ka «këllqe».

Borgjezia e re titiste noton në kontradikta. Nga njëra anë, ajo nuk mbahet dot në fuqi pa u bërë zonë influence e njërës ose e tjetrës superfuqi, nga ana tjetër, e zhytur në borxhe e në detyrime, kërkon të hiqet si e pavarur dhe të ruajë Federatën nga goditjet e mundshme të njërës ose të tjetrës superfuqi. Borgjezia titiste nxiti nacionalizmin dhe shthuri unitetin

e kombësive, nga ana tjetër, kërkon ta forcojë këtë «unitet» në rrugën kapitaliste.

Borgjezia titiste me vetadministrimin shturi unitetin ekonomik të Federatës dhe, në të njëjtën kohë, siç doli nga një intervistë e kohëve të fundit e Ljubiçiqit, ministri i Mbrojtjes i Jugosllavisë, po bën thirrje për «unitetin ushtarak kundër rrezikut që na kërcënon nga dy superfuqitë». Kështu Jugosllavia bëhet një vend që do të ndjellë rreziqe dhe andrralla për ne, prandaj duhet të jemi vigjilentë.

Borgjezia titiste nuk e ka harruar shovinizmin serbomadh. Ajo s'e ka luftuar dhe këtë nuk mund ta bëjë dot, por përpiqet ta kundërbalancojë me atë kroatomadh. Borgjezia luan në litar, si në platformën e brendshme me serbët e kroatët, ashtu edhe në platformën e jashtme me Bashkimin Sovjetik dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Është e qartë se mbeturinat e vjetra të Karagjorgjeviçëve dhe të Maçekëve janë plotësisht të gjalla tek titistët. Derisa këto tendenca ekzistojnë dhe ushqehen nga borgjezia titiste dhe mbështeten me politikën, me ideologjinë antimarksiste dhe me ekonominë kapitaliste, nuk mund të ketë as barazi, as unitet në mes popujve të Jugosllavisë.

Si mund të ekzistojë kjo barazi, kur Kosova me popullsi shqiptare shtypet e gjakoset dhe shqiptarëve në Jugosllavi nuk u jepeshin e nuk u jepen nga titistët të drejtat e tyre kombëtare dhe demokratike? Si mund të ketë unitet, kur për shkak të vetadministrimit Malit të Zi, Kosovës dhe Maqedonisë së prapambetur nuk u jepet asnjë ndihmë efektive ekonomike? Lënia pas dore

nga ana kulturore e Kosovës nga funksionarët serbë, dëbimi i shqiptarëve nga tokat e tyre për në Turqi, nuk tregojnë veçse atë që asgjë nuk kishte ndryshuar në mendjen e shovinizmit serb titist. Një nga personat që i shtypte kosovarët dhe që i gjakosi ishte Dushan Mugo-sha<sup>1</sup>, kurse një nga ata që i mbronte ishte Miladin Popoviçi<sup>2</sup>. Borgjezia titiste të parin e bëri «hero të popujve të Jugosllavisë», të dytin «natën» e vrau me atentat, «ditën» e bëri hero.

Procesin e zhvillimit të Jugosllavisë duhet ta kemi vazhdimisht në vëzhgim të rreptë.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

---

1. Erdhi në Shqipëri në verën e vitit 1941. Siç u vërtetua më pas, ishte ngarkuar nga udhëheqja jugosllave për të zhvilluar punë agjenturore në radhët e komunistëve shqiptarë e të PKSH. Në pranverën e vitit 1943 rekrutoi si agjent të jugosllavëve Mehmet Shehun, të cilin e nxiti që të kryente akte terroriste e gabime të rënda sektare me qëllim që të përgatitej terreni për shtrembërimin e vijës së drejtë të PKSH, për goditjen e nënshtrimin e udhëheqjes së saj.

2. Komunist internacionalist jugosllav, i cili u lirua nga komunistët shqiptarë në vjeshtë të vitit 1941 nga një kamp përqendrimi fashist në Shqipëri. Qëndroi në Shqipëri për të mbajtur lidhje midis PKSH dhe PKJ dhe përkrahu qëndrimin internacionalist të PKSH. Në shtator të vitit 1944, me urdhër të udhëheqjes së PKJ, u largua nga Shqipëria dhe, në mars të vitit 1945, u vra me atentat të kurdisur nga shërbimi i fshehtë jugosllav.

# T'U BIEM ME SHUFËR TË THANTË TENDENCAVE QË DOBËSOJNË LIDHJET E PARTISË ME MASAT

Shënime

3 prill 1975

Ne duhet të luftojmë që lidhjet e Partisë me masat t'i kalitim akoma më shumë çdo ditë. Fakti se vija e Partisë në drejtimet e shumta të ndërtimit të socializmit po korr suksese, fakti se thirrjeve të Partisë u përgjigjen me dhjetëra e dhjetëra mijë njerëz në punë e në aksione, flasin për këto lidhje të çelikta. Kurrë nuk do të ngjiste një unitet i tillë Parti-klasë-masë pa ekzistencën e këtyre lidhjeve kaq të sinqerta dhe të forta.

Ne duhet të përdorim çdo mjet e formë: shtyp, radio, televizion, konferenca, lexime, takime kolektive dhe individuale, që masave t'u japim mundësinë t'i shprehin Partisë mendimet, dëshirat, kritikën dhe ajo t'u shpjegojë atyre hapur çdo gjë dhe të dëgjojë kurdoherë me seriozitetin më të madh zërin e tyre.

Burokratët, fodullët, arrogantët vënë gurë në rrotën në këtë çështje të madhe Parti-klasë-masë. Partia

duhet t'i demaskojë dhe t'i luftojë pa mëshirë këta dhe metodat e punës së tyre, që më të shumtat e herës fshihen nën «zyrtarizmin», kanë në xhep edhe teserën e Partisë, gjuha u këndon si bilbil e disa herë përdorin si armë edhe diturinë e teknokracinë.

Disa njerëz jo të këqij, por qullër, mendjelehtë, që flenë mbi dafina, kujtojnë se është bërë maksimumi nga ana e tyre dhe janë dembelosur edhe në mendime, edhe në veprime dhe kthehen në parazitë, humbasin frymën revolucionare, bëhen indiferentë e, me dashje pa dashje, bëhen rezerva numër një e burokratëve. Këta u fryjnë të parëve në vesh që të rritet burokratizmi, se kjo siguron letargjinë e tyre.

Prandaj Partia asnjëherë nuk duhet të lërë t'i shpëtojë rasti pa rrahur me shufër të thantë këto tendenca që dobësojnë lidhjet e saj me masat. Duhet punuar që shtypi të lexohet nga të gjithë e të gjithë të komunikojnë me shtypin dhe me organet e pushtetit e të Partisë. Zëri i masës është e domosdoshme të dëgjohet, pse kush nuk e dëgjon, ai bën krim.

Organizatat e masave: Fronti Demokratik, Bashkimet Profesionale, organizata e Rinisë dhe ajo e Gruas janë leva të rëndësishme të Partisë, që lidhin këtë me popullin në formë të organizuar. Partia jonë e hodhi poshtë sugjerimin e revizionistëve sovjetikë dhe disa të tjerëve, sipas të cilëve organizata e Frontit, e Gruas etj. «s'kanë ç'na duhen», sepse, sipas tyre, «sot nuk luajnë ndonjë rol si në kohën e luftës»!

Në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare organizatat e masave të ne luajtën një rol të madh, por, pas Çli-

rimit e tëhu, ato kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë një rol kolosal, që nuk ka barazim me rezultatet e kohës së luftës. Vetëm të kihet parasysh se, pavarësisht nga rezultatet e mëdha që kanë arritur këto organizata në sqarimet politike dhe ideologjike me masat e gjera dhe në hedhjen e tyre në aksione revolucionare, gjithë Partia duhet ta kuptojë mirë rolin e madh drejtues që duhet të ushtrojë mbi këto organizata dhe jo vetëm me direktivat dhe me vijën që jep, jo vetëm me ata shokë që punojnë në forumet e tyre, por edhe për faktin që të gjithë komunistët duhet të militojnë pa përjashtim në radhët e organizatave të masave. Në këtë çështje të fundit jemi larg asaj që kërkon Partia, sepse kjo nuk kryhet si duhet. Shumë komunistë mendojnë se mjafton të punojnë në këto organizata ata anëtarë partie që janë të zgjedhur në forumet e tyre. Me siguri që komunistë të tillë kanë koncepte të kësaj natyre edhe për punën e Partisë, të cilën, sipas tyre, duhet ta kryejë vetëm udhëheqja e zgjedhur, kurse për ata mjaft që të bëjnë atë punë të thjeshtë shtetërore që u është ngarkuar dhe të lidhin duart. Mendime të tilla janë të gabuara dhe duhen ndrequr.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1974-1975», f. 171*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Për rininë» (Përmbledhje veprash), vëll. II, f. 411*



# VIJA E PARTISË NË RADHË TË PARË TË STUDIOHET DHE TË ZBATOHET NË JETË PA GABIME

Shënime

4 prill 1975

Atdheu ynë socialist është i rrethuar në të gjitha anët nga shtete borgjeze, kapitalisto-revizioniste, prandaj në politikën tonë duhet ta kemi kurdoherë parasysh këtë rrethim të rrezikshëm. Janë të dënueshme pikëpamjet e mburravecëve që kujtojnë se një rrezik i tillë i madh mund të përballohet me lehtësi. Për ta përballuar rrezikun, në radhë të parë, situatat brenda duhet t'i kemi të forta. Në këtë drejtim mbështetja kryesore e forcës sonë në mbrojtje të atdheut është uniteti i popullit, përçarja na e dobëson mbrojtjen. Ky unitet duhet të bazohet në kuptimin e drejtë nga ana e popullit të vijës së Partisë. Nuk duhet të lodhemi kurrë së shpjeguari masave politikën e Partisë, domethënë ta propagandojmë gjerësisht këtë politikë. Sigurisht, propaganda është kurdoherë e mirë dhe asnjëherë e tepërt, por vijën politike të Partisë dhe të pushtetit popullit duhet ta shohë të realizohet me sukses në jetë,

ndryshe ai nuk bindet lehtë. Dhe ne luftojmë për një bindje reale, të plotë, jo të rreme ose gjysmake, pse vetëm në këtë rrugë sigurohet uniteti i vërtetë, i pafytyrës.

Disa njerëz mendojnë se çdo gjë varet nga ekonomia. Natyrisht, ekonomia mbetet gjithnjë baza, por jo faktori i vetëm përcaktues, politika zë kurdoherë dhe në çdo gjë vendin e parë. Le të marrim çështjen e Luftës Nacionalçlirimtare. Rolin kryesor në atë kohë e luajtën politika e drejtë e Partisë, qëndrimet e saj politike ndaj problemit të luftës kundër pushtuesve, uniteti politiko-ushtarak i popullit, problemi politiko-organizativ i ndërtimit të pushtetit të ri popullor. Me mbarimin e luftës dhe me marrjen e pushtetit nga Partia, në ndërtimin e socializmit qëndron, gjithashtu, në radhë të parë, vija politike e Partisë.

Problemi i unitetit të popullit, ndërtimi i një ekonomie socialiste moderne, ngritja e arsimit dhe e kulturës popullore, përgatitja e popullit dhe e atdheut për mbrojtje, problemi i njohjes në arenën ndërkombëtare i Republikës Popullore të Shqipërisë dhe sigurimi për të i një numri sa më të madh miqsh e dashamirësh në popuj, në shtete të ndryshme dhe në proletariatin ndërkombëtar, të gjitha këto e të tjera të tilla janë më parë se çdo gjë çështje të rëndësishme politike, të cilat përbëjnë politikën e Partisë dhe të Republikës sonë Popullore.

Mund të themi se në të gjitha problemet që përmenda më lart, ne kemi fituar një eksperiencë jo të vogël. Kjo eksperiencë është shumë e vlefshme dhe e

çmueshme, në qoftë se studiohet me zell, me seriozitet dhe me këmbëngulje nga njerëzit tanë dhe në rast se dihet dhe bëhen përpjekje të mësohet që ajo të shfrytëzohet e të zbatohet drejt. Zbatimi i marksizëm-leninizmit nga Partia jonë, pa u mburrur, është zhvilluar pozitivisht, jo në mënyrë dogmatike, por, duke ruajtur parimet, ky zbatim u është përshtatur situatave konkrete të vendit. Gjatë punës sonë ne kemi pasur suksese dhe gabime, shumë vështirësi kemi kaluar, prandaj, derisa kemi bërë gjithë këto përparime, në rast se do të dimë të mbështetemi në këtë eksperiencë të fituar, sukseset tona do të jenë akoma më të mëdha.

Disa mendojnë se ne jemi bërë administratorë të mirë të ekonomisë socialiste dhe nxjerrin konkluzione të gabuara subjektive, mburren dhe me këtë ata dëmtojnë çështjen. Ne nuk mund të themi që s'kemi fituar njëfarë eksperience në administrim, por, në rast se njerëzit tanë qederosen më shumë dhe tregohen më të vëmendshëm, ata do të konstatojnë se brenda globalit të administrimit, që mund të çmohet disi i mirë, ka edhe administratorë të këqij, që bëjnë gabime të palejueshme, që bëjnë shpërdorime, që nuk planifikojnë drejt, që drejtojnë dhe administrojnë në sipërfaqe dhe që nuk kontrollojnë. Këto janë çështje të një lufte të përditshme që duhet bërë, prandaj nuk mund të lejo- het askush që jo vetëm të mburret, por as edhe ta rru- mbullakosë këtë me shprehjen justifikuese se «është e pamundur të mos na ngjasin». Por, kur punonjësin e bankës e kemi njeri të mësuar, pse të ngjasë që banka të paguajë ndërmarrjen bujqësore për një sasi të kon-

siderueshme misri, që kjo nuk e ka dorëzuar kurrë? Ose përse t'u paguajë për katër vjet rresht prerësve të lëndës së drurit për një sasi lënde që ata nuk e kanë prerë dhe nuk e kanë dorëzuar kurrë? Të tilla ngjarje, të natyrave të ndryshme, e dëmtojnë dhe e dobësojnë ekonominë tonë, por dobësojnë politikisht dhe ideologjikisht edhe njerëzit, që, për një sërë arsyesh, i bëjnë këto ligësi.

Të gjitha këto çështje, edhe kur zbatohen drejt, edhe kur zbatohen gabim, mund të quhen vallë se janë probleme vetëm ekonomike ose në radhë të parë ekonomike? Jo! Ato janë në radhë të parë probleme politike. Janë politike, në radhë të parë, se nëpërmjet politikës ekonomike marksiste-leniniste dhe jo nëpërmjet «ekonomizmit» Partia synon të ndërtojë socializmin, i cili, derisa ekzistojnë klasat, nuk mund të konsiderohet i ndërtuar plotësisht.

Socializmi ynë nuk është si socializmi vetadministrues që trumbeton Titoja<sup>1</sup>. Titoja mund të mburret sa të dojë, por ai lloj «socializmi» që predikojnë titistët nuk do t'u sjellë kurrë asgjë të mirë popujve të vendeve të Afrikës, të Azisë e të Amerikës.

Për ne çështja qëndron që socializmin e vërtetë, që po ndërtojmë në të gjitha fushat në mënyrë revolucionare, njerëzit tanë, nëpërmjet një lufte të ashpër klasash, në të gjitha aspektet e zhvillimit të tij dia-

---

1. Dy ditë më parë, në një fjalim të mbajtur në Shkup, Josip Broz Titoja tha: «Në jugosllavët na shpallin revizionistë, pse i rezistuaam Stalinit dhe përhapëm ndërtimin e socializmit në vendet e Afrikës, të Azisë, të Amerikës».

lektik të ndërtimit, duhet ta shpjegojnë dhe ta kuptojnë politikisht, pse vetëm kështu do të kuptojnë psenë e gjërave, do të dalin me analiza dhe me konkluzione të drejta, do të dinë të ndajnë të mirën nga e keqja, do të parashikojnë dhe do të përgatitin të ardhmen.

Disa nuk e kuptojnë akoma si duhet rolin e madh që luajnë klasa punëtore dhe fshatarësia në ndërtimin e socializmit. Ata i përsëritin parimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit për pozitën e këtyre dy klasave në shoqërinë tonë socialiste, por, që të bëjnë një analizë të thellë marksiste-leniniste të kësaj çështjeje kapitale në kushtet e vendit tonë dhe të mendojnë se, të bazuar fort në tezat e Marksit dhe të Leninit, klasa punëtore është udhëheqja dhe ajo duhet të ecë në aleancë me fshatarësinë, këtë ata nuk e bëjnë dhe nënvleftësojnë rolin e madh revolucionar që ka luajtur dhe luan edhe sot fshatarësia në vendin tonë.

Para Çlirimit fshatarësia shqiptare ishte klasa më e shtypur, por njëkohësisht më patriote dhe me energji të shumta revolucionare, duke marrë parasysh se në vendin tonë, edhe pas vitit 1912 kur u shpall Pavarësia, nuk ekzistonte klasë punëtore, po ekzistonin esnafë, çirakë dhe njëfarë klase punëtore e sapokrijuar, me prejardhje më shumë nga fshati, në disa punishte ose fabrika të vogla.

Luftërat kundër pushtuesve, bejlerëve dhe pashallarëve turq e vendës, kundër shovinistëve grekë, serbë dhe italianë kanë qenë fshatarët e varfër dhe të mesëm që i kanë bërë. Gjaku i tyre ishte shfrytëzuar vazhdimisht nga feudo-borgjezia.

Luftën Nacionalçlirimtare, të udhëhequr nga Partia Komuniste e Shqipërisë, parti marksiste-leniniste, e bëri fshatarësia e varfër dhe e mesme bashkë me klasën punëtore, forcat kryesore të kësaj lufte. Kjo luftë filloi në qytet, ku punëtorët, çirakët, studentët dhe disa intelektualë patriotë e përparimtarë organizuan propagandën dhe dhanë alarmin e parë me greva, demonstrata, sabotime, atentate dhe trakte. Por lufta më e gjerë e armatosur u zhvillua në fshat. Baza kryesore e kësaj lufte u bë fshati, që u vu në dispozicion të Partisë dhe të luftës për çlirim. Fshatarësia jonë u dogj, ajo hapi zemrën, shtëpitë, dha bukën, dha gjakun, jetën e bijve dhe të bijave të saj dhe çdo gjë tjetër më të shtrenjtë që kishte.

Pas çlirimit fshatarësia jonë patriote vazhdoi përsëri në mënyrë revolucionare të japë çdo gjë. Ajo, me gjithë varfërinë që kishte trashëguar, mbajti, me aq sa kishte, me bukë, me qumësht, me mish etj., punëtorët e qyteteve dhe gjithë nëpunësit e administratës së re që po ngrihej. Fshatarësia u bë forca dërrmuese e rindërtimit të vendit, të rrugëve, të urave, të shtëpive e të fabrikave të djegura. Fshatarësia mbushi e shumëfishoi klasën punëtore nga radhët e saj dhe Partia e kaliste këtë me ideologjinë marksiste-leniniste. Në asnjë vend tjetër, me kushtet e vendit tonë, fshatarësia nuk është treguar kaq revolucionare, si kjo jona, kaq besnike e Partisë dhe e klasës punëtore.

Me çeljen e minierave, me ndërtimin e industrisë së re, u rrit, u kalit dhe po kalitet klasa punëtore dhe tash Partia këtë e ka ngritur në lartësi jo vetëm në

numër, por sidomos në rolin e saj hegjemon si udhëheqëse e denjë e vendit drejt ndërtimit të plotë të socializmit. Te ne klasa punëtore dhe Partia e saj marksiste-leniniste kanë në dorë pushtetin dhe, në aleancë të ngushtë me fshatarësinë, ndërtojnë me sukses socializmin.

Partia, me politikën e saj të drejtë, të matur, duke treguar durim dhe duke përdorur bindjen, e çoi fshatarësinë në rrugën e kolektivizimit, të likuidimit të pronës private në bujqësi. Kjo nuk ishte një çështje thjesht teknike, por, në radhë të parë, ishte një detyrë politike e Partisë nga më të mëdhatë e më të lavdishmet. Më parë se të ishte ekonomike, ajo ishte, pra, një detyrë politike. Duhej bindur dhe sqaruar fshatarësia, që dilte nga stadi i feudalizmit dhe i skllavërimit ekonomik, që të merrte një rrugë të panjohur për të. Ajo jo vetëm duhej ta kuptonte politikisht këtë rrugë, por natyra e fshatarësisë ishte që të shihte rezultatet e kolektivizimit, që të bindej për të mirat e tij. Kjo është arsyeja që Partia eci me kujdes jo vetëm në organizimin e kooperativave, por filloi dhe bëri investime të mëdha në bonifikim dhe në ujitjen e tokave, në hapjen e tokave të reja, në fillimin dhe në shtimin e mekanizimit të bujqësisë e kështu me radhë në marrjen e një sërë masash të tjera që e bindën fshatarin tonë për rrugën dhe për politikën e drejtë të Partisë në ndërtimin e ekonomisë socialiste në fshat. Kur mendojmë zhvillimin e kësaj pune në kompleksitetin e vet, brenda kuadrit të ndërtimit të socializmit në qytet dhe në fshat, shohim drejtësinë e vijës së Partisë në zgjidhjen e harmonishme të një sërë problemesh shumë të kok-

lavitura, me plot rreziqe e të papritura, me plot vështirësi, të mëdha e të vogla, të brendshme dhe të jashtme. Një gabim politik ose edhe organizativ mund të na rrezikonte situatën që kërcënohej vazhdimisht nga brenda dhe nga jashtë.

Çështja qëndron këtu, që fshatarësia shqiptare, aleatja e klasës sonë punëtore, është treguar në çdo moment me një ndjenjë të lartë revolucionare, direktivat e Partisë ajo i ka bërë të sajat dhe i ka mbrojtur. Bujqësia është sot baza e ekonomisë sonë socialiste, kurse industria — udhëheqësja e kësaj ekonomie. Prandaj në asnjë kohë dhe në asnjë mënyrë vëmendja e Partisë dhe kujdesi i saj dhe i klasës punëtore nuk duhet të dobësohen në drejtim të fshatit. Pra, të luftohet më mirë se deri tani që jeta e kooperativistëve të shkojë duke u përmirësuar.

Përmirësimi, ngritja e nivelit të jetesës në fshat nuk duhet të konsiderohen, siç mendojnë disa majtistë, sikur qenkan një sakrificë që qyteti po bën për fshatin. Dihet se është fshatarësia ajo që bëri dhe vazhdon të bëjë më shumë sakrifica, por niveli i jetesës së saj qëndron më i ulët se ai i qytetit. Disave u duket si normale gjendja ekzistuese, që nëpunësit dhe punonjësit me rrogë më të ulët në qytete kanë të ardhura më të mëdha se kooperativisti më punëtor në mjaft kooperativa bujqësore.

Të ardhurat, shpërblimi duhet të vazhdojnë të jenë të diferencuar, sipas punës, por nga organet shtetërore nuk duhen lënë në harresë vendimet e Komitetit Qendror që kërkojnë të studiohen diferencat në pagat



e punonjësve. Fryrja e organikave parazitare e shumë të këqija të tjera në çështjen e planifikimit dhe të investimeve pa bukë dhe pa kritere të shëndosha, jo vetëm shkaktojnë anomali në jetën e njerëzve, por ato godasin rëndë dhe dobësojnë vijën politike të Partisë. Zhvillimin e fshatit tonë socialist nuk duhet ta shohim duke u udhëhequr vetëm nga disa suksese të mira të pamohueshme në disa rajone. Këtë zhvillim ne duhet ta shohim me imtësi në të gjitha anët e fshatit tonë kooperativist. Duhet të na tërheqë vëmendjen fakti se një numër i madh kooperativash, sidomos mallore e gjysmëmallore, kanë akoma të ardhura të ulëta dhe shumë të ulëta për ditë-punë. Shumë arsye na jepen dhe shumë arsye ka, por të gjitha këto Partia duhet t'i shohë një nga një me kujdesin më të madh dhe çdo gjëje t'i japë zgjidhjen e drejtë.

Kolektivizimi duhet të konsolidohet dhe jo të dobësohet, pse, po u dobësua, kjo do të jetë katastrofë për socializmin. Po t'u hedhim një sy vendeve revizioniste, do të shohim se është shkatërruar kolektivizimi i bujqësisë edhe atje ku kishte filluar të ngrihej, gjë që ka sjellë likuidimin e socializmit. Në këto vende revizioniste ekziston një industri e fuqishme dhe një klasë punëtore, e cila, në vend që ta mëkëmbte, ta ndihmonte e ta fuqizonte aleaten e saj, fshatarësinë kooperativiste, lejoi likuidimin e saj dhe humbi kështu bazën e madhe të socializmit në fshat, lejoi krijimin e pronarëve të mëdhenj dhe të mesëm të tokave, krijimin e rezervës së njerëzve të papunë në qytete e nëpër fshatra. Partia duhet të luftojë çdo prirje majtiste

të mbuluar me slogane pseudomarksiste në këto probleme kyç.

Natyrisht, problemi i bujqësisë dhe konsolidimi i kolektivizimit nuk mund të tolerojnë një mënyrë, një metodë dhe një stil pune burokratik. Vendosja përgjithmonë e kooperativistit në fshat, popullimi i fshatrave dhe i ndërmarrjeve bujqësore të shtetit me qytetarë të rinj, nuk mund as të mbahet, as të bëhet me dekrete, por me masa shumë efikase në vend, që atje, në kooperativat dhe në ndërmarrjet bujqësore, të krijohen mundësi akoma më të mëdha e më të mira, të bëhen investime më shumë për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës, njerëzit dhe familjet që vendosen në fshat të kenë ku të rrinë, ku të jetojnë. Për kuadrot që dërgon atje shteti nuk po ndërtohen akoma banesa, nuk merren masa serioze për të gjithë ata që duhen vendosur në ndërmarrje e në kooperativa bujqësore. Çdo ndërtim bëhet në qytete, që po na fryhen, po na fryhen, gjithashtu, aparatet me njerëz që duhet t'i thithë fshati. Po si t'i thithë e t'i mbajë fshati, kur politika dhe vendimet e Partisë nuk po kuptohen dhe nuk po zbatohen si duhet?

Një numër i madh specialistësh me arsim të lartë dhe të mesëm të bujqësisë, në vend që të dërgohen të punojnë në fshat, po mbahen në qytete dhe janë fryrë zyrat me ta, gjoja sikur drejtojnë, sikur bëjnë studime, sikur supervizojnë. Zyrat dhe ndërmarrjet e qyteteve janë mbushur, gjithashtu, me ekonomistë e me financiarë, në një kohë që ekonomitë kooperativiste kanë mbetur lakuriq.

Politika e Partisë është kjo? Jo! Kjo s'ka qenë dhe s'do të jetë kurrë politika e Partisë, por e atyre që nuk e kuptojnë ose nuk duan ta zbatojnë vijën e drejtë të Partisë. E keqja e madhe qëndron në atë që të gjitha këto shtrembërime të vijës së Partisë bëhen «në emrin e Partisë» dhe nga njerëz të Partisë, bile kryesorë, që nga ministra dhe drejtorë. Këta japin tonin e këtyre veprimeve, këta ia imponojnë bazës, e cila nuk lejohet të thotë mendimin dhe, kur e thotë, ai hidhet në shportë. Vallë kjo është vija e Partisë në politikën me masat? Vallë kështu rekomandon Partia për zbatimin e vijës së saj, siç veprojnë disa njerëz të pandërgjegjshëm? Jo, kjo nuk është vija e Partisë, por e kundërta e saj.

Disa elementë partie që kanë fituar një diplomë, që kanë fituar njëfarë eksperience, mendojnë se kanë prekur qiellin me dorë, kanë krijuar një mentalitet kulaku se janë bërë të paprekshëm, se nëna i paska pjellë të rrojnë kaluar mbi shalë me çull dhe të vrasin e të presin si të duan. Këtyre njerëzve Partia duhet t'u thyejë hundët dhe kërcinjte, t'i zbresë menjëherë e pa hezitim nga kali dhe t'i bëjë të ecin në këmbë dhe jo në rrugët me asfalt të qyteteve, por në llucën e në baltën e fushave ku punohet e prodhohet, ku fitohet buka me djersë dhe jo me llogje.

Kudo, mbi punët, mbi njerëzit, mbi mendimet dhe mbi veprimet e tyre, duhet të vendosen vija dhe politika e Partisë. Partia dhe klasa të jenë në këmbë. Klasa në socializëm punon, vigjilon dhe drejton. Kjo duhet të kuptohet mirë, se ka njerëz që e kuptojnë ve-

tëm sikur klasa duhet të punojë, ndërsa dy detyrat e tjera janë prerogativat e tjetërkujt. Sipas këtyre njerëzve, janë zyrtarët, burokratët, «të mësuarit» ata që vigjilojnë dhe drejtojnë.

Partia duhet medoemos të vërë në radhë të parë klasën punëtore që të drejtojë e të vigjilojë dhe zyrtarët të zbatojnë si duhet detyrat që u caktojnë Partia dhe diktatura e klasës. Kontroll punëtor do të thotë vigjilenca punëtore në veprim, diktatura e klasës në veprim. Kontrolli punëtor është klasa në drejtim, ai është rektifikimi i gabimeve dhe i shtrembërimeve të zyrtarëve burokratë. Kontrolli punëtor është zbulimi dhe dënimi me ashpërsi i punës armiqësore dhe i atyre që e bëjnë atë. Partia dhe klasa punëtore duhet të hapin sytë nga hileqarët, të cilët për sy e për faqe pranojnë ndonjë kritikë që u vjen nga poshtë dhe pastaj, duke shpërdoruar pozitën, hakmerren kundër kritikuesit. Ky fenomen nuk është imagjinar, por real dhe duhet gjetur metoda më e përshtatshme e luftës kundër tij. Në përgjithësi, ata që hakmerren dhe mund ta zhvillojnë këtë veprimtari të shëmtuar, ose janë në vende drejtimi, ose janë njerëz që shpifin. Ka edhe komunistë, edhe nëpunës me pozita që e bëjnë këtë. Kujdes të madh duhet të bëjnë Partia dhe klasa nga këto veprime, pse këto synojnë të çajnë Partinë nga klasa dhe klasa të humbasë besimin tek udhëheqja; arrihet që njerëzit të ngurrojnë të flasin, se e pësojnë nga zyrtarë të tillë të poshtër nën maskën e pozitës, të cilët synojnë të forcojnë pushtetin e tyre dhe të krimbin pushtetin popullor. Këtyre duhet t'u vëmë përballë

opinionin e shëndoshë, dërrmues. Prandaj në këtë luftë kërkohet unitet për mbrojtjen e së drejtës dhe të të drejtit, duhen guxim, trimëri dhe luftë kundër indiferentizmit. Partia dhe klasa janë me popullin, me trimat.

Këto parime e probleme që u theksuan më lart kanë një rëndësi të madhe politike dhe ideologjike, pse duhet të dimë që Lenini na mëson dhe eksperiencia e madhe e Partisë sonë na ka vërtetuar se divergjencat e mëdha lindin nga mosmarrëveshjet e vogla. Disa nuk u vënë rëndësi këtyre mosmarrëveshjeve të vogla, i nënvleftësojnë, i zgjidhin gabim, disa herë me rrugë administrative, dhe harrojnë se jeta është jetë dhe të tilla gjëra krijojnë pakënaqësi. Këto pakënaqësi të ndryshme, në forma dhe në përmbajtje, janë të shumta, bëhen akoma më të shumta po t'i lësh dhe veprojnë si një plagë e vogël në trup që, po nuk e shërove si duhet, mund të shkaktojë vdekjen e njeriut. Lenini na thotë se çdo divergjencë, dhe krejt e parëndësishme, mund të bëhet politikisht e rrezikshme, në qoftë se paraqitet mundësia që ajo të zhvillohet në një përçarje.

Politika e Partisë është një çështje kapitale. Çdo gjë ka politikën e Partisë me vete. Këtë politikë çdo njeri duhet ta studiojë dhe ta ketë parasysh, asgjë nuk duhet të dalë jashtë prizmit të saj. Asnjë klasë, na ka mësuar Lenini, nuk mund të sundojë pa një qëndrim politik ndaj çdo çështjeje. Pa një qëndrim të tillë politik për çdo problem, pra, Partia jonë nuk mund ta kryejë edhe detyrën e saj të madhe në prodhim.

Prandaj të ndash politikën nga ekonomia, ta quash veten «ekonomist» dhe të mendosh se je njëkohësisht

edhe njeri politik marksist-leninist, pa bërë përpjekje për të qenë i tillë, kjo, pa asnjë dyshim, të çon në gabime politike dhe në gabime ekonomike.

E njëjta gjë na ngjau në ushtri. Tradhtarët Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako e të tjerë na hiqeshin si «ushtarakë të zotë, strategë dhe takticienë të mbaruar». Por ç'fshihaj në kufomat e tyre? Një qelbësirë e madhe! Ata politikën e Partisë e kishin vënë nëpër këmbë, hiqeshin sikur e dinin edhe politikën, edhe artin ushtarak, po nuk dinin as njërën, as tjetrin. Ata tradhtuan njërën, tradhtuan edhe tjetrin. Ata më parë tradhtuan politikisht dhe kjo i çoi edhe në tradhtinë ushtarake. Prandaj si në ekonomi, si në çështjet e mbrojtjes, si në çështjen e arsimit e të kulturës, politika e drejtë e Partisë duhet të sundojë, të udhëheqë, të sqarojë. Kjo lypset të bëhet e qartë. Të thellohen njerëzit në të, të studiojnë ata me kujdesin më të madh marksizëm-leninizmin dhe eksperiencën e Partisë sonë dhe t'i kenë këta parasysh në punë, në jetë, në luftën e përditshme. Nga një punë e tillë, nga një kuptim i tillë dhe nga një zbatim i drejtë i vijës së Partisë varen ekzistenca dhe kaimtja e unitetit të popullit rreth Partisë, varen ndërtimi me sukses i socializmit dhe mbrojtja e tij nga sulmet e rrezikshme të armiqve të jashtëm dhe të brendshëm.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1974-1975»,*

*f. 174*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1974-1975», f. 174*

## DE PROFUNDIS TJETËR PËR SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

Shënime

8 prill 1975

Shtetet e Bashkuara të Amerikës i lanë duart nga Kamboxhia. Tok me kukullën e tyre, Lon Nolin, vranë e prenë kamboxhianë, dogjën qytete e fshatra dhe tash, në pamundësi të vazhdonin barbarizmat, tërhoqën Lon Nolin dhe kriminelët e luftës dhe i kënduan *De profundis*-in Kamboxhias.

Amerikanët janë duke larë duart edhe nga Vietnam i Jugut. Njëri pas tjetrit, 3-4 presidentë amerikanë hodhën në Vietnam aq bomba, aq napalm, aq iperit, sa as në Luftën e Dytë Botërore nuk u përdorën! Të vrarët, të plagosurit, shkatërrimet dhe djegiet nuk mund të llogariten. Hunëve, të cilët historia i përshkruan shumë barbarë, ashtu siç edhe ishin, amerikanët ua kaluan aq shumë, saqë, pa u gabuar, hunët mund t'i cilësojmë më «humanitarë» se amerikanët! Por patën edhe amerikanët «fushat katalonike»<sup>1</sup> të tyre.

---

1. Fushat ku Atila u mund nga kundërshtarët e tij.

Thieut, kukullës së tyre në Vietnamin e Jugut, iu shtrëngua laku dhe po i zihet fryma. Ai, duke qenë në shkatërrim e sipër, thërret amerikanët për ndihmë. Mirëpo Fordit nuk i vjen zëri, sepse është duke i dalë tymi i fundit në një «Dien Bien Fu» të ri që quhet Sajgon, ku gjenerali amerikan nuk dëshiron të pësojë fatin e gjeneralit Dë Kastri.

Tash Fordi shpërtheu «fushatën humanitare» për Vietnamin. Ai po tërheq «jetimët» e barbarizmave të tij, 100 mijë refugjatë vietnamezë, ndër të cilët preferon, sa të jetë e mundur më shumë, të rinj dhe të reja. Këta janë kolonët e rinj që ngjyrën e fytyrës s'e kanë të zezë si skllëvërit që bliheshin dikur në Afrikë duke u shikuar dhëmbët dhe muskujt, por janë nga raca e verdhë. Skllëvërit e rinj vijnë nga Azia, megjithatë edhe këtyre përsëri ua shikojnë dhëmbët dhe ata që nuk i kanë në rregull, i hedhin në det. Amerikanëve u duhen këto rezerva skllëvërish, prandaj shpërthyen operacionin për «shpëtimin e refugjatëve vietnamezë», të cilin do ta bekojë edhe papa Pavli VI dhe «do të derdhin lot» plakat amerikane, të cilat do t'u japin refugjatëve, «këtyre viktimave të barbarëve komunistë», nga një këmishë të vjetër najloni që ta veshin.

Kisingeri, i kthyer dje nga një takim me Fordin, mbajti një *De profundis* tjetër, atë të Vietnamit. «S'ke-mi, — tha ai, — veçse 150 milionë dollarë për ndihma, të cilat do të shërbejnë për shpëtimin e refugjatëve», pra për operacionin që thamë më lart dhe për të përgatitur ndonjë kompromis. Shtetet e Bashkuara të Amerikës arrogante kërkuan ndihmën e Francës ose të ndo-



një shteti tjetër (lexoje të Bashkimit Sovjetik), që këta të bëjnë diçka për t'u shpëtuar fytyrën agresoreve amerikanë dhe, si shpërblim, Shtetet e Bashkuara do t'u japin atyre që do t'u vijnë në ndihmë nga një kockë.

Kambanat e disfatave për Shtetet e Bashkuara të Amerikës po bien nga çdo anë. Ato nuk janë akoma kambanat e vdekjes, por të disfatave të mëdha e vdekjeprurëse.

Këto disfata politike janë rezultat i krizës së madhe ekonomike, që prej vitesh ka mbërthyer botën kapitalisto-revizioniste, duke shkaktuar dallgë të thella, që u dobësojnë forcën dhe u nxjerrin pareshtur bojën manovrave dhe intrigave imperialisto-revizioniste. Lindja e Mesme është një «furrë» tjetër për imperializmin amerikan. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet «kobures» së tyre, Izraelit, harxhuan në këtë zonë miliarda dollarë. Përse? Për të siguruar naftën e kësaj zone. Mirëpo miti i «pathyeshmërisë» së Izraelit u zhduk dhe plani amerikan nuk u solli këtyre atë që dëshironin. Dominimi i intrigave të Kisingerit nëpërmjet Izraelit perëndoi. Prandaj tash po duket në qiell një tjetër plan amerikan: Pse SHBA të mos bëjnë sikur do ta lënë në llucë Izraelin dhe të kthehen në «miqësinë» me arabët? Politika e armiqësisë me arabët dhe e miqësisë me Izraelin nuk solli gjë veç krizën e naftës. Prandaj duket se po fillon një fazë e re: «dashuri» me arabët dhe «zemërim» me Izraelin. Në të vërtetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do ta sakrifikojnë kurrë Izraelin, por do të bëjnë demagogji të madhe

sikur gjoja janë për «përmbajtjen» e Izraelit, bile edhe për «kthimin e tij në kufijtë e mëparshëm», ndërsa popujve arabë do t'u thonë «ne jemi miq me ju». *De profundis* tjetër për politikën agresive amerikane, një gjoja kthim në rrugën e «paqes» e të «miqësisë» dhe papa Pavli VI do të mbetet i kënaqur. Miku i amerikanëve, shahu i Iranit, po punon në drejtimin e tyre. Ai «u puth» me Al-Bakrin<sup>1</sup>, me të cilin gjer dje po thereshin në kufi. Qëllimi është: T'i qërojnë sovjetikët nga kjo zonë, t'ua ngrenë këmbët nga Afganistani dhe të mbështetin Buton<sup>2</sup> me armë kundër Indisë, ku sovjetikët po livadhisin. Pra, kthesa e amerikanëve të detyruar nga disfata synon të qërojë terrenin nga sovjetikët që kërkojnë të kullotin në Egjipt, në Siri, në Liban dhe kudo rreth këtyre zonave. Duket, pra, qartë se imperializmi amerikan është në krizë të madhe.

Edhe partnerët e tij në këtë batak janë futur, deri në grykë kanë hyrë. Zërat e tyre janë të ngjirur, që të gjithë po përpëliten, po dridhen, po hedhin çape hezituese. NATO-ja lëkundet dhe zien nga tërmetet, por edhe mbahet në këmbë: Franca edhe ka ikur prej saj, edhe vërtitet brenda. Zhiskar d'Estëni vërtitet andej-këtej, pa pasur as personalitet dhe as ndonjë politikë të qartë. Ai ecën si i hutuar, hiqet si me arabët, fut atje gishtin dhe prapë e tërheq, fut gishtin në Greqi dhe shpejt e tërheq, diku thotë një fjalë të mirë për

---

1. Ahmed Hasan Al-Bakr — ish-president i Republikës së Irakut.

2. Zylfikar Ali Buto — ish-kryeministër i Pakistanit.

Turqinë, jep dy buzëqeshje për Rusinë, një të shtrënguar të dorës për Gjermaninë, një buzëqeshje për Anglinë dhe kështu me të tjerët... Franca gjoja është kundër amerikanëve, por, në fakt, nuk është kundër. Anglia është në fund të qypit, ose më mirë në fund të detit. Ajo po merret edhe me Shelepinin<sup>1</sup>! Gjermania Perëndimore s'po dëgjohet, sigurisht punon nën rrogëz.

Rusi ka hyrë në një krizë po aq kolosale sa edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përpara krizës amerikane ai rri sus, si një qen salloni. Pse vallë? A nuk do të sulmojë kur partneri i tij i madh gjendet në vështirësi? Jo! Bashkimi Sovjetik është agresiv, por ndodhet vetë në krizë të brendshme politike, ekonomike dhe ushtarake. Bashkimi Sovjetik është në dekadencë ekonomike, industria e tij është e vjetër, ai dëshiron ta modernizojë këtë, prandaj kërkon kredi kolosale nga imperializmi amerikan, i cili nuk ia jep pa marrë koncesione. Satelitët e tij janë në lëvizje. Në Traktatin e Varshavës ata mbahen me forcë, në KNER mbahen me forcë, detyrohen, gjithashtu, me forcë të bëjnë mbledhje partie dhe deklarata të përbashkëta.

Dhe megjithëse e tërë kjo krizë, tërë kjo kalbësirë e imperializmit dhe e socialimperializmit duket qartë, prapëseprapë bëhen përpjekje që të fshihet, të mbulohet. Me se? Me çfarë? Me psikozën e luftës së përgjithshme dhe të pjesshme. Kjo psikozë është e kurdisur

---

1. Në atë kohë u përjashtua nga Byroja Politike e KQ të PK të BS dhe u hoq nga funksioni i kryetarit të Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale të Bashkimit Sovjetik.

nga dy superfuqitë dhe e ushqyer nga agjenturat e tyre.

«Qipro!» — zhurmë e madhe: «Mesdheu në rrezik!». Kolonelët grekë vepruan, turqit kundërvepruan, sovjeti lëvizti, bullgari «qëndisi», Titoja «lukurisi», Zhiskari «dërdëllisi» dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës shtojnë e fuqizojnë bazat e tyre ushtarake. Këto bëhen nga frika që kanë imperializmi e socialimperializmi nga popujt e botës, si dhe për të kapërcyer pa plagë të mëdha krizën e rëndë që po kalojnë Bashkimi Sovjetik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe klikat antipopullore në vendet e ndryshme.

Karakteristikë e përgjithshme e klikave antipopullore kapitaliste në vendet e ndryshme është përpjekja që bëjnë ato për të mos u angazhuar shumë dhe fare hapur me njërin ose me tjetrën superfuqi. Këtë nuk e bëjnë se janë për një politikë të pavarur nga superfuqitë, por se nuk janë të sigurtë se si do të dalin nga kriza. Ato edhe lidhjet e vjetra i mbajnë nën presion, por, kur u duhet, hedhin vickla, hiqen sikur mbrojnë «interesat kombëtarë», kurse, në fakt, trustet e koncernet që drejojnë këto vende janë kokë e këmbë kozmopolite, kokë e këmbë në duart e superfuqive.

Shtetet e Evropës Perëndimore edhe e duan çlirimimin nga zgjedha e amerikanëve, por edhe nuk rrojnë dot pa amerikanët, se dridhen nga sovjetikët. Ato kanë frikë po të largohen forcat amerikane nga kontinenti, sepse e dinë që, në një luftë të mundshme me sovjetikët, amerikanët, në qoftë se do t'u vijnë në ndihmë, këtë do ta bëjnë pas orës 12, sikurse kanë bërë në dy luftërat e para. Por Shtetet e Bashkuara, thonë disa,

nuk mund të kthehen në «izolacionizëm». Kjo është e vërtetë, por pikërisht këtë lodër «joizolacioniste» bënë ata si në kohën e Uilsonit<sup>1</sup>, ashtu dhe në të Rusveltit<sup>2</sup>. Këtë mund ta bëjnë fare mirë edhe nën një president tjetër. Kësaj i thonë «një manovër e vogël» për të dobësuar kundërshtarët me një luftë të përgjakshme që pastaj të vijnë SHBA e të hanë gështenjat që të tjerët ua kanë nxjerrë nga zjarri.

Mendimi im është se në këto situata të dyja superfuqitë, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe Bashkimi Sovjetik, janë në krizë të madhe, ndaj lufta kundër tyre duhet të vazhdohet e ashpër në të dy frontet. Ne as mund të dalim e as mund të jemi dakord me konkluzionin e disave, sipas të cilëve «socialimperializmi sovjetik është më i rrezikshëm se imperializmi amerikan», prandaj «të ashpërsojmë luftën kundër të parit dhe ta dobësojmë luftën kundër të dytit»<sup>3</sup>. Kjo do të thotë të ndihmojmë njërin, imperializmin amerikan, duke u bashkuar me të në luftë kundër tjetrit, socialimperializmit sovjetik. «Thellojmë kontradiktat», tho-

1. Tomas Udrou Uilson — president i SHBA-së në vitet 1913-1920.

2. Franklin Delano Rusvelt — president i SHBA-së në vitet 1933-1944.

3. Këto pikëpamje të gabuara antimarksiste, të cilave Partia e Punës e Shqipërisë u bëri kritikë të rreptë parimore qysh në shfaqjen e tyre, i përhapte dhe i mbronte udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës. Siç vërtetoi edhe koha, në këtë mënyrë ajo kërkonte të justifikonte kursin e vet politik të afrimit e të bashkëpunimit me imperializmin amerikan dhe me kapitalin botëror kundër socializmit e popujve.

në ata. Po në favor të kujt i thellojnë? Në qoftë se pretendojnë se i thellojnë në favorin e proletariatit e të popujve, atëherë duhet të godasësh njëlloj edhe të dyja superfuqitë.

Janë, po ashtu, të gabuara, mendoj unë, ato pikëpamje, sipas të cilave duhet mbrojtur Tregu i Përbashkët Evropian, që nuk është tjetër veçse një krijesë e kapitalizmit botëror. Po pse të mbrohet? Gjoja për të përballuar presionin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Sovjetik. Po në duart e kujt është ky Treg i Përbashkët? Në duart e kapitalistëve dhe të monopoleve ndërkombëtare për të shtypur e për të shfrytëzuar popujt. Si rrjedhim, ata që i mbrojnë këto teza, pranojnë se duhet fuqizuar pushteti i borgjezisë evropiane mbi popujt. Kjo do të thotë që, në vend që të nxitim revolucionet progresiste popullore kundër kapitalit nacional dhe atij kozmopolit, të nxitim shtypjen dhe shfrytëzimin, të nxitim luftën botërore imperialiste. Ne komunistët jemi për luftëra të drejta dhe jo për luftëra të padrejta dhe, në rast se pëlqet një luftë e padrejtë nga imperializmi botëror, ne duhet ta sabotojmë atë dhe ta kthejmë në një luftë revolucionare.

Për sa i përket Partisë së Punës të Shqipërisë, kjo do të vazhdojë të zbatojë vijën e saj të drejtë pa lëkundjen më të vogël. Vija e Partisë sonë është revolucionare, prandaj ne i ndihmojmë revolucionarët, partitë komuniste (marksiste-leniniste) që janë në pozita revolucionare, njerëzit përparimtarë. Ndihma që u jep këtyre Partia jonë është një ndihmë modeste, por edhe

ata i japin Partisë dhe popullit tonë ndihmën dhe përkrahjen e tyre në arenën ndërkombëtare. Shqipëria duhet ta çmojë drejt këtë ndihmë të jashtme që i jepet. Kjo ndihmë ka bërë që jo vetëm të çahet izolimi borgjezo-revizionist që i bëhet Shqipërisë socialiste, por që edhe politika, historia, zhvillimi dhe përparimi i vendit e i Partisë sonë të njihen kudo. Në kohë të mira dhe të vështira ne duhet ta llogaritim këtë ndihmë. Prandaj punën më miqtë e jashtëm ta zgjerojmë vazhdimisht në rrugë marksiste-leniniste, ta kemi kurdoherë në vëmendjen tonë dhe dita-ditës ta ushqejmë propagandën tonë për vendet e huaja.

Vendet e vogla, popujt e vegjël kanë nevojë për njëri-tjetrin; ata duhet të mbështetin njëri-tjetrin në luftën kundër synimeve djallëzore të superfuqive. Këtu nuk është fjala vetëm për të qenë vigjilentë ndaj aleancave që kurdisin me njëri-tjetrin krerët borgjezë ose revizionistë që shtypin popujt e tyre, por sidomos për të krijuar dhe për të vënë në lëvizje opinionin përparimtar revolucionar, për të mbrojtur çështjen e të gjithë popujve në tërësi dhe të çdo populli në veçanti.

Natyrisht, kohët janë shumë të rrezikshme. Popujt duhet të kuptojnë se aktualisht të dyja superfuqitë përgatitin luftën e tretë botërore, e cila do të pëlcasë kur kontradiktat në mes dy superfuqive do të acarohen në kulm, kur si njëri, edhe tjetri imperializëm do të kenë narxhuar të gjitha mjetet e politikës «paqësore» dhe do ta vazhdojnë politikën e tyre me mjete të tjera, me luftë. Por kësaj i tremben të dyja palët, se do të jetë luftë me armë bërthamore, shka-

tërrimtare, ku zor të ketë fitues e të mundur. Prandaj përgatitja e saj nga të dyja superfuqitë nuk bëhet vetëm duke u armatosur ato vetë kush e kush më shumë, më shpejt e deri në dhëmbë për ditën e «ndeshjes së tmerrshme». Kjo është njëra anë. Ana tjetër është se superfuqitë në politikën e tyre i bëjnë shantazh njëra-tjetrës për ndarjen e tregjeve të botës, zhvillojnë procesin e kolonizimit dhe të shfrytëzimit të popujve të tjerë. Në këtë proces hyn edhe armatosja e klikave që sundojnë mbi këta popuj. Këto klika janë shtypëse të popujve të tyre dhe «aleate» të asaj superfuqie që u ofron më shumë. Nga kjo lindin konfliktet e veçuara, që çojnë drejt konfliktit të përgjithshëm botëror.

Pra, të dyja superfuqitë, para «lojës tragjike» të fundit, luajnë lojën e shahut, duke përdorur pionet e tyre: Izraelin kundër vendeve arabe, Vietnamin e Thikut kundër Vietnamit të Veriut. Ato nxitin mosmarrëveshjet midis Greqisë e Turqisë dhe nesër do të nxitin popujt e Afrikës në mes tyre, gjë që qysh tani e kanë filluar me Etiopinë dhe Somalinë etj. Lufta e pjesshme mund të kalojë edhe në Amerikën Latine. Pasi mbaroi Bangladeshi, mund të fillojë një luftë midis Indisë dhe Pakistanit ose midis Pakistanit dhe Afganistanit. Po vazhdon lufta e Jemenit të Veriut me atë të Jugut dhe kështu do të ecë puna, derisa zjarri i luftës të kalojë në Evropë.

Kjo metodë ndiqet nga dy superfuqitë, në garë me njëra-tjetrën, për hegjemoni botërore. Para Luftës së Parë Botërore dhe duke u maskuar më me kujdes pas saj, Fuqitë e Mëdha çonin zyrtarisht ushtritë



dhe kanonierat e tyre për të kolonizuar popujt. Pas Luftës së Dytë Botërore ndodhi e njëjta gjë, por në forma të tjera. Vende të ndryshme, siç ndodh në Evropë, janë pushtuar *de jure* dhe *de facto* prej superfuqive me ushtri dhe me bomba atomike. Këto forca ushtarake shtohen vazhdimisht dhe qëndrojnë të pacenuara, qysh kur u fitua lufta mbi Hitlerin. Popujt e Evropës, në vend që të çliroheshin, u robëruan trefish, politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht. Të gjitha shtetet e tjera të botës, me përjashtim të Shqipërisë, janë të pushtuara, gjithashtu, si të thuash, në mënyrë të trefishtë: diku politikisht ato janë bërë bishti i dy superfuqive, diku ekonomikisht janë bërë kolonitë e tyre dhe diku gjatë janë kthyer në baza ushtarake, ku klikave në fuqi u jepën armë për të ruajtur zgjedhën mbi popujt.

Këto taktika, kjo strategji vdekjeprurëse e të dyja superfuqive duhen demaskuar, duhen luftuar. Kjo është çështje e përbashkët e gjithë popujve, ndaj dhe lufta duhet zhvilluar e ashpër prej gjithë popujve. Lufta kundër dy superfuqive dhe satelitëve të tyre në të gjithë botën është një ndërmarrje kolosale, e rëndë, e koklavitur, e cila, pa ngritur në këmbë gjithë popujt, nuk mund të ketë suksesin e duhur. Popujt e botës në këtë luftë duhet të kenë strategjinë dhe taktikat e tyre, të cilat kërkohet të jenë revolucionare. Nuk është e thënë që këtë luftë duhet ta organizojnë e ta bëjnë vetëm komunistët e vërtetë. Jo, kjo do të ishte gabim. Lufta kundër dy superfuqive dhe aleatëve të tyre nuk mund të bëhet nga një pakicë, por nga shumica, me kusht

që kjo pakicë, partia marksiste-leniniste, të mos humbasë personalitetin e vet dhe jo siç bën Kina që deklaroi se «bën pjesë në botën e tretë» apo se «duhet luftuar vetëm kundër njërës superfuqi» etj. Shqipëria socialiste nuk bën pjesë në të ashtuquajturën botë e tretë dhe as e pranon këtë koncept antimarksist. Shqipëria ndihmon gjithë popujt dhe shtetet që ngrenë krye kundër të dyja superfuqive, që u prishin këtyre planet agresive dhe robëruese, që i dobësojnë me goditjet e tyre dhe ngjallin frymën luftarake revolucionare për të shkuar më tej në fitoren e plotë të popujve. Me këta do të jetë Shqipëria socialiste, pa qenë as në «botën e dytë», as në «të tretën». Shqipëria i përket vetëm botës socialiste dhe për këtë lufton në rrugën marksiste-leniniste.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha, «Superfuqitë»,  
f. 378*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Superfuqitë»,  
f. 378*

# LETRAT NGA POPULLI — ERË E FRESKËT E DEMOKRACISË SONË SOCIALISTE

Shënime

11 prill 1975

Letrat që më dërgojnë njerëzit e popullit përbëjnë për mua një thesar të paçmuar. Unë jo vetëm që i lexoj me vëmendje të madhe, por reflektoj thellë mbi to, për të analizuar paraprakisht karakterin e çështjes personale apo të interesit të përgjithshëm, karakterin e personit që e shkruan, aq sa mund të më lërë të kuptoj letra, dhe këndej të mendoj deri në ç'shikallë janë të vërteta dhe të qena ato që shkruhen në të. Kjo është një punë paraprake që bëj dhe, në përgjithësi, atyre që do të vërtetojnë brendinë e letrës, u rekomandoj se ç'duhet të më vërtetojnë.

Të marr dhe të lexoj letrat e popullit është për mua diçka pasionante. Fizikisht nuk do të mundja të takohesha dhe të bisedoja sy më sy me aq njerëz sa do të dëshiroja, as njerëzit nuk mund të më thoshin dot me gojë aq gjëra sa më ngrenë në letrat e tyre. Po ç'horizonte të gjera të hapin letrat e popullit, ç'gjëra interesante të zbulojnë për njerëzit, për karakterin, pu-

nën, drejtësinë, padrejtësinë, hatërllëqet dhe matrapazllëqet e një pjese të tyre! Ç'gjëra me vlerë të bëjnë të ditur ato, duke dashur ose pa e kuptuar, për gjendjen shoqërore, për frymën që sundon, për anët e mira e të dobëta të organeve të pushtetit dhe të Partisë atje ku jetojnë autorët dhe nga shkruajnë letrat!

Ndodh që një letër e thjeshtë provokon tek unë një nxitje të tillë, që më ndihmon të mësoj një situatë në rreth, saqë asnjë raport i komitetit të Partisë nuk na e ka paraqitur më parë. Një fshatar i thjeshtë nga Zall-Dardha e rrethit të Dibrës, në një letër të shkurtër që më ka dërguar para ca kohësh, më thoshte se brigadieri, me urdhër të kryetarit, me disa punëtorë bujqësie i kishin hyrë në shtëpi dhe me zor i morën plehun e oborrit, ky i ndaloi, po ata e rrahën, dhe kërkonte drejtësi.

Shikoni, shumë e thjeshtë është letra, po shumë e qartë: padrejtësia dhe krimi që kryhen ndaj këtij personi.

Në anë të kësaj letre i kërkoj sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të Rrethit të Dibrës: «A janë të vërteta këto dhe pse lejohet të bëhen? A merren masa për këto krime? Janë të vërteta çfarë thotë fshatari për kryetarin e kooperativës? Në qoftë se po, çfarë lufte klasash është kjo? M'u përgjigj, të lutem, të gjitha këtyre pyetjeve, duke më dhënë edhe mendimin tënd dhe ç'masa do të merrni».

Sekretari i parë i rrethit m'u përgjigj jo shkel e shko, por duke më bërë një analizë të gjendjes së Partisë në rreth dhe më flet për masat që mendon se

duhet të marrim ne në qendër dhe ata në shkallën e rrethit të tyre. Këto masa kanë rëndësi për jetën e Partisë jo vetëm për rrethin e Dibrës, por për gjithë Partinë. Dhe këtë e shkaktoi vetëm letra e thjeshtë e një kooperativisti.

Dëgjoni: ngjarja për të cilën bën fjalë fshatari ishte e vërtetë dhe fajtori iu dha gjyqit. Të gjitha ato që shkruan ai për kryetarin e kooperativës, rezultojnë të vërteta. Kush është ky kryetar i kooperativës? Njëfarë njeriu që tre xhaxhallarë i ka pasur kulakë, një kushëri të pushkatuar, një nip agjent të UDB-së jugosllave, xhaxhanë e gruas të dënuar politik. Dhe një njeri i tillë shkon nga ofiqi në ofiq dhe jo vetëm që më rri në Parti, por ka katër vjet që drejton edhe kooperativën bujqësore. Skandaloze!

Pse ka ndodhur kështu? Jepet përgjigje se të gjitha këto ky i paska fshehur në biografi, sikur të mos ishte nga fshati, por sikur të kishte ardhur nga Afrika e Jugut dhe nuk ia njeh kush biografinë!

Janë shumë të dënueshme qëndrimet e atyre shokëve të Partisë dhe të pushtetit që nuk u vënë rëndësi ose u vënë shumë pak rëndësi letrave të popullit. Në bazë, letrave, me përjashtim të atyre që na vijnë neve, dhe që shokët e rretheve bëjnë përpjekje për një verifikim më të mirë dhe marrje masë më të drejtë e më të shpejtë, nuk u vihet rëndësia e duhur, nuk bëhen hetime serioze, por përciptazi u jepet zgjidhje. Ka hatëre, ka padrejtësi në zgjidhje, ka arrogancë dhe të gjitha këto krijojnë pakënaqësi, të cilat shprehen me dërgimin e letrave anonime që marr. Këto letra ano-

nime nuk shkruhen të tëra nga njerëz armiq. Jo, shumë rrallë ndodh që më dërgohen letra anonime nga elementë të këqij. Shkruesi i letrës anonime nuk mund të jetë kurdoherë armik vetëm për faktin se dërgoi letër anonime. Ato shkruhen më shumë për të shpjeguar një gjendje jo të shëndoshë, një padrejtësi të bërë nga dikush në pushtet që vepron keq, në kundërshtim me ligjet dhe, derisa shkel ligjet, shkruesi i letrës anonime ka frikë të tregojë emrin, se personi për të cilin ankohet, do të hakmerret kundër tij. E mira është që autori ta vërë emrin, por duhet të dimë se, jashtë ligjit, jashtë normave etj., ka edhe njerëz me përgjegjësi që veprojnë keq dhe hakmerren. Në shumë letra anonime që dërgoj në bazë për verifikim, vë re një karakteristikë: atë që shokët e rretheve shkruajnë në përgjigjet që japin se «këto dhe ato janë të vërteta, por jo plotësisht, pse ka ngjarë kështu dhe ashtu» etj. Kjo, derisa letra është anonime, është një tendencë për ta lehtësuar të akuzuarin dhe evitohet kështu ballafaqimi.

Për mua, por këtë ua them edhe shokëve, një letër nga populli është një nga bisedat më të hapëta, më të vlefshme dhe më fitimprurëse, që na sqaron, na zbulon, na kritikon, na këshillon dhe ajo forcon Partinë, shtetin, denoncon armiqtë, matrapazët dhe gënjeshtarët. Prandaj, kush i nënvleftëson këto letra, ai nënvleftëson direktivën e Partisë, rolin e masave që ndërtojnë socializmin. Të nënvleftësosh direktivën e Partisë, do të thotë t'u lësh terren burokracisë, prepotencës, arrogancës, krijimit të borgjezisë së re, që dëshiron të sundojë mbi klasën dhe mbi Partinë. Të nën-

vleftësosh letrat e popullit, do të thotë të nënvleftësosh zërin e masave.

Unë do të dëshiroja të më vijnë më shumë letra, jo vetëm duke marrë shkas një ngjarje personale, një pakënaqësi e një padrejtësi që i bëhet një personi, por të më vijnë edhe letra ku, ai që më shkruan, të marrë mundimin të më thotë mendimin e tij kritik për një problem që e quan të rëndësishëm dhe të nevojshëm, të më bëjë analizën mirë ose keq të një gjendjeje o të një situate, ashtu siç e sheh ai, aq sa dhe si e mendon ai, të më thotë ç'duhet bërë sipas tij, ç'masa duhen marrë për përmirësimin e punës etj. Ç'fitim të madh do të kenë Partia dhe shteti nga këto letra!

Pyes: A kam mundësi unë të marr kontakt me gjithë këta njerëz që kanë diçka t'i thonë Partisë nëpërmjet meje? Jo, nuk kam mundësi! Por unë kam mundësi të studioj dhe i studioj të gjitha letrat e popullit dhe ato i lexoj jo për të shkruar kohën, pse kohën e kam shumë të zënë, por jam dhe do të jem shumë i lumtur që një kohë të mirë të ditës së punës sime ta zë duke biseduar me popullin, duke u konsultuar me popullin, duke mësuar nga populli nëpërmjet letrave që më dërgon.

Unë marr shumë raporte për punët dhe gjykoj mbi to, këshillohem e diskutojmë me shokët, nxjerrim konkluzione dhe marrim vendime. Por, kur lexova një letër që më dërguan pesë kooperativistë nga Gjergjevica e Korçës, të them të drejtën, mora vesh shumë më mirë për gjendjen e kooperativës së bashkuar të Gjergjevicës, Voskopojës, Krushovës dhe Shipskës, sesa nga

ato që kisha lexuar në raportet e Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës. Unë i njoh ato fshatra dhe fshatarët, se kam qenë dhe kam luftuar me ta në kohën e luftës. Unë e di që ata rrojnë tash më mirë, por akoma jo si duhet. «Hë mo, se malësi është», thuhet dhe na flitet kurdoherë për fushën e Korçës. Mirëpo malësia duhet ndihmuar më shumë. Nga halli këta malësorë venë gjetkë për të punuar si muratorë dhe atëherë zyrtarët u futin gjoba, kujtojnë se masat administrative mund t'i rregullojnë këto probleme të ekonomisë politike të socializmit. Po Komiteti i Partisë i Rrethit të Korçës ç'bën? Asgjë, ai bën sehir. Ka dy vjet me radhë që po u thonë: «Do t'jua heqim gjobat», dhe akoma nuk po ua heqin.

Por letra që më dërguan fshatarët e Gjergjevicës shtron problemin e madh: Pse largohen fshatarë nga fshati? Është e qartë, se nuk u del. Disa zyrtarë me rroga fikse thonë: «Nuk u del se nuk punojnë». Sa gabim! Po atje ku venë dhe marrin një pagë më të madhe, vallë nuk punojnë? Mos ngrohen në diell? Puna është se, që të qëndrojnë në fshat, ata duhet t'i mbajë fshati jo vetëm me parulla e me slogane, por me organizim, me ndihma, me kredi, me kujdes të veçantë nga rrethi e me masa të tjera si këto. Atëherë nuk largohet njeri nga fshati.

Dëshiroj që këto mendime t'i venë popullit në vesh. Disa, dhe këtë e kam dëgjuar, thonë: «Ne mund t'i shkruajmë shokut Enver, po letrat nuk i venë, nuk ia japin». Kjo nuk ka asnjë fije të vërtete. Të gjitha letrat unë i marr, kam shokë veçanërisht për to, që



m'i përgatitin dhe të gjitha i lexoj, mbaj shënim mbi to, jap udhëzime, dërgoj njerëz të bëjnë hetime, pse nevoja e do që shumë gjëra të verifikohen në vend, mbasi mjaft herë ka gjëra subjektive, ka ckozgjerime, ngandonjëherë del që, edhe disa njerëz që më shkruajnë, nuk thonë të vërtetën. Prandaj në bazë duhet pasur kujdes për zbatimin e udhëzimeve.

Mundet që edhe në gjykimin tim dhe në kontrollin që porosis të bëhet, të ketë nganjëherë boshllëqe, që edhe komitetet e Partisë të rretheve të mos jenë në çdo rast objektive në përgjigjet që më japin dhe të mos i zbatojnë drejt udhëzimet dhe vendimet e drejta që u rekomandohen. Ç'mund të bëhet me këto raste? Vetë i intercsuari të më rishkruajë, po objektivisht, drejt, të më informojë si iu zgjidh çështja, si iu tha dhe si nuk iu tha, ndryshe bëhet një rreth vicioz dhe problemet nuk marrin fund kurrë. Shkruesi i letrës duhet të jetë objektiv, prandaj, kur shkruan letrën, duhet të mendojë edhe ai vetë që ta lehtësojë zgjidhjen drejt të problemit qoftë personal, qoftë të karakterit të përgjithshëm.

Letrat e popullit kanë rëndësi shumë të madhe jo vetëm të studiohen e të zgjidhen drejt problemet që ngrihen në to, por të ruhen, të klasifikohen, pse ato janë një thesar i paçmuar për sociologët, ekonomistët, historianët, studiuesit e Partisë, pse andej mund të nxirren konkluzione të zhvillimit të luftës së klasave, të kontradiktave antagoniste dhe joantagoniste, andej nxirren përparimi, si dhe metodat e veprimet e dënueshme që e pengojnë këtë përparim.

Letrat e popullit tregojnë shkallën e pjesëmarrjes së tij në punët e Partisë dhe të shtetit, ato reflektojnë nivelin e zhvillimit të demokracisë popullore proletare te ne, tregojnë popullin në aksion dhe në veprim, kontaktet e ngushta, intime e të sigërtë me udhëheqësit e tij të zgjedhur. Kush e frenon një veprimtari të tillë, kush e përçmon, kush e mbyl, ai duhet dënuar rreptë. Duhet kuptuar dhe duhet thënë haptazi një e keqe e tillë. Kjo, në qoftë se vjen, vjen vetëm nga ata që drejtojnë keq. Ç'duhet bërë atëherë kundër atyre që udhëheqin keq dhe nënvleftësojnë, përçmojnë apo mbytin këtë burim force popullore, këtë erë të fortë dhe të freskët të demokracisë së popullit? Të fshihen nga vendet drejtuese dhe në vend të tyre të sillen njerëz të ndershëm, të thjeshtë, punëtorë, popullorë.

Populli ynë e ka të qartë se pushteti është i tij, se të gjitha ligjet e rregullat veprojnë dhe duhet të veprojnë në të mirën e tij. Përpara padrejtësisë që i bën ndonjëri që është në pushtet, njeriu, që te ne është në të drejtën e vet, duhet të mos e ndiejë kurrë veten të izoluar dhe të mos mendojë se është në pabarazi: nga një anë, zyrtari i veshur me pushtet dhe që e shpërdoron këtë, dhe, nga ana tjetër, ai që nuk është në pushtet, por në të drejtën e tij. Jo! Njeriu që ka të drejtë është kolos, se ai ka me vete gjithë popullin, ka Partinë, ka pushtetin e proletarëve, kurse ai që ka hyrë kontrabandë në pushtet ose ka degjeneruar, nuk është veçse një mizë, një krimb që duhet qëruar.

Të punojë Partia që të zhduket nga mentaliteti i njerëzve ideologjia borgjeze për pushtetin dhe plotfuqi-

shmërinë e atyre që janë në pushtet. Populli duhet të mësojë, të kuptojë dhe të zbatojë në praktikë teori-në marksiste-leniniste për pushtetin e proletarëve. Të mos mendohet nga asnjë se këtë e dimë, e kuptojmë dhe e zbatojmë si duhet. Të jemi realistë. Të gjithë ne jemi të zgjedhur. Po nga kush? Nga populli, në gjirin e të cilit punojmë. Pavarësisht nga nomenklatura, populli na zgjedh e na aprovon, prandaj ai duhet edhe të na pushojë, kur nuk punojmë mirë. Po a zhvillohet si duhet kjo procedurë? Jo! Pse? Se nuk e lejon burokratizmi. Duhet të ekzistojnë drejtoria dhe dega e kuadrit, që të propozojnë kuadrin, t'i bëjnë këtij edhe biografinë, por pastaj ta pranojnë atë ose jo, çështjen le ta rrahë me vaj e me uthull masa dhe jo të vendoset vetëm pse kështu do drejtori, komiteti apo ministri. Të gjitha këto udhëzime e direktiva, këtë vijë të drejtë, i ka bërë të qarta Partia. Atëherë pse nuk realizohen siç kërkohet? Se njerëzit nuk thellohen si duhet në filozofinë, në ideologjinë, në politikën dhe në format organizative të Partisë. Prandaj këto duhet t'i kuptojmë të gjithë dhe që të gjithë duhet të luftojmë fort që të zbatohen.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1974-1975», f. 188*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Për pushtetin popullor» (Përmbledhje vep-rash), f. 545*

# SHTETI YNË U NGRIT ME GJAK PËR TË QENË DHE PËR TË MBETUR PUSHTET I POPULLIT PUNONJËS

Shënime

15 prill 1975

Shoku Hysni na raportoi se kishte thirrur shokët ministra dhe u kishte folur që në aparatet shtetërore shikohet një ngathtësi nga ana e tyre në luftën kundër burokratizmit. Shokët punëtorë që kanë vajtur për ndihmë e kontroll në këto dikastere janë ankuar se «nuk kanë gjetur gatishmëri e ngrohtësi nga ana e nëpunësve» dhe kanë lënë të kuptohet sikur shfaqet njëfarë rezistence e heshtur nga ana e këtyre të fundit.

Punëtorët shohin drejt dhe e ndiejnë frymën jo të shëndoshë që ekziston në disa aparate shtetërore. Disa njerëz të këtyre aparateve janë mësuar dhe kanë krijuar një bindje të sëmurë dhe mikroborgjeze, sikur janë ata që duhet të administrojnë dhe jo të administrojë klasa punëtore. Administrimi i punëve shtetërore, i ekonomisë socialiste, mendojnë ata, është prerogativa, privilegji vetëm i specialistëve, i teknikëve, i zyrtarëve «të mësuar dhe të emëruar». Ky koncept për-

forcohet edhe me atë që shumica e këtyre janë anëtarë partie.

Këta shokë janë futur në Parti, por filozofia dhe parimet e Partisë nuk u janë futur si duhet në kokë e nuk u janë bërë gjak. Të ardhur në pushtet e në drejtim. disa deri edhe në Komitetin Qendror ose si anëtarë të Qeverisë, ka nga këta shokë që jo vetëm nuk po bëjnë përpjekje të thellohen në studimet e teorisë, të filozofisë, të ekonomisë, të organizimit, të ushtrisë, të arsimit dhe të kulturës, por kanë tendenca borgjeze dhe mikroborgjeze në të kuptuarit dhe në të zbatuarit e këtyre problemeve kapitale të shtetit, të ekonomisë socialiste, të politikës ekonomike. Tendencat dhe botëkuptimet e tyre, jo plotësisht të qarta e në rrugën marksiste-leniniste, nuk i lejojnë ata të mendojnë dhe të zbatojnë atë që, në një shtet të diktaturës së proletariatit, klasa punëtore është hegjemone dhe kjo jo vetëm të përsëritet si papagall, por hegjemonia e klasës të vendoset edhe në administrim, edhe në kontroll e kudo.

Në vetadministrimin titist ne shohim blafin e madh sikur gjoja administron klasa punëtore. Në fakt, në Jugosllavi, kjo klasë robtohet, ndërsa drejton dhe administron borgjezia e re e nëpunësve, e burokratëve etj. Edhe atje këta burokratë janë anëtarë të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe nuk mungohet të flitet «për ndërtimin e socializmit», «për rolin e klasës punëtore» etj.

Sa rrezik bëhet për ne, në rast se nuk marrim masa të rrepta të çdo lloji për të mbytur në vezë atë krimb, që mban erë të qelbur revizioniste, titiste. Edhe

në vendet revizioniste transformimet rrënjësore nga socializmi në kapitalizëm nuk u bënë në një ditë, por ato kaluan gradualisht nga një proces degjenerimi dhe korrumpimi politiko-ideologjik dhe organizativo-ekonomik i njerëzve, i Partisë, i institucioneve qeveritare, i ndërmarrjeve ekonomike. Nga hozrashotet u kalua në «vetadministrim», nga centralizmi në decentralizim, nga një aparat operativ revolucionar në një aparat të zgjeruar dhe të rëndë e burokratik, nga kontrolli i «lektut» në zhdukjen krejt të kontrollit, nga një tregti e jashtme në duart e shtetit në një tregti të jashtme në duart e çdo ndërmarrjeje, nga stimujt moralë në stimujt materialë etj.

Në të gjitha këto probleme që po këqyrim të zhvillohen në Jugosllavi, në Bashkimin Sovjetik e në vendet e tjera revizioniste, duhet të ndalemi seriozisht dhe ta shikojmë te ne çdo gjë në prizmin e teorisë sonë, të analizojmë intësisht çështjet «si janë te ne» dhe jo të themi me mendjelehtësi se «janë mirë». Duhet të shkojmë nga ajo analizë marksiste-leniniste si «duhet të jenë» mendimet e veprimet tona në periudha të caktuara të zhvillimit tonë dhe të dalim në atë vëzhgim metikuloz: si janë. janë drejt apo ka shtrembërime, ka devijime? Atëherë, pa humbur kohë dhe pa hezitar, po të ketë devijime, duhet të merren masa të korrigjohen.

Unë nuk them se këto studime, këto vëzhgime nuk duhet t'ua besojmë, në radhë të parë, njerëzve dhe shokëve të mësuar, por them jo vetëm këtyre; asnjëherë nuk i duhet besuar atij që këto probleme kapitale i

shih me syrin e ideologjisë borgjeze e mikroborgjeze. Por, mund të thuhet, si është e mundur që shokë, bile dhe shokë partie, që punojnë në vende kyç të Komisionit të Planit të Shtetit, në financat shtetërore, në bankë e në tregti, të arrijnë t'i shikojnë problemet me këtë sy të gabuar? Fare lehtë, kjo ndodh se këta njerëz, duke u bërë «specialistë», e quajnë veten «të pagabuar», ata me kohë janë bërë «papët» e drejtimit të ekonomisë, të specialitetit ushtarak, arsimor, kulturor etj. Me kalimin e kohës këta nuk i kritikon kush seriozisht për të metat në punën e tyre, pse rreth vetes kanë përgatitur njerëz që mendojnë dhe veprojnë si ata, që mbështetin shoqi-shoqin, ata bëjnë «kohën e mirë», se «të keqen», që rrjedh nga «puna e mirë» e tyre, e kanë bërë të tjerët, ata që duhet të pyeten, por që s'pyeten. Një situatë e tillë mund të zhvillohet fare mirë dhe të mbulohet me një eufori «revolucionare», me një metodë që gjoja «pyesim masën», kurse ajo s'pyetet për ato që duhet, po pyetet për gjëra të parëndësishme, që të krijohet përshtypja sikur pyetet.

Vëreni, në «studimet» që bëhen, në fakt nuk marrin pjesë punëtorë dhe kooperativistë, dhe kur këtyre u drejtohet ndonjë pyetje «si thoni ju?», kjo është formale, është vetëm një përpjekje për të krijuar iluzionin se «po merret mendimi i masës», ndërsa në fakt dominon paramendimi, koncepti i formuar me kohë.

Flitet se fshatarësia pyetet, po nuk është kështu kurdoherë. Iu hoq një copë e oborrit se kjo u gjykua nga lart si e tepërt dhe u bë me dekret. Ne lart e gjykuam të drejtë e në rrugën leniniste këtë masë, që çon

në rritjen dhe në forcimin e vazhdueshëm të pronës së grupit dhe në shndërrimin gradual të saj në pronë të përgjithshme, u nisëm edhe nga disniveli në standardin e jetesës së fshatarit në krahasim me qytetarin. Ne bëmë deklaratën që «nga toka që iu mor oborreve, prodhimet t'u jepen të gjitha kooperativistëve», dhe këtë ua çuam fshatarëve dhe u thamë: «Jeni dakord?». Ata u shprehën se ishin dakord. Po ç'ngjau pas kësaj mase? Si u zbatua ky vendim i drejtë i Partisë? S'u zbatua aspak mirë dhe më vonë as që u zbatua fare! Fshatari s'mori asgjë nga prodhimet e realizuara nga këto toka të oborreve, se të gjitha i përlau plani i shtetit, mbasi duhej të furnizohej «në rregull dhe pa ndërprerje qyteti». Po kush e bëri këtë gabim? Kush e shke-li këtë vendim? «Kushi» mos është vallë ai i vogli? Jo, në radhë të parë janë drejtues të lartë të dikastereve ekonomike. Duhej kontrolluar ky vendim se si po zbatohet në jetë. Të gjitha këto gjëra nuk flasin për mirë, këtu rrotën e drejtë të zhvillimit nuk e pengon të ecë përpara një kleçkë e vogël, por gurë që duhen spastruar seriozisht.

Shteti ynë, që u ngrit nga një luftë e përgjakshme, nuk u krijua që të shndërrohet në një aparat burokratik borgjez; ai lindi mbi gërmadhat e shtetit të vjetër, që u shemb me luftë dhe me gjak, për të qenë dhe për të mbetur pushteti i popullit punonjës, për të qenë një armë e proletariatit në luftën e tij të klasës, për të qenë, siç thotë Lenini, një «dajak» i veçantë dhe i ashpër për të gjithë ata që do të duan ta dobësojnë, ta deformojnë dhe ta shkatërrojnë.



Të kemi kurdoherë parasysh se ne jemi në periudhën e kalimit nga kapitalizmi në komunizëm. Kjo do të thotë se gjatë kësaj periudhe kapitalizmi dhe socializmi janë në luftë të papajtueshme. Kjo luftë vazhdon gjatë gjithë kohës së tranzicionit që nuk dihet sa vazhdon, por që do të vazhdojë akoma gjatë. Askush nuk duhet të mendojë se kjo luftë është fituar përgjithmonë te ne. Jo! Dhe, siç thashë, ajo që te ne quhet lufta e klasave, vazhdon dhe do të vazhdojë.

Dihet se me luftën që bëri populli dhe që e udhëhoqi Partia jonë, klasa punëtore mori fuqinë. Kapitalistët, bejlerët, agallarët, me një fjalë kapitalizmi e humbi fuqinë, por të mos harrojmë për asnjë çast se derisa socializmi me kapitalizmin vazhdojnë të jenë në luftë, kapitalizmi, megjithëse i mundur, përpiqet ta rimarrë fuqinë. Në këtë periudhë tranzicioni, edhe pse klasa punëtore e ka shtënë fuqinë në dorë dhe kapitalizmi e ka humbur, zhvillohen beteja të cilat duhet të fitohen nga klasa punëtore. Por beteja fitohet jo duke bërë gjumë, por duke qenë vazhdimisht vigjilentë, duke luftuar hap pas hapi.

Në Bashkimin Sovjetik, në Jugosllavi edhe në vendet e tjera revizioniste kapitalizmi ia rrëmbeu përsëri nga duart pushtetin socializmit. Pse? Se u shua lufta e klasave dhe në vend të saj u vendos paqja në mes socializmit dhe kapitalizmit. Renegatët titistë dhe hrushovianë ishin ata që, në këtë periudhë tranzicioni, donin të vendosej «paqja» e brendshme dhe e jashtme. Këta donin, luftuan dhe ia arritën qëllimit që të pushohej lufta e klasave, donin që «të puthen kundër-

shtarët ndërluftues». Këta renegatë janë agjentë të kapitalizmit. Të tillë janë kudo mikroborgjezët, oportunistët, revizionistët, arrivistët, indiferentët, pavarësisht nëse e kanë apo jo emrin Tito, Hrushov, Gomulka, Liu Shao Çi, Sejfulla Malëshova, Koçi Xoxe, Beqir Balluku e plehra të tjera si këta.

Agjenti i imperializmit, Hrushovi, kritikon Stalinin se kishte bërë gabim kur thoshte që reaksioni kapitalist egërsohet, sa më shumë i afrohet vdekja. Stalini nuk ka gabuar as edhe një grimë për atë që ka thënë, të cilën po e vërtetojnë kohët. Por Hrushovi luftonte kundër Stalinit për të fshehur antileninizmin e tij të tërbuar. Ky renegat bërtiste gjoja për leninizmin pikërisht për ta luftuar leninizmin.

Mësimet e Leninit duhet të na udhëheqin ne kurdoherë në rrugën tonë dhe të mos harrojmë se gjatë gjithë periudhës së diktaturës së proletariatit vazhdon lufta e klasave. Pas ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit klasat shfrytëzuese vërtet janë mundur dhe janë zhdukur si klasë, por vazhdojnë të ekzistojnë mbeturinat e tyre. Lenini na mëson se pas përmbyesjes atyre u mbetet baza ndërkombëtare, u mbeten të holla dhe lidhjet shoqërore.

*«Energjia e rezistencës së tyre është rritur, pikërisht si pasojë e disfatës së tyre...»<sup>1</sup>.*

Mbi këtë bazë ekziston edhe mundësia e lindjes së një klase të re borgjeze. Këtë e provojnë Jugoslla-

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 30, f. 113.

via, Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera revizioniste. në të cilat kapitalizmi brenda vendit ngriti krye dhe baza kapitaliste ndërkombëtare i erdhi përnjëherë në ndihmë me armë, me kredi, me ideologji, me politikë, me diplomaci, që ta merrte përfundimisht dhe plotësisht fuqinë, siç e mori.

Këto mësimë të mëdha nuk duhet t'i harrojnë kurrë Partia jonë dhe klasa punëtore. Armiku i klasës shfaqet, lufton e hedh helm në shumë mënyra, në shumë fusha. Rrallë ai shfaqet hapur, por veprimtaria e tij armiqësore, në qoftë se nuk zbulohet dhe nuk goditet me kohë për vdekje, rritet e bëhet e rrezikshme, dhe atëherë kur armiku e ndien veten më të fortë, godet haptazi. Prandaj Partia dhe klasa duhet të jenë sidomos vigjilente ndaj armiqve të çdo ngjyre dhe të çdo kalibri, që, me formula gjoja partie, gjoja leniniste, gjoja parimore, fshehin luftën që bëjnë në favor të restaurimit të kapitalizmit. Në punën e këtyre armiqve Partia dhe klasa nuk duhet të shohin vetëm lustrën e jashtme, fjalët bombastike dhe rrahjen me grushte të gjoksit, por të shikojnë dhe të gjykojnë me vigjilencë edhe veprimet e mëdha të tyre, edhe veprimet e vogla, pse veprimet sabotuese të mëdha mbështillen shumë herë me një iluzion euforik të rremë, që u del boja në veprimet e vogla të tyre. Këto «veprime të vogla», të dënueshme, krijojnë turbullira, pakënaqësi, mirëpo faji për këto u ngarkohet të vegjëlve. Këto mijëra «veprime të vogla» të dënueshme janë pjesë përbërëse e së madhes, e cila një mëngjes pëlçet në qiellin e kaltër në rast se Partinë dhe klasën i ka zënë gjumi. Kështu

ngjau në Jugosllavi, në Bashkimin Sovjetik e gjetkë, por nuk duhet të ngjasë kurrë te ne, nuk duhet ta lejojmë në asnjë mënyrë që të ngjasë. Prandaj klasa dhe Partia të jenë kurdoherë në këmbë, vigjilente, në luftë.

Paragjykimet ose mbeturinat e vjetra në lidhje me shtetin, në lidhje me njerëzit në pushtet dhe me kompetencat e tyre, duhet të fshihen me fshesën e ideologjisë proletare. Në kokën e njerëzve të Shqipërisë së re socialiste duhet të rrënjosen idetë e reja të socializmit, të rrënjosen çështja se diktatura e proletariatit është shkatërrimi i diktaturës së borgjezisë, se diktatura e proletariatit është diktatura e demokracisë proletare dhe shkatërrimi i diktaturës së demokracisë borgjeze.

Të mos kemi iluzione se te ne janë zhdukur shfaqjet e demokracisë borgjeze dhe ndikimi i tyre në shoqëri. Jo! Do të bëhej gabim po të mendohet kjo, se atëherë kemi rënë në një gjumë të rëndë dhe ky sjell atë «paqen borgjeze», atë «shuarje të kritikës proletare», atë «moszhvillim të luftës së klasave» për të cilat fola më lart. «Të mos e kritikoj. që të mos më kritikojë», «Të mos e kritikoj, se i mbetet qejfi, se e kam kushëri, se është në ofiq më të lartë», «Ç'më duhet mua të përzihem» e të tjera shfaqje të tilla spikatin kudo dhe nuk janë veçse shfaqje të botëkuptimeve jorevolucionare. Këto, po të lihen, po të mos shpjegohen, po të mos luftohen, bëhen një lëmsh i tmerrshëm dhe përgatitin terrenin për katastrofa.

Prandaj nuk na lejohet të lëmë që të zhvillohen të tilla tipare e botëkuptime të një klase shfrytëzuesish të përmbysur e të mundur si klasë, por jo të zhdu-

kur plotësisht, sidomos si ideologji. Të mos harrojmë se në socializëm ekzistojnë akoma klasa, po, nga ana tjetër, socializëm do të thotë të shkosh drejt zhdukjes së plotë të klasave. Kjo do të thotë, siç na mëson Lenini, të zhduket ndryshimi në mes punëtorit dhe fshatarit, si dhe midis njerëzve të punës mendore dhe fizike. Dihet se kjo nuk mund të bëhet menjëherë dhe diktatura do të bëhet e panevojshme vetëm kur të zhduken klasat dhe deri atëherë ajo duhet të veprojë kundër armiqve.

Pra, në luftën për zhdukjen e klasave, që do të thotë për ndërtimin me sukses të socializmit, Partisë i bie detyrë e madhe për edukimin e njerëzve të saj të klasës dhe të të gjithë popullit me botëkuptimin filozofik marksist-leninist, me moralin e klasës së proletarëve, me vendosmërinë, guximin dhe pastërtinë e klasës dhe të ideologjisë së saj. Ky edukim duhet të jetë teorik dhe praktik njëkohësisht. Mendimi dhe veprimi të dy të jenë në harmoni të plotë, në rrugë revolucionare, në unitet të pathyeshëm për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e tij. Diktatura e proletariatit të kuptohet çështje, përse shërben dhe të përdoret pa mëshirë kundër armiqve.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1974-1975», f. 197*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Për pushtetin popullor», (Përmbledhje veprash), f. 551*

## OBORRET NUK PRODHOJNË PËR TREG, POR PËR FAMILJET E KOOPERATIVISTËVE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

24 prill 1975

E dimë pse e kemi krijuar oborrin kooperativist dhe pse janë krijuar diferencime në madhësinë e tij dhe në numrin e bagëtive. Unë nuk shoh asnjë arsye serioze që të na shtyjë të bëjmë ndryshime, sepse oborri kooperativist ruan edhe karakterin, edhe arsyen për të cilat është lënë. Ai nuk e ka plotësisht karakterin e pronës personale, pse ligjet e shtetit tonë socialist e ndalojnë kooperativistin ta shesë apo ta blejë tokën etj. Kjo i është dhënë atij për përdorim vetjak, që ta shfrytëzojë për një kohë.

Oborri nuk ka për qëllim që të prodhojë për treg, por prodhon për të ndihmuar ekonomikisht familjen kooperativiste. Ky oborr shkon duke u pjesëtuar në ku-

---

1. Në këtë mbledhje u shqyrtua një studim për disa probleme të oborrit kooperativist.

rora dhe nuk jepet sipërfaqe toke tjetër, për asnjë kategori njerëzish që punojnë në fshat.

Vija e Partisë është: prodhimi kryesor sigurohet në kooperativë, prandaj këtu duhet të përqendrohen të gjitha forcat. Oborri ka qenë dhe mbetet provizor; ai duhet të shkojë duke u venitur dhe jo «duke u rinuar», por zhdukja e tij nuk mund të bëhet me dekrete.

Bagëtitë e oborreve janë, gjithashtu, të diferencuara dhe kemi pasur arsye që i kemi lënë. As këto arsye nuk mund t'i zhdukim me dekrete ose pse u bashkuan kooperativat. Raportet socialekonomike në prodhim duhen mbajtur parasysh, prandaj të mos e vlerësojmë oborrin jashtë këtyre raporteve, si nga ana sociale, në lidhje me pronën kooperativiste dhe me shoqërizimin, ashtu edhe nga ana ekonomike, në krahasim me prodhimin e madh.

Kur flasim për oborrin, duhet të kuptojmë të dyja degët e tij: atë të prodhimit bujqësor dhe atë të prodhimit blegtoral. Të dyja këto degë i vijnë në ndihmë ekonomisë kooperativiste. Në rast se ua heq familjeve kooperativiste prodhimet e oborrit dhe nuk ua zëvendëson nga prodhimi i madh i kooperativës, atëherë do të krijohen vështirësi në furnizimin e kooperativistëve. Pra, çështja nuk shtrohet që të marrim masa administrative në këto drejtime, gjoja të bazuara në disa statistika të njëanshme dhe fragmentare, por të shtojmë prodhimin e madh socialist në kooperativa; të rritet vlera e ditës së punës të kooperativistit, domethënë fuqia blerëse, që edhe ai, përveç të tjerave, të blejë po aq prodhime bujqësore sa edhe qytetari. Këtë rrugë Partia e ka cak-

tuar prej kohësh, por organet shtetërore nuk po e zbatojnë si duhet dhe për këtë ngarkohen me fajë të rënda.

Është fakt se ka rritje në prodhimin e ekonomive të mëdha, por, krahas kësaj, ka edhe eufori. Ndodh që planet nuk realizohen; ka deficite të shumta në shpërndarjen e prodhimeve, veçanërisht në fshat. Akoma nuk kemi arritur që prodhimi i madh i zgjeruar bujqësor të dominojë si duhet mbi atë kooperativist. Në rast se qëndrojmë në këtë stad ose ecim ngadalë, kjo nuk është në të mirë të shtimit të prodhimit, të rritjes së mirëqenies, të politikës ekonomike të socializmit, e cila duhet kuptuar dhe duhet zbatuar drejt.

Ne, në ekonomitë tona bujqësore (shtetërore dhe kooperativiste) duhet të kujdesemi më shumë si për të shtuar numrin e krerëve të gjësë së gjallë, edhe për të rritur rendimentin për krerë me qëllim që të kemi më tepër prodhime në mish, në qumësht dhe në lesh. Mendoj që edhe oborret të ruajnë numrin e krerëve sipas Statutit të Kooperativave Bujqësore dhe të kujdesen, gjithashtu, për të rritur rendimentin në mish e në qumësht, që të plotësojnë sa më mirë nevojat e kooperativistëve. E them këtë se në oborrin kooperativist ka raste që ruhen akoma mentaliteti dhe praktika e vjetër e fshatarit mikroborgjez për të pasur sa më shumë bagëti, jashtë rregullave të statutit.

Fshatarin ne duhet ta bindim më mirë me argumente, që të punojë më tepër në kooperativë, se këtu ai siguron më shumë të ardhura. Por vetëm me fjalë fshatari nuk bindet, prandaj të bëjmë ç'është e mundur që ai t'ia shohë sa më shumë hairin prodhimit të madh.



Ne nuk mund të pajtohemi me ato gjykime, sipas të cilave në malësi janë ndryshuar raportet ekonomike në krahasim me ato të kooperativave kodrinore e fushore, për arsye se familjet në malësi kanë më tepër të ardhura, mbasi ndonjë pjesëtar i tyre punon në minierë apo në ndonjë ndërmarrje tjetër shtetërore, dhe prej këtej të dalim me konkluzionin se këtyre familjeve duhet t'ua shkurtojmë numrin e bagëtive të oborreve! Mirë, fuqia blerëse e këtyre familjeve në malësi është shtuar, po ku do t'i blejnë ato mishin, qumështin, vezët etj.? Ua kemi krijuar ne një treg të tillë? Jo! Atëherë, të ushqehen me kartmonedha? Jo! Këto çështje nuk mund të gjykohen kështu. Ky është një objekt i madh i politikës ekonomike të socializmit.

Të ardhurat nga ndërmarrjet bujqësore dhe nga kooperativat duhet të shtohen me prodhime masive. Ne duhet t'i kushtojmë rëndësi ndarjes së mirë e të drejtë të prodhimeve, duke luftuar matrapazët, burokratët, llafazanët e mburravecët.

Në rast se shtohet prodhimi (dhe ky duhet të jetë objektivi kryesor), do të ulen edhe çmimet. Fshatari do të krijojë kështu fonde rezervë si edhe qytetari; do të krijojë edhe ai një fuqi blerëse të arsyeshme nga dita e punës; do të ketë ç'të blejë dhe me se të blejë. Atëherë oborri do të venitet për të; ai vetë do të shohë dhe do të bindet se në atë copë oborr harxhon shumë punë, e cila, e përdorur në prodhimin e zgjeruar socialist, i sjell më shumë të ardhura. Në këtë rrugë duhet të ecim. Por përpjekjet tona në këtë drejtim nuk shkojnë me ritmin e duhur.

Pa i krijuar këto kushte, sipas mendimit tim, nuk mund të bëhet fjalë as për shkurtimin ose zhdukjen e oborreve dhe të komponentëve të tyre, as për shpërndarjen e tokave për oborre për ata që nuk kanë. As përpara dhe as tash nuk duhet orientuar që oborret të prodhojnë për treg, por vetëm për nevojat e familjes së kooperativistit. Por, nga ana tjetër, të mos harrojmë se edhe gjithë jetën oborri nuk do të mbahet. ai vjen duke u venituar e do të shuhet. Kjo, siç thashë në fillim, nuk do të bëhet me dekrete ose me masa administrative, gjoja me dëshirën e asamblesë. Vetëm të dhënat konkrete ekonomike, që vërtetojnë pjekjen e një situatë të tillë, dhe kushtet e rrethanat politiko-ekonomike të të gjithë vendit mund të na shtyjnë dhe të na bindin të marrim atë masë.

Edhe çështja e blerjes së bagëtive të oborreve nga kooperativat duhet të ecë në rrugë të drejtë ekonomike. T'i mësojmë kooperativat që të ecin në rrugën që kërkohet në lidhje me kafshët e oborrit. Krahas kësaj duhet të punojmë që ekonomia e zgjeruar socialiste të ecë akoma më mirë.

Në përfundim desha të nënvizoj edhe një herë disa çështje të veçanta që ngrihen në diskutime.

1. Të orientohen kooperativistët se çfarë duhet të mbjellin në oborret, pse vihet re që mbjellin më shumë perime për t'i shitur në treg. Këtu nuk bëhet fjalë për një tufë majdanos apo një dorë qepë të njoma. Ju vetë<sup>1</sup>

---

1. U drejtohet disa kadrove të Ministrisë së Bujqësisë e të komiteteve të Partisë të rretheve Lushnjë e Korçë, të ftuar në këtë mbledhje.

bini në kundërshtim me përqindjen e bimëve që mbillen në oborr. S'janë serioze këto arsyetime!

2. Normat e oborreve në një kooperativë të bashkuar as duhen ngritur, as duhen ulur dhe as duhen barazuar. Dëshira është që të barazohen, por këtë nuk mund ta bëjmë se duan kooperativat e fushës. Duhet krijuar kushtet për shkurtimin e oborreve të malësisë. Detyra jonë është që t'i bindim kooperativistët në rrugën që thashë më parë.

3. Ashtu siç u shpreha edhe më lart, pjesëtarëve të familjes që shkëputen nga trangu nuk mund t'u jepet oborr i ri, veç tokës që u takon të marrin nga ndarja e sipërfaqes së oborrit të trungut. Pra, tokë tjetër s'duhet t'u jepet nga fondi i kooperativës.

4. Sasia e drithit, e fasuleve, e bulmetit etj., që do të shpërndahet për konsum të brendshëm të kooperativës, duhet të varet nga prodhimi. Po kjo procedurë, me një diferencë të vogël që përfaqëson oborri, duhet të ndiqet edhe për qytetin. Por oborri të mos merret si pretekst që t'u shkurtohen kontingjentet fshatarëve, pse kjo do të thotë: qyteti të hajë, të furnizohet me prodhime bujqësore e blegtorale, kurse fshati që prodhon, jo. Një praktikë e tillë, me gjithë vendimet e marra, do të ishte e gabuar.

5. U duhet bërë e njohur mirë kooperativistëve që ata të ndiejnë e të binden se prej realizimit të planit nga ana e tyre varet edhe furnizimi. Kjo është një këshillë me vend dhe, që të bëjë efekt, duhet thënë si e tillë dhe jo në formë urdhri.

Po për punonjësit e qytetit, punëtorë e nëpunës,

kur nuk realizojnë planet, kur nuk plotësojnë detyrat ndaj fshatit etj., kemi ndonjë këshillë për t'u dhënë në lidhje me furnizimet me prodhime bujqësore e blegtorale? Apo këta të qytetit duhet të furnizohen në rregull edhe kur nuk realizojnë detyrat?! Mosrealizime ka dhe do të ketë nga të dyja palët; në bujqësi ca më shumë, për arsye të kushteve që dimë; por mendimi im është që të mos bëhen dallime: shpërndarja të varet nga prodhimi dhe proporcionet në shpërndarje fshat-qytet duhet të jenë të drejta. Asnjë masë kufizuese, sipas mendimit tim, nuk duhet të merret ndaj kooperativistëve.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verball i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

# NË USHTRI DUHET TË EKZISTOJË MË TEPËR SE KUDO GJETKË NJË DISIPLINË E HEKURT

Udhëzime<sup>1</sup>

15 maj 1975

Në ushtri duhet të ekzistojë më tepër se kudo gjetkë një disiplinë e hekurt, e cila të kuptohet nga të gjithë dhe për çdo punë.

Kërkesa e llogarisë për zbatimin drejt dhe në mënyrë krijuese të rregulloreve, të vendimeve, të ligjeve dhe të urdhrave kërkon nga të gjithë zbatim me një disiplinë të hekurt. Kërkesa e llogarisë nën një disiplinë të hekurt nuk duhet konfunduar aspak me arrogancën, me prepotencën mikroborgjeze dhe antiproletare. Ai që bën lëshime në kërkesën e llogarisë për të mos u quajtur «prepotent dhe arrogant», bie në një gabim të rëndë, ai nuk e kryen detyrën, tregohet liberal, oportunist, mikroborgjez dhe përgatit situata të vështira për ushtrinë.

---

1. Këto udhëzime, pasi u dhanë në një mbledhje të kuadrove kryesore të forcave të armatosura, u botuan në një broshurë dhe u dërguan në ushtri për përdorim të brendshëm.

Kuadri dhe ushtari i Ushtrisë sonë Popullore duhet të tregohen trima në gjykim dhe në veprim. Armiqtë që zbuluam në radhët e ushtrisë ishin arrogantë dhe prepotentë, por, nën këtë trajtë karakteri, ata fshihnin liberalizmin, disfatizmin, moszbatimin e vendimeve të programeve dhe ecnin duke i ndryshuar krejt orientimet e Partisë për ushtrinë. Disa oficerë dhe ushtarë, përpara kësaj arrogance, u treguan të frikshëm për të kritikuar dhe liberalë, prandaj gabuan.

A mund të mendoni ç'mund t'i ngjasë ushtrisë në rast se kuadrot, nga druajtja se mos quhen arrogantë dhe prepotentë, nuk tregohen të guximshëm në kërkimin e llogarisë? Në këtë rast tendencat liberale do të vazhdojnë edhe në masën e ushtarëve dhe çdo urdhër e vendim, çdo direktivë, më parë do të fillojë të diskutohet e të diskutohet pa fund dhe pastaj do të zbatohet kur e ka marrë ferra uratën.

Cilido, kuadër dhe ushtar, duhet ta ketë të qartë se është ushtar, të mendojë drejt e me reflekse të shpejta dhe të kalojë përnjëherë në zbatim të detyrës. Të gjithë duhet të edukohen të kryejnë detyrën që u takon si individ dhe si njësi. Ndryshe nuk mund të ecet.

Kërkesa e llogarisë është marksiste; kritika e drejtë e bazuar është marksiste; autokritika e shëndoshë është, gjithashtu, marksiste, por, të harrosh të kryesh detyrën, të kthehesh në një kritizër të sëmurë, ta marrësh dhe ta konsiderosh kritikën si denigrim dhe të humbasësh çdo besim në ndreqjen e një shoku që gabon, kjo nuk është marksiste. Nuk është marksiste as kur

ndonjë gjykon se të tilla veprime dhe sjellje nuk janë marksiste dhe hesht, pse ka frikë mos akuzohet se mbron fajtorin. Në të tilla raste shokët duhet të kuptojnë se duke heshtur përpara padrejtësisë, nuk mbrojnë fajtorin, por mbrojnë shtrembërimet që u bëhen normave të Partisë nga priirjet subjektiviste dhe pikërisht «arrogante» të disave.

Njerëzit nuk duhet të bien as nën influencën e fajtorëve të parë, por as edhe nën atë të fajtorëve të dytë. Ata duhet të qëndrojnë fort në pozita partie në gjykimin e problemit, të individit, të fajit dhe të dënimit që jepet. Kjo ka mundësi të bëhet dhe duhet të bëhet, sepse edukata ideopolitike e Partisë po jepet, sepse shoqëria dhe ndërtimi i socializmit i edukojnë njerëzit, sepse ngritja teknike dhe lidhja e ngushtë me punën, me njerëzit, me detyrat ta forcojnë logjikën e shëndoshë të gjykimit. Vetëm po të mos duash të ndjekësh një rrugë të tillë të drejtë e të natyrshme si jona, do të mendosh e do të veprosh shtrembër dhe gabim.

Unë këto kohët e fundit nuk kam vizituar ndonjë repart ushtarak, por më kanë informuar shokët. Punët kanë hyrë në rrugën e ndreqjes, megjithatë të mos harrojmë se përpara kemi shumë për të bërë. Ç'duhet të kuptojmë me këtë që them? Të kemi në gatishmëri të plotë ushtrinë, sepse nuk mund të mendohet asnjëherë «kemi kohë». Jo! Koha për të qenë në gatishmëri nuk pret. Ka gati një vit që u zbulua puna armiqësore në ushtri. Një vit kemi që po shkruajmë, po mbajmë fjalime, po bëjmë mbledhje. Mua më duket se të gjitha

këto nuk janë të pamjaftueshme për të sqaruar gjendjen. Nuk dua të them me këtë se paskëtaj nuk duhen bërë mbledhje e nuk duhen dhënë sqarime, por të qëndrosh tërë kohën nëpër mbledhje e në diskutime dhe këto të mos të të shërbejnë ose të të shërbejnë pak për të kryer konkretisht punën që të është ngarkuar, kjo duket sikur sjell të mira, po nuk sjell shumë fryte.

Mendoj se shokët e disa njësive ushtarake kanë një detyrë të madhe, se ndryshe nuk i kishim krijuar këta organizma. Njësia dhe shokët që e drejtojnë atë, dhe me këtë kuptoj komandën, duhet të drejtojnë repartet, duhet të mësojnë t'i drejtojnë mirë tash në kohë paqëje, që të mundin t'i drejtojnë mirë edhe në kohë lufte. Në qoftë se nuk stërviten të drejtojnë mirë që tash, në kohë lufte do të na shkaktohen humbje. Me drejtimin unë kuptoj që ata të jenë gjithë kohën nëpër reparte, të ndihmojnë, të mbikëqyrin, të kontrollojnë si punojnë shokët në bazë, si bëhet stërvitja, ç'nevoja kanë repartet, të japin shpjegime konkrete në punë. Ata që drejtojnë njësinë duhet të njohin njerëzit, vendin, frymën, moralin e reparteve dhe të popullit. Mirëpo këtë detyrë nuk e bëjnë kurdoherë si duhet.

Më kanë thënë se shokët e disa njësive edhe detyra të tjera përgatitore për veten dhe për repartet që komandojnë nuk po i kryejnë. Pyeta se ç'po bëjnë njësitë për Tezat e Këshillit të Mbrojtjes: Po i punojnë, po i zbërthejnë etj.? Më janë përgjigjur se akoma s'po bëhet gjë. Po kush do t'ua bëjë? Nga cili presin t'ua bëjë? Apo presin nga ai kuadër oficer me titull të madh «profesor i akademisë» që, siç më raportuan, kishte



bërë një zbërthim të «taktikës partizane në kohën e luftës», zbërthim që ishte për të qarë, për ta hedhur në shportë. Ai kishte kopjuar andej, kishte kopjuar këtej, i kishte lidhur keq çështjet e asgjë nuk kishte futur nga koka e tij dhe ne kënaqemi se kemi një «profesor» që na mëson kuadrot. Kësaj i thonë të bësh një punë angari, të mos vrasësh mendjen, të mos djersish. Vajtjen në reparte unë e quaj të domosdoshme, por jo të bëhet një vajtje shkel e shko sa për të parë ç'të të dalë përpara, vajtja ka vlerë atëherë kur shkon i përgatitur.

Duhet jo vetëm eprorët të kontrollojnë vartësit, por edhe këta të kontrollojnë eprorët; jo vetëm eprorët të kritikojnë vartësit, por edhe këta të kritikojnë ata më lart. Prandaj vartësit, kur nuk kënaqen nga shpjegimet, nga instruktimet e pamjaftueshme të eprorëve, të mos mbyllin gojën, po t'ua thonë mendimin hapur, ndryshe krijohet amulli, sepse kontrolli i zbatimit të vendimeve është i njëanshëm dhe, kur është i njëanshëm, ka me vete vetëkënaqësinë, frymën e prepotencës, të hierarkisë së sëmurë e të shumë të këqijave që kemi kritikuar e që kultivonin armiqtë e Partisë dhe të ushtrisë që demaskuam...

Kontrollin në ushtri do ta vendosim të shumanshëm: qeveritar (Ministria e Mbrojtjes), partie (aparartet e Partisë në ushtri dhe në terren), kontroll punëtor (ushtarë aktivë dhe rezervistë), drejtpërdrejt nga Ministria e Mbrojtjes, nga komitetet e Partisë të reparteve, nga komitetet e Partisë të rretheve e drejtpërdrejt edhe nga Komiteti Qendror i Partisë.

Kuadrot kanë shumë nevojë të kontrollohen. Kjo s'ido të thotë se «nuk kihet besim tek ata», por do të thotë se e do interesi që çdo njeri të kontrollohet si punon, mirë apo keq, dhe të edukohet kështu të kryejë si duhet detyrën. Klasa punëtore dhe Partia dëshirojnë që kudo të punohet mirë, që çdo gjë të ecë në rregull dhe njerëzit të bëjnë detyrën me ndërgjegje të plotë.

Kuadrot dhe ushtria duhet të jenë të bindur se ne kemi në duar armë të mira dhe në sasi, kemi mjete transportuese dhe mekanizma të bollshëm. Të gjitha këto duhet t'i mbajmë dhe t'i përdorim mirë.

Këto që po ju them, i futni mirë në kokë, se jemi në rrethim e do të luftojmë në rrethim, prandaj nuk na lejohet që armët dhe teknikën luftarake të mos i mbajmë mirë. Në kohën e luftës vriteshim për një pushkë, dhe për të blerë dy mitralozë të vjetër, Komiteti Qendror i Partisë ishte i detyruar t'u dërgonte shokëve njëqind napolona flori nga ndihmat që i mblidhte lekë-lekë nga populli. Disa nga ju këto nuk i dinë ose i dinë si përralla. Tash ushtria jonë është e pajisur mirë me armë dhe me mjete luftarake, por mos mendoni, shokë, se këto rrjedhin si uji nga një çezmë e pashteruar. Kujdes, shokë, edhe për armët, edhe për mekanizmat etj., se përgatitemi për të mbrojtur atdheun, përgatitemi për luftë eventuale dhe jo për dasmë. Kam formuar mendimin se nuk bëhet kujdes si duhet për armët dhe nuk ka përdorim të mirë të mjeteve e të makinerive që kemi në ushtri.

Unë mendoj se edhe llogaritë për makinat e trak-

torët që i duhen ushtrisë janë bërë me kritere joreale. Mendohet që në kohë lufte të përdoren me mijëra e mijëra makina e traktorë, jo vetëm ata që ka sot ushtria, por është planifikuar që, për kohë lufte, të merren dhe nga ekonomia popullore mijëra e mijëra të tjerë. Unë ju rekomandoj që të gjitha këto të llogariten më me mend.

Llogaritë për transportin nuk duhet të mbështeten në një llogari automatike: të ketë kaq nënreparti, kaq reparti dhe kaq njësia. Jo! Duhet të llogaritet konkretisht çfarë do të transportojnë dhe nga ku e deri ku do t'i transportojnë. Kjo «nga ku e deri ku» dhe «sa» ka rëndësi të madhe jo vetëm për ekonomizimin e mjeteve, por sidomos për reduktimin e largësive dhe për edukimin taktik e strategjik të njerëzve. . .

Në parantezë, unë mendoj që transportin e ushqimit të ushtrisë në kohë lufte ta llogaritni mirë, mbi baza reale e jo ta neglizhoni. E llogaritni këtë si duhet dhe kurrë të mos mendohet si Beqir Balluku se ushtari mund të luftojë «me supë dhe me bukë të reduktuara në tuba si pasta dhëmbësh». Të tilla gjëra ai i lexonte në revistat amerikane. Por mos kini iluzione të gabuara!

Flitet për riparimet kapitale, të mesme, të mjeteve e të makinave. Specialist nuk jam, por më duket se riparimet kapitale bëhen të shpeshta dhe në një periudhë kohe relativisht të ngushtë, të shkurtër për një shfrytëzim të tillë te ju, që duhet të konsiderohet nën normalen dhe, megjithëkëtë, prapë ky shfrytëzim në kohë paqeje duhet të jetë më i vogël te ju, në rast se do të ekzistonte një kontroll i fortë. Edhe për ripa-

rimet e armëve duhet të krijohet një edukatë e tërë, që armët të mbahen mirë, të prishen më pak dhe të riparohen me më pak mjete. Unë po ju them hapur: nuk u besoj shumë llogarive që bëhen në ushtri për këtë problem dhe nuk duhet të presim, por riparimet e armëve të bëhen shpejt e me këto uzina që kemi. Çdo armë duhet të jetë e gatshme për përdorim në çdo kohë. Kështu duhet të mendojë ushtria, sidomos për mjetet e luftimit.

Flitet se Beqir Balluku dhe Petrit Dumja për këto gjëra nuk kishin vënë detyra konkrete. Atëherë pyes: Përse janë harxhuar këto resurse? A është ashtu se këta sektorë nuk kishin asnjë detyrë, siç thoni ju? Jo, nuk qëndrojnë arsyet që jepen. Ç'lidhje ka, për shembull, vjetërsia e grykës së zjarrit me lënien pas dore të automjeteve dhe të agregateve?!

Për shfrytëzimin e automjeteve dhe të agregateve ju thoni se do të ndreqni shpërndarjen. Edhe unë ju këshilloj që të ndreqet patjetër, por me rigorozitet, me llogari teknike dhe joburokratike. Në këtë punë duhet t'ju udhëheqë ndjenja e shfrytëzimit total dhe ajo e ekonomizimit të tepricës e jo t'ia heqësh njërës që s'i duhet dhe t'ia japësh tjetrës, që edhe kësaj s'i duhet, dhe të notojë në to.

Të vihen në rezervë sa më shumë mjete dhe puna të bëhet sa më mirë. Të vihen në rezervë automjete dhe agregate, karburante e vegla ndërrimi, të bëhen reduktive punëtorësh nëpër uzina, duke ngritur normat dhe rendimentet. Këto rezerva duhet t'i krijojmë vetë për kohën e keqe.

Lidhur me mjetet që disponohen në ushtri dhe që do të jepen edhe paskëtaj, duhet që çdo gjë të planifikohet si në sektorin civil, bile edhe ca më mirë, ca më shtrënguar. Ushtarakët të mësohen të përdorin çdo gjë me ekonomi, pse janë mësuar me mendimin liberal-oportunist «Për ushtrinë s'ka kufi, asaj duhet t'i jepet çdo gjë, dhe çdo gjë që merr, ta harxhojë pa ekonomi». Marksizmi na mëson se Partia dhe klasa punëtore duhet të tregohen të ashpra kundër oportunitizmit dhe liberalizmit, pse këto sëmundje në një vend të diktaturës së proletariatit, në mënyrë të hapur ose të fshehur, nën maskën e marksizmit, janë deformimet më të fëlliqura që i bëhen marksizëm-leninizmit.

Na raportohet se vetëm në fund të vitit 1976 do të përfundojë elektrifikimi i nënrepartëve të artilerisë kundërajrore, gjë që puçistët e kishin sabotuar. Ju jeni të kënaqur me këto data, por unë them: Përse kaq vonë? Çështje të tilla ushtarake nuk presin. Ne, në një kohë rekord, elektrifikuam gjithë vendin dhe ç'vështirësi kishte! Prandaj ju rekomandoj luftë revolucionare drejtpërdrejt në çdo gjë dhe për çdo gjë!

Shumicën më të madhe të pjesëve të ndërrimit t'i bëjmë në vend, duke u mbështetur në forcat tona. Ju merrni angazhim për këtë, mirëpo angazhimi duhet të realizohet. Çdo uzinë dhe çdo makinë duhet të punojë me tri turne, me sistem pune rigoroz dhe me disiplinë të hekurt. Në këto uzina të punojnë civilë të zgjedhur politikisht, pse ushtari ka shërbime të tjera. Çdo uzinë, çdo punëtor, çdo vegël etj. të ketë normativa dhe jo çdo lloj norme, por teknike. Domethënë të gjitha ofi-

çinat që dispononi të ngarkohen plotësisht dhe si duhet, nga ato të mos krijohen stoqe të panevojshme e të shumta, që rrjedhin nga mungesa e ndërgjegjes së drejtuesve, të planifikuesve, nga mungesa e kontrollit dhe nga qëndrimet e atyre liberalëve që e konsiderojnë çelikut sikur e gjejnë në rrugë duke ecur.

Për sa i përket gatishmërisë së ndërlidhjes së tankeve nuk jam dakord me frazat që thuhet se «do t'i arrihet gatishmërisë», por duhet të merrni masa të rrepta e rigorozë që kjo të arrihet medoemos dhe në një periudhë shumë të shkurtër.

Për çështjen e ndërlidhjes në ushtri jam interesuar vazhdimisht dhe vazhdimisht ka gënjyer Beqir Balluku. Kjo të mos ngjasë më, se do të marrim masa të rrepta kundër fajtorëve dhe gënjeshtarëve. Kush gënjen, kudo, por veçanërisht në ushtri, ai saboton mbrojtjen.

Ju këshilloj, shokë, të jeni të vëmendshëm, zbatues rigorozë të detyrave në këto drejtime, mos ua hidhni të gjitha fajet për këto çështje armiqve që zbuluam në ushtri. Ata kanë bërë krime dhe do të gjykohen, por njerëzit që punonin më parë në këta sektorë vazhdojnë të punojnë edhe sot. A i kanë kuptuar edhe këta fajet e tyre? Këta duhet t'i vënë pyetjen vetes: «Po ne ç'bënim kur Beqir Balluku, Hito Çakoja dhe Petrit Dumja komplotonin?». Ata ta gjejnë vetë përgjigjen, se nuk është e zorshme ta gjejnë. Nuk është keq t'ua thonë kurdoherë Partia dhe shoku, por duhet t'ua thotë e t'i vrasë ndërgjegjja e tyre edhe vetë, se ndryshe nuk shërohen.

**Aviacioni.** Me aviatorët duhet të bëhet një punë politike e shëndoshë, të forcojmë në ta ndjenjën patriotike dhe atë të disiplinës proletare të hekurt në drejtimet:

- a) E përdorimit në mënyrë të përsosur nga ana teknike dhe e luftimit të avionit;
- b) e disiplinës së hekurt për mirëmbajtjen në shëndet të plotë të aviatorit;
- c) e disiplinës së hekurt teknike në mirëmbajtjen dhe në riparimin e avionit në tokë;
- ç) për të qenë ekonomë në resurset e avionëve, jo dorëlëshuar, duke marrë parasysh kushtet tona.

Duhet të merren të gjitha masat që të ruhet dhe të mirëmbahet teknika luftarake e aviacionit.

Detyrat luftarake nga aviacioni të kryhen sipas kërkesave të Tezave të Këshillit të Mbrojtjes, me sasinë e avionëve që kemi. Mbi këto baza të llogariten dhe aftësitë luftarake konkrete të aviacionit tonë, përqindja e humbjeve të mundshme të tij në raport me humbjet e armikut, që ne të bëjmë luftime ajrore me leverdi, me humbje minimale për ne dhe maksimale për armikun...

Stërvitjen luftarake të aviacionit duhet ta bëjmë në koordinim me armët e tjera.

Nuk e kam të qartë ku bëhet, si bëhet studimi i kushteve atmosferike të fluturimeve në çdo orë të ditës dhe të natës. Kjo duhet bërë për të njohur mirë qysh tash e kurdoherë korridoret e veçanta, rrymat e ajrit etj. në drejtime të veçanta të veprimeve luftarake.

Ne duhet të stërvitemi për asgjësimin e shenjës «me predhën e parë», por të mos na ngopni me fjalë, siç bëhej, dhe me metoda që përdoreshin më parë. Ne duhet të ekonomizojmë, por llogaritë t'i bëjmë si në kohë lufte, kur gjen shumë pengesa përpara.

Shkolla e aviacionit, si dhe gjithë shkollat e tjera, por veçanërisht kjo, duhet të mbahet rigorozisht nën kontroll e në edukatë të fortë politike, morale, teknike. Atje të sundojnë rregulli, disiplina e hekurt, pastërtia, vigjilenca politike dhe teknike, ndryshe s'do të kemi aviatorë, as avionë të mirë. Nga pilotët të mos njihen liberalizmi dhe indisciplinimi si në jetë, në shkollë, ashtu edhe në fluturim.

Merrni masa për të kapërcyer sa më parë dobësitë në sigurimin e gatishmërisë së avionëve dhe të helikopterëve.

Ju duhet të keni plan për të specializuar njerëzit për riparimin e të gjithë tipave të avionëve. Kjo është e vetmja rrugë jona. Ne duhet të fillojmë zgjerimin e uzinave, profilizimin dhe specializimin e tyre. Me shpresa të mos qëndrojmë, duhet të mbështetemi në forcat tona.

Mos u qani për mjetet që duhen për mirëmbajtjen. Këto nevojiten dhe do t'i sigurojmë, por të përdorim mirë ato që kemi, të krijojmë edhe vetë. Këtë të fundit të mos e harrojmë, se, po ta mbajmë mendjen kurdoherë nga importi, mund të mbetemi edhe pa to.

Veglat e ndërrimit duhet t'i bëjmë këtu në shumicën më të madhe. Po e lamë këtë të na e zgjidhë im-



porti, avionët nuk do të jenë në gjendje ta kryejnë detyrën.

Municipionet e tyre t'i përdorni me nikoqirllëkun më të madh dhe t'i kurseni në stërvitje e në luftë.

**Tanket.** Të mirëmbajmë këto modele që kemi dhe të përvetësohet mirë përdorimi i tyre. Ne mund të sjellim ndonjë pajisje moderne për t'ua vënë këtyre që kemi.

Rezervistët traktoristë duhet të mbahen në efciencë e të stërviten si tankistë rezervistë dhe s'duhet të qahemi, por të punojmë në mirë me ta. Të mendojmë për mbrojtjen kundërajrore të tankeve jashtë rrugeve, duke stërvitur sa më mirë rezervistët. Ekuipazhet e tankeve duhet të përvetësojnë mirë specialitetet. Secili nga personat që e përbëjnë ekuipazhin të njohë e të zotërojë specialitetin e tjetrit, që secili të jetë në gjendje të kryejë edhe funksionet e shokëve të ekuipazhit tankist.

Duhet të bëhet kujdes në kthimin e tankeve të stërvitjes në rezervën luftarake pas riparimit, me qëllim që gatishmëria e armës luftarake të tankeve të mos bjerë. Nuk duhet lejuar që të gjitha tanket «të jenë të përdorura». Kjo s'duhet të ndodhë. Në stërvitje të kullandrisemi me ato përqindje të numrit të tankeve që kemi caktuar dhe këto t'i mbajmë në gatishmëri të plotë.

Mirëmbajtja e tankeve është një detyrë nga të parat. Nuk pranojmë shfaqësime ose nxjerrjen e pengesave të kota. Të merren të gjitha masat dhe të mos ketë asnjë tank që të mos jetë në gatishmëri të plotë.

Pjesët e ndërrimit të tankeve të shtohen dhe të bëhen në vend, bile të krijohet edhe një rezervë e arsyeshme për ato më të nevojshmet.

Stërvitja e tankistëve gjatë periudhës së shërbimit ushtarak duhet përmirësuar e duhet përsosur më tej. Plani i stërvitjeve, që është përmirësuar, duhet të zbatohet medoemos...

**Flota luftarake-detare.** Kudo duhen rishikuar prodhimi në vend i pjesëve të këmbimit dhe rigjenerimi i atyre të konsumuara.

Siç na thuhet, për këto mjetet e prodhimit janë, kurse lënda e parë mungon. Përse ndodh kështu? Apo mos vallë lënda e parë ka ekzistuar dhe është përdorur keq dhe nga kush? Kjo duhet gjetur (por jo duke thënë «e kanë shpërdoruar Beqir Balluku, Petrit Dumja dhe Hito Çakoja», se kjo është e lehtë të thuhet), ose ajo ekziston diku dhe duhet gjetur e duhet dhënë. Unë mendoj se në administrimin e lëndës së parë nuk ka pasur aspak kontroll dhe kam frikë se ekziston ky mentalitet i keq. Të jemi rigorozë në këtë drejtim.

Duhen plotësuar mjetet teknike me specialistë aq sa është e nevojshme dhe as më pak e as më shumë.

Çdo mjet të jetë në gatishmëri luftarake.

Për sa u përket armatimeve dhe municioneve, duhet të paraqiten kërkesa të studiuara dhe të arsyeshme që të plotësojmë nevojën e fuqisë së zjarrit.

Mendoj që mjaft uzinave të sektorit civil t'u ngarkohet detyra të punojnë edhe për flotën dhe për armët e tjera. Që tash në kohë paqeje të mësojmë pu-

nëtorë në këto uzina që të prodhojnë për ushtrinë...

Fortifikimet në bregdet nuk duhet të zvarriten më. Të gjenden specialistët e nevojshëm. Kur kërkohen specialistë për të fryrë zyrat dhe institutet, nga këta ka me qindra, kurse kur kërkohen për zbatim, nuk gjen dot dy.

Duhet të spastrohen prapavijat e ushtrisë nga elementët e pazotë e të pandërgjegjshëm, dhe në radhë të parë nga ata të dyshimtë dhe armiq.

Linjat dhe grupet elektrike, me të cilat punohet sot, jo të lihen e të braktisen si mall pa zot, me pretekstin se «janë të vjetra», por të riparohen, të konservohen dhe të mbahen në gatishmëri. Çdo gjë të riparohet, çdo gjë të jetë në gatishmëri për rast lufte.

Në repartet ushtarake, kuptoj në komanda, duhet të shikohet më nga afër numri i kuadrove, në drejtim të tepricës. Në përgjithësi flitet se me kuadro jemi mangët, por ka komandantë njësisish që thonë se ka vend për të bërë shkurtim kuadrosh.

*Botohet për herë të parë, me  
ndonjë shkurtim, sipas origji-  
nalit, që gjendet në Arkivin  
Qendror të Partisë*

# TE FORCOJME NDERGJEGJEN SOCIALISTE NE PUNE, TE MPREHIM PARESITUR VIGJILENCEN REVOLUCIONARE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

21 maj 1975

Unë propozoj që të dy raportet t'i marrim në shqyrtim së toku, pse janë gati të një natyre. Në të dy flitet për punën politike-ideologjike dhe për veprimtarinë armiqësore. Jeni dakord? (*Të gjithë u shprehën dakord.*)

Të më falni ju, shokë të organizatave të masave, se që në fillim do t'ju bëj një kritikë. Në këtë raport ka vetëm konstatime: flitet se çfarë po ngjet, por çfarë është bërë dhe çfarë duhet të bëhet në të ardhmen, nuk thuhet asgjë. Është mirë që në diskutimet tuaja t'i

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua për zbatimin e detyrave të Plenumit të 4-t të KQ të Partisë për demaskimin e propagandës armiqësore dhe për luftën kundër zakoneve prapanike e besimeve fetare, si dhe për problemet që dilnin në këtë fushë sipas porosive të Kongresit të 6-të të PPSH.

jepet përparësi kësaj ane të problemit. Konstatime kemi plot. Plot gjëra dini ju, plot gjëra dimë edhe ne, por çështja është të na thoni çfarë duhet bërë.

Kisha disa pyetje për shokun Rrapo Dervishi. Shkollat mirë shkollat fillore në minoritet? U jepen mësuësve udhëzime për mësimin e gjuhës, se si ta japin ata këtë lëndë? Kontrollohen këto çështje si në shkollat e tjera të rrethit? Kjo duhet bërë me doemos. Të përpiqeni për t'u mësuar minoritarëve gjuhën amtare. Vija e drejtë e Partisë sonë për çështjen nacionale kërkon që të kontrollohen edhe shkollat e minoritetit, ashtu siç kontrollohen shkollat shqipe, për të parë nëse e zhvillojnë mirë mësimin etj. Keni në seksionin e arsimit të rrethit inspektor për shkollat ku jepet mësimi në gjuhën greke?

Si bëhen përkthimet e materialeve të Partisë e të librave të tjerë nga shqipja në greqisht? Keni ndonjë redaksi të veçantë për këtë? Në ç'shikullë përkthehen materialet e Partisë, që i merr gjithë populli, gjithë komunistët? Sigurisht, të tëra këto materiale nuk përkthehen, por dua të di si veprohet konkretisht.

Është interesuar ndonjëherë sektori përkatës i aparatit të Komitetit Qendror për përhapjen dhe për shfrytëzimin e materialeve të Partisë në pakicën kombëtare greke? Është kontrolluar se çfarë përkthehet, çfarë nuk përkthehet dhe çfarë duhet të përkthehet? (Gjithmonë është fjala për literaturën që përkthehet në gjuhën greke e që përdoret nga popullsia e minoritetit.) E them këtë se puna politike forcohet duke studiuar materialet e Partisë. Edhe një kuadër nuk bën

dot punë politike në popull pa studiuar më parë materialet e Partisë. Po në minoritet si mund të bëhet punë politike pa pasur të përkthyer dokumentet dhe materialet e Partisë, në mos të tëra, të paktën pjesën më të rëndësishme?

Në minoritet mund të ketë plot njerëz, të cilët dinë pak shqip, por këtu është fjala që minoritari të marrë materiale të Partisë, t'i lexojë e t'i kuptojë ato, gjë që kërkon t'i ketë edhe në greqisht. Të përpiqemi që këtij minoriteti t'i mësojmë gjuhën e re greke në zhvillimin e saj. Sigurisht, gjuha greke, si çdo gjuhë tjetër, ka bërë ndryshime të mëdha jo vetëm nga qindra vjet më parë, po edhe kohët e fundit. Ata që janë larguar nga vendi ynë para 30-40 vjetëve, nuk flasin dot shqip si ne, se kanë një horizont shumë më të ngushtë të leksikut, kanë atë të folur që kemi pasur ne 30-40 vjet përpara. Prandaj duhet të interesohemi, se të gjitha këto probleme kanë zgjidhje. Pse të mos sillen disa fjalorë të gjuhës së sotme greke apo edhe materiale të tjera për ata shokë që merren me shkollat dhe me kulturën e minoritetit?

*Pasi shoku Rrapo Dervishi iu përgjigj pyetjeve të mësipërme, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Si e kuptojnë masat e popullit dhe Partia në rreth luftën e klasave dhe në ç'forma e zhvillojnë atë? Se, po të kuptojnë drejt luftën e klasave, janë në gjendje të vlerësojnë drejt edhe çdo gjë tjetër. Ata që e kuptojnë thellë se ç'është lufta e klasave, nuk habiten pse ndodh kjo apo ajo ngjarje; ata dinë se ka armiq jo vetëm jashtë, por dhe brenda vendit, që duhen luftuar. Ata

që nuk e kuptojnë luftën e klasave, thonë: «Pse ngjau kështu, pse u bë ashtu?». Në këto situata që na janë krijuar, çfarë fryme ekziston, çfarë veprimtarie zhvillon armiku? Çfarë gjërash të theksuara dalin? Si demaskohen e luftohen shfaqjet e huaja? Si këshillohen ata që gabojnë? Ku paraqiten më shumë këto shfaqje, në çfarë drejtimesh të politikës, të ekonomisë, të kulturës etj.? Në cilat krahina duken më shumë e në cilat më pak?

*Mbas përgjigjeve që iu dhanë edhe këtyre pyetjeve, shoku Enver Hoxha tha:*

Në përgjithësi, mendimi im është që në Gjirokastër punët shkojnë mirë, si nga ana ekonomike, ashtu edhe nga ana politike, prandaj nuk kemi ndonjë vërejtje. Të meta, natyrisht, ka dhe ato duhet t'i luftojmë kurdoherë, por, siç tha shoku Rrapo, në përgjithësi gjendja në rrethin e Gjirokastrës është e mirë. Këto rekomandime e këshillime që u bënë këtu në mbledhje, gjatë ndërhyrjeve, janë të drejta, prandaj i shikoni dhe i zhvilloni më tej.

**SHOQJA TEFTA CAMI<sup>1</sup>:** Ne rrimë kokulur kur krahasojmë rrethin tonë me atë të Gjirokastrës për ngritjen e nivelit ekonomik të kooperativave bujqësore.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Pse është një gjendje e tillë ekonomike në rrethin tuaj? Çfarë konkluzionesh keni nxjerrë ju? Pse ndodhin këto gjëra kur dibranët i njohim që janë punëtorë? Ndoshta nuk janë specia-

---

1. Në atë kohë sekretare e Komitetit të Partisë të Rrethit të Dibrës.

listë të misrit, po ata kanë qenë specialistë të jonxhës. Edhe për blegtorinë janë kujdesur, atëherë pse paraqitet kjo situatë? Mos e ulin nivelin disa zona të rrethit? Si është niveli në zona të veçanta? Mos këta faktorë bëjnë që niveli i rrethit të jetë më i ulët, duke e krahasuar me rrethe të tjera? Po shokët e Ministrisë së Bujqësisë a janë interesuar për këto çështje?

*SHOQJA TEFTA CAMI:* Ata kanë ardhur, kanë bërë studime, po përgjigje nuk na kanë dhënë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kush ka ardhur prej tyre dhe sa kohë ka që kanë ardhur atje? Po studimet sa kohë ka që kanë përfunduar?

*Pasi iu dhanë përgjigjet pyetjeve të bëra dhe pas diskutimeve të të pranishmëve, shoku Enver Hoxha tha:*

Ky ekspozim i problemeve nga ana e shoqeve dhe e shokëve që diskutuan sot këtu, jo vetëm na ndihmon në punë në shokët e udhëheqjes, por, në të njëjtën kohë, tregon se organizatat e Partisë të rretheve të Gjirokastrës e të Dibrës, si dhe organizatat e gruas e të rinisë, përpiqen dhe luftojnë me sukses për zbatimin e detyrave të Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror të Partisë dhe kanë arritur përparime.

Paraqitja e gjendjes së rrethit të Dibrës nga ju, shoqja Tefta, është rezultat i një analize objektive dhe të qartë. Në këtë analizë duken edhe përpjekjet që ka bërë Partia dhe veçanërisht udhëheqja e saj në rrethin tuaj për t'u dalë përpara problemeve që shtrohen. Kudo, në të gjitha organizatat e Partisë në rrethe, ka vështirësi, por është pozitiv fakti që ju e keni kuptuar se vështirësitë e rrethit tuaj, sidomos në drejtimet politike



dhe ideologjike, janë më të mëdha nga ato të disa rretheve të tjera. Kjo shpjegohet me arsyet që dimë, siç janë, për shembull, bajraktarizmi, që e kemi ndeshur në të kaluarën, në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare, dhe mbeturinat e tij, me të cilat ndeshemi sot. Këto mbeturina, sikurse the drejt ti, duken edhe sot në shumë aspekte të punës, të mendimit, të trajtimit të problemeve dhe të veprimit.

Unë mendoj se, pavarësisht nga kritika e drejtë që u bë këtu për sa u përket rritjes së vigjilencës revolucionare dhe këmbënguljes për t'i çuar gjer në fund problemet që dalin në këtë fushë, ju drejtuesit e organizatës së Partisë në rreth jeni dhe duhet të jeni luftëtarë e të guximshëm. Mos u tutni nga ato që thonë elementët jo të shëndoshë. Ju ndiqni rrugën e Partisë dhe zbatoni pa lëkundje direktivën e saj. U vini kufi dhe u tregoni vendin të gjithë atyre elementëve që kanë mbeturina të theksuara të tarafeve, të bajraktarizmit, atyre që duan të informohen për diçka jashtë rregullave të Partisë, atyre që shesin mend duke u mbështetur në të kaluarën e tyre qoftë edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, por që më vonë nuk i kanë ndjekur me besnikëri qëllimet e kësaj lufte. Përpara këtyre njerëzve asnjë komunist nuk duhet të përulet, përkundrazi, t'u thuhet të katër të vërtetat në fytyrë, pra t'u vihen në dukje jo vetëm meritat, por edhe të metat. Në këtë drejtim të punohet me vendosmëri dhe me besim në drejtësinë e vijës së Partisë.

Të luftojmë indiferentizmin, të zhvillojmë ndjenjën e luftës së klasave. Këto gjëra jo vetëm t'i shpjegojë

Partia nëpërmjet materialeve të saj, por të sqarohen edhe njerëzit se si zhvillohet kjo luftë në gjirin e popullit. Kur dikush vjen e thotë: «More, po si u bë kjo punë kështu? Si u dënua ky njeri? Si u transferua ky tjetri?», ai që dëgjon pyetje të tilla të përgjigjet: «Ai u dënua se ka qenë armik i Partisë dhe i popullit, se kishte shkelur këtë dhe atë ligj. Ai tjetri u transferua jo se ia punuan pa të drejtë, po se nuk ka punuar mirë». Pra, në këtë mënyrë bëhet sqarimi i problemeve që ngrihen, nëpërmjet një pune politike bindëse.

Ka njerëz që vazhdojnë t'u japin vazhate të tyre paja të mëdha. A luftohet në këtë drejtim, kur dihet se ka shumë familje që e ndjekin këtë zakon prapanik? Ç'janë gjithë këto harxhe që bëhen? «Po si të mos bëj shpenzime për çupën?», mund të thotë ndonjë prapanik. Këtij duhet t'i thuhet: «T'i bësh, por jo pajë kaq të madhe» etj., etj. Pra, e kam fjalën që për çdo çështje të ngjallet një debat politik. Kjo ka shumë rëndësi.

Ne jetojmë në një zhvillim politik të tillë ku kurdoherë shprehen mendime e bëhen debate. Partia vërtet jep direktiva, të cilat të hapin horizont e të orientojnë, por të gjithë njerëzit nuk orientohen drejt përnjëherësh. Pikërisht, detyra e Partisë dhe e organizatave të masave është që të nxitin njerëzit që secili të bëjë punë politike në bazë të direktivave të Partisë. Kjo nuk do të thotë të diskutojmë kot së koti. Gjërave pa vlerë t'u vëmë kufi. Në qoftë se dikush do të vijë e të thotë: «More vesh gjë? E qarkulluan filanin!», kjo shprehje ka brenda edhe habinë, edhe mospranimin, edhe anën politike, por ai që flet kështu kërkon edhe shpjegime. Ai tjetri që

i dëgjon këto fjalë, duhet ta sqarojë bashkëbiseduesin se përse është i domosdoshëm qarkullimi i kuadrove, por jo t'i marrë këto llafe e t'i transmetojë mbrapsht, në një frymë thashethemesh. Në rast se transferohet një kuadër dhe kjo çështje bisedohet nga njerëzit, ai që dëgjon, duke ditur direktivën e Partisë, duhet të shpjegojë se Partia ka nevojë, prandaj e transferoi atë, i cili është shok i mirë, është komunist i mirë etj. Diskutime të tilla do të bëhen, por ka raste që këto çështje nuk i diskutojnë në frymë të shëndoshë dhe përhapen fjalë kot andej-këtej. Kjo mënyrë veprimi jopozitive nuk duhet të lejohet. Njerëzit parimorë e të ndershëm të punojnë sipas direktivave të Partisë, kundër shpifjeve e thashethemeve.

Në radhë të parë ne duhet t'i mësojmë njerëzit që t'i dënojnë dhe t'i urrejnë këto shfaqje, se vetëm kështu ata edhe do të luftojnë për t'i zhdukur ato. Kur vërtetohet në familje ose në të afërmit ndonjë gjë e papëlqyeshme, sipas rastit, të ndërhyhet menjëherë dhe t'u thuhet se këto sjellje nuk janë të mira. Kur ai që është i molepsur me këto shfaqje nuk arrin ta kuptojë se ka shkarë, le të rrimë e të bisedojmë shtruar me të e t'ia shpjegojmë mirë këtë çështje. «Mos të të vijë hidhur, se për të mirën tënde po të flas», t'i themi atij që ka gabuar. Ky është një qëndrim luftarak që duhet t'ua rekomandojmë njerëzve. Kështu ata mësohen të mendojnë e të luftojnë politikisht.

Mua më duket se ju i keni të qarta format dhe metodat e luftës e të punës që duhet të zhvilloni në rrethin e Dibrës, por megjithatë ky rreth duhet ndih-

muar edhe nga Komiteti Qendror i Partisë dhe nga Qeveria. Është e domosdoshme të merren disa masa më efektive si për ngritjen e nivelit politik të masave, ashtu edhe për kuptimin e drejtë të nevojës së zhvillimit të luftës së klasave. Në këtë proces nuk duhen harruar mbeturinat e së kaluarës, zhdukja e të cilave kërkon një luftë të vazhdueshme ideologjike, politike, bile edhe administrative, kur e lyp nevoja. Megjithatë, që të bëhet me sukses kjo luftë, duhet të shoqërohet me një ndihmë më të madhe e më të kujdesshme nga ana e shtetit, sidomos nga Ministria e Bujqësisë. Puna juaj dhe ndihma e shtetit duhet t'i shërbejnë përmirësimit të gjendjes ekonomike të këtij rrethi.

Nga informatat që na dërgoni, ne dimë se ka mjaft kooperativistë të ju që nuk e çmojnë si duhet pasurinë e përbashkët socialiste, bile disa prej tyre jo vetëm nuk e çmojnë, por ka raste që edhe e dëmtojnë dhe e shpërdorojnë. Ky nuk është qëndrim socialist ndaj pronës shoqërore, por një sjellje e shëmtuar. Në të kaluarën, kur ekzistonte prona private, burim i të gjitha të këqijave, bëheshin edhe vjedhje. Tani kohët kanë ndryshuar rrënjësisht. Në përgjithësi njerëzit e shohin pronën socialiste si pasurinë e tyre dhe e ruajnë si sytë e ballit, por ka edhe raste dëmtimesh e shpërdorimesh, kundër të cilave duhet luftuar më me këmbëngulje. Partia të punojë që prona socialiste të mos preket si në ndërmarrjet ekonomike, ashtu edhe në kooperativat bujqësore.

Disa njerëz mund të pretendojnë se vjedhjet ngjasin edhe për mungesë të fuqisë blerëse, që rrjedh nga

mosrealizimi i prodhimeve. Njeriu i ndershëm i popullit, i cili punon e derdh djersë, ka fuqi blerëse, ky realizon një të ardhur të mjaftueshme për të blerë e për të jetuar në kushte normale, siç kërkon Partia. Një njeri i tillë ndien gëzimin e punës dhe nuk ka përse të turpërohet duke marrë ca fasule ose ca misër në arë. Kurrë nuk mund të justifikohet moralisht një vjedhës i pasurisë kooperativiste, duke pretenduar se «vodha nga- që nuk më mjafton ajo që kam.»! Në qoftë se ai ka bërë pak ditë-punë në kooperativën bujqësore, atëherë, është e natyrshme që do të marrë më pak të ardhura. Po përse nuk ka punuar sa duhet? Ndoshta se është dembel dhe ky ves i tij është trashëguar me kohë sipas konceptit të vjetër anadollak «Lodhu sa më pak!». Disa kooperativistë nuk e kanë kuptuar akoma si duhet rëndësinë e prodhimit të madh socialist, prandaj e nënvleftësojnë dhe e dëmtojnë atë. Oborrin që është lënë në përdorim të tyre, këta e ruajnë shumë, e punojnë me kujdes dhe realizojnë nga prodhimet e tij të ardhura shumë më të mira nga ato të kooperativës! Ky është një tregues që duhet të tërheqë vëmendjen e Partisë në rreth e në bazë, me qëllim që ta bëjë më mirë dhe më praktikisht propagandimin e kolektivizimit, të të mirave që sjell ky etj.

Më parë rrethi i Dibrës ka qenë më i dalluari për kultivimin e jonxhës, kurse tani është mbrapa. Përkundrazi, rrethi i Gjirokastrës, i cili nuk e kultivonte jonxhën, duke parë dobinë e saj, arriti rezultate të mëdha. Një nga të ardhurat më të mira të kooperativave bujqësore të rrethit të Gjirokastrës del nga jonxha. Gji-

rokastritët marrin shumë të ardhura edhe nga duhani e qepujkat, në një kohë që ju vazhdoni të merrni 3-4 kuintalë duhan për hektar. Me një prodhim të tillë, sigurisht, nuk mund të shtohen të ardhurat.

Unë e njoh mirë të kaluarën e Çermenikës e të Shmilit. Kur isha gjatë kohës së Luftës Nacionalçlirimtare në Çermenikën e Zezë, gjendja atje qe aq e rëndë dhe e mjerueshme, sa të vije duart në kokë. Kjo ishte arsyeja që e kishin quajtur këtë vend Çermenika e Zezë. Ka kohë që unë nuk kam shkuar atje, por shokët që kanë vajtur më kanë thënë se tani nuk është lehtë të njihen ato anë, sepse vendi ka ndryshuar, toka është punuar e është lulëzuar. Në Çermenikë e Shmil janë ngritur shtëpi të reja, të pastra, të lyera etj., etj.

Në këto rrethana të një përparimi të vrullshëm të mbarë vendit tonë na vjen keq që kooperativistët e Dibrës, me një traditë të shquar për marrjen e shumë prodhimeve bujqësore, të bëjnë hapa prapa. Prandaj çështjen e propagandimit të punës e të prodhimit dhe ngritjen e ekonomisë në këtë rreth të mos i lëmë pas dore. Është e nevojshme që ju, shokë të rrethit, të studioni më thellë cilat janë arsyet e kësaj prapambetjeje, janë arsye organizative, ekonomike, sociale, apo vetëm disa nga këto?

Ne kemi pasë praktikuar më përpara lëvizjen e kooperativistëve nga Veriu në Jug për shkëmbim eksperience, për shembull, disa fshatarë dërgoheshin nga rrethi i Dibrës në atë të Gjirokastrës etj. Kjo lëvizje, që ka dhënë rezultate pozitive, natyrisht, të mos zhvillohet me shumë shpenzime, por edhe pa disa shpenzime të

nevojshme nuk mund të bëhet. Të jeni të bindur se kooperativistët që do të dërgohen në disa vende, si në Vlorë, në Elbasan, në Gjirokastrë etj., do të priten shumë mirë. Atje do të fitohet eksperiencë, për shembull, jo vetëm për teknikën e mbjelljes së qepujkave, të duhanit etj., por sidomos do të mësohet për mënyrën e rritjes së konsideratës politiko-ideologjike për kolektivizimin, pra do të shihet në praktikë ç'të ardhura ka pasur dhe çfarë ngritjeje të mirëqenies materiale e të nivelit ideopolitik, kulturor ka sjellë me vete kolektivizimi. Prandaj mos e neglizhoni, por shikojeni me kujdes çështjen e dërgimit përsëri të kooperativistëve nga Veriu në Jug.

Për sa i përket luftës kundër propagandës revizioniste jugosllave, orientimet e Partisë i keni kuptuar drejt. Kështu vazhdoni të veproni edhe në të ardhmen. Me revizionistët jugosllavë ne jemi armiq, por nuk jemi aspak të tillë me popujt e Jugosllavisë, dhe veçanërisht me vëllezërit tanë kosovarë. Regjimi titist i ushqen me ideologjinë e vet armiqësore popujt që ka nën sundim. Nga ky rrezik nuk kanë shpëtuar as kosovarët. Ka më shumë se tri dekada që armiku propagandon me të gjitha format dhe mjetet idetë e tij reaksionare. Këtë fakt duhet ta kenë parasysh vazhdimisht njerëzit tanë në Dibër dhe në rrethet e tjera. Mbrojtja e atdheut jo vetëm nga agresioni ushtarak, por edhe nga diversioni e agresioni ideologjik e politik është çështje patriotike.

Kur vjen babai, motra apo vëllai nga Kosova ose Dibra e Madhe, të përpiqemi t'i sqarojmë për realitetin tonë, për politikën e drejtë që bën Partia jonë dhe për

perspektivat që kemi përpara, t'u bëjmë të njohura sukseset e ndërtimit të socializmit në Shqipëri, t'u tregojmë pikëpamjet tona të drejta marksiste-leniniste për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve shoqërore, ekonomike, politike, kulturore etj.

Dashuria dhe respekti për vëllanë a motrën që jeton larg nesh, të ruhen. Ata që vijnë në Shqipëri të priten me ngrohtësi si motër a vëlla. Për çdo gjë që është nevoja, të afërmit tanë, që jetojnë larg atdheut, t'i sqarojmë, pa ekzagjerime. T'u themi atyre: «Shikojini vetë fushat, ndërmarrrjet bujqësore, shkollat, spitale, fabrikat etj. Në vendin tonë ndihma mjekësore sigurohet falas, tatimet dhe taksat janë hequr, çdo fshat është elektrifikuar» etj.

Nga diskutimi yt, shoqja Vito<sup>1</sup>, unë nxjerr konkluzionin se organizata e gruas punon aktivisht për të vënë në jetë porositë e Partisë. Ka përparime të mëdha në kuptimin e vijës së Partisë nga ana e grave. Mundet që ju, si organizatë e Bashkimit të Grave, ose organizata e Bashkimit të Rinisë, të mos e shikoni sa duhet efektin e këtyre përparimeve që kemi arritur, se ju konkretisht ndesheni me problemet, me të metat e vështirësitë në kuadrin e organizatës, por efektin pozitiv të punës suaj duhet ta shikoni në kuadrin e zhvillimit të përgjithshëm dhe në qëndrimet e përgjithshme politike, ideologjike, luftarake që mbajnë në punë individët, të cilët militojnë në organizatat tuaja. Ne vërejmë me kënaqësi se ka një shpirt luftarak të shëndoshë në

---

1. Vilo Kapo, në atë kohë Presidente e BGSH.



radhët e grave e të rinisë. Jo vetëm këta, por dhe fëmijët kanë fituar autoritet më të madh te prindërit, gjë që përpara nuk e kishin sa duhet. Nga gjithë kjo punë që është bërë, tani babai ka respekt si për vajzën, ashtu edhe për djalin e tij, jo vetëm kur fëmija është në punë dhe i shpie rrogën, por edhe kur ai është në shkollë.

Ne nuk duhet të shikojmë vetëm rastet negative që janë shumë të rralla dhe jotipike. Unë mendoj se ndikimi i punës së Partisë dhe i asaj të organizatave të masave është i madh derisa pranojmë (dhe kjo është e vërtetë) që nuk ka shqetësime te njerëzit kur vajza gjashtëmbëdhjetë apo shtatëmbëdhjetëvjeçare vete në hekurudhë apo në aksione të tjera. Kjo do të thotë se ndikimi në konceptet dhe në ndërgjegjen e të mëdhenjve është real, konkret, i kapshëm dhe prindi nuk ka frikë që vajza të shkojë atje ku i bën thirrje organizata, sepse organizata e rinisë dhe ajo e gruas kanë fituar autoritet; po kështu, siç thashë edhe më parë, dhe vetë e reja ndaj prindërve të saj. Prandaj, për të nxjerrë konkluzione të sakta, nuk duhet të bazohemi vetëm në disa raste të papëlqyeshme, sepse të tilla ka sot, po do të ketë edhe nesër. Unë mendoj se të kalojnë 148 mijë vajza të reja në të gjitha aksionet, ky është një hap i madh cilësor.

Partia, në radhë të parë, është ajo që i frymëzon për vepra të mëdha organizatat e masave, të rinjtë e të rejat që bëjnë pjesë në këto organizata. Por një rol të veçantë në edukimin e njerëzve luajnë edhe vetë organizatat tuaja. Dëshirat realiste dhe pa pretendime të

tepruara të njerëzve tanë të punës, të anëtarëve të shoqërisë sonë të shëndetshme, Partia duhet t'i plotësojë. E tillë është dëshira e madhe që kanë shprehur nxënësit dhe studentët, të rinj e të reja, për të vajtur në aksione. Ky qëndrim i tyre është shumë pozitiv dhe i lavdërueshëm.

Dëshirat që janë shprehur në këtë drejtim tregojnë, së pari, që njeriu ynë i ri e ka kuptuar se atdheu socialist është i tij, se për këtë atdhe ai duhet të fillojë të derdhë djersën që tash në moshë të re; së dyti, i riu dhe e reja mendojnë se në aksion ata do të njihen me shumë shokë dhe shoqe, do të zgjerojnë kështu shoqërinë dhe horizontin e tyre. Ka një mijë e një arsye që të rinjve ua do shpirti të shkojnë në aksion. Atje ata gjejnë kënaqësi, jo se e konsiderojnë aksionin si lodër, përkundrazi, se të rinjtë tanë kanë marrë një edukatë të madhe revolucionare.

Interesimin për t'u njohur me vendin dhe me njerëzit duhet ta nxitim e ta zhvillojmë në radhët e gjithë pjesëtarëve të rinisë sonë. Kjo ka rëndësi të madhe, se do të jetë një nga nxitjet më konkrete dhe më realiste të rinisë, e cila dëshiron të shohë përparimet e vendit të vet. Të shikosh përparimet e këtij vendi, do të thotë të mësosh më shumë për atdheun. Një nga filozofët më të mëdhenj të Francës, Montenji, i cili ka shkruar edhe për Skënderbeun, thotë se ka mësuar aq shumë duke udhëtuar e duke marrë kontakt me njerëzit, duke studiuar doket e zakonet e tyre, sa kurrë nuk do të mësonte, sikur edhe dyfishin e jetës së tij të kishte pasur mundësi ta kalonte në shkollë. Çështjen e njohjes së të

rinjve me vendin, me punën dhe me njerëzit, ne duhet ta nxitim dhe ta organizojmë.

Sa më shumë të punohet sot për të krijuar në radhët e rinisë një dashuri të zjarrtë për atdheun dhe për të gjitha horizontet e gjera të tij, aq më shumë Partia nuk do të gjejë vështirësi nesër, kur t'i thotë të riut: «Ngrihu ti, djalë, e shko në krahinën e Lumës, se atje duhet të punosh për nevojat e atdheut!». I riu, i edukuar nga Partia, do të vejë me gjithë qejf atje ku e thërret atdheu i tij. Disa njerëzve, që janë rritur në një botë tjetër dhe që jetojnë e punojnë në botën tonë socialiste, kur u thotë Partia «shkoni e punoni në kooperativat e reja të Lumës», u duket sikur u bie pika në kokë, sikur do të mbyten në lumë! Atyre nuk u pëlqen të lëvizin, se janë mësuar në guaskën e tyre, në zyrë, janë mbërthyer në karrige, janë burokratizuar.

Në qoftë se punojmë për t'i organizuar mirë punët, atëherë do të rritet më shumë edhe rëndësia e organizatës së Frontit Demokratik, të cilën e ka në konsideratë Partia. Fronti e mbështet vijën e Partisë, se në këtë organizatë të gjerë masash bëjnë pjesë të gjithë patriotët, atje sintetizohet gjithë ky aktivitet i madh i komunistëve, i grave, i punëtorëve, i të rinjve. Në organizatën e Frontit rrihen në një shkallë më të gjerë dhe në një horizont më të madh problemet, sepse në radhët e saj bën pjesë një masë më e madhe njerëzish, burra dhe gra, të rinj e të reja, komunistë dhe patriotë të paorganizuar në Parti. Pikërisht ky organizim sipas orientimeve të Partisë e ka bërë Frontin tonë që të forcohet e të gjallërohet vazhdimisht.

Ne kemi akoma mbeturina të theksuara, që shfaqen në jetën dhe në punën tonë. Këto mbeturina nuk duhet të na çuditin, se në jetë gjëra të tilla, që u përmendën këtu, edhe do të ngjasin. Fakti që ekzistenca e mbeturinave është një realitet i njohur, nuk do të thotë aspak që ne të lidhim duart para tyre. Jo, duhet të ndeshemi rreptë dhe në mënyrë të gjithanshme me ato. Lufta kundër mbeturinave bëhet politikisht, ideologjikisht etj. Për këtë qëllim mund të na shërbejnë shumë forma e metoda pune si, për shembull, referatet, udhëzimet, mbledhjet etj., por duhet të kemi mirë parasysh se të gjitha referatet e udhëzimet që përgatiten ose mbledhjet që organizohen duhet të shërbejnë për t'i luftuar mbeturinat e huaja jo vetëm në mbledhje, por, siç u tha këtu, shtëpi më shtëpi, kokë më kokë për çështje konkrete. Kjo kërkon që t'i ngrenë mendimet, bisedimet dhe diskutimet tona në një nivel më të lartë politik dhe ideologjik. Të hiqet dorë nga formulat e zbrazëta, nga diskutimet dhe mendimet boshë e pa përmbajtje, që as të ngrohin, as të ftohin. Revolucionarizimi i ndërgjegjes së njerëzve nuk mund të bëhet as në një ditë, as duke punuar njësoj me të gjithë. Ne duhet të frymëzojmë drejt gjithsecilin, qoftë edhe në një shkallë të ulët, që të reagojë për çdo çështje në mënyrë politike. Po arritëm këtë, ne, natyrisht, nuk do t'i zhdukim krejtësisht mbeturinat, por shfaqjet e tyre do t'i pakësojmë në një shkallë shumë më të madhe. Eksperienca tregon se me punën e vazhdueshme ideopolitike, te burrat dhe te gratë, veçanërisht tek të rinjtë dhe të rejat, këto mbeturina mund të luftohen me sukses.

Në këtë drejtim Partia duhet t'i kuptojë, t'i ndihmojë dhe t'i përdorë mirë levat e saj. Ndihma që duhet të japë Partia për organizatat e masave nuk është çështje lëmoshe, por detyrë që rrjedh nga roli i saj udhëheqës, mobilizues dhe organizues. Në qoftë se përgjegjësja e organizatës së gruas u ngrit me shumë të drejtë kundër rrëmbimit të një vajze në fshatin Dukat, atëherë çfarë bënte atje organizata-bazë e Partisë? Përse kjo organizatë partie nuk e vlerësoi këtë çështje, në një kohë që edhe vetë nëna e vajzës informoi se në një rrëmbim të tillë merrnin pjesë edhe komunistë? Përse ajo priti derisa të ndërhyenin komiteti i Partisë dhe kryesia e gruas e rrethit? Kjo do të thotë që ajo organizatë partie nuk është në rrugë të drejtë. Në këtë drejtim organizatat-bazë duhet të punojnë më tepër, ato kanë orientime të qarta për këto çështje. Nuk ka organizatë-bazë partie që nuk e di se ajo duhet të vërë në lëvizje levat, por kjo gjë duhet kuptuar e duhet vlerësuar në mënyrë konkrete. Duhet të ndihet nevoja e mbështetjes nga organizatat e masave për propagandimin dhe për zbatimin e vijës së Partisë. Kontrolli i masave do të bëhet i efektshëm në rast se këto masa do t'i ngremë politikisht. Duhet të kuptohen vija e Partisë dhe nevoja e zbatimit të saj edhe nga organizata e gruas, nga ajo e bashkimeve profesionale, nga rinia, nga Fronti etj.

Partia i zbuloi elementët armiq, i demaskoi dhe u tregoi vendin, por megjithatë ata na kanë dëmtuar. Këto dëme politike, ideologjike, materiale dhe në pu-

nën me kuadrot, duhen riparuar. Armiku e fillon luftën duke synuar më parë të komprometojë dhe të prishë njerëzit e pastaj t'i futë këta në veprim. Kështu kanë bërë të gjithë armiqtë, qofshin ata që vepruan në ushtri, qofshin ata që vepruan në sferën e ideologjisë, si dhe këta në sektorin e industrisë së naftës. Edhe armiqtë e tjerë, që mund të veprojnë akoma në ekonominë tonë, këtë gjë synojnë: të përpunojnë njerëzit kundër Partisë. Prandaj, shokë, të forconi luftën, të shtoni vigjilencën. Të mos flemë para veprimtarisë së armikut dhe të mos mashtrohemi prej tij, siç ka ndodhur në disa organizata partie në ndërmarrje ose në rrethe. Nuk duhet të mbylleshin sytë, për shembull, para aktivitetit armiqësor të Pirro Gushos, vetëm sepse ky ishte sekretar i parë i komitetit të Partisë në Fier. Organizata e Partisë, në këtë rast, ka fjetur, nuk ka informuar dhe nuk ka reaguuar. Në këtë drejtim edhe këtëj nga qendra janë vërtetuar gabime. Këto gabime kanë ndihmuar të zhvillohej puna armiqësore. Por, në qoftë se tregohet një vigjilencë më e madhe nga baza dhe në rast se veprimet e jashtëligjshme do t'i viheshin në dukje në kohën e duhur udhëheqjes, këto dëme do të ishin evituar dhe kësaj pune armiqësore do t'i vihej fre më shpejt dhe më thellë.

Duhet ta kemi të qartë dhe të jemi të bindur se, me zbulimin e elementëve armiq në sektorët që përmendëm, nuk është shuar lufta e armikut të klasës kundër nesh. Fije të padukshme të kësaj pune armiqësore ekzistojnë akoma dhe duhen zbuluar. Këto fije po mbulohen tashti, se armiku është trembur nga go-

ditjet, por ne nuk duhet të kënaqemi duke vërejtur se armiku i tulatur nuk bën më «gëk». Natyrisht, ai mundet të mos ndihet tashti që është struktur, por pret me padurim çastin që të fillojë prapë luftën kundër pushtetit tonë popullor, prandaj lufta e klasave do të vazhdojë deri në ndërtimin e plotë të shoqërisë komuniste.

Ju, shokë të organizatave të masave dhe të komiteteve të Partisë të rretheve, duhet të dini se punët e Partisë dhe ato shtetërore lypset të jenë nën kontroll të vazhdueshëm. Direktivat e Partisë të mos i pëlqeni thjesht si formulime e t'i reduktoni në slogane e citate, por t'i konsideroni si orientime me vlerë dhe t'ju shërbejnë për të shtyrë përpara prodhimin, për t'i vënë fre çdo pune armiçsore.

Në qoftë se ne kontrollojmë dhe ndihmojmë, sugjerojmë dhe këshillojmë, por edhe i qortojmë njerëzit që nuk punojnë mirë, kjo do të thotë se zbatojmë si duhet vijën e Partisë. Në të kundërtën, po të kënaqemi me pak, po të na mbulojë euforia, do të humbasim vigjilencën. Vetëkënaqësia dhe mungesa e vigjilencës na kanë shkakuar kurdoherë rreziqe. Është krijuar mendimi që uniteti në udhëheqje është i shëndoshë. Kjo është e vërtetë, por nuk do të thotë që brenda në udhëheqje nuk na kanë dalë edhe tradhtarë, armiq të betuar të Partisë. Sikur ne t'i kishim kontrolluar më mirë këta njerëz, pra, sikur të kishim zbatuar me këmbëngulje parimin e drejtë që shokun ta besojmë, por edhe ta kontrollojmë, atëherë do t'u kishte dalë boja me kohë këtyre armiqtë. Kjo që po them është vërejtje për

ne këtu, por vlen edhe për ju në rrethe e në bazë, sepse Beqir Balluku ahengjet dhe paturpësitë e tij nuk i bënte këtu me ne, por atje poshtë. Ne nuk dinim për këto punë të liga që bënte ai. Njëherë që u njoftuam për diçka, e bëmë për ujë të ftohtë. «Ku është Beqir Balluku?», pyetnim ne, «kontrollon repartet», na thoshin. Kurse ai shkonte nga ahengu në aheng dhe hartonte plane për të rrëzuar pushtetin. Të kuptohemi se, kur flasim që vigjilenca duhet të jetë kudo, është fjala për vigjilencën revolucionare e jo për dyshime të kota të formuara andej-këtej, që krijojnë situata të vështira e të paqena.

Njerëzit e tepërt, që kanë mbushur zyrat kot, duhet t'i çojmë ku mund të japin më shumë për ndërtimin e socializmit. Një ditë pyeta se ç'po bëhet me kuadrot që janë shkurtuar nga aparatet e qendrës. Pyeta, se më duket që shpërndarja e funksionarëve, sidomos këtu në Tiranë, po bëhet në mënyrë burokratike. Pasi vendosen shkurtimet, thuhet: «Pesë kuadro t'i marrë rrethi i Gjirokastrës, pesë t'i vëmë në dispozicion të rrethit të Dibrës, pesë të tjerë t'ia japim Vlorës, pesë t'i dërgojmë këtu e pesë atje!». Kjo lëvizje e kuadrit nuk mund të bëhet pa pyetur rrethin se në ç'drejtime ka më tepër nevojë. Kur të merret përgjigjja e rrethit, se është ngushtë, për shembull, për kryetar kooperative, për një drejtor banke, për një inxhinier mekanik etj., atëherë të bëhet edhe lëvizja. Nuk mund t'i thuhet rrethit: «Na, merrni këta!». Ku t'i çojë rrethi ata kuadro që i dërgohen pa i marrë mendimin paraprak për nevojat që ka?



Prandaj, ju shoku Haki [Toska]<sup>1</sup> dhe ju shoku Petro [Dode]<sup>2</sup> duhet të bisedoni me shokët e Qeverisë për të bërë një studim rigoroz e me kritere të shëndosha lidhur me shkurtime të bëhen.

Ka disa ditë që më është dërguar një listë nga Kryeministria për shkurtime në rrethe. Aty shënohej se kaq do të shkurtohen në këtë rreth, kaq në atë e aq në tjetrin. Duke lexuar, thashë me vete: «Mirë që do të bëhen këto shkurtime, por duhet treguar kujdes se mos hiqen disa kuadro të mirë të rrethit për t'u liruar vendin shokëve që vijnë nga Tirana!?!». Pse të shkarkohet nga detyra, për shembull, një drejtor në rreth, kur ka punuar mirë dhe nuk shihet me vend të qarkullojë? Ose, nuk do të ishte e pëlqyeshme, gjithashtu, që një kuadër, i cili që zëvendësministër ose drejtor në një ministri, të shkojë në rreth e të vendoset në një punë të thjeshtë zyre. Si do të kalitet kështu ky njeri? Që të mos ndodhë ky fenomen, e përsëris, çështja duhet studiuar në marrëveshje me rrethin, të cilit t'i thuhet se shoku që po dërgojmë është i profilit që ju keni nevojë, për shembull, është ekonomist, dhe ka punuar mirë, ka këto cilësi, mund të bëjë këtë dhe atë punë. Këtë karakteristikë e dërgon qendra e punës prej nga del ky kuadër, siç është, bie fjala, ministria ose një institucion tjetër qendror. Qendra duhet ta shoqërojë medoemos kuadrin me një karakteristikë, bile shumë të detajuar, duke bërë edhe rekomandime që kuadri, mundësisht, të vihet në njërën nga këto ose ato detyra.

---

1, 2. Në atë kohë sekretarë të KQ të PPSH.

Kjo është një punë e paqme, ndryshe nuk do të vepronhet mirë.

Po na vijnë lajme që vërtetojnë veprime të nxituara dhe ekstreme ndaj disa kuadrove. Një inxhinier vërtet mund të ketë bërë ndonjë gabim në punë ose në jetë, por Partia nuk thotë që këtij t'i pritët koka, ose t'i ndërrohet profili, pse bëri një gabim që nuk e justifikon ndëshkimin e rëndë. Inxhinierit që gaboi, nuk mund t'i thuhet: «Shko e puno me kazëm!», kur atij mund t'i jepet edhe një punë tjetër e përshtatshme në profesionin e tij, duke e ndihmuar politikisht që të përmirësohet dhe duke e kontrolluar. Prandaj duhet të bëhet një punë e kujdesshme. Veprimet në trajtimin e kuadrove dhe të të gjithë punonjësve duhet të kryhen me urtësi, në vijë partie, pa lejuar që të shkaktohen shqetësime dhe alarmime të kota.

Ne kemi informata që në ndonjë rreth po përgatiten lista me emra njerëzish, të cilët mendojnë t'i pushojnë nga punët që kryejnë, si «të papërshtatshëm». Dhe «për të argumentuar» këtë qëndrim, fillojnë nga origjina e gjyshit e stërgjyshit dhe dalin tek ata, që kanë një aktivitet shoqëror e politik shumë të mirë. Si është e mundur që, pasi e kanë mbajtur 17 ose 20 vjet në Parti një njeri që punon mirë, t'i thonë: «Meqenëse rrjedh nga një familje e pasur, do të të përjashtojmë nga Partia!». Si u përjashtoka nga Partia një njeri, kur gjatë 17 vjetëve veprimtarie si komunist, si inxhinier i dalluar, ka treguar se është besnik i Partisë dhe i popullit? Si mund të përjashtohet ky nga

Partia, vetëm sepse rrjedh nga një familje e pasur, kur asnjë nga familja e tij nuk është i dënuar për ndonjë veprimtari armiqësore dhe kur ai nuk ia ka fshehur Partisë origjinën e tij?

Ka edhe rrethe që kanë hartuar lista me 50 emra arsimitarësh e arsimtaresh, të cilat kanë nga 20 e ca vjet që punojnë dhe duan t'i pushojnë nga puna se «u mungojnë kushtet e nevojshme për të edukuar brezin e ri». Pas Çlirimit këta mësues e mësuesc kanë qenë të rinj e të reja, kanë bërë pjesë në organizatën e rinisë dhe kanë edukuar me mijëra të rinj e të reja. Të kërkosh pushimin e tyre nga puna tani, kur njëri ose tjetri është në prag të pensionit, ky është një qëndrim sektar, në këtë rast më i dënueshëm nga liberalizmi, sepse krijon shqetësime të panevojshme. Partia këto gjëra duhet t'i shikojë me mend. Ata që kanë bërë gabime, të ulen në përgjegjësi, ata që kanë fshehur origjinën e tyre dhe, natyrisht, për këtë qëndrim janë fajtorë, të shikohen. Këta, sipas rastit, mund të ulen nga vendi ose përgjegjësia që u është dhënë pa të drejtë, por jo t'i hedhim rrugëve. Edhe kur largohet njeriu nga detyra që kryen, sepse i mungojnë kushtet politike, duhet të sqarohet duke i thënë: «More shok, kjo është luftë klasash, ne kemi respekt për ty si person, por në këtë punë nuk të mbajmë dot. Ne bëmë gabim kur të morëm në këtë punë, por edhe tani ne nuk po të hedhim poshtë». Duhet të bëjmë kujdes në këto gjëra, shokë, të mendojmë e të veprojmë kurdoherë duke zbatuar drejt vijën e Partisë.

Shpesh ndodh që, kur ndonjëri me më shumë përgjegjësi vepron shtrembër ndaj vartësit, të tjerët, edhe kur e kuptojnë padrejtësinë, heshtin! Pse? Që të mos akuzohen se mbrojnë një njeri që «nuk është shumë i mirë». Jo, të ngrihesh e të flasësh të drejtën, duke theksuar se nuk është e vërtetë ajo që ngre dikush, dhe të vësh në dukje se ato që thuhet për dikë janë tendencioze, të ckgagjeruara etj., kjo është detyrë e ndershme për cilindo. Pra, për të tilla gjëra duhet me pasë kurajë prej komunisti e patrioti. Në këto situata ngrenë krye clementët oportunistë, që shtrembërojnë vijën e Partisë, duke rënë në majtizëm. Ka edhe konformistë e indiferentë të tillë që në këto raste heshtin, duke menduar: «Ç'më duhet mua të flas derisa sekretari i organizatës-bazë ose shefi i repartit e trajtoi problemin ndryshe? Ç'më duhet mua të ngrihem e ta mbroj këtë njeri për të cilin ka rrezik të më akuzojnë se e përkrah?». Këto qëndrime janë shumë të dëmshme. Secili, duke thënë të vërtetën e duke arsyetuar me logjikë partie, duhet të jetë i ndërgjegjshëm se mbron vijën e Partisë dhe nuk mbron atë që paska një njeri të lig në fis. Porosia e Partisë është që të metat duhet t'ia vëmë në dukje secilit. Kur është rasti për këto të meta, cilido mund të zbritet nga përgjegjësia, por asnjë nuk mund të ndëshkohet kur nuk e meriton ndëshkimin. Këtë guxim, për të mbrojtur të vërtetën dhe vijën e Partisë, duhet ta kemi kurdoherë, se, po nuk patëm guxim, atëherë do të krijohet një konfuzion i madh.

Këto kisha për të thënë. Ju përgëzoj për sukseset që keni arritur dhe ju uroj punë të mbarë!

*Botuar për herë të parë, me disa shkurtime, në librin: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1974-1975», f. 207*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH, që gjendet në AQP*

**PARTIA DHE SHTETI I DIKTATURËS  
SË PROLETARIATIT MBROJNË KURDOHERË  
INTERESAT E POPULLIT DHE TË SOCIALIZMIT**

*Fjala e mbylljes në Plenumin e 7-të  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

29 maj 1975

Të dashur shokë dhe shoqe,

Duke u bazuar në punimet e këtij Plenumi të rëndësishëm të Komitetit Qendror për naftën, duke pasur parasysh diskutimet dhe vendimet e mbledhjeve të Byrosë Politike për këtë çështje, ku edhe unë kam folur dhe ju jeni në dijeni, dëshiroj të shfaq rëndimet e mia jo vetëm për çështjen e naftës, por edhe për një sërë problemesh të tjera që gjithnjë Partia është duke i diskutuar dhe duke i zgjidhur me sukses.

---

1. Ky Plenum. që i zhvilloi punimet në datën 26-29 maj 1975, diskutoi rreth raportit të Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi disa konkluzione dhe detyra që na dalin nga analiza e punës armiqësore e sabotuese në industrinë e naftës», mbajtur nga shoku Haki Toska.

Duke studiuar protokollet e mbledhjeve të Kryesisë dhe të Këshillit të Ministrave për të metat e gabimet që janë vërtetuar në aparatet shtetërore dhe në disa sektorë të ekonomisë, ku janë zhvilluar shumë burokratizmi e teknokratizmi, që na kanë çuar në mbylljen e syve deri në sabotime të rënda, siç është ai i naftës, konstatoj se, krahas Mehmet Shehut, i cili ka përgjegjësinë e tij për këtë, nga disa ministra autokritika në përgjithësi është e sipërfaqshme dhe kritika në mes tyre e druajtur dhe e përmbajtur. Te shokët e mësipërm dhe te disa të tjerë më duket se druajtja vjen nga komprometimi në fajin ose në gabimin dhe në këto raste nga ata që kanë kryer gabime dhe faje të rënda, si Abdyl Këllezi dhe Koço Theodhosi, bëhen orvatje që faji të shpërndahet, duke thënë: «Të kam pyetur», «të kam vënë në dijeni», «vendimin e kemi marrë tok» etj.

Natyrisht, njerëzit që vuajnë nga disa komplekse, nuk u rezistojnë si duhet këtyre stratagjemave<sup>1</sup>. Autokritika e disa shokëve të Qeverisë nuk është sa duhet e thellë politikisht dhe ideologjikisht, theksi nga ana e tyre vihet më tepër në raportimin teknik të çështjeve dhe këndej bëhen përpjekje për njëfarë autokritike, që s'del nga kuadri teknik i problemit.

Ata vënë në dukje rrezikshmërinë e zhvillimit jo-normal të një sërë çështjesh, por largohen nga thellimi i problemeve dhe nuk shohin pasojat politiko-ideologjike të këtij zhvillimi. Kështu bën, për shembull, Abdyl Këllezi për ato që thotë; ai duhej t'u përgjigjej në mble-

---

1. Dredhi.

dhjen e Qeverisë një sërë pyetjeve, duhej të bënte autokritikë serioze e jo të dredhonte, duke iu përgjigjur shkarazi vetëm pyetjeve.

Shokët, natyrisht, thonë se i vret edhe ndërgjegjja. Kjo është e kuptueshme, po jo e mjaftueshme. Një analizë ideologjike të këtyre problemeve në vetvete dhe të shtrembërimeve që janë vërtetuar tek Abdyl Këllezi e Koço Theodhosi, nuk shoh të bëhet si duhet. Kjo ka rëndësi të madhe të kryhet, ndryshe shtrembërimet dhe devijimet do të përsëriten, siç po përsëriten.

Duhet të dalim me konkluzionin se ka shokë, dhe kjo është më e keqe, që hiqen sikur ideologjikisht dhe politikisht i kuptojnë të gjitha gjërat. Por kjo nuk është kështu në shumë raste. Punët na vërtetojnë se problemet i vëmë në binarë të drejtë, por ka njerëz që duan dhe luftojnë t'i devijojnë dhe që mendojnë se edhe teorinë, edhe politikën e problemit e kanë të qartë një herë e përgjithmonë, kurse për anën organizative, që ka edhe kjo një rëndësi të madhe, ata thonë: «Jemi specialistë të mbaruar» për këtë çështje. Këto që po them i vërtetojnë ndodhitë e njëpasnjëshme që po analizojmë.

Më 1966 morëm masa politike, shpjeguam «ideologjikisht thellë» dhe organizuam punët «aq mirë», sa që u kujtua se u kuptua me baza ç'është burokratizmi dhe si duhet luftuar ai. Mirëpo faktet vërtetojnë se nga disa asgjë nuk ishte kuptuar dhe organizuar si duhej. Pas atij operacioni, që u konsiderua i rëndësishëm, ç'na rezultoi? Diçka shumë më e rëndë, shumë më e rrezikshme. Dhe pse shumë më e rrezikshme? Sepse kjo ndodhi pas operacionit të parë që u tha se u kuptua



rrezikshmëria e burokratizmit, të cilët po i vihej fre. Mirëpo, në fakt, ky fre ishte prej kashte dhe më në fund u hoq fare. Pse? Po na thuhet: «Na shkau nga dora, s'e parashikuam, u entuziazmuam» etj.

Jeta vërtetoi se rreziku i burokratizmit jo vetëm që politikisht dhe ideologjikisht nuk ishte kuptuar, por nga disa u morën masa të atilla organizative që të fryheshin aparatet, që burokratizmi të bëhej një gangrenë në administratat drejtuese të ekonomisë, të tregtisë, të Komisionit të Planit të Shtetit, të kulturës, të ushtrisë etj., të bëhej kështu një gangrenë për shtetin.

Njerëzit që hiqen sikur i dinë këto gjëra edhe teorikisht, edhe politikisht, në fakt nuk dinë mirë ç'është shteti i proletarëve, ç'është demokracia e proletariatit dhe ç'është, nga ana tjetër, administrata shtetërore, nuk i kuptojnë teorikisht rëndësinë e njërës dhe të tjetrës, lidhjet dhe vartësitë në mes tyre, por këta njerëz arrijnë në konkluzionin e gabuar teorik të identifikojnë administratën me shtetin. Sipas tyre, po përmende termin administratë, me këtë duhet nënkuptuar shteti i proletarëve dhe këndej është fare lehtë të kalohet në praktikën që administrata të sundojë mbi shtetin dhe jo shteti mbi administratën.

Shteti i proletarëve, diktatura e proletariatit, nuk është vetëm administrata, por, në radhë të parë, është pushteti shtetëror i klasës punëtore ngadhënjimtare në revolucionin socialist që udhëhiqet nga Partia. Ky shtet ekziston për të shtypur armiqtë e klasës punëtore.

Këtë gjë e kemi kuptuar, thonë. Jo, nuk është plotësisht kështu, derisa nuk kuptohet dhe nuk ushtrohet

si duhet nga ana e klasës punëtore dhe e masave të gjera të popullit pjesëmarrja aktive dhe e drejtpërdrejtë në qeverisjen e vendit, duke përfshirë sferën legislative dhe ekzekutive në tërë gamën që ka përcaktuar Partia, që bazohet në leninizmin; në qoftë se këshillat popullorë nënvleftësohen dhe lihen formalë; në rast se në aparatet nuk vijnë njerëz të klasës dhe të masave punonjëse, ku të punojnë me temp revolucionar; në rast se çdo gjë nuk kontrollohet sipas normave të demokracisë proletare. Në qoftë se ne nuk do të mbështetemi fort në të gjitha tezat leniniste për këto probleme kapitale, atëherë mund të futemi në rrugën oportunisto-liberale. Nuk mjafton vetëm të flitet me terma marksistë dhe në praktikë të lejohet të zhvillohen pikëpamje borgjeze, liberale, revizioniste. T'i themi hapur këto mendime, të mos na vijë rëndë, t'i thellojmë ideologjikisht këto çështje, pse ka shokë që nuk i kuptojnë dhe s'bëjnë përpjekje t'i kuptojnë, prandaj thonë: «Na vret ndërgjegjja» dhe mjaftohen me kaq.

Çështja e shtetit është një problem kapital për Partinë dhe ka shumë rëndësi për klasën punëtore. Kuptimi i drejtë i rolit dhe i funksioneve të shtetit socialist është një çështje teorike e dorës së parë. Duhet ta kuptosh atë mirë teorikisht, që të mund të veprohesh drejt edhe në praktikë.

Deformimet teorike të fuqisë shtetërore të çojnë në një numër qorrësokaqesh që Marks, Engelsi dhe Lenini i kanë theksuar me forcë, duke demaskuar deri në fund rrymat antimarksiste për shtetin. Për ne komunistët dhe për klasën punëtore duhet të jetë e ngulitur mirë në

kokë teoria marksiste-leniniste për shtetin. Të ruhemi nga deformimet mikroborgjeze, anarkiste, liberale etj. për teorinë tonë bazë. Ka njerëz që shumë herë hiqen sikur e njohin si duhet këtë çështje, por praktika ka vërtetuar shpesh boshllëqet në kuptimin e saj.

Ne dimë që shteti, në përgjithësi, është një organ i sundimit klasor, ai, siç thotë Engelsi,

*«... është produkti i shoqërisë në një shkallë të caktuar të zhvillimit»<sup>1</sup>.*

Klasa jonë punëtore, në aleancë me fshatarësinë, fitoi me luftë dhe me violencë mori pushtetin, ua rrëmbeu atë çifligarëve e borgjezisë dhe, mbi gërmadhat e shtetit të vjetër feudo-borgjezo-fashist, krijoi shtetin e saj, diktaturën e proletariatit, që është një shtet, një forcë speciale për shtypjen e klasave shfrytëzuese nga klasat e të shfrytëzuara. Kjo diktaturë e proletariatit krijon edhe aparatit e fuqisë së shtetit.

Shteti, pra, siç na mësojnë klasikët tanë, është organizimi i violencës për zhdukjen e klasave të shfrytëzuesve. Shteti do të thotë proletariati i organizuar në klasë sunduese<sup>2</sup>. Këtë mendim të madh të Marksit e kemi zbatuar në jetë dhe duhet ta kuptojmë thellë. Të kuptojmë mirë se klasa punëtore organizon edhe mjetet për ta ushtruar violencën kundër armiqve të saj dhe në

1. K. Marks e F. Engels, «Vepra të zgjedhura», vëll. II, Tiranë, 1975, f. 339.

2. Shih: K. Marks e F. Engels, «Vepra të zgjedhura», vëll. I, Tiranë, 1975, f. 42.

interes të punonjësve, që do të thotë në interesin e gjithë popullit.

Derisa ekziston shteti, të kuptohet qartë se antagonizmat e klasave janë të papajtueshëm dhe nga kjo është e domosdoshme të kuptojmë si duhet rolin revolucionar të proletariatit, i cili është organizuar në një klasë sunduese, që do të thotë shteti.

Po insistoj në këto parime marksiste-leniniste për rolin e proletariatit dhe të diktaturës së tij, sepse në praktikë po na shpëtojnë deformime në kuptimin dhe në zbatimin e prerogativave të saj.

Po të marrim kuptimin teorik dhe praktik të funksionarëve të aparateve të shtetit, do të konstatojmë se ka funksionarë, si pjesëtarë të organeve të shoqërisë, që disa herë vihen mbi shoqërinë, mbi klasën; këta harrojnë se shoqëria dhe klasa janë mbi ta.

Është gjetur si diçka e drejtë, edhe teorikisht, edhe praktikisht, që funksionarët e lartë dhe të mesëm të shtetit e të aparateve të marrin rroga të larta. Po pse?

Mësuesit tanë të mëdhenj, Marksi e, më pas, Lenini, kanë vënë në dukje se diferencat në paga duhet të jenë të vogla. Këtë mësim të vlefshëm për pagat oportunistët e kanë konsideruar si një kërkesë të demokracisë primitive. Duke polemizuar me oportunistët për këtë gjë, Lenini thotë:

*«... ish-socialdemokrati Ed. Bernshtajn, kushedi sa herë i ka përsëritur qesënditë banale borgjeze në lidhje me demokratizmin «primitiv». Si gjithë oportunistët, si dhe kautskianët e sotëm,*

*ai nuk e ka kuptuar fare, së pari, se kalimi nga kapitalizmi në socializëm nuk mund të bëhet pa njëfarë «rikthimi» në demokratizmin «primitiv» (sepse ndryshe si mund të kalohet në kryerjen e funksioneve të shtetit nga shumica e popullsisë dhe nga gjithë popullsia pa përjashtim?)...»<sup>1</sup>.*

Këto mësimë u harruan fare në Bashkimin Sovjetik, veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore.

Po edhe te ne, në Shqipëri, ka mbetur njëfarë fryme dhe mentaliteti i gabuar, sipas të cilit «fungsionarë të shtetit duhet të jenë vetëm ata me shkollë të lartë, ata duhet të drejtojnë dhe të kenë rrogat më të larta». Kjo është në kundërshtim me atë që thotë Lenini. Ne i kemi dhënë arsim, qoftë edhe të mesëm, një shumicë të madhe punëtorësh që mund të drejtojnë fare mirë çfarëdo pune shtetërore me një pagë normale të punëtorit<sup>2</sup>, prandaj të zhdukim mentalitetin e kastës së njerëzve të privilegjuar, në mes të të cilëve kultivohen prepotenca dhe arroganca, prirja që aparatet të vihen mbi shtetin e të marrin kështu nëpër këmbë parimet marksiste-leniniste dhe normat e Partisë.

Ne flasim kundër burokratizmit, por janë këta njerëz që e ushqejnë këtë të keqe; ne flasim kundër vënies së interesit personal mbi interesin e përgjithshëm, por me diferencat e mëdha të rrogave e nxitim

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 25, f. 497.

2. Shih: V. I. Lenin, Veprat, vëll. 25, f. 497-498;

këtë interes personal; ne flasim kundër arrogancës dhe prepotencës, por hierarkia në administratat shtetërore (jo në funksionet organizative dhe në detyrat, por në rrogat e larta dhe në kuptimin mikroborgjez për vendin që mbahet në administratë) i krijon këto; ne flasim për mendjemadhësinë e njerëzve, por duhet të dimë se këtë e ushqen edhe mendimi borgjez i epërsisë në shoqëri dhe në pushtet i «njerëzve të mësuar». Të gjitha këto pikëpamje e të tjera të tilla spikatin në mjaft nga nëpunësit tanë që luftojnë për pozita në shtet, për rroga të larta, që luftojnë të ngjiten dhe zemërohen kur ulen në përgjegjësi, që e kanë shumë zët transferimin, qarkullimin dhe punën në bazë e konsiderojnë si një ofendim, si një padrejtësi, sikur puna dhe prodhimi i madh nuk janë në fabrika ose në fusha, por në ministri apo në zyra.

Të gjitha këto botëkuptime filozofike jo të drejta, natyrisht, duhen ndrequr me një edukatë të shëndoshë politike dhe ideologjike, por kjo edukatë, po nuk u shoqërua edhe me masa praktike, nuk ka vlerë. Teoria duhet të gjejë zbatim në jetë.

Lenini na thotë se pushimi i atyre që s'e kryejnë detyrën, heqja e cilitdo funksionari që nuk kryen si duhet punën,

*«... ulja e rrogës së tyre në nivelin e një «page të barabartë me atë të punëtorit» të zakonshëm, këto masa demokratike të thjeshta dhe «që kuptohen vetvetiu», duke bashkuar*

*plotësisht interesat e punëtorëve dhe të shumicës së fshatarëve, shërbejnë njëkohësisht si urëz që çon nga kapitalizmi në socializëm»<sup>1</sup>.*

Gjithë këto aparate të fryra shtetërore dhe të kooperativave bujqësore, me këto mentalitete dhe botëkuptime që krijojnë te njerëzit, u kushtojnë shumë shtrenjtë nga ana politike dhe ekonomike shoqërisë sonë, punëtorëve dhe fshatarëve. Këto dy klasa mike, që janë baza shoqërore e shoqërisë sonë, të jemi më se të sigurt se janë në kundërshtim me aparatet e fryra dhe të kushtueshme. Ato duan aparate revolucionare, kompetente, që ne i kemi krijuar, por i kemi fryrë, pa llogaritur as botëkuptimin e sëmurë që krijojnë stimujt, ditët e punës për gjëra pa bukë në kooperativa, orët pa punë në fabrika, lejet për të dhënë provimet ose për t'i marrë ato dhe për të mos i dhënë fare këto provime etj. Të gjitha këto janë bërë me lehtësi në kurriz të shoqërisë, sikur shteti ynë i proletarëve të notonte në bollëk. Dyqanet ia kemi çuar popullit deri te dera e shtëpisë dhe prapë ka njerëz që qahen, i kemi fackosur ato me shitëse, të cilave ua kemi shtuar përqindjet e të ardhurave, gjoja që të mos vjedhin, kurse ato që duan të vjedhin, prapë do të vjedhin, po të mos ushtrohet kontroll nga masat dhe nga shteti. Prura një shembull në mes shumë të tjerëve, por ka gjëra edhe më serioze se këto. Prandaj, pa hezituat, çështjet që s'janë drejt, t'i vëmë në rrugë të drejtë.

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 25, f. 493

Lenini thotë:

*«Ne nuk jemi utopistë. Ne nuk «ëndërroj-  
më» se si mund të bëjmë menjëherë pa asnjë  
qeverisje, pa kurrfarë nënshtrimi; këto ëndrra  
anarkiste... janë të huaja për marksizmin...»<sup>1</sup>.*

Edhe ne komunistët shqiptarë duhet ta kemi adminis-  
tratën të zhdërvjellët dhe të pastër, ashtu si porosit  
Lenini, pse ajo i nevojitet diktaturës së proletariatit për  
të ndërtuar socializmin, për të shtypur armiqtë e kla-  
sës, frymën dhe ideologjinë e tyre. Çështja, thotë Lenini,  
qëndron në atë se është e domosdoshme që çdo gjë  
dhe të gjithë

*«... duhet t'i nënshtrohemi pararojës së arma-  
tosur të të gjitha masave të shfrytëzuara dhe  
punonjëse — proletariatit»<sup>2</sup>.*

Lenini na këshillon ta zhdukim dhe ta zëvendësojmë  
«hierarkinë» specifike të nëpunësve të shtetit me dety-  
rën e thjeshtë të «rojtësit dhe të kontablit», funksione  
këto që çdo njeri është në gjendje t'i kryejë.

*«... ne, punëtorët, — thekson Lenini, — duke  
u mbështetur në eksperiencën tonë si punëtorë,  
duke krijuar një disiplinë të hekurt sa më të  
rreptë, të përkrahur nga pushteti shtetëror i*

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 25, f. 503.

2. Po aty.



*punëtorëve të armatosur, t'i bëjmë nëpunësit e shtetit zbatues të thjeshtë të direktivave tona, «mbikëqyrës dhe llogaritarë» që duhet të jenë përgjegjës, të zëvendësueshëm dhe të paguhën në mënyrë modeste (sigurisht, duke mbajtur teknikët e të gjitha kategorive, llojeve dhe shkallëve të ndryshme) — ja detyra jonë proletare, ja nga se mund dhe duhet të fillojmë. . .»<sup>1</sup>.*

Duke u mbështetur në mësimet e klasikëve tanë, që përbëjnë një thesar të madh, të pashtershëm, të pazbuluar sa e si duhet nga ne dhe të pazbatuar me këmbëngulje, del detyrë t'u futemi thellë të gjitha këtyre problemeve që po analizojmë dhe të mos i konsiderojmë si çështje thjesht teknike. Të mos luftojmë burokratizmin me forma dhe metoda burokratike, por të kuptojmë mirë, në radhë të parë ne, dhe t'ua bëjmë të qartë edhe të tjerëve, rëndësinë politike dhe ideologjike të problemeve dhe shembullin më parë ta japim ne se i kemi kuptuar ato dhe i kemi zbatuar drejt në jetë.

Kur bëhen gabime, disa thonë: «Na vret ndër-gjegjja». Po pse? Kjo nuk shpjegohet thellë. Po pse nuk shpjegohet? Sepse ai që ka gabuar s'guxon të thellohet në shkaqet e vërteta të gabimit, se ai nuk ka marrë mundimin të studiojë thellë leninizmin dhe vepren e Partisë sonë. Dhe ka nga ata që tregohen shumë fodullë në këtë drejtim, domethënë në «pjekurinë e tyre politike», derisa nuk u ka dalë kallaji.

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 25, f. 504.

Abdyl Këllezhi hiqet si «ekonomist i madh», por si marksist ai është shumë i dobët, bën gabime shumë të rënda. Derisa atij «i kanë shpëtuar këto gjëra», sikurse deklaroi vetë, ai ka dëmtuar ekonominë, ai nuk është ekonomist i mirë, pse nuk i kupton çështjet politikisht drejt, pse ideologjikisht jo vetëm është i përciptë, por i shikon edhe gabim, derisa lejon dhe ndihmon rrugën oportuniste, liberale e revizioniste të depërtojë në aparatet e shtetit.

Janë vërtetuar, në fakt, faje në këto drejtime, të cilat anëtarë të tjerë të Qeverisë, anëtarë të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë dhe sekretarë të Partisë të rretheve kanë bërë gabim që të tilla prirje nuk i kanë luftuar me kohë. Është e vërtetë se shumë gjëra nuk kuptohen drejt prej tyre: nga një sektarizëm i tepruar, nga një centralizëm burokratik i rreptë, kallojnë në një liberalizëm dhe në një decentralizëm burokratik të shfrenuar. Të tilla luhatje, që e kanë burimin në moskuptimin si duhet të teorisë së Partisë dhe të politikës së saj, nuk flasin për pjekuri marksiste. Po të thellohej autokritika në këto çështje dhe t'u bëhej një analizë e shëndoshë ideopolitike shkaqeve dhe pasojave të prirjeve negative, atëherë me të vërtetë «do ta vrasë ndërgjegjja» atë që ka gabuar.

Partia na ka besuar vende të rëndësishme, prandaj çdo gjë që bëjmë ta mendojmë mirë, por të mos kujtojmë se pa ne shteti i proletarëve nuk mund të ecë përpara. Me njerëz të sëmurë dhe të pazotë, në rast se i lë të livadhisin, ky shtet mund të dobësohet dhe të shkatërrohet. Po pse mund të shkatërrohet? Disa mund të

thonë: «Çfarë pyetje!? Këtë kush nuk e di?». E dinë, por jo të tërë e dinë dhe nuk luftojnë të tërë si duhet kundër të tillë njerëzve. Atëherë duhet t'ua themi: Të sëmurët duhet të shërohen, duke ua vënë hapur në dukje fajet e tyre, t'i shërojnë Partia dhe klasa, por t'i shërojnë seriozisht, t'i dërgojnë në «spitale» dhe të sjellin në vend të tyre njerëz të shëndoshë nga çdo pikëpamje.

Ky kontroll i sëmundjes dhe i të sëmurëve nuk duhet lejuar të bëhet i përciptë vetëm nga disa zyrtarë, nga drejtori ose shefi i kuadrit, por nga gjithë Partia, përpara gjithë Partisë, klasës dhe masës së punonjësve. Deri tash disa zyrtarë të mëdhenj dhe të mesëm të sëmurë i kanë shpëtuar në njëfarë mase «dajakut», siç quan Lenini shtetin e proletarëve. Kemi demaskuar dhe kemi dënuar plot armiq dhe kryesorë, por shumë njerëz të tjerë, që kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë gabime, shumë funksionarë që nuk punojnë ose që punojnë keq, i lëmë të drejtojnë, të zvarriten. Pse? Duhet të njohim një të keqe të madhe: këtu ka komprometim dhe sentimentalizëm të sëmurë. Duhet prerë me shpatë ky «komb gordian». Këta të komprometuar, liberalë, oportunistë e karrieristë diktaturën e proletariatit e konsiderojnë si «një republikë shokësh» dhe kështu këta «gjeneralë» civilë mendojnë se bëhen të paprekshëm.

Kiço Ngjela është bërë një i tillë. Ç'nuk janë mbledhur në Ministrinë e Tregtisë ku drejton ai! Pesë nëpunës kryesorë dhe jo të shëndoshë të asaj ministrie kanë gra të huaja, sovjetike etj. A nuk është e habitshme që këta i mban Kiço Ngjela në tregtinë e jashtme? Pse i mban dhe i mbron Kiço Ngjela këta njerëz?

E dini ç'i tha Vasil Kati, ndihmësi kryesor i Kiço Ngjelës, Lipe Nashit, kur ky u pushua dhe ishte në pragun e arrestimit? «Mos u mërzit, se të marrim ne në Ministrinë e Tregtisë». «Ky ministri ynë (Kiço Ngjela), vazhdoi t'i thoshte Vasil Kati Lipe Nashit, i mbron kuadrot e ministrisë, kurse ai juaji (Koço Theodhosi) nuk i mbron». Ky është mendimi i Vasil Katit, por në fakt që të dy ministrat i mbrojnë kuadrot e tyre edhe kur s'duhën mbrojtur.

Me gjithë dënimet që iu dhanë Lipe Nashit, vete Zenel Hamiti dhe i thotë: «Pse mërzitesh, do të të emërojmë drejtor të Rafinerisë së madhe të Ballshit». I venin edhe në shtëpi dhe e mbanin me «gajret» këtë armik, këtë sabotator!

Pse tentojnë të na e fshehin, siç bëri Koço Theodhosi, pjekjen misterioze me Pirro Gushon e Lipe Nashin, kur ky i fundit u kthye nga Gjermania Perëndimore? Pse vajti Lipe Nashi në Gjermani? Pse caktuat Lipen dhe jo ndonjë specialist? Më parë, siç na tha Koçoja këtu, kishin vajtur 4-5 specialistë të tjerë për atë problem, të cilët bënë dhe tratativat për çmimin. Pastaj ju i thatë Lipe Nashit: «Shko ta blesh ti!». Këtë deshëm të dinim ne: Pse e dërguat Lipe Nashin, kur atë pajisje mund ta blinte dhe specialisti? Ç'do të na thoni për dy inxhinierët që kanë vajtur jashtë të shoqëruar nga njerëzit e firmave perëndimore dhe shoqëritë e huaja u kanë hapur dyert këtyre «bukuroshëve» tanë dhe u kanë treguar se si i bëjnë pusët në thellësi të mëdha? Po për atë rastin e «specialistit» tjetër të huaj, i cili tha që të shfrytëzojmë gëlqerorët, dhe që pasi Lipja ta tho-

të ty, ti jep urdhër që të zbatohet porosia e tij?!

Ti, Koço, je anëtar i Byrosë Politike. Kështu i kupton e i zbaton vendimet e Partisë? Kështu, në tymb, i dëgjon gjërat që të thuhet? Nuk mund të na i thonë dhe të na i analizoni një çikë qëllimet e errëta dhe misterioze të këtyre takimeve? Këto qëndrime të dyshimta të mos na i mbyllni kalimthi me një «e kam ndërgjegjen të vuarë».

Kur Partia i vë në vendin që meritojnë këta njerëz fajtorë, se Partia çdo gjë e zbulon, të tillë shokë rrinë me buzë varur, si të persekutuar, sikur janë bërë «gabime fatale» kundër këtyre «kokave të mëdha», në vend që të pohojnë haptazi fajet e tyre, të venë në Parti e në popull dhe t'u thonë hapur atyre: «Kam gabuar rëndë», «Partia më dha një dënim të merituar».

Unë them që qëndrimet e tua, Koço, kanë ndihmuar në veprimtarinë armiqësore. Ti na thua se armiqët kanë përfituar nga gabimet e tua. Njëra nga të dyja: gabimet e tua kanë ndihmuar, apo s'kanë ndihmuar në veprimtarinë armiqësore? Ti këtë duhet ta thuash hapur.

Ne në Gjirokastrë kemi një fjalë: «Jo ve, po kokove». Ti Koço mund të thuash që «unë nuk i kam këshilluar ata që të sabotojnë». Koçoja e kërkon këtë nuancë, prandaj shprehet që nuk i ka thënë me gojë atij e këtij: «Oburra, vini kazmën!». Kuptojeni këtë nuancë! Koçoja kërkon të tregohet shumë finok, kujton se e shpëton kërkitimi i këtyre formulimeve! Por jo, nuk e shpëton! Ky qëndrim e fut edhe më thellë atë, sepse të jesh

anëtar i Byrosë Politike dhe ministër i Industrisë, drejtues për naftën, në këtë sektor me rëndësi të madhe të ekonomisë, dhe të bësh gabime të rënda, gabime kolosale, të mos zbatosh vijën e Partisë, të mos kontrollosh e ta lësh naftën në fatin e disa banditëve dhe të kërkosh nuancën e një fjale për të kaluar «fësht», kjo të fut më thellë brenda ty, Koço! Prandaj, si konkluzion, ti je bashkëpunëtor i sabotatorëve të naftës, apo i ke ndihmuar qorrazi?!

Sipas teje, ti ke vepruar qorrazi. Atëherë shtrojmë çështjen: Kaq naiv je ti që nuk i merrke vesh e nuk i kuptoke fare këto çështje të naftës?! Në qoftë se ishe kaq naiv, duhej të vije të thoshe: «Amani more shokë, më hiqni që këtej, se nuk jam për këtë punë». Ti këtë nuk e bërë, por përkundrazi, hiqeshe shumë i zgjuar, shumë kompetent.

Në fillim ti the se «kam punuar si teknokrat». Por teknokrat do të thotë të jesh aq teknik sa ta mbivlerësosh teknikën e të harrosh politikën dhe ideologjinë. Pra, ti tani, duke thënë se «kam ndihmuar qorrazi në sabotimet e naftës», bie në kundërshtim me atë që the për teknokratizmin. Përse i kritikojmë ne Protoko Muratin e të tjerë dhe u themi që «përveç sabotatorë, jeni edhe teknokratë»? Ua themi këtë sepse ata e kishin vënë Partinë nën këmbë! Atëherë, edhe ti Partinë në punën tënde e ke vënë nën këmbë. Prandaj, shokët e Plenumit, me pyetjet që të bënë, të hapën një horizont të madh. Ti duhet të ndihmosh veten dhe Partinë, në radhë të parë, se ndryshe nuk mund të shpëtosh. Ke bërë fajë,

bile të rënda, dhe kështu si rezulton, je sabotator. Në qoftë se do të lehtësosh fajin tënd, ndihmoje Partinë dhe thuaja çdo gjë haptazi! Ti i di ligjet e Partisë: kur i flet haptazi, ajo këtë e mban parasysh në masën që merr. Partia është zemërgjerë.

Më thonë se Sadik Bekteshi, ky element antiparti, revizionist e tradhtar, çdo ditë, veshur «kreko» si një borgjez që u bë, shkon në kafenenë më të mirë, ulet këmbë mbi këmbë, më pi duhan e kafe, më ha edhe pasta dhe me këtë mënyrë manifestive provokon me qëndrimin e tij, duke dashur të thotë: «Ja, si zotni jam, tërr s'ma bën veshi nga vendimi që mori Partia kundër meje». Kërkon të më marrë edhe 900 lekë të reja në muaj, që është pensioni më i madh te ne. Po kemi ligje, thonë. Mirëpo ligjet i bën klasa. Pa të pyesim ca klasën nëse duhet t'u japim pensione të tilla armiqve si ky. Atëherë ku qëndron diferenca në mes një elementi të tillë dhe një oficeri patriot? Diferencimin e drejtë e pengon burokratizmi dhe, kur flet burokratizmi, nuk flet klasa.

Pse ti, Abdyl Këllezi, si anëtar i Byrosë Politike dhe kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit, harrove parimin e madh që s'duhet të lejojmë të ndërtojmë jashtë nevojave të domosdoshme vepra joprodhuese, që s'duhet të lejojmë as fryrjen më të vogël të organikave me elementë joprodhues?

Ti, Abdyl Këllezi, na thua se ke luftuar dhe ke shkurtuar, por këto që na dalin, s'janë të paqena. Ato janë të faktuara. Na thua se «kemi pasur presion nga poshtë». Por ti ke ardhur disa herë tek unë dhe më je

mburrur që, si Komision i Planit të Shtetit, «i kemi frenuar kërkesat dhe ekzagjerimet e bazës, u kemi rënë me sëpatë të madhe». Domethënë këto që na dalin, janë plotësisht të pranuar nga ana jote. Atëherë si i përgjigjesh ti kësaj çështjeje me shprehjen «na shpëtoi nga kontrolli»? Jo, kjo është një përgjigje simpliste, sepse të gjitha këto gjëra të këqija që kanë dalë, si: listorganika, fryrja e tyre, konfondimi i inxhinierit me punëtorin si gjendje shoqërore, fryrja e byrove teknike etj., duhen shpjeguar më parë, duhet shpjeguar pse u deformua për to vija e Partisë. Pse u deformua vija e Partisë, kjo ka rëndësi kapitale, Abdyl Këllezi, gjë që nuk shpjegohet nga ti.

Thuaj më mirë që vuan nga megalomania dhe nga dëshira për një ideologji të kundërt me atë të Partisë, nga zelli për ta vënë këtë ideologji antimarksiste në zbatim dhe për të vënë, gjithashtu, shumë në dukje veten tënde, sa arrin deri aty që të lësh aktivin jetik të naftës dhe të vish në Tiranë për të asistuar në mbledhjen solemne të çlirimit të Tiranës! Pse e bëre këtë ti, Abdyi? Autokritika jote, kur thua «mund edhe të mos vija», nuk është e sinqertë. Këtë ti e ke shkruar edhe në një letër që më ke dërguar. Kur ti e pe gjendjen kaq serioze pse u ngrite e ike nga aktivi? Ne nuk diskutojmë se ç'të tha Koçoja, por pse u ngrite e ike ti, duke qenë anëtar i Byrosë Politike dhe kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit. Kur kishe parë aq shumë gjëra, një rrezik kaq të madh, pse nuk arrite të konkludoje vetë, por le bedel Koçon? Kur u zbulua puna armiqësore në ush-



tri, Petrit Dumja bëri një xhiro, domethënë një voltfas<sup>1</sup> dhe ia hodhi të tëra Beqir Ballukut. Ke qenë edhe ti këtu. Ç'bëri ai? E pa që u zbulua puna armiqësore në ushtri dhe tha: «Beqir Balluku, ky i ka bërë të tëra këto!». Edhe unë, pas të gjitha këtyre gjërave që the ti, mund të arrij në konkluzionin se ti kërkon t'ia hedhësh të tëra Koço Theodhosit.

Ti je anëtar i Byrosë Politike. Vete në aktivin e naftës, konstaton gjithë ato gjëra dhe hesht. Po përse vete ti atje, për lodër?! Si kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit shikon që Shqipërisë nuk i jepen fusha naftë, një punë kjo krejt armiqësore, dhe mjaftohesh duke i thënë Koço Theodhosit: «Shiko, se këtu këta njerëz nuk janë në rregull, prandaj mblidh institutin!». I jep mësim, mblidh këta e mblidh ata, dhe Koço Theodhosi nuk bën hiçgjë. Si duhet kuptuar kjo? Ne kemi pasur raste që shokëve u kanë vdekur njerëz të afërm dhe nuk kanë ikur nga mbledhje të tilla të rëndësishme. Po ti, atëherë, pse ike nga aktiviteti? Pra, si të mos gjykojmë se ti ke menduar: «Hajde, t'ia hedhim Koços këtë, sepse ai është ministër i Industrisë dhe i Minierave dhe unë të lahem!». Prandaj lypset më mirë të thuash: «Duhej të vija që të më shihnin në presidiumin e mbledhjes dhe në televizor në këtë eveniment të rëndësishëm, pse kisha nevojë, për punën time të sotme dhe të mëvonshme, të qëndronte lart autoriteti im». Ti, Abdyl Këllezi, e harrove naftën dhe u largove nga ak-

---

1. Nga frëngjishtja — kthesë, ndryshim qëndrimesh e mendimesh.

tivi, se kishe frikë të prononcoheshe, e harrove ekonominë përpara mendjemadhësisë personale dhe frikës të dilje atje me konkluzione, sepse ishte njëkohësisht dhe i implikuar. Këto të çojnë në rrugë të rrezikshme, prandaj u detyrua i gjithë Plenumi të të kërkonte shpjegime, por ti u bëre bisht të gjitha pyetjeve që t'u drejtuan.

Böhët një mbledhje aq e rëndësishme e naftës dhe ti, «ekonomist i madh», siç je hequr, ngrihesh e ikën, në vend që të rrije dhe të jepje atje mendimin konkluziv. Vallë s'kishte rëndësi për ty nafta? Nuk e dije ti se fusha naftë nuk po zbuloheshin dhe me qindra milionë lekë shkonin kot? As të shkoi fare ndër mend se atje mund të kishte punë armiqësore? Shumë e çuditshme kjo ndodhi tek ti, që sheh çdo gjë! Unë i di të gjitha përgjigjet që ke dhënë ti për këto pyetje, dëgjova edhe përgjigjet demagogjike dhe teknike, por aspak politike e ideologjike, që dhe këtu në Plenum, për të shpëtuar nga llumi ku ke rënë, por të gjitha ato flasin në disfavorin tënd.

Ti, Abdyl Këllezi, pyete në aktivin e naftës për një inxhinier gjeolog. Bëre mirë që pyete, dhe the: «Pyeta se më pëlqeu diskutimi i tij». Mirë! Po derisa të pëlqeu ky diskutim, do të thotë të mos të të kenë pëlqyer ato të të tjerëve. Atëherë pse nuk pyete edhe për Protoko Muratin, për Beqir Aliajn dhe për Milto Gjiko-pullin, «diskutimet e të cilëve nuk të pëlqyen»? Pse nuk pyete dhe për Lipe Nashin, mikun tuaj, veçanërisht të Koço Theodhosit, që, megjithëse ishte ndëshkuar nga Qeveria, ju e bëtë hero? Nuk na thua, po për këta pse nuk pyete? Ta them unë: Nuk pyete, se u druajte t'i

vije gishtin plagës, se mos i zbuloje petën lakrorit. Për sa thua se gjoja i dërgove këtij ose atij protokolle e letra përmbledhëse për naftën, këto i bëre se s'kishe ç'bëje e sa për të thënë që «vura në dijeni», sikur ti të ishe korrier që përcjell protokolle dhe jo udhëheqës që shkon aty ku duhet për të shtruar e për të diskutuar për gjendjen e krijuar e problemet që dalin. Këto që thua s'qëndrojnë në këmbë. Unë s'dija asgjë ç'po ndodhte në sektorin e naftës. Në korent më vuri vetëm letra e atij punëtorit të naftës, të cilën e mora në datën 1 shkurt 1975.

Kjo letër më habiti! Thirra atëherë Hakiun [Toska], i cili më dha protokollin që ti ia kishe dërguar me 37 ditë vonesë nga mbledhja që qe bërë në naftë më 16 nëntor 1974. E theksoj, 37 ditë vonesë. Kjo është e dënueshme dhe vërteton atë që u mendove shumë që t'ia dërgoje dhe një gjë e tillë, në fakt, i përkiste, në radhë të parë, ta bënte Koço Theodhosit si ministër i Industrisë dhe i Minerave. Po ashtu ajo që thua, se gjoja i paske thënë Hakiut që «mundësisht të vihet në korent edhe shoku Enver», është e kurdisur nga ti për rastin.

Kur të pyeta unë në një takim (dhe jo se më vure ti në korent): «Ç'kemi gjë nga nafta?», në atë kohë unë isha në dijeni të gjendjes së atjeshme dhe kisha nxjerrë konkluzione, por doja të dija edhe mendimin tënd. Ti më fole për disa gjëra pa rëndësi dhe, kur të njoftova se punëtorët të akuzojnë edhe ty, se në fakt kështu është, ata të akuzojnë, u trondite, mblodhe supet dhe më the: «Ç'kanë ata me mua? Unë s'kam asnjë faj, s'kam përgjegjësi». Dhe me kaq mbeti kjo gjë, mendove ti, por nuk menduan kështu Partia, Byroja Politike dhe

unë. Dy ditë para mbledhjes së Qeverisë ti u bëre i sëmurë dhe ike me pushime. Më vonë u bënë gjithë ato analiza. Ti u ktheve nga pushimi, lexove edhe protokollin e mbledhjes së Byrosë Politike, ku të kritikonin. Pastaj kaluan javë të tëra, unë të prita të vije, të shpjegoje përgjegjësinë tënde. Ti nuk erdhe fare tek unë. Pyes: S'i vure rëndësi punës, apo kishe frikë të ballafaqoheshe me mua? Mos e ndieje veten fajtor? Mua më duket se po, prandaj nuk erdhe.

Për mendimin tim, ti, Abdyl, je kryesori dhe pas teje vjen Koço Theodhosi. Krijuat gjithë ato drejtori të veçanta, nëndrejtori, agjenci e nënagjenci, gati të shkëputura nga ministritë, dhe të gjitha këtyre u dhatë edhe kompetenca me barrë, pa harruar rrogat e majme njerëzve. Vërtet mendove ti se kjo ishte një çështje teknike? Jo, unë mendoj që në kokën tënde fshiheshin qëllime të një veprimi ideologjik organizativ antimarksist. Pse e bëtë këtë në një mënyrë të tillë? Ne kemi thënë dhe do të themi se ministritë janë organe qendrore, që problemet e vogla të mos bëjnë të harrohen të mëdhatë, por kjo shkaktoi të kundërtën: Ministritë lanë duart nga problemet e mëdha dhe veçanërisht Ministria e Industrisë dhe e Minerave, dhe çfarë të larë, nga nafta, nga minierat etj. dhe merreshin nëse duhej t'i pranonte ose jo UMB-ja 9 makinat bujqësore që Andrea Mançoja kishte sjellë me spekulime me italianët, makina që s'vlenin një grosh dhe që janë hedhur hendeqeve.

Mirë, mor Abdyl Këllezi, duke u hedhur në «reforma dhe në organizime», nuk mendove pak se këto veprime të pathelluara dhe të pakontrolluara të çonin

në një rrugë të gabuar të ndërmarrjeve të vetadministrimit? Nuk të shkoi në mendje kjo? Nuk bëre një analizë të këtyre gjërave që rrokulliseshin në rrugë të gabuar, sa që ti shkele ligjet dhe parimet e vendosura nga Partia, ndërsa për këto veprime nuk mungon të kritikosh të tjerët dhe të hiqesh si ideolog i pagabuar? Ti dije çdo gjë që bënte Lipe Nashi dhe banda e tij, ti u diktoje atyre dhe Koço Theodhosi; ti i ke dhënë aprovimin Lipe Nashit që me materialet e naftës të ndërtonte ura, ke lejuar që me dollarët e naftës të blinte ç'të donte dhe të ndante, ku të donte ai, vetura, televizorë etj.! Tok i kemi kritikuar ndërmarrjet dhe sistemin e vetadministrimit titist. I harroje këto, apo të pëlqente vetadministrimi? Këtë ti e di, por unë mendoj se të pëlqen. Atëherë, kur ti dhe Koço Theodhosi shihnit ç'bënin Lipe Nashi dhe të tjerë si ai, pse nuk i dilnit me propozime Qeverisë që ta likuidonte menjëherë këtë situatë? Ju nuk guxonit të dilnit me to, se ju zbulohet plani i sabotimit, ju nuk guxonit të prishnit kompetencat e dhëna ministrave, kurse guxonit të dëmtohej ekonomia.

Si mund të besohet se këto organizime që bëtë, që ju pëlqyen, që i latë të ndiqnin rrugën e tyre të gabuar dhe nuk e ngritët zërin për t'u marrë masa kundër shtrembërimeve, paskan ndodhur se «ju shpëtuan nga kontrolli», siç thua ti, Abdyl Këllezhi?! Jo, po të besojmë me kaq lehtësi, do të dëmtonim rëndë interesat e Partisë e të shtetit.

Në debatet që u bënë për tekstin e ekonomisë politike ti the se nuk e ke parë gjithë tekstin, por vetëm disa pjesë. Ti, si kryetar i komisionit të hartimit të këtij

teksti, duhej ta shikoje të tërë. Por, ja, ta pranojmë edhe atë që pe vetëm «disa pjesë». Por si kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit ti duhej të shikoje patjetër, veçanërisht ato «disa» që të takonin drejtpërdrejt ty, si për shembull, pjesën e planifikimit. Këtë pse e neglizhove? Mirë tërë tekstin nuk e lexove dhe lejove gabime, po këtë pjesë pse nuk e pe?!

Më falni të shpreh atë që mendoj, po te disa shokë kryesorë të Komitetit Qendror, si Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi e ca të tjerë, ka një megalomani nënçmuese, të kuptohemi, jo të deklaruar, ndaj eksperiencës dhe materialeve të Partisë sonë. Ata bëjnë këtë arsytim: «Në këto i dimë, i kemi jetuar, i kemi marrë vetë, atëherë thellimi në to nuk është për ne, po për kuadrat në bazë». Bukur! Po të jetë kështu, atëherë i zbatoni drejt e pa gabime. Ku bëhen gabime më të mëdha e të rrezikshme, poshtë në bazë, apo lart në qendër? Duhet të njohim se këto bëhen më shumë lart. Atëherë duhet të gjendet arsyeja pse ngjet kjo. Mendoj se çka theksova në fillim është një nga arsytimet më të sëmurë e më të rrezikshme, pse të bën që të mos ndjekësh busullën, gjë që është mëma e shumë rreziqeve.

Unë u them disa shokëve të Qeverisë se u ka humbur vigjilenca politike e ideologjike dhe, pavarësisht nga fjalët e mëdha që përdorin, ata janë mbështetur kryesisht në masa administrative: «Të pyesim disa teknokratë, të marrim mendimin e specialistëve, të nëpunësve», kurse «mendimi i masave — në shportë!». Këtë e pohojnë vetë Abdyli dhe Koçoja, natyrisht, jo në këtë formë, siç e them unë, por aty jemi, se me gojë

në «diskure»<sup>1</sup> jemi «në krye të buxhakut». «Ngopuni me formula e slogane», por «ne bëjmë si na thonë Andrea Mançoja, Lipe Nashi, Beqir Amerika ose ndonjë tjetër». «Na nxorët një nomenklaturë të tretë ose të katërt», tha Kiço Ngjela, kur e penguan Andrea Mançon të shkonte në Perëndim, pse dyshohej. Ç'do të thotë ky besim i verbër te disa njerëz, sa edhe kur kërkojnë t'u hapin sytë, hezitojnë t'i hapin?

Ju, shokë të Komisionit të Planit të Shtetit, vetë pohoni «Nuk kemi ndjekur si duhet as procesin e planifikimit dhe as zbatimin e tij». E dini ç'do të thotë kjo? Të punosh për të sabotuar planin. Komiteti Qendror ka të drejtë dhe detyrë të të kërkojë llogari ty, Abdyl Këllezi, që të ka vënë në krye të Komisionit të Planit të Shtetit, përse nuk është kryer si duhet kjo detyrë. Mos ke dashur të sabotosh ekonominë? Harrove ti forcën e Partisë dhe të popullit, që nuk të lënë të veprosh si ta ka qejfi?

Kurdoherë, kur kemi kërkuar llogari për këto mosrealizime, na është thënë që «fajin e kanë baza dhe ministritë». Ato, sigurisht, kanë fajë dhe nuk dua t'i shfajësoj, por një autokritikë nuk kam dëgjuar nga ti, Abdyl Këllezi, nuk kam dëgjuar as për Komisionin e Planit të Shtetit. Vetëm vetëlavdërime! Ju po i kaloni në histori si «organizma që çdo gjë e kanë parë drejt, në vijën e Partisë, e kanë peshuar si duhet». Por këto që na dalin, për të cilat Komisioni i Planit të Shtetit dhe ti personalisht, Abdyl, keni përgjegjësi të rëndë, ç'do t'i

---

1. Fjalime:

quajmë, gabime apo punë për t'u lavdëruar? Por, pa e vënë dorën në zjarr, unë mendoj se do të zbulojmë gabime të tjera të rënda, si në investime, në financë dhe sidomos në frymën e sëmurë që është lejuar nga ju, duke marrë pozat e «moslejuesve».

Ti, Abdyl Këllezi, ke pohuar: «Kam parë që fondë i pagave po rritej në përpjesëtime jo të drejta». Atëherë pse nuk i vure në korent Qeverinë dhe Byronë Politike, ku më parë të bëje autokritikë vetë? Pse nuk e bërë problem të Byrosë Politike që nuk duhej hequr kontrolli i bankës? Pastaj kur ky kontroll u vu prapë kudo, përse u përjashtua sektori i naftës? Ishte vallë ky një operacion thjesht teknik që ti thoshe se ishte kundër heqjes? Unë nuk e besoj këtë, pse ty, Abdyl Këllezi, s'të shkoi në mendje ana politike, ideologjike dhe financiare e problemit, se në këto anë do të shkaktoheshin dëme, siç u shkakatuan. Ti mund të më thuash se vendimet i mori Qeveria, dhe unë nuk kam ndër mend t'ia heq asaj këtë përgjegjësi, por ti je përgjegjësi kryesor, frymëzuesi, se hiqeshe si «papa» i ekonomisë dhe i financës. Kështu je hequr kurdoherë. Ti thua vetë se ke bërë një sërë zigzagesh në këtë çështje të rëndësishme dhe nuk ndërhyre. Vetë pohon që «deri tash kam menduar pse nuk ndërhyra dhe s'e gjej dot arsyen». Përpiqu me kurajë, se do ta gjesh pshenë!

Abdyl, ti mburreshe shumë dhe pa vend, kurse Partia na mëson të jemi të thjeshtë, por duhet të pohoj se unë nuk i kam ngrënë mburrjet e tua. Kam konkluduar për ty se përvetësoje mendimet e të tjerëve, të specialistëve e të punëtorëve, dhe këtë e bëje për t'u



dukur para meje, duke menduar se çka më thoshe, unë e haja dhe e dëgjoja për herë të parë. Të kam bërë shumë herë aluzione dhe kritika që ta braktisje këtë metodë, por ti ke vazhduar dhe vazhdon si më parë, duke na u hequr si shumë i zoti dhe kompetent, bile edhe në këtë Plenum nxitoheshe të jepje përgjigje zjarr për zjarr, pa pritur të mbaronin pyetjet që të bëheshin. Vetë pohon se për këto që janë zbuluar, ke përgjegjësi, se ato të kanë shpëtuar nga kontrolli, gjë që nuk është e vërtetë, pse kanë qenë bindje për ty, kurse investimet, ndërtimet, kontrollin e bankës i ke pasë nën kontroll. Mirëpo sikur shpejtohesh ca edhe në këtë pohim.

Ti, Abdyl, pohove se, kur i bën vetes pyetjen «Pse na ngjanë këto gjëra?», të duket se burimi i kësaj është «mungesa e ekuilibrit» ose më mirë të themi «ngurrimi». Përpiqesh më kot të japësh ndonjë shpjegim teknik, por të humbasësh ekuilibrin ose të ngurrosh është çështje me një domethënie politike dhe ideologjike të rëndësishme. Jo vetëm fjalët në vetvete, por çdo gjë, çdo punë, çdo ndodhi, thotë Lenini, ka vulën e vijës së partisë, ka politikën e partisë. Vula e Partisë nuk duket në ato që na thua ti, as në veprimet e tua për kompetencat dhe për të gjitha gabimet e tjera që ke bërë. Atëherë, mund të na e shpjegosh më qartë, nga ana ideologjike flas, këtë dizekuilibër dhe ngurrim tek ti në vijë? Ti nuk more mundimin t'i shpjegoje ato, por t'i fshihje, t'i maskoje. Ti e pe se Komiteti Qendror i Partisë është i kalitur e në krye të detyrës dhe t'i demaskoi qëllimet e liga.

Ti thua se jeni ndeshur «rreptë» me Koço Theodhosin «për probleme të karakterit serioz»<sup>1</sup>. Mirëpo ky afirmim i akshamit rrëzohet vetvetiu, sepse ti, si anëtar i Byrosë Politike, nuk i ke shtruar ndonjëherë në Byro këto gjëra. Por as këtu s'na i vutë në dukje këto, as ti, Abdyl, as ti, Koço. Ju këtu e mbrojtët shoku-shokun. Pse vallë? Vetë ky lloj solidariteti është komprometues.

Abdyl, po më çudit dhe më vjen keq që çështjes së naftës po i rrëshqet në mënyrë tangente. Nuk duhet të veprosh kështu, se s'të lejon Komiteti Qendror ta trajtosh në këtë mënyrë çështjen. Ti mund ta rëndosh Koço Theodhosin, se ai është ministër, siç bënë Petrit Dumja dhe Hito Çakoja për Beqir Ballukun, por ti e pe se si e zbuloi Komiteti Qendror veprimtarinë armiqësore dhe tradhtarë të Beqir Ballukut me shokë. Ashtu edhe për ty, Komiteti Qendror s'të ndan nga përgjegjësia e njëjlojtë me Koçon, në mos më shumë.

Ti drejton Komisionin e Planit të Shtetit dhe duhet ta dish që, në rast se ne nuk kemi naftë, plani ynë ekonomik, si ai aktual dhe ai perspektiv, nuk mund të ecë. Me se do të lëvizë gjithë kjo industri që kemi? Me se do të lëvizin tërë këto makineri? Po armët e ushtrisë si do të vihen në veprim? Me se do të punojnë TEC-et tona, kur edhe ato që punonin me qymyr, ke qenë ti, në

---

1. Këtë taktikë përdornin edhe puçistët Beqir Balluku e Petrit Dume, që, për të mbuluar komplotin e kurdisur, ngritën legjendën e mosmarrëveshjeve që gjoja ekzistonin ndërmjet tyre.

mos gabohem, një nga ata që je përpjekur të vihen në punë me naftë? Po TEC-eve të ardhshme, po industrisë së petrokimisë, për të cilën ti na bëve premtime të mëdha, si do t'u vejë halli? Mos të kemi çuar në atë dikaster që të na bësh plane në erë?

Në këto situata të vështira që kalon ekonomia e vendit tonë, ti, si kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit, mund të thuash tash se nuk ke përgjegjësi, dhe s'është fjala për përgjegjësi teknike, por politiko-ideologjike?

Ti na je hequr planoviku i planeve «perspektive të mëdha», po pse u habite kur të tha Adil Çarçani se «shoku Enver dëshiron që të kemi një plan perspektiv 30-vjeçar për naftën»?! Unë s'di se si ia kam thënë këtë shokut Adil, por them jo për 30 vjet, por, po të jetë e mundur, ta kemi një plan të tillë edhe për 100 vjet. Ti s'qenke interesuar si duhet për fushat ekzistuese dhe tash tërhiqesh si ngjalë nga një terren i rrezikshëm. Si, të mos interesohem unë për të ardhmen e naftës? Ti ke pohuar që «të interesohemi për gjendjen aktuale». Pikërisht edhe unë për këtë po interesohem tash e vazhdimisht dhe jam interesuar aq shumë, sa nuk më zë gjumi. Atëherë na thuaj ti, Abdyl, që «interesohesh për gjendjen aktuale», pse na sabotuan në naftë? Ti duhej të ishe interesuar për këtë «dhe je interesuar», siç thua edhe vetë. Atëherë pse ndodhi ky sabotim? Ti bën sikur ke haruar unitetin e mendimeve të tua me të Tuk Jakovës, këtij agjenti titist, por Partisë i kujtohen. Ti e di se Tuk Jakova ishte kundër nxjerrjes së naftës, por, pas kaq vjetësh, ti, Abdyl, na del në sabotimin e naftës!

Kjo është e çuditshme! A nuk të duket ty, Abdyl, e çuditshme kjo ngjashmëri?

Ti thua «jam ndeshur rreptë me Koçon», e theksoj «rreptë», «për probleme serioze». Mund të na thuash përse kanë qenë këto diskutime «të rrepta»? Këto ne duhet t'i dimë, se ti s'na the gjë. Vetë pohon se shihje që «Ministria e Industrisë dhe e Minierave kishte humbur kontrollin nga nafta». Po ti ç'bëre për këtë konstatim të rëndësishëm? Bisedove ndonjëherë me Koçon «rreptësisht»? Dhe ç'doli? Asgjë! Ç'bëre më vonë? Pse s'e ngri-te këtë çështje në Byronë Politike apo në Qeveri, ku të thoshe se «nafta na ka ikur nga duart», përse na ka ikur dhe të merreshin masa urgjente? Ti përgjigjesh: «Kam gabuar»! Mirëpo nga anëtari i Byrosë Politike dhe kryetari i Komisionit të Planit të Shtetit, që e di mirë se pa naftë ngel në vend tërë ekonomia sot dhe mot, një përgjigje e tillë nuk është e njaftueshme.

Mirë Koço Theodhosi kishte vendosur të bënte një punë sabotuese, një gjumë të rëndë dhe shumë të rrezikshëm për ekonominë tonë, por ti që e shihje këtë gjendje, pse nuk dhe alarmin? Ti pranon se nuk të vajti ndër mend që në industrinë e naftës «po bëhej një punë armiqësore», po ç'emër i kishe vënë asaj pune të qartë për ty, kur thua: «Na gënjenin çdo vit dhe çdo vit s'na jepnin naftë, sot na jepnin sihariqe, kurse të nesërmen na thoshin të kundërtën». Dhe ti, me të marrë këto «sihariqe», i futje në plan përnjëherë qindra mijë tonë. Ti me Koçon ishit më të zellshmit kur këtë deficit (të ashtuquajtur deficit, pse kjo sasi as që kishte ekzistuar kurrë, veçse në planin tuaj) jua shpërndanit fu-

shave ekzistuese, pusët e të cilave u përmbytën me ujë:

Lipe Nashi, pavarësisht se është armik e tradhtar, ju akuzon se ju e keni detyruar t'i sforcujë pusët, se ai ka qenë kundër kësaj dhe thotë se «u kam shkruar edhe letra Koços e Abdylit, kam pasur kundërshtime zyrtare me ta».

Ne e kemi thënë mendimin tonë për fajet dhe përgjegjësitë e Koço Theodhosit. Unë këtu nuk po zgjatem, sepse kam folur në mbledhjen e Byrosë Politike<sup>1</sup> e të gjithë ju, shokë, jeni njohur me këto materiale. Kurse ti, Abdyl, veprime drejtpërdrejt në sabotim me specialistët, ti kishe, përveç kësaj, planin si një armë kontrolluese që të jepte të dhëna dhe të lejonte që, kur gjendja nuk ecte përpara, të veje në naftë aq shpesh, sa që t'u hyje më thellë këtyre problemeve. Po këtë s'e bëre. Kishe arsye që s'e bërë këtë, sepse ishte plani sabotues, ishte puna armiqësore që të ndalonin.

Bashkëpunimin tënd me Koçon nuk duhet ta zvogëlosh. Mos e bëj si Petrit Dumja me Hito Çakon ndaj Beqir Ballukut, pse Koçoja ka gabuar, por për mua, me aq sa mund të kem konstatuar, Koçoja këshillohej vazhdimisht me ty, ai s'bënte gjë pa të pyetur, pse e ndiente nevojën tënde. Ti ishe udhëheqësi i tij në punën armiqësore sabotuese. Koçoja dukej sikur kishte gjykime të pjekura dhe precize për problemet, ai është shumë metikuloz dhe budalla s'është, por faktet tregojnë se nuk ishte aq i hedhur dhe aq bombastik sa ti. Koka kryesore, pa ia hequr përgjegjësinë Koços, ishte ti. Edhe

1. Shih në këtë vëllim f. 207.

mendimet e tua, gjoja më të specializuara, Koçon nuk e ndihmuan për të mirë, por për të keqen e Partisë. Unë mendoj se Koçoja ishte i predispozuar për një punë antiparti, armiqësore, pse nuk e honepste vijën e Partisë, prandaj ju u bashkuat, gjetët shoku-shokun dhe u futët thellë në punën armiqësore.

Unë hëpërhë nuk do të zgjatem më tutje për këto probleme të mëdha, pse, siç e dimë, janë duke u zhvilluar kudo kontrole punëtorë dhe të Partisë mbi gjërat, mbi organizmat dhe mbi njerëzit. Këto studime dhe kontrole nga baza do të na zbulojnë gjëra të mira dhe të këqija, prej tyre do të fitojmë një eksperiencë të madhe politiko-ideologjike dhe do të na bëjnë të korrigjojmë shtrembërimet e vijës, t'i ndreqim gabimet atje ku janë vërtetuar, të shërojmë të sëmurët dhe të shlypim armiqtë. Komitetit Qendror dhe Qeverisë do t'u vijmë të dhëna të sakta, të mbështetura drejt në analiza të thella, mbi të cilat duhet të gjykojmë. Deri tash, për këto fushata, Komiteti Qendror dhe Qeveria janë kënaqur nga mendimet dhe nga konkluzionet që tërhiqnin zyrtarët, tek të cilët duhet të kemi besim, por edhe t'i kontrollojmë. Këtë herë, më duket mua, u duhen shtuar këtyre edhe raportet e drejtpërdrejta të kontrollit punëtor, por të një kontrolli punëtor pa «kontroll nga ana e zyrtarëve». Kemi shumë nevojë për zërin e klasës, për mendimin e klasës, kemi nevojë të na gjykojë ajo dhe jo të kënaqemi me vetëgjykimin tonë. Vetëgjykimi ynë është disa herë subjektiv, gjykimi i punëve nga një sërë njerëzish të zyrave u vërtetua se ka pasur brenda edhe koncepte jo të drejta. Të gjitha këto gabime, shtrë-

mbërime dhe abuzime rëndonin mbi shtetin tonë, mbi klasën, mbi punonjësit. Ata që i pësuan këto, kanë të drejtë të flasin, të propozojnë dhe të vendosin ndaj atyre që kanë shkelur ligjet e shtetit dhe direktivat e Partisë.

Është e domosdoshme që kjo gjë të bëhet dhe duhet të bëhet e vazhdueshme. Kontrolli i Partisë, i klasës dhe i masës duhet të ushtrohet i rreptë në çdo gjë e mbi këdo. Partia, forumet, Qeveria dhe aparatet shtetërore dhe ekonomike s'duhet të lejojnë më që jo vetëm të dobësohet grushti i shtetit të proletarëve, por as të mbetet ky formal dhe i cunguar.

Të bëhet zakon që jo vetëm të kritikohen dhe të ndreqen me shpejtësi gabimet, por edhe të dënohen fajtorët. Shtypi të flasë për fajtorët, dhe jo vetëm për të vegjlit, por të flasë edhe për të mëdhenjtë, kur gabojnë, kur e lejon situata e përgjithshme e jashtme, në mënyrë që të mos e shfrytëzojnë armiqtë, pse duhet thënë që për këta «të mëdhenj» është krijuar një situatë e privilegjuar. Por gojarisht populli duhet vënë në korent për ata që bëjnë faje. Ka sekretarë partie, ka anëtarë të Komitetit Qendror, ministra, zëvendësministra dhe të tjerë që bëjnë gabime, që s'punojnë mirë, që nuk e meritojnë besimin që u kanë dhënë Partia e shteti dhe jo vetëm nuk kritikohen si duhet, jo vetëm nuk shkarkohen, por edhe kur kritikohen dhe shkarkohen, nuk e merr vesh njeri pse u mor kjo masë, në vend që të vihet në dukje pse ngjet një gjë e tillë. Edhe tash, në këtë Plenum luftarak, ka shokë që u kritikuan rëndë dhe meritonin dënime më të rrepta. Por

këta shokë të mos mendojnë se Komiteti Qendror dhe Byroja Politike u treguan liberalë ndaj tyre. Të mos mendojnë se e hodhën lumin edhe këtë herë. Komiteti Qendror e kupton shumë mirë arsyen dhe vepron në interes të Partisë e të vetë atyre shokëve që kanë gabuar dhe që shpresohet se mund të korrigjohen.

Një iluzion është ai që të mos flasim për ata që gabojnë për të mos u «diskredituar» Partia dhe shteti që i kishin sjellë në ato pozita. Opinioni i merr vesh, edhe po të mos ia thuash ndodhitë. Ai i gjykon njerëzit dhe udhëheqësit sa vlejné nëpërmjet punës dhe qëndrimeve politike. Lufta e klasave i shpjegon këto ndodhi e këto veprime dhe ne të mos kërkojmë t'i mbulojmë, duke lënë të kuptohet se kuadrot e lartë nuk gabojnë, kur në realitet ka disa që edhe gabojnë. Komiteti Qendror i sheh dhe i peshon vlerat e gjithsecilit nga ne dhe, kur e sheh të domosdoshme e të nevojshme për ata që gabojnë, i shkarkon nga përgjegjësitë. Përpara ne kemi Kongresin e Partisë dhe atje do të na gjykojë Partia, jo vetëm se kemi bërë Luftën Nacionalçlirimtare, por si po e bëjmë edhe tash këtë luftë të madhe për ndërtimin e socializmit.

Mbajtja fshhtë e dënimit të një njeriu që ndëshkohet i lejon atij që të spekulojë, të hiqet si viktimë e ambicies së njërit e të tjetrit, lejojmë kështu që me veprimet tona të krijohen pakënaqësi dhe mendime të gabuara. Ne duhet të japim herë pas here shembullin në shtyp për këto çështje.

Partia e ka thënë kurdoherë: Askush të mos mendojë se e ka marrë me tapi detyrën që i është caktu-



ar. Askush nga ne të mos mendojë se, meqenëse ka bërë luftën, nuk ka gabuar asnjëherë, prandaj s'ka pse lëviz nga vendi ose nga udhëheqja. Shokë të tillë duhen respektuar dhe nderuar nga Partia. Por të mos harrojmë se duhet të vazhdojmë të kryejmë detyrat me konsekuencë dhe, e dyla, vitet bëjnë punën e tyre. Partia dhe Komiteti Qendror duhet vazhdimisht të përgatitin udhëheqës të rinj, të mendojnë për vazhdimësinë, për të ardhmen. Leninizmi na mëson, nga ana tjetër, se, kur partia na cakton në punë, kjo është thjesht një detyrë për ne. Sot je këtu, nesër nevoja e do që të vesh atje dhe duhet të vesh. Në qoftë se s'do të vesh, rri pa ngrënë. Në rast se flet kundër pushtetit, diktatura të godet. Në qoftë se bën gabime, do të kritikohesh dhe do të ulesh në detyrë, në rast se vazhdon, do të rrokullisesh më poshtë. Në rast se kapaciteti i punës t'u dobësua, duhet të kuptosh që vendin t'ia lësh shokut që jep një rendiment më të madh. Të erdhi koha për pension, t'ia lësh vendin tjetrit, por edhe në pension kur të dalësh, nuk duhet të lidhësh duart dhe të mos vrasësh mendjen apo të qëndrosh indiferent, po të vazhdosh të punosh për Partinë dhe për shtetin tënd e jo për të fituar ndonjë rrogë mbi pensionin dhe të grish si njëfarë... i cili merr maksimumin e pensionit që jepet te ne dhe e kemi emëruar edhe këshilltar, duke marrë 500 lekë të roja mbi maksimalen e pensionit, domethënë gjithsej 1 400 lekë të ardhura, dhe prapë qahet se «Partia nuk interesohet për mua»! Ai na dashka që të vejë jashtë, se nuk i rrihet në vendin e tij. Po çfarë ka bërë ky njeri për Partinë dhe për diktaturën? Asgjë më shu-

më se një kuadër i zakonshëm, kurse pretendimet e tij janë ato të një borgjezi. Për mendimin tim, qenia në Parti për të tillë njerëz ka qenë një rastësi. Partia me ta është sjellë më së miri, më se korrekte dhe këta njerëz kanë paturpësinë të thonë se «Partia nuk interesohet» për ta! Unë mendoj se Partia duhet të interesohet me të vërtetë për disa si këta elementë. T'i sjellë në vete, sepse ata po shfrytëzojnë dhe abuzojnë mbi indulgjencën<sup>1</sup> dhe mirësinë e Partisë dhe të klasës.

Duhet të konstatojmë dhe të njohim se kritikak që u bëjmë punës, shokëve, autokritikat që po bëjmë, nuk janë të lehta, ato janë të rënda, shumë herë të hidhura e të zorshme. Këto shumë herë kuptohen drejt dhe shërbejnë për edukimin dhe për korrëgjimin e punëve dhe të njerëzve, por disa herë nuk bëhen dhe as kuptohen si duhet në të dy drejtimet, edhe në drejtim të kritikës, edhe në drejtim të autokritikës.

Mund të mendojmë se kemi gjetur kurdoherë masën e drejtë? Nuk mund ta themi kurdoherë këtë. Ne komunistët duhet të bëjmë përpjekje të mëdha për të qenë sa më të saktë në gjykime, sa më të drejtë në vendime dhe sa më gjakftohtë në shqyrtimin e problemeve.

Faktet treguan dhe tregojnë se vendi ynë u gjend në një situatë të rëndë, së cilës duhej t'i bënim dhe do të vazhdojmë t'i bëjmë ballë me sukses. Armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm punonin në mënyrë të organizuar për të rrëzuar Partinë dhe pushtetin. Veprimtaria e tyre, që ishte e shumanshme: në ushtri, në arsim

---

1. Zemërgjerësinë.

e kulturë, në ekonomi etj., u zbulua. Ky ishte një komplot i madh, i gjerë dhe i rrezikshëm. Që arritën deri në atë shkallë sa të vepronin këta armiq, s'ka dyshim se gjetën boshllëqe në punën tonë, gjetën një terren të dobët, ku hodhën farën e tyre të keqe. Dobësia qëndronte deri atje sa shumë njerëz menduan se kjo punë armiqësore, ky komplot i rrezikshëm ishin si diçka sporadike, si disa gabime ose çoroditje personash, shpejt të rregullueshme me një apo me dy mbledhje dhe me disa autokritika.

Vigjilenca e Partisë, eksperiencia e saj e madhe, nuhatja revolucionare dhe gjakftohtësia bënë që kjo punë armiqësore të zbulohet në rrezikshmërinë dhe në tërë gjerësinë e saj. Pastaj ka edhe njerëz, flas për ata me qëllime të mira, që e nënvlerësojnë këtë eksperiencë të madhe të Partisë! Kur një punë armiqësore bëhet e qartë, atëherë të gjithë kontribuojnë në dërrmimin e saj. Këtu qëndron forca e Partisë, por kjo forcë duhet të tregohet e plotë për ta parandaluar armikun që të veprojë. Të gjithë e dimë se armiku nuk fle, ai vepron dhe vepra e tij nuk mund të jetë veçse antiparti dhe antishtetërore, ndryshe s'mund të quhet punë armiqësore, prandaj armiku, duke vepruar, do të lërë gjurmë. Këto gjurmë të ujkut nënvleftësohen shumë herë, megjithëse kemi dalë ta ndjekim dhe ta vrasim «ujkun», megjithëse orë e çast Partia na mëson që të punojmë, të luftojmë dhe të jemi vigjilentë.

Armiku punon në mënyrë të fshehtë, por për «ushtarët e tij besnikë» ai nuk ka fshehtësi. Ai bën mbledhje

të fshehta me lejtënantët e vet<sup>1</sup> dhe këta vepronë, por sado që ta ruajnë konspiracionin e tyre, ata janë si strucët. Vetëm po të mbyllësh sytë dhe të kesh humbur vigjilencën, nuk do të mundësh t'i shohësh veprimet e tyre në kundërshtim me normat e Partisë dhe me ligjet e shtetit.

Kjo punë armiqësore, që zbuluan Partia dhe organet e diktaturës, ishte mjaft e gjerë. Në këtë komplot ka pasur armiq të vendosur, që janë koka dhe skeleti i komplotit, por ka pasur edhe elementë joarmiq, por syleshë, servilë, megalomanë e prepotentë që, pa qenë të lidhur drejtpërdrejt në këtë punë armiqësore, ndihmonin veprimtarinë e tyre. Këtu qëndron një nga detyrat më të rënda dhe më delikate të Partisë për të ndarë shapin nga sheqeri: cili është armik, cili nuk është armik, kush ka bërë gabime të rënda dhe kush ka bërë gabime më pak të rënda; kush i njeh sinqerisht gabimet dhe kush nuk i njeh ato. Gabimet janë individuale, por janë edhe kolektive. Kolektivisht asnjë nuk mund t'i shpëtojë përgjegjësisë, pse ne kemi për detyrë të gjykojmë, të vendosim, të vepronim dhe të kontrollojmë. Në një mënyrë ose në një tjetër, askush nuk mund të lajë duart nga përgjegjësia kolektive dhe sidomos në ata sektorë ku vërtetohen gabime. Por, pa nënvleftësuar përgjegjësinë kolektive për fajin, këtë dikush e ka bërë, ka fajtorë drejtpërdrejt dhe këta janë fajtorët kryesorë. Në gjykimin e fajeve, në analizën e punëve ku janë vërtetuar gabime, të dyja këto përgjic-

---

1. Këtu ka kuptimin: me kuadrot e vet (të armikut).

gjësi duhet të hidhen në balancë, pse pastaj gjykimi dhe vendimi nuk mund të jenë të drejtë.

Zakonisht fajtorit i vërsulen me të drejtë, por ka edhe nga ata, si Dashnor Mamaqi dhe tradhtari Pirro Gusho e të tjerë, që ngriheshin e çirreshin në mbledhjet e Komitetit Qendror me një histerizëm të shfrenuar, për t'u maskuar, por, kur fillon të flasë Partia, atëherë na del që sekretarë partie e kanë lënë rrethin për ibret, që me Beqir Ballukun bënin ahengje, që Dashnor Mamaqi, i cili çirrej në Plenumin e Komitetit Qendror kundër Fadil Paçramit dhe Beqir Ballukut, ishte njeriu i tyre besnik dhe bashkëveprues, kurse Pirro Gushoja doli një tradhtar sabotator dhe nga kryesorët e komplotit.

Dhe drejtësia e rreptësia e Partisë janë të dyja të nevojshme të ushtrohen, kur vërtetohen fajet dhe gabimet në punë e në njerëzit. Partia dhe ne anëtarët e saj, kudo ku punojmë, jemi përgjegjës për çdo gjë që ngjet në vendin tonë. Ne jemi në pararojë të klasës. Kjo do të thotë se ne jemi përgjegjës përpara saj dhe shtetit të saj për fjalën tonë, për vendimet dhe për veprimet tona kolektive dhe individuale.

Unë mendoj se ata që kanë qenë objekt i kritikave të rrepta nga shokët, nga organizatat-bazë dhe nga forumet, i kanë merituar plotësisht këto kritika. Shokët që kritikohen duhet të kuptojnë dhe t'i ndiejnë thellë fajet e tyre, shkakët që i shtynë t'i bënin gabimet, ata duhet të kuptojnë politikisht dhe ideologjikisht rrethanat në të cilat vepruan dhe dëmin që shkaktuan. S'ka rrugë tjetër shërimi për ata vetë dhe për gjithë punën tonë.

Ne duhet të jemi të rreptë, por të praktikojmë një rreptësi me drejtësi. Ka përgjegjësi Abdyl Këllezi për fajet e tij shumë të rënda, prandaj edhe unë, edhe ju të gjithë s'ia kursyem kritikën. Ai ka bërë faje të rënda, që nuk i lejoheshin. Po pse i bëri? Abdyl ishte një kuadër jo dosido dhe të mos na hiqet si i hutuar, ai nuk duhej të bënte gabime të tilla, që nuk na i tha pse i bëri. E thashë edhe më sipër, kur fola për Abdylin, se ai nuk është një marksist, përveç kësaj dhe si konsekuencë, tek Abdyl Këllezi spikatin fort mendjemadhësia dhe një siguri e mbivlerësimi i tepruar i kapaciteteve të veta, e sidomos i ideve të tij antimarksiste revizioniste, gjëra që e kanë çuar në gabime kolosale, në marrje vendimesh vetë, pa u këshilluar me shokë të Qeverisë për probleme që ai duhej të këshillohej. Por këto kanë qenë një pjesë e planit të tij të fshehtë.

Ai, si kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit, kish-te formuar një ide të shtrembër dhe të rrezikshme për kompetencat e tij. E theksova edhe më sipër se për Abdyl Këllezin çdo gjë në Komisionin e Planit të Shtetit ishte «pa gabime» dhe kjo ndodhte se atje ishte në krye ai, pra edhe veprimet që ndërmerrete për të gjitha çështjet që kritikojmë dhe për të cilat ka përgjegjësi Abdyl Këllezi, po në këtë frymë megalomanie dhe vetëkënaqësie gjykoheshin prej tij. Në këto kushte, trarin në syrin tënd nuk e sheh dot, por qimen në syrin e tjetrit e sheh. Mendjemadhësia të shtyn edhe në karrierizëm, për t'u ngjitur më lart. Po ku do të shkosh? A keni pasur ndonjë qëllim në komplotin që po kurdisej? Ti, Abdyl Këllezi, shkon deri atje saqë në Kuç të Kurveleshit të

thuhet se «ne kemi automobil, se na e dha Abdyl Këllezi». Po ku e gjete ti automobilin që dhe, si dhe fondet e tjera shumë të mëdha që po akordoje andej-këtej? Atëherë, duke vepruar kështu, qëllimi arrihet. «Unë Abdyl Këllezi jam aq i plotfuqishëm, saqë edhe një automobil në Kuç duhet të vejë në emrin tim». Kërkesa dhe përkëdhelja e kultit të çon në rrugë të gabuara të rrezikshme dhe ne mendojmë se s'bëheshin pa qëllim. Ti ke punuar, po me këto të meta në karakterin tënd dhe në detyrë nuk mund të bësh punë të paqme. Faktet e veprimtaria jote e treguan këtë.

E thashë edhe më sipër se faje s'ke vetëm ti, faje kanë edhe shokët e tjerë ministra, por fajet e tua janë shumë të rënda, puna jote është armiqësore. U dhanë kompetenca, këto mund që të ishin ca të gjera, por këto kompetenca ti, Abdyl, i përdore me qëllim të keq e të caktuar, keq i përdorën këto edhe ministrat e tjerë. Edhe ata u treguan administratorë të dobët. Ju i caktoni fondet nën limit dhe kjo ka rëndësi. Qeveria i vendos, por çdo ministër përse i përdor ato shumë keq? Ti, Abdyl, je fajtori kryesor, por janë fajtorë edhe ministri i Bujqësisë, ai i Industrisë, i Tregtisë, i Arsimit e të tjerë, që nuk i përdorin mirë këto fonde.

Ti ke faje të rënda për listorganikat dhe për çështje të tjera, siç janë byrotë teknike, por edhe ministrat e tjerë që i ngrinin, që i pranonin dhe i frynin këto, nuk kanë përgjegjësi? Kanë patjetër përgjegjësi, edhe kolegjialisht, edhe individualisht.

Në momente të vështira nevojitet pjekuria e Partisë, pse kur ajo nuk e humbet busullën në këto mo-

mente, atëherë nuk humbet as rrugën. Pra, në momentet kur na ngjanë gjithë këto gjëra, Partia nuk na lejon të tregohemi as të rrëmbyer e të pamatur, as të butë, oportunistë dhe sentimentalë, por të jemi të drejtë dhe të rreptë përballë çdo problemi dhe ndaj çdonjërit nga ne që bën gabime. Sa për armiqtë, kundër këtyre duhet të jemi të pamëshirshëm.

Puna armiqësore kundër Partisë dhe vendit tonë u zbulua në vija kryesore dhe në njerëzit kryesorë, por nuk duhet të mendojmë se çdo gjë u llagaris, se armiku u dërrmua përfundimisht. Të tilla mendime janë iluzione të rrezikshme. Kësaj pune armiqësore i duhen zbuluar të gjitha fijet, që ajo të bëhet e padëmshme. Pastaj janë konsekuencat e kësaj pune armiqësore që duhen riparuar, duhen shëruar njerëzit, duhen vënë drejt punët, duhen riparuar organizimet e shtrembra dhe organizmat e sëmurë. Kjo është një punë kolosale, jo e lehtë, por jo dhe e pakapërcyeshme.

Metodat që kemi vënë në lëvizje për të riparuar situatat janë të drejta, por këto duhet të zbatohen me këmbëngulje, gjë që do të bëhet, në rast se do të kuptohen drejt. Këtë e them se nuk kuptohen mirë qëllimi i metodës së punës dhe nevoja e zbatimit të masave që caktohen, nuk shpjegohen mirë këto dhe shumë herë zbatohen në mënyrë dogmatike. Po u zbatuan kështu metodat e punës për ndreqjen e situatave, atëherë deformohet qëllimi i drejtë i Partisë.

Prandaj duhet një vigjilencë e madhe nga ana e Partisë dhe e organeve shtetërore, njerëzit që kanë gabuar duhet t'i vëmë të punojnë gjelkë, në vende të për-



shtatshme, ku të korigjohen, por dhe të japin, pse zotësia nuk u mungon. Partia për çdo gjë duhet të ketë kujdes të madh, që të mos kalohet nga një ekstrem në ekstremin tjetër, gjë që vjen nga mungesa e pjekurisë në drejtim, nga mungesa e bindjes se ky apo ai organizëm duhet kur e krijojmë dhe s'duhet kur e shkurtojmë, po ashtu nga mungesa e guximit politik për të mbrojtur atë që duhet dhe për të zhdukur e për të kritikuar atë që s'duhet. Kësaj i thonë konformizëm. Në këto situata, kur janë krijuar me vend e pa vend organizma dhe funksione të fuckosura, të shkohet në anën tjetër, të suprimohen vende, njerëz dhe funksione që i duhen ekonomisë sonë socialiste, do të bëhej gabim i madh. Në këtë drejtim, dashur ose padashur, mund të na zhvillohet një punë tjetër armiqësore. Të ruhem nga djathtizmat, por të ruhem, gjithashtu, edhe nga majtizat.

Duhet të luftojmë konfuzionin, anarkinë, hutimin, pasigurinë dhe pritshmërinë që shkaktohen nga këto situata. Një gjendje e tillë i shërben armikut. Partia, pushteti, të gjithë njerëzit duhet të jenë në këmbë si në kohë lufte dhe jo si në kohë qetësie. Udhëheqësit, në radhë të parë, duhet të jenë kudo, jo vetëm të mbajnë fjalime e të qortojnë, por të marrin kontakt me masën, me individë, me drejtues, me punëtorë e me fshatarë, të shpjegojnë, të japin këshilla, të organizojnë në vend çdo gjë që duhet ndrequr. Kjo është metoda revolucionare për çdo kohë e për çdo njeri, por sidomos për momentet aktuale.

Detyra jonë më e madhe është që nga kjo situatë të dalim më të fortë dhe sa më parë. Duhet shpejt të hiqet

ankthi që mund të ketë krijuar dhe ka krijuar në njerëzit ky veprim frontal i armikut. Partia dhe pushteti janë në gjendje ta ndreqin shpejt dhe mirë këtë situatë, me punë e jo me llafe.

Konstatoj se ka me barrë thashetheme, fjalë boshe, shpifje. Nga disa njerëz po bëhen llafe që ushqejnë tekat e sëmura, sikur të mos kenë çfarë të bëjnë dhe me se ta shkojnë kohën. Biseda të tilla jo vetëm janë pa fryt, por edhe shumë të dëmshme. Një fjalë thuhet nga fundi i Sarandës dhe jehona e saj ndihet pas dy ditësh në Malësinë e Madhe. Vallë shfaqje patriotizmi është veprimi i këtyre njerëzve? Punë revolucionare i thonë kësaj? Jo, kjo është një punë e sëmurë, punë e njerëzve me një zbrazëti të madhe politike dhe ideologjike. Kjo duhet ta bëjë Partinë të mendohet thellë dhe të shohë nëse format e saj të edukimit dhe të informacionit janë shumë frytdhënëse.

Po, mund të thuhet, ka njerëz të tillë. Unë mendoj se njerëzit që veprojnë kështu, s'janë vetëm «njerëz të rrugëve», midis tyre ka edhe nga ata që janë punonjës në aparate shtetërore dhe partie.

Qeverisë, që i mbaroi të gjitha këto analiza, i duhet të shqyrtojë një nga një problemet dhe sektorët që do-lën me gabime dhe, me pjekuri e me gjakftohtësi, të marrë masa që t'i ndreqë. Natyrisht, këto punë nuk mund të kryhen duke bërë një mbledhje në muaj. Ka probleme që kërkojnë më parë studime, pastaj të vendosen, ka probleme të tjera që njihen, prandaj zgjidhja e tyre është e lehtë të bëhet dhe s'duhet zvarritur, ka,

më së fundi, probleme që duhet t'i zgjidhin vetë ministrat, vartësit e tyre, ndërmarrjet.

Kjo është një çështje e gjerë, e koklavitur, por nuk mund të lejohet që punët të zgjidhen as me javashllëk, as me rrëmujë dhe keq. Situatat nuk duhet t'i ngrijnë iniciativën dhe kompetencat. Iniciativë dhe kompetenca duhet të kenë përgjegjësit e çdo rangu, por këto të mos i kuptojnë dhe të mos i zbatojnë si t'u teket, siç bënë disa, që i përdorën sikur t'i kishin çorapët e tyre. Shokët e Kryesisë së Këshillit të Ministrave ankohen e thonë se «u dhamë kompetenca», por «na lanë pa informata». «Dhënien e informatave» e vutë në vend, po shumë gjëra nuk i patë, ju kaluan edhe çështje të rrezikshme bile. Prandaj mendoj se nga këto pësime duhen nxjerrë mësim.

Të jemi në krye të punëve, se ato që na ngjanë tregojnë që nuk kemi qenë si duhet as zbatues, as kontrollues, as administratorë të mirë.

Të gjitha punët e Partisë dhe të shtetit tonë, veçanërisht zbatimi i planeve ekonomike, duhet të ecin shumë më mirë nga sa kanë ecur deri tash. E vërteta është se ka gjëra të dënueshme në bujqësi, në industri, në tregti, në ndërtim etj. Kudo kemi mjaft deficite, kemi subvencionime, kemi harxhe jashtë mase. Kërkohej shumë e më shumë, pretendohet të hahet më mirë, të vishemi më mirë, të banojmë më mirë, të marrim rroga të mira dhe honorare, por, po të mos realizohen planet si duhet, në sasi dhe në cilësi, nga do të dalin këto që kërkohej?

Të jemi realistë, shokë. Dy rrugë na paraqiten: O

të ngremë prodhimin, ose rrezikohet ulja e nivelit të jetesës; o do të rregullojmë rrogat dhe do të ngremë njëkohësisht nivelin e jetesës, duke i vënë bujqësinë dhe industrinë në pozita luftarake, ose do të ulet niveli i jetesës dhe do të shtohet pakënaqësia në masat. Këto janë ligje që me llafe nuk zgjidhen, por duhen zgjidhur konkretisht me punë dhe me luftë.

Shokë dhe shoqe,

Një punë e thellë edukative, politike dhe ideologjike, po zhvillohet kudo në Parti, në organet e pushtetit, në administratë, në ekonomi, në bujqësi, në arsim e kulturë, në ushtri e kudo dhe kjo shoqërohet edhe me masa organizative të përshtatshme dhe të arsyeshme për t'i bërë këta organizma me të vërtetë drejtues, veprues dhe studiues.

Lufta që po zhvillon dhe që ka zhvilluar kurdoherë Partia kundër burokratizmit, nuk është një veprim thjesht teknik apo administrativ. Kjo luftë, në radhë të parë, ka synuar në përforcimin e një stili dhe të një metode pune revolucionare që Partia kërkon nga njerëzit dhe nga aparatet ku këta punojnë. Prandaj këto dy qëllime: lufta kundër burokratizmit dhe lufta për një stil e metodë pune revolucionare nuk mund të kuptohen si dy probleme pa lidhje me njëri-tjetrin, lufta bëhet njëkohësisht për të dyja, por që ato të bëhen mirë, duhet të kuptohen politikisht dhe ideologjikisht si shumë të

nevojshme e të domosdoshme, të shëndetshme për socializmin.

Lufta kundër burokratizmit duhet të kuptohet nga njerëzit se është e nevojshme, ashtu siç është e nevojshme për organizmin masa e ushqimit që duhet të hajë gjithsecili, që as shumë s'duhet të jetë, se shkatërron shëndetin, por as edhe pak, se nuk punon dhe nuk rron dot.

Lufta kundër burokratizmit i shqetëson disa njerëz, po shqetësimi i tyre është pa arsye dhe pa vend. Ky shqetësim vjen nga qederi «Ku do të më caktojnë? Ku do të punoj unë?». Këto dy gjëra të menduara keq e kanë burimin në një çështje: «Mos më heqin nga Tirana, se m'u shkaktua gjëma shpirtërore dhe materiale».

Po ta pyesim një njeri të tillë: Pse të lindin këto ndjenja egoiste dhe këto pretendime për personin tënd dhe nuk mendon se me qindra e me mijëra si ti kanë edhe ata të drejtën të vijnë në Tiranë dhe zotësinë të punojnë këtu? Përse e kërkon këtë privilegj për veten tënde dhe nuk mendon se mund ta ketë edhe një tjetër? Pastaj pse qenka privilegj Tirana dhe nuk konsiderohet privilegj vajtja për të punuar e për të jetuar edhe në Korçë, Shkodër, Kukës, Gramsh, Çorovodë, Kutalli, Shmil apo Fushë-Arrëz? Vallë nuk zien jeta dhe në këto qendra, nuk vlon puna në gjithë këto vende, nuk jetojnë edhe atje njerëzit tanë që punojnë e lodhen, që çlodhen, dëfrejnë, edukohen e mësojnë? Atëherë, përse na u mërzitke ti, kur të thonë të vesh të rrosh dhe të punosh në këto vende, kur e do nevoja e punës dhe e atdheut?

Ti shqetësohesh më kot, se nuk i kupton politikisht drejt problemet, nuk e kupton drejt ndërtimin e socia-

lizmit, se Shqipërinë e shikon në prizmin e ngushtë mikroborgjez të një jete sedentare, të palëvizshme, jo në zhvillimin e saj revolucionar. Ti rron me rutinën e një jete të mykur mikroborgjeze, nuk je njeri i hapësirave të gjera, nuk ecën me ndryshimet, me progresin, nuk ndjek botëkuptimin e ri, ke frikë nga e reja. Po të shkosh në një vend tjetër pune, në një qytet tjetër, në një tjetër kooperativë, ti hutohesh, akoma pa vajtur fillon të mërzitësh dhe kjo vjen se në realitet nuk i do njerëzit, ashtu siç të mëson Partia, ti ke frikë të lidhesh në miqësi me njerëzit e rinj, pse këta të duken të huaj; ti ke pasë krijuar një shoqëri të vjetër dhe ke frikë, ke druajtje të krijosh një të re.

Të gjitha këto të bëjnë të mendosh: «Obobo ç'më ngjau mua!». Po çfarë të ngjau? Asgjë! Ti do të shkosh të punosh në një qytet tjetër, në një qendër pune tjetër, sa të jetë e mundur do të të ruhet profili i zanatit, por edhe në qoftë se ky nuk ka mundësi të të ruhet qind për qind, aty afër do të kesh një punë sipas profilit, sipas zotësisë dhe moshës.

Shteti do të marrë të gjitha masat që lëvizja mos të shkaktojë shqetësime në anën ekonomike për të gjithë njerëzit e familjes tënde të aftë për punë, edhe për çështje banese po kështu. Por, edhe në qoftë se kjo e fundit nuk plotësohet dot menjëherë, duhen kuptuar drejt nevojat, duhet pasur durim. Shteti kurrë nuk do të të thotë të marrësh familjen me vete dhe të flesh në rrugë pa të siguruar strehimin. Por, kur shteti ta gjen strehimin, atëherë duhet të mblidhesh me familjen dhe jo siç bëjnë disa që shpresojnë se do të rikthehen shpejt atje nga

erdhën. Një mentalitet i tillë është i gabuar. Ata shokë përgjegjës, partie o pushteti, që u japin të tilla shpresa kuadrove që transferojnë ose që qarkullojnë, janë oportunistë, liberalë e tarafxhinj, janë nga ata që i kanë qejf hatëret.

Partia është kundër lëvizjeve të kota, të shpeshta e të paarsyeshme të të sëmurëve e pleqve, por cilido që për arsye të shëndosha duhet të lëvizë, të ndiejë një gëzim dhe jo një brengë, të thotë se do të vote të shoh, të rroj dhe të punoj me njerëz, me shokë të rinj dhe jo të mykem në një jetë rutinë; do të vote të shoh fabrika, fusha e horizonte të reja, do të mësoj nga zakonet, nga doket, nga kontaktet me vëllezër e me motra të tjerë. Prandaj të tillë njerëzve, të tillë funksionarëve duhet t'u flitet drejt dhe hapur që të zhdukin shqetësimet e kota që kanë në kokë e në zemër.

Në këto lëvizje që po bëhen ne shohim që njerëz të kooperativave, punonjës dhe specialistë, boshatisën menjëherë zyrat dhe shkuan në prodhim. Këtë gjë bënë edhe agronomë, mjekë, inxhinierë dhe specialistë të tjerë që kishin fryrë institutet dhe byrotë teknike. U lumtë të gjithë këtyre! Kjo do të thotë se ata e kanë kuptuar drejt direktivën e Partisë. Kështu duhet ta kuptojnë e ta zbatojnë edhe njerëzit e aparateve e të zyrave, pedagogët dhe mësuesit. S'duhet të ketë asnjë hezitim, pse kjo bëhet për të mirën e atdheut dhe e mira e atdheut është edhe e mira e tyre. Këto dy gjëra nuk ndahen dhe Partia këto të dyja nuk i ndan nga njëra-tjetra.

Partisë i dhemb kur ndien se te disa ka shqetësime

dhe bën çmos që t'ua zhdukë e të krijojë edhe tek ata gëzim. Në këtë rrugë të drejtë Partia duhet t'i ndihmojë të gjithë njerëzit. Çdo gjë që bën Partia e bën për të mirën e shoqërisë dhe të njerëzve.

Janë bërë edhe gabime, të cilat nuk mund të fshihen. Këto gabime njerëzit i kanë bërë, prandaj autorët e tyre duhet të ndëshkohen dhe të edukohen. Edhe Partia, edhe klasa, edhe masat duhet të jenë vigjilente. Motoja «beso e kontrollo» nuk është vetëm për disa, por për të gjithë. Ka njerëz që na hiqen shumë të zgjuar, shumë revolucionarë, shumë rigorozë kur s'duhet, por edhe shumë oportunistë, prapë kur s'duhet. «Ku ishin, pse nuk i panë më parë këto gjëra dhe këta armiq?», thonë disa nga këta «të zgjuar». Dakord, pyetja është me vend, por kjo pyetje u vihet edhe atyre: «Po ju ku keni qenë? Përse nuk i keni parë këta njerëz që venin e vinin te ju, që bisedonin me ju, që ju u kërkonit dhe ata jua bënë nga një favor me qëllim që ju të mbyllnit gojën edhe atëherë kur duhej të flitnit etj.? Kështu ju ka mësuar Partia të vepronit? Natyrisht, jo!».

Atëherë duhen bashkuar forcat, përpjekjet, vigjilenca, duhen fuqizuar puna, prodhimi, edukimi dhe jo të bëhen muhabete të kota e pa baza, duke menduar se gjoja kështu ndreqen punët, por që në fakt këto prishin punë. Armiku çdo gjë shfrytëzon, prandaj nga cilido kërkohet punë me mend dhe me përgjegjësi. Armiku dhe parullat e tij duhen luftuar.

Ne këtu, në Komitetin Qendror, shtruan dhe diskutuan këto probleme të rëndësishme, analizuan the-



llë, më duket mua, edhe gabimet, edhe fajet që janë vërtetuar. U bënë autokritika dhe kritika konstruktive, u analizuan dhe u vunë në dukje fajet kolektive dhe fajet personale. Të gjitha këto duhet të na bëhen mësim të vlefshme.

Për njerëzit që gabojnë duhet të marrim edhe masa, që do të ndikojnë në edukimin e tyre.

Siç rezultoi nga të gjitha këto analiza në forume të ndryshme të Partisë dhe të Qeverisë, Koço Theodhosi ngarkohet me faje të rënda për mungesë vigjilence revolucionare në drejtimin e sektorit të naftës, ku u lejuan të vepronin dhe të na sabotonin për një kohë të gjatë ekonominë tonë elementë armiq. Mosshqetësimi i tij për këtë punë armiqësore të grupit sabotator të naftës, mosmarrja e masave, mosvënia në korent udhëheqjen e Partisë dhe të shtetit, familjariteti i dyshimtë me Pirro Gushon e Lipe Nashin, aprovimi i plotë për çka thoshin inxhinierët sabotatorë, do të thotë se te Koço Theodhosi ka diçka më shumë se mungesë vigjilence. Koços jo vetëm i ka munguar vigjilencia revolucionare, por ai ka treguar edhe shumë paaftësi drejtimi dhe organizimi në funksionet që i ishin ngarkuar si anëtar i Byrosë Politike dhe ministër i Industrisë dhe i Minerave. Me të tilla funksione dhe përgjegjësi, Koço Theodhosi nuk i lejohet që të shfrytëzoheshin në mënyrë kaq kriminale fonde kolosale që shteti i kishte rezervuar industrisë së naftës, nuk i falet lehtë lënia e shtetit tonë socialist për pesë vjet me radhë pa fusha të reja naftë. Janë të papranueshme nga parimet politiko-organizative të Partisë prirjet e theksuara të Koço Theodhosit për krijimin

e drejtorive të përgjithshme, që ishte një formë shkëputjeje nga parimi i centralizmit demokratik të drejtim, dhe ecja e tyre në një drejtim të gabuar e të rrezikshëm të vetadministrimit. Të gjitha këto gabime e faje të rënda të Koços nuk e kanë burimin thjesht në një cektësi ideologjike dhe në një mungesë përpjekjesh të thella e të vazhdueshme nga ana e tij për të studiuar teorinë tonë shkencore marksiste-leniniste dhe eksperiencën e shumanshme e të vlefshme të Partisë sonë. Të gjitha këto na bëjnë të mendojmë se Koço Theodhosi ishte futur në komplot, në një punë të organizuar armiqësore kundër Partisë dhe pushtetit. Për këtë gjë unë bashkohem me propozimet e gjithë shokëve dhe mendoj që Koço Theodhosi të mos jetë më anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror, të shkarkohet nga detyra si ministër i Industrisë dhe i Minerave, të përjashtohet nga Komiteti Qendror dhe nga Partia. Me punë të palodhur, atje ku do të caktohet, Koçoja duhet të punojë dhe të provojë me vepra se po ia lan ndershmërisht dëmet e mëdha që i ka bërë çështjes së madhe të socializmit<sup>1</sup>.

Abdyl Këllezi ka përgjegjësi të madhe dhe të rëndë për punën e rrezikshme dhe armiqësore që u zhvillua në sektorin e naftës. Ne e theksuam se Koço Theodhosi ka përgjegjësitë e veta, por Abdyl Këllezi nuk qëndron aspak larg atij dhe, si kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit, jo vetëm ka përgjegjësi se veproi në mënyrë

---

1. Koha vërtetoi se Koço Theodhosi ishte zhytur thellë në veprimtarinë armiqësore, ndaj mori dënimin e merituar nga gjyqi i popullit.

aktive dhe lejoi një gjendje të tillë, por edhe si anëtar i Byrosë Politike atij i mungoi vigjilenca revolucionare për vite me radhë për të mos diktuar punën armiqësore që zhvillonin sabotatorët në naftë. Abdyl Këllezit as që i shkoi ndonjëherë në mendje se atje po bëhej një punë armiqësore, por edhe kur u duk qartë e ia thanë atij dhe Koço Theodhosit në aktiv, ai nuk e konceptonte dot një gjë të tillë. Kjo nga ana e tij tregon miopi politike të madhe, një prirje jo vetëm për të dobësuar dhe për të nënvleftësuar luftën e klasave, por edhe për të goditur pushtetin popullor. Qëndrimet e Abdyl Këllezit tregojnë se te ky person është i theksuar oportunizmi, por jo vetëm kaq. Veprimtaria, qëndrimet, përkrahjet, mosvënja në korent e udhëheqjes për sabotimet dhe sabotatorët, mosmarrja e masave për ta penguar këtë veprimtari armiqësore tregojnë se Abdyl Këllezi ka qenë brenda në komplot në një punë të organizuar armiqësore me një gjerësi të madhe.

Përveç kësaj, kjo veprimtari liberale dhe armiqësore në industrinë e naftës ka dukje të theksuara edhe në gjithë punën e Abdyl Këllezit në tërë atë sektor të gjerë e shumë të rëndësishëm që drejtonte ai në Komisionin e Planit të Shtetit. Abdyl Këllezi ka qenë frymëzuesi dhe përkrahësi kryesor i fryrjes së aparateve shtetërore, të organizmave të shumtë të copëtuar e të fryrë, të mungesës së kontrollit nga ana e tij në drejtim të detyrave që i qenë ngarkuar nga Qeveria etj. Abdyl Këllezi nuk i ka bërë këto veprime nga mungesa e kapacitetit, as nga padija, as rastësisht, por me ndërjegje dhe me qëllim që të luftojë pushtetin popullor. Ai e ka të thek-

suar mungesën e qartësisë ideologjike marksiste-leniniste dhe në vend të saj edhe origjina, edhe mënyra e jetesës dhe e të menduarit e kanë çuar atë të gërshetojë slogane gjoja marksiste-leniniste për të kamufluar pikëpamjet e tij revizioniste titiste-sovjetike. Të treguarit shumë «aktiv» i shërbente atij dhe si mbulesë e personit të tij të dyfishtë. Ai ka, gjithashtu, shumë të theksuar mendjemadhësinë dhe vetëkënaqësinë për veprimet dhe për mendimet e tij. Abdyl mendonte se çdo gjë që thoshte dhe që kryente ky ishte e drejtë dhe me prepotencën, si me thënë, të njeriut kompetent u imponohej edhe të tjerëve, atyre që mundte. Tash duket hapur tendenca e përpjekjeve që bënin njerëz të tillë si Abdyl, Koçoja e të tjerë për të komprometuar sa më shumë njerëz. Por Partisë këta nuk mund t'ia hedhin dot. Abdyl Këllezi mendonte dhe punonte jo vetëm për dëmet që i vinin ekonomisë socialiste nga kjo punë e dënueshme e tij, por punonte që të shtohej katastrofa për vendin tonë. Partia i tha «Ndal!».

Abdyl Këllezi interesohej shumë për zhvillimin e kultit të personit të tij dhe përpiquej që shkëlqimi i veprimeve dhe i sukseseve të klasës dhe të Partisë të binte tek ai në një pjesë të konsiderueshme, pse ishte anëtar i Byrosë Politike dhe kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit që «drejton gjithë ekonominë». Janë vetëm karakteristika të karakterit borgjez dhe mikroborgjez të tij këto? Patjetër se po, por ai punonte edhe për një të ardhme borgjezo-revizioniste që po i përgatitej atdheut tonë nga grupet armiqësore.

Për të gjitha këto, unë mendoj që edhe Abdyl Kë-

llezi të mos jetë më anëtar i Byrosë Politike, të shkarrohet nga detyra shtetërore si kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit dhe të përjashtohet nga Komiteti Qendror e nga Partia. Abdyl duhet të korrigojohet thellësisht nga të metat, të jetë kokulur, të njohë fajet e tij të rënda. Abdyl Këllezi është gjendur edhe herë të tjera në gabime të rrezikshme antiparti e antishtetërore dhe tani duhet të vërë mend që të mos shkojë më thellë në veprimtarinë e tij.

Partia i ka vlerësuar në kohën e duhur gabimet e Abdyl Këllezit, sa herë që ato janë shfaqur, ajo është treguar e drejtë, ka bërë diferencime dhe i ka pasë dhënë dorën derisa ai erdhi dhe në Byronë Politike. Kjo tregon, nga një anë, drejtësinë e Partisë ndaj kuadrove dhe, nga ana tjetër, pandreqshmërinë dhe armiqësinë e disa kuadrove të tillë. Prandaj kritikata dhe dënimet e drejta e të merituarat të Komitetit Qendror t'i marrë seriozisht, që t'i shërbejnë për të mos gabuar më dhe të punojë shumë atje ku do të caktohet<sup>1</sup>.

Kiço Ngjela, sipas mendimit tim, duhet të kritikohet rëndë dhe të paralajmërohet shumë seriozisht, pse puna në ministrinë që drejton ka qenë shumë e sëmurë, shumë e molepsur dhe formonte një rrezik të madh për ekonominë tonë. Kjo punë përbënte rrezik edhe për Sigurimin e Shtetit. Kiço Ngjela është përgjegjës për ato që u zbuluan në dikasterin e tij.

---

1. Abdyl Këllezi nuk e përiligji as këtë ndihmë që i dha Partia. Më vonë gjyqi i popullit e dënoi për krime kundër shtetit.

Fakt është se ai ishte rrethuar me elementë armiq, matrapazë, antiparti dhe të dyshimtë për lidhje me armiqtë e jashtëm. Ai jo vetëm nuk e mprehu vigjilencën kundër këtyre elementëve të këqij, por i mbrojti deri në fund me një mendjelehtësi dhe prepotencë të dënueshme.

Karakteristikë e Kiço Ngjelës është se ky ka dy natyra: Një natyrë të ashpër për jashtë dikasterit të tij dhe një natyrë të butë, oportuniste dhe liberale për bashkëpunëtorët dhe vartësit në ministrinë ku drejton. Kjo situatë është krejt e dukshme në karakterin e Kiços. Toni i tij i ashpër të jep përshtypjen sikur kërkon llogari, por toni i butë karshi bandës që kishte bërë fole në Ministrinë e Tregtisë e rrëzon të parën. Kiço Ngjela duhet të mësojë se nuk gabohemi aq kollaj nga taktika e tij: të atakojë që të evitojë kritikën dhe dhënien e llogarisë. Mos i merr Partinë dhe Komitetin Qendror përleshko, se gabohet rëndë! Qëndrimi yt shumë i gabuar, jovigjilent, jorevolucionar u dha mundësi armiqve, që ishin struktur nën ombrellën tënde, të shinin brenda e jashtë vendit me veprime të paligjshme dhe armiqësore, të spekulonin sigurisht me çmimet e eksport-importhit, të vinin me mijëra dollarë në bankat e huaja në emrin e tyre, natyrisht, jo të nxjerrë prej kursimeve nga rrogat, por nga matrapazllëqet. Njerëz si Andrea Mançoja dhe një kategori si ky, vallë bënin vetëm këto gjëra, apo ishin edhe në shërbim të agjenturave armike? Sigurisht, duhet të dyshojmë. Nuk është nevoja të na thonë vetë këta se janë agjentë të Intelixhens Servisit. Nuk të tërhoqi vëmendjen ty, Kiço, blerja nga ana e tyre

e kamionëve anglezë të këqij, që i sollën për të rinj dhe me një kosto prej tre milionë dollarësh, në qoftë se nuk gabohem? Tok me ta sollën edhe agjentë të Intelixhens Servisit gjoja për të bërë riparimet, menjëherë sa i futën në punë!

Ç'janë këto gjëra, Kiço, që janë bërë nën hundën tënde? Ku e ke pasur kokën? Shumë herë je kritikuar, se qaheshin ndërmarrjet e ndryshme nga importi, por ti avancoje çdo herë arsye objektive: jo largësitë, jo rrugët, jo koniunkturat botërore. Mirë të gjitha këto, por asnjëherë nuk të shkoi ndër mend të kontrolloje punën e gjithë këtyre myteberëve të borgjezuar që mërrinin si specialistë, zëvendësministra, disa prej tyre drejtorë, disa të tjerë atashe tregtarë?

Kiço Ngjela është fajtor, atij i kanë munguar viggjilenca dhe ngritja ideopolitike, ai është treguar liberal në punë dhe ka pasur familjaritet të theksuar e butësi në kërkimin e llogarisë ndaj vartësve.

Mos harro, Kiço, se në Plenum s'bëre fare autokritikë ose këtë e bëre të zbehtë. Kjo nuk mund të kalojë kështu, prandaj reflekto thellë dhe i bëj një autokritikë të hapët, me shkrim, Komitetit Qendror.

Të gjitha këto unë mendoj se Kiçon duhet ta shkundoj dhe t'i shërbejnë si paralajmërim për të mos i përsëritur më. Mendoj t'i jepet njëkohësisht një vërejtje e rëndë me shënim në kartën e regjistrimit<sup>1</sup>.

---

1. Faktet e shumta që dolën më vonë provuan veprimtarinë armiqësore të Kiço Ngjelës, prandaj gjyqi i popullit e dënoi atë për krime kundër shtetit.

Ju dëgjuat diskutimin mizerabël të Ramadan Xhangollit<sup>1</sup>. Ai u paraqit këtu duke na thënë se iu desh të përgatiste dy diskutime: Një para se të vinte në Plenum dhe një tjetër pasi dëgjoi pyetjet e shokëve dhe çështjet që dolën për Koço Theodhosin. Ramadan Xhangolli deshi të na bindte sikur këto gjëra, që provojnë sa thellë është futur Koço Theodhosi në punën armiqësore e sabotuese në sektorin e naftës, i paskan ardhur papritur, i mësoi vetëm këtu, në Plenum. Ramadan Xhangolli «e qortoi» Koço Theodhosin që nuk iu përgjigj pyetjeve të tij, që ishin pyetje «shoqërore» e jo «me spec» si të të tjerëve. Dhe kur shokët e Plenumit e vunë Ramadan Xhangollin me shpatulla pas muri, duke e pyetur përse pyetjet e shokëve qenkan me spec dhe të tijat qenkan shoqërore, ai pohoi se me Koço Theodhosin ka pasur miqësi të ngushtë, ndryshe nga të tjerët. Në fillim ai u përpoq të na bindte se në takimet e tyre «miqësore» s'kishin biseduar për çështjet e naftës e punën e sabotatorëve, veçse Koço Theodhosi i paska kërkuar këshillë këtij farë «kryeplaku fshati» se si ta bënte autokritikën e tij në Plenum. Ai s'mundi të mohonte se kanë biseduar për kritikën që i janë bërë në Byronë Politike e në Qeveri Abdyl Këllezit, për dyshimet e Koço Theodhosit mbi vetëvrastjen e Pirro Gushos etj. Dhe ky këndes pa pupla, i cili në fillim na u paraqit me dy diskutime, duke u hequr sikur ra nga qielli, kur mori vesh për punët e fëlliqura të Koço Theodhosit

---

1. Në atë kohë sekretar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë.



e të Abdyl Këllezit, në fund të seancës, gjatë pushimit, kërkoi të takohej me mua që të më deklaronte se ai në Shtëpinë e Partisë, ku herë pas here mbliidhen shokë të udhëheqjes, vinte posaçërisht për të dëgjuar çfarë thuhej për elementët sabotatorë e punë të tjera dhe informatat e marra ia transmetonte Koço Theodhosit. Ai luante kështu rolin e informatorit të grupit sabotator e armik të naftës dhe të ekonomisë.

U bë e qartë për ne se me Koço Theodhosin, por edhe me të tjerë që nuk dihen, Ramadan Xhangolli ka biseduar dhe ka punuar në rrugë grupazhi kundër Partisë. Del kështu që është implikuar edhe ky në këtë punë komplotiste.

Nuk është hera e parë që Ramadan Xhangolli krijon miqësira të tilla të sëmurë. Ai është implikuar në këtë rrugë edhe me Nexhip Vinçanin e Gjin Markun, kur këta zhvillonin veprimtari armiqësore kundër Partisë, por atëherë Komiteti Qendror bëri diferencimin, duke i dhënë mundësi Ramadanit që të ndreqej. Jeta tregon se ky nuk u shërua nga këto sëmundje të këqija dhe vazhdoi në rrugën e tij armiqësore kundër Partisë.

Ramadan Xhangolli është një njeri pa vlerë. Aftësia e tij është të thurë intriga dhe të zhvillojë punë grupazhi, pse sa për punën, dihet se kudo është treguar i pazoti, prandaj ka qenë shkarkuar tri herë si sekretar partie rrethi.

Për të, më duket, është e tepërt të zgjatem më shumë, prandaj i propozoj Plenumit që Ramadan Xhangolli të përjashtohet nga Komiteti Qendror dhe nga Partia.

Për Thoma Delianën do të thosha se ky nuk po tregohet i aftë për të drejtuar arsimin dhe kulturën. Ai nuk u tregua i mprehtë dhe vigjilent në diktimin e punës armiqësore të Fadil Paçramit, as organizator i mirë në ndjekjen e detyrave të rëndësishme ideologjike që kishte vënë Partia përpara shkollës dhe kulturës sonë socialiste. Ai ka lejuar të përhapen ide të sëmura në disa kuadro dhe institucione, ka lejuar indisiplinimin në dhënien e mësimeve dhe në kualifikimin e nxënësve, studentëve, mësuesve e pedagogëve, është treguar liberal në kërkesat për zbatimin e disiplinës shkencore në shkolla dhe në marrëdhëniet me njerëzit. Për këto unë mendoj se Thoma Deliana nuk e kryen si duhet detyrën që i ka ngarkuar Partia, por e bën këtë me shumë të meta, gabime e boshllëqe, prandaj mendoj të paralajmërohet seriozisht për këto dobësi dhe propozoj t'i jepet një vërejtje e rëndë me shënim në kartën e regjistrimit, sikurse është propozuar edhe nga disa shokë.

Veprimtaria kryesore e armiqve sabotatorë me Pirro Gushon e Lipe Nashin, Abdyl Këllezin e Koço Theodhosin, si dhe bashkëpunëtorët e tyre, u zbulua dhe u likuidua. Ky është një sukses i madh që duhet të na forcojë ndërgjegjen dhe besimin në veprimtarinë e drejtë dhe shpëtimtare të Partisë, e cila na udhëzon e na udhëheq drejt në punën për ndërtimin e socializmit dhe në luftën e klasave kundër të gjithë armiqve që përpigjen të dëmtojnë Partinë dhe pushtetin tonë popullor. Prandaj të gjithë, Parti dhe popull, të çohen në këmbë dhe të mobilizohen për të kryer detyrat sa më parë e sa më mirë në të gjithë sektorët. Këto që ngjanë të na

shërbejnë për të ngritur më tej vigjilencën revolucionare, në radhë të parë të komunistëve, dhe të të gjitha masave punonjëse të vendit tonë, pse armiku na sulmon dhe përsëri do të na sulmojë, prandaj të jemi vazhdimisht në luftë kundër armikut dhe të fitojmë ashtu sikundër kemi fituar kurdoherë mbi të.

### Shokë,

Pas gjithë këtyre masave të domosdoshme që kemi marrë për spastrimin e udhëheqjes së Partisë nga elementët armiq, lind nevoja e plotësimit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror me shokë të rinj. Ne kemi përjashtuar nga udhëheqja dhe nga Partia në Plenumin e 4-t, të 5-të, të 6-të dhe në këtë Plenum tre anëtarë dhe një kandidat të Byrosë Politike për veprimtari armiqësore. Shosha e Partisë qëroi nga udhëheqja «egjërën», ajo flaku tej elementët antiparti, armiq të socializmit e të popullit dhe jemi të ndërgjegjshëm se me këtë punë do të forcohen më shumë Partia dhe udhëheqja.

E kemi detyrë të domosdoshme që, për të siguruar vazhdimësinë, të ngremë shokë me moshë relativisht të re, të provuar në luftën e madhe që udhëheq Partia për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e atdheut dhe të marksizëm-leninizmit nga armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm. Të sjellim në Byronë Politike elementë të klasës, me origjinë dhe me gjendje punëtore, sidomos nga ata anëtarë të Plenumit që, gjatë gjithë veprimtarisë së tyre, kanë treguar zotësi e konsekuencë në

zbatimin e vijës së drejtë të Partisë. Tash Partia jonë ka përgatitur dhe ka kuadro rezervë të dalë nga gjiri i klasës sonë punëtore, besnikë të çështjes së atdheut e të socializmit, energjikë, të qëndrueshëm, komunistë e patriotë të zjarrtë.

Lidhur me sa më sipër propozoj që kandidatët e Komitetit Qendror: shokët Pali Miska, Llambi Gegprifti dhe Qirjako Mihali të ngrihen në anëtarë të Komitetit Qendror<sup>1</sup>.

Meqë ju, shokë, u shfaqët dakord me sa u para-shtrua, atëherë propozoj që të vijnë në Byronë Politike:

### I. Si anëtarë të Byrosë Politike:

1. **Shoku Hekuran Isai.** Lindur më 1933 në Peqin të rrethit të Elbasanit, me origjinë punëtore. Ka mbaruar Shkollën e Lartë të Partisë, pranuar në Parti më 1957.

Vetë ka qenë tetë vjet punëtor, pastaj është ngritur vazhdimisht në udhëheqje të organizatës së ndërmarrjes, sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit, pastaj sekretar i parë i komitetit të Partisë në rrethet Librazhd dhe Dibër. Në Kongresin e 5-të është zgjedhur kandidat dhe në Kongresin e 6-të anëtar i Komitetit Qendror të PPSH. Është deputet në Kuvendin Popullor.

---

1. Në këtë Plenum shokët Hekuran Isai dhe Pali Miska u zgjedhën anëtarë të Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe shokët Llambi Gegprifti e Qirjako Mihali kandidatë të saj.

Duke qenë gjithnjë një aktivist i mirë shoqëror, ka milituar aktivisht në organizatat e masave. Vlerësohet si punëtor i palodhur dhe që vazhdimisht ka mbajtur qëndrime të drejta konsekuente parimore, është kurajoz, bën kritikë dhe autokritikë dhe lufton të ruajë cilësitë e mira të klasës punëtore.

Shoku Hekuran Isai propozohet, gjithashtu, të zgjidhet edhe sekretar i Komitetit Qendror në vend të shokut Petro Dode, i cili propozohet të shkojë kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit e zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave.

**2. Shoku Pali Miska.** Lindur më 1931 në Bradvicë të Korçës, me origjinë fshatar i varfër. Familja e tij gjatë luftës e më pas ka mbajtur e mban qëndrim të mirë. Është pranuar anëtar partie më 1951. Ka mbaruar Institutin e Lartë Ekonomik.

Ka punuar shtatë vjet punëtor sharre, më vonë është ngritur në përgjegjësi deri drejtor i Ndërmarrjes së Sharrave në Fushë-Arrëz. Më 1968 u zgjodh sekretar e mandej sekretar i parë i komitetit të Partisë të këtij rrethi dhe kohët e fundit sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Kukësit. Në Kongresin e 6-të është zgjedhur kandidat i KQ të PPSH. Si sekretar i parë në rrethin e Pukës ka drejtuar mirë, ka fituar përvojë si punëtor partie, është i lidhur me masat dhe gëzon respekt në organizatën e Partisë e në popullin e rrethit ku ka punuar. Me rastin e 30-vjetorit të Çlirimit i është dhënë titulli «Hero i Punës Socialiste». Është deputet në Kuvendin Popullor.

Gjithashtu propozohet që shoku Pali Miska të emërohet ministër i Industrisë dhe i Minierave.

## II. Si kandidatë të Byrosë Politike:

1. Shoku Llabi Gegprifti. Lindur në Potkozhan të Pogradecit më 1942. Me origjinë fshatar i varfër. Qëndrimi i familjes së tij gjatë luftës e më pas ka qenë dhe është i mirë. Pranuar në Parti më 1964.

Vetë ka qenë për disa vjet punëtor. Ka mbaruar Fakultetin Gjeologji-Miniera, kursin e lartë njëvjeçar të ekonomisë politike pranë Shkollës së Partisë dhe vazhdon me korrespondencë degën mekanike të Fakultetit të Inxhinierisë.

Në shkollë është dalluar si nxënës e student i mirë, ndërsa si inxhinier, punëtor partie e drejtor ndërmarrjeje ka bërë punë të frytshme e të palodhur, është dekoruar me Urdhrin «Për punë të shquar në minierë-gjeologji» të Klasit të 2-të. Kudo është cilësuar si kuadër me partishmëri. Është i ri, me aftësi dhe me perspektivë. Tip studioz, i thjeshtë, i ndershëm, masovik dhe gëzon simpatinë e respektin e masave kudo ku ka punuar. I papërtuar në punë dhe ka treguar aftësi të mira drejtuese e organizative, mbështetet në masat e vlerëson vërejtjet dhe mendimet e tyre. Në Kongresin e 6-të është zgjedhur kandidat i KQ të PPSH. Në dhjetor të vitit 1974 është emëruar zëvendësministër i Mbrojtjes Popullore, detyrë që kryen edhe tani.

2. Shoku Qirjako Mihali. Lindur më 1929 në Korçë, me origjinë punëtor, babai i tij ka qenë murator. Anëtar partie pranuar më 1949. Ka mbaruar studimet e larta për inxhinier i përpunimit të naftës. Qëndrimi i familjes gjatë luftës e më pas ka qenë dhe është i mirë.

Gjatë nëntëmbëdhjetë vjetëve të punës së tij në bazë, në industrinë e përpunimit të naftës dhe në uzinën e nitrat amonit «Gogo Nushi», është treguar punëtor i palodhur, ka bërë përpjekje për të kryer mirë detyrat, duke u mbështetur në masat, ka organizuar e ka drejtuar mirë punën, ka luftuar të njohë problemet e ndërmarrjes dhe të kryejë detyrat e planit. Është shok me partishmëri, me aftësi dhe me cilësi të mira si komunist e si kuadër. Ka bërë vazhdimisht përpjekje për të rritur më tej nivelin e tij. Ai nuk është konformuar me veprimet armiqësore të Pirro Gushos e të Koço Theodhosit, prandaj ata janë orvatur ta shkarkonin nga detyrat që kishte. Që në Kongresin e 5-të është zgjedhur kandidat i KQ të PPSH.

Më lejoni tani të them disa konkluzione të nxjerra nga vëzhgimi i ngjarjeve politike ndërkombëtare.

Amerikanët i lanë duart nga Kamboxhia. Tok me kukullën e tyre, Lon Nolin, ata vranë e vranë kamboxhianë, dogjën qytete e fshatra dhe, në pamundësi për të vazhduar më tej barbarizmat, u thyen dhe u tërhoqën bashkë me Lon Nolin e me kriminelët e tjerë të luftës.

Tash forcat e Frontit, siç e dini, janë brenda në Pnom-Pen dhe në gjithë Kamboxhian. Kjo është një fitore e madhe. Reaksioni jep shpirt dhe është në drithmën e fundit para vdekjes.

Nga ana tjetër, i gjithë Vietnami i Jugut u çlirua, Sajgoni ra me luftë dhe jo në bazë të kompromisit të traktateve të Parisit. Me rënien e Sajgonit mori fund

një nga luftërat më të gjata e më barbare që ka parë bota gjatë këtij shekulli. Imperializmi amerikan kishte zënë vendin dhe luante rolin e imperializmit fashist hitlerian, kurse populli heroik vietnamez, për më shumë se 35 vjet me radhë, luftoi heroikisht dhe pa pushim kundër francezëve, kundër japonezëve, përsëri kundër francezëve dhe kundër amerikanëve. Nga gjatësia e luftërave kjo e Vietnamit u ngjet luftërave 100-vjeçare, 30-vjeçare etj. të shekujve të kaluar, por lufta e imperializmit amerikan në Vietnam ua kaloi egërsisë, barbarizmave dhe mjeteve që u përdorën në Luftën e Dytë Botërore.

Megjithëkëtë, populli vëlla heroik vietnamez luftoi me armë në dorë, rezistoi dhe fitoi.

Lufta në Vietnam vërtetoi tezën leniniste se pushteti popullor fitohet me pushkë, me luftë. Derri do plumb. Imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik dhe borgjezia reaksionare duhen luftuar me armë nga popujt. Këta vetëm kështu mund të çlirohen. Historia nuk ka dhënë asnjë shembull që popujt dhe klasa punëtore të marrin në dorë pushtetin në rrugën parlamentare dhe reformiste.

Revizionistët modernë e reklamojnë shumë këtë rrugë, bile e theksojnë si të veçmen, se ata janë kundër revolucionit në përgjithësi, e sidomos kundër revolucionit proletar, kundër çlirimit të popujve. Revizionistët janë për pajtimin e proletariatit me padronët kapitalistë, janë për reforma, nga të cilat proletariati të marrë thërrimet e sofrës së majme të kapitalistëve, janë për «kompromisin historik» të revizionistëve italianë.



Siç e dimë, marrëveshja e Parisit ishte pjella e kompromisit të ndyrë sovjeto-amerikan në kurriz të vietnamezëve. U desh që vietnamezët të vazhdonin luftën që të arrinin në çlirimin e plotë të atdheut të tyre, siç arritën. Partia jonë ua pati thënë hapur shokëve vietnamezë pikëpamjen e vet për marrëveshjen e Parisit se, pa e hedhur në shportë këtë marrëveshje, nuk do të kishte çlirim të vendit të tyre. Dhe kështu ngjau.

Imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik vazhdojnë të armatosen në mënyrë të hapët e me arrogancë, pa përfillur opinionin publik botëror. Ata janë gati t'i hidhen në grykë njëri-tjetrit dhe të tjerëve, njëri pas tjetrit. Vazhdon armatosja dhe çdo ditë që kalon duket më shumë psikoza e shfrenuar e luftës. Të dyja superfuqitë kanë vënë në gatishmëri e në lëvizje çdo gjë, forcat e tyre të armatosura në dete e në oqean, në portet e ndryshme të tyre dhe në baza detare të vendeve të treta, të marra me qira ose të grabitura me forcë. Sapo një flotë e mbiujshme ose e nënujshme e një superfuqie del në ndonjë det ose oqean, aty përnjëherë ia mbërrin edhe flota e superfuqisë tjetër. Këto flota rivalizojnë, por bëjnë edhe politikën e kanonierave kundër atyre vendeve të treta, udhëheqësit e të cilave ose duan të çlirohen nga kthetrat e këtyre dy armiqve të egër, ose përpiqen të heqin zinxhirin e njërës për të rënë nën zinxhirin e tjetrës, që i jep më shumë dollarë apo më shumë rubla. Këto flota agresive detare dhe ajrore në dete e në baza të ndry-

shme u përngjasin atyre sharonjarëve<sup>1</sup> që fluturojnë mbi kufomat e të vrarëve në fushat e betejës. Ato janë të gatshme për të mbështetur politikën agresive të qeverive përkatëse, presin sinjalin e veprimit të diplomacisë së agresionit që shoqërohet me spiunazh të shfrenuar, por edhe me tregti për të blerë dhe për të korrup-tuar ata që janë të korruptueshëm në vende të ndryshme, të cilët i përdor për të ushtruar atje influencën, për intriga, korrupsion, «luftë civile» dhe për komplete.

Të dyja superfuqitë janë kthyer në tregtarë armësh aq të tmerrshëm, saqë Armstrongët, Mauzerët, Bazil Zaharovët e së kaluarës, po t'i krahasosh me ta, duken si shitës lodrash për kalamanët. Por këto armë shiten, natyrisht, për llogari të tyre, për të mbrojtur secila interesat e vet strategjike dhe për t'i vënë blerësit e këtyre armëve në luftë me njëri-tjetrin.

Të marrim një nga sheshet e betejës: Lindjen e Mesme. Këtu një numër shtetesh arabe janë në grindje e në mosmarrëveshje haptazi me Izraelin. Por, në realitet, në këtë rajon janë të dyja superfuqitë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, që grinden për zona influence, për naftën, për sigurimin e rrugëve imperiale, për depërtim në kontinentet e Afrikës e të Azisë për të siguruar tregje shfrytëzimi, për shkatërrim qytetërimesh dhe për skllavërim popujsh. Qeverive dhe klikave reaksionare të këtyre vendeve,

---

1. Nga frëngjishtja — zogj që ushqehen me kërma.

të përgatitura nga diplomacia e tyre e agresionit, u shesin vetëm armë dhe u rrëmbejnë popujve bukën e gojës. Kush të kërkojë më shumë armë dhe kush të shesë më shumë! Qeveritë e vendeve të naftës janë krimbur në dollarë dhe me këta blejnë armë nga Bashkimi Sovjetik, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Franca, nga Anglia dhe nga kush ka t'u shesë. Po për çfarë i blejnë këto armë? Për të shtypur popujt e tyre, për të goditur popuj të tjerë dhe për të ndihmuar gjithsecili padronin e vet. Sadati hedh valle në litar. Ai lidhet me Brezhnjevin dhe merr armë prej tij; pastaj zemërohet me të dhe lidhet me «vëllanë» Kisinger, i cili është vëlla edhe me Izraelin, që me Egjiptin është në luftë. Kisingeri kështu manovron me të dy. Rusi e ka «grurë» me Sirinë, e cila merr armë prej tij dhe është pizmosur me Egjiptin, që e ka mirë me mbretin e Arabisë Saudite dhe ky nuk e ka keq me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që mbrojnë Omanin dhe kanë ndërtuar baza atje. Omani ka miqësi dhe mbrohet nga shahu i Iranit, i cili është në konflikt me Irakun, që është edhe prosovjetik, edhe kundër Jordanisë, e cila është proamerikane, antiegjiptiane dhe kundër Organizatës për Çlirimin e Palestinës, e kështu mund të vazhdojmë gjatë. E gjithë kjo është pasqyrë reale e politikës në Lindjen e Mesme.

Ç'po ngjet në Mesdhe?

E njëjta gjë. Kolonelët e Athinës bënë puç në Qipro, të shtyrë nga CIA. Dështuan edhe ata, edhe amerikanët. Bashkimi Sovjetik «mbrojti» Qipron dhe «inkurajoi» Turqinë. Kjo sulmoi Qipron dhe u vendos

atje. Greqia u zemërua keq për këtë, po s'kishte ç'të bënte. Ajo kërcënoi NATO-n dhe doli «përgjysmë» prej saj. Shtetet e Bashkuara të Amerikës u zemëruan me Greqinë, rusi e la Turqinë dhe e ktheu fytyrën me buzëqeshje cinike nga Greqia. Senati i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i frikësuar se mos rusi futej në Greqi, mori një vendim që t'ia priste Turqisë furnizimet me armë. «Të jap unë armë», i tha kësaj rusi. Mirëpo meqë Shtetet e Bashkuara të Amerikës rrezikoheshin në të dyja tablotë, atëherë organizuan, tash së fundi, me CIA-n, një puç të ri «të vogël» sa për paralajmërim kundër Karamanlisit dhe pro Papadhopollosit. Ky puç dështoi, por duhen pritur të tjera që do të vijnë pas, pse në Ballkan nuk ka qetësi, nuk ka stabilitet, ka vende ku sundon kjo ose ajo superfuqi të armatosura deri në dhëmbë, që në gjak nuk kanë veç luftën grabitqare, intrigat, shtypjen, agresionin.

Bota zien mbi një vullkan dhe vetëm rezistenca e vendosur e popujve e shpëton njerëzimin nga këto dy kuçedra e nga këto intriga.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës hëngrën një dru të madh, pësuan një disfatë të pariparueshme në Kamboxhia. E para, u pa qartë nga gjithë bota se imperiaлизmi amerikan, me gjithë forcën e armëve dhe forcën e tij ekonomike, nuk mund t'i imponojë vullnetin e tij qoftë dhe një populli shumë të vogël që ka vendosur t'i rezistojë dhe ta luftojë me armë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës hodhën në balancën e Kamboxhias armët moderne, këshilltarë, gjeneralë dhe ushtri të tyre, hodhën furnizime ekonomike të pallogaritshme, ngritën në

skenë një grusht tradhtarësh, me Lon Nolin në krye, organizuan ushtri mercenare, angazhuan edhe «prestigjin» e vet si një fuqi super e madhe dhe, megjithatë, balanca anoi nga ana e popullit kamboxhian.

Ç'mësime nxjerrin popujt nga kjo disfatë kolosale e Shteteve të Bashkuara të Amerikës? Se imperializmi është në kalbëzim, se perandoria e Shteteve të Bashkuara po kërcet në themelitë, në organizimin dhe në politikën mbi të cilën është ndërtuar. Me luftë, me armë, me kukulla, me baza, me kredi dhe me shfrytëzim e shantazh atyre u duhet të mbajnë në sundim popuj. Mirëpo karakterin e dollarit që kullon gjak, e njohin të gjithë. Kukullat përdoren deri në fund për të mbështetur padronin, gjakosin popullin e tyre, por më në fund thyhen e bëhen pluhur nga lufta popullore. Shembull i fundit janë Lon Noli dhe Van Thieu, që janë duke dhënë shpirt. Pra s'mund të qëndrojnë në këmbë demagogjia se Shtetet e Bashkuara të Amerikës «demokrate» luftojnë tok me miqtë e tyre «demokratë», Lon Nolin dhe Van Thieun, për «lirinë dhe demokracinë» e popujve.

Domethënë nga të gjitha anët disfata politike, ushtarake dhe ekonomike për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. «Besimi» i aleatëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në to, kuptohet, ka rënë te këmbët. Përndoi besimi i mëparshëm i klikave dhe i kukullave për padronin «e fuqishëm». Në fakt, klikat dhe kukullat mendojnë tash më shumë se kurdoherë se padroni është bërë i rrezikshëm, ai punon vetëm për vete, i përdor këto si vrasëse të popujve të tyre dhe i lë në baltë, kur

thyhet në beteja me popujt e botës. Po nuk janë vetëm klikat dhe kukullat si Lon Noli, Van Thieu apo fashistët kilianë që mendojnë kështu, ka edhe «aleatë të mëdhenj», zyrtarisht të deklaruar, që me kohë po dyshojnë në këtë aleancë të krimbur, ku sundon një superfuqi imperialiste, që edhe me ta, pavarësisht nga traktatet, ka të njëjtat qëllime dhe vepron e do të veprojë në të njëjtën mënyrë si me klikat dhe me kukullat.

Ky mosbesim real në këtë aleat të pabesë po duket haptazi në format e shantazheve që i bëhen. Në «aleancë» ka filluar të spikatë ndjenja «nacionale», mbrojtja «nacionale». «Aleatët», edhe në qoftë se nuk e thonë, kanë filluar të mendohen dhe të lëvrijnë: «Si do të mbrohemi? Asgjë nuk kemi të sigurt me Shtetet e Bashkuara të Amerikës; këto të lënë në llucë për interesat e tyre».

Socialimperializmi sovjetik, nga ana e tij, është po në këtë krizë të madhe. Asnjëri nuk i beson demagogjisë së tij, çdo veprim i tij u tregon popujve se politika, qëllimet, synimet e tij janë të njëjlojta me ato të imperializmit amerikan: hegjemoni botërore, ndarje e tregjeve, duke bërë çmos të evitojë ballafaqimin me të. Por lufta për tregje të dy nuk i pengon të kenë klika dhe kukulla, t'i vënë këto të gjakosen me njëra-tjetrën dhe t'u nxjerrin gështenjat nga zjarri. «Aleatët» e socialimperialistëve sovjetikë janë të pakënaqur në kulm nga padroni, vendet e tyre janë të pushtuara, ato nuk mund të çlirohen pa luftë. Por këtë nuk mund ta bëjnë. Deri në njëfarë pike mund të bëjnë ca tregti me vendet kapitaliste dhe të marrin ndonjë çikë kredi, aq sa i le-

verdis të lëshojë perin padroni. Po të tendoset peri në atë drejtim nga ana e tyre, padroni ua pret me shpatë.

Rumania bën përjashtim nga kjo gjendje, por si duket sovjetikët i kanë caktuar asaj detyra speciale, që mund të hedhë edhe vicka kundër padronit, por në fund të fundit t'i shërbejë, bile të jetë në shërbim të plotë të tij. E gjithë veprimtaria e grupit të Çausheikut të lë të dyshosh për këtë, pse edhe bërtet se kërcënohet nga sovjetikët, por edhe nuk shkëputet nga Traktati i Varshavës. Kësaj i thonë të jesh brenda, por të hiqesh sikur je gjysmëjashtë.

Në marrëdhëniet padronë-satelitë, këta të fundit ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë më të lirë, më manovrues, bëjnë shantazhe, kurse satelitët e sovjetikëve janë në fre të fortë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kërcënojnë satelitët e tyre me kërcënimin sovjetik, kurse sovjetikët nuk i kërcënojnë dot satelitët e tyre me kërcënimin amerikan, pse lidhjet me SHBA-në ata i lutin, mbasi duan «lirinë» amerikane. Por që të dy luajnë me kërcënimin e luftës botërore. Kurse vendet e ashtuquajtura të paangazhuara rrojnë nën kërcënimin e dyfishtë, të luftës së përgjithshme dhe të asaj të pjesëshme.

Por në këtë kuadër të përgjithshëm shkon duke u dobësuar miti i fuqive të mëdha, që mund të bëjnë ç'të duan pa u ndëshkuar dhe pa pësuar disfata. Amerikanët po pësojnë të tilla disfata politike, ekonomike dhe ushtarake etj. Sovjeti akoma nuk ka pësuar disfata ushtarake. Ai pësoi një disfatë politike të madhe në

Çekosllovakia, nga e cila hala s'e ka marrë veten. Deri tash ai është ruajtur të bëjë agresion atje ku parashikon se mund të gjejë rezistencë me armë, pse me siguri do të pësojë disfata politike dhe ushtarake. Ai mezi mban njëfarë emri me demagogji, po e çori edhe këtë cipë, mbaroi nga çdo pikëpamje. Sovjeti me këtë taktikë kërkon të ruajë «mitin» se ushtria e sovjetëve është «lubi e pamposhtur». I duhet ky mit dhe nuk do që ta djegë, pse atëherë do të vijë rrokullisja e tmerrshme drejt greminës. Strategjia e sovjetikëve është ta ruajnë këtë mit dhe të vazhdojnë politikën hegjemoniste të socialimperializmit.

Imperializmi amerikan ka pësuar disfata, rusi duket sikur jo. Ky është një iluzion, se të dy kanë pësuar disfata dhe të dy manovrojnë për një strategji të re dhe për taktika të reja. Fordi paralajmëroi hapur që «askush të mos përpiqet të peshkojë në ujë të turbullt kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës». «Uji i turbullt» janë Kamboxhia, Vietnami, Lindja e Mesme. «Askushi» është, në radhë të parë, Bashkimi Sovjetik.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës përpara disfatave nuk rrinë pa menduar dhe pa i përgatitur rusit një shkelm që të mos lëvizë. Ç'mund të jetë ky shkelm? Supozime: e para, s'i japin kredi për të cilat ai ka shumë nevojë; e dyta, ta qërojnë krejtësisht Rusinë nga Lindja e Mesme, nga Gjiri Persik dhe nga Afrika. Kjo pikë e dytë është pikë jetike ekonomike dhe strategjike.

Kush ka influencë në vendet arabe dhe në Afrikë, e mbyll Rusinë në kafaz. Këtë do të orvaten të bëjnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës; Izraelin këto do ta



mbrojnë, por edhe «miqësinë» me vendet arabe nuk do ta sakrifikojnë. . .

Bashkimit Sovjetik i mbeten pozitat e Evropës. Disa hapin parullën se Shtetet e Bashkuara të Amerikës në politikë do të ecin sipas «Doktrinë Monro<sup>1</sup>». Jo, ato nuk do të shkojnë në izolacionizëm, por në gjysmë mundet, në pamundësi që të vendosin hegjemoni të plotë mbi aleatët e NATO-s. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë interesa në Evropë, të cilët do të vazhdojnë t'i mbrojnë. Pra, në parim, ato janë «mburoja» e Evropës Perëndimore kundër «rrezikut sovjetik». Por «izolacionizmi amerikan» mund të shprehet në atë që «unë do t'ju ndihmoj, por më ndihmoni edhe ju mua në këto dy kriza kolosale, se kështu ndihmoni edhe vetveten».

Ne shohim Francën të lëvizë në këtë drejtim, të japë përshtypjen se po bëhet një fuqi botërore, që duhet të pyetet. Nesër këtë rrugë do të marrë edhe Gjermania Federale, e cila tash s'po ndihet shumë. Politika e Brandit dështoi, ajo kryesisht synonte «bashkimin e të dy shteteve gjermane». Kësaj nuk ia arriti dot, po kjo nuk do të thotë se imperializmi gjerman ka hedhur armët. Një mëngjes ky do të zgjohet dhe synimi i tij kryesor do të jetë kundër sovjetikëve. Anglia po këtë rrugë do të ndjekë. Pra, mund të mendohet një strategji e re: Të izolohet Bashkimi Sovjetik në Evropë dhe t'i ndalet vrapit kudo, Shtetet e Bashkuara të Amerikës të mbeten xhandari kryesor, por të ngjallen edhe xhandarë të tjerë, ndaj të cilëve bëhej një politikë përbuzëse dhe kështu

---

1. Xhejms Monro — president i SHBA-së në vitet 1817-1825.

Timurlengu dhe aleatët e tij ta thyejnë Bajazit Jellëremin, Bashkimin Sovjetik, ta mbyllin në kafaz dhe ta shëtitin si ariun në panair.

Nuk dimë sa e vërtetë është çështja se perëndimorët janë «dakord» që të përfundojë faza e parë e mbledhjes për «sigurimin evropian», dhe se «nuk ngulin shumë këmbë për çështjen e hyrjeve të lira të ideve dhe të njerëzve». Siç duket të dyja palët duan të nënshkruajnë një paçavure pa vlerë. Pse vallë? Mos duan t'i japin një «satisfaksion» grupit proamerikan të Brezhnjev, për të fituar kohë derisa Shtetet e Bashkuara të Amerikës të marrin veten nga disfatat, të ngjitin vazot e thyera, të rifitojnë besimin e humbur, të përgatiten për zgjedhjet e ardhshme presidenciale dhe perëndimorët, aleatë të tyre, t'i ndihmojnë, të ndihmojnë edhe veten për konsolidimin e njëfarë pavarësie dhe fuqie më të madhe në aleancën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Këtë zhvillim duhet ta vëzhgojmë, se ky po bëhet, por në ç'forma dhe në ç'drejtime nuk ka ndonjë gjë të përcaktuar. Rëndësi ka të vazhdohet tatëpjeta e dy superfuqive, të minohen prepotenca dhe hegjemonia e tyre, të pengohen dhe të luftohen intrigat e tyre, të luftohet psikoza e frikës që mbajnë gjallë këto dy superfuqi, të forcohet ndjenja e mbrojtjes dhe e dinjitetit kombëtar të popujve e të shteteve të pavarura dhe të kaliten fryma revolucionare dhe uniteti ndërkombëtar i proletariatit dhe i punonjëseve në të gjithë botën.

Disfatat e superfuqive duhet të shfrytëzohen në kulm e në të gjitha mënyrat. Ne duhet të japim kontributin tonë në këtë luftë si kurdoherë e më shumë se kur-

doherë. Vigjilenca jonë duhet të jetë shumë e madhe. Për këtë arsye kërkohet nga gjithë Partia, nga gjithë populli, nga ne të gjithë që të jemi plotësisht të mobilizuar në çdo drejtim, të kryejmë me sukses të gjitha detyrat: detyrat në fushën e mbrojtjes, detyrat ekonomike, ato në lëmin e arsimit e të kulturës etj. dhe mbi të gjitha të forcojmë unitetin e Partisë sonë e ta bëjmë atë një instrument të mprehtë, ndërsa Partinë një udhëheqëse plotësisht revolucionare të klasës sonë të lavdishme punëtore.

Për këtë ne i kemi të gjitha kushtet. Kemi një popull trim, luftëtar dhe të guximshëm që e do Partinë, e mbron atë me të gjitha forcat e tij dhe e ndjek me besnikëri deri në fund. Situatat në vendin tonë janë shumë optimiste dhe lufta kundër elementëve tradhtarë, që zbuluam në ushtri e në ekonomi, e forcon akoma më shumë dhe do ta forcojë edhe më tej gjendjen e brendshme të vendit tonë.

*Botuar për herë të parë,  
me shkurtime, në librin:  
Enver Hoxha, «Gjithmonë  
vigjilencë» (Për organet e  
Punëve të Brendshme),  
vëll. I 2-të, f. 373*

*Botohet sipas origjinilit që  
gjendet në Arkivin Qendror,  
të Partisë*

## KONTROLLI I MADH I PARTISË DHE I MASAVE I PRET RRUGËN BUROKRATIZMIT

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit  
të Kuvendit Popullor të RPSH*

30 maj 1975

*Në këtë mbledhje rendi i ditës përbëhej nga disa pika. Shoku Enver Hoxha, me ndërhyrjet e tij, i hapi mbledhjes horizont të gjerë, që secili nga pjesëmarrësit të shfaqte lirisht mendimet e veta. Këto ndërhyrje po i përmbledhim në këtë diskutim.*

Të rinjtë që shquhen gjatë punës në aksione janë shumë, me dhjetëra mijë; ata punojnë me vrull e me heroizëm shembullor. Edhe unë mendoj që, zakonisht, për ta të përdoret si stimul moral distinktivi, i cili të jetë i bukur e i madh, që aksionistët ta kenë si shenjë kujtimi nga puna e tyre në aksion.

Nëpërmjet dekorimit duam t'i inkurajojmë edhe nënat, që të lindin sa më shumë fëmijë.

Çështja që përmendi shoku Muharrem Sefa<sup>1</sup> është

---

1. Në atë kohë anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor,

parimore, bazë. Punojnë a s'punojnë mirë, e meritojnë a s'e meritojnë dekoratën njerëzit që propozohen për dekorim, këtë i takon ta gjykojë kolektivit ku ata bëjnë pjesë. Kolektivi duhet të gjykojë nëse brigadieri apo kooperativisti është i mirë në të gjitha drejtimet. Në qoftë se këtë çështje do t'ia linim në dorë vetëm kryesisë së kooperativës, të jemi të bindur se do të ketë subjektivizëm e hatëre. Njëri në kryesi do të thotë: «T'ia japim dekoratën këtij», tjetri — atij, duke u nisur nga qëndrimi i shtrembër, se dikë e kanë mik, dikë tjetër e kanë djalë halle apo xhaxhai. Mua më duket se në raste të tilla dikasteri nuk luan as rolin më të vogël. Por, kur dekorohen ndërmarrjet, është e drejtë të japë mendimin ministria përkatëse, pasi, përveç rrethit, duhet ta dijë mirë, për shembull, edhe Ministria e Bujqësisë cila kooperativë bujqësore është më e mirë, cila jo. Gjer sot atë që thotë rrethi bëjnë edhe dikasteret.

Lipe Nashi na sabotonte, ai ishte armik, Qeveria e kishte dënuar me paralajmërim për pushim nga puna, duke njoftuar edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Naf-tës për këtë masë kundër tij, ndërsa Pirro Gushoja dhe Koço Theodhosi e propozuan të bëhet «Hero i Punës Socialiste»! Sikurse doli në Plenumin e 7-të të Komitetit Qendror të Partisë, Koço Theodhosi e mbajti propozimin një muaj e gjysmë në sirtar dhe, më në fund, e serviri. Kur e pyetëm: «Si u bë kjo punë kështu, mor Koço Theodhosi?», «Po ja, — na u përgjigj

---

kryetar i kooperativës bujqësore të bashkuar Burlzanë të rrethit të Krujës.

ai, — u këshilluam me një instruktor të aparatit që merret me kuadrin!». «Po ti që ke qenë anëtar i Qeverisë, ministër i Industrisë dhe i Minierave, që drejtoje edhe industrinë e naftës, ç'nevojë kishe të pyesje instruktorin e kuadrit? Nuk e njihje ti Lipe Nashin?!». Kësaj pyetjeje nuk iu përgjigj dot Koço Theodhosi.

Edhe një vërejtje kisha unë. Kam përshtypjen se dekorimet bëhen në seri, me fushata. Po u bënë kështu, ato jo vetëm nuk do të shërbejnë për qëllimin që kërkohet, por do të vërtetohen edhe gabime, duke u dekoruar ata që nuk e meritojnë dhe jo ata që e meritojnë. Dikasteri, për t'u mburrur se ka bërë punë të madhe, bën thirrje: «Oburra të dekorohen sa më shumë njerëz», bile dekorohen edhe burokratë nëpër institucione e ndërmarrje. Përgjithësisht, ka raste që burokratët në ndërmarrje jo vetëm marrin dekorata, por dhe shpërblehen nga fondi i veçantë, që është krijuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për ndërmarrjet ekonomike shtetërore, kur këto plotësojnë detyrat e planit etj. Ndodh që më shumë nga ky fond i marrin ata që bëjnë shkresa, kurse punëtorët marrin më pak!

Unë jam dakord me raportin e paraqitur në këtë mbledhje, por propozoj të shikohen këto çështje. Natyrisht, të mos përjashtojmë edhe marrjen e mendimit të dikasterit për dekorimin e njerëzve, por të mos e lejojmë dikasterin që të bëjë manipulime për sa u përket njerëzve që kërkohen dekorata nga baza. Partia bën politikën e kuadrit, por ajo bën edhe konkluzionet për vlerësimin e kualiteteve të këtij kuadri në bazë. Orga-

nizata e Partisë ose ajo e Frontit duhet t'i ketë parasysh njerëzit që dallohen për t'i stimuluar dhe për të përhapur shembullin e tyre përnjëherësh. Të mos pritet që të bëhen tri-katër shoqe ose shokë të dalluar e pastaj të dekorohen. Le të propozohen vetëm një ose dy që e vlejné për t'u dekoruar, pastaj, sipas kohës, meritave, punës që bëjnë, të tjerë. Duke propozuar njëherësh, ta zëmë, një-qind veta, ka rrezik të krijohet pikëpamja që në këtë çështje dikush ka manipuluar dhe ka shënuar në listë edhe ndonjë që nuk e meriton. Kurse të tjerë, që pretendojnë se duhej të dekoroheshin, do të pyesin: «Po ne, pse nuk na dekoruan?». Kur dekorohen një ose dy veta njëherësh, që me të vërtetë dallohen në gjithë kolektivin, atëherë të tjerë do të thonë: «Shumë mirë u bë».

Kisha dhe një vërejtje parimore për heqjen e dënimeve, gjë që është parashikuar nga dispozita e nenit 56 të Kodit Penal.

Partia kurdoherë ka porositur që të mos merren në punë me përgjegjësi materiale ata që janë dënuar një herë me vendim të gjykatës për përvetësim të pasurisë socialiste. Megjithatë, shikojmë se janë marrë në punë shtetërore si arkëtarë, magazinierë, shitës, kamerierë, grumbullues, llogaritarë, inventarizues etj. edhe nga ata që kanë vjedhur një herë.

Këtë gjendje ne e kemi lejuar vetë, bile duke e sanksionuar edhe me ligj. Sipas nenit 56 të Kodit Penal, është pranuar instituti i heqjes së dënimit me kalimin e kohës. Dispozita e këtij neni quan të padënuar:

Së pari, ata që janë dënuar me kusht, kur, në va-

zhdim të afatit të provës së caktuar nga gjykata, nuk kanë kryer krim tjetër.

Së dyti, ata që janë dënuar me heqje të lirisë për një kohë jo më tepër se gjashtë muaj ose me çdo dënim tjetër më të lehtë dhe që, gjatë dy vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit të tyre, nuk kanë kryer krim tjetër. Kështu, në qoftë se dikush vodhi pasurinë socialiste dhe u dënua për këtë krim me gjashtë muaj burg, pas dy vjetësh nga dita e vuajtjes së dënimit, ai ligjërisht konsiderohet sikur nuk është dënuar kurrë!

Së treti, ata që janë dënuar me heqjen e lirisë për një kohë më tepër se gjashtë muaj gjer në tre vjet dhe që, gjatë pesë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit, nuk kanë kryer krim tjetër.

Së katërti, ata që janë dënuar me heqje të lirisë për një kohë më tepër se tre vjet gjer në dhjetë vjet dhe që, gjatë dhjetë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit, nuk kanë kryer krim tjetër. Kështu, për shembull, në qoftë se një njëzetepesëvjeçar dënohet me 7 vjet heqje të lirisë për përvetësim të pasurisë socialiste me përsëritje, në grup të organizuar ose me përpjesëtime të mëdha, ky, në moshën 42-vjeçare, domethënë 10 vjet pas vuajtjes së dënimit, do të quhet i padënuar penalisht dhe, po të vjedhë përsëri, gjykata nuk do ta gjykojë si përsëritës, por do ta trajtojë sikur e gjykon për herë të parë, sepse kështu e parashikon neni 56 i Kodit Penal!

Ky qëndrim i shprehur në ligj mendoj se na ka dëmtuar: «S'kam vjedhur unë, kjo akuzë s'është e drejtë juridikisht», thotë vjedhësi i pasurisë socialiste!



Siç u tha këtu, heqjen e dënimit e shpjegojnë me nevojën e rehabilitimit të njerëzve të dënuar, që këtyre të mos u qëndrojnë gjithë jetën mbi kurriz një dënim i dhënë para shumë kohësh. Si mund të harrohet krimi, kur keqbërësi e ka kryer atë në mënyrë të ndërgjegjshme? Pse duhet të mbylлим sytë para së vërtetës? Sigurisht, është ndryshe çështja kur vjedhësit, shpërdoruesit e të tjerë njihen, por e keqja është kur nuk njihen, sepse këta njerëz, për të fshehur këmbët, ngrihen, për shembull, nga Gjirokastra e shkojnë në Shkodër, duke ndërruar edhe emrin apo mbiemrin! Shoku Haki Toska më tregoi se kishte takuar në Shkodër një nga këta dhe i kishte thënë: «Si ore na qenke shndërruar kështu?».

Kur këtyre njerëzve të dënuar u thuhet me të drejtë nga organet e Partisë e të pushtetit, në raste të ndryshme, se kanë qenë të dënuar, ata zemërohen, shkojnë përnjëherë në zyrën e gjendjes gjyqësore penale të Gjykatës së Lartë dhe sjellin prej aty një dëshmi penaliteti «të bardhë». Kjo zyrë vepron kështu, duke u bazuar në nenin 56 të Kodit Penal, i cili e ndalon të shënojë të vërtetën! Në qoftë se zyra e gjendjes gjyqësore penale ka vepruar ndryshe, domethënë nuk e ka zbatuar nenin 56 të Kodit Penal, kjo nuk është një zgjidhje e drejtë e problemit. Asnjë zyrë nuk mund t'i shmangët zbatimit të ligjit për sa kohë që ky është në fuqi. Veprimi i drejtë në këtë rast do të ishte studimi dhe pastaj, mbi bazën e këtij, propozimi për ndryshimin e nenit të Kodit Penal. Mua më duket se institutin juridik të heqjes së dënimit duhet ta studiojë

Presidiumi dhe, pasi të bëhet studimi, ta rishikojmë këtë çështje<sup>1</sup>.

Kisha edhe një vërejtje tjetër. Shikoni ç'po bëhet nga ministritë, ato i zbresin planet edhe pa arsye dhe, kur vete i kontrollojnë aparati i Presidiumit o ndonjë organ i administratës shtetërore, që shikon një mijë e njëqind shkarravina, asnjëri nuk e mban fajin. Ky është veprim i dënueshëm i ministrive, është anarki. Qeveria duhet absolutisht të marrë masa, sepse shkelje të tilla na shkaktojnë shumë të këqija e çrregullime.

Shokët e Ministrisë së Bujqësisë nuk janë në rregull. I takon deri një njeriu të padëshiruar të kishte në dorë planin e ministrisë! Vendosin për tokat e reja Abdyl Këllezi e ndonjë tjetër, pa pyetur as byrotë e komiteteve të Partisë, as komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve. Këtu fshihen ato veprime që ju do t'i lexoni në materialet e Plenumit të 7-të të Komitetit Qendror të Partisë. Abdyl Këllezi vazhdimisht thoshte: «Fajin e kanë rrethet që nuk realizojnë planet, e kanë komitetet ekzekutive të këshillave popullorë» etj., etj. kurse, sipas tij, Komisioni i Planit të Shtetit «shkëlqente», asnjë gabim nuk kishte ky institucion që drejtohej prej tij! Kur Komisioni i Planit të Shtetit kërkonte të hapeshin 20 000 hektarë tokë e re, fajin për mosrealizim e kishin rrethet. Gjithmonë, edhe kur planifikimi ishte i gabuar, sipas Abdyl Këllezit rrethi ishte fajtori! Edhe kur e pyeti Myslim Peza: «Si i keni

---

1. Me ligj të Kuvendit Popullor të RPSH, nr. 5383, datë 11 shkurt 1976, neni 56 i Kodit Penal u shfuqizua.

vënë në plan këta 100 hektarë tokë të re që do të hapë Peza?», Abdyli iu përgjigj: «Ti, Babë, qenke kundër vijës së Partisë!». «Unë, — i tha Myslim Peza, — s'jam kundër vijës së Partisë, por shiko mos je ti!»!

Duhet organizuar kontroll i madh e i bashkërenduar nga Partia dhe nga masat. Ndaj elementëve borgjezë dhe burokratë, që kujtojnë se bëjnë ligjin dhe marrin nëpër këmbë interesat e shtetit dhe të popullit, duhet të merren masa.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Presi-  
diumit të Kuvendit Popullor,  
që gjendet në AQP*

# PUNA ARMIQËSORE NË EKONOMI ËSHTE E BASHKËRENDAR ME VEPRIMTARINË ARMIQËSORE NË USHTRI DHE NË IDEOLOGJI

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit  
të Kuvendit Popullor të RPSH*

30 maj 1975

Për masat e marra në Plenumin e 7-të të Komitetit Qendror të Partisë lidhur me veprimtarinë armiqësore shumë të rrezikshme, që është zhvilluar në dëm të ekonomisë sonë në përgjithësi dhe të industrisë së naftës në veçanti, së shpejti do të vihen në korent Partia dhe populli<sup>1</sup>.

Puna armiqësore e zhvilluar në ekonomi nuk është diçka e rastit, as e veçuar, përkundrazi, nga faktet e pakundërshtueshme del se ajo është e bashkërenduar me punën armiqësore të tradhtarëve Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako e të tjerë, që vepruan në ushtri dhe, më tutje akoma, me punën e tradhtarëve Fadil

---

1. Kjo u realizua nëpërmjet një letre të Plenumit të 7-të të KQ të PPSH drejtuar komunistëve e punonjësve.

Paçrami e Todi Lubonja, që vepruan në sferën e ideologjisë, të artit e të kulturës.

Qëllimi i Abdyl Këllezit dhe i Koço Theodhosit, tok me një grup sabotatorësh në sektorin e naftës, si: Lipe Nashi, Beqir Amerika, Koço Plaku e të tjerë, që janë arrestuar, ishte sabotimi i kërkimeve të naftës. Pesë vjet me radhë nuk janë zbuluar fusha nafte në vendin tonë, megjithëse jemi të bindur që nëntoka e Shqipërisë ka naftë. Armiqtë kanë vepruar me ndër-gjegje të plotë armiqësore. Ata, në kundërshtim me rregullat teknike, duke përfituar nga mungesa e kontrollit, i kanë vënë kazmën perspektivës së naftës dhe, për të mos u zbuluar, kanë gënjyer Qeverinë dhe Komitetin Qendror të Partisë, duke premtuar se do të nxirrnin naftë sot e do të nxirrnin nesër. Në fakt ata nuk nxorën naftë dhe nuk mund të nxirrnin, se ishin armiq.

Në një material të botuar pak më parë për përdorim të brendshëm në Parti «Mbi punën armiqësore në naftë»<sup>1</sup>, të cilin besoj se e keni lexuar, jeni vënë në dijeni për sa i përket punës së Koço Theodhosit, Partia, si kurdoherë, ecën me kujdes të madh, ajo i gjykon rrethanat dhe provat me durim, me gjakftohtësi dhe me metodën dialektike të analizës. Të dhënat rreth veprimtarisë armiqësore në naftë u mbledhën me kujdes, dalngadalë, ato u plotësuan dhe doli si përfundim që

1. Me këtë titull u botua në atë kohë një broshurë, ku u përfshinë materiale të muajve shkurt-mars 1975, të cilat botohen në këtë vëllim. (Shih f. 107, 124, 136, 153, 207.)

Abdyl Këllezi ishte një nga personat kryesorë, që ka vepruar sistematikisht për sabotimin e ekonomisë dhe të nxjerrjes së naftës. Ai ka përgjegjësi edhe për krijimin e një shtete të dënueshme në aparatet e ekonomisë dhe në ato shtetërore, ku u frynë së tepërmi organikat.

Abdyl Këllezi dhe Koço Theodhosi, të mbërthyer nga faktet, kanë pohuar se kanë bërë një punë sabotuese. Natyrisht, këta janë përpjekur «të shpjegojnë» se kanë vepruar gjoja në mënyrë të pandërgjegjshme, se punën armiqësore të Lipe Nashit me shokë «nuk l pamë me kohë», «nuk kuptuam se bëhej punë armiqësore» etj., por sado që u munduan të gënjejnë, kur panë se Komiteti Qendror i vuri para përgjegjësisë dhe nuk u besonte dredhive të tyre, u detyruan të pohojnë.

Po kështu rezultoi plotësisht e provuar se Ramadan Xhangolli ishte bashkëpunëtor i Abdyl Këllezit dhe i Koço Theodhosit e bënte pjesë në një grup me ta. Ky ishte vënë prej këtyre që të përgjonte çfarë bisedonin shokët e udhëheqjes në Shtëpinë e Partisë dhe t'u raportonte. Këtë fakt ai e ka pohuar me gojën e tij në kohën kur ishte i mbledhur Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë.

Kjo ishte një veprimtari armiqësore shumë e rrezikshme, një komplot i madh i organizuar kundër Partisë, por syrit të saj dhe të popullit armiqtë nuk mundën t'i fshiheshin. Vërtet ata na dëmtuan dhe për njëfarë kohe u përpoqën të organizonin katastrofën, por Partia i zbuloi dhe i goditi. Gjithë Partia dhe ne, si anëtarë të saj, po luftojmë gjatë kësaj kohe për t'i riparuar këto dëme të mëdha.

Armiqtë e dinë se Shqipëria socialiste është një shembull për popujt e tjerë, për klasën punëtore të vendeve të ndryshme. Ajo tregon si duhet luftuar, ç'forma e metoda pune duhen përdorur në bazë të ideologjisë marksiste-leniniste për të fituar lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin. Megjithëse e shohin që vendi ynë u qëndron me sukses të gjitha intrigave, dallavereve, kërcënimeve dhe sulmeve të tyre, prapëseprapë armiqtë nuk i kanë hedhur armët. Prandaj ata do të jenë kurdoherë në sulm kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, shtetit tonë socialist dhe Partisë sonë, që e udhëheq këtë shtet. Partia na mëson të jemi vigjilentë, se armiku është dinak dhe i pabesë. Nuk thotë kot populli: «Ujët fle, hasmi s'fle».

Kaq kisha sa për të plotësuar një çikë çështjen që u shtrua këtu.

Për sa i përket shtrirjes në gjerësi të kësaj pune armiqësore, dokumentet që hedhin dritë për këtë, janë të gjitha gati, së shpejti ato do t'ua japim Partisë dhe popullit për të marrë dijeni.

Në qoftë se shokët kanë ndonjë pyetje plotësuese, mund t'u përgjigjem, por, në përgjithësi, ky është thelbi i kësaj çështjeje.

Ne do t'ia themi popullit ato që janë vërtetuar në këto drejtime, por nuk duhet t'u japim rast armiqeve që të spekulojnë. Armiqtë e brendshëm, megjithëse asgjë të keqe nuk kanë çfarë të thonë në adresë të Partisë sonë, sigurisht, nuk do të rrinë pa llomotitur ndonjë fjalë. Jemi mësuar ne me pallavrat e tyre dhe dinë t'i lustojmë e t'i shkatërrojmë ata. Rëndësi

për ne ka që t'ia bëjmë të ditur popullit veprimtarinë e armiqve dhe me siguri populli do të miratojë plotësisht qëndrimin e drejtë të Partisë e do të luftojë çdo armik dhe çfarëdo propagande të dëmshme.

*Datohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Presi-  
diumit të Kuvendit Popullor,  
që gjendet në AQP*



## TREGUESIT



## TREGUESI I LENDES

### A

*Aparatet e organeve udhëheqëse të PPSH*

— aparati i KQ të Partisë, instruktorët — 5, 70-71, 256, 257-258, 383;

— aparatet e komiteteve të Partisë dhe punonjësit e tyre — 168, 180-181, 182-184, 189-189, 201, 201, 205, 235, 260.

*Aparatet shtetërore, administrata shtetërore dhe punonjësit e tyre* — 168-169, 170, 180-181, 185-186, 231, 235, 256-257, 261, 263, 269-270, 295-298, 324-325, 350-351, 409, 411, 414-417, 418-419.

*Armigtë; lufta kundër vepërimitarisë armiqësore* — 86, 109-110, 298-299, 357, 400-401, 414-417, 497-498.

*Arsimi në RPSH — zhvillimi i tij; lufta kundër të metave e dobësive në fushën e arsimit* — 42-43, 256, 383-384, 463.

*Arti Ushtarak i Luftës Popu-*

*llore* — 78-79, 83-84, 87, 89-90, 94, 96-97.

### B

*Bashkimi i Grave të Shqipërisë* — 200, 313, 394-395.

*Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë; organizata e rinisë në ushtri* — 182-183, 184-185, 394-395.

*Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik — degjenerimi i partisë, i pushtetit dhe i jetës ekonomike e shoqërore* — 72, 263, 264, 286-287, 355-357, 358;

— politika e jashtme; sabotues i luftërave çlirimtare të popujve; kriza dhe disfatat — 233, 477-478, 480-482, 483-484.

*Blegtoria — zhvillimi i saj* — 60, 362, 361.

*Borgjezia, borgjezia e re revizioniste* — 45, 309-311, 356-357.

*Betëkuptimi mikroborgjez e*

*borgjez, psikologjia mikrobor-  
gjeze — lufta kundër tyre —*

6-8, 15, 220, 231-232, 352-  
-353, 358, 391, 455-458.

*Bujqësia në RPSH — lufta kun-  
dër të metave dhe gabimeve;  
mekanizimi dhe sigurimi i  
fuqisë punëtore në bujqësi —*  
67, 68-69, 322, 324.

*Burokratizmi, teknokratizmi,  
intelektualizmi dhe lufta kun-  
dër tyre —* 43, 44, 138-139.

143, 155, 160, 171-172, 179-  
-188, 189, 213-217, 219-221,  
222-224, 231, 232-235, 257,  
259-263, 269-270, 277-278, 289-  
-293, 312-313, 326, 349, 350-  
-351, 410-411, 415-417, 419,  
424, 425-426, 432-433, 454-  
-457.

## D

*Debatë, ballafaqimi, diskutimi  
shkencor —* 43-44, 131, 133,  
250-251.

*Dekorimet; kriteret e dekori-  
mit —* 233-234, 486-489.

*Demokracia socialiste —* 348-  
-349, 358, 411-412.

*Dënimi (ndëshkimi) penal —  
qëndrimi ndaj të dënuarve —*  
172, 489-492.

*Disiplina proletare dhe disi-  
plina tekniko-shkencore —* 114-

-116, 218, 273-274, 275-276,  
377.

*Drejtoria e Përgjithshme e  
Naftës dhe e Gazit —* 103, 104,  
110, 111, 120, 125-127, 132,  
133, 151, 155, 160, 217, 223,  
234, 271, 288, 487.

## E

*Edukimi komunist — eduki-  
mi ideopolitik i komunistëve, i  
masave dhe i kadrove —* 36-  
-37, 227, 229-230, 231-232,  
231-282, 343-349, 353-359, 388,  
396-397, 399, 416, 454;

— studimi i dokumenteve  
dhe i materialeve të Par-  
tisë — 213, 333-334, 432;

— puna me njerëzit, bindja  
— 315-316, 362, 365, 388-

-389, 398-399.

*Ekonomia popullore — zhvilli-  
mi i saj —* 302, 310, 453-454;

— masat dhe detyrat për  
shëndoshjen e gjendjes  
në ekonomi, në sektorin  
e naftës, gjatë dhe pas  
shpartallimit të grupit sa-  
bolues — 116-117, 122-123,  
134, 145-146, 147-148, 203-  
-209, 293-294, 450-454, 463-  
-469.

*Engels, Fridrih —* 21, 94, 412,  
413.

*Enver Hoxha — të dhëna autobiografike* — 35, 56, 175, 341-342, 345-347, 392, 429-430, 434-435, 437.

*Evropa, «sigurimi evropian»; ndërhyrjet e superfuqive në këtë rajon* — 334-335, 339, 433-434.

## F

*Familja — demokratizimi i marrëdhënieve familjare. Shkurorëzimet* — 73, 173-178, 274, 395.

*Fronti Demokratik i Shqipërisë* — 313, 397, 489.

*Fshatarësia — traditat patriotike; roli dhe pjesëmarrja e saj në Luftën Nacionalçlirimtare dhe në ndërtimin socialist të vendit* — 199, 319-320, 321-322, 323, 346, 353-354, 362, 363, 392-393, 417.

*Fshati socialist — politika e Partisë për zhvillimin e tij* — 193, 197, 198-199, 321-325, 346.

## G

*Gruaja dhe vajza shqiptare — politika dhe kujdesi i Partisë; krijimi i kushteve lehtësuese për gruan* — 174-175, 194-196, 198-199, 395.

*Grupi armiqësor, komplotist e*

*puçist i B. Ballukat, P. Dames, H. Çakos etj. në ushtri dhe lufta për shpartallimin e tij*

— strategjia, taktikat dhe metodat e grupit — 119, 140, 149, 213-221, 275-276, 328, 425, 426-427, 436, 494;

— veprimtaria e tij për të dobësuar dhe goditur organizatën e Partisë dhe rolin e saj udhëheqës — 184-185, 216, 219, 220-221, 230-231, 232;

— përpjekjet për të zëvendësuar ideologjinë marksiste-leniniste me ideologjinë borgjezo-revizioniste — 76, 79, 80, 83, 93, 97;

— puna e tij për të sabotuar vijën ushtarake të Partisë, ushtrinë dhe mbrojtjen e vendit — 75, 76, 79, 80-81, 82-83, 99, 92, 93, 95, 97, 182, 184, 218-

-220, 369, 373, 374, 375, 376;

— degjenerimi borgjezo-revizionist i pjesëtarëve të tij. Agjenturë në shërbim të shteteve revizioniste — 82, 97-98, 182, 402;

— zbulimi, gjykimi e dënimi i grupit dhe i punës armiqësore të tij — 98, 146-147, 151, 425, 436.

*Grupi armiqësor sabotues i A. Këllezit, K. Theodhosit e K. Ngjelës në ekonomi e në sektorin e naftës dhe lufta për shpartallimin e tij* — 70, 409-410, 420;

— veprimtaria sabotuese në ekonomi — 433-434, 436-437, 449, 492-493, 494;

— veprimtaria sabotuese në shpim-kërkime, në zbulimin e vendburimeve të reja dhe në shfrytëzimin e naftës — 102-103, 105-106, 113, 114-117, 118-119, 126-127, 128, 133-134, 137, 140-144, 148-149, 153-155, 157-158, 159, 161, 163, 208-212, 218, 221-222, 271, 288-289, 299-300, 422-425, 426-430, 434, 436-439, 459-461, 495-496;

— përpjekjet për të goditur e mënjanuar organizatën e Partisë dhe rolin e saj udhëheqës — 139-140, 216-217, 221, 223-224, 225-226, 230-231, 233, 287-288, 424;

— metodat dhe taktikat e grupit — 110-112, 117-120, 121, 129-130, 139-144, 149, 151-152, 209-211, 293, 409, 421-424, 426-430, 434-436, 445-446, 447, 448-449, 461-

-462, 464, 466-467, 487-488, 492-493;

— tendencat e tij vetadmnistruese, burokratike e teknokratike — 216-218, 222-224, 233, 235, 263, 271, 289, 425-426, 430-431, 459-460, 461;

— agjenturë në shërbim të shteteve revizioniste e imperialiste — 164, 464-465;

— veprimtaria armiqësore, sabotuese në tregtinë e jashtme — 294, 421-422, 463-465;

— zbulimi, gjykimi dhe dënimi i pjesëtarëve të grupit e i punës së tyre armiqësore — 143, 149-150, 151-152, 218, 224-225, 288, 444-446, 450, 459-467, 468, 487-488, 495-498.

## GJ

*Gjeologjia, kërkimet gjeologjike për naftë e gaz*

*Shih:* Nafta — shpim-kërklmet dhe studimet për naftë...

*Gjykata popullore* — 173, 174-175, 178.

## I

*Industria*

— industria mekanike. Uzi-

- nat ushtarake — 52, 68, 375-376, 378-379, 380-381;  
— industria e lehtë; prodhimi i mallrave të konsumit — 51, 54-55, 57-58, 59.
- Instituti i Nastës dhe i Gazit* — 64-66, 101-102, 103-104, 108, 110, 111, 112, 114, 115, 117-118, 120, 121, 123, 126-127, 132, 137, 138-139, 140, 141, 142, 144, 146, 151, 153, 154-155, 157, 160, 162, 222, 223, 288.
- Inteligjencia — edukimi marksist-leninist i saj* — 156, 281, 285.
- Interesi i përgjithshëm dhe ai vetjak* — 183, 279, 300-301, 457-458.
- 5**
- Jetesa dhe mirëqenia në shoqërinë tonë socialiste* — 273-279, 303-305, 322, 453-454.
- Jugosllavia, revizionizmi jugosllav — vetadministrimi jugosllav, shovinizmi serbomadh, depërtimi i kapitalere të huaja* — 307-311, 318, 351, 355-357, 353, 393.
- K**
- Kamboxhia* — 329, 473, 478-479, 482.
- Kapitalizmi — rendi i shtypjes dhe i varfërimit të masave* — 8-9, 26, 301, 334, 355.
- Këshillat popullore dhe këshilltarët, komitetet ekzekutive dhe aparatet e tyre; epërsia e organeve të zgjedhura mbi ato ekzekutive dhe mbi aparatet* — 166-167, 168-171, 415-416.
- Këshilli i Ministrave (Qeveria), Kryesia e Këshillit të Ministrave* — 66, 69, 217, 228, 229, 233, 234, 244, 262, 390, 402, 409, 430, 432, 438, 440, 452-453, 487, 488, 492.
- Klasa punëtore — roli udhëheqës, cilësitë revolucionare dhe edukimi i saj* — 147-148, 152, 156, 227-228, 265, 270, 281-282, 285, 291, 292-293, 319, 320-321, 325-326, 350-351, 411-412, 413-414, 417.
- Klasat dhe lufta e klasave* — 109, 172, 177, 226-227, 295, 302-303, 305-306, 342-343, 355-359, 384-385, 387-388, 400-401, 412.
- Kodi Penal, Kodi i Familjes* — 174-175, 429-492.
- Kolektivizimi socialist i bujqësisë, kooperativat bujqësore. Politika e Partisë për zhvillimin dhe konsolidimin e rendit kooperativist* — 321-322, 323-

- 324, 361-366, 392-393.
- Komunisti — cilësitë, roli pararojë, edukimi i tij* — 183, 212, 227, 229-230, 231-232, 314, 444.
- Kontrolli i Partisë, i shtetit, i klasës punëtore dhe i masave* — 43, 145, 147, 148, 149, 151, 156-157, 159, 160, 184, 185, 207-208, 257-258, 326, 350, 371-372, 421, 434, 440-441, 493.
- Kosova* — 310-311, 393-394.
- Kritika dhe autokritika; kërkesa e llogarisë* — 46-47, 119-120, 142-143, 212, 234-235, 258, 289, 326-327, 368-369, 409-410, 441, 444, 447.
- Kriza dhe kontradiktat në botën kapitaliste e revizioniste, kriza energjetike* — 109, 209-311, 331, 332-336, 337-339, 479-484.
- Kuadrot*
- politika e Partisë me kuadrin, Lufta kundër shtrembërimeve të saj — 72-74, 103-105, 134, 137-138, 147-148, 162-163, 189-190, 265-266, 264-286, 287-288, 292-294, 324-325, 349, 404-406, 488-489;
  - roli dhe vendi i kuadrove në shoqëri; revolucionarizimi dhe qarkullimi i tyre — 187-188, 256, 264-266, 267-269, 270, 271, 233, 286, 287, 290-291, 294, 295, 300-301, 324-325, 389, 402-403, 414-416, 442-443, 455-458;
  - edukimi i kuadrove dhe lufta kundër shfaqjeve të huaja tek ata; lufta kundër borgjezimit në radhët e tyre — 254-255, 260, 261, 267-269, 275-279, 283-286, 287, 290-292, 303-306, 326, 350-351, 352-353, 416-417, 420-421, 443-444, 455-458;
  - ngritja e kuadrove nga radhët e klasës punëtore — 145-146, 265, 283, 291, 292-293, 469-470;
  - përgatitja, zgjedhja, kualifikimi dhe shpërndarja e tyre — 53, 148, 204-205, 206, 296-297;
  - lidhjet e kuadrove me masat, dhënia llogari e kuadrove para masës; lufta kundër mënjanimin të rolit të masave — 111-112, 129-130, 141, 142-146, 151-152, 156-157, 160-161, 162, 185, 211, 233-234, 290-295, 371-372, 432-433;
  - kuadrot, inxhinierët, dhe teknikët në naftë; lufta kundër shfaqjeve të hua-



- ja tek ata — 108, 121, 130, 147-148, 151;  
 — kuadrot në ushtri — edukimi dhe lufta kundër shfaqjeve të huaja — 75-79, 83-83, 94, 98-99, 183-184, 185, 187-188, 189-190, 243, 286, 368-372, 381.

## L

*Legjislacioni, ligjet — njohja, interpretimi dhe zbatimi i tyre. Përsosja e ligjeve* — 173-178, 261, 425, 489-492.

*Lenin, Vladimir Iliç* — 11, 21, 141, 185, 230, 231, 276, 286, 296, 319, 327, 354, 356, 359, 412, 414-415, 416-417, 418-419, 421, 435.

*Letërsia dhe artet në RPSH — zhvillimi dhe rritja e nivelit cilësor të tyre* — 2-3, 11-12, 37-38;

- funksioni njohës dhe edukativ; pasqyrimi i realitetit, lidhja me jetën dhe me masat popullore — 10-11, 13-16, 17-18, 32-36, 38;
- poezia, drama, teatri, estrada, kinematografia, muzika — 2-3, 4, 24-25, 26-31, 32-36;
- kritika letraro-artistike — 20-24;

— arti popullor, artistët amatorë. Aktivitetet letraro-artistike — 4, 26, 29-36, 55;

— shkrimtarët dhe artistët, talentet e reja; Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve — 2-3, 5, 10-19, 24, 25-27, 28, 30-32, 35, 36-38.

*Letërsia dhe arti botëror — letërsia dhe arti përparimtar; vlerësimi i tyre* — 19-20, 36, 37, 46;

— letërsia dhe arti borgjezo-revizionist. Qëndrimi kritik ndaj tyre — 12, 22, 25-26.

*Letrat, kërkesat dhe ankesat e popullit; puna me letrat* — 143-144, 164-165, 173, 175, 177, 341-349, 429.

*Ligjet objektive* — 96-97.

*Lindja e Mesme — udërhyrjet e superfaqëve në këtë rajon* — 331-332, 476-477, 482-483.

*Literatura e huaj — qëndrimi kritik ndaj saj* — 37, 44-46, 94, 249-250.

*Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar — përvoja, mësimet dhe rëndësia* — 77, 79, 214-215, 296, 316, 320, 372.

*Lufta; kuptimi marksist-leninist i saj. Ligjet e luftës* —

*njohja dhe zbatimi i tyre* —  
80, 81-82, 86-92, 94-97, 336,  
337-339, 475-476.

### M

*Marks, Karl* — 21, 94-95, 177,  
302, 319, 412, 413, 414.

*Marksizëm-leninizmi* — *udhë-  
heqje për veprim; studimi  
dhe zbatimi i tij* — 21, 36-37,  
79, 81, 94-95, 213, 280-282,  
285, 316-317, 352, 375.

*Mbrojtja e atdheut* — *përga-  
titja e ushtrisë, e popullit dhe  
e vendit për mbrojtje* — 36-  
-80, 95, 187, 219, 238-243,  
299-300, 372-373, 380-391.

*Mendjemadhësia, arroganca,  
prepotenca* — 79, 112, 113-114,  
130, 131, 139-140, 368, 416,  
426, 427-428, 432, 434-435,  
448-449, 462.

*Metoda dhe stili në punë* —  
147, 149-150, 160, 190-191,  
212-213, 237, 388-389, 450-  
-451, 452-453, 454-455

*Ministritë dhe kuadrot e tyre*  
— 255, 256-257, 263, 325,  
350, 354, 409, 487-488, 492;  
— *Ministria e Mbrojtjes Po-  
pulllore* — 371, 430, 449;  
— *Komisioni i Planit të  
Shtetit* — 208, 209, 353,  
411, 493, 492;  
— *Ministria e Industrisë*

dhe e *Minierave* — 110,  
120, 126, 129, 157, 160,  
208, 217, 223, 261, 271,  
287-288, 430, 438, 449;

— *Ministria e Bujqësisë* —  
68, 289, 297, 386, 390, 449,  
492;

— *Ministria e Tregtisë* —  
449, 463, 464;

— *Ministria e Arsimit dhe e  
Kulturës* — 5, 49, 256,  
449;

— *Ministria e Shëndetësisë*  
— 194.

*Minoriteti grek në Shqipëri;  
shkollat në minoritetin grek*  
— 383-384.

### N

*Nafta* — *rëndësia e saj. Roli  
udhëheqës i Partisë në sekto-  
rin e naftës* — 107-108, 109,

153-154, 162, 164, 221-222;

— *shpim-kërkimet dhe stu-  
dimet për naftë, kërkimi  
i vendburimeve të reja;  
teoritë dhe metodika e  
kërkimeve të naftës dhe  
e shfrytëzimit të saj* —  
51, 64-66, 67-68, 101-103,  
107-108, 114-119, 125-126,  
127, 128-129, 130-132, 140-  
-142, 147, 149-150, 158-  
-159, 161-163, 210, 439;

— *mosrealizimet e planit në*

sektorin e naftës; të metat e gabimet dhe lufta kundër tyre — 64-66, 67-68, 101-105, 109, 120, 121, 125-126, 132-133, 208-210, 232-233, 433-439.

*Shih edhe:* Grupi armiqësor sabotues i A. Këllezit, K. Theodhosit e K. Ngjelës në ekonomi e në sektorin e naftës dhe lufta për shpartallimin e tij.

*Ndërtimet, arkitektura, urbanistika* — 245-251.

*Ndërtimi i socializmit në Shqipëri: politika e Partisë për ndërtimin socialist të vendit* — 5-6, 9-10, 213, 215-216, 226, 228, 301, 302-306, 316-317, 318-319, 354-355, 358-359.

*Ngushtimi i dallimeve ndërmjet qytetit dhe fshatit* — 273, 322, 354, 365, 366.

## O

*Oportunizmi, liberalizmi, sektarizmi dhe lufta kundër tyre* — 72-74, 116-117, 368, 375, 404-405, 408, 451.

*Organikat, listorganikat — lufta për shkurtimin dhe përsosjen e tyre* — 189, 223, 235, 250-257, 262-263, 269-270,

295-298, 323, 324-325, 381, 403, 425-426, 449, 461.

*Organizata-bazë e Partisë — roli udhëheqës, revolucionarizimi, forcimi i demokracisë së brendshme* — 67, 71, 202-206, 230-231, 254-256, 399;

— organizatat-bazë të Partisë në dikastere — 231, 287-288;

— organizatat-bazë të Partisë në sektorin e naftës — 112, 122, 134-135, 144, 146, 148, 223-224, 225.

*Organizatat e masave* — 71-72, 200, 313-314, 382-383, 395, 399, 401.

*Organizimi, drejtimi dhe administrimi i punës dhe i ekonomisë* — 66, 70-72, 116-117, 238-239, 317-318, 350-351.

## P

*Paga — ngushtimi i dallimit ndërmjet pagave* — 274-277, 278, 303-305, 322-323, 414-416, 418-419.

*Partia e Punës e Shqipërisë — lufta e klasave në Parti* — 227; — lufta kundër veprimfarsisë armiqësore antiparti në ideologji, në ushtri dhe në ekonomi — 214, 298-299, 399-400, 437-438, 444-447, 463-469, 494-495;

- qëndrimi ndaj të metave e gabimeve dhe ndaj elementëve që gabojnë dhe bëjnë faje — 110, 255, 269-270, 293-294, 387, 401-406, 419-421, 423, 441-444, 446-447, 449-451, 456-459.
- Partia e Punës e Shqipërisë*
- *organet udhëheqëse qendrore dhe lokale*
  - Kongresi i Partisë — Kongresi VI i PPSH (1—7 nëntor 1971) — 107-108, 110, 114, 202;
  - Komiteti Qendror, Byroja Politike dhe Sekretariati i KQ: uniteti në udhëheqje — 4-5, 66, 68, 69, 71, 99, 110, 121, 128, 140, 142, 146, 151, 162, 190-191, 202, 235, 236-237, 242-243, 259, 262, 269, 276, 296, 304, 322-323, 371, 372, 390, 401-402, 408, 430, 435, 436, 438, 439, 440, 442, 469-473;
  - Plenumi i 4-t i KQ (26—28 qershor 1973) — 11, 40-41, 42, 110, 386, 469;
  - Plenumi i 6-të i KQ (16—17 dhjetor 1974) — 125, 165, 235-236, 469;
  - Plenumi i 7-të i KQ (26—29 maj 1975) — 408-485, 487, 492, 491;
  - konferencat, komitetet dhe byrotë e Partisë në rrethe — 160, 166, 201-206, 236, 237, 401-402;
  - komitetet e Partisë të rretheve të Vlorës, të Beratit dhe të Lushnjës — 153-154, 160, 399;
  - organizatat dhe komitetet e Partisë të rretheve të Dibrës, të Korçës, të Gjirokastrës dhe të Kukësit — 294, 342-343, 346, 386-387;
  - organizatat dhe komitetet e Partisë të rrethit të Fierit, të rajonit Patos-Marinzë dhe të Institutit të Naftës e të Gazit — 114, 122, 139-140, 145, 153-154, 156, 157, 207, 224, 400-401;
  - organizatat dhe komitetet e Partisë në ushtri dhe në shkollat e lira ushtarake — 179, 185, 219, 232, 233-241;
  - studimet, materialet, raportet për organet udhëheqëse — 190-191, 243-244, 259-260, 261-262.
- Partia e Punës e Shqipërisë* — *vija, vendimet e direktivat; organizimi dhe jeta e brendshme*
  - vija e përgjithshme, strategjia e taktikat; lufta për zbatimin dhe mbrojt-

- tjen e tyre — 212-213, 219, 261, 266-267, 271, 272, 300, 315-316, 321-326, 327-328;
- roli udhëheqës i Partisë — 69-72, 170-171, 180, 215-216, 221, 225-226, 227-230, 236-237, 314;
- parimet dhe normat, vendimet, direktivat e detyrat e Partisë; lufta për zbatimin dhe mbrojtjen e tyre — 142, 202, 212-213, 227-230, 277, 344, 353-354, 388-389, 401;
- lidhjet e Partisë me masat; informimi i masave nga Partia — 312-314, 441-442, 451, 497-498;
- puna e Partisë, përmbajtja e saj; kapja pas hallkës kryesore — 164, 182-183, 188-189, 191, 243;
- informacioni, informimi në Parti — 122, 132, 143-144, 164-165, 402, 429;
- zgjedhjet në Parti — 201-206;
- lufta kundër dualitetit Parti-pushtet dhe kundër spostimit të organeve të pushtetit nga organet e Partisë — 70-71, 228, 229-230;
- përvoja dhe masat për t'i prerë rrugën revizionizmit në Shqipëri dhe për të çuar përpara revolucionin e ndërlimin e socializmit — 72, 181-182, 216, 263-272, 275-279, 287, 302-306, 316-317, 323-328, 351-353, 355-359, 420-421.
- Planifikimi, planet — realizimi i planeve, lufta kundër të metave dhe gabimeve në planifikim. Plani i 5-të pesëvjeçar — 63-74, 159-160, 365-366, 453-454, 492-493.*
- Politika e jashtme e RPSH; solidariteti dhe përkrahja internacionaliste për lëvizjet e luftërat çlirimtare dhe revolucionare të popujve — 39-40, 325-337, 340, 475.*
- Politika në plan të parë: kuptimi politik i problemeve — 110, 220, 221-222, 316, 318-319, 327-328.*
- Populli shqiptar — virtytet moralo-politike, traditat patriotike e revolucionare — 2, 33, 95, 300.*
- Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPSH — 172, 173, 174.*
- Prona socialiste — lufta kundër shpërdorimit të saj. Obo-rrri kooperativist — 353-354, 360-362, 363-366, 390-391.*
- Propaganda, propaganda për botën e jashtme. Përkthimet — 38-40, 315-316, 393-394.*

*Pushteti popullor* — 170-171, 348-349, 411-412.

*Shih edhe: Këshillat popullorë...; Aparatet shtetërore, administrata shtetërore dhe punonjësit e tyre.*

## R

*Rinia — cilësitë dhe edukimi i saj; aksionet e rinisë* — 252-253, 395-397, 486.

## RR

*Rrethimi dhe presioni imperialisto-revizionist — lufta për përballimin dhe çarjen e tyre* — 10, 298, 315.

## S

*Socializmi dhe komunizmi* — 302, 355-359.

*Stalin, Josif Visarionoviç* — 21, 52, 72, 93, 185, 230, 233, 234, 236, 264, 286, 356.

*Superfuqitë — strategjia, taktikat, bashkëpunimi, rivaliteti dhe disfatat e tyre* — 307-308, 333-334, 335-336, 337-340, 475-480, 481-484.

## SH

*Shëndetësia në RPSH — institucionet dhe shërbimet shëndetësore; mjekët dhe punonjësit e tjerë të shëndetësisë* — 192-194, 196-198;

— kujdesi për nënën dhe fëmijën. Profilaksia, propaganda shëndetësore — 193-196, 197-200.

*Shfaqjet e huaja, zakonet prapanike; lufta kundër tyre* — 198-199, 388, 390, 398-399, 417, 452.

*Shkolla e Lirë Ushtarake* — 238-243.

*Shkollat ushtarake* — 79, 87, 378.

*Shtetet e Bashkuara të Amerikës — politika e jashtme, kriza, disfatat* — 329-332, 334-335, 473-474, 477, 478-480, 481, 482-484.

*Shteti. Shteti socialist, diktatura e proletariatit. Teoria marksiste-leniniste për shtetin* — 171, 278, 302-303, 305-306, 354-355, 356, 358-359, 411-419, 420, 421.

*Shtypi në RPSH* — 313, 314, 441, 442.

## T

*Teoria dhe praktika — uniteti dialektik i tyre* — 187, 213-214, 227, 280-281.

*Teoritë borgjezo-revizioniste për revolucionin tekniko-*

-shkencor, për rolin e klasës punëtore, luftën e klasave, për rrugën paqësore dhe për «teorinë e tri botëve» — 297-298, 318, 335-336, 340, 355-356, 474.

Tezat e Këshillit të Mbrojtjes — 78-79, 84, 370-371, 377.

Tregtia e jashtme — eksporti, importi — 56, 162, 210.

## U

Uniteti Parti-popull — 99-100, 315, 485.

Universiteti i Tiranës — 42-49, 148.

Ushtria Popullore — roli udhëheqës i Partisë — 187-188, 240-241;

— strategjia dhe taktikat ushtarake — 80, 84-85, 87-88, 89-90, 92-93;

— edukimi ideopolitik dhe përgatitja ushtarake. Stërvitja ushtarake — 75-76, 78-79, 80-88, 96-97, 183, 186-187, 241-243, 377-378, 379, 380;

— forca, revolucionarizimi, disiplina ushtarake — 185, 186-187, 367-369, 371, 373-374, 375-376, 377;

— komanda, komandimi. Bashkëveprimi ndërmjet armëve, shërbimeve, re-

parteve e njëjësive ushtarake në luftë — 85, 370, 381;

— armatimi, mjetet luftarake; zotërimi dhe mirëmbajtja e tyre — 372-376, 377-381;

— artileria kundërajrore, ndërlidhja; aviacioni, aviatorët — 86, 375, 376, 377-379;

— tanket, tankistët; flota luftarako-detare — 86, 376, 379-381;

— njohja e armikut ( e strukturës, e armatimit, e strategjisë dhe e taktikës së tij) — 78, 81-82, 84, 85, 92-93, 95;

— masat dhe detyrat për shëndoshjen e gjendjes në ushtri pas shpartallimit të grupit komplotist të B. Ballukut, P. Dumes, H. Çakos, etj. — 69-70, 98-99, 186-187, 369-371, 376, 381;

— Forcat Vullnetare të Vetëmbrojtjes Popullore, forcat rezerviste, ushtari, paraushtarakët — 82-83, 84, 98-99, 240, 241-242, 379.

*Shih edhe:* Grupi armiqësor komplotist e puçist i B. Ballukut, P. Du-

mes, H. Çakos etj. në  
ushtri dhe lufta për  
shpartallimin e tij.

*Ushtritë e huaja; arti ushtarak, strategjia dhe taktikat ushtarake* — 80, 87, 88-93, 94-95, 96.

## V

*Vendet revizioniste — restaurimi i kapitalizmit dhe kontradiktat në gjirin e tyre* —

9, 301, 323, 351-352, 355-357, 480-481.

*Vietnami — lufta e popullit vietnamez për liri* — 329-330, 332, 473-474, 479, 482.

*Vigjilenca revolucionare* — 74, 135, 155, 164, 165, 271, 279, 288, 299, 326, 355, 357-358, 393, 400, 401, 402, 453, 468-469, 485.

*Vija e masave* — 111-112, 169-170, 312-314, 353-354.



## TREGUESI I EMRAVE

### A

- Alia, Ramiz — 36, 200.  
 Afezulli, Thoma — 52.  
 Agolli, Dritëro — 1, 2, 3, 5,  
 13, 33, 38.  
 Al-Bakr, Ahmed Hasan —  
 332.  
 Aleksandër (Cari) — 309.  
 Aleksandri i Madh — 88-89.  
 Aliaj [Amerika], Beqir — 103,  
 111, 114, 116, 117-118, 119,  
 120, 130, 138-139, 142, 144,  
 151, 154, 161, 163, 211, 217,  
 271, 428, 433, 495.  
 Alimehmeti, Faik — 61.  
 Alushi, Shyqyri — 35.  
 Antoni, Mark — 91.  
 Antuaneta, Mari — 176.  
 Atila — 329.

### B

- Babameto, Luan — 53.  
 Balzak, Honore dë — 19.  
 Balluku, Beqir — 73, 75, 79,  
 90, 92, 94, 119, 140, 149,  
 151, 152, 182, 186, 219, 241,

275-276, 293, 323, 356, 373, 374,  
 376, 380, 402, 427, 436, 439,  
 447, 494.

- Bekteshi, Sadik — 425.  
 Bize, Zhorzh — 36.  
 Bozo, Naunka — 105.  
 Brand, Vili — 483.  
 Brezhnjeviç, Leonid — 477, 484.  
 Buto, Zylfikar Ali — 332.

### C

- Cami, Tefta — 385, 386.  
 Cezar, Jul — 90-92.  
 Curri, Bajram — 34.

### Ç

- Çarçani, Adil — 50, 104, 152,  
 437.  
 Çako, Gaço — 35.  
 Çako, Ilito — 75, 93, 94, 95,  
 119, 144, 149, 151, 182, 186,  
 189, 190, 219, 220, 261, 275-  
 -276, 328, 376, 380, 436, 439,  
 494.  
 Çausheku, Nikolae — 481.  
 Çoka, Jorgo — 59-60.

## D

- Daija, Tish — 35.  
 Dedej, Ali — 61.  
 Dedi, Juli — 59.  
 Deliana, Thoma — 468.  
 Dervishi, Rrapo — 171, 383,  
 385.  
 D'Estën, Zhiskar — 332-333,  
 334.  
 Dë Kastri (gjenerali) — 330.  
 Dibra, Shaqir — 170.  
 Didro, Dëni — 19.  
 Diogjeni — 53.  
 Dodbiba, Mihal — 293.  
 Dodbiba, Pirro — 67, 68.  
 Dode, Petro — 403, 471.  
 Dume, Petrit — 73, 75, 83,  
 90, 92, 93, 94, 119, 140, 149,  
 151, 182, 186, 219, 275-276,  
 328, 374, 376, 380, 427, 436,  
 439, 494.

## E

- Ford, Xherald — 330, 482.  
 Frashëri, Naim — 28.

## G

- Gegprifti, Llambi — 470, 472.  
 Gaci, Pjetër — 35.  
 Gëdeshi, Anastas — 50, 53.  
 Gomulka, Vladislav — 356.  
 Gusho, Pirro — 156, 157-158,  
 159, 160, 162, 165, 271, 293,  
 294, 400, 422, 447, 459, 466,  
 468, 473, 487.

## GJ

- Gjikopulli, Milto — 113, 141,  
 163-164, 428.  
 Gjoka, Pjetër — 28.

## H

- Hoxha, Nexhmije — 50, 57.  
 Hajdari, Kapllan — 144, 156-  
 -157.  
 Hamiti, Zenel — 142-143, 422.  
 Hitler, Adolf — 339.  
 Hoxha, Çerçiz — 56.  
 Hrushov, Nikita — 93-94, 109,  
 356.  
 Hyskja, Demir — 28.

## I

- Isai, Hekuran — 470-471.  
 Iden, Anton — 109.  
 Ilo, Vangjo — 57.  
 Islami, Pajo — 108.

## J

- Jakova, Tuk — 106, 437.  
 Jelldërem, Bajazit — 484.

## K

- Kapo, Hysni — 101, 105, 153,  
 162, 189, 350.  
 Kadare, Ismail — 38.  
 Kalo, Miranda — 54.  
 Kanrober, Fransua — 94.  
 Kapo, Vito — 394.

- Karamanlis, Kostandin — 473.  
 Kati, Vasil — 422.  
 Këllezi, Abdyl — 67, 101-105,  
 136, 164, 203-209, 233, 409-  
 -410, 420, 425-440, 448-450,  
 460-463, 466, 467, 468, 492-  
 -493, 495, 496.  
 Kisinger, Henri — 330, 331,  
 477.  
 Kolevica, Petraq — 61-62.  
 Konomi, Vita — 56.  
 Kovaçi, Ramiz — 35.  
 Kraja, Musa — 3.  
 Kurti, Tinka — 28.  
 Kushi, Medi — 33.
- Manço, Andrea — 294, 430,  
 433, 464.  
 Marku, Gjini — 467.  
 Miho, Koço — 245.  
 Mitrushli, Nikolla — 59.  
 Molier, Zhan Baptist — 19,  
 20.  
 Montenji, Mishel — 396.  
 Mosko, Sokrat — 245.  
 Mugosha, Dushan — 311.  
 Mula, Avni — 35.  
 Murati, Protoko — 111, 115-  
 -116, 119, 120, 142, 144, 149,  
 154, 163, 424, 428.  
 Muzina, Vitore — 56.

## L

- List, Franc — 36.  
 Liu Shao Çi — 356.  
 Ljarja, Rikard — 28.  
 Ljubiçiç, Nikolla — 310.  
 Lon Nol — 329, 473, 479, 480.  
 Lubonja, Todi — 495.  
 Luca, Ndrekë — 28.  
 Luigji i 15-të — 176.  
 Luigji i 16-të — 176.  
 Lukeni — 90.

## M

- Miska, Pali — 470, 471.  
 Myftiu, Manush — 50.  
 Mihali, Qirjako — 470, 472-  
 -473.  
 Malëshova, Sejfulla — 356.  
 Mamaqi, Dashnor — 447.

## N

- Nashi, Lipe — 67, 103, 104,  
 116, 120, 127, 129, 143, 144,  
 151, 211, 271, 293, 294, 298-  
 -299, 422-423, 423, 431, 433,  
 439, 459, 468, 487-488, 495,  
 496.  
 Nesho, Gaço — 160, 161.  
 Nguyen Van Thieu — 330, 479,  
 480.  
 Ngjela, Kiço — 421-422, 433,  
 463-465.

## O

- Onufri — 40.

## P

- Peristeri, Pilo — 105-106.  
 Pali, Illa — 60-61.

Paçrani, Fadil — 214, 298,  
447, 468, 494-495.

Papadhopoulos, Jorgo — 473.

Papajani, Diogjen — 53.

Papa Pavli VI — 330, 332.

Pashko, Eleni — 53.

Pataj, Xhevdet — 293.

Peza, Myslim — 492-493.

Pili, Stilian — 51.

Pisli, Lezan — 60.

Plaku, Koço — 103, 111, 113,

118-119, 120, 133, 139, 144,

149, 151, 154, 163, 293, 495.

Plaku, Panajot — 118, 133,

144, 293.

Pompeu — 91, 92.

Popović, Miladin — 311.

Preza, Lule — 56.

Prifti, Perikli — 165.

Prosi, Sandër — 28.

## Q

Qazimi, Ema — 35.

Qirko, Milo — 53.

## R

Radovička, Petrit — 52.

Raglan, Xheims — 94.

Raidhi, Pandi — 23.

Rufus, Minucius — 91.

Ruso, Zhan Zhak — 19.

Rusvelt, Franklin — 335.

## S

Sadat, Anvar — 477.

Saliçaj, Fahrije — 56, 57.

Saliu, Avni — 170.

Sallaku, Skënder — 29.

Sefa, Muharrem — 486-487.

Sinani, Paskal — 124-130, 131,

132, 133, 134-135, 136-138,

142, 143, 146, 148, 149-150,

211.

Sina, Zeliha — 35.

Skënderbeu, Gjergj Kastrioti

— 396.

Sokoli, Fatime — 33-34.

Spahiu, Xhevahir — 13-14.

## SH

Shehu, Mehmet — 187-188,

311, 409.

Shelepin, Aleksandër — 333.

Shopen, Frederik — 36.

## T

Toska, Haki — 50, 58-59, 104,

106, 124, 134, 152, 153, 162,

403, 408, 429, 491.

Timurlengu — 484.

Tito, Josip Broz — 309, 318,

334, 356.

Turkemada, Tomas — 139.

Tozaj, Sihat — 167-168, 169.

## TH

Theodhosi, Koço — 63-64, 65,

66, 67, 68, 102, 103-104, 120-

-121, 132, 136, 151, 152, 157,

164, 208, 211-212, 217-218, 221,  
222-223, 224-225, 233, 234,  
271, 289, 409, 410, 422-425,  
427, 428, 429, 430, 431, 432,  
436, 438-440, 459-460, 461,  
462, 466, 467, 468, 473, 487-  
-488, 495, 496.

**U**

Uilson, Tomas Udrou — 335.

**V**

Vinçani, Nexhip — 467.

Volter, Fransua — 22.

**X**

Xoxe, Koçi — 356.

**XH**

Xlabia, Ramiz — 104-105.

Xhangolli, Ramadan — 466-  
-467, 496.

Xhemall, Mentor — 35.

**Z**

Zadeja, Çesk — 35.

Zaharov, Bazil — 476.

Zajmi, Bashkim — 53.

Zefi, Violeta — 35.

Zela, Vaçe — 35.

Zeneli, Hajro — 1, 3.

Ziçishti, Llambi — 193.

Zyko, Demir — 33.

**ZH**

Zhukov, Georgi — 93-94.



## TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMERTIMEVE TË TJERA

### A

- Afganistan — 332, 338.  
Afrikë — 318, 330, 338, 476, 482.  
Akademia Franceze — 19-20.  
Aktivi i kërkimeve të naftës e të gazit (Fier, nëntor 1974) — 107, 110-111, 112, 113-114, 116-117, 119, 121, 122, 136-137, 140-143, 144, 157, 159, 163, 234, 288, 426, 427-428, 439.  
Amerika Latine — 318, 338.  
Angli — 333, 483.  
Aos [Vjosë] (lumë ~) — 91, 92.  
Apoloni (Fier) — 91, 131.  
Arabia Saudite — 477.  
«Arti shqiptar në shekuj» (ekspozita ~, Paris, 1974) — 39.  
Atikë (Gërçeq) — 88.  
Azi — 318, 476.

### B

- Balkan — 470.  
Bangladesh — 338.  
Banka e Shtetit Shqiptar — 317-318.

- Bashkimi Sovjetik, ushtria sovjetike (1917—1953) — 76-78  
Berat — 114.  
Biblioteka Kombëtare — 247-248.

### C

- CIA — 477.

### Ç

- Çekoslovakia — 482.  
Çermenikë (Librazhd—Elbasan) — 392.

### D

- Dibër — 342-343, 365-387, 389-391, 392-394.  
Dibër (Jugosllavi) — 393-394.  
«Doktrina Monro» — 483.  
Drejtoria Gjeologjike — 64.  
Dukat (Vlorë) — 399.  
Durrës [Dyrrachium] — 2, 91.

### E

- Egjipt — 291, 332, 477.  
«Ekonomia politike» (teksti ~) — 431-432.

Ekspozita e arteve figurative  
— Tiranë — 41.  
Ekspozita «Shq përta sot» —  
Tiranë — 50-02.  
Elbasan — 34, 114.  
Etlopi — 338.

## F

Fabrika e Qelqit — Kavajë  
— 55.  
Fabrika e Qelqit — Korçë —  
59.  
Farsali [Thesali] (Greqi) —  
91.  
Festivali Folklorik Ndërkombëtar  
i Dizhonit, 1972 (Francë)  
— 39.  
Festivali i Dytë Kombëtar Folklorik  
— Gjirokastrë — 39.  
Fier — 105, 157, 288.  
Francë — 139, 170, 330, 332-  
-333, 483.  
Fuqitë e Mëdha — 338-339.  
«Fushat Katalonike» — 329.

## G

Gorisht — 140.  
Greqi — 332, 334, 338, 477,  
478.

## GJ

Gjermania Perëndimore (RF  
e Gjermanisë) — 333, 483.  
Gjiri Persik — 482.

Gjirokastrë — 384, 385, 391-  
-392.  
Gjykata e Lartë e RPSH —  
491.

## H

Hekurudha Përrenjas — Gu-  
ri i Kuq — 252.  
Helespont [Dardanele] (Turqi)  
— 88.

## I

Indi [Indus] — 89, 332, 338.  
Inkuizicioni — 139.  
Instituti i Lartë Bujqësor —  
Tiranë — 256.  
Intelixhens Servisi — 464-465.  
Irak — 477.  
Iran — 477.  
Izrael — 331, 338, 476, 477,  
482-483.

## J

Jemeni i Jugut — 338.  
Jemeni i Veriut — 338.  
Jordani — 477.

## K

Kanali i Suezit — 291.  
Kavajë — 34, 55.  
Kili — 480.  
Kinë — 163, 340.  
KNER (Këshilli i Ndihmës  
Ekonomike Reciproke) — 333.



Kombinati i tekstileve «Stalin» — Tiranë — 29, 58, 257.  
 Kombinati Metalurgjik (Kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë») — Elbasan — 252.  
 Konferenca e Parisit (Marrëveshja e Parisit) për Vietnamin (1974) — 473, 475.

Konispol (Sarandë) — 153.  
 Kooperativa Bujqësore e Bashkuar e Gjergjevicës, Korçë — 345-346.

Kooperativa Bujqësore e Bashkuar e Krushovës, Korçë — 345-346.

Kooperativa Bujqësore e Bashkuar e Shipskës, Korçë — 345-346.

Kooperativa Bujqësore e Bashkuar e Voskopojes, Korçë — 345-346.

Kooperativa bujqësore «Enver Hoxha» e Bujanit, Tropojë — 252-253.

Kooperativa Bujqësore e Zall-Dardhës, Dibër — 342.

Krujë — 153.

Kuç (Kurvelesh) — 443-449.

Kukës — 294.

## L

«Letra e Hapur e KQ të PPSH» (4 mars 1966) — 219-220.

Liban — 332.

Lufta e Almas (Krimë), 20 shtator 1854 — 94-95.

Lufta e Dytë Botërore (1939—1945) — 329, 474.

Lufta e Krimesë — (1853—1856) — 94-95.

Lushnjë — 249.

## M

Mali i Zi — 310.

Maqedoni — 310.

Mesdhe (zona ~) — 334, 477.

Moskë — 163.

## N

NATO (Pakti i Atlantikut Verior) — 332, 473, 483.

Ndërmarrja artistike «Migjeni» — Tiranë — 29, 31, 55.

Ndërmarrja e Shpim-Kërkit të Naftës e të Gazit — Sarandë — 125-127, 128.

«Nënë Shqipëri» (poema ~, D. Agolli) — 33.

Nymphicon — 91.

## O

Obot (Sukodër) — 153.

Oman — 477.

Organizata për Çlirimin e Palestinës — 477.

Orient — 89.

Orikum [Pashaliman] (Vlorë) — 91.

## P

Pakistan — 338.  
 Pallati i Kongreseve — Tiranë — 246.  
 Pezë (Tiranë) — 493.

## Q

Qipro — 334, 477.  
 Qyteti Stalin — 148.

## R

Rumani — 461.

## S

Sajgon — 330, 473-474.  
 Sarandë — 125, 126, 127, 128, 137, 211.  
 Sigurimet Shoqërore Shtetërore — 194-195.  
 Siri — 332, 477.  
 Skrapar — 114, 158-159.  
 Somali — 333.  
 Spanjë — 139.

## SH

Sheshi «Skënderbej» — Tiranë — 247.  
 Shkodër — 3-4, 114, 491.

Shkolla e mesme artistike «Jordan Misja» — Tiranë — 36.  
 Shkolla Normale — Elbasan — 34.  
 Shmil (Elbasan) — 392.

## T

Teatri i Operës dhe i Baletit — 29, 247.  
 Tiranë — 114, 196, 245-250, 426, 455.  
 Traktati i Varshavës — 333, 481.  
 Tregu i Përbashkët Evropian — 336.  
 Turqi — 333, 334, 339, 477-478.

## U

Uzina Mekanike Bujqësore — Durrës — 68.

## V

Vatikan — 139.  
 Vendet Arabe — 331, 332, 338, 492.

## Z

«Zekthi» (romani) ~, E. Vojnë — 27.

## L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 54-T ..... V—IX

### 1974

SHKRIMTARËT DHE ARTISTËT JANË NDIHMËS  
TË PARTISË PËR EDUKIMIN KOMUNIST TË NJE-  
RËZVE TANË — Fjala në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH (20 dhjetor 1974) ..... 1—41

PUNA KRIJUESE E POPULLIT DHE VEPRA E PAR-  
TISË T'U SHËRBEJNË PEDAGOGËVE SI BAZË  
PËR PUNËN SHKENCORE — Nga diskutimi në mble-  
dhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (20 dhjetor 1974) 42—49

KËTË BAZË TË SHËNDOSHË PËR TË ECUR PËR-  
PARA E KA KRIJUAR PARTIA — Nga biseda gjatë  
vizitës në ekspozitën «Shqipëria sot» (24 dhjetor 1974) 50—62

NGJARJET QË NA NDODHËN NË USHTRI T'I SHO-  
HIM TË LIDHURA NGUSHITË ME DETYRAT PËR  
REALIZIMIN E PLANIT — Diskutim në mbledhjen  
e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 dhjetor 1974) 63—74

### 1975

T'I FUTEMI THELLË STUDIMIT TË TEORISË SË  
ARTIT USHTARAK — Shënime (9 janar 1975) ..... 75—100

- NË NAFTË NA KANË SULMUAR KURDOHERË  
 ARMIQTË. TA SHIKOJMË MIRË KËTË PROBLEM  
 — Bisedë me shokun Hysni Kapo (3 shkurt 1975) 101—106
- ORGANIZATA E PARTISË NË SEKTORIN E NAFTËS  
 TË KUPTOJË MIRË PËRGJEGJËSITË QË KA  
 DHE TË VIHET NË KRYE TË PUNËVE — Shënim  
 (3 shkurt 1975) 107—123
- TË DHËNA SHQETËSUESE, QË TË BËJNË TË MEN-  
 DOSH SE NË NAFTË KA PUNË ARMIQËSORE —  
 Bisedë me shokun Paskal Sinani (4 shkurt 1975) 124—135
- PUNËTORËT TË PUNOJNË, TË JENË VIGJILENTË,  
 TË BËJNË KRITIKË E AUTOKRITIKË — Bisedë me  
 shokun Paskal Sinani (6 shkurt 1975) 136—152
- INTELEKTUALËT DHE TEKNIKËT TË NE JANË  
 NDIHMËSIT E KLASËS PUNËTORE — Bisedë me  
 sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të disa rre-  
 theve të vendit (7 shkurt 1975) 153—165
- SECILI TË KRYEJË DETYRËN NË PËRPUTHJE  
 ME PARAMET DHE ME NORMAT E VENDOSURA  
 — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit  
 Popullor të RPSH (28 shkurt 1975) 166—172
- INTERPRETIMI DREJT I DISPOZITAVE LIGJORE  
 NUK LEJON QËNDRIME SUBJEKTIVE E ARBITRA-  
 RE — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Ku-  
 vendit Popullor të RPSH (28 shkurt 1975) 173—178
- PROBLEMET NUK ZGJIDHEN VETËM NGA APA-  
 RATET — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të  
 KQ të PPSH (3 mars 1975) 179—191

<p>TË NDIHMOHET EFEKTIVISHT FSHATI PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT TË NENËS DHE TË FËMIJËS — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (3 mars 1975) .....</p>	192—200
<p>NË KUSITË TË QETA DEMOKRACIA E PARTISË ËSHTË MË E GJERË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (3 mars 1975) .....</p>	201—206
<p>DUHEN LUFTUAR PA MËSHIRË BUROKRATIZMI, TEKNOKRATIZMI DHE INTELEKTUALIZMI — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (5 mars 1975) .....</p>	207—237
<p>STRUMBULLARI NË USHTRI ËSHTË PARTIA — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (5 mars 1975) .....</p>	236—244
<p>NDËRTIMEVE TONA TË JAPIM TIPARE ME TË VËRTETË SOCIALISTE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (5 mars 1975) .....</p>	245—251
<p>JU PO TREGONI NJË SIEMBULL TË LARTË GATISIMËRIE E PATRIOTIZMI — Letër drejtuar të rejave dhe të rinjve të kooperativës bujqësore «Enver Hoxha» të Bujanit (22 mars 1975) .....</p>	252—253
<p>JO RAPORTE ME FRAZA STEREOTIPE, POR ME PROBLEME KONKRETE — Shënime (26 mars 1975)</p>	254—258
<p>KUADROT KANË ROLIN E TYRE, POR JO TË BËJNË LIGJIN MBI PARTINË — Shënime (26 mars 1975) .....</p>	259—272
<p>PARTIA DO QË NIVELI I JETESËS SË POPULLIT TË JETË I KËNAQSIËM, POR JO TË KRIJOHEN SHITRESA TË FAVORIZUARISH DHE TË BORGJEUARISH — Shënime (28 mars 1975) .....</p>	273—279

MARKSIZËM-LENINIZMI — ARMA E KLASËS PUNËTORE — Shënime (29 mars 1975) .....	280—282
KUADRI DUHET TË EDUKOHET NË SHKOLLËN E KLASËS PUNËTORE — Diskutim në mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë (31 mars 1975) .....	283—306
FORMIMI DHE ZHVILLIMI I BORGJEZISË SË RE TITISTE JUGOSLLAVE — Shënime (1 prill 1975) .....	307—311
T'U BIEM ME SHUFËR TË THANTË TENDENCAVE QË DOBËSOJNË LIDHJET E PARTISË ME MASAT — Shënime (3 prill 1975) .....	312—314
VIJA E PARTISË NË RADHË TË PARË TË STUDIO- HET DHE TË ZBATOHET NË JETË PA GABIME — Shënime (4 prill 1975) .....	315—328
DE PROFUNDIS TJETËR PËR SHITETET E BASH- KUARA TË AMERIKËS — Shënime (8 prill 1975) .....	329—340
LETËRAT NGA POPULLI — ERË E FRESKËT E DE- MOKRACISË SONË SOCIALISTE — Shënime (11 prill 1975) .....	341—349
SHTETI YNË U NGRIT ME GJAK PËR TË QENË DHE PËR TË MBETUR PUSHTET I POPULLIT PU- NONJËS — Shënime (15 prill 1975) .....	350—359
OBORRET NUK PRODHOJNË PËR TREG, POR PËR FAMILJET E KOOPERATIVISTËVE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (24 prill 1975) .....	360—366
NË USHTRI DUHET TË EKZISTOJË MË TEPËR SE KUDO GJETKË NJË DISIPLINË E HEKURT — Udhëzime (15 maj 1975) .....	367—381

<p>TË FORCOJME NDERGJEGJEN SOCIALISTE NË PUNË, TË MPREHIM PARESHTUR VIGJILENCËN REVOLUCIONARE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (21 maj 1975) .....</p>	382—407
<p>PARTIA DHE SHTETI I DIKTATURËS SË PROLETARIATIT MBROJNË KURDOHERË INTERESAT E POPULLIT DHE TË SOCIALIZMIT — Fjala e mbylljes në Plenumin e 7-të të KQ të PPSH (29 maj 1975) .....</p>	408—485
<p>KONTROLLI I MADH I PARTISË DHE I MASAVE I PRET RRUGËN BUROKRATIZMIT — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (30 maj 1975) .....</p>	486—493
<p>PUNA ARMIQËSORE NË EKONOMI ËSHTË E BASHKËRENDUAR ME VEPRIMTARINË ARMIQËSORE NË USHTRI DHE NË IDEOLOGJI — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (30 maj 1975) .....</p>	494—498
<p>Treguesi i lëndës .....</p>	501
<p>Treguesi i enrave .....</p>	515
<p>Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera .....</p>	521